



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE

TITULLI:

**NDRYSHIMET BASHKËKOHORE NË MENDËSITË E
SHQIPTARËVE PËR VAJZAT DHE GRATË**

Paraqitur në kërkim të gradës shkencore “Doktor”
nga Merita Poni

Udhëhequr nga Prof. Dr. Zyhdi Dervishi

TIRANË, 2016

E DREJTA E AUTORIT

DEKLARATË STATUORE

Në përgjegjësinë time deklaroj se ky punim është shkruar prej meje, nuk është prezantuar ndonjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe korrekt, sipas standardeve të mirëpranuara ndërkombëtarisht.

©2016 Të gjitha të drejtat i rezervohen autorit



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE

TITULLI:

**NDRYSHIMET BASHKËKOHORE NË MENDËSITË E
SHQIPTARËVE PËR VAJZAT DHE GRATË**

Paraqitur në kërkim të gradës shkencore “Doktor” në fushë të
sociologjisë

nga Merita Poni

Udhëhequr nga Prof. Dr. Zyhdi Dervishi

Juria e vlerësimit

- 1.
- 2.
- 3.
- 4.
- 5.

TIRANË, 2016

TITULLI : Ndryshimet bashkëkohore në mendësitë e shqiptarëve për vajzat dhe gratë

ABSTRAKT

Ky studim analizon mendësitë paragjyquese që rëndojnë mbi vajzat dhe gratë në fshat. Studimi synon të evidentojë ndikimin e paragjykimeve tek mundësitë për përparim shoqëror, arsimor dhe ekonomik të vajzave dhe grave. Studimi i referohet mënyrës së jetesës së vajzave dhe grave dhe mendësive shoqërore mbizotëruese për aftësitë e tyre, në mjedisin rural të Farkës (Prefektura e Tiranës). Në studim është përdorur metoda sasiore për mbledhjen e të dhënave empirike dhe metoda cilësore për pasurimin e tyre me përjetimet vetjake të vajzave dhe grave që u intervistuan pas anketimit. Janë anketuar 672 vajza dhe gra banore të Farkës, të moshës 18 vjeç – 70 vjeç. Për përpunimin e të dhënave sasiore u përdor paketa e përpunimit të të dhënave sasiore SPSS, ndërsa për përpunimin e të dhënave nga intervizitimi u përdor analiza tematike, që i përputhi të dhënat cilësore me temat e ngritura nga kërkimi empirik. Të dhënat e kërkimit pasqyrojnë gjendjen e tyre si të paragjykuara në mjedisin e sotëm fshatar dhe reagimet e tyre ndaj paragjykimeve. Sipas të dhënave të studimit, del se mjedisi shoqëror në fshat është mjaft i rënduar me paragjykime kundrejt vajzave dhe grave. Paragjykimet që dëmtojnë më shumë vajzat dhe gratë në fshat janë ato mbi karakterin, personalitetin, moralin, kapacitetin intelektual dhe aftësitë për punë. Pjesa më e madhe e paragjykimeve burojnë prej roleve sociale të vajzave dhe grave, të lidhura kryesisht me funksionet e riprodhimit, shërbimit dhe të përkujdesjes. Në fshat, vajzat përballen me paragjykimet që në moshën shkollore. Më pas, paragjykimet i ndjekin ato në jetën familjare, kur martohen dhe bëhen nëna, duke ua shndërruar mjedisin familjar, nga një vend që duhet t'u sigurojë qetësi dhe mbrojtje, në një mjedis abusiv, në të cilin paragjykimet veprojnë më fort, duke shkaktuar tek ato përjetime negative. Paragjykimet i shoqërojnë vajzat dhe gratë edhe në marrëdhëniet e punës. Ato bëhen shkak për nënvlerësimin e aftësive profesionale dhe kapacitetit intelektual të tyre dhe i pengojnë të përparojnë në karrierë, të marrin poste drejtuese dhe të ndërmarrin iniciativë sipërmarrëse. Një pjesë e vajzave dhe grave kanë përjetuar një dëshpërim të thellë prej sulmeve paragjyquese.

FUSHA E STUDIMIT: Sociologji gjinore

FJALË KYÇE: *mendësi paragjyquese, fshat, stereotipe gjinore, rol shoqëror, arsim, familje, punë, karrierë profesionale.*

TITLE: The contemporary changes of the Albanian mentality on girls and women

ABSTRACT

This study explores the gender stereotypes against girls and women in the rural context. The scope of the research is to provide evidence on the negative effects of the gender stereotypes in the opportunities of girls and women to prosper in social, educational, economic and familial environments. The research has analysed the reality of women and girls living in a patriarchal context full of cultural norms that regulate the social role of women in the private and public space. The research is conducted in the rural area of Farkë (Tirana District). The research has made use of the combined methodology, quantitative and qualitative and their instruments. The survey was used for gathering of the empirical data, and the in-depth interview was used to enrich the statistical information with the narratives of the women and girls. The study involved 672 participants, of age 18-70 years old. The research empirical data were processed with SPSS and the qualitative information was processed through thematic analysis.

The study findings convey a mirror of the social reality of women and girls as subject of gender stereotypes in the rural context, which is full of prejudices against them. The most common gender stereotypes are about personality, morality, intellectual capacity and abilities. The majority of the stereotypes are based on the social roles ascribed to women that are mainly confined to reproduction, care and service provision to others. In the rural context, the girls face the effects of stereotypes at the early age of schooling, and after in the familial life as women, as mothers and wives. Familial context is very stereotypical, with predefined roles and functions for women in rural economy. The stereotypes render the familial space, from a protective place into a very abusive one, where women and girls are subject of both verbal and physical violence. The working space is gender stereotyped as well. The stereotypes against women devalue the professional abilities and the intellectual capacity of women as workers and hamper their carrier and their entrepreneurship initiatives. The prejudiced women and girls have suffered the negative consequences of the gender stereotypes on them.

STUDY DOMAIN: Sociology of Gender

KEY WORDS: *gender stereotypes social role, rural context, education, family, work.*

MIRËNJOHJE

Për realizimin e këtij studimi ndihmuan shumë vetë, të cilët është e pamundur t'i përmend të gjithë me emra, por që u jam shumë mirënjohëse. Në veçanti, kontribuan për të bërë këtë studim disa persona, të cilët i kushtuan shumë vëmendje kërkesave për kryerjen e tij, që nga projekt-ideja e deri tek gjetjet e kërkimit.

Së pari, falenderoj Ferdinand Ponin, bashkëshortin tim, i cili, me njohjet e shumta dhe respektin e thellë që gëzonte ndër banorët e zones dhe punonjësit e komunës, e lehtësoi shumë procesin e mbledhjes së të dhënave nga terreni. Gjithashtu, bagazhi njohës për karakteristikat nënkulturore të zonës, për heterogjenitetin e banorëve dhe zhvillimin socioekonomik të komunës vlejti shumë për konceptimin e ideve fillestare të projektit kërkimor. Ai lehtësoi edhe gjetjen e të dhënave zyrtare për komunën.

Së dyti, falenderoj dy djemtë e mi, Rei dhe Ralf, të cilëve u kam munguar gjatë kohës që mblidhja, analizojta dhe interpretoja të dhënat e kërkimit. Ata do ta mirëkuptojnë mungesën time kur të shohin përfundimin e këtij punimi dhe sidomos kur të përfundojnë vetë studimet universitare.

Së treti, falenderoj Prof.Dr. Zyhdi Dervishin, udhëheqësin e këtij punimi, të cilit i jam thellësisht mirënjohëse sepse me durim, profesionalizëm dhe prakticitet udhëzoi ecurinë e plotë të studimit, që nga konceptimi e deri tek hedhja e gjetjeve në tekst. Falë profesionalizmit të tij në fushën e kërkimeve sociologjike, ky punim mori trajtën e kërkimit shkencor, duke iu nënshtruar të gjitha etapave të kërkimit social dhe kërkesave për rigozitet shkencor.

Së katërti, falenderoj të gjitha vajzat dhe gratë e Farkës që plotësuan anketata, dhanë intervistat dhe ofruan informacione përmes bisedave të lira, që treguan shumë durim e dashamirësi për realizimin e studimit, për kohën e çmuar që vunë në dispozicion të kërkimit, për çiltërsinë e përgjigjëve dhe për mikpritjen shembullore që treguan ndaj anketueseve.

Së pesti, falenderoj personelin e njësisë administrative Farkë, që mundësoi lidhjet me vajzat dhe grate e njësisë së tyre dhe bëri njoftimet për takimet me anketueset si dhe vuri në dispozicion dy punonjës për të mbështetur procesin e mbledhjes së të dhënave dytësore mbi njësinë, për të dhënat demografike dhe për treguesit e zhvillimit urban dhe ekonomik të njësisë.

Së gjashti, falenderoj kolegët e Departamentit të Sociologjisë, të Universitetit të Tiranës, të cilët ofruan këshilla dhe vërejtje të vlefshme për çështjet kërkimore dhe për interpretimin e të dhënave.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Abstrakti në shqip	iii
Abstrakti në anglisht	iv
Mirënjohje	v
Përmbajtja e lëndës	vi
Lista e tabelave	xi
Lista e figurave	xii

I. HYRJE

1.1. Paragjykimet për vajzat dhe gratë	1
1.2. Parashtimi i problemit	3
1.3. Qëllimi dhe objektivat studimore	6
1.4. Rëndësia e studimit	9

II. METODOLOGJIA

2.1. Strategjia e kërkimit	11
2.1.1. Përcaktimi i fushës së kërkimit	11
2.1.2. Problemi në shqyrtim	12
2.1.3. Literatura e hulumtuar	13
2.1.4. Konceptet kryesore të studimit	14
2.1.5. Burimet dytësore	18
2.2. Metodologjia e kërkimit	19
2.2.1. Metodologjia sasiore	19
2.2.2. Projekti i kërkimit: studim rasti	21
2.2.3. Metoda sasiore për mbledhjen e të dhënave: anketa	22
2.2.4. Pyetjet kerkimore	22
2.2.5. Pyetsori i anketës	23
2.3. Realizimi i studimit	25
2.3.1. Vendi i kërkimit	25
2.3.1.1. Karakteristikat mjedisore	26
2.3.1.2. Popullsia e zonës	27
2.3.1.3. Probleme për pronësinë ndaj tokës	29
2.3.1.4. Ekonomia e zonës	29
2.3.1.5. Kultura materiale	30
2.3.2. Kampioni i kërkimit	31
2.3.3. Mbledhja e të dhënave	32
2.3.3.1. Pilotimi	32
2.3.3.2. Anketimi	33
2.3.4. Përpunimi i të dhënave	33
2.4. Kufizime metodologjike	34

III. ANALIZA E TË DHËNAVE DEMOGRAFIKE

3.1. Shtrirja e kampionit të studimit	37
3.2. Përkatësia sipas ndarjes krahinore	37
3.3. Origjina qytetare dhe fshatare	41

IV. PARAGJYKIMET PËR VAJZAT NË SHKOLLË	
4.1. Rëndësia e arsimimit të vajzave dhe grave	43
4.2. Profile dhe probleme të arsimimit të vajzave në Republikën e Shqipërisë	45
4.2.1. ... në periudhën e regjimit socialist totalitar	47
4.2.2. ... përgjatë tranzicionit pasocialist	50
4.3. Arsimimi në Komunën Farkë	52
4.4. Ndikime nënkulturore të paragjykimet për vajzat dhe gratë	53
4.5. Paragjykimet gjatë moshës shkollore për vajzat në Farkë	55
4.6. Paragjykimet për vajzat në shkollën 8-vjeçare	57
4.6.1. Të paragjykuara më shumë nga shoqet	57
4.6.2. Të paragjykuara nga mësuesit	68
4.6.3. Të paragjykuara edhe nga djemtë	72
4.6.4. Të paragjykuara nga të afërmit	74
4.6.5. Të paragjykuara nga fqinjët	81
4.7. Paragjykimet për vajzat në shkollën e mesme	82
4.7.1. Të paragjykura për sjelljen	83
4.7.2. Të paragjykuara për veshjen	86
4.7.3. Të paragjykuara për komunikimin me djemtë	88
4.7.4. Të paragjykuara si të paafta	90
4.7.5. Shpeshësia e paragjytimeve	90
4.7.6. Të paragjykuara më shumë nga shoqet e shkollës	92
4.7.7. Të paragjykuara nga fqinjët	96
4.7.8. Të paragjykuara nga të afërm të fisit të babait	99
4.7.9. Të paragjykuara nga mësueset	100
4.7.10. Të paragjykuara nga shokët	103
4.8. Paragjykimet për vajzat në shkollën e lartë	106
4.8.1. Të paragjykuara për intelektin dhe aftësitë	107
4.8.2. Të paragjykuara për sjelljet dhe komunikimin me të tjerët	108
4.8.3. Të paragjykuara për veshjet	110
4.8.4. Të paragjykuara për origjinën fshatare	110
4.8.5. Të paragjykuara për komunikimet me djemtë	111
4.8.6. Denduria e paragjytimeve	112
4.8.7. Të paragjykuara më shumë nga shoqet	113
4.8.8. Të paragjykuara nga fqinjët	115
4.8.9. Të paragjykuara nga të afërmit	116
4.8.10. Të paragjykuara nga pedagoget	119
4.8.11. Të paragjykuara nga djemtë e kursit	120
4.9. Krahësime të paragjytimeve për vajzat në shkollë	121
4.9.1. Nën peshën e paragjytimeve të shumëllojshme në shkollë	121
4.9.2. Të paragjykuara në shumë drejtime gjatë moshës shkollore	125
V. PARAGJYKIMET PËR VAJZAT DHE GRATË NË FAMILJE	
5.1. Paragjykimet dhe normat e kodifikuara të kulturës	129
5.1.1 Ndikime të kulturës osmane	131
5.1.2. Vajzat dhe gratë: pronë e meshkujve të familjes	133

5.1.3. <i>Dhunimi i grave sipas normave kulturore kanunore</i>	135
5.1.4. <i>Paragjykimi se gratë janë krijesa të djallit</i>	137
5.1.5. <i>Dukuria e virgjinave</i>	139
5.2. <i>Paragjykimet për vajzat dhe gratë gjatë regjimit socialist totalitar</i>	142
5.2.1. <i>Lëvizja për emancipimin e vajzave dhe grave në vitet 1967-1971</i>	143
5.2.2. <i>Paragjykimet mbi punësimin e grave: gruaja e ka vendin në shtëpi?! 145</i>	145
5.2.3. <i>Të paragjykuara si të paafta për drejtim</i>	147
5.2.4. <i>Të shitura në martesë me mblesëri</i>	148
5.2.5. <i>Nën peshën e përgjegjësive familjare</i>	154
5.2.6. <i>Paragjykime me sfond moralizues</i>	156
5.3. <i>Paragjykimet në familjen e bashkëshortit</i>	157
5.3.1. <i>Paragjykuar nga familjarët e të fejuarit</i>	159
5.3.1.1. <i>Fejesa me blerje dhe shkuesi: dashuria si turp!</i>	161
5.3.1.2. <i>Veçimi i vajzave nga djemtë</i>	164
5.3.1.3. <i>Fejesa në moshë të vogël</i>	165
5.3.1.4. <i>Ekzogamia: pengesë për martesat me dashuri</i>	165
5.3.1.5. <i>Prejardhja familjare kriter me rëndësi për fejesën</i>	166
5.3.1.6. <i>Tradita e blerjes së nuses</i>	167
5.3.1.7. <i>Tabuja e virgjërisë</i>	168
5.3.1.8. <i>Moskundërshtimi i vajzës</i>	169
5.3.1.9. <i>E huaj në shtëpi të prindërve</i>	170
5.3.1.10. <i>Të rinjtë e fejuar nuk shikoheshin me njëri-tjetri në fejesë</i>	171
5.3.1.11. <i>Paja e nuses</i>	173
5.3.1.12. <i>Paragjykimet në fejesë nga të afërmit e të fejuarit</i>	174
5.3.2. <i>Shpeshësia e paragjykimeve në familjen e bashkëshortit</i>	175
5.3.3. <i>Përshtatja me normat kulturore për martesën</i>	177
5.3.4. <i>Dasma</i>	179
5.3.5. <i>Shkaqet e paragjykimeve në martesë</i>	180
5.3.6. <i>Të paragjykuara për sjelljen</i>	182
5.3.7. <i>Pozita e nënshtruar e gruas në familje</i>	184
5.3.8. <i>Pozita e gruas jashtë mjedisve familjare</i>	188
5.3.9. <i>Të paragjykuara si të paafta për punë në familjen e bashkëshortit</i>	192
5.3.10. <i>Të paragjykuara për veshjen në familjen e bashkëshortit</i>	195
5.3.11. <i>Paragjykuar për mënyrën e komunikimit</i>	197
5.3.12. <i>Paragjykuar për kujdes të pamjaftueshëm për fëmijët</i>	199
5.3.13. <i>Origjina si shkak i paragjykimeve</i>	202
5.3.14. <i>Të paragjykuara për cilësitë fizike</i>	204
5.3.15. <i>Të paragjykuara në disa fronte njëherësh</i>	205
5.3.15.1. <i>Paragjykuar në fejesë</i>	206
5.3.15.2. <i>Paragjykuar në martesë</i>	208
5.3.15.3. <i>Paragjykuar si nëna</i>	208
5.3.16. <i>Paragjykuar nga fqinjët</i>	210
5.3.17. <i>Paragjykuar më shumë nga vjehrra</i>	211
5.3.18. <i>Vjehrra: më pak paragjykues se vjehrra</i>	217
5.3.19. <i>Paragjykuar nga bashkëshorti</i>	219
5.3.19.1. <i>Intimitet i ndaluar</i>	221

5.3.19.2. Rrahja e gruas	221
5.3.19.3. Vrasja e gruas sipas normave kulturore kanunore	222
5.3.19.4. Ndarja e gruas nga bashkëshorti	223
5.3.19.5. Poligamia: një e drejtë për burrin	225
5.3.19.6. Trashëgimia: përjashtim për gruan	226
5.3.19.7. Paragjykimet e bashkëshortit ndaj gruas	226
5.3.19.8. Veshja si shkak për paragjykimet edhe nga bashkëshorti	228
5.3.20. Të paragjykuara nga kunatat	230
5.3.20.1. ... nga gratë e kunetërve	230
5.3.20.2. ... edhe nga motrat e bashkëshortit	232
5.3.20.3. Kunati: më pak paragjykes	233
VI. PARAGJYKIMET PËR VAJZAT DHE GRATË NË PUNË	
6.1. Papunësia: këputje e hallkës kryesore të integritetit shoqëror	235
6.2. Konfliktet me pronarët në punë: motivet kryesore	238
6.3. Konfliktet me drejtuesit në punë	244
6.3.1. Konflikte nga keqkuptime të rastit	244
6.3.2. Konflikte nga gabimet në punë	245
6.3.3. Abuzime të pronarëve me pagën	245
6.3.4. Paragjykimet për aftësitë: burim konfliktesh	248
6.3.5. Kërkesa abuzive të drejtuesve: burim konfliktesh	248
6.3.6. Konflikte edhe nga ngacmimet seksuale	249
6.4. Shpeshësia e paragjykimeve të drejtuesve	251
6.5. Opinione për punën e kryer nga gratë	253
6.5.1. Më punëtore se burrat	254
6.5.2. Më korrekte se burrat në marrëdhëniet e punës	255
6.5.3. Më modeste për punën që kryejnë	256
6.5.4. Kanë më pak pretendime për pagën se burrat	257
6.5.5. Ankohen më pak për kushtet jo të përshtatshme të punës	260
6.5.6. Janë më pak të korruptueshme	264
6.5.7. Respektojnë ligjin më korrektësisht se burrat	266
6.5.8. Më të prirura për punë vullnetare	266
6.5.9. Përse ndjehen inferiore ndaj burrave në punë?	267
6.6. Paragjykimet në vendin e punës	269
6.6.1. Paragjykimet në institucionet dhe ndërmarrjet publike	269
6.6.1.1. Paragjykuar më shumë nga kolegët e punës	269
6.6.1.2. Paragjykuar edhe nga drejtuesit e njësisë	272
6.6.1.3. Nivele të ulëta drejtimi: intensitet më i lartë paragjykimesh	276
6.6.1.4. Paragjykuar nga vartësit	278
6.6.1.5. Më paragjykuese ndaj njëra-tjetrës se burrat ndaj tyre	279
6.6.1.6. Shpeshësia e paragjykimeve	281
6.6.1.7. Shkaqet e paragjykimeve ndaj të punësuarave	284
6.6.1.7.1. ... edhe si të paafta për punë	284
6.6.1.7.2. Të ngacmuara dhe të paragjykuara	287
6.6.1.7.3. Të paragjykuara për mënyrën e sjelljes	289
6.6.2. Paragjykimet për të punësuarat në firmat private	290

6.6.2.1. Paragjykuar më shumë prej drejtuesve se prej kolegëve	290
6.6.2.2. Gratë më paragjykuese për njëra-tjetrën	292
6.6.2.3. Drejtueset gra janë më paragjykuese se ata burra	293
6.6.2.4. Shpeshtësia e të paragjykuarit në firmat private	296
6.6.2.5. Shkaqet e paragjykimeve	297
6.6.2.5.1. Të paragjykuara si të paafta	297
6.6.2.5.2. Të paragjykuara për mangësi në komunikim	298
6.6.2.5.3. Të paragjykuara për mënyrën e veshjes	299
6.6.2.5.4. Të paragjykuara edhe kur ankohen për pagën	300
6.6.3. Paragjykimet për të vetpunësuarat si pronare	301
6.6.3.1. Paragjykuar nga rivalët e njësisve private analoge	301
6.6.3.2. Paragjykuar nga të njohurit	302
6.6.3.3. Paragjykuar nga vartëset	303
6.6.3.4. Shpeshtësia e paragjykimeve	304
6.6.3.5. Shkaqet e të paragjykuarit	305
VII. VETVRASJA SI FORME REAGIMI NDAJ PARAGJYKIMEVE	
7.1. Vetvrasja: rrugë shpëtimi nga paragjykimet	309
7.2. Këndvështrimi dyrhemian për vetvrasjen	310
7.3. Vetvrasjet në Republikën e Shqipërisë sipas të dhënave zyrtare	312
7.4. Vetvrasja si një formë reagimi ndaj paragjykimeve të shumfishta	317
7.3.1. Moshë më e rrezikuar për vetvrasje	319
7.3.2. Niveli arsimor: cilat janë më të rrezikuara të vetvriten?	324
7.5. Në ndihmë të vajzave dhe grave që mendojnë të vetvriten	333

REFERENCAT	xiii
SHTOJCA	xix

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Statistika të arsimit: nxënës në shkollën e mesme gjatë viteve: 2000-2013	51
Tabela 2: Studentë të diplomuar në vite sipas gjinisë: 2008-2013	124
Tabela 3: Vetvrasjet nga viti 1999-2008	309
Tabela 4: Llojet e vetvrasjeve për periudhën 1999-2004	310
Tabela 5: Llojet e vetvrasjeve të kryera nga femrat në vitet 1999-2004	311
Tabela 6: Numri i vdekjeve nga aksidentet sipas nëngrupeve, për vitin 2007	313

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Harta e Qarkut Tiranë	26
Figura 2: Harta e Farkës	27

KAPITULLI I

HYRJA

1.1. Paragjykimet për vajzat dhe gratë

Paragjykimet për gratë kanë një histori të gjatë. Edhe pse kanë ekzistuar në të gjitha shoqëritë, paragjykimet për gratë kanë shfaqur intensitet të ndryshëm në kohë dhe vende të ndryshme, varësisht nga stadi i zhvillimit të shoqërive. Paragjykimet për vajzat dhe gratë kanë qenë lidhur me rolet sociale dhe pritshmëritë shoqërore për përmbushjen e tyre (Martin, P., 2003:350). Roli social i gruas është konsideruar ngushtësisht i lidhur me familjen, ekonominë shtëpiake dhe përkujdesin për fëmijët. Meqë vendi më i përshtatshëm për gruan është konsideruar hapësira private, përfaqesuar nga shtëpia dhe familja, hapësira publike për angazhim shoqëror dhe ekonomik ka qenë më e kufizuar (Basow, S., 2003:137). Rolet sociale dhe stereotipet që i bashkëshoqërojnë ato janë konstrukte shoqërore të ndërtuara shoqërisht përgjatë zhvillimit të kulturës. Ato mësohen përmes procesit të shoqërizimit brenda institucioneve shoqërore si familja, shkolla, puna, feja dhe pushteti dhe ushtrohen përgjatë gjithë ciklit të jetës (Giddens, A., 1997: 84-94). Pavarësisht se nuk u janë dhënë role sociale në shumicën dërrmuese të jetës publike, gratë në të gjitha shoqëritë janë përpjekur të afirmohen përtej sferës private dhe të përmbushin edhe role të tjera të dobishme shoqërore përveç përkujdesit, megjithë pengesat e vendosura kundër tyre prej paragjykimeve.

Ky studim ka në fokus pikërisht paragjykimet për gratë në kontekstin kulturor dhe social, në sferën private dhe publike. Studimi është bërë me gratë e zonës së Farkës, komunë e qarkut të Tiranës, dhe gjetjet u përkasin kryesisht atyre, por në shkallë të caktuara mund të kenë vlefshmëri edhe për gratë në kontekstin aktual kulturor në Shqipëri. Studimi jep një panoramë të paragjykimeve për gratë përgjatë periudhës së tranzicionit pas-socialist. Paragjykimet vendosin

pengesa të shumta kulturore për arritjet e vajzave dhe grave në planin personal dhe si grup shoqëror. Pengesat mund të variojnë që nga nënvlerësimi i aftësive e deri tek nënrenditja e grave si shtresë më e ulët sociale që Simone de Beauvoir do ta cilësonte si “seksi i dytë” (de Beauvoir, S., 20023:425). Pasojat e paragjyqimeve për gratë janë të shumta dhe rezultojnë në pabarazi të thella mes grave dhe burrave në shumë aspekte të jetës, dhe kryesisht në pasuri, status dhe ndikim shoqëror, pasi vetë përkatësia gjinore cilësohet prej studiuesve si një prej shembujve më domethënës të shtresëzimit shoqëror (Giddens, A., 1997:227). Dallimet në pasuri dhe status janë ngushtësisht të lidhura edhe me një lloj tjetër të diferencimit shoqëror, me përjashtimin nga sfera influente e pushtetit publik që ushtrohet përmes pjesëmarrjes në politikë. Ndikimin e paragjyqimeve përçmuese për aftësitë drejtuese të grave, në vendin tonë, e ka përmbledhur në mënyrë tepër argumentuese sociologu Zyhdi Dervishi i cili shprehet se: “... përvoja tregon se gratë, të mënjanuara nga jeta shoqërore dhe politike, ... në moshën e pjekurisë e kanë të vështirë, ose më saktë, të pamundur të aktivizohen në jetën politike, sepse veç të tjerash, angazhimi në punët rraskapitëse në ekonominë shtëpiake i dekalifikon pothuajse të gjitha gratë në atë shkallë, sa që ato nuk mund të përditësohen me zhvillimet bashkëkohore edhe në fushën politike” (2001:107).

Si pasojë e paragjyqimeve të shumta, angazhimi publik i grave është frenuar, në kundërshtim me zotimet politike të Republikës së Shqipërisë për të qenë vend anëtar i Bashkimit Europian, ku rritja e pranisë publike të vajzave dhe grave dhe barazia gjinore, si shprehje e nivelit të demokracisë në vend, përbën një ndër përparësitë që lipsen përmbushur si vend kandidat (European Commission, 2013:9). Që vendi ynë të përparojë, për t’u bërë pjesë e bashkësisë së vendeve europiane, lipset një ndryshim rrënjësor kulturor në mendësitë paragjyquese dhe qëndrimet diskriminuese ndaj vajzave dhe grave. Angazhimi i grave në sferën familjare kurrësesi nuk përkthehet në mungesë zotësie për të pasur angazhime publike dhe as nuk shpreh mungesë interesi apo dëshirë nga ana e tyre për t’u marrë me veprimtari shoqërore, ekonomike dhe politike jashtë ekonomisë familjare. Në një anketim të kryer nga sociologu Zyhdi Dervishi me gratë në fushatën zgjedhore për deputetët e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të qershorit 2009, të pyetura se sa dëshironin ato të përfaqësoheshin në organet e pushtetit qendror, rezultoi se 47.7 për qind ishin dakord për përfaqësimin 30 për qind sipas minimumit të kuotës ligjore, 34 për qind mendonin se duhej të përfaqësoheshin njësoj sa burrat dhe rreth 15 për qind mendonin se duhej të kishte më shumë gra se sa burra në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë (2011:247).

Natyrisht shqetësimi i grave për mirëqenien e familjes përbën një vlerë të madhe shoqërore me dobi të pallogaritshme për qëndrueshmërinë dhe kohezionin e familjes. Në një shoqëri me nevoja të shtuara si për individin dhe për familjen, mospunësimi i grave jashtë ekonomisë familjare nuk është shumë frytdhënës për ekonominë e familjes. Prandaj, pjesëmarrja e grave në tregun e punës, për të siguruar të ardhura për familjen është një domosdoshmëri. Sado kufizues të jetë roli i paragjyqimeve në angazhimin ekonomik të grave jashtë ekonomisë familjare, nevojat ekonomike të familjes kanë tendencë ta zbehin ndikimin e paragjyqimeve. Vetë angazhimi ekonomik dhe profesional i grave në tregun e punës ka bërë që paragjyqimet për aftësitë profesionale, drejtuese dhe manaxheriale të grave të veniten.

1.2. Parashtimi i problemit

Paragjyqimet për gratë janë një shqetësim i vazhdueshëm për kërkimin shkencor në studimet sociologjike për gjininë. Zakonisht, vendin më të madh në morinë e studimeve gjinore e zenë ato që vijnë nga shkencat sociale, për t'i dhënë një shpjegim social, kulturor e psikologjik dallimeve gjinore, por nuk mungojnë edhe studimet nga fusha e shkencave të natyrës si biologjia dhe mjekësia që përpiqen të japin përgjigje shkencore për ndryshimet mes gjinive. Studimet e deritanishme, të ndërmarra nga shkencat e natyrës, nuk kanë gjetur shkaqe biologjike ose natyrore që të justifikojnë shtresëzimin gjinor dhe pabarazitë mes gjinive me shkaqe të brendshme të lindura ose të dhëna në materialin gjenetik, përveçse dallimeve në anatomine riprodhuese dhe dallimeve fizike në peshë, gjatësi dhe force fizike, për të cilat ka diskutime sepse një pjesë e studiuesve ia dedikojnë këto dallime kryesisht angazhimeve të ndryshme në veprimtari fizike (Basow, S., 2003:67; Giddens, A., 1997:165). Zbulimet shkencore kanë gjetur me shumë ngjashmëri se sa dallime në shkallën e njohjes dhe afeksionit për të dyja gjinitë. Më shumë dallime në shkallën e njohjes dhe ndjeshmërisë ka mes të gjithë individëve, pavarësisht gjinisë, se sa mes femrave dhe meshkujve, pasi gjinia nuk ka lidhje me këto aftësi. Shfaqja e emocioneve në publik (për vajzat) dhe shprehja pa ndrojtje e agresivitetit për vetafirmim intelektual e fizik (për djemtë) janë më shumë rrjedhoja të ndikimit kulturor të të mësuarit social, sipas të cilit vajzat edukohen të jenë “të ndjeshme” ndërsa djemtë të bëhen “të zotët”. Studimet

gjinore të profilizuara venë në dukje se janë kulturorë faktorët që përcaktojnë rrugëtime të ndryshme për vajzat dhe djemtë në jetën si të rritur.

Paragjykimet për vajzat dhe gratë kanë frenojnë çlirimin e energjive krijuese të tyre si dhe kufizojnë ndihmesën e tyre për zhvillimin e shoqërisë. Veçanërisht, për mjedisin shoqëror shqiptar, sociologu Zyhdi Dervishi shprehet se: “paragjykimet për gratë kanë tejngopur gjithë atmosferën e shoqërisë shqiptare dhe si një masë xhelatinoze e padukshme, pengojnë angazhimin e vajzave dhe grave në jetën politike” (2011: 18). Megjithë praninë e madhe të mjegullnajës së paragjyqimeve në shoqërinë shqiptare, studimet sociologjike janë relativisht të pakta. Pavarësisht numrit të kufizuar të studimeve të thelluara gjinore, ka një numër të konsiderueshëm raportesh që pasqyrojnë gjendjen e grave në Republikën e Shqipërisë, ku theksi vihet tek prania dhe pasojat e paragjyqimeve në jetën e tyre familjare, veprimtaritë shoqërore dhe angazhimet ekonomike e politike.

Paragjykimet për gratë janë shprehje e perceptimit shoqëror për aftësitë e grave dhe ndikojnë në realizimin e mundësive vetjake të tyre. Në këtë kuptim, paragjykimet lipsen parë lidhur ngushtë me perceptimet shoqërore të ndikuara thellësisht nga elementet kulturorë të mjedisit shoqëror në të cilin zhvillohen. Kultura shërben si një gjenerator i fuqishëm për agjencitë shoqërizuese që përçojnë tek pjesëtarët e së njëjtës kulturë normat dhe vlerat morale të asaj shoqërie. Procesi shoqërizues i ekspozon të gjithë individët, që në lindje ndaj formësimit kulturor, pavarësisht gjinisë së tyre, e për këtë arsye ky studim merr në konsideratë jo vetëm paragjykimet që mbartin burrat për gratë, por edhe paragjykimet që kanë gratë për veten dhe ndaj njëra-tjetrës (Bronwyn, D., 2002:103). Në këtë studim, gratë analizohen në të dyja rolet: si viktima dhe si mbartëse të paragjyqimeve. Gjithashtu, duke marrë parasysh faktin se paragjykimet janë konstrukte sociale dhe jo të dhëna njëherë e përgjithmonë, ky studim trajton edhe mundësitë dhe dinamikën e ndryshimit të paragjyqimeve.

Jo vetëm kultura e vendit në përgjithësi, por edhe nënkultura në veçanti ndikon në shkallën e paragjyqimeve për gratë. Në zonën ku është kryer studimi, elementët nënkulturorë të zonës janë përzier me element të nënkulturave të tjera të mbartura nga familjet e ardhura në zonë si pasojë e migrimit të brendshëm. Kësaj përzierje nënkulturore i mbivendoset edhe difuzioni kulturor që përcillet në zonë nga të afërm të banorëve të zones që janë emigrantë jashtë shtetit e që vijnë të qëndrojnë herë pas here në zone dhe që ruajnë komunikim të vazhdueshëm me

familjen e origjinës. Studimi reflekton në menyrë rigorozë ndikimin që kjo mbivendosje kulturore ka në evoluimin e paragjytimeve për gratë në zonën e Farkës.

Megjithë ndryshimet strukturore të ekonomisë dhe ndryshimet politike që kanë pasuar shpërbërjen e regjimit socialist, paragjykimet për gratë vazhdojnë të jenë rezistente ndaj ndryshimeve. Rezistenca kulturore që shprehet përmes ruajtjes së normave konservatore ndaj paragjykimet dhe diskriminimit për vajzat dhe gratë. Varësia ekonomike dhe niveli i ulët i ndërhyrjes së organizmave shtetërore në sferën e marrëdhënieve private, për të marrë në mbrojtje interesat e gruas, e kanë ekspozuar këtë të fundit ndaj formave të shumta të diskriminimit. Për më tepër, që pas vitit 1990, në zonën ku kryhet studimi ka një prani të shtuar të familjeve të zhvendosura nga krahina të tjera, në kërkim të një jete më të mire, pranë kryeqytetit. Prania e të ardhurve dhe mosnjohja me vendasit ka ndikuar në rritjen e vigjilencës së ndërsjellë të të dyja grupimeve ndaj sjelljes së vajzave dhe grave që shprehet më së shumti në marrjen në kontroll të lëvizjeve jashtë shtëpisë, shoqërimin jashtë shtëpie vetëm me meshkuj ose të afërm të familjes, ndalimin e shoqërimit me meshkujt me të cilët nuk kanë lidhje fisnore, e deri në izolim shtëpiak. Edhe pse ushtrohet “në interes” të nderit të vajzave dhe grave, kontrolli i tyre nga meshkujt ka shkaktuar probleme serioze për të drejtat e vajzave dhe grave siç janë: braktisja e shkollës, pengimi i iniciativës private ekonomike, mungesa e lirisë së zgjedhjes e deri kufizimi i mundësive për punësim.

Paradoksalisht, në vend që të ofronte mundësi integrimi në jetën kryeqytetase, migrimi ka çuar në izolim shtëpiak të grave të ardhura. Gjithashtu, qëndrimet e vendasve dhe mendësitë e të ardhurve kanë çuar në grupim të tyre sipas përkatësisë krahinore. Hermetizimi është një fenomen i njohur që shoqëron etnocentrizmin. Gjatë procesit të izolimit relative, grupet krijojnë kufij mes tyre dhe i ruajnë këto kufij ndarës me anë të mekanizmave të përjashtimit që përfshijnë kufizimin e ndërmartësive midis grupeve, kontakteve sociale dhe ndarjen fizike në lagje (Giddens, A., 1997:225). Gjithashtu, kur zhvendosen pranë zonave urbane, të ardhurit e rinj priren të vendosen në afërsi të banorëve të nënkulturave fqinje dhe me prejardhje të afërt gjeografike duke formuar nënbashkësi të reja (Fisher, Claude, 1976: 544). Përveç paragjytimeve ekzistuese, gratë dhe vajzat, kryesisht ato të ardhura janë vënë nën shënjestrën e paragjytimeve të reja që kanë për bazë përkatësinë krahinore dhe nënkulturore.

Pozita e paragjykuar e grave bashkëshoqërohet edhe me vështirësi ekonomike, sidomos për të ardhurat. Gratë janë kryesisht të angazhuara në ekonominë familjare në punë bujqësore

dhe blegtorale. Toka, që varion nga një bahçe e mbjellë me perime për konsum familjar e deri tek parcelat me kultura të ndryshme bujqësore si ullinj, misër, qepë, lakër, domate, etj, si dhe bagetitë janë në pronësi të bashkëshortëve të tyre. Edhe pse janë kontribueset kryesore në këto veprimtari, gratë kanë pak mundësi të administrojnë të ardhurat që vijnë nga tregtimi i prodhimeve bujqësore e blegtorale, pasi këto tregtohen prej bashkëshortëve të cilët marrin edhe shpërblimin financiar. Një pjesë tjetër e grave të punësuara në njësitë e shitjes së mallrave të konsumit, në bar-kafenetë dhe restorantet në pronësi të familjarëve të tyre, punojnë gjithashtu nën mbikqyrjen e burrave të familjes dhe nuk kanë akses tek fitimet. Në të dyja rastet, si kur punojnë tokën ashtu edhe kur punojnë në sferën e shërbimeve të ndryshme të familjes, gratë nuk kanë marrëdhënie të formalizuara pune dhe kur konfliktohen me punëdhënësit e familjes nuk kanë se ku të ankohen. Duke qenë se konteksti familjar dhe shoqëror janë faktorë përcaktues në pozitën e grave dhe ndikojnë në nivelin e paragjykimeve ndaj tyre, studimi lokalizohet pikërisht në një mjedis të mirëpërcaktuar dhe në ndërthurjen e faktorëve kulturorë dhe shoqërorë për të pasqyruar pozitën e grave në zonën e Farkës.

1.3. Qëllimi dhe objektivat: Përse një studim në zonën e Farkës?

Farka është zgjedhur si vend studimi për një mori arsyes, ku ndër më kryesoret veçohen: *Së pari*, përse i përket ndërthurjes së elementeve rurale me ato urbane, Farka paraqet një realitet jo fort të zakonshëm, pasi fshatrat e dikurshëm po transformohen në qendra urbane jo vetëm nga pikpamja e zhvillimit ekonomik, por edhe nënkulturor. Farka është një ndër 16 komunat e rrethit të Tiranës. Afërsia e drejtëpërdrejtë me qytetin e Tiranës ka bërë që, më shumë se sa komunat e tjera, Farka të shndërrohet në një zgjatim urban të Tiranës që ka edhe numrin më të lartë të popullsisë urbane në Republikën e Shqipërisë, 70 për qind krahasuar me 53.5 për qind të popullsisë urbane në vend (INSTAT, 2011: 20). Gjithësesi, Farka përfshihet në zonën rurale të rrethit të Tiranës dhe kjo për arsye se paraqet ende një vijimësi të zhvillimit tradicional bujqësor që ka trashëguar prej së shkuarës dhe që vazhdon ende të jetë një veprimtari kryesore ekonomike për komunën. Përveç afërsisë me kryeqytetin, me të cilin kufizohet në veri, Farka është zgjedhur edhe për një arsye tjetër studimore: popullsia e Farkës përbën rreth 12 për qind të popullsisë rurale të rrethit të Tiranës dhe rradhitet e treta për nga shtesa e popullsisë pas komunës Kashar

dhe Paskuqan, ku ka përqëndrime të larta të popullsisë imigruese nga qarqe të tjera të vendit. Nga viti 1990 deri në vitin 2013, Popullsia e Farkë është shtuar gati dy herë e gjysëm, nga 10.000 banorë në 1990 në 22.633 banorë në 2013 (INSTAT, 2013:21). Sipas të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile (DPGJC), popullsia e Farkës në 2013 është 12.359 banorë, pra rreth 10 mijë banorë më pak se sa raportimi i INSTAT. Shtesa e popullsisë prej mbi 10 mijë banorësh në Farkë nuk figuron në regjistrin e gjendjes civile pasi në këtë regjistr shënohen vetëm banorët e regjistruar, ndërsa banorët e paregjistruar, siç është rasti i 10 mijë banorëve të padukshëm në statistikat e gjendjes civile, janë të regjistruar në njësi të tjera administrative. Ata nuk banojnë më në këto njësi, por as nuk janë shkëputur prej tyre, prandaj nuk ndodhen as në regjistrin e gjendjes civile të komunës Farkë, pasi nuk mund të regjistrohen si residentë në dy vende njëherësh. Shtesa prej 10.000 banoresh paraqet kryesisht popullatën e ardhur në komunën Farkë pas vitit 1990. Shtesa e popullsisë me banorë të rinj, të ardhur nga qarqe të tjera të vendit, paraqet interes studimor pasi, përveç avantazheve që i sjell komunës me fuqi të shtuar punëtore dhe konsumatore, faktorë të rëndësishëm këto për funksionimin ekonomik të zonës, paraqet edhe sfida kryesisht psikokulturore për vendasit dhe për të ardhurit. Pikërisht kjo përzierje e elementeve nënkulturore të popullsisë së komunës Farkë përbën një aspekt të rëndësishëm të kërkimit. Gjithashtu, Farka përbën rreth 12 për qind të popullsisë rurale të rrethit Tiranë dhe është e treta për nga përqindja e popullsisë rurale në nivel rrethi, pas Kasharit dhe Pakuqanit (DPGJC, 2013) dhe të marra së bashku këto tri komuna, për shkak të afërsisë gjeografike me kryeqytetin, përfaqësojnë ekspozimin më të lartë ndaj proceseve urbanizuese në nivel rrethi dhe vendi. Për më tepër, Farka është nyja lidhëse e Tiranës me Elbasanin një tjetër zonë urbane. Gjithashtu, përmes Farkës kalon edhe rruga kombëtare që lidh Shqipërinë e Mesme me atë Juglindore.

Së dyti, si pikënisje për këtë studim ka shërbyer edhe një punim i mëparshëm në fushën e marrëdhënieve gjinore në Shqipëri, i sociologut Zydi Dervishi i titulluar „Gratë në syrin e ciklonit të sfidave dhe perspektiva“ (2001) ku jepet një analizë e detajuar e gjendjes së grave gjatë dhjetëvjeçarit të parë të tranzicionit pasocialist, në vitet 1990-2000. Studimi i këtushëm vendoset një dhjetëvjeçar më pas në kohë dhe në një hapësirë më të kufizuar për dy motive. Nga njëra anë, duke ekspoluar gjendjen e paragjykimëve për gratë një dekadë më pas nga studimi i mëparshëm, ky studim ndërmerr një vlerë krahasuese në aspektin kronologjik. Nga ana tjetër, duke studiuar gjendjen e grave në një lokalitet më të ngushtë se sa studimi i mëparshëm, ky

studim synon të krahasojë gjetjet e studimit të mëparshëm që ka një shkallë përgjithësimi dhe gjithëpërfaqësimi në shkallë vendi me gjendjen e e një grupi më të vogël shoqëror, por që gjithashtu mund të ketë vlera përgjithësuese për shkak të kompozimit nënkulturor të kampionit të studimit. Gjithësesi, të dyja arsyt kontribuojnë në krahasimin e situatës së grave të para dhjetë viteve, përgjatë viteve 1990-2000 dhe me atë të viteve 2001-2014.

Së treti, studimi motivohet edhe për arsye vetjake kërkimore. Duke qenë se banoj në komunën Farkë që prej vitit 2010, jam e përfshirë në ndërveprimin e përditshëm me banorët e kësaj zone, edhe si banore, edhe si studiuese. Duke qenë e ndikuar nga profesioni i sociologjisë, marrëdhëniet e mia me ta dhe të tyre me njëri-tjetrin në komunitet i kam shqyrtuar me një sy më të vemendshëm se sa një vëzhgues i zakonshëm. Njohja nga afër me banorët e zonës më ka dhënë shkas të hulumtoj marrëdhëniet e tyre të përditshme dhe shkallën e ndikimit të faktorëve kulturorë në ndërveprimin simbolik të tyre. Veçanërisht, më ka tërhequr vëmendjen gjendja e grave në komunën e Farkës pasi paraqet një shumëllojshmëri përfaqësuese nga pikpamja identitare, individuale dhe kolektive. Zona ku banoj përbëhet nga popullsi më e hershme dhe nga banorë të ardhur pas vitit 1990. Këta të fundit janë më së shumti çifte dhe familje relativisht të reja që janë përfshirë nga procesi i xhentrifikimit (largimit nga qyteti), në kërkim të një standarti më të lartë jetese, kryesisht nga pikëpamja mjedisore, pasi periferia rurale ofron mjedisë më të përshtatshme, si përsa i përket hapësirës, ashtu edhe ndotjes akustike dhe ndotjeve urbane. Në mesin e këtyre të ardhurve janë identifikuar gra që punojnë në administratën e lartë shtetërore, që janë sipërmarrëse, pedagoge universitetesh ose studiuese, drejtuese, artiste dhe gra që ushtrojnë veprimtari shoqërore. Por, gjithashtu, është vërejtur se jo të gjitha gratë e zonës janë të tilla. Madje konstatohet se një pjesë e madhe e grave, sidomos gratë që janë banore para vitit 1990, kanë dallime të shumta në stilin e jetesës, të veshjes dhe të komunikimit në krahasim me gratë e ardhura në Farkë pas vitit 1990. Kjo shumëllojshmëri mënyrash të jetuari dhe komunikuar më ka nxitur të shqyrtoj se çfarë kanë të ndryshme dhe çfarë kanë të përbashkët gratë e kësaj zone dhe se çfarë ka ndikuar që disa të jenë të realizuara shoqërisht dhe disa të bëjnë një jetë të mbyllur brenda ekonomisë shtëpiake?

1.4. Rëndësia e studimit

Ky studim ka rëndësi për disa arsye, ndër të cilat do veçoja tre më kryesoret.

Së pari, në aspektin e vlerës njohëse, ky studim paraqet një ndihmesë modeste në pasqyrimin e gjendjes së grave dhe sfidave me të cilat ato përballen përgjatë procesit të afirmimit vetjak dhe atij kolektiv, si grup shoqëror. Studime të thelluara në fushën e marrëdhënieve gjinore për një kontekst të veçantë siç është zona e Farkës nuk rezultojnë të jenë ndërmarrë deri më tani.

Së dyti, nga pikëpamja metodologjike, ky studim është rezultat i kombinimit të dy paradigmave kërkimore në studimin social, i paradigmeve sasiore dhe cilësore. E para jep informacion të bollshëm mbi funksionimin e institucioneve sociale si: martesat, familja, edukimi, feja, puna; ndërsa e dyta pasuron kërkimin me qasje më të personalizuar të pjesëmarrëseve në studim, siç janë: ndjesitë, opinionet, qëndrimet, vlerësimet dhe reagimet e tyre ndaj mënyrës së funksionimit të institucioneve sociale dhe rolit të këtyre institucioneve në jetën e tyre. Hulumtimi i problematikës social-kulturore të grave nga dy këndvështrime metodologjike paraqet avantazh kërkimor, si për analizën, ashtu edhe për gjetjet e studimit, pasi njëra strategji kërkimi plotëson tjetrën. Studimet që përdorin metodat e kombinuara të paradigmave kërkimore paraqesin avantazhe të dukshme ndaj përdorimit të një metodologjie të vetme.

Së treti, përse i përket dobishmërisë publike, ky studim ka vlerë për institucionet politikëbërëse, pasi mund të vlejë për hartimin e politikave progjinore dhe gjetjes së rrugëve më efektive për të luftuar rrënjët e pabarazisë gjinore. Kjo analizë përpiqet të shpjegojë shkaqet e paragjyqimeve, gjë që mund të kontribuojë në identifikimin e zgjidhjeve të mundshme për probleme të mprehta sociale që burojnë nga paragjykimet gjinore. Deri më sot, zbatimi i politikave sociale në fushën e barazisë gjinore ka synuar më shumë ndreqjen e pasojave të paragjyqimeve me bazë gjinore se sa shkaqet që ushqejnë paragjykimet, e për pasojë, përpjekjet e deritanishme për të kufizuar dhe tejkaluar pabarazitë gjinore në praktikë kanë dhënë rezultate të pakënaqshme. Lipsen ndërmarrë studime dhe veprimtari praktike për të trajtuar problematikën e diferencave të thella sociale gjinore në themel, pa lënë mënjatë edhe trajtimin e pasojave, në mënyrë që politikat në fushën e drejtësisë sociale me fokus gjininë të japin rezultatet e kërkuara.

1.4. Qëllimi dhe objektivat studimore

Ky studim synon të ekspolojë ndikimet diskriminuese të paragjytimeve gjinore në pozitën shoqërore të vajzave dhe grave. I përqëndruar në zonën e Farkës, në Shqipërinë e Mesme, ky studim synon të hulumtojë situatën specifike të vajzave dhe grave që jetojnë në këtë hapësirë sociokulturore. Për të realizuar këtë qëllim studimor, janë parashtruar edhe objektivat përkatëse si më poshtë:

1. Të hulumtohen llojet e paragjytimeve gjinore që rëndojnë mbi vajzat e gratë dhe përhapja e tyre;
2. Të analizohet ndikimi i paragjytimeve në ndërveprimin e përditshëm dhe në angazhimin e grave në veprimtaritë shoqërore dhe ekonomike;
3. Të vlerësohet ndikimi i institucioneve sociale, agjencive shoqërizuese, kontekstit shoqëror dhe normave kulturore në formimin, transmetimin, ruajtjen dhe përforcimin e roleve gjinore dhe paragjytimeve që i shoqërojnë ato;
4. Të identifikohen pengesat morale që vendosen ndaj vajzave dhe grave në ndërtimin e marrëdhënieve shoqërore dhe vetafirmimin e tyre social si pasojë e paragjytimeve kundër tyre;
5. Të evidentohen përmasat e dëmit që shkaktojnë paragjykimet në plan personal dhe shoqëror për vajzat dhe gratë;
6. Të parashtrohen mundësitë për ndryshim pozitiv të pozitës shoqërore të vajzave dhe grave në të ardhmen, duke evidentuar, nga njëra anë, shkaqet e rrjedhojat e paragjytimeve dhe, nga ana tjetër, faktorët mbështetës për emancipim shoqëror dhe ndryshime kulturore.

KAPITULLI II

METODOLOGJIA

2.1. Strategjia e kërkimit

Strategjia e kërkimit ishte faza gjatë të cilës u përcaktuan hapat konkretë të studimit. Në këtë fazë u qartësua fusha e studimit dhe u formulua problem kërkimor. Për të mësuar se çfarë kërkimesh ishin bërë më parë në këtë fushë dhe për këtë problem, u shqyrtua edhe literatura ekzistuese. Për të saktësuar problemin u përdorën edhe burimet dytësore nga dokumentacioni zyrtar. Në këtë fazë u shpjeguan edhe konceptet kryesore që janë përdorur në studim.

2.1.1. Përcaktimi i fushës së kërkimit

Kërkimet sociologjike po përqendrohen gjithnjë e më shumë në çështjet që lidhen me paragjykimet për vajzat dhe gratë. Paragjykimet gjinore nuk janë shqetësuese vetëm për vajzat dhe gratë që janë viktimë e drejtëpërdrejtë e tyre por për të gjithë shoqërinë. Pyetje të tilla si: Cfarë i bën paragjykimet të jenë kaq rezistente? Përse zhvillimet teknologjike dhe arritjet shkencore nuk i çbëjnë dot stereotipet gjinore? Përse rritja e nivelit të arsimimit nuk i shpëton dot vajzat dhe gratë nga diskriminimi gjinor? janë ende shqetësuese për fushën e studimeve gjinore. Problemet që lidhen me paragjykimet gjinore janë objekt i këtij studimi. Natyrisht, ky studim nuk pretendon të japë përgjigje përfundimtare për larminë e paragjykimeve për vajzat dhe gratë, por gjithësesi paraqet një përpjekje serioze për të analizuar disa prej tyre sic janë: paragjykimet në mjedisin shkollor, familjar dhe në marrëdhënien e punës. Përgjigjet për çështjet kërkimore të

këtij studimi janë një pasqyrim real i të dhënave faktike të mbledhura përmes anketimit dhe bisedave të lira me gra dhe vajza. Duke i qëndruar besnik opinioneve, përjetimeve dhe qëndrimeve të vetë vajzave dhe grave të përfshira në kërkim, studimi ka mundur të saktësojë maksimalisht përgjigjet për pyetjet e ngritura. Për mbledhjen e të dhënave janë përdorur teknika standarte të këkrimit social ku vendin kryesor e ze anketa. Ndërsa për të analizuar materialin e mbledhur është përdorur paketa SPSS dhe grupimi i përgjigjeve në rubrika tematike.

Përpara se të niste kërkimi në terren, studimi u parapri prej planifikimit për procedurën e kryerjes së tij. Përgjatë peshimit të përparësive dhe mangësive që paraqisnin metodat kërkimore për këtë studim, u vendos që anketimi do të ishte metoda më frytdhënëse pasi do të gjeneronte një larmi më të madhe përgjigjesh. Më pas u hartua një strategji kërkimi për mbledhjen e të dhënave në terren si dhe u përcaktuan elementët kryesorë të kërkimit që janë: vendi i mbledhjes së të dhënave, vajzat dhe gratë që do të përfshiheshin në kërkim dhe vecoritë e tyre, koha për mbledhjen e të dhënave, testimi i pyetsorit dhe kalendari i realizimit të kërkimit.

2.1.2. Problemi ne shqyrtim

Ky studim filloi me një problem kërkimor që lidhet me paragjykimet për vajzat dhe gratë. Në fakt, kërkimi u nxit nga pozita aktuale e grave dhe vajzave shqiptare që ndikohet shumë prej paragjykimeve. Për këtë çështje studimet e thelluara sociologjike në Shqipëri janë të pakta dhe nga pikëpamja shkencore akademike do vecoheshin dy të tillë: „*Gratë në syrin e ciklonit të sfidave dhe perspektiva*“ (2001) dhe „*Gratë në turbulencat e mendësive dhe realiteti politik*“ (2010) të realizuar nga sociologu Zyhdi Dervishi. Studimi vjen si nevojë për të plotësuar pamjaftueshmërinë e të dhënave në këtë fushë. Gjithashtu, studimi synon të japë një ndihmesë në njohjen e rolit të institucioneve shoqërore në krijimin dhe përdorimin e paragjykimeve kundrejt vajzave dhe grave.

Pamjaftueshmëria e studimeve të thelluara sociologjike në fushën e paragjykimeve gjinore shoqërohet edhe me mungesë studimesh specifike për zona të vecanta të vendit si krahina, qytete apo fshatra. Edhe pse mund të kenë vlerë përgjithësuese në nivel kombëtar, studimet e deritanishme në fushën e paragjykimeve gjinore nuk pasqyrojnë në mënyrë të detajuar pozitën e vajzave dhe grave në një lokalitet të caktuar. Ky studim u ndërmor në zonën e Farkës, për disa arsye metodologjike, ndër të cilat mosnjohja e realitetit të vajzave dhe grave është

kryesore. Përvec zbulimit të një realiteti të panjohur për paragjykimet ndaj vajzave dhe grave në këtë zonë, studimi mbart edhe një interes tjetër kërkimor që është plotësimi i hendekut në të kuptuarit e shkaqeve të këtij realiteti duke shtruar pyetje jo vetëm se „Cfarë po ndodh“, por edhe“ Përse po ndodh kështu“? Pyetjet kërkimore të këtij studimi janë pikërisht të lidhura me gjetjen e shkaqeve të paragjykimeve dhe jo vetëm me përshkrimin e gjendjes së paragjykuar të vajzave dhe grave. Pyetjet qendrore të kërkimit - *përse vajzat dhe gratë paragjykohen në mjediset shkollore, familjare dhe në punë* - kanë të bëjnë pikërisht me shkaqet e paragjykimeve që ndikohen edhe prej korrelacionit me treguesit demografikë si: mosha, arsimi, statusi martesor, përkatësia nënkulturore/krahinore dhe fetare.

2.1.3. Literatura e hulumtuar

Ky studim nuk vjen i vetëm në arenën e studimeve për paragjykimet për vajzat dhe gratë, pasi problemet e ngritura prej tij kanë dalë edhe si pasojë e hulumtimit të një pune studimore të mëparshme që është bërë në këtë drejtim nga studiues të tjerë dhe ka ndjekur rekomandimet e sugjeruara nga literatura e deritanishme në këtë fushë. Ndër rekomandimet më të rëndësishme është kryerja e studimeve specifike si përsa i përket zonës së kërkimit ashtu edhe problematikave dhe kushteve konkrete të mjedisit kërkimor (Dervishi, Z., 1998:44). Gjithashtu për formulimin sa më të saktë të çështjeve kërkimore, janë konsultuar burime akademike bashkëkohore nga revista shkencore dhe libra profesionalë në fushën e studimeve gjinore. Studimet në këtë fushë të kryera në kohë të mëparshme kanë dhënë shpjegime për mjaft prej shkaqeve dhe pasojave të paragjykimeve në mjedis socio-kulturore, të ndryshme nga ato të këtij studimi. Studimet e deritanishme përbëjnë një material të bollshëm përsa i përket ndikimit të agjencive shoqërizuese në krijimin, mbartjen, transmetimin dhe ruajtjen e paragjykimeve në kultura të ndryshme. Mbështetja tek studimet e hulumtuara ka qartësuar çështjet kërkimore të ngritura në këtë projekt studimor, si dhe ka ndihmuar në përzgjedhjen e metodave më të përshtatshme për kërkimin.

Si çdo kërkim tjetër sociologjik, edhe ky studim nisi me rishikimin e të dhënave të disponueshme në fushën e paragjykimeve për vajzat dhe gratë. Literatura që u shqyrtua u nda në katër grupime: (i) në literaturë sociologjike për çështjet gjinore; (ii) në literaturë për çështje të familjes dhe gjinisë në Shqipëri, në këndvështimin historik, sic janë shkrime të së shkuarës nga autorë të huaj për Shqipërinë dhe kanunet (normat kulturore të sjelljes); (iii) në literaturë nga periudha e

regjimit socialist, si tekste analitike të autorëve shqiptarë dhe analizë e imtësimshme e periodikëve të disa viteve, sidomos të viteve 1967-1971; dhe (iv) në literaturë për paragjykimet. Pjesa dërrmuese e formateve standarte të shkrimit të punimeve akademike udhëzojnë që punimet shkencore të kenë një kapitull më vete për literaturën, në mënyrë që të kuptohet qartësisht se çfarë thuhet në literaturë dhe se çfarë rekomandimesh dalin prej shqyrtimit për kërkime të mëtejshme (Giddens, A., 1997:632). Por, në këtë studim literatura nuk është paraqitur e vecuar në një kapitull të vetëm për të riardhur më pas në kapitullin e gjetjeve. Sikurse pohojnë studiuesit e metodave kërkimore, në shkrimin e një punimi akademik udhëzimet nuk shërbejnë si receta të gatshme për punimin (Bryman, A., 2004:51).

Në këtë studim, për të shmangur përsëritjen e gjetjeve të mëparshme tek pjesa e interpretimit të të dhënave të studimit, u parapëlqye që literatura të shkrihet me gjetjet e studimit duke e vënë atë në funksion të drejtëpërdrejtë të studimit. Kjo ishte një zgjedhje e vështirë, pasi jo vetëm që iu shmang rregullit të zakonshëm të paraqitjes së një kapitulli më vete për literaturën, por edhe sepse shkrirja e literaturës me gjetjet kërkon një nivel më të lartë interpretimi të literaturës në funksion të gjetjeve. Gjithësesi, shkrirja e dy kapitujve në një paraqet një dobi praktike për leximin e punimit dhe i sjell më pranë gjetjeve studiuesit e mëparshëm duke sqaruar lexuesit për mënyrën se si i kanë përcaktuar ata çështjet kërkimore të ngjashme. Gjthashtu, shmang edhe përsëritjen e dyfishtë të autorëve të mëparshëm dhe e bën të panevojshëm përdorimin mbi një herë të citimeve nga literatura ekzistuese. Megjithatë, kriteri shkencor i qartësisht të opinionëve të kërkuesit nga opinionet e studiuesve të mëparshëm është respektuar rigorozisht, duke cituar në mënyrë akademike çdo të dhënë të huazuar nga burime të tjera.

2.1.4. Konceptet kryesore të studimit

Studimi ka përdorur një sërë konceptesh të huazuara nga fusha e studimeve gjinore për ta vënë kërkimin në shtratin e këtyre studimeve. Disa nga konceptet kryesore të studimit janë: gjinia, identiteti gjinor, roli gjinor, stereotipet gjinore, shtresëzimi gjinor, patriarkia, seksizmi, paragjykimet dhe diskriminimi gjinor. Një përkufizim i detajuar i këtyre koncepteve jepet në vjëm.

Gjinia

Seksi dhe gjinia, edhe pse përdoren shpesh në vend të njeri-tjetrit, si seksi mashkull dhe femër, janë koncepte të ndryshme nga njëri-tjetri. Seksi është koncept biologjik që përcakton qeniet njerëzore në meshkuj dhe femra, nga pikëpamja biologjike. Ndërsa gjinia ose përkatësia gjinore është koncept kulturor, një tërësi modelesh dhe sjelljesh të mësuara (Giddens, A., 1997:205). Gjinia është koncept kulturor sepse përcaktohet shoqërisht. Kultura udhëzon anëtarët e një shoqërie se çfarë do të thotë të jesh dhe sillesh si burrë apo si grua, pra shoqëria përcakton dhe vlerëson sjelljen femërore dhe mashkullore. Por, gjinia është edhe koncept psikologjik sepse lidhet me ndjenjat për përkatësinë emocionale të të qenit pjesëtar i njëjës gjini (Basow, S., 2003: 11). Shoqëria përcakton kulturalisht se çfarë është gjinia, ndërsa individi përshtatet psikologjiksht me përcaktimin shoqëror të gjinisë.

Identiteti gjinor

Ndjenjat subjektive të njerëzve për të qenit vajzë/grua ose djalë/burrë dhe sjellja e tyre sipas përcaktimit shoqëror për gjininë përbëjnë identitetin gjinor. Identiteti gjinor mësohet në fëmijëri përmes procesit të shoqërizimit të fëmijës me vlerat, besimet, normat dhe sjelljen e pëlqyeshme nga shoqëria. Shkalla me të cilën individët identifikohen me përcaktimin shoqëror të gjinisë tregon tipizimin seksual ose gjinor të tyre (Basow, S., 2003: 11). Sa më shumë t'i përmbahet përcaktimit shoqëror për gjininë dhe rolin gjinor, aq më i gjinizuar ose i tipizuar seksualisht është një individ.

Roli gjinor

Individët për të marrë pëlqim dhe aprovim shoqëror për qëndrimet dhe sjelljen e tyre u përmbahen rregullave që shoqëria ka përcaktuar si kritere për rolin e tyre social dhe roli është ngushtësisht i lidhur me gjininë. Nëse individët nuk u përmbahen rregullave shoqërore për rolin social atëherë ata përballen me ndëshkim shoqëror si mospëlqim dhe mosaprovim i sjelljes (Basow, S., 2003: 11). Rolet shoqërore lidhen me përmbushjen e detyrimeve shoqërore për individët, përkatësisht sipas gjinisë. Kështu për shembull, roli përkujdesës përcaktohet si shoqërisht i vlefshëm për gratë dhe roli vendimmarrës përcaktohet si shoqërisht i pëlqyeshëm për burrat. Përgjatë ciklit të jetës, individët marrin role shoqërore të ndryshme në varësi të gjinisë dhe moshës.

Stereotipet

Stereotipet janë përgjithësimet kategorizuese për njerëzit për shkak të përkatësisë sociale të tyre ndaj një grupi shoqëror. Stereotipet përhapen në mënyrë universale brenda një kulture dhe mësohen përgjatë procesit të socializimit dhe të mësuarit të roleve shoqërore. Përgjithësimet stereotipizuese janë shumë problematike sepse janë skematizime shumë të thjeshtëzuara dhe të paverifikuara. Stereotipet mund të mos jenë të vërteta jo vetëm për grupin në përgjithësi, por as për ndonjë anëtar të veçantë të grupit që mund të shfaqë cilësi individuale që nuk përputhen me kategorizimin stereotipik. Pasojat rënduese të stereotipeve janë se “Stereotipet fajësojnë pa faj” (Giddens, A., 1997: 176). Të menduarit stereotip i hap rrugë paragjykimëve.

Shtresëzimi gjinor

Shtresëzimi gjinor është produkt i pushtetit, i cili që në fillimet e qytetërimit modern dhe me institucionalizimin e patriarkatit është përqëndruar në duart e burrave. Shtresëzimi nga ana e vet prodhon pabarazi sociale sepse e ndan shoqërinë njerëzore në grupe, ku ata që kanë pushtet grumbullojnë më shumë autoritet dhe kanë më shumë ndikim se sa grupet pa pushtet, që vendosen nën autoritetin e grupit të pushtetshëm. Përveç autoritetit dhe ndikimit shoqëror, grupi me pushtet përvetson edhe burime pasurore materiale si pronat dhe pasuri që shërbejnë për të krijuar pushtet (Lerner, G. 1986: 186). Shtresëzimi gjinor është pabarazi strukturore mes burrave dhe grave, që përbëjnë edhe grupet më të mëdha shoqërore. Përkatësia gjinore është ndër shembujt më domethënës të shtresëzimit (Giddens, A: 2003:211). Aktualisht, nuk ka asnjë shoqëri ku burrat të mos kenë më shumë pasuri, status dhe ndikim se gratë në shoqëri.

Patriarkia

Me patriarkë kuptohet mbizotërimi i shoqërisë nga burrat (Giddens, A: 2003:175). Patriarkia është manifestim i institucionalizimit të mbizotërimit të burrave mbi gratë dhe fëmijët në familje dhe shtrirje e dominimit shoqëror të burrave mbi gratë në përgjithësi. Patriarkia nënkupton që burrat kanë pushtetin në të gjitha institucionet e shoqërisë dhe se gratë janë të privuara nga pushteti. Sistemi patriarkal mbahet prej marrëdhënieve patriarkale që realizohen përmes dominimit të një grupi, të konsideruar inferior (gratë) nga një grup tjetër i konsideruar superior (burrat) të cilët lidhen me njëri-tjetrin përmes detyrimesh të ndërsjellta dhe të drejtash. Gratë si

grup i nështruar shkëmbejnë mbrojtjen dhe mbështetjen ekonomike që u ofrohet prej burrave me nënrenditje dhe shërbime shtëpiake dhe seksuale. Kjo praktikë e ka origjinën në fillesat e familjes patriarkale, në të cilën ati kishte pushtet pothuajse absolut mbi gjithë pjesëtarët e familjes dhe u detyrohej atyre mbështetje ekonomike dhe mbrojtje nga rreziqet, ndërsa familjarët i detyroheshin respekt të padiskutueshëm, nënrenditje dhe nënshtrim patriarkut (Lerner, G. 1986:239). Por, nënrenditja nuk zgjaste përgjithmonë për djemtë, të cilët në moshë madhore, me krijimin e familjes së vet, shndërroheshin në patriarkë. Ndërsa nënrenditja dhe nënështimi i grave dhe vajzave zgjaste për gjithë jetën edhe kur vajzat martoheshin, pasi ndërronin vetëm padron, pra binin nën zotërimin e një burri tjetër. Të gjitha shoqëritë e njohura janë patriarkale megjithëse shkalla dhe karakteri i pabarazisë midis sekseve ndryshon shumë midis tyre (Giddens, A: 2003:175).

Seksizmi

Seksizmi nënkupton ideologjinë e supremacisë së burrave, e superioritetit mashkullor dhe besimeve që e mbështesin atë. Seksizmi dhe patriarkia përforcojnë njëri-tjetrin. Seksizmi ekziston edhe në shoqëritë që e kanë ndaluar me ligj patriarkinë. Një shembull i tillë vjen nga vendet ish-socialiste ku, edhe pse u ndalua me ligj prona private që shërbente si bazë për marrëdhëniet patriarkale, edhe pse kushtetutat garantonin një barazi totale në jetën publike, marrëdhëniet shoqërore dhe familjare ngelën seksiste. Patriarkia prodhohet dhe ruhet në familje pavarësisht faktit se marrëdhëniet patriarkale në sektorë të tjerë shoqërorë ndalohen me ligj (Lerner, G. 1986:239). Në vendet ish-socialiste, ekzistenca e seksizmit si ideologji ka bërë që legjislacioni për të drejtat civile të grave si të barabarta me burrat të mos funksiononte në praktikë.

Paragjykimet

Paragjykimet janë opinione ose qëndrime të mbajtura nga anëtarë të një grupi ndaj një grupi tjetër (Giddens, A., 1997:251). Paragjykimet janë bindje të krijuara më parë për një individ ose grup shoqëror bazuar më tepër në atë që thuhet se sa në fakte reale, bindje që i rezistojnë ndryshimeve madje edhe informacionit të ri. Shumica e njerëzve janë të prirur të krijojnë opinione vlerësuese për njerëz të ngjashëm me ta dhe paragjykime përcmuese apo shpërfillëse për njerëzit e ndryshëm prej tyre nga pikëpamja kulturore, nga pamja e jashtme, etj (Dervishi, Z.,

2008:52). Përgjithësisht njerëzit kanë paragjykime positive ndaj grupeve me të cilat identifikohen dhe paragjykime negative ndaj grupeve të tjera. Paragjykimet shfaqen më së shumti si qëndrime armiqësore dhe urrejtje ndaj një personi, vetëm sepse ky mbart karakteristikat e grupit tjetër (Allport, G., 1979:37).

Diskriminimi

Nëse paragjykimi ka të bëjë me opinionet dhe qëndrimet kundër një individi të një grupi tjetër shoqëror, diskriminimi ka të bëjë me sjelljen (Giddens, A., 1997:251). Diskriminimi lidhet me veprimtari që shërbejnë për të përjashtuar anëtarët e një grupi nga mundësitë që u jepen të tjerëve vetëm sepse janë të ndryshëm. Diskriminimi përcaktohet si trajtim i diferencuar i grupimeve të ndryshme të njerëzve në shoqëri (Dervishi, Z., 2008:53). Diskriminimi shfaqet në shumë forma që variojnë nga indeferentizmi ndaj mohimit të të drejtave civile e deri tek përjashtimi shoqëror për grupe shoqërore të ndryshëm nga shumica e popullsisë. Ndërsa diskriminimi gjinor ka të bëjë me përjashtimin e grave nga postet publike vendimarrëse dhe nga disa lloj profesioneve që ushtrohen prej burrave (Basow, S., 2003: 282).

2.1.5 Burimet dytësore

Për qëllime kërkimore studimi u mbështet jo vetëm në literaturë shkencore por edhe në burime dytësore si informacioni zyrtar dhe statistikat. Infomacioni dytësor u mblodh nga disa burime zyrtare ku, ndër më kryesoret vecohen: INSTAT, Qarku i Tiranës, Komuna Farkë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC). Marrja e të dhënave dytësore ishte një domosdoshmëri për të patur statistika të sakta për popullatën e zonës dhe ndarjen e saj sipas agregatëve demografikë: gjini, moshë, vendbanim, arsimim, punësim. Këto statistika ndihmuan në përcaktimin e kampionit përfaqësues dhe përzgjedhjen e pjesëmarrëseve në kërkim. Gjithashtu, të shënat statistikore ofruan informacion në lidhje me lëvizjet migratore të zonës dhe shtesën e popullsisë ndër vite.

2.2. Metodologjia e kërkimit

Metodologjia e kërkimit orienton rrugëtimin që do të ndjekë studimi për t'iu përgjigjur pyetjeve të ngritura dhe përcakton mjetet e nevojshme për realizimin e kërkimit (Robson, C., 2002:76). Metodologjia i shndërron pyetjet kërkimore në një projekt studimi dhe sqaron çështjet që kanë të bëjnë me realizimin e kërkimit në praktikë. Përbërësit keyesorë të strategjisë së përdorur në këtë studim janë: përcaktimi i qëllimit të kërkimit dhe pyetjeve kërkimore, metodat e përgjedhura për kryerjen e kërkimit, për mbledhjen e të dhënave, për përpunimin e të dhënave, për lidhjet shkakësore mes variablave sociologjike, për sigurimin e vërtetësisë dhe vlefshmërisë së gjetjeve të studimit. Gjithashtu metodologjia përcaktoi edhe kriteret e përzgjedhjes së kampionit të studimit. Në funksion të mbledhjes së të dhënave, metodologjia saktësoi edhe kohën dhe vendin e kryerjes së kërkimit.

Studimet sociale mbështeten në dy lloj metodologjish: në kërkimin sasior dhe në kërkimin cilësor. Gjithësesi, përveç përdorimit të njësrës prej metodologjive, përdoret edhe kombinimi i tyre. Ky studim u mbështet tek metodologjia sasiore për të ekspoluar situatën e vajzave dhe grave të cilat vetëraportuan gjendjen e tyre përgjatë anketimit që ishte metoda kryesore e mbledhjes së të dhënave. Projekti kërkimor u realizua në Komunën Farkë që shërbeu si një rast studimor për të ofruar përgjigje për çështjet kërkimore që lidhen me paragjykimet për vajzat dhe gratë.

2.2.1. Metodologjia sasiore

Kërkimi sasior ka qenë forma kryesore e kërkimit social deri në mes të viteve 1970, kohë në të cilën filloi të rritej ndikimi i metodologjisë cilësore (Bryman, A., 2004:62). Ky studim u mbështet në metodologjinë sasiore të kërkimit social. U përzgjedh kjo metodë kërkimi për asye se shërben edhe për të pasqyruar gjendjen edhe për të investiguar shkaqet e paragjykimeve. Shkaqet për sjelljen paragjykuese mund të jenë personale (si niveli i lartë i konformizmit me stereotipet dhe autoritarizmi i theksuar) dhe shoqërore. Në këtë kërkim theksi është vënë më shumë tek këto të fundit, duke i korreluar me karakteristikat e pjesëmarrëseve në studim si mosha, statusi martesor, arsimi, punisimi, etj.

Kërkimi sasior përmbledh disa hapa studimi si: shqyrtimi i kuadrit teorik, përcaktimi i çështjeve të kërkimit, hartimi i projektit studimor, përcaktimi i koncepteve që do përdoren më dendur në studim, përzgjedhja e vendit, përcaktimi subjekteve, mbledhja e të dhënave, analiza e të dhënave dhe rezultatet e kërkimit. Metodologjia sasiore është ngushtësisht e lidhur me anketimin, i cili përfaqëson ende një ndër metodat më të rëndësishme në fushën e kërkimeve sociologjike (Dervishi, Z., 1998:43). Megjithëse është huazuar si koncept prej shkencave të natyrës, matja në kërkimin sasior nuk ka të njëjtin kuptim si në shkencën e fizikës, pasi sjellja njerëzore nuk ka attribute të matshme fizike. Me matje në shkencat sociale kuptohet vlerësimi i attributeve, karakteristikave dhe vecorive dalluese të njerëzve në lidhje me sjelljen e tyre si grup shoqëror ndaj dukurive shoqërore. Në këtë studim me matje kuptohet përcaktimi dhe vlerësimi i atyre karakteristikave të subjekteve të kërkimit që kanë kuptim për studimin dhe të tilla janë atributet demografike si: mosha, vendbanimi, përkatësia krahinore ose nënkulturore, përkatësia fetare, statusi martesor, niveli i arsimimit dhe punësimi. Këto karakteristika kanë kuptim për studimin sepse ndikojnë në peshën që kanë paragjykimet tek vajzat dhe gratë dhe në reagimet e vajzave dhe grave ndaj tyre. Përmes matjes, në studim, janë saktësuar në mënyrë më të qartë lidhjet (korrelacionet) mes koncepteve si ndikimi i nivelit të shkollimit tek statusi i punësimit ose ndikimi i pavarësisë ekonomike tek „imunizimi“ ndaj pasojave të paragjyqimeve, etj. Koncepte të tilla si opinionet dhe qëndrimet e të anketuarave për aftësitë profesionale të grave, për vlerat më të cmuara morale, për format e reagimit kundër paragjyqimeve janë të pamatshme në kuptimin e ngushtë të fjalës, por duke përcaktuar tregues për matjen e parapëlqimeve, besimeve dhe qëndrimeve në pyetsorin e anketës është bërë e mundur që të përcaktohen shkallë matëse. Këto koncepte janë matur duke përdorur teknika kërkimi të tilla si shkallën e Likertit (me pesë pohime), përgjedhjen parësore të përgjigjeve alternative të pyetsorit, përcaktimin e përgjigjes për nga rëndësia sipas opinionit të përgjigjedhëneses, etj. Qëndrimet mund të maten vetëm në mënyrë të tërthortë duke koduar përgjigjet gjatë përpunimit të të dhënave. Kërkimi sasior paraqet epërsi edhe për shkak se informacioni i mbledhur përpunohet më lehtësisht me anë të metodave matematikore dhe informatizimit, duke kuantifikuar përgjigjet e duke i paraqitur ato në vlera sasiore. Natyrisht, duke pasur parasysh faktin se „numrat nuk flasin vetë“, të gjitha paraqitjet statistikore janë interpretuar.

2.2.2. Projekti i kërkimit: studim rasti

Për mbledhjen e të dhënave ky studim fokusohet në një zonë të vecantë. Studimi i rastit si projekt kërkimor paraqet përparësi sepse studion në thellësi dhe me detaje një dukuri të caktuar në një kontekst specifik. Kjo formë kërkimi po përdoret gjithnjë e më shpesh, pasi sic pohojnë studiuesit e shkencave sociale, prej studimit të rasteve specifike vijnë edhe disa prej studimeve më të arrira në sociologji (Bryman, A., 2004:48). Studimi i rastit po përdoret dendur në kërkimin social jo se paraqet ndonjë mënyrë të pazakontë kërkimi ose sepse eksploron dukuri të panjohura, por sepse ofron një mjedis të përshtatshëm kërkimi për pyetjet që presin përgjigje. Studimi i rasteve hedh dritë mbi kontekste të vogla studimi duke replikuar studime të ndërmarra më parë, në shkallë më të gjerë, me qëllim që të vërtetohet aplikimi i gjetjeve në mjedise më të kufizuara (Bell, J., 2005:10). Studimi i një rasti të vecantë bën një analizë të thelluar të problemit me gjithë kompleksitetin dhe vencantësitë që paraqet konteksti i kërkimit. Studimi i rastit është vecanërisht i dobishëm kur dukuritë sociale studiohen brenda një konteksti specifik (Yin, R., 2009:18).

Për të bërë një analizë të thelluar të problemit, studimi i rastit nuk kufizohet në mënyrë strikte prej shtrëngimeve metodologjike të përzgjedhjes së një metode të vetme për mbledhjen e të dhënave, por përdor cdo metodë që konsiderohet e dobishme për kërkimin. Gjithashtu, studimi i rastit është shumë më specifik dhe i fokusuar se anketimet e gjera dhe në dallim nga studimet përshkruese ai jep shpjegime shkakësore për dukuritë sociale (Gray, D., 2007:124). Për shkak se studimi i rastit përdor dy nga metodat kyce të metodologjisë cilësore, vëzhgimin dhe bisedën e lirë, shpesh ekziston prirja për ta kategorizuar atë si projekt cilësor kërkimi. Por, sic venë në dukje metodistët e shkencave sociale, ky përcaktim nuk është i saktë, pasi studimi i rastit është projekti kërkimor më fleksibël ku bashkohen pa problem të dyja metodologjitë e mëdha: sasiorja dhe cilësorja (Robson, C., 2002:89).

Ky studim vjen në vijim të një studimi të mëparshëm për paragjykimet për vajzat dhe gratë në nivel kombëtar të titulluar „Gratë në syrin e ciklonit: sfida dhe perspektiva“ (2001) të kryer nga sociologu Zyhdi Dervishi. Për më tepër, sic edhe sugjerohet prej studiuesve shqiptarë, në mungesë të studimeve për zona specifike në vendin tonë, studimi i tyre merr rëndësi për kërkimin social (Dervishi, Z., 1998:49). Në këtë studim është përdorur rasti studimor sepse në zonën e Farkës nuk ka studime të mëparshme që tq kenë hulumtuar në thellësi problemin e

paragjykimeve gjinore. Një prej kritikave në drejtim të studimit të rastit si menyrë kërkimi është se nuk lejon përgjithësim. Në fakt, qëllimi i studimit të një rasti nuk është përgjithësimi, por referimi krahasues. Ky studim nuk ka për qëllim që gjetjet e veta t'i shpallë si të vërteta përtej kontekstit ku është kryer studimi.

2.2.3. Metoda sasimore për mbledhjen e të dhënave: anketa

Në këtë studim, të dhënat empirike u mbledhën përmes anketimit, duke përdorur një pyetsor të strukturuar. Anketat u mbushën përmes intervistimit të drejtëpërdrejtë nga anketuesja ose në prani të saj. Pyetjet e anketës u zërthyen në përgjigje alternative prej të cilave përgjigjedhënëset mund të zgjidhnin vetëm një dhe pjesërisht u lanë të hapura përmes alternativës „tjetër“, për të cilën kërkohet një përcaktim, pasi ishin përgjigje të paspecifikuara më parë në anketë. Përdorimi i pyetjeve të mbyllura me përgjigje të fiksuara ndihmoi në mbledhjen e shpejtë të informacionit dhe paraqiti përparësi në kodim dhe përpunim. Gjithësesi, meqë një pyetsor nuk mund të përmbajë të gjitha përgjigjet e mundshme për një pyetje, të anketuarave iu ofrua mundësia të ofronin një përgjigje tjetër. Të gjitha alternativat „tjetër“ u pasuan nga një shpjegim i përgjigjes dhe plotësim me material shkresor shtesë, brenda formatit të pyetsorit dhe më pas u koduan. Gjithashtu, në pyetsor u përfshinë edhe pyetje të hapura që kishin të bënin me informacion specifik që nuk mund të merrej me pyetje të mbyllura dhe as me alternativë të hapur përgjigjesh.

2.2.4. Pyetjet kërkimore

Për të hulumtuar ndikimin e paragjykimeve në jetën individuale dhe në veprimtarinë ekonomike dhe shoqërore të vajzave dhe grave çështjet kërkimore janë konsultuar gjerësisht me literaturën bashkëkohore sociologjike në fushën e gjinisë. Në vijim sqarohen shkurtimisht pyetjet kërkimore:

1. Çfarë ndikimi ka mjedisi social në pëshfaqjen e paragjykimeve? Në këtë pyetje evidentohet roli që kanë faktorët shoqërorë kontekstualë në formimin dhe veprimin e paragjykimeve siç janë: vendbanimi, prejardhja krahinore, arsimimi, statusi ekonomik, statusi martesor, prindërimi dhe perkatësia fetare.

2. Çfarë paragjykimesh rëndojnë më shumë mbi vajzat dhe gratë në zonën e Farkës? A janë vajzat dhe gratë mbartëse apo vetëm viktima të paragjykimeve?
3. Çfarë paragjykimesh rëndojnë më shumë mbi vajzat dhe gratë përgjatë viteve kur studiojnë në shkollë dhe çfarë pasojash sjellin ato?
4. Çfarë paragjykimesh rëndojnë më shumë mbi vajzat dhe gratë përgjatë angazhimit në veprimtari ekonomike dhe çfarë pasojash sjellin ato?
5. Çfarë paragjykimesh rëndojnë më shumë mbi vajzat dhe gratë në mjedisin familjar dhe çfarë pasojash sjellin ato?
6. Si reagojnë vajzat dhe gratë ndaj paragjykimeve për to?
7. Kush u gjendet pranë vajzave dhe grave kur këto paragjykohen dhe si mundohen ato t'i tejkalojnë paragjykimet?

2.2.5. Pyetsori i anketës

Pyetsori përbëhet nga tetë seksione të organizuara në 66 pyetje përmes të cilave janë zbërthyer çështjet kërkimore. Seksionet përmbajnë tematika të caktuara të cilat sqarohen shkurtimisht në vijim.

Seksioni i parë: Të dhënat socio-demografike

Seksioni i parë për të dhënat socio-demografike është organizuar në 11 pyetje të cilat lidhen me gjendjen demografike dhe shoqërore të të anketuarave. Ky seksion ofron të dhëna thelbësore për studimin, pasi përmban informacion mbi variablat e studimit që janë: mosha, vendbanimi, niveli arsimor, përkatesia fetare, përkatesia krahinore, statusi martesor, prindërimi, bashkejtesa familjare dhe sigurimi i të ardhurave në familje. Secili nga këta tregues lidhet drejtëpërsëdrejti me çështjet kërkimore, pasi ata kanë ndikim në shfaqjen e paragjykimeve.

Seksioni i dytë: Të dhënat për punësimin

Ky seksion përmban 5 pyetje që kanë të bëjnë me gjendjen e punësimit të grave dhe vajzave në zonën e Farkës dhe mbi marrëdhëniet që ato kanë me pronarët dhe drejtuesit e njësive ku punojnë. Gjithashtu këto pyetje hedhin dritë edhe mbi situatën e punësimit të grave në ekonominë familjare dhe aksesin e tyre tek të ardhurat që sigurojnë përmes vetpunësimit. Në këtë seksion bëhet edhe një pyetje mbi qëndrimet ndaj aftësive intelektuale dhe profesionale të vajzave dhe grave, e shtruar në formën e pohimeve që maten përmes shkallës së Likert-it.

Seksioni i tretë: Paragjykimet në shkollë

Ky seksion është ndarë në 12 pyetje përmes të cilave investigohen paragjykimet më të zakonshme në mjedisin shkollor për vajzat dhe gratë në të trija ciklet e studimit: në shkollën 9-vjecare, shkollën e mesme dhe shkollën e lartë. Në këtë seksion të anketuarat pyeten se për çfarë janë paragjykuar më shumë dhe nga kush përgjatë kohës që kanë qenë në shkollë. Në formulimin e pyetjeve janë reflektuar edhe ndryshimet që karakterizojnë të anketuarat në periudha të ndryshme kohore, duke i sjellë pyetjet në kontekstin e tyre të shkollimit.

Seksioni i katërt: Paragjykimet në familjen e bashkëshortit

Seksioni i katërt përmban pyetje për paragjykimet që rëndojnë më shumë mbi vajzat e fejuara dhe gratë e martuara në familjen e bashkëshortit. Ndër personat që përfshihen në familjen e bashkëshortit janë njerëzit e familjes së bashkëshortit me të cilët gruaja bashkëjeton si: prindërit, vellezërit e motrat e bashkëshortit dhe të afërm të familjes. Pyetjet interesohen për llojet më të përhapura të paragjykimeve ndaj grave në rolin social të bashkëshortes, nuses, nënës dhe kunatës. Në këtë seksion shtrohet një pyetje e hapur për etiketimet që përdoren më shpesh nga familjarët e bashkëshortit në formën e paragjykimeve kundër grave.

Seksioni i pestë: Paragjykimet në vendin e punës

Seksioni i pestë është organizuar në pesë pyetje që kërkojnë informacion për llojet më të shpeshta të paragjykimeve për vajzat dhe gratë si punonjëse dhe drejtuese në institucionet publike dhe private ose si pronare firmash. Ky seksion ngre pyetje se nga kush dhe për çfarë paragjykohen më shumë vajzat dhe gratë për aftësitë e tyre profesionale. Ndër alternativat e personave paragjykuar janë përfshirë kategoritë: kolegë pune, drejtues, eprorë, vartës, klientë dhe punonjës të administratës shtetërore.

Seksioni i gjashtë: Reagimet ndaj paragjykimeve

Ky seksion përmban tetë pyetje që lidhen me mënyrën se si reagojnë vajzat dhe gratë kur vihen në shënjestër të paragjykimeve, se çfarë emocionesh u shkakton atyre paragjykimi dhe se si do ta përcaktonin ato sjelljen paragjykuese të të tjerëve ndaj tyre. Në këtë seksion shtrohen edhe dy pyetje në lidhje me ndikimin që kanë paragjykimet në çështjet e personalitetit, karakterit dhe moralit dhe nëse ato kanë nxitur mendimeve negative për të mos jetuar ose për t'u larguar nga mjedisi paragjykuar.

Seksioni i shtatë: Vlerat dhe qëndrimet

Seksioni i shtatë përmban gjashtë pyetje për vlerat që çmohen si më të rëndësishmet për vajzat dhe gratë dhe për qëndrimet e tyre ndaj personave paragjykses dhe thashethemeve që përdorin këta kundër vajzave dhe grave. Në këtë seksion ndodhet edhe një pyetje e hapur në lidhje me përcaktimin për paragjykimet dhe paragjyksesit, e cila i le mundësi të anketuarave të shprehin me fjalët e tyre ndjesitë dhe opinionet për paragjykimet.

Seksioni i tetë: Ndhma për t'u mbrojtur nga paragjykimet

Në këtë seksion, të përbërë prej gjashtë pyetjesh, vajzat dhe gratë përgjigjen se kush do t'u vinte atyre në ndihmë nëse do shënjestroheshin prej paragjyksimeve dhe se kujt i besojnë ato më shumë për të shpëtuar nga sulmet paragjyksuese. Tek njerëzit që do mund të afronin ndihmë në rast paragjykimi përfshihen: persona të familjes, të afërm dhe shoqëria e ngushtë.

2.3. Realizimi i studimit

Realizimi i studimit përfshiu disa hallka të cilat përmbushën objektivat kryesore të kërkimit sic ishin: përcaktimi i vendit të kërkimit dhe studimi i karakteristikave të tij, përzgjedhja e kampionit të studimit të përbërë nga vajza dhe gra që shfaqnin karakteristikat e kërkua prej studimit, hartimi i pyetsorit të anketës, mbledhja e të shenave nga terreni dhe përpunimi i të dhënave.

2.3.1. Vendi i kërkimit

Kërkimi u krye në komunën Farkë që është njëra prej 24 komunave të Qarkut të Tiranës. Komuna Farkë është një ndër njësitë vendore më të mëdha të Qarkut të Tiranës, me një sipërfaqe prej 35.2 km². Farka kufizohet ne veri me Bashkinë e Tiranës, në jug me komunën e Petrelës, në lindje me komunën e Dajtit dhe në perëndim me komunën e Vaqarrit. Komuna Farkë, sipas rajonizimit fiziko-geografik bën pjesë në zonën qendrore të Shqipërisë në ultësirën perëndimore. Komuna e Farkës e ka marrë emrin nga fshati Farkë, që është qendra më e hershme e banuar e kësaj zone. Farka është themeluar si njësi administrative vendore në vitin 1992 (Komuna Farkë, 2012:25).

2.3.1.1. Karakteristikat mjedisore


Relievi i zonës është kodrinor-fushor, ku pjesën më të madhe e zenë hapësirat kodrinore me rreth 75 për qind të sipërfaqes me lartësi maksimale deri 250 metra. Zona karakterizohet nga një klimë mesdhetare. Gjithashtu Farka ka edhe një sipërfaqe pyjore prej rreth 370.37 hektarë (ha) që gjendet në kodrat Selitë, Sauk, Mjull-Bathore dhe përreth rezervuarit të Farkës. Bimësia natyrore ka shtrirje të kufizuar në në terrene të pakultivuara të kodrave dhe përfaqësohet nga shkurret mesdhetare, por ka një larmi të madhe bimësh mjekësore. Komuna Farkë ndodhet në pjesen jugore të qytetit Tiranës në një largësi prej 6 km dhe ka një pozitë shumë të përshtatshme gjeografike, pasi nëpër të kalon aksi kryesor i autostradës Tiranë- Elbasan përgjatë të cilit shtrihet zona ekonomike që përfaqëson pjesë të rëndësishme të biznesit dhe industrisë së vendit.



Harta e Qarkut Tiranë

2.3.1.2. Popullsia e zonës

Komuna Farkë përbëhet prej gjashtë fshatrash: Farkë e madhe, Farkë e Vogël, Lundër, Mjull-Bathore, Sauk dhe Selitë. Për shkak të ndryshimeve urbanizuese të zonës së Selitës dhe Saukut si dhe ndryshimeve administrative në territorin e Bashkisë së Tiranës, Selita dhe nje pjesë e Saukut janë përfshirë brenda kufijve administrativë të qytetit të Tiranës; Selita është bërë pjesë e njësisë pesë të Bashkisë Tiranë ndërsa një pjesë e Saukut dhe Mjull-Bathores janë bërë pjesë e njësisë dy të Bashkisë Tiranë¹. Me ligjin e ri Nr. 115 “Për ndarjen administrative territoriale të njesive të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë”, të miratuar më 1 gusht të vitit 2014, ndryshon harta territoriale administrative duke pakësuar numrin e bashkive nga 367 në 61 (neni 1), dhe Farka pritet të shndërrohet nga Komunë në Bashki për shkak të numrit të popullsisë mbi 15 mijë banorë.



Harta e Farkës

¹ Me VKM 170 DATE 30.01.1995 një pjesë e fshatit Selitë ka kaluar në varësi të Njesisë Bashkiake Numër 5 Tirane si dhe me VKM 526 DATE 12.06.1996 një pjesë e fshatit Sauk dhe Mjull-Bathore kanë kaluar në varësi të Njesisë Bashkiake Numër 2 Tirane.

Pas Kasharit dhe Paskuqanit, Farka paraqet një prirje të lartë urbanizuese, për shkak të shtimit të popullsisë dhe të veprimtarive tregtare dhe industriale në zonë pas vitit 1990 (Komuna Farke, 2012:1). Para vitit 1990, popullsia e kësaj zone ka qenë kryesisht homogjene me përkatësi fetare të besimit myslyman. Me shpërbërjen e sistemit socialist totalitar, kjo zonë pësoi lëvizje të vrullshme demografike. Për shkak të zhvillimit ekonomik të zonës, popullsia është rritur në mënyrë të ndjeshme me të ardhur nga zona të ndryshme të Shqipërisë, duke u shndërruar në një popullsi heterogjene nga pikëpamja nënkulturore. Nga një popullsi prej rreth 10.000 banorësh në vitin 1990, sot numërohen 25 742 banorë, të cilët nuk janë të gjithë të regjistruar në gjendjen civile të Komunës Farkë (Komuna Farke, 2012:26). Sipas regjistrimit administrativ të gjendjes civile të Komunës Farkë, të vitit 2012, Farka ka 12.151 banorë, ndër të cilët 6516 meshkuj dhe 5635 femra. Pjesa e munguar në statistikat e komunës figuron e regjistruar në njësi të tjera vendore pavarësisht se banojnë në Farkë. Kompozimi i popullsisë në vendase dhe të ardhur është: 55 për qind autoktonë dhe 45 për qind të ardhur (Komuna Farke, 2012:46). Pjesa më e madhe e popullsisë urbane përbëhet prej të ardhurve dhe është përqëndruar në fshatrat Selitë dhe Sauk. Mbi 85 për qind të popullsisë së këtyre fshatrave e përbëjnë banorë të ardhur nga rrethe të ndryshme të vendit, të cilët janë vendosur në komplekset e reja të banimit, duke e transformuar këtë pjesë të komunës në periferi të qytetit të Tiranës. Ndërsa, përqendrimi më i madh i popullatës vendase, e cila merret me veprimtari bujqësore, ndodhet në fshatrat Lundër, Farkë e Madhe dhe Farkë e Vogël dhe më pak në Sauk. Toka përdoret për qëllime rezidenciale dhe aktivitet bujqësor. Vetëm në fshatrat, Selitë dhe Sauk ka pak familje që e përdorin tokën për qëllime bujqësore sepse ndërtimet e paligjshme të para viteve 2000 i kthyen parcelat bujqësore në truall. Ndërsa në fshatrat e tjera, ky përdorim është i shpërndarë në parcela të kufizuara në ngastra shumë të vogla toke, me mundësi të pakta mekanizimi.

Rritja e popullsisë është ndikuar nga kthimi i zonave të tëra bujqësore në zona urbane, për shkak të kushteve gjeografike dhe afërsisë me qytetin e Tiranës. Shtesa e popullsisë është shkaktuar kryesisht prej popullsisë së ardhur dhe më pak prej rritjes natyrore demografike. Komuna Farkë ka përjetuar zhvillim dinamik socio-ekonomik, sidomos gjatë dhjetëvjeçarit 2000-2010. Përgjatë këtyre viteve, komuna ka pësuar rritje masive të popullatës, kryesisht prej migrimit të brendshëm, të shoqëruar me një rritje të hapësirës urbane (Mazari, N., 2012:11). Pjesa më e madhe e banorëve të ardhur dy dhjetëvjeçarët e fundit janë nga zonat Veriore dhe

Lindore të Shqipërisë, por edhe nga zonat Juglindore. Të ardhurit janë kryesisht nga: Kukësi, Dibra, Tropoja, Librazhdi, Elbasani, Peqini, Fieri, Gjirokastra, Berati, Skrapari, dhe Përmeti (Mazari, 2012:11; Komuna Farkë, 20012:45). Kryesisht familjet e vendosura janë nga zona veriore e Shqipërisë, Kukës dhe Dibër. Pjesa më madhe e këtyre familjeve janë vendosur në fshatin Farkë e Vogël dhe Farkë e Madhe. Ardhje ka patur edhe para vitit 1990, sidomos nga Veriu i Shqipërisë. Këta banorë u vendosën kryesisht në fshatin Farkë e Vogël dhe Fshat i Ri.

2.3.1.3. Probleme për pronësinë ndaj tokës

Në periudhën e regjimit socialist, Farka ka qenë pjesë e Ndërmarrjes Bujqësore "Gjergj Dimitrov". Pas shpërbërjes së regjimit socialist, Farka pësoi ndryshime. Territori u nda midis ish-pjesëtarëve të ndërmarrjes bujqësore, në bazë të Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, "Për tokën". Më pas, Ligji nr 7512 "Mbi sanksionimin dhe mbrojtjen e pasurisë private, iniciativës së lirë, aktiviteteve private të pavarura dhe privatizimit" datë 10.08.1991, i hapi rrugën privatizimit të pasurive shtetërore. Më vonë, në vitin 1993 ligji nr. 7699 "Mbi kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës bujqësore" sanksionoi të drjetën e ish-pronarëve të kompensoheshin në vlerë monetare, por nuk pati efektivitet sepse ish-pronarët nuk pranuan sistemin e letrave me vlerë si kompensim. Ligji 7843 "Mbi rregjistrimin e pasurive të paluajtshme", i datës 13 korrik 1994, hodhi bazat ligjore për krijimin e Sistemit të Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, që filloi zbatimin në mars 1996. Gjithë këto ligje vetëm sa kanë shkaktuar konfuzion me moszbatimin. Përsa i takon pronësisë mbi tokën, në komunën Farkë ajo është ndarë në bazë të Ligjit nr. 7501 për Tokën, dhe pastaj është ndarë, shitur dhe urbanizuar me leje ose në mënyrë informale. Në shumë raste, toka pretendohet njëkohësisht nga dy pronarë dhe është zënë në mënyrë të paligjshme nga ish-pronarët dhe për rrjedhojë ka dy posedues prone: njëri është pronar toke pa dokumente dhe tjetri posedues dokumenti ligjor por pa pronë (perfituesit e ligjit 7501). Përveç titujve të pronësisë, probleme të tjera për pronësinë mbi tokën janë: mbivendosjet, zhvendosjet, parregullsitë në plotësimin e dokumentacionit si dhe caktimi i zonave urbane (vijat a verdha) në kundërshtim me ligjin 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën". Regjistrimi i pronave në shumicën e rasteve nuk i përgjigjet pozicionit topografik të saj, pasi baza hartografike që u trashëguar ishte pothuajse krejtësisht e parregullt. Së fundi, mungesa e një regjistri për pronat dhe ndryshimet që kanë pësuar ato e komplikon problematikën për pronësinë. Të dhënat flasin qartë për një

parregullsi kaotike të pronësisë të pasuar jo vetëm me konflikte midis pretenduesve të ndryshëm, por dhe në konflikte brenda familjes.

2.3.1.4. Ekonomia e zonës

Sektorët që kanë peshën më të madhe në ekonominë e komunës Farkë janë: bujqësia, shërbimet tregtare dhe ndërtimi. Toka është një faktor i rëndësishëm në zhvillimin e ekonomisë lokale në përgjithësi dhe ekonomisë bujqësore në veçanti, pasi ajo përfaqëson magazinën e furnizimit me lëndë ushqyese për zonën dhe për qytetin e Tiranës. Fondi i tokës bujqësore është 1518 ha dhe përdoret për arë, pemtore, fruta, ullinj, agrume dhe vreshta. Veprimtaritë bujqësore kryhen në fshatrat me më shumë sipërfaqe toke arë të punueshme që janë: Farka e Madhe (151.2 ha), Farka e Vogël (121.8 ha), Lundra (165.8 ha) dhe me pak Mjull-Bathorja (80.2 ha). Një pjesë e popullsisë të zonave Lundër, Farkë e Vogël, Farkë e Madhe janë të vetëpunësuar pranë ekonomisë së tyre bujqësore e blegtorale duke nxjerrë të ardhura nga shitja e produkteve. Ndërsa fshatrat Sauk (40 ha) dhe Selitë (18 ha) që kanë pak tokë arë të punueshme janë përdorur më shumë për veprimtari ndërtimi dhe shërbimesh tregtare (Komuna Farkë, 2012:7). Sektorët e tjerë të ekonomisë si industria dhe shërbimet, janë pozicionuar kryesisht përgjatë aksit kryesor Tiranë-Elbasan. Në komunën Farkë ushtrojnë veprimtari rreth 475 biznese që kane punësuar një pjesë të popullsisë (Komuna Farkë, 2012:37). Subjektet që ushtrojnë aktivitetet ekonomik janë regjistruar kryesisht gjatë viteve 2007 – 2012 dhe shtrihen përgjatë zonave: Selitë, Sauk, Rruga Nacionale Tiranë-Elbasan dhe Zona Tregtare Lundër (Tirana East Gate – TEG). Sipas veprimtarinë që ushtrojnë bizneset grupohen: 51 për qind në sektorin e tregtisë, 10 për qind në sektorin e shërbimeve, 25 për qind në sektorin e prodhimit, 13 për qind në sektorin e ndërtimit dhe 1 për qind në sektorin e transportit (po aty). Zona e Farkës është e njohur edhe për zejet artizanale, ku vendin kryesor e zë poceria.

2.3.1.5. Kultura materiale

Farka dëshmon kulturë të pasur materiale në lëmin etnografik, ku mund të përmenden: veshjet popullore, folklori dhe kuzhina tradicionale. Stili i veshjeve popullore është mjaft i përafërt me atë të Tiranës. Karakteristikë e veçantë e veshjeve të burrave janë: brekushet e

bardha, këmisha e bardhë prej pëlhure me mëngë të gjata e shoqëruar me një xhoke, me jakën e ngritur dhe me xhufka në supe. Ndërsa jeleku i punuar me shajak ose cope të kuqe ka qenë përdorur kryesisht nga të rinjtë. Gjithashtu, pjesë e kostumit tradicional të burrave është një brez në mes, i punuar me fije të kuqe dhe të bardha. Këtij kostumi i bashkangjitet qeleshja, e cila në ndryshim me zona të tjera, është më e gjatë dhe e rrafshët. Një element tjetër janë opingat. Karakteristikë e veshjeve të grave është dimiqi (çitjane) ngjyrë mermeri të bardhë, këmisha e hollë e shoqëruar me jelek prej kadifeje të qëndisuar me fije ari. Element i kësaj veshjeje është edhe një medaljon ose napolon prej floriri, i varur në qafë kryesisht nga nuset e reja. Në kokë vendoset kësula e qëndisur me ar ose argjend. Këtij kostumi i shtohen këpucët e bardha me taka. Në këtë zonë, që në kohë të hershme, mjaft familje prodhonin vetë veshjet tradicionale me mjete artizanale. Ky prodhim siguronte edhe të ardhura për familjet artizanale, traditë kjo e trashëguar edhe në ditët e sotme. Gjithësesi, veshjet popullore nuk përdoren më në jetën e përditshme, por ndonjëherë, vetëm në raste ceremonish martesore, prej nuseve të reja.

2.3.2. Kampioni i kërkimit

Ky studim u realizua në Farkë, me 672 vajza dhe gra të moshës 18-80 vjeç, përgjatë viteve 2009-2014. Në përzgjedhjen e kampionit u tregua kujdes për kriterin e përfaqësimit, prandaj në studim u përfshinë 672 pjesëmarrëse nga 5635 vajza dhe gra që është popullata femërore komunës (Komuna Farkë, 2012:26). Kampioni është përfaqësues për nga karakteristikat demografike: mosha, arsimi, punësimi, vendbanimi, vendi i origjinës dhe statusi martesor. Gjithashtu për të respektuar edhe përfaqësimin gjeografik kampioni u shpërnda sipas numrit të banorëve në disa njësi vendore të Komunës Farkë dhe konkretisht në: Farkë të Madhe, Farkë të Vogël, Lundër dhe Sauk.

Për përzgjedhjen e kampionit u përdor teknika e kuotimit, përcaktimit të kuotave përfaqësuese që përbëjnë nëngrupe të kampionit. Kuotat u përdorën me qëllim që të krijohet një kampion që përfaqëson në mënyrë proporcionale kategoritë në studim që janë: vajzat, gratë nëna, gratë profesioniste, gratë e punësuara në ekonominë familjare, në ndërmarrje dhe institucione shtetërore dhe gra sipërmarrëse. Kategoritë kryesore që shërbyen për një përfaqësim të drejtë të popullatës së vajzave dhe grave në studim ishin dy variabla demografike: vendbanimi dhe mosha dhe më pas këto u ndanë në variabla të tjera si: shkollimi, punësimi dhe statusi martesor. Sipas

vendbanimit kampinoni u nda në katër kategori: Farkë e Madhe, Farkë e Vogël, Lundër dhe Sauk, ku ka edhe përqëndrim më të madh të popullatës autoktone, pasi Selita dhe Sauku janë transformuar në lagje të Tiranës. Ndërsa sipas moshës kampioni u nda në gjashtë nën-grupe: 18-25 vjeç, 26-35 vjeç, 36-45 vjeç, 46-55 vjeç, 56 -65 vjeç dhe 66 vjeç e lart. U vendos që në kampion të përfshihej një kuotë e caktuar vajzash dhe grash nga secili fshat dhe secila grupmoshë. Kur plotësohej numri i vajzave dhe grave të anketuara për një fshat dhe grupmoshë, atëherë kuota mbushej dhe anketimi për atë kategori përfundonte. Në një studim rasti, shtresëzimi i kampionit me kuota paraqet përparësi ndaj përzgjedhjes rastësore. Duke qenë se nuk është probabilitar, kampioni me kuota nuk paraqet probleme që lidhen me gabimin statistikor, i cili ndodh në përzgjedhjen rastësore (Bryman, A., 2004:227).

Në lidhje me nivelin arsimor, kampioni u nda në katër kategori: me shkollë fillore, 8 ose 9-vjeçare, të mesme, të lartë dhe nivel pasuniversitar. Për të pasqyruar me vërtetësi paragjykimet në zonë, kampioni u nda në banore të hershme dhe në banore të ardhura nga zona të tjera gjeografike. Gjithashtu për të përfutur një informacion të bollshëm në lidhje me paragjykimet në shkollë, familje dhe punë, kampioni përfshiu vajza të reja në moshë shkollore, gra të martuara dhe vajza dhe gra të punësuar brenda dhe jashtë ekonomisë familjare.

2.3.3. Mbledhja e të dhënave

Të dhënat u mblodhën në katër fshatra: Farkë e Madhe, Farkë e vogël, Lundër dhe Sauk, përgjatë katër muajve: dhjetor 2013-mars 2014. Mbledhja e të dhënave u parapri nga testimi i pyetsorit, i cili rezultoi i dobishëm për modifikimin e pyetjeve të anketës përfundimtare.

2.3.3.1 Pilotimi

Përpara se anketa të hidhej për plotësim në terren pyetsori u testua përmes pilotimit. Së pari, pilotimi provoi nëse pyetjet vlenin dhe së dyti, garantoi konsistencë logjike të anketës. Pilotimi ndihmoi edhe në pastrimin e pyetsorit nga pyetje të panevojshme, të paqarta dhe përsëritëse, si edhe në pasurimin me përgjigje alternative për anketën. Gjithashtu, pilotimi krijoi një ide të qartë për kohëzgjatjen e plotësimit të anketës në terren. Periudha e pilotimit shërbeu edhe si fazë trajnimi për intervistimin e drejtëpërdrejtë.

2.3.3.2. Anketimi

Anketimi u krye në fshatrat më të mëdha të komunës Farkë: Farkë e Madhe, Farkë e Vogël, Lundër dhe Sauk, përgjatë periudhës 1 dhjetor 2013 – 30 mars 2014. Për organizimin e mbledhjes së të dhënave ndihmuan bashkëpunëtorë të shumtë nga zona e Farkës: mjekë, mësues, punonjës të administratës së komunës dhe pronarë lokale. Anketimi u krye në disa mjedise: shtëpi, ambulanca, shkolla, restorante, komunë. Për anketimin në shtëpia ndihmuan punonjësit e komunës, të cilët morën kontakte paraprake me kryepleqtë e fshatrave dhe këta mundësuan takimet nëpër shtëpi. Edhe për takimet me vajzat dhe gratë në mjedise të shërbimit publik si shkolla dhe ambulanca ndihmuan punonjësit e komunës, të cilët njoftuan punonjësit e qendrave shëndetësore dhe drejtoritë e shkollave për takimet dhe këta të fundit njoftuan gratë për t'u grumbulluar në ditë dhe orare të caktuara në shkolla dhe qendra shëndetësore. Gjithashtu, për realizimin e anketimit bashkëpunuan edhe pronarët e lokaleve dhe njësive të shërbimit (bar-kafene, restorante, rrobaqepësi, shtëpi botuese, fasoneri), të cilët të njoftuar më parë nga administrata e komunës, mundësuan plotësimin e anketave me punonjëset e tyre gjatë orarit të punës.

Gjatë anketimit u mbajt parasysh edhe sugjerimi nga teoria feministe se metoda sasimore mund të krijojë marrëdhënie nënrenditëse hierarkike mes kërkuesit dhe të kërkuarve (Oakley, A., 1981:48). Për të shmangur këtë raport asimetrik pushteti, si kërkuese u përpoqa t'u shpjegoja vajzave dhe grave pjesëmarrëse në kërkim se studimi i paragjykimeve është një çështje me rëndësi për ato dhe për mua, dhe se ky studim synon të jetë emancipues dhe i nxit ato të mos jenë pre e paragjykimeve.

2.3.4. Përpunimi i të dhënave

Të dhënat e mbledhura u përpunuan përmes paketës SPSS, e cila u përdor nga një profesioniste e statistikave sociale. Gjatë kohës së hedhjes së të dhënave dhe kodifikimit për përpunim informatik, si dhe gjatë nxjerrjes së rezultateve të përpunuara jemi konsultuar vazhdimisht për paraqitjen numerike, grafike dhe tabelare duke përfshirë vlerat nominale, frekuencat, përqindjet, kombinimin e dy dhe më shumë variablove (bivariate dhe multivariate analysis).

2.4. Kufizime metodologjike

Studimi është mbështetur tek metoda sasiore kryesisht, por ka përdorur edhe metodën cilësore përmes intervistimit dhe bisedave të lira me pjesëmarrëset në kërkim. Gjithashtu, pyetsori përmban edhe pyetje të hapura për të mbledhur informacion të vlefshëm për kërkimin, i cili do ishte i paplotë pa të dhënat nga pyetjet e hapura. Meqë studimi i paragjyqimeve është një çështje që shfaq ndjeshmëri të lartë tek përgjigjedhëneset, të cilat duhej të raportonin për situata personale të përjetimit të paragjyqimeve, u përdorën jo vetëm pyetje të hapura në pyetsor, por edhe cikle pyetjesh për të zbërthyer më mirë opinionin e tyre dhe zbuluar kontraditat në përgjigjet e dhëna (Dervishi, Z., 1998: 51). Gjithësesi, si për çdo kërkim social, edhe ky studim paraqet disa kufizime.

Së pari, mbledhja e të dhënave u krye përmes metodës sasiore kryesisht. Edhe pse të dhënat u pasuruan përmes materialit cilësor që u mblodh prej pyetjeve të hapura, intervistave dhe bisedave të lira, fondi i të dhënave për çështje kërkimore me ndjeshmëri emocionale siç është paragjykimi do të ishte më i plotë nëse do të ishte përdorur më gjerësisht edhe metoda cilësore. Kjo për arsye se rrëfimi për situata paragjyquese rëndohet prej shqetësimit se flitet për gjëra personale me një person jo të afërt. Për më tepër, sikurse ka vënë në dukje kërkuesi social, Zyhdi Dervishi, shqiptarët, si popujt ballkanikë në përgjithësi, kanë një formim psikokulturor tejet kompleks që përshkohet nga *tuhajësimi* ose prirja për të mos e shprehur veten e për të mos u prononcuar për shqetësime shpirtërore, ekonomike, sociale, sidomos kur këto kanë profil individual (1998:49). Sado që për të minimizuar efektet e tëhuajimit u përdorën rubrika me cikle pyetjesh që synonin të zbërthenin mesazhet kontradiktore të shprehura prej përgjigjeve të dhëna, prevalimi i metodës sasiore përmbi atë cilësore mund të ketë bërë që një pjesë e të anketuarave të mos shprehen thellësisht për qëndrimet e tyre. Marrja e opinionit të të gjitha pjesëmarrëseve në kërkim përmes metodës cilësore do të pasuronte informacionin për qëndrimet e tyre, por do të kufizonte numrin e pjesëmarrëseve në studim.

Së dyti, kampioni i përzgjedhur për kërkimin vërtet përbëhet nga një përfaqëse përfaqësuese vajzash dhe grash që banojnë në zonën e Farkës, të cilat paraqesin një larmi nënkulturash si pasojë e migrimeve të brendshme, por nuk pretendon të jetë përfaqësues në nivel

kombëtar. Gjithësesi, duke dashur të paraqesë realitetin shoqëror të grave në zonën e Farkës, që ndodhen në një kontekst sa rural aq edhe urban, studimi edhe pse nuk ngre pretendime përgjithësuese për gjetjet, gjithësesi synon të bëjë krahasime përafruese të gjendjes së vajzave dhe grave të Farkës me gjendjen e vajzave dhe grave të tjera në Shqipëri.

Së treti, realizimi i anketimeve njëkohësisht me intervistimet mori shumë kohë fizike, gjë që ndikoi në kohëzgjatjen e anketimit dhe mledhjes së të dhënave përtej kalendarit të parashikuar dhe zgjati rreth katër muaj (dhjetor 2013-mars 2014). Gjithashtu, koha për realizimin e anketimeve u kushtëzua edhe nga faktorë të tjerë që kishin të bënin me angazhimet ditore të grave pjesëmarrëse si: punët e shtëpisë, përkujdesja për familjarët, punët bujqësore e blegtorale, shitja e perimeve në treg dhe puna me pagesë. Edhe pse gratë pjesëmarrëse u kontaktuan paraprakisht prej bashkëpunëtorëve të komunës, drejtorive të shkollave dhe qendrave mjekësore, dhe pronarëve të njësive private ku ato punonin për t'u informuar se do kishin takim me një studiuese “për gratë”, gjatë procesit të anketimit gratë shprehnin shqetësim për kohëzgjatjen e anketimit pasi “ i prisnin punët, familja, dreka...”. Ndërsa për intervistimin u shfrytëzuan momentet kur gratë nuk paraqisnin shtrëngesa kohore dhe kur kishin mundësi të qëndronin më gjatë. Gjithësesi, një tjetër vështirësi kishte të bënte edhe me administrimin e të dhënave të intervistimit, të cilat u morën të gjitha me shënime pasi nuk u përdor diktofon dhe intervistimet e bëra u kryen njëkohësisht me anketimin.

Së katërti, vendi i anketimit paraqiste shpesh vështirësi në kryerjen e tij në privatësi. Megjithëse u tentua të grumbullohen pjesëmarrëset në orare, ditë dhe vende të caktuara për anketimin, mbledhja e tyre ishte e porealizueshme, pasi gratë kishin angazhime kohore dhe përparësi familjare dhe profesionale që ndryshonin shumë. Anketimet u kryen në mjedise private si shtëpi dhe në mjedise publike ku kishte përqëndrime të pjesëmarrëseve si në shkolla, klinika mjekësore dhe qendra pune. Anketimi paraqiti disa vështirësi praktike për kryerjen në qetësi si në mjedise private ashtu edhe ato publike. Në mjediset shtëpiake, gratë e anketuara shfaqnin shqetësim për kohën e intervistimit, pasi duhej të merreshin me punët e shtëpisë. Ndonjëherë, pjesëtarët e familjes të bërë kureshtarë se për çfarë po pyetej gruaja vinin dhe dëgjonin madje edhe “jepnin opinionin e tyre” për pyetjet që i drejtoheshin gruas. Ndodhte, që përgjigjet të jepeshin thjesht formalisht pasi në prani të gruas ndodhej vjehrra apo kunatat. Ndërsa në mjedise publike, si kopshte dhe shkolla, nënat që kishin ardhur për të marrë fëmijët nxitonin të ktheheshin në shtëpi se fëmijën “e kishte marrë uria”, “se e prisnin fëmijët e tjerë” se “do

shtronin drekën”, edhe pse ishin njoftuar paraprakisht prej mesueseve ose drejtuesve të shkollës që do merrnin pjesë në anketim. Gratë në mjedise punë shfaqnin një ndjenjë thujse ankthi kur përgjigjeshin se mos përgjigjet e tyre po dëgjoheshin prej pronarëve apo menaxherëve, apo se mos përgjigjet e tyre i bëheshin me dije këtyre të fundit.

Së pesti, paraqitja sasiore e shkallës së paragjyimit paraqet vështirësi, pasi nuk ka instrumente të drejtëpërdrejta matëse për paragjykimet, por vetëm të tërthorta e që vijnë prej vetraportimeve të përgjigjedhënësive që janë njëkohësisht të paragjykuara dhe paragjyqese. Gjithashtu, niveli i vështirësisë së matjes rritet edhe më shumë kur synohet matja e shkallës së ndikimit të paragjyqimeve në nivel grupi për gratë, si grup shoqëror i paragjykuar, nga vetja dhe nga burrat. Përveç shfaqjes së dyfishtë të paragjyimit për gratë, edhe diversiteti i tyre paraqet një tjetër vështirësi në njehsimin e shkallës së paragjyimit kundër tyre. Gjinia nuk është i vetmi përcaktues shoqëror për gratë në studim, edhe pse është kryesori. Përcaktues të tjerë socialë si: vendi i origjinës, përkatësia nënkulturore, statusi martesor, niveli i edukimit, mosha, statusi i punësimit dhe niveli i të ardhurave familjare dhe personale janë gjithashtu tejte domethënës për përballjen e tyre me paragjykimet, me llojet dhe intensitetin goditës të paragjyqimeve. Për këtë arsye, sintetizimi i paragjyqimeve në një kategori të vetme për arsye matjeje ka qenë i pamundur sikurse është e pamundur të njehohen veçoritë e grave pjesëmarrëse në studim.

KAPITULLI III

ANALIZA E TË DHËNAVE DEMOGRAFIKE

3.1. Shtrirja e kampionit të studimit

Janë anketuar 672 vajza dhe gra nga Komuna Farkë, të cilat banojnë në 4 fshatra: Farkë e Madhe, Farkë e Vogël, Lundër dhe Sauk. Shpërndarja gjeografike e tyre jepet ne tabelën e poshtëshënuar. Kjo shpërndarje korrespondon si përqindje me numrin e popullsisë në këto fshatra, ndër të cilët fshati Farkë e Madhe ka edhe numrin më të lartë të banorëve, i pasuar sipas përfaqësimit numrik të popullsisë përkatësisht prej fshatit Farkë e Vogël, Sauk dhe Lundër.

Kampioni sipas vendbanimit		
Vendi	numri	%
Farkë e Madhe	268	39.9
Farkë e vogel	218	32.4
Lundër	80	11.9
Sauk	106	15.8
Total	672	100.0

3.2. Përkatësia sipas ndarjes krahinore

Sipas përkatësisë së krahinave nga kanë ardhur, të anketuarat janë ndarë në 4 grupe: nga Veriu, nga Jugu, nga Shqipëria e Mesme dhe nga Tirana. Tirana është vendosur si kategori më vete për dy arsye. E para, sepse në të përfshihet Farka që është zona e studimit dhe e dyta, për të


kuptuar se si është kompozuar popullata e Farkës nga pikpamja e përkatësisë krahinore, në të ardhur dhe vendas. Përkatësia krahinore e kampionit paraqitet në tabelën e mëposhtëme.

Origjina	Rreth		Qytet		Fshat	
	nr	%	nr	%	nr	%
Shqipëria veriore	190	28.3	83	49.4	107	21.2
Shqipëria Jugore	62	9.2	44	26.2	18	3.6
Shqipëria e Mesme	39	5.8	25	14.9	14	2.8
Tirana	381	56.7	16	9.5	365	72.4
Gjithësej	672	100	168	100	504	100

Nga të dhënat, del se pjesa më e madhe e vajzave dhe grave të studimit 56.7 për qind janë nga Tirana, ku përfshihet edhe Farka. Ndërsa pjesa tjetër janë nga: rrethet e Veriut 28.3 për qind, nga rrethet e Jugut 9.2 për qind dhe nga Shqipëria e Mesme 5.8 për qind. Nga pikpamja nënkulturore, Tirana bën pjesë në Shqipërinë e Mesme. Për pasojë e marrë bashkë me Tiranën, përqindja më e lartë e popullsisë së Farkës është nga Shqipëria e Mesme, ku përqindjen më të lartë e ze Tirana, me 62.0 për qind. Nga Shqipëria e Mesme janë edhe të ardhurat në Farkë me familjet nga Elbasani, Peqini, Durrësi dhe Kavaja. Në vend të dytë renditet Veriu, ku përqindjen më të lartë e zenë të ardhurat nga rrethi i Kukësit me 62.1 për qind, i pasuar nga rrethi i Dibrës me 17.9 për qind, dhe nga rrethet e tjera: Pukë, Mat, Tropojë, Kurbin, Lezhë, Mirditë e Shkodër që përfaqësojnë 20 për qind. Të ardhurat nga Jugu zenë një përqindje të vogël prej 9.2 për qind dhe përbëhet nga të ardhura nga rrethet: Mallakastër, Kolonjë, Fier, Gjirokastrë, Gramsh, Korçë, Lushnjë, Përmet, Pogradec dhe Librazhd.

Sipas përkatësisë nga rrethet Tirana me 56.7 për qind dhe Kukësi me 17.5 për qind përbëjnë shumicën, 74.2 për qind e kampionit të studimit, që përkon edhe me përbërjen e popullatës së Farkës. Përsa i përket ndarjes në popullsi qytetare dhe popullsi fshatare, kampioni ndahet në 25.0 për qind nga qyteti dhe 75.0 për qind nga fshati. Është e kuptueshme që popullsia e Komunës është shumica me origjinë fshatare.

Origjina: qytet/fshat




Pjesën më të madhe të vajzave dhe grave me origjinë nga qyteti e përbëjnë veriorët që zenë 49.4 për qind të kampionit, të cilat pasohen nga vajzat e gratë e ardhura nga qytetet e Shqipërisë Jugore që zenë 26.2 për qind dhe nga Shqipëria e Mesme 14.9 për qind. Nga Tirana janë vetëm 9.5 për qind e kampionit. Shumica e vajzave dhe e grave me origjinë nga qyteti janë nga Veriu i Shqipërisë prej nga kanë ardhur edhe pjesa më e madhe e migrantëve të brendshëm. Nga Shqipëria e Jugut ka më pak të ardhura me origjinë nga qyteti pasi të shpërngulurit nga qytetet janë vendosur kryesisht në qytetin e Tiranës dhe jo në fshatrat e saj. Pjesa më e vogël e të ardhurave janë me origjinë nga Tirana. Këto ose janë martuar në Farkë ose janë shpërngulur nga qyteti i Tiranës me banim në fshatin Sauk dhe Lundër (kompleksi i vilave Blur). Nga Tirana 72.4 e vajzave dhe e grave janë me origjinë fshatare. Ndër vajzat dhe gratë me origjinë fshatare nga Tirana, numrin më të lartë e pëfaqësojnë 219 vajzat dhe gratë nga komuna Farkë që përbejnë 60.0 për qind të peshës specifike. Ndërsa 146 vajzat dhe gratë nga fshatrat e tjerë të Tiranës përbëjnë 40.0 për qind të kampionit nga fshati me origjinë nga Tirana.

Pas Tiranës, në vend të dytë vjen kategoria e vajzave dhe grave me origjinë nga fshatrat e rretheve të Veriut që përbëjnë 21.2 për qind të kampionit. Shumica e vajzave dhe e grave të tilla kanë ndjekur familjet e tyre të shpërngulura nga fshatrat veriorë në drejtim të Tiranës. Familjet migrante me origjinë nga fshati janë vendosur në Komunën Farkë pasi kanë parapëlqyer të vazhdojnë të merren me verpimtari bujqësore dhe blegtorale sikurse merreshin në fshatrat nga ku vijnë. Në Tiranë, ata kanë lëvizur për të gjetur më shumë treg shitjeje për produktet e tyre bujqësore e blegtorale si dhe për të pasur më shumë mundësi shkollimi për fëmijët. Familjet e


migruara nga Veriu kanë blerë parcela tokash nga fshtarët vendas ku kanë ngritur shtëpi banimi dhe kanë veprimtaritë bujqësore me të cilat sigurojnë të ardhurat kryesore.

Vajzat dhe gratë me origjinë nga fshati nga rrethet e Shqipërisë së Jugut dhe të Shqipërisë së Mesme përbëjnë një përqindje të vogël të kampionit, përkatësisht 3.6 dhe 2.6 për qind. Të shpërngulurit nga Shqipëria e Mesme dhe nga rrethet e Jugut kanë parapëlqyer më shumë të vendosen në qytetin e Tiranës ose në njësitë vendore Numër 2 dhe numër 5, një pjesë e të cilave kanë qenë territore administrative të Komunës Farkë.



Ndër vajzat dhe gratë e anketuara 32.6 për qind janë nga Farka dhe 67.4 për qind të ardhura në Farkë. Kjo përqindje e lartë e të ardhurave shpjegohet me dy arsye. E para, sepse një pjesë e të ardhurave në Farkë nga fshatrat e Tiranës janë martuar në Farkë dhe përbëjnë 32.2 të të ardhurave nga fshatrat. E dyta, sepse në Farkë ka një përqindje të konsiderueshme të të ardhurave me familjet e tyre nga rrethet e tjerë.

Përkatësia e kampionit në: vendase dhe të ardhura



Të ardhurat nga rrethet e Veriut përbëjnë përqindjen më të lartë të të ardhurave rreth 41.9 për qind të kampionit. Të ardhurat nga rrethi i Tiranës përbëjnë 35.8 për qind, të ardhurat nga Shqipëria e Jugut përbëjnë 13.3 për qind dhe nga Shqipëria e Mesme 8.6 për qind. Origjina e të ardhurave nga Veriu është më e lartë se të ardhurat nga rrethet e tjera, pasi në Farkë kanë migruar më shumë familjet nga Veriu. Ndërsa përqindja e lartë e të ardhurave nga Tirana, përfaqësohet kryesisht prej vajzave të fshatrave të Tiranës që janë martuar në Farkë. Janë shumë më pak vajzat dhe gratë me origjinë nga qyteti i Tiranës, 3.2 për qind, që kanë ardhur të jetojnë në Farkë. Këto janë kryesisht nga familje që, në procesin e xhentrifikimit, janë zhvendosur nga qyteti për të jetuar në komplekse vilash luksozë në Farkë, larg ndotjes mjedisore dhe akustike të kryeqytetit. Ndërsa nga Shqipëria e Jugut dhe e Mesme përqindja e të ardhurave është më e ulëta, 22.0 për qind e të ardhurave të marra së bashku.

3.3. Origjina qytetare dhe fshatare

Janë me origjinë nga qyteti 168 vajza dhe gra të ardhura në Farkë, ndërsa me origjinë nga fshati janë 285 prej tyre. Në përqindje, sipas origjinës qytet/fshat janë: nga qyteti janë 37.0 për qind e të ardhurave dhe nga fshati janë 63.0 për qind e tyre. Sikurse për ndryshoret e tjera sociologjike, edhe ndarja e kampionit të të ardhurave në qytete/fshatra është bërë në 4 kategori sipas tabelës së poshtëshënuar.

Origjina e të ardhurave	Rreth		Qytet		Fshat	
	nr	%	nr	%	nr	%
Zona						
Shqipëria Veriore	190	41.9	83	49.4	107	37.5
Shqipëria Jugore	62	13.7	44	26.2	18	6.3
Shqipëria e Mesme	39	8.61	25	14.9	14	4.9
Tirana	162	35.8	16	9.5	146	51.2
Gjithësej	453	100	168	100	285	100

KAPITULLI IV

PARAGJYKIMET PËR VAJZAT NË SHKOLLË

4.1. Rëndësia e arsimimit të vajzave dhe grave

Në shoqërinë moderne arsimit është shpesh mundësia e vetme për të gjetur punë dhe për t'u afirmuar si individ me vlera dhe dobishmëri ekonomike e shoqërore. Mungesa e arsimimit shoqërohet me pasoja negative afatgjata që përkeqësojnë pozitën psikologjike, sociale dhe ekonomike. Njerëzit e paarsimuar, përgjithësisht, përballen me varfëri të skajshme dhe krijojnë varësi nga përkrahja ekonomike shtetërore dhe ndihma e familjarëve. Rëndësia e arsimimit është vlerësuar përgjatë gjithë zhvillimit të njerëzimit pavarësisht se deri në shekullin e XIX-të arsimit nuk ekzistonte në formën zyrtare që njohim sot, pasi masivizimi i arsimimit ndodhi vetëm pas industrializimit në përgjigje të kërkesave ekonomike në rritje për krahë pune më të kualifikuara në ekonominë industriale. Që prej lindjes së arsimimit universal në vendet e industrializuara perëndimore, studiuesit sociale dhe ekonomistët kanë theksuar rëndësinë në rritje të tij si gjeneratori më i fuqishëm i zhvillimit të ekonomisë dhe shoqërisë (Orstein, C. A. & Hunkins, F. P., 2003:92). Më herët se të ndodhte masivizimi i arsimimit, që në shekullin e XVIII-të, mbështetësit e arsimimit publik parathanë se vetëm arsimit masiv universal do të krijonte një fuqi prodhuese dhe sipërmarrëse, si dhe do të kultivonte qytetarë të lirë për ndërtimin e një shoqërie demokratike (Rush, B., 1786:29; Jefferson, Th., 1893:221). Studiues të shquar të arsimimit, si Noah Webster dhe John Dewey në vazhden e parardhësve të tyre, kanë theksuar vlerën unike që ka arsimit në formimin kulturor dhe etik të qytetarëve për të ndërtuar një shoqëri vlerash (Webster, N., 1989:27; Dewey, J., 2004:202). Rëndësia e arsimimit për mobilitetin vertikal social dhe sheshimin e dallimeve klasore, përmes ushtrimit të parimit të mundësive të barabarta, e shndërroi arsimin pas Luftës së Dytë Botërore, sikurse e thekson Hannah Arendt në një të drejtë të

patjetërsueshme qytetare (Arendt, H., 1998: 150). Edhe në kohën pasmoderne, në një shoqëri shërbimesh dhe konsumi, roli i arsimit vazhdon të jetë shumë i rëndësishëm.

Përveç kuptimit të ngushtë si një specialist me njohuri nga shkenca dhe teknika, koncepti mbi njeriun e arsimuar mbart edhe një kuptim të gjerë, si një individ i kulturuar që mëshiron vlera të larta intelektuale dhe kulturore të transmetuara prej arsimimit. Shkolla bën bashkë dijen me kulturën. Sociologët argumentojnë se shkolla është ende qendra kryesore që transmeton dije kulturore dhe vendi ku “konsumohet” kulturë (Fuga, A., & Dervishi, Z., 2002:13). Gjithashtu, studimet në fushën e edukimit theksojnë rëndësinë utilitare që arsimit ka në përgatitjen për jetën kolektive, mbijetesën ekonomike dhe pjesëmarrjen në veprimtari shoqërore. Që në vitin 1860, Herbert Spencer vlerësoi ndikimin që arsimit ka në zhvillimin moral dhe intelektual të të rinjve që bashkë me formimin tekniko-shkencor krijon edhe vlera kulturore aq të nevojshme për krijimin e lidhjeve shoqërore (Spencer, H., 1860:103). Edukimi si proces shoqërizues me vlerat, besimet dhe normat kulturore të përbashkëta, fillon në gjirin e familjes dhe vazhdon në institucionin e shkollës. Megjithëse shkolla është kontakti i parë me botën sociale, ajo nuk është vetë bota, pasi siç argumenton Hannah Arendt, shkolla është një institucion mes fushës private të shtëpisë dhe botës që ndërmjetëon kalimin e fëmijës nga familja në botë (1998:157).

Falë arsimimit, shoqëria njerëzore, të paktën që prej epokës moderne industriale, po njih një zhvillim të parreshtur dhe shkëmbim kulturor që po përhapet në shkallë globale si pasojë e perhapjes së informacionit dhe angazhimit të njerëzve në veprimtari të ndërsjellta shoqërore dhe kulturore. John Dewey, një nga mendimtarët më të shquar të arsimit, duke analizuar funksionet e arsimit në shoqërinë amerikane të shekullit të XX, arriti në përfundimin se vetëm në një shoqëri demokratike arsimit kryen një funksion të dyfishtë: përçimin e dijes tradicionale dhe rinovimin kulturor të shoqërisë (Dewey, J. 1938:39). Shkolla formon një kulturë kombëtare duke transmetuar vlerat e përbashkëta shoqërore. Kjo kulturë përcakton mënyrën e reagimeve, të sjelljes dhe qëndrimeve e, për pasojë, botëkuptimet e mësuara në shkollë përcaktojnë në një shkallë të konsiderueshme edhe personalitetin. Megjithë dallimet në personalitet, shkolla zhvillon në mënyrë uniforme një kuptueshmëri të njëjtë për kulturën dhe ndërgjegjësim për përkatësinë kulturore si komb. Në një mjedis të larmishëm shumëkulturor dhe nënkulturor, shkolla, si asnjë institucion tjetër, zhvillon edhe një kuptueshmëri për dallimet dhe nuancimet kulturore duke i ekzpozuar nxënësit ndaj ndryshimeve kulturore të gjithësecilit.

Megjithëse ka qenë vlerësuar shumë për funksionet shoqërore, arsye për të cilën edhe u masivizua që në fillim të viteve 1820, arsimi fillor dhe i mesëm nuk ka qenë një realitet i prekshëm për vajzat deri në mes të shekullit të XX, rreth një shekull pas universalizimit të tij në perëndim. Shkollimi i vajzave, në fillesat e veta, behej i veçuar nga ai i djemve. Ndërsa arsimi i lartë ka qenë edhe më i vonuar. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës për shembull, vajzat nuk pranoheshin në shumë universitete dhe shkolla të larta profesionale deri në vitet 1960, ku ndër të fundit ka qenë universiteti prestigjioz i Harvardit që hapi dyert për vajzat vetëm në vitin 1963 (Thio, A., 1989:273).

4.2. Profile dhe probleme të arsimit të vajzave në Republikën e Shqipërisë

Sikurse në Perëndim, edhe në Republikën e Shqipërisë, arsimi u masivizua pas Luftës së Dytë Botërore. Nga pikëpamja gjinore, arsimi ishte një shërbim që ofrohej në mënyrë të njejtë si për vajzat, ashtu edhe për djemtë. Menjëherë pas çlirimit, në vitin 1945 u ndërmorr një fushatë e gjerë kundër analfabetizmit. Përgjatë dy dhjetëvjeçarëve të parë të regjimit socialist u hartua legjislacioni për arsimin parauniversitar në të cilin theksohej universaliteti dhe përfitimi falas për të gjithë. Arsimi u konsiderua si mjete më efikas për ndërtimin e ekonomisë socialiste dhe “shoqërisë së re”, që nënkuptonte zhdukjen e dallimeve klasore.

Përpyqje për arsimin janë bërë edhe përpara vendosjes së regjimit socialist. Shkolla e parë në gjuhën shqipe u hap në 8 mars 1887 në Korçë. Hapja e saj hodhi themelet e arsimit kombëtar sepse ishte e para shkollë me fizionomi kombëtare e laike ku mësonin bashkë djem e vajza. Por për opinionin e kohës së atëhershme, ishte e papranueshme që vajza të dërgohej në shkollë e aq më shumë në një shkollë me djem, prandaj rilindasit Gjerasim dhe Sevasti Qiriazhi hapën shkollën e parë në gjuhën shqipe për vajza më 23 tetor 1891, duke mashtruar autoritetet turke sikur shkolla ishte në gjuhën angleze (Instituti i Studimeve Pedagogjike, 2003:102-140). Në vitin 1898, mendimtari Faik Konica botoi një ese “Për Edukimin” në revistën *Albania*, në të cilën ai e quan edukimin shkencë të së ardhmes dhe motorin e të gjitha shkencave (Konica, F. (1898), 2012:9). Madje tek arsimi Konica shihte edhe emancipimin shoqëror të kombit shqiptar. Thirrjen për zgjim të vetëdijes kombëtare përmes arsimit, Konica e bëri në një kohë kur në trevat veriore dhe jugore të Shqipërisë etnike ishin çelur shkolla sllave dhe greke, si pasojë e presionit

shovinst sllavo-grek për të penguar hapjen e shkollave shqipe. Konica e trajton çështjen e arsimit si gjenerator të emancipimit shoqëror e kombëtar edhe në një shkrim tjetër për edukimin “Rritja mendore e popullit shqiptar”, ku nënvizon rëndësinë që ka arsimimi i të rriturve krahas atij të fëmijëve, pasi “koha e re nuk pret deri sa të bëhet i ditur brezi i ri, prandaj të gjithë qytetarët pa dallim moshe duhet të emancipohen shoqërisht” (Konica, F. 1906, cituar nga Andrea F. 2012:36). Një rëndësi parësore në emancipimin shoqëror sipas Konicës ka arsimimi i vajzave dhe grave, sepse nga nënat varet edukimi i një kombi. Konica e perfrazon në mënyrë lakonike rolin e gruas në emancipimin e një kombi duke u shprehur se “çupa e sotme është mëma e së nesërme, andej do dalin gjithë shqiptarët e kohës për të ardhur” (po aty). Aq shumë e vlerëson Konica rolin e gruas në ndërgjegjësimin kombëtar për çlirim nga perandoria osmane sa që e kurorëzon atë si kampione të lirisë. Konica, në shkrimin “Martesa në Shqipëri” (Albania, 28 shkurt 1898) shprehet se janë nënat ato që bashkë me qumështin e gjirit ushqejnë tek bijtë e tyre ndjenjën patriotike të lirisë: “Me qumështin e mëmës merrret dhe liria”. Edhe në një shkrim tjetër për emancipimin e vajzave dhe grave “Të drejtat e grave dhe mendimtari Shopenhauer” (Albania, prill 1899) Konica thekson se pa barazi mes grave dhe burrave nuk ka qytetërim europian, madje evokon me forcë një shkallë të lartë emancipimi shoqëror në Shqipëri të tillë që të lejojë pjesëmarrjen e vajzave dhe grave në edukim, politikë dhe punët e shtetit (Andrea, F., 2012:35).

Të drejtat e vajzave dhe grave për jetë intelektuale dhe prodhuese u reflektuan edhe në Kodin Civil të miratuar në vitin 1938, por shumica e vajzave dhe grave nuk i njihnin fare sepse ishin analfabete. Për këtë çështje kanë shkruajtur edhe feministet shqiptare të asaj kohe, ku një zë te veçantë përfaqësonte Olga Plumbi, e cila shprehet: “Edhe pse gruaja shqiptare sipas Kodit Civil ka të drejta, madje më shumë se gratë e kombeve më të qytetëruar se yni, ajo është në *padijeni* për të drejtat që i janë dhënë dhe do të kalojë shumë kohë gjer sa ajo ta kuptojë që mund të përfitojë prej tyre” (Plumbi, O. (1938), 2012:124). Olga Plumbi shkon më tej kur krahason ligjin me moret shqiptare sa shprehet se në vitet 1930-1940 njohja ligjore e të drejtave civile dhe politike për gratë e bënte shtetin shqiptar të ishte një hap përpara mendësive patriarkale të shoqërisë shqiptare, saqë kjo trembej se mos arsimimi do t’ia hapte kaq shumë sytë vajzave dhe grave “sa do të çfaqej nevoja për kufizim të atyre të drejtave”. Këtë frikë të perceptuar të shoqërisë shqiptare për emancipimin edukativ të vajzave dhe grave Olga Plumbi e fashit duke thënë se asgjë nuk mund ta ndalë zhvillimin shoqëror të vajzave dhe grave dhe se “kur gruaja të

fillojë të mejtojë, do të ketë arritur një shkallë të atillë zhvillimi që do të jetë shumë larg prej kohës së sotme” dhe se nuk diskutohet më që “mbarëvajtja dhe përparimi i çdo populli varen nga përparimi dhe zhvillimi i gruas” (Plumbi, O. 1938, 2012:125).

4.2.1. ... në periudhën e regjimit socialist totalitar

Përpjekjet përpara Luftës së Dytë Botërore nuk mundën ta masivizojnë dot arsimin. Shtrirja e arsimit masiv në të gjithë vendin ndodhi përgjatë viteve të regjimit socialist, kohë në të cilën u masivizua sistemi arsimor publik. Vendi trashëgoi një prapambetje të thellë arsimore, mungesë kuadroshe dhe një numër të pakët shkollash fillore. Në vitin shkollor 1938-1939 funksiononin gjithësej 643 shkolla fillore ku mësonin rreth 52 mijë nxënës ose një e katërta e fëmijëve të moshës shkollore dhe në prag-çlirimi, mbi 80 për qind e popullsisë ishte analfabete, me 90 për qind të vajzave dhe grave analfabete (Komisioni Qendror për Arsimin, 1969:9-10). Në vitin 1945, numri i shkollave fillore u rrit në 1097 me 77 mijë nxënës, nga të cilat 90 për qind u ngritën në fshatra. Në vitin 1946 u miratua Ligji për Reformën Arsimore dhe Ligji për Arsimin e Përgjithshëm të Detyrueshëm Fillor, zbatimi i të cilëve e rriti numrin e shkollave në vitin shkollor 1948-1949 në 1909 (73 për qind) dhe numrin e nxënësve në 162 mijë (110 për qind), si dhe i dha fund analfabetizmit në vitin 1955, gjatë të cilit përfundoi shtrirja e arsimit të detyrueshëm fillor në të gjithë vendin në 2174 shkolla fillore me 138.875 nxënës dhe filloi krijimi i rrjetit të shkollave profesionale (Po aty:40-45). Rrjeti arsimor u shtri edhe në zona ku më parë nuk kishte pasur shkolla. Këto arritje janë shprehur edhe në krijimitarinë folkloristike me natyrë ideologjike të viteve të regjimit socialist. Në një vjershë kushtuar ngritjes së shkollës në Gramsh, vargjet përshkruajnë gëzimin e banorëve për shkollën e re, në të cilën do të mësonin të gjithë pa dallim moshe:

*Pa shikoni fshatin tonë,
Shkoll' të re tani ndërton,
Shkoll' të madhe me dy kate,
I ka dhomat si pallate,
Se atje do mësojmë,
Si të rinj dhe baballarë,*

Fshati yn' si këtë shkollë,

As në ëndërr s'e kish parë

(“Shkolla jonë e re”, Vjersha Nr.385. Gramsh, 1973, Bob.978/7, Këngë popullore të Luftës NCL dhe të periudhës së ndërtimit socialist, Haxhihasani, Q., Mustaqi, A., Vasili K., Instituti i Folklorit, 1976:415)

Në vitin 1963 u miratua Ligji “Mbi organizimin e Sistemit Arsimor ne RPSH” që bëri të detyrueshëm arsimin tetëvjeçar dhe forcoi sistemin e arsimit profesional, duke hapur shkolla bujqësore në fshat dhe shkolla industriale në qytet. Shtrirja e arsimit të detyrueshëm 8-vjeçar në vitin 1963-1968 zgjidhi përfundimisht edhe arsimimin 8-vjeçar të vajzave, të cilat deri në atë kohë dërgoheshin prej familjeve vetëm në shkolla fillore. Nga 93 për qind e nxënësve që përfunduar shkollën 8-vjeçare në vitin 1968, 47 për qind ishin vajza (Po aty: 46-57). Shkolla u hapën për herë të parë në fshatrat e largët malorë dhe u dërguan aty mësues nga qyteti. Ja si e përshkruan hapjen e shkollës në fshatin Iballë të Pukës një poezi e kohës:

Mir' se t'gjeta ty moj Iballe,

n'ato shpate n'ato male

Si kudo në tan' Shqipni,

Ke tradita e burrni.

....

Në kto male, në kto suka

Na erdh' djal msues nga Puka,

Për malsort si rreze drite,

U hap shkolla e parë shqipe.

(“Shkolla e par' në rreth të Pukës”, Vjersha Nr.384, Berishë, Pukë, 1974. Bob. 1184/6, Haxhihasani, Q., Mustaqi, A., Vasili K., Instituti i Folklorit, 1976:414)

Ndërtimi i bazës ekonomike të socializmit shtroi nevojën për punonjës të kualifikuar. Në vitin 1970 u shenjua një etapë e re për arsimin: krijimi i shkollave të mesme të përgjishme dhe shtimi i shkollave të larta për përgatitjen e punonjësve të kualifikuar. Në vitin shkollor 1968-1969, ndiqnin arsimin 536 mijë nxënës e studentë, rreth një e katërta e popullsisë, ose 1 në katër

vetë (Po aty:58-62). Në kohën e regjimit socialist, sistemit arsimor nuk i jepej rëndësi vetëm për të ndërtuar ekonominë socialiste. Sistemi arsimor u përdor edhe si mjet për përhapjen e ideologjisë komuniste tek masat e gjera (Jenkins, L., Musha, K., & Molnar, D., 1999: 46).

Megjithë deklaratimet politike dhe punën e organizatave të Partisë së Punës, të rinisë, të gruas për barazi gjinore, aktivizimi i vajzave dhe e grave në jetën shkollë-artistike, politike dhe prodhuese pengoheshin prej paragjykimëve diskriminues që mbartte në përgjithësi shoqëria për pozitën shoqërore të gruas. Opinionet shoqërore godiste vajzat dhe gratë deri brenda familjes. Në fshat, vajzat pengoheshin prej prindërve, anëtarëve të familjes dhe fisit të ndiqnin shkollat e mesme dhe të larta. Në familjen fshatare u ruajtën konceptet konservatore patriarkale ndaj vajzave, edukimi i të cilave, prej frikës së thashethemeve, kryhej përmes ndrydhjes, nënshtimit, qortimit e deri ndëshkimit fizik, duke kultivuar pasivitet dhe ndrojtje. Në një poezi të kohës përshkruhet me vërtetësi gjendja e nënshtuar e vajzave, për shkak se familjet i ruheshin fjalëve të opinionit dhe për të ruajtur nderin i mbanin vajzat të ngujuara në kullë deri ditën që i martonin:

*Jam një cuc' e re bazjane,
Le e rrit nëpër kto male;
N'malet tona plot me kulla,
çiftelia ka qenë veç për burra.
Cuca e Bazit mbyll' n'kull,
Veç çorap me lot pat thur.
E kur shkante për ujë në krue,
Zemra i thoshte, mor, me këndue,
Me çue zanin nalt sa t'djalit,
por kish frik' lisat e malit,
se të ndiqte kisha udhës
e kanuja pas tërkuzës...*

(“Jam një cuc' e re bazjane”, *Vjersha Nr. 441, Madhesh, Mat, 1973, Bob.960/7, Këngë popullore të Luftës NCL dhe të periudhës së ndërtimit socialist*, Haxhihasani, Q., Mustaqi, A., Vasili K., Instituti i Folklorit,, 1976:475).

4.2.2. ... përgjatë tranzicionit pasocialist

Pas shpërbërjes së regjimit socialist, gjendja e sistemit arsimor u përkeqësua shumë, sidomos përgjatë dhjetëvjeçarit të parë 1990-2000. Me fillimin e masivizimit të privatizimit dhe të liberalizimit të ekonomisë, sidomos pas viti 1992, shumë qendra kulturore dhe arsimore në fshat u privatizuan e u shndërruan në njësi shitjeje, në banesa dhe u “pushtuan” nga të pastrehët (Fuga, A. & Dervishi, Z., 2002:22). Prej vitit 1992 e në vazhdim, funksionet kulturore dhe sociale të shtetit u dobësuan. Brenda dy viteve, 1991-1992, u rrënuan një e treta e shkollave dhe 2000 arsimtarë u larguan nga vendi (Jenkins, L., Musha, K. & Molnar, D., 1999: 46). Kriza ekonomike dhe politike thuajse e shkatërroi krejt sistemin arsimor. Përgjatë dy viteve, 1990-1992 u dogjën dhe shkatërruan 997 shkolla dhe u dëmtuan deri në themele 1500 nga 5500 shkolla, ndër këto 55 për qind ishin shkolla të arsimit 8-vjeçar (Lule, E. 2009:36). Dëmtimi i bazës materiale dhe shkollave në fshat shkoi në atë shkallë sa 60 për qind prej tyre dolën jashtë funksionimit. Shkatërrimi i shkollave kompromentoi jo vetëm procesin mësimor, por edhe frekuentimin e mësimin. Pati rënie të numrit të nxënësve në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, sidomos në fshatra. Nga viti shkollor 1990-1991 deri në vitin shkollor 1997-1998, në zonat rurale, numri i nxënësve në sistemin parashkollor shkoi në 33 për qind, në sistemin 8 vjeçar ra në 94 për qind dhe në shkollat e mesme të fshatrave u zvogëlua 4.4 herë (Lule, E. 2009:37; Fuga, A. & Dervishi, Z., 2002:24). Në vitin shkollor 1996-1997, përkeqësimi i vazhdueshëm i kushteve elementare në shkolla pamundësoi edhe arsimimin e 20 për qind të nxënësve në fshatra. Në harkun kohor të 7 viteve, 1991-1998, në zonat rurale u mbyllën 316 shkolla (INSTAT, 1998:33). Në një studim socio-pedagogjik të kryer në vitin 2000 në fshatrat e Shqipërisë, sociologët Artan Fuga dhe Zyhdi Dervishi konstatuan mjerimin e shkollave të fshatit, duke e përmbledhur kështu atë që vëzhguan gjatë studimit:

“Gjendja infrastrukturore e kulturës në fshatin shqiptar, nëse abstrahojmë nga gjendja e shkollave, mund të karakterizohet e prapambetur deri në braktisje, mjaft e varfër, fare larg, jo vetëm srtandarteve të kohës, por edhe të kushteve normale të domosdoshme. Sigurisht që vështirësitë materiale të shkollave pengojnë funksionimin normal të tyre. Një pjesë e ndërtesave, nga brenda dhe jashtë, janë mjaft të dëmtuara ...” (2002:20).

Shkatërrimi i shkollave ishte i krahasueshëm me atë të vendeve në gjendje lufte. Kriza politike e vitit 1997 që u shkaktua ndër të tjera edhe prej rënies së skemave piramidale ku popullsia kishte investuar kursimet, u shndërrua thujtë në luftë civile. Pasojat ishin të rënda në shumë sektorë të jetës në vend, por më të dukshme se kudo ishin në sistemin arsimor. Problemet e arsimit kanë goditur të gjithë brezin e shkolluar në dhjetëvjeçarin e parë të tranzicionit, vitet 1990-2000, por veçanërisht ka prekur shkollimin e vajzave, pasi familjet të trembura për sigurinë e tyre në rrugë dhe në shkollë i kanë detyturuar vajzat të ndërpresin studimet pas përfundimit të shkollës 8-vjeçare, sidomos në zonat rurale. Gjithashtu, zbrazja e zonave verilindore për shkak të migrimit të brendshëm çoi në mbylljen e shkollave që nuk kishin nxënës. Për pasojë, një pjesë e të rinjve që mbetën në fshatra migruan, ndërsa vajzat vuajtën qëndrimin në shtëpi (Fuga, A., & Dervishi, Z., 2002:175).

Megjithë problemet e shumta të dhjetëvjeçarit të parë të tranzicionit ekonomik e shoqëror, sistemi arsimor vazhdoi të funksiononte dhe mësimi nuk u ndërpre. Edhe pse vuajti mungesën e financimit të mjaftueshëm shtetëror, sistemi arsimor iu nënshtrua reformimeve të njëpasnjëshme dhe rregullimit ligjor me miratimin e ligjit “Për arsimin parauniversitar” të aprovuar në vitin 1995. Përmirësimet, veçanërisht në infrastrukturën arsimore dhe në sistemin arsimor në përgjithësi filluan të duken pas vitit 2000. Gjatë dhjetëvjeçarit të dytë të tranzicionit, në vitet 2000-2010 ka pasur një rritje pothuajse dyfish të numrit të nxënësve në shkollat e mesme të përgjithshme. Ky dyfishim duket edhe në tabelën e mëposhtme, duke krahasuar vitet shkollore 2000-2001 dhe 2010-2011. Përgjatë vitit shkollor 2000-2001 kishte 16.377 nxënës, prej të cilëve 9345 ishin vajza, ndërsa në vitin shkollor 2010-2011 kishte gjithësej 35.553 nxënës, prej të cilëve 18.232 ishin vajza. Në vitet e mëpasme, numri ka qenë në rritje. Në vitin shkollor 2012-2013 në shkollë të mesme ishin 41.577 nxënës, nga të cilët 21.451 vajza gjë që reflekton stabilizimin e sistemit arsimor.

Statistika të arsimit: nxënës në shkollën e mesme gjatë viteve 2000-2013		
Viti	Gjithësej	Vajza
2000-01	16.337	9.345
2001-02	16.997	9.885
2002-03	18.842	10.472

2003-04	21.348	11.415
2004-05	25.106	13.319
2005-06	24.433	13.444
2006-07	24.303	13.350
2007-08	26.255	14.426
2008-09	29.460	16.268
2009-10	29.984	16.628
2010-11	35.553	18.236
2011-12	38.083	19.924
2012-13	41.577	21.451

Burimi: INSTAT 2015:45

4.3. Arsimimi në Komunën Farkë

Komuna Farkë ka një shkollë të mesme të bashkuar në fshatin Farkë e Madhe që mban emrin e fshatit, e cila funksionon për të treja ciklet e arsimit: fillor, 9-vjeçar dhe shkollë e mesme e përgjithshme ose gjimnaz. Në komunë gjenden edhe 3 shkolla 9-vjeçare në fshatrat: Mjull Bathore, Lundër dhe Farkë e Vogël. Farka e Madhe ka edhe numrin më të lartë të nxënësve, në përputhje me numrin e popullsisë së Komunës. Në shkollën e mesme ka 303 nxënës, nga të cilët 164 janë vajza (sipas të dhënave nga Drejtoria e Shkollës së Bashkuar Farkë e Madhe). Në studim morën pjesë 58 vajza të kësaj shkollë që përbëjnë gati një të tretën ose 35.3 për qind të numrit të të gjitha nxënësve të shkollës. Nxënëset e përfshira në studim ishin të moshë 18 deri 19 vjeç dhe studionin në vitin e fundit të shkollës së mesme në klasën e 12-të. Në lidhje me numrin e të anketuarave, nxënëset janë 8.6 për qind e tyre. Në raport me numrin e nxënësve të klasave të 12-ta ato janë 100 për qind dhe në raport me numrin e nxënësve të shkollës së mesme janë 35.5 për qind, ndërsa në raport me trupën e nxënësve djem dhe vajza të marrë sëbashku në shkollë të mesme, ato përbëjnë 19.1 për qind të të gjithë nxënësve të shkollës. Në studim morën pjesë të gjitha vajzat e klasave të larta të shkollës së mesme.

4.4. Ndikime nënkulturore te paragjykimet për vajzat dhe gratë

Vajzat përballen me shumëllojshmëri paragjykimesh në moshën shkollore, të cilat mbarten prej atyre vetë dhe prej njerëzve që i rrethojnë. Të ndodhura në një mjedis paragjykues për aftësitë e vajzave dhe grave dhe të rritura me stereotipe gjinore, vajzat janë shndërruar vetë në paragjyuese të vetes. Gjithashtu, konteksti rural në të cilin janë rritur vajzat dhe gratë e Farkës i ka përforcuar edhe më shumë paragjykimet dhe stereotipet gjinore që mbarten në mendësitë e banorëve të zonës. Të para ngushtësisht të ndërthurura me rolet sociale, stereotipet shpesh ushqejnë paragjykimet dhe justifikojnë veprimin e tyre kundër vajzave dhe grave. Kryesisht paragjykimet më të zakonshme lidhen me rolin përkujdesës të grave, rol që merr rëndësi parësore kur ato bëhen nëna. Në periudhën e mëmësisë, grave iu njihet si detyrë parësore, dhe shpesh e vetme, rritja e fëmijëve. Sigurisht që përkujdesi prindëror është një përgjegjësi individuale dhe shoqërore për gruan. Problemi qëndron se kjo përgjegjësi shihet vetëm si rol femëror dhe jo mashkullor dhe se burrat shkurajohen kulturalisht të përkujdesen për fëmijët e tyre gjatë prindërimit. Mbivlerësimi dhe ekskluziviteti i rolit përkujdesës përkundrajt roleve të tjera si punonjëse, drejtuese, krijuese, etj. bllokton mundësitë e vajzave dhe grave për aktivizim jashtë hapësirës shtëpiake (Ridgeway, B., 2004:520). Për pasojë angazhimi i tyre në veprimtari ekonomike dhe shoqërore mbetet i pakët.

Studimet kanë treguar se procesi shoqërizues, përmes të cilit mësohen rolet sociale, ka ndikim të madh tek të gjithë njerëzit, e për pasojë edhe tek vajzat (Parsons, T., 1956:148; Weinreich, H., 1978:74). Që në fëmijëri, vajzat janë të ekspozuara ndaj ndikimit të procesit shoqërizues dhe stereotipeve gjinore që e bashkëshoqërojnë atë. Vajzat dhe gratë nuk janë vetëm viktimë e paragjykimeve për to, por edhe mbartëse të paragjykimeve të injektuara në mendësinë e kulturës së tyre dhe të mësuara gjatë përvetësimit të normave shoqërore për rolet sociale. Studimet konfirmojnë se, nga njëra anë, vajzat dhe gratë vuajnë paragjykimet e burrave kundër tyre dhe, nga ana tjetër, paragjykimet kundër vetes. Në një studim të kryer me 140 vajza kolegj, në vitin 1968, Philip Goldberg gjeti se vajzat e paragjykonin veten po aq sa ç'i paragjykonin djemtë. Këtë përfundim Goldberg e arriti pasi bëri një eksperiment të thjeshtë. Ai u shpërndau vajzave disa artikuj të shkruajtur nga e njejtja dorë, por që u paraqitën si të shkruara gjysma nga një autor dhe gjysma tjetër nga një autore, dhe studenteve ia kërkua të vlerësonin se kush kishte bërë artikujt më të mirë prej të dyve. Vajzat vlerësuan si më të mira artikujt e shkruar nga autori

burrë, edhe pse ishin të të njëjtit autor. Ky fakt e bindi studiuesin Goldberg se vajzat janë vetëparagjykuese. Por më shqetësues për Goldberg-un ishte ndikimi që kanë paragjykimet tek vajzat. Si pasojë e paragjykimeve, ato e nënvlerësojnë veten dhe ndihen inferiore ndaj burrave (1964:34-35). Sipas Goldberg, paragjykimi për vetveten i hap rrugë qëndrimeve përcmuese të burrave për gratë dhe të vetë grave për veten, sepse nëse dikush mendon se gratë janë inferiore në aftësi edhe do të presë më pak prej tyre. Një tjetër dëm i paragjykimeve është shtrembërimi i perceptimit të grave për aftësitë e veta, sepse i bën ato të besojnë se janë vërtetë inferiore krahasuar me burrat. Po kaq i dëmshëm është edhe shtrembërimi i fakteve nga paragjykimet, sepse në vend që të shihen siç janë, faktet shihen siç pritej të ishin. Ky efekt shihet sidomos kur gratë shfaqin shkallë të lartë kompetence profesionale dhe intelektuale. Në vend të vlerësohen për atë që janë, keto gra “anatemohen” si burra, pasi shfaqin aftësi intelektuale dhe profesionale që shihen si cilësi mashkullore. Për më tepër, ato edhe nënvlerësohen, sepse duke shfaqur cilësi mashkullore kanë dështuar të kryejnë rolin femëror të gruas pasive, të nënshtruar dhe pa ambicie (French, E & Lesser G, 1964:125).

Gjithashtu, edhe studime të kryera në Republikën e Shqipërisë e konfirmojnë këtë gjetje të literaturës perëndimore për paragjykimin e dyfishtë për gratë dhe vajzat. Siç konstatohet në studimin e Zyhdi Dervishit, për paragjykimet ndaj vajzave dhe grave, vajzat dhe gratë ndodhen nën trysninë e dyfishtë të paragjykimeve, pasi mbi to rëndojnë jo vetëm paragjykimet e llojllojshme të burrave, por dhe paragjykimet e ndërsjellta të njëra-tjetrës (2001:48).

Paragjykimet i ndjekin vajzat dhe gratë përgjatë gjithë ciklit të jetës, por në periudha të ndryshme të jetës ato shfaqin forma dhe intensitet të ndryshëm goditës. Studimet tregojnë se paragjykimet janë më të shumta dhe më penguese sidomos në moshën 15-25 vjeç, që përkon me adoleshencën dhe rininë e hershme (De Beauvoir, S., 2003:320). Rreth moshës 15 vjeç, në fillim të adoleshencës, vajzat pësojnë ndryshime të dukshme të fizikut që i bëjnë ato të bien në sy. Zhvillimi trupor shpesh i nxit të tjerët të mendojnë se tashmë vajzat 15 vjeçare janë të rritura. Gjithashtu, në këtë moshë formohet dhe konsolidohet personaliteti, dhe sjellja e tyre vëzhgohet intensivisht prej të rriturve të tjerë që presin që ato të sillen si të rritura e të shpalosin me vetëdije gjithë bagazhin e dijeve të ngulitura që në fëmijëri për rolin shoqëror të të qenit grua. Por, pavarësisht rritjes fizike, ndryshimeve fiziologjike hormonale dhe trupore, adoleshenca nuk shënjon hyrjen e një fëmije automatikisht në botën e të rriturve, përkundrazi, adoleshenca është një periudhë kalimtare dhe, si e tillë, nuk mund të jetë përfundimtare (Bernstein, A, Lenhart,S.,

1993:66). Përveç kësaj, adoleshenca merr vite për shndërrimin e një fëmije në një individ të rritur, vite që mund të zgjasin edhe një dhjetëvjeçar dhe nuk janë të njëjta për të gjithë adoleshentët (Brannon, L., 1996: 72). Natyrisht, zgjedhjet dhe vendimet që marrin adoleshentët mund të mos jenë shumë të peshuara, pasi stadi jetësor i adoleshencës nuk korrespondon me pjekurinë moshore të të rriturve. Prandaj edhe në këtë moshë, kontrolli prindëror ndaj sjelljes së vajzave adoleshente është shumë vigjilent.

Por, edhe përtej moshës së adoleshencës, përgjatë viteve të rinisë së hershme, deri në moshën 25 vjeç, paragjykimet për vajzat nuk zbuten. Paragjykimet në këtë moshë përdoren më së shumti si formë e kontrollit social që familjarët ushtrojnë mbi vajzat që këto të mos marrin “rrugë të keqe dhe mos shkelin në dërrasë të kalbur”, gjë që mund të ndodhë si pasojë e mungesës së përvojës jetësore (Dervishi, Z., 2001:49). Kjo periudhë e jetës korrespondon me ngjarje të mëdha në jetën e një vajze, siç janë: mbarimi i shkollës së mesme apo të lartë, krijimi i miqësive të ngushta që mund të zgjasin gjithë jetën, krijimi i lidhjeve intime dashurore që mund të përfundojnë në martesë, hyrja në punë, apo edhe ardhja në jetë e një fëmije (Papalia, D. P., Olds, S.W., & Feldman, R.D., 2008: 347). Për këtë arsye ka një kontroll të shtuar të familjes mbi jetën e vajzave dhe grave të reja në këtë periudhë të jetës, kontroll që synon të minimizojë sulmet dashakeqe të paragjykimeve dhe t’i mbrojë vajzat nga thashethemnaja e përfoljes që mund të dëmtojnë imazhin dhe emrin e familjes.

4.5. Paragjykimet gjatë moshës shkollore për vajzat në Farkë

Meqë paragjykimet për vajzat janë të pranishme gjatë gjithë jetës shkollore, pyetjet e shtruara në kërkim i hulumtojnë ato përgjatë të trija cikleve të shkollimit: në 8 dhe 9-vjecare, shkollë të mesme dhe shkollë të lartë. Nga të dhënat e kërkimit rezulton se nga 672 vajza dhe gra, vetëm 4.5 për qind janë me shkollë fillore dhe këto i përkasin moshës mbi 65 vjeç. Këto nuk kanë mundur të ndjekin shkollimin e metejshëm pasi vëtëm shkolla 4-vjeçare ishte e detyrueshme në moshën kur ato ishin reth 10-12 vjeç. Arsimi 8-vjeçar u bë i detyrueshëm vetëm pas viti 1963 dhe në atë kohë, këto gra ka qenë mbi 15 vjeç. Një pjesë e konsiderueshme e kampionit 35.3 për qind janë me shkollë 8-vjeçare. Mjaft prej tyre nuk e kanë kryer shkollën e mesme për arsye se janë futur shpejt në punë bujqësore në ndërmarrjen bujqësore “Gjergj

Dimitrov”, ndërsa një pjesë pohojnë se me përfundimin e shkollës 8-vjeçare nuk u lejuan nga familjarët të ndiqnin më tej shkollën e mesme për arsye të pasigurisë së madhe për jetën dhe moralin e vajzave në vitet 1990-2000. Vajzat dhe gratë me shkollë të mesme përfaqësojnë numrin më të lartë të të anketuarave me 37.8 për qind. Ndërsa 22.5 për qind e kampionit janë me shkollë të lartë dhe vetëm 0.4 për qind me formim pasuniversitar.

Të gjitha vajzat dhe gratë pohojnë se kanë qenë të paragjykuara në shkollën 8-vjeçare. Përqindja e të paragjykuarave në këtë moshë është shume e lartë, 94.3 për qind dhe lidhet me dy arsye. *Së pari*, të gjitha vajzat dhe gratë kanë kryer shkollën 8-vjeçare, e për pasojë numri i atyre që i janë përgjigjur pozitivisht kësaj pyetjeje është relativisht i lartë. *Së dyti*, sulmet e thashethemeve fillojnë të godasin vajzat pikërisht në moshën e pubertetit dhe adoleshencës. Gjatë kësaj moshe, 11-16 vjeç, vajzat pësojnë ndryshime fiziologjike të shpejta, në gjatësi, peshë dhe tipare dytësore seksuale duke i identifikuar për nga fiziku me gra të moshës së rritur. Shpesh rritja fiziologjike për vajzat përfundon në këtë moshë, pra rreth të 15-tave dhe prindërit dhe familjarët e vajzës tregojnë një kujdes të shtuar mbi sjelljen, veshjen, komunikimin dhe marrëdhëniet e vajzës me të tjerë, në mënyrë që të shmangin përfoljen ndaj moralit të vajzave. Ndryshimet fiziologjike shoqërohen edhe me një rritje graduale të përvojës jetësore që bashkëshoqërohet edhe me ndryshime në personalitet dhe në karakter, të cilat kristalizohen përgjate viteve të adoleshencës dhe rinisë së hershme. Ndikimi i mjedisit të ngushtë shoqëror si: familja, fisi, fqinjët, shoqet e shkollës dhe mësuesit është shumë i fuqishëm në këtë periudhë të jetës.

Kanë raportuar për paragjykime në shkollën e mesme 405 vajza dhe gra. Ndër këto 382 raportojnë se janë ndjerë të paragjykuara në shkollë të mesme, që në raport me numrin e përgjithshëm të të anketuarave përfaqësojnë 56.8 për qind, ndërsa në raport me numrin e atyre që kanë përjetuar paragjykimet në shkollë të mesme përfaqësojnë 94.3 për qind të të paragjykuarave. Vetëm 5.6 për qind ose 23 prej tyre deklarojnë se nuk janë ndjerë të paragjykuara në shkollën e mesme. Pësha specifike e vajzave dhe e grave që kanë përjetuar paragjykime në shkollë të mesme është e njëjtë me atë të shkollës 8-vjeçare.

Për paragjykimet në shkollën e lartë kanë raportuar 151 vajza dhe gra që kanë përfunduar të trija ciklet e shkollimit: 8-vjeçar, të mesëm dhe të lartë dhe që përbëjnë 19 për qind të kampionit prej 672 vetësh. Nga këto 128 vajza dhe gra që përfaqësojnë 86.5 për qind të atyre me

shkollë të lartë janë ndjerë të paragjykuara në shkollë të lartë dhe vetëm 13.5 për qind nuk janë ndjerë të paragjykuara.

4.6. Paragjykimet për vajzat në shkollën 8-vjeçare

Vajzat paragjykohen prej gjithë mikromjedisit rrethues, por më shumë prej njera-tjetrës, prej të afërmeve të fisit të babait dhe prej mësueseve gra. Paragjykesit mund të grupohen në katër kategori: (i) shoqëria e shkollës ku bëjnë pjesë shoqet dhe shokët e klasës, (ii) fisi ku bëjnë pjesë të afërm të fisit të babait dhe të nënës; (iii) fqinjët dhe (iii) mësuesit ku bëjnë pjesë mësuesit burra, mësueset gra dhe mësueset vajza (beqare). Shoqëria e shkollës është grupi më paragjykes për vajzat me 33.5 për qind të peshës specifike të paragjykesve, ku peshën më të lartë e mbajnë vajzat me 24.6 për qind përkundrejt djemve me 8.9 për qind. Pas shoqërisë së shkollës, në vend të dytë, vjen fisi me peshë specifike 30.7 për qind ku fisi i babait ze 23.1 për qind dhe ai i nënës 6.5 për qind. Në vend të tretë vijnë fqinjët që zenë një peshë specifike prej 18.9 për qind të paragjykesve. Në vend të katërt dhe të fundit renditen mësuesit me 14.4.

4.6.1. Të paragjykuara më shumë nga shoqet


Në shkollën 8-vjeçare, që aktualisht është 9-vjeçare, vajzat kanë përjetuar më shumë paragjykim prej shoqërisë së tyre se sa prej të tjerëve. Ndër personat që i kanë paragjykuar më shumë vajzat në shkollë kanë qenë vetë vajzat, pra shoqet e klasës të cilat zenë 24.6 për qind të peshës specifike të paragjykesve, ndërsa djemtë 8.9 për qind. Siç duket, edhe nga përqindjet, vajzat janë dy herë e gjysëm më shumë paragjyqese se djemtë për njera tjetrën. Ka disa arsye se përse vajzat janë me paragjyqese për njëra-tjetrën se sa djemtë.

Së pari, vajzat qëndrojnë më shumë me njëra tjetrën në shkollë se sa me djemtë dhe për pasojë, ato kanë mundësi të vëzhgojnë dhe komentojnë cilësitë dhe sjelljen e njera tjetrës më shumë se çdo të bënin djemtë. Shoqëria me djemtë shkurajohet prej të rriturve kryesisht prej familjarëve, por edhe prej mësuesve, për arsye që lidhen me moralin dhe nderin. Miqësisë mes vajzave dhe djemve i vihen shumë pengesa moralizuese që mbajnë nën kontroll më shumë vajzat se sa djemtë. Ketyre të fundit shoqëria me vajza iu komentohet si shkathtësi seksuale dhe madje

inkurajohen nga normat kulturore të kenë sa më shumë njohje të tilla. Pra, normat në lidhje me miqësinë midis gjinive kanë standarte të dyfishta: për djemtë janë lejuese, ndërsa për vajzat janë ndaluese. Për arsye se shoqëria me djem mund të shihet si e dyshimtë prej të tjerëve, vajzat kufizohen të krijojnë shoqëri me djem dhe lejohen të kenë miqësi vetëm me njëra tjetrën. Kjo ndarje gjinore e shoqërisë shkollore, në shoqëri vajzash dhe shoqëri djemsh, bën që dy grupet të kenë marrëdhënie shoqërore të pakta me njëri-tjetrin dhe për pasojë të mos njihen sa duhet. Për më tepër, të edukuara për të qenë më shprehëse dhe me të orientuara ndaj plotësimin të nevojave të të tjerëve, vajzat e kanë më të lehtë të vendosin marrëdhënie miqësore. Miqësia e bën marrëdhënien mes tyre më intime. Gjatë qëndimit me njëra-tjertën, ato i hapen njëra-tjetrës më shumë se askujt tjetër për dëshirat, perceptimet, pëlqimet dhe nevojat personale. Kjo hapje në mirëbesim ofron shumë informacion, të cilin shoqet mund edhe ta keqpërdorin.

Vajzat e gjykojnë njëra-tjetrën për shumçka duke përfshirë tiparet fizike, sjelljen, personalitetin, veshjen, qëndrimet, origjinën krahinore ose klasore, etj. Në një nga intervistat, një vajzë në vitin e fundit të shkollës së mesme, ende e lënduar nga thashethemet në drejtim të moralit prej shoqeve të klasës rrëfen se: “Gojë e liga të shoqeve të shkaktojnë një plagë që edhe me kalimin e viteve nuk mbyllet. Unë e kam pësuar prej thashethemeve kur isha në klasën e tetë. Ende më mundon zhgënjimi që më shkaktuan kur më përfolën për shoqërinë e pastër që kisha me një djalë nga klasa paralele me të cilin takohesha në prani të tyre në korridorin e shkollës ose në oborr për të konfirmuar zgjidhjet e problemave në matematikë. Një ditë, sa nuk më ra të fikët kur kushëriri im në po atë shkollë më thotë të mos shoqërohesh me me atë djalin se po ziente gjithë shkolla! U shokova tej mase dhe desha ta bindja që ishte thjesht një keqkuptim, ndërsa ai ma preu duke më thënë se për të ashtu ishte, por jo për shoqet e mia.” Ndërsa e tregonte këtë histori me tone vuajtëse, i lexohej në sy brenga që mbante brenda vetes edhe pse kishin kaluar disa vite.

Kush i paragjykon më shumë vajzat në shkollën 8-vjeçare?



Së dyti, vajzat konkurojnë për të rënë në sy të djemve dhe për të tërhequr vëmendjen e tyre. Përgjithësisht marrëdhëniet mes vajzave janë më miqësore dhe intime, krahasuar me ato mes djemve, të cilët i ndruhen hapjes personale dhe vendosjes së raporteve të ngushta me njëri-tjetrin, nga frika se mos miqësia mes tyre keqkuptohet prej të tjerëve dhe interpretohet si deviancë seksuale. Gjithësesi, edhe miqësia mes vajzave ka pëngesat e veta. Njëra prej tyre është konkurrenca për djem. Në moshën e adoleshencës së hershme, njohja me persona të gjinisë tjetër i ndihmon vajzat të përcaktojnë identitetin e tyre gjinor. Edhe pse shoqërimi me djem nuk inkurajohet, njohjet e vajzave me djem janë të pashmangshme, aq më tepër që vajzat dhe djemtë shkollohen në të njëjtat mjedise arsimore. Dëshira për të bërë për vete një djalë i ekspozon miqësitë e tyre ndaj mosbesimit tek njëra-tjetra. Shumë prej kontakteve të paqëllimta të vajzave me bashkëmoshatarë interpretohen si lidhje të dyshimta prej vetë atyre. Vajzat e shohin njëra-tjetrën si rivale, sidomos për lidhjet ose shoqërimin me djem me status më të lartë shoqëror. Kjo është e kuptueshme, pasi në një shoqëri tradicionale ku statusi femëror përcaktohet prej pozitës sociale të mashkullit, vajzat priren të krijojnë njohje me djem që vijnë nga familje më të pasura, me prona, më prindër me pozitë ose me djem më të rritur. Gara mes njëra-tjetrës për të tërhequr vëmendjen e djemve ua kufizon miqësitë vajzave. Madje, në kërkim të shoqërisë me djem me status, ndodh që t'i konsiderojnë miqësitë me vajza të tjera si më pak të rëndësishme pasi nuk sjellin ndonjë përfitim. Njëra nga të intervistuarat përshkruan historinë e njohjes me një djalë në

shkollë dhe zilinë e shoqes së ngushtë për këtë lidhje: “Nuk e mendoja kurrë se shoqja ime e ngushtë mund të ishte armikja ime e përbetuar. Kur u lidha me një djalë në shkollë, të cilin e njihnim të dyja dhe vinte nga një familje e mirë, ajo nuk shfaqti asnjë shenjë gëzimi madje nuk e priti mirë dhe unë e mora për xhelozë dhe dashamirësi nga ana e saj sepse koha që kaloja me të do i kushtohej atij. I tregoja gjithçka shoqes sime sepse kisha nevojë të hapësira me dikë. Por një ditë, pas një pritje të gjatë pas mësimit, ai djali më telefonon për të më thënë se kishte mësuar se unë kisha një tjetër. Kur i tregoj shoqes sime për incidentin, ajo pa iu dridhur qerpiku më pohoi ftohtë se informacionin ia kishte dhënë ajo dhe që nga ajo ditë nuk folëm më”.


Së treti, vajzat konkurojnë për të rënë në sy të mësuesve. Një prej pritshmërive shoqërore në shkollën 8-vjeçare për vajzat është edhe arritja e rezultateve të larta në mësim. Arritjet akademike i identifikojnë vajzat e kësaj moshe jo vetëm si nxënëse të mira por edhe si vajza të mira, pasi performanca akademike është një tregues që mund të parathotë ecurinë e mëtejshme në shkollë dhe sjelljen e mëvonshme. Vlerësimet me nota të mira flasin për një përdorim të mirë të kohës në dobi të të mësuarit dhe jo për veprimtari të padobishme që nuk kanë lidhje me formimin shkollor. Meqë treguesit akademikë janë të ndërlidhur me sjelljen në shkollë, vajzat përpiqen që përmes të mësuarit të marrin jo vetëm vlerësim me nota sa më të mira por, edhe përgëzime për sjellje të mirë. Natyrisht jo të gjitha ja dalin të marrin vlerësime të larta akademike dhe ato që janë nxënëse shumë të mira ngjallin zili tek nxënëset e tjera. Dëshira për t’u vlerësuar pozitivisht nga mësuesit i vendos vajzat në një garë të ethshme kundrejt njëra-tjetrës. Por sado që përpiqen të bien në sy të mësuesve për mirë, jo të gjitha ja dalin me sukses, aq më tepër që krijimi i përshtypjeve pozitive tek mësuesit është ngushtësisht i lidhur me rezultatin në mësim, çka arrihet përmes përpjekjeve individuale. Këtë e tregon vetë forma e vlerësimit me notë që është vlerësim individual dhe jo kolektiv. Mënyra se si është organizuar të mësuarit dhe vlerësuarit i nxit nxënësit drejt një gare individuale që nuk lejon bashkëpunim tjetër përveç atij që garanton sukses individual. Në fakt ky organizim jep një mesazh kundërtësues për vajzat, të cilat janë edukuar për të qenë më shumë të orientuara drejt ndërvarësisë dhe bashkëpunimit me të tjerët, se sa drejt pavarësisë dhe suksesit personal, që janë attribute të pëlqyeshme për sjelljen mashkullore. Një e intervistuar në bisedë u shpreh: “Vajzat në sipërfaqe përshfaqin një pamje prej nxënëseje të edukuar dhe të sjellshme për të rënë në sy të mësuesve, por në thellësi trazohen nga ndjenja e cmirës për arritjet e nxënëseve të mira dhe bëjnë çmos t’u vënë shkopinj nën rrota duke i përfolur si “peshkope”, si qenie të “dala jashtë kohe”, me horizont të ngushtë e që nuk

marrin vesh nga jeta, etj. Akoma i kam ndër sy lotët e nxënësës më të mirë të klasës, të cilës disa vajza nga zilia i fluturonin çantën e librave nga dritarja për ta poshtëruar. Edhe sot ndihem keq që nuk mund ta mbroja dot”. Në këtë rrëfim duket qartë se si nevoja e paplotësuar për vlerësim pozitiv nga ana e mësuesve i nxit nxënëset e lëna në hije, përta i përket përparimit në mësim, të dalin në sipërfaqe me sjellje hakmarrëse duke kundër-reaguar tërthorazi ndaj mungesës së vlerësimeve prej mesuesve. Duket se në këtë mënyrë ato kompensojnë pabarazinë me njëra-tjetrën, krijuar prej diferencave në të nxënë dhe në vlerësim.

Së katërti, vajzat janë mësuar ta gjykojnë veten si më pak të afta si pasojë e shoqërizimit. Përgjatë viteve të fëmijërisë vajzat shoqërizohen për rolin përkujdesës, ndërsa djemtë për rolin e sigurimit të ushqimit. Edhe pse pritet që këto role të përmbushen në rradhë të parë brenda kontekstit familjar, pritshmëritë shoqërore janë të tilla që këto role të shtrihen edhe jashtë gjirit të familjes dhe të realizohen edhe në sferën publike. Pritshmëritë e ndryshme për vajzat dhe për djemtë kanë ndikim edhe në perceptimin për veten. Ndikim të madh kanë edhe stereotipet gjinore sidomos tek vajzat pas moshës 12 vjeç (Orenstein, 1995:15). Në fillim të adoleshencës vajzat përballen me më shumë kërkesa prej familjes, të afërmeve, fqinjëve dhe mësuesve për t’u përshtatur me rolin social të gruas që nënkupton më shumë përgjegjësi për përkujdes ndaj pjesëtarëve të familjes, punëve të shtëpisë: si gatimi, pastrimi, mirëmbajtja e rregullit të shtëpisë. Stereotipet gjinore dhe ideologjia seksiste që predikon përmbushjen e një gruaje vetëm nëse plotëson rolin e bashkëshortes dhe nënës prek thajse çdo aspekt të jetës së një vajze (Friedan, B, 1963:15). Për një vajzë, të sapodalë nga bota e fëmijërisë, ku pritshmëritë përmbushen duke luajtur “shtëpiash”, ballafaqimi me realitetin, ku përgjegjësitë nuk janë më një lojë, por detyra shoqërore, është shokues. Vajzat pritet të tregojnë shkathtësi në përmbushjen e këtyre detyrave përgjatë pubertetit dhe gjithë adoleshencës. Për kryerjen me sukses të rolit shtëpiak ato marrin edhe vlerësime positive përgjithësisht prej anëtarëve të rritur të familjes, prej fqinjëve dhe fisit. Mirëpo në shkollë, vajzat vendosen edhe përballë kërkesave për përparim në mësim që për t’u përmbushur kërkojnë jo vetëm kohë fizike në dispozicion, por edhe motivim nga ana e vajzave. Nëse i gjithë edukimi informal shoqërizues ka synuar të formojë shprehi sociale në funksion të përmbushjes së rolit të përkujdesjes tek vajzat, kërkesat për edukim formal nxisin formimin e shprehive që lidhen me suksesin vetjak. Mesazhet kundërthënëse që vijnë nga mjedisi social dhe nga shkolla krijojnë konfuzion tek vajzat për përzgjedhjen e qëndrimeve ndaj shkollës. Për më tepër, në fshat, vajzat edhe pse shkojnë në shkollë janë më të trysnuara nga kërkesat e

mikromjedisit të ngushtë social, të familjes dhe fisit, se sa nga pritshmëritë për përparim në mësim të mësuesve, kontakti me të cilët është më shumë formal se sa ndërveprues. Vajzat nuk kanë kontakte të tjera përveç orës së mësimit me mësuesit e shkollës, pasi pjesa më e madhe e të cilëve as që nuk jetojnë në fshat, por vijnë nga qyteti dhe largohen me mbarimin e mësimit. Konflikti që shkaktohet prej prishmërive të ndryshme për vajzat në fshat nga familja dhe nga shkolla rezulton në paqartësi për vajzat që nuk dinë të përcaktojnë se cila pritshmëri shoqërore vlen të përmbushet më mirë: ajo e përkujdesjes që kërkohet nga familja dhe mbështetet edhe nga shoqëria apo ajo e suksesit akademik individual që kërkohet nga sistemi arsimor? Meqë presioni shoqëror që vjen nga familja dhe rrethi i gjerë shoqëror është më i madh se sa kërkesat formale të shkollës, pritshmëritë për rolin përkujdesës marrin përparësi ndaj suksesit akademik për vajzat.

Grafiku: Paragjykuar më shumë në shkollën 8-vjeçare



Përveç kësaj mospërputhje në rolet sociale, para vajzave qëndron edhe një hendek psikologjik që është vetvlerësimi i ulët në lidhje me aftësitë për të bërë gjëra që nuk lidhen me rolin përkujdesës, që është një ndikim i drejtëpërdrejtë i stereotipizimit gjinor të sjelljes femërore. Vajzave, sidomos në fshat, iu thuhet shpesh se nuk duhet të flasin para të tjerëve, se mendimet duhet t'i mbajnë për vete dhe se duhet të sillen në atë mënyrë që të mos bien në sy. Këto udhëzime nuk i ndihmojnë vajzat të shkëlqejnë në shkollë, përkundrazi edhe atëherë kur ato kanë mësuar dhe e dinë përgjigjen, ato ngurrojnë ta ngrenë dorën dhe të përgjigjen në orën e mësimit. Në një intervistë, në vajzë që kishte dhunti në matematikë u shpreh se: “Edhe pse e dija përgjigjen, nuk e ngrija dorën sepse kisha shumë ankth të flisja para të tjerëve, kisha frikë se

emocionet më tradhëtonin dhe jepja përgjigjen e gabuar. Nëse do ndodhte kështu do humbja edhe atë fare pak besim që kisha tek vetja. Mua sikur do më pushonte zemra po të ngrija dorën. I thosha vetes “Ngrihu, mos ki turp!” por nuk më dilte zëri. Mirë që bëja detyrat e shtëpisë që mësuesja të kuptonte se nuk isha keq në matematikë”.

Duke mos marrë pjesë në mësim vajzat nuk kanë mundësi as të tregojnë se kanë mësuar dhe as të korrigjohen nëse nuk janë të qarta për përgjigjen. Në shumë takime, vajzat pohuan se djemtë ishin më të guximshëm dhe merrnin fjalën pa e kërkuar edhe pse nuk e dinin përgjigjen apo nuk e kuptonin pyetjen. Gjithashtu, mesueset kryesisht, për arsye disiplinimi, ua jepnin më shumë fjalën djemve ose për t’i bërë ata pjesëmarrës ose për mos t’i lejuar të prishnin mësimin. Përvoja e shkollës nuk u shërben vajzave për të ngritur vetvlerësimin, pasi mësueset plotësojnë më shumë pikësyzimet e veta për të vënë qetësi në klasë, duke u marrë më shumë me disiplinimin e sjelljes së djemve se sa me mësimin. Hezitimi i vajzave për të folur në klasë është tregues i vetbesimit të ulët. Për pasojë ato nuk aktivizohen sa duhet në klasë. Mungesa e pjesëmarrjes u heq të drejtën për të folur, për t’u dëgjuar dhe për të gabuar. Vajzat nuk guxojnë të marrin përsipër rrezikun e dështimit akademik, si një mundësi për t’u përmirësuar në të ardhmen. Përvoja e aktivizimit në klasë rrit kapacitetin për të mësuar. Nxënësit që flasin kanë edhe më shumë mundësi të marrin vlerësime, gjë që rrit vetvlerësimin. Gjithashtu, ata që marrin pjesë në mësim zhvillojnë dëshirën për të mësuar dhe mbajnë qëndrim pozitiv ndaj shkollës (Sadker, M & Sadker, D., 2010:79). Në kushtet kur angazhimi i vajzave kufizohet prej vetbesimit të pakët se mund t’ia dalin, vetparagjykimi për aftësitë akademike është i pashmangshëm.

Vajzat e paragjykojnë shumë njëra-tjetrën edhe për pamjen e jashtme. Vajzat që janë ndjerë të paragjykuara nga shoqet për veshjen përbëjnë 39.4 për qind të të paragjykuarave. Veshja është simbolikë dhe përmban mesazhe për shikuesit. Të vëna nën tryshninë e garës së dukjes së jashtme vajzat preokupohen shumë për imazhin dhe veshjen e përditshme. Shkolla ka uniformë për nxënësit, por ajo nuk përdoret rregullisht dhe nga të gjitha. Mungesa e disiplinës shkollëre për veshjen u le mundësi vajzave të mos e respektojnë uniformën dhe të vishen si të dëshirojnë. Uniforma nuk vishet për tri arsye. *E para*, sepse uniforma përbën shkak për paragjykim për mospasjen e të ardhurave familjare dhe pamundësinë financiare për të blerë rroba cilësore dhe të shtrenjta. Vajzat që veshin uniformë etiketohen si të varfra. Ato përballen edhe me fyrrje nga shoqet të cilat i qesëndisin me romuze të llojit: “t’u ngjitën rrobat në trup”,

“ndërroje njëherë lëkurën”, “laje njëherë uniformën”, etj. *E dyta*, veshja u krijon mundësi vajzave të tregojnë pozitën shoqërore para njëra-tjetrës dhe ato përpiqen të duken edhe më mirë se ç’janë në të vërtetë pozitat ekonomike të familjeve të tyre. Me anë të veshjes, vajzat kanë krijuar në lloj shtresëzimi shoqëror në mjediset shkollore, duke vlerësuar si shtresë të lartë ata nxënës që vishen më rroba relativisht të shtrenja, të modës dhe që i ndërrojnë shpesh veshjet. Ndërsa ato që nuk kanë mundësi të krijojnë një graderobë luksoze me të ardhurat e familjes konsiderohen si shtresë më e ulët. Por, në fund të hierarkisë shoqërore të veshjes qëndrojnë ato vajza që veshin unifromën, të cilat përçmohen se nuk kanë çfarë të veshin. *E treta*, vajzat e përdorin veshjen si strategji për të rënë në sy, jo vetëm të njëra-tjetrës, por edhe të djemve. Në vitet e fundit të shkollës 8-vjeçare dhe 9-vjeçare, vajzat kanë një identitet të qëndrueshëm gjinor dhe shfaqin interes për gjininë tjetër. Zhvillimi hormonal ndikon shumë në tërheqjen e ndërsjelltë të adoleshentëve ndaj gjinisë tjetër për të krijuar shoqëri intime dhe për të flirtuar. Në këtë moshë fillojnë edhe dashuritë e para mes vajzave dhe djemve në shkollë, të cilat kanë një ndikim të madh në dinamikën e marrëdhënieve të tyre. Tërheqja ndaj djemve është kaq e fortë sa që në shumë raste vajzat prishin edhe miqësitë me njëra tjetrën për arsye rivaliteti, për të rënë në sy të djemve, sidomos atyre që vijnë nga familje me status më të lartë shoqëror dhe ekonomik se të vetin.

Vajzat e paragjykojnë njëra-tjetrën edhe për sjelljen, për të cilën janë paragjykuar 16.4 për qind e tyre. Nuk është çudi që vajzat janë për vete paragjykuese të sjelljes së njëra-tjetrës. Ato që në vogëli i janë nënshtruar procesit të shoqërizimit, përmes të cilit kanë formuar kuptimet e veta për sjelljen femërore dhe mashkullore. Kuptimet kulturore për sjelljen e përshtatshme sipas gjinisë përkthehen në parashikime të forta se si duhet të sillen njerëzit në situatë të caktuara. Parashikimet avancojnë përshtypjet dhe kthehen në stereotipe të qëndrueshme që i kategorizojnë sjelljet në të përshtatshme ose jo. Të mësuarit social është i mbushur me stereotipe gjinore, të cilat e ngurtësojnë sjelljen brenda kufijve të qartë për secilën gjini bashkë me udhëzimin që kufijtë nuk duhen kapërcyer. Sado që në pamje të parë stereotipet duket se kanë një funksion pozitiv në parashikimin e sjelljes, kufijtë që ato vendosin për sjelljen individuale kanë pasoja negative. Në rastin e vajzave dhe grave, kufijtë e imponuar nga stereotipet gjinore janë shumë shtrëngues dhe “policohen” ashpërsisht prej shoqërisë, prej burrave dhe vetë grave që i ndruhen ndëshkimit shoqëror në rast moskonformimi. Ngurtësia e rolit gjinor pengon kapacitetin dhe potencialin e vajzave dhe grave të materializohet në ato fusha në të cilat ato

ndihen të afta të veprojnë. Arsimi ka qenë thujtë e vetmja mundësi për vajzat dhe i ka nxjerrë ato nga korniza e ngurtë e rolit social si qenie të varura, pasive dhe pa ambicie, duke i përgatitur me shprehuri punë dhe jete. Megjithatë arrijtjet e sigururara në përparimin shoqëror të vajzave, edhe arsimit si pjesë e institucionit social të edukimit ku konsumohet kulturë vuan në praktikën e vet shfaqjen e stereotipeve gjinore për disa arsye. Së pari, ndërveprimi i aktorëve të shkollës është i stereotipizuar nga pikpamja gjinore. Së dyti, aktorët janë mbartës të skripteve kulturore që janë të gjinizuara dhe shfaqin qëndrime stereotipike në sjelljen e tyre dhe së treti, programi i fshehtë i shkollës që është të mësuarit e vlerave të përbashkëta kulturore është i gjinizuar. Të gjithë këta faktorë ndikojnë që shkolla të shndërrohet në riprodhuese të kulturës, sado të propagandojë luftën kundër qëndrimeve paragjyquese dhe sjelljes diskriminuese kundër vajzave.


Vajzat kanë shumë paragjykime për aftësitë e veta sidomos për ato që kanë të bëjnë me përparimin në mësim. Rreth 12.1 për qind e vajzave ndihen të paragjykuara nga shoqet e tyre për aftësitë. Ato e gjykojnë veten më pak të afta se djemtë edhe pse arrijtjet në mësim i kanë shpesh më të mira. Kur dalin mirë në një orë mësimi ose në një provim, vajzat ia dedikojnë suksesin më shumë rrethanave se sa zotësisë së tyre. Kur intervistova disa vajza që i pritën të dilnin nga provimi i kimisë, ato të gëzuara thanë se kishin dalë mirë në provim ngaqë fati kishte dashur t'u binin pyetje të lehta që i dinin. Është e qartë se më shumë se vetes, vajzat ia atribuojnë suksesin vetjak fatit, duke treguar kështu bindjen se sukcesi i tyre është rastësor dhe lidhet me faktorë të jashtëm dhe jo të brendshëm. Megjithatë ishin përgatitur për provimin ato nuk e lidhën suksesin me zotësinë dhe aftësinë e treguar si pasojë e një pune të mëparshme, por ja lanë kurorën rastësisë. Edhe pse demonstrojnë aftësi të mira akademike, vajzat kanë vetbesim të ulët, i cili është shumë i ndikuar nga vlera e pakët që të rriturit në zona rurale i japin formimit arsimor të vajzave. Për shkak të vlerësimit të munguar të familjes fshatare për shkollimin e mëtejshëm të vajzave, vajzat jo vetëm që nuk ndihmohen të mësojnë, por edhe rëndohen me punë shtëpie dhe bujqësi në ekonominë familjare.

Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarave, 10.9 përqind janë ndjerë të paragjykuara për cilësitë e tyre fizike. Në moshën e adoleshencës, ndryshimet në tiparet fizike, që nga madhësia trupore e deri tek tiparet e fytyrës, janë të dukshme dhe përfundimtare. Këto ndryshime bëhen shpesh shkak për etiketime me qëllim denigrues nga ana e vetë adoleshenteve. Etiketimet nuk kursehen as për ato vajza që zmadhohen në trup dhe as për ato që nuk e kanë përfunduar ende ciklin e rritjes. Vajzat me përmasa të mëdha trupore janë shpesh tabelë qitje si për shoqet.

Ato etiketohen me cilësime fyese të huazuara nga fjalori rural blegtoral si “lopë”, “pelë”, “mushkë”, “dosë”. Ku sulm verbal ka për synim të ulë vlerën e vajzave të etiketuara dhe krijon një barriera përjashtuese për to. Njëra nga arsyet për sulme të tilla dashakeqe është edhe dëshira e vajzave për të tërhequr vëmendjen e djemve mbi veten, pasi vajzat me trup të zhvilluar bien më shumë në sy dhe janë më tërheqëse për djemtë. Edhe vajzat me një fizik më pak të zhvilluar janë pre e paragjykimeve. Ato shpesh etiketohen me cilësime fyese që aludojnë varfërinë. Vajza të tilla vihen veçanërisht në lojë kur edhe shkëlqejnë në shkollë. Rezultatet e mira akademike të tyre ngjallin zili tek shoqet të cilat i ironizojnë me shprehje poshtëruese. Njëra nga të intervistuarat gjatë rrëfimit të historisë së vet në shkollën 8-vjeçare në lidhje me etiketimet përçmuese nga shoqet e klasës u shpreh: “Në klasë të 8-të unë isha ende imcake dhe mezi dukeshja mes shoqeve të mia që më mbulonin me gjatësi. Isha shumë e dobët që e vogël, por kur hyra në adoloshencë dobësia ime binte edhe më shumë në sy dhe krijonte një dallim shumë të dukshëm mes meje dhe bashkëmoshatareve të mijja. Megjithëse e imët, unë isha nxënëse e mirë dhe dilja shllëqyeshëm në provime. Shoqet e mia, edhe pse përfitonin prej meje sepse u tregoja detyrat dhe problemat në provime, kishin shumë zili dhe më tallnin duke më fyer ”mos na u hiq si e zgjuar se kokëthatë je, ku i gjete mendttë ti, dy kile njeri je!”. E ndjeja veten shumë keq që më bënin objekt sulmi vetëm për shkak të fizikut dhe nuk shihnin që kisha gjëra të tjera për t’u vlerësuar”.

Edhe pse mënyra e të folurit dhe dialekti zënë një peshë specifike më të ulët se sa paragjykimet për sjelljen, veshjen dhe cilësitë fizikë, ato janë shumë shqetësuese për 8.5 për qind të vajzave që shprehen se janë paragjykuar për këtë shkak. E folura dhe dialekti janë linja të qarta dalluese në popullatën e Fakës e cila është e përbërë nga vendas dhe të ardhur kryesisht nga veriu i Shqipërisë, Kukësi dhe Dibra. Vajzat me origjinë nga Veriu vihen shpesh në lojë për mënyrën e të folurit dhe dialektin, për shkak të origjinës që identifikohet përmes të folurit. Vajzat me origjinë nga veriu ndihen shumë të paragjykuara sepse me kast vajzat vendase bëjnë sikur nuk i kuptojnë kur flasin ose u thonë të flasin “shqip”. Paragjykimi për të folurën është shenjë e epërsisë së grupit të vendasve ndaj të ardhurve. Vajzat e ardhura nga veriu konsiderohen si të huaja. Edhe pse banorët nga veriu e kanë blerë tokën nga fshatarët e Farkës, përsëri ndaj tyre mbahet një qëndrim disi armiqësor sikur ta kishin zaptuar tokën. Në bisedat rastësore me banorët vendas shpehej frika se të ardhurit do shndërroheshin shpejt në zotër të fshatit sepse pasi u kishin marrë tokat do u merrnin edhe vajzat për nuse. Të ardhurit e kishin perceptuar këtë ndjesi armiqësore të vendasve dhe kishin krijuar lagje të përbëra nga familje të së njëjtës krahinë, fshat

e madje edhe fis, për t'u ndodhur në shoqërinë dhe mbrojtjen e njëri-tjetrit. Edhe lagjet kishin marrë emra të rinj sipas përkatësisë krahinore të banorëve, si Kukës i Madh, Kukës i Vogël dhe lagja e dibranëve. Në shkollë, vajzat përcillnin ndjesitë e prindërve dhe të afërmeve të tyre që shpreheshin me konsidetara jomiqësore për të tjerët që nuk ishin të ngjashëm me ta. Një vajzë që kishte ardhur shumë e vogël nga Kukësi me familjen shprehet se paragjykimet për dialektin ishin shumë të hidhura dhe të përditshme duke treguar: “Ne kemi ardhur nga Kukësi kur unë isha 5 vjeç dhe shkollën e kam bërë këtu. Megjithëse kam kaluar gjithë jetën këtu, vajzave të klasës që janë rritur me mua u duket sikur kam ardhur sot nga Kukësi dhe më shohin si të huaj. Ma kujtojnë shpesh origjinën dhe më tallin me fljalë të zonës sonë, të cilat unë nuk i përdor kurrë me to, por vetëm kur flas më të afërmit e mi. Edhe pse nuk dallohem në të folur kur komunikoj jashtë shtëpisë, përsëri për shoqet e mia mbetem “maloke që nuk di me fol”!.



Vajzat paragjykohen mes njëra tjetrës më një denduri shumë të lartë, 65.5 për qind çdo ditë, çdo javë dhe çdo muaj. Peshën më të madhe të të paragjykuarave e zënë vajzat që e vuajnë përditë peshën e paragjytimeve të shoqeve që përbëjnë 32.7 për qind. Kjo është një shifër shumë domethënëse që flet për një sulm të vazhdueshëm të vajzave kundër njëra-tjetrës. Mbajtja lart e tempit të luftës paragjyqese kundër njëra-tjetrës vjen nga vigjilenca që ato tregojnë për të të vëzhguar dhe vënë në peshore qëndrimet, sjelljen dhe veprimet e njëra-tjetrës. Askush nuk i

paragjykon vajzat më një frekuencë kaq të lartë, përditë, sa ç'e paragjykojnë ato njëra-tjetrën në shkollë. Vrulli i paragjytimeve nuk bie as përgjatë javëve dhe muajve të shkollës. Shpeshtësia me të cilën vajzat paragjyken çdo javë dhe çdo muaj është 32.8 për qind, thuajse identike me shpeshtësinë e paragjytimeve të bëra çdo ditë në drejtim të vajzave nga njëra-tjetra. Paragjykimet e bëra nga njëra-tjetra i mban vajzat në gjendje alarmi se janë gjithë kohës nën vëzhgim nga "policia" e moshatareve të veta, gjë që kompromenton krijimin e miqësive afatgjata dhe të sigjerta mes tyre. Edhe vajzat që ekspozohen më rrallë se një herë në muaj ndaj paragjytimeve të shoqeve përfaqësojnë një përqindje të konsiderueshme me peshë specifike 33.9 për qind. Shpeshtësia me të cilën vajzat paragjykojnë njëra-tjetrën në shkollë tregon se paragjykimi brenda gjinisë është i pranishëm përgjatë gjithë jetës shkollore dhe u shkakton shqetësim të konsiderueshëm vetë vajzave, të cilat luftën me paragjykimet e kanë më të ashpër mes vetes se sa me të tjerët.

4.6.2. Të paragjykuara nga mësuesit

Vajzat paragjyken edhe prej mësuesve të tyre për aftësitë, sjelljen dhe veshjen. Mësuesit në fakt më shumë janë kritikë pasi mundohen që t'i tërheqin vajzave vëmendjen për mësimet. Mësueset janë më shumë paragjyktuese se sa mësuesit për veshjen dhe sjelljen ndërsa mësuesit janë më kritikë për aftësitë e nxënëseve të tyre. Mësuesit janë edhe më autoritarë se mësueset. Vajzat ndihen shumë keq kur kritikohen nga mësuesit për aftësitë, pasi mësuesit flasin rrallë, por e "kanë fjalën të rëndë si guri". Opinione të anketuarave në lidhje me stilet pedagogjike janë shumë të ndryshme, përsa i përket kohës të cilës i referohen. Brezi i grave mbi 40 vjeçe ankohet më shumë për stilet e ashpra pedagogjike të përdorura në kohën e tyre. Njëra prej tyre rrëfën: "Kur isha në shkollë 8-vjeçare, mësuesi i punës me dru na godiste në duar me shkop druri dhe madje na kërcënonte se do na thyente gishtat me çekan. Unë terrorizohesha nga sjellja e pamëshirshme e tij dhe, megjithë përqëndrimin, unë e humbja toruan nga frika kur i vinte radha punës sime. Aq i tmerrshëm ishte ky mësues, sa më shumë frikë kishim lëndën e punës me dru se sa matematikën". Gratë më të reja dhe vajzat e që në kohën e studimit ishin në vitin e fundit të shkollës së mesme nuk kujtojnë ngjarje kaq terrorizuese nga përvoja e shkollës, por dëshmojnë raste të rralla kur janë qëlluar me pëllëmbë nga mësuesit për detyrat e shtëpisë. Është e lartë pesha specifike e vajzave, 41.7 për qind, që janë paragjykuar, kritikuar, madje edhe

ndëshkuar nga mësuesit për aftësitë në të mësuar. Një e katërta e e vajzave janë paragjykuar për veshjen, njësoj si nga mësuesit ashtu edhe nga mësueset, të cilët u kanë terhequr atyre vëmendjen për llojin e papërshtatshëm të veshjes në shkollë. Njëra nga të intervistuarat tregon: “Në vitin e fundit të shkollës 8-vjeçare ngaqë hodha shumë shtat ndërrova edhe veshjen. Duke mos gjetur gjëra të përshtatshme për përmasat e mia, detyrohesh të blija rroba për të rritura dhe natyrisht që kjo veshje më rriste pak në moshë, por gjithësesi ishte veshje vajzash. Kjo përshtatje e veshjes sime ndaj ndryshimit të menjëhershëm të fizikut u keqkuptua nga mësueset e mia, të cilat më thumbonin shpesh me ironi.” Nuk i kanë lënë gjë mangut vetes që tani, po kur të rriteni çfarë do vishni? Nuk po na lini rradhe as neve!” Mësueset na përgojonin shpesh edhe me njëra-tjetrën. Këtë fakt na e pohonte një shoqja jonë, e ëma e së cilës ishte mësuese në shkollën tonë”. Veçanërisht paragjykuese kanë qenë mësueset gra ndaj vajzave që vishnin rroba të ngushta dhe fustane të shkurtra në shkollë. Mësuesit dhe mësueset u kujtonin shpesh vajzave në orën e mësimi se shkolla nuk është agjenci mode, por vend për të mësuar. Të anketuarat tregojnë se sidomos mësueset ndikoheshin shumë në vlerësimin akademik prej veshjes së nxënësve. Njëra prej tyre shprehet në mënyrë lakonike: “Për mësueset tona më shumë rëndësi kishte se si ishim veshur se sa si ishim përgatitur për lëndën. Ato grindeshin shpesh me ne për gjëra që nuk kishin lidhje më mësimin, por me sjelljen dhe veshjen. Kapeshin me ndonjërin prej nesh për mënyrën se si ishte veshur e “pispillosur” dhe kështu kalonte gjithë ora e mësimi.”

Mësueset janë edhe më të rrepta për disiplinën me vajzat. Ato i paragjykojnë vajzat që shkelin disiplinën duke i akuzuar se po sillen si djem. Ky krahasim u tregon vajzave se djemve u lejohej të thyejnë disiplinën, ndërsa vajzave jo. Gjithashtu, mësueset janë më të ashpra me vajzat kur këto kundërshtojnë dhe u mbyllin gojën duke u thënë: “Mos kundërshto se je vajzë! Vajzat nuk kthejnë fjalë!”.

Vajzave u kërkohet edhe të merren me pastrimin e klasave dhe shkollës, ndërsa djemve jo. Në grupet e pastrimit të klasës, edhe pse në klasë kishte djem, mësueset nuk caktonin asnjëherë djem, por i pyesnin nëse donin të dilnin vullnetarë, kurse vajzat i caktonin më detyrim. Kjo lloj sjellje me standart të dyfishtë u përçon vajzave disa mesazhe. *E para*, se punët e pastrimit janë detyrë femërore pavarësisht se ku kryhen, në shtëpi apo në shkollë. *E dyta*, u komunikojnë vajzave se ato nuk kanë mundësi të zgjedhin, ta pranojnë apo jo një detyrë, ndërsa djemtë mund edhe të zgjedhin. *E treta*, vajzat nuk mund dhe as duhet të kundërshtojnë, ndërsa djemtë kanë luksin të refuzojnë autoritetin.

Krahasuar më mësuesit, mësueset i paragjykojnë më pak vajzat për aftësitë, për faktin se ato e dinë që në fshat vajzat janë shumë të rënduara me punë shtëpiake dhe në ekonominë bujqësore. Gjithashtu, mësueset e dinë që në fshat, familjet rurale nuk presin që vajzat të përparojnë në mësimet për arsye që lidhen me rolin e tyre të ardhshëm si gra. Por paragjykimet në drejtim të aftësive nuk mungojnë, pasi 15 për qind e të anketuarave tregojnë se janë paragjykuar nga mësueset në lidhje me aftësitë akademike dhe disiplinën shkollore.

Vajzat ndiheshin të paragjykuara nga mësueset edhe në drejtim të nderit sidomos për shoqërimin me djem. Qëndrimet me djem interpretoheshin si takime erotike dhe mësueset i përflisnin vajzat që kishin shoqëri me djem. Për të shkurajuar shoqëri të tilla, mësueset bënin moralizime gjatë orës së mësimit që perfundonin me “këshillën dashamirëse”: “Mos u merrni me dashuri, por mësoni!”.

Vajzat paragjykohen më shpesh nga mësueset se sa nga mësuesit. Vajzat që paragjykohen përditë nga mësueset janë 34.6 për qind krahasuar me 16.7 për qind të paragjykuara përditë nga mësuesit. Edhe vajzat që paragjykohen çdo javë nga mësueset janë më shumë 21.2 për qind krahasuar me 16.7 për qind që paragjykohen çdo javë nga mësuesit. Edhe pse mësuesit vijnë të fundit në radhën e paragjykesve të vajzave, këto shprehen se paragjykimet e mësuesve i lëndojnë më shumë, pasi mësuesit janë figura autoriare.

Vajzat krijojnë idhujtari për figurat pedagogjike të të dyja gjinive dhe vuajnë shumë psikologjikisht kur këto figura idolatrike i paragjykojnë. Besimi i tyre se do mund të arrijnë të bëhen si mësuesit dhe mësueset e veta shembet kur ato paragjykohen nga ato prej të cilëve frymëzohen. Standarti i dyfishtë që trupa pedagogjike mban ndaj vajzave dhe djemve në shkollë e trondit besimin e vajzave tek drejtësia dhe objektiviteti i mësuesve. Standardi i dyfishtë është i dukshëm në çdo aspekt të sjelljes së nxënësve, por më i dukshëm është tek çështjet e disiplinës, kur vajzave u kërkohet të jenë të bindura dhe të mos krijojnë konflikte, ndërsa djemve u tolerohet kundërshtimi i autoritetit dhe dhuna. Disiplina shkollore i vendos nxënësit nën autoritetin e mësuesve, duke krijuar një marrëdhënie hierarkike mësues–nxënës. Megjithatë, edhe pse duket sikur kontrolli akademik ushtrohet mbi të gjithë nxënësit njësoj, në fakt ai është më i fortë për vajzat se sa për djemtë. Vajzave u kërkohet më shumë se sa djemve të jenë të konformuara me rregullat e shkollës dhe të binden ndaj autoritetit të mësuesve. Ndërsa ndaj djemve, mësuesit tregojnë një tolerancë më e madhe madje edhe kur djemtë thyejnë rregullat e shkollës dhe disiplinën në klasë. Kur djemtë përfshihen në konflikte fizike në shkollë, sjellja e tyre

justifikohet me faktin se janë djem, ndërsa vajzat ndëshkohen moralisht nëse konfliktojnë me njëra-tjetrën dhe quhen deviante me pretekstin se po sillen si djem. Këto mesazhe që mësuesit përcjellin tek vajzat u tregojnë atyre se nuk janë të barabarta me djemtë, prandaj nuk mund të sillen si ata. Megjithëse edhe sjellja agresive e djemve qortohet prej mësuesve, përsëri ata tolerohen pasi pritet që ata të jenë agresive. Ndërsa vajzat ndëshkohen, madje dyfishin, *e para* sepse kanë thyer disiplinën dhe *e dyta* sepse po sillen si djem. Përveç standardit të dyfishtë ndaj sjelljes së vajzave dhe djemve, mësuesit, por më shumë mësueset mbajnë edhe në orën e mësimit një qëndrim më tolerant ndaj djemve se sa ndaj vajzave, jo vetëm për çështje të disiplinës, por edhe për çështje të mësimit. Mësueset merren më shumë me djemtë gjatë orës së mësimit dhe i falin kur vijnë pa mësuar dhe pa detyra. Ndërsa vajzat marrin qortime dhe vërejtje më të ashpra dhe në sy të klasës, nëse vijnë pa detyra dhe pa mësuar. Atyre iu kërkohen sqarime për mospregatitjen, ndërsa djemve, jo vetëm që nuk u kërkohet sqarim, por këshillohen të përpiqen të mësojnë më shumë për herën tjetër. Nga vajzat pritet që të jenë gjithmonë në rregull me kërkesat akademike, ndërsa djemve u lejohet edhe të vijnë të papregatitur dhe të mos mbahen përgjegjës për mospregatitjen.

Shkollimi nuk është një koncept abstrakt, por përvojë të jetuari për nxënësit dhe i jep atyre mundësi të lidhin të menduarit me veprimet. Nxënësve u thuhet që të zhvishen nga paragjykimet dhe ta trajtojnë njëri-tjetrin si të barabartë, pavarësisht dallimeve. Të paktën ky është njëri ndër objektivat madhorë të arsimit. Mirëpo, kur vetë mësuesit mbajnë qëndrime të dyzuara në trajtimin e nxënësve, bazuar në stereotipizimet gjinore, atëherë nxënësit bëhen konfuzë për qëndrimet dhe sjelljen e tyre. Nëse, mes asaj që thuhet dhe asaj që bëhet nuk ka unitet, atëherë arsimit nuk ka moral. Vlerat e demokracisë dhe barazisë më shumë mësohen përmes të vepruarit se sa përmes të thënit. Mësuesit kanë një rol të rëndësishëm në këtë proces, jo vetëm sepse ato u mësojnë nxënësve përmbajtjen e librave, por edhe sepse ndërveprojnë me ta dhe u modelojnë sjelljen dhe qëndrimet me veprimet e veta. Qëllimet e propoganduara nga programi shkollor dhe tekstet e edukimit qytetar për respektimin e ndërsjelltë pavarësisht ndryshimeve mes njerëzve, përfshirë edhe ndryshimin gjinor, nuk kanë kuptim nëse nuk zbatohen në praktikë.

4.6.3. Të paragjykuara edhe nga djemtë

Vajzat shigjetohe nga paragjyimet helmatisëse edhe të djemve në shkollë. Shkaku kryesor i paragjykimit të djemve për vajzat është veshja e tyre. Duket paradoksale se si përpjepjekjet e vajzave për t'u veshur në mënyrë të tillë që t'u bëjnë përshtypje për mirë djemve dhe për të rënë në sy të tyre rezultojnë në fakt në mospëlqimin e këtyre të fundit. Djemtë komentojnë veshjen dhe imazhin e vajzave, duke dhënë edhe gjykime për to. Vajzat që janë ndjerë të paragjykuara nga djemtë për veshjen dhe dukjen e jashtme janë 31.7 për qind. Vlerësimet negative të djemve variojnë në varësi të veshjes së vajzave. Ata janë kritikë për mënyrën e ekzagjeruar dhe të papërshtatshme të veshjes së vajzave në shkollë, por më shumë janë paragjykses për cilësinë e veshjes së shoqeve të klasës. Djemtë sikurse edhe vajzat janë nën efektin e imazhit të “femrës seksi si kukulla playboy” dhe presin që shoqet e tyre të shfaqin karakteristika të pamjes që i përafrojnë me këtë imazh irreal. Vajzat që nuk mund t'i afrohen këtij imazhi, i cili në fakt nuk është i vërtetë por virtual, vuajnë më së shumti nënvlerësimin e shokëve të tyre dhe janë gati një e treta e vajzave. Vajzat e përjetojnë përditë ankthin e vlerësimit të shokëve dhe shoqeve të tyre për veshjen. Një vajzë, gjatë bisedës, pas anketimit, u shpreh: “Ne vajzat jemi të vëzhguara dyfish për veshjen dhe pamjen, nga njëra-tjetra dhe nga djemtë. Ne nuk mund ta shmangim dot lupën e vëzhgimit të shokëve dhe shoqeve tona, pasi jemi përditë në kontakt me ta. Sa herë vlerësohem për pamjen dhe veshjen, ne duket se kalojmë nëpër ngushticën e përbindëshave Shilla dhe Karibda, si Odeseja. Më shumë ankth kam nga nota që do më venë shokët e klasës përditë se sa nga notat që do marr në mësimet”. Kalimi nëpër gjykimin përbuzes të shokëve është bezdi e madhe për vajzat pasi i vendos ato nën trysinë e të dukurit perfekt që të marrin vlerësime pozitive. Ky gjykim shoqëror ka edhe ndikim në shpërqëndrimin e tyre nga mësimet. Në vend që të preokupohen për rezultatet në mësimet, vajzat shqetësohen më shumë për dukjen, pasi kjo merr më shumë vëmendje nga ana e shokëve dhe shoqeve të klasës.

Një pjesë e konsiderueshme e vajzave paragjykohen edhe për origjinën. Veçanërisht të ekspozuara ndaj paragjykimeve krahinore janë vajzat, familjet e të cilave kanë migruar në Farkë nga veriu i Shqipërisë pasi përbejnë edhe shumicën absolute të të ardhurve. Vajzat e ardhura paragjykohen më shumë edhe për sjelljen që sipas djemve është e ndryshme nga ajo që pritet në zonën e fshatit të tyre. Vajzat që paragjykohen edhe për sjelljen edhe për origjinën përbëjnë 26.6 për qind të peshës specifike të të paragjykuarave dhe korrespondojnë me përqindjen e të

ardhurve që është rreth 25 për qind. Pothuajse të gjitha vajzat me origjinë nga veriu janë të paragjykuara për origjinën dhe sjelljen që konsiderohet si më pak e përpunuar se sa ajo e vendasve që e vendosin veten më lart në hierarkinë subkulturore për shkak të përkatësisë ndaj Tiranës. Gjithashtu të paragjykuara për origjinën janë edhe ato vajza gjyshërit e të cilave kanë zbritur nga malësitë e Tiranës, të cilët gjithashtu vendosen nga vendasit kodrinorë në një shkallë më të ulët kulturore për shkak të jetesës baritore të izoluar në malësi.

Për aftësitë ndihen të paragjykuara nga djemtë rreth 10.0 për qind e vajzave. Djemtë, të kompleksuar para vajzave për shkak të rezultateve më të ulëta në mësim, mundohen t'i denigrojnë vajzat për t'i vënë në pozita më inferiore. Nga paragjykimi për aftësitë nuk shpëtojnë as vajzat shumë të afta në mësim. Ndaj tyre djemtë përdorin sharje fyese si “fshatare e paditur” ose “mos na shit mend se ke nota të mira se fshatare je!”. Një vajzë që e kishte përjetuar paragjykimin poshtërues të shokëve për aftësitë tregon: “Kur isha në klasë të shtatë mësoja shumë sepse shkencat e natyrës u rënduan me koncepte të reja. Pavarësisht se mësuesit në fakt në klasë u kushtonin më shumë vëmendje djemve se sa në vajzave, sepse djemtë janë shumë të zhurmsëm, ata ishin të drejtë në vlerësimet që jepnin për nxënësit. Mësuesja e fizikës më caktoi të punoja me njërin nga djemtë për ta ndihmuar të kuptonte ushtrimet. Unë pranova, por shokët e klasës refuzuan në bllok që unë ta ndihmoja shokun, madje e detyruan edhe atë të refuzonte, sepse djemtë nuk prisnin ndihmë nga vajzat, por ja dilnin vetë. Kur u përpoqa të përmbushja porosinë e mësueses dhe t'u mbushja mendjen që të ndihmohesh nuk është turp, njëri nga ata ma preu shkurt: “Ik mbushu, mos na u hiq si e zgjuar sepse merr nota të mira, se fshatare je e fshatare ke për të mbetur”.

Vajzat, edhe pse gjykohen pak më rrallë nga djemtë se sa nga vetja, përsëri e vuajnë helmin e paragjyqimeve të djemve në mënyrë të vazhdueshme, përgjatë gjithë kohës që janë në shkollë. Është e lartë, 56.6 për qind, pesha specifike e vajzave që paragjykohen nga djemtë çdo ditë, javë e muaj të vitit akademik. Më shumë se gjysma e vajzave përballen me sulmin paragjyqës të djemve për veshjen, sjelljen, origjinën dhe aftësitë shumë shpesh. Por, edhe vajzat që paragjykohen më rrallë se një herë në muaj nga djemtë, që përbëjnë 43.3. për qind të peshës specifike të të paragjykuarave nga ata, tregojnë se thumbimet e djemve janë shumë djegëse dhe ato i vuajnë pasojat e etiketimeve denigruese përgjatë gjithë kohës së shkollës.

Vajzat mundohen që të mos tregojnë për përvojat e tyre të konflikteve me djemtë pasi mund të shkaktojnë konflikte hakmarrëse ndaj tyre nga ana e familjarëve të vet. Ose më keq

akoma mund të akuzohen se ato e kanë merituar sepse kanë provokuar ngacmimet e djemve në adresë të vet. Vajzat, të mësuara përgjatë periudhës së shoqërizimit që të mos flasin për konflikte dhe të mos përfshihen në to, përgjatë kohës së adoleshencës e përforcojnë heshtjen për gjëra që lidhen me to siç janë marrëdhëniet me të tjerët e sidomos me djemtë. Morali që u mësohet vajzave është të heshtin dhe t'u shërbejnë mirëqenies së të tjerëve edhe duke sakrifikuar jo pak prej mirëqenies së vet, pasi për vajzat mirëqenia e tjetrit vjen përpara të vetës. Vajzat mësohen t'i shmangin konfliktet pasi sjellja konfliktuale mund t'i identifikojë me djemtë dhe kjo do t'i bënte të qortueshme si deviante, që nuk i përmbahen rolit të tyre gjinor që është të mos krijojnë konflikte. Edhe kur ndodhin konflikte vajzat tërhiqen ose përpiqen që konflikti të zgjidhet në atë mënyrë që të mos dëmtohet askush. Një qëndrim i tillë i vajzave është konstatuar edhe në studimet mbi moralin dhe gjininë, ndër të cilat shquhet studimi i Carol Gilligan. Pasi kreu rreth 200 intervista me pyetje për moralin dhe perceptimin për veten, ajo arriti në përfundimin se për gratë dhe vajzat person i moralshëm është dikush që ndihmon të tjerët, që nuk u sjell telashe të tjerëve, që u bën mirë të tjerëve, që u shërben nevojave të të tjerëve edhe po qe se duhet të sakrifikojë nevojat e veta (Gilligan, C., 1982:65).

4.6.4. Të paragjykuara nga të afërmit

Vajzat ndihen shumë të trysnuara nga kontrolli që të afërmit e fisit, sidomos ata nga ana e babait, ushtrojnë mbi to. Më shumë se gjysma e vajzave, 55.5 për qind e tyre janë ndjerë të paragjykuara nga fisi i babait. Të afërmit e fisit i kritikojnë shpesh vajzat për sjelljen dhe janë shumë vigjilentë për çështje të nderit. Përveçse janë shoqërizuar me normat kulturore për rolin e vajzës dhe gruas, vajzat edhe kontrollohen vazhdimisht nëse po i përmbahen këtij roli. Praktikant e shoqërizimit synojnë pikërisht t'u mësojnë vajzave rolin e tyre të ardhshëm si gra. Vajzat i përvetësojnë normat kulturore që lidhen me gjininë e tyre që në vogëli përmes lojrave, imitimit të nënave të tyre dhe shpërblimit që marrin për sjelljen konform gjinisë. Bota e lojrave femënore të vajzave është e mbushur me figura vajzash pasive në pritje të princit të kaltër, ose fëmijësh që duhen mësuar ose shëruar dhe përkujdesur. Kjo botë transformohet në realitet pas disa vitesh kur vajzat presin të vijë dikush t'u propozojë, kur zgjedhin degën e studimit që i çon drejt punëve të shërbimit dhe përkujdesit si mësuesia, infermiera dhe shërbimi social. Bashkë me rolin social,

ato përvetësojnë edhe stereotipet gjinore duke brendësuar paragjykimet stereotipizuese për gjininë e vet që ka ndikim të drejtëpërdrejtë tek vetvlerësimi.

Gjithashtu, në familje vajzave u mësohet të mos e shprehin zemërimin dhe të mos e ngrenë zërin pasi këto janë sjellje të pranueshme vetëm për djemtë. Nga vajzat pritet të tregohen të duruara, të nënshtruara dhe kokulura. Për sjellje të mirë ato marrin shpërblim moral që i vlerëson ato si “vajza të mira”. Nënshtrimi ndaj të tjerëve i çmobilizon vajzat nga vendimmarrja për veten. Duke qenë të nënshtruara ato nuk lejohen të kenë kontroll mbi jetën e tyre dhe kontrollohen prej të tjerëve, kryesisht të rriturve brenda familjes dhe fisit. Kontrolli i nisur në vajzëri nuk përfundon kurrë, por vazhdon të ushtrohet edhe kur janë madhore, gra të martuara dhe nëna me fëmijë. Kufizimet që vendosen ndaj vajzave përmes kontrollit patriarkal pengojnë zhvillimin e shprehive të tilla si pavarësia, vetbesimi dhe ambicia. Kontrolli pengues krijon varësi të vajzave nga të tjerët, kryesisht nga meshkujt më të rritur. Kontrolli fisnor nuk i lejon vajzat të ecin vetë, përkundrazi i shkurajon. Duke mos u lejuar të provojnë pa pasur frikë se mos dështojnë në vendimet që marrin dhe se mos ndëshkohen për atë që bëjnë, vajzat nuk guxojnë të marrin vendime dhe, për pasojë, nuk fitojnë përvojë jetësore. Mungesa e përvojës i bën mosbesuese ndaj aftësive të veta që nuk i kanë provuar dot për shkak se nuk u jepen mundësitë. Ky mosbesim që vjen nga mungesa e përvojës, e cila natyrshëm mund të jetë edhe dështim, pasi nga gabimet mësohet, shpeshherë ul vetvlerësimin e vajzave dhe rrit konformizmin e tyre me stereotipet. Duke mos e provuar vërtetësinë e stereotipeve gjinore në realitet, vajzat arrijnë t'i besojnë si të vërteta të padiskutueshme. Atyre u është imponuar prej të tjerëve një perceptim i shtrembëruar për aftësitë e veta. Për më tepër, meqë konformimi me stereotipet gjinore shpërblehet me trofe moralizuese, vajzat sillen në mënyrë stereotipike sipas prishmërive shoqërore në mënyrë që të marrin shpërblimin prej prindërve dhe të afërmeve. Duke përvetësuar dhe përpunuar një sjellje konformiste stereotipike gjinore, vajzat edhe “specializohen” në këtë lloj sjellje dhe i brendësojnë normat kulturore për gjininë në atë shkallë sa shndërrohen edhe vetë në rojtare vigjilente të tyre. Sa më të konformuara me identitetin gjinor, aq më të shpërblyera janë. E meqë ideologjia seksite që mbartet në normat kulturore patriarkale i konsideron vajzat dhe gratë si qenie inferiore ndaj burrave, shpërblimi moral jepet nëse qëndrimet dhe sjellja e tyre përputhen me këtë konsideratë kulturore, që do të thotë: sa më inferiore të tregohen vajzat, aq më të shpërblyera janë moralisht nga normat patriarkale. Primi moral për vajzat dhe gratë në shoqërinë tradicionale patriarkale është të marrin rolin e ndihmëses dhe shërbyeses së të tjerëve

sidomos të burrave. Vajzat dhe gratë, sipas studimeve të mëparshme në fushën e gjinisë, e përcaktojnë vlerën e tyre shoqërore vetëm nëse shfaqin aftësi përkujdesi, bindjeje dhe nënshtrimi ndaj të tjerëve, pasi në ndërgjegjen shoqërore të cilën ato e përvetësojnë përmes të mësuarit të normave kulturore, vajzat dhe gratë janë më shumë objekt, që përdoret nga të tjerët për përmbushjen e nevojave të tyre, se sa subjekt që mendon për përmbushjen e kërkesave të veta (Chodorow, N., 1194:21).

Të shqetësuar për nderin e vajzave të tyre, prindërit dhe fisi, vigjilojnë vazhdimisht sjelljen e vajzave për t'i ruajtur ato nga fjalët dhe thashethemet, që vijnë nga drejtime të shumta në fshat, sidomos nga fqinjët. Një tjetër arsye për vëzhgimin e sjelljes së vajzave, nga fisi dhe familja qëndron edhe në frikën e supozuar të tyre se vajzat mund të bien viktimë e mashtrimeve të djemve, sidomos atyre më të rritur që kanë më shumë përvojë se sa ato. Vajzat kanë një perceptim romantik për dashurinë dhe mund t'i besojnë me lehtësi një djali a burri që i premtin dashuri dhe martesë. Vajzat nuk kanë faj që e idealizojnë dashurinë dhe presin kurorëzim të saj me martesë. Ato kanë mësuar përgjatë shoqërizimit prej tyre pritjet që të martohen dhe të krijojnë familje. Të vetëdijshëm se edukimi që u kanë dhënë që në vogëli mund ti shtyjë naivisht drejt të besuarit të një panjohuri që mund të ketë qëllime dashakeqe, i ve në alarm familjarët e vajzave në moshën e adoleshencës, të cilat vuajnë gjithashtu edhe nga mungesa e përvojës së njohjeve me djem pasi kjo nuk është e moralshme. E meqë vajzat nuk janë në gjendje të ruhen prej mashtrimeve, për shkak të naivitetit të mësuar dhe mungesës së njohjeve me gjininë e kundërt, atëherë në roje nderit të tyre dalin familjarët, kryesisht meshkujt e fisit të cilët patrollojnë lëvizjet, takimet, daljet nga shtëpia dhe oraret e qëndrimit jashtë të vajzave të fisit.

Kultura patriarkale e vendos përgjegjësinë e ruajtjes së nderit në duart e meshkujve të familjes. Nëse këta dështojnë në misionin e ruajtjes së nderit të vajzave dhe grave të familjes, ose në rast se në familje nuk ka meshkujt të rritur, atëherë për përmbushjen e këtij misioni mobilizohen meshkujt e fisit. Jo vetëm vajza, por edhe familja vendoset në rrezën e projektorit të vëzhgimit të fisit, që vigjilon nëse familjarët meshkujt po e përmbushin apo jo këtë detyrim fisnor. Preokupimi për ruajtjen e nderit prek më shumë fisin e atit, pasi vajza mban mbiemrin e fisit atëror dhe identifikohet më shumë si person i këtij fisi, se sa i fisit të nënës, mbiemri i të cilit nuk trashëgohet. Askush nuk do ta identifikonte një pasardhës me fisin e nënës në shoqërinë patriarkale për shkak të mekanizmave të partilineritetit dhe patrilokalitetit që e nxjerrin gruan nga shtëpia dhe zhdukin mbiemrin e vajzërisë.


Në kulturën rurale, fisi ka pushtet të jashtëzakonshëm në jetën e familjeve që e përbëjnë për shkak të ndërvarësisë për ushqim, mbrojtje dhe afeksion nga fisi. Në të gjitha anketat është artikuluar qartë ndikimi i fisit për çështje nderi në jetën e vajzave dhe grave, përmes kontrollit të drejtëpërdrejtë të familjes dhe kontrollit të tërthortë të pjesëtarëve të fisit. Në njërin nga bisedat e zhvilluara me gratë pas anketimit, një grua që punonte pjatolarëse në një restorant të zonës dhe që kishte punuar në fermë më parë, tregon se si presioni i fisit mbi familjen e saj e kishte penguar të vazhdonte shkollën e mesme: “Në klasë të tetë hodha shumë shtat, aq sa dukeshin më shumë si grua se sa si fëmijë. Që të mos bija në sy për zhvillimin tim, rrija e kërrusur dhe madje fashoja edhe gjinjtë që të mos më dukeshin se ndihesha shumë e turpëruar. Në siklet të madh dukeshin edhe prindërit e mi që isha transformuar ashtu krejt paprtitur në një trup gruaje dhe nuk dinin si të silleshin me mua, por mbaj mend që dita ditës bëheshin më të ashpër dhe më të vrazhdë në komunikimin me mua, sikur të kisha bërë ndonjë gabim. Prindërit ishin shumë të shqetësuar nga frika se mos fisi dhe fqinjët do më nxirrnin fjalë për nderin, tani që nuk dukeshin me fëmijë. Veçanërisht i egër me mua ishte vëllai i madh, i cili mori rolin e policit se bababi nuk kishte zemër të sillej keq. Vëllait ia ktheja ndonjëherë fjalën se nuk më linte të shkoja tek të afërmit në lagje dhe më rrihte: “Më mirë të të rrah unë – thoshte – se sa të na çnderosh!”. Ai arriti të fitonte kaq shumë pushtet për ruajtjen e nderit tim, sa një ditë të bukur shpalli vendimin se nuk do shkoja në shkollë të mesme. Gjithë hallin e kishte të rrinte rehat nga fjalët e shokëve dhe fisit dhe nuk shqetësohej për të ardhmen time. E kam falur që ka ngritur dorë mbi mua, por nuk e fal që më la pa shkollë”.

Po në funksion të ruajtjes së nderit, fisi i të afërmeve sidomos nga ana e babait, ushtrojnë shumë kontroll ndaj vajzave për mënyrën e veshjes. Vajzat që e ndejnë veten të paragjykuara nga fisi për veshjen përbëjnë 23.2 për qind të të paragjykuarave. Kontrolli për veshjen synon të pengojë rënien e vajzave në sy të meshkujve, të cilët jo rrallë here, nisur edhe nga veshja provokuese e vajzave, guxojnë t’i ngacmojnë dhe t’u afrohen më shumë se ç’duhet. Për të shmangur vëmendjen e meshkujve të tjerë dhe konfliktet që mund të lindin me ta për çështje nderi, të afërmit e familjes dhe fisit tregohen veçanërisht të vëmendshëm për veshjen e vajzave, sidomos atyre adoleshente.

Çdo ditë 51.0 për qind e vajzave përballen me paragjykimet e fisit të babait për sjelljen dhe veshjen. Kjo denduri e lartë kontrolli sigurohet edhe prej afërsisë gjeografike me fisin atëror, me të cilët jetojnë në një hapësirë relativisht të ngushtë, siç është fshati. Shpeshtësia me të cilën

fisi paragjykon sjelljen dhe veshjen e vajzave është tregues i qartë i shqetësimit që kanë për nderin e vajzave në moshë të hershme, se mos “shkasin në dërrasë të kalbur dhe thyejnë qafën (njollosin nderin) për gjithë jetën”.


Denduria e paragjytimeve për vajzat në shkollën 8-vjeçare



Shumë nga gratë që nuk kanë vazhduar shkollën e mesme shprehen se janë penguar prej familjes, së shtyrë prej fisit, që të mos investonin në shkollimin e vajzave për disa arsye. *E para*, sepse fisi gjykon se vajzat do të shkojnë në derë të huaj dhe çdo investim shkollor është i pakuptimtë, sepse vlera financiare e tij nuk kthehet tek familja. *E dyta*, sepse fisi mendon se vajzës i duhet aq edukim sa të përmbushë rolin tradicional të gruas si shërbyese dhe përkujdesëse dhe për përmbushjen e këtij roli nuk është i nevojshëm shkollimi. *E treta*, sepse fisi trembet se mos shkollimi mund t’i emancipojë vajzat dhe t’u japë liri mendimi dhe vendimmarrje, deri në atë shkallë sa ato të refuzojnë kontrollin e familjes dhe fisit mbi to. *E katërta*, duke shkuar në shkollë, vajzat do kenë mundësi të njihen me djem dhe mund të humbin virgjërinë që është kusht për martesë, pra shkollimi mund të kompromentojë nderin e tyre. Një grua e re që kishte qenë nxënëse shumë e mirë në shkollë 9-vjeçare tregon se për arsye nderi dhe për ta martuar përpara se të humbte virgjërinë, familja e kishte fejuar që në klasë të 9-të dhe e kishte mbyllur në shtëpi. Ndër të tjera ajo rrëfen: “Në fund të shkollës 9-vjeçare, nëna më tha se nuk do shkoja në shkollë të mesme se kështu kishte vendosur babai im emigrant në Angli, me arsyetimin se meqë në shtëpi nuk kishim meshkuj, nuk kishte kush më mbikqyrte jashtë shtëpisë. Ai kishte frikë se mund të më dilnin fjalë e çënohej nderi i familjes. Unë dhe motra më e vogël ishim shumë të mira në mësim dhe nënës i vinte shumë keq që nuk do vazhdonim shkollën por do përsërisim

fatim e saj duke u martur të vogla dhe duke e mbyllur jetën që 15 vjeç. Kur kërkova ta sqaroja tim atë në telefon se shqetësimi i tij ishte i kotë ai ma preu shkurt: “Shkolla nuk është për vajza, ju do martoheni, do shkoni në derë të burrit, nuk ka ç’u duhen mësimet, mësoni të bëni punët e t’u shërbeni njerëzve të burrit. Vajzat nuk i do njeri për mend që të bëjnë shkollë!”. Dhe babai e mbajti fjalën, më fejoj atë verë. Në shtator, kur shoqet e mia shkonin në shkollë të mesme, unë vadisja me lot të nxehtë dëshpërimi gardhin e shtëpisë, nga ku nuk mund të dilja më. Më dukej se më kishin burgosuar pa faj, vetëm pse isha vajzë. Mësueset e shkollës ndërhyjnë edhe në fis që të flisnin me tim atë, por pa sukses. Djali me të cilin më kishte fejuar ishte gjithashtu në Angli, gati dyfishi i moshës sime. Edhe ai nuk donte që unë të shkoja në shkollë nga frika se mos njihja ndonjë djalë tjetër dhe bija në dashuri dhe e prishja fejesën me të. Për të më qetësuar nëna më ngushëllonte me fjalë të buta duke më thënë: “Të paktën në Angli nuk do vuash me burrin, se jashtë shtetit burrat nuk i rrahin gratë!”.

Vajzat që paragjykohen për çështje nderi nga fisi çdo javë dhe çdo muaj përbëjnë 27.0 për qind të të paragjykuarave nga fisi. Këto nuk janë në një kontakt të përditshëm me njerëzit e fisit, pasi banojnë larg prej tyre. Vajzat që përballen me paragjykimet kontrolluese të fisit, nga ana e babait, më rrallë se një herë në muaj, përfaqësojnë 21.3 për qind. Këto janë kryesisht vajza me origjinë nga krahina të tjera, sidomos nga veriu, fisi i të cilave jeton pjesërisht në Farkë dhe pjesërisht në veri. Sjellja dhe sidomos veshja e tyre janë objekt diskutimi nga ana e fisit që i trembet ndikimit emancipues të stilit të jetesës kryeqytetase që kërcënon ekzistencën dhe vazhdimësinë e normave kulturore të vendit të origjinës. Në sytë e banorëve të ardhur jetesa kryeqytetase përkthehet si stil i degjeneruar dhe i rrezikshëm për nderin e vajzave, prandaj ata i pengojnë shëtitjet e vajzave dhe shkollimin e tyre në kryeqytet.



Fisi nga ana e nënës është gjithashtu shumë paragjykes për sjelljen e vajzave madje edhe më shumë se sa i bababit. Vajzat që paragjykohen për sjelljen nga fisi i nënës përbëjnë 65.9 për qind të të paragjykuarave. Arsyeja se përse fisi i nënës është shumë i kujdesshëm në “monitorimin” e sjelljes së mbesave ka të bëjë me shmangien e fjalëve, pasojat e të cilave rëndojnë, jo vetëm mbi mbesën që përflitet, por edhe mbi bijën e tyre. Kontrolli dhe edukimi i vajzave shihet si detyrë parësore e nënave dhe nëse vajzat përfliten se kanë gabuar, faji për këtë u hidhet më së shumti nënave që nuk kanë kryer si duhet edukimin e bijave të tyre. Nëse fajësohet nëna për paaftësi edukimi, edhe fisi i nënës ndihet i prekur sepse në mënyrë të tërthortë as këta nuk kanë ditur ta mësojnë bijën e tyre të mësojë bijën e vet. Duke dashur të shmangim aludime të tilla që implikojnë fisin në paaftësi për të edukuar vajzat e veta, fisi i nënës tregon një kujdes të shtuar ndaj mbesave të veta dhe i këshillon ato të sillen mirë që të nderojnë nënat e tyre, derën e nënës së tyre. Gratë e anketuara tregonin shpesh se kur kërkonin ndihmë nga fisi i nënës për t’u mbrojtur nga paragjykimet e fisit të bababit, ato “binin nga shiu në breshër”. Të afërmit e fisit të nënës ishin edhe më paragjykes për sjelljen e vajzave dhe i këshillonin shpesh këto që të mos gabonin se me gabimet e tyre ekspozonin para gjyqimit të fisit të atit edhe nënat e tyre të pafajshme. Njëra nga gratë gjatë bisedës së lirë pas anketimit, në valën e diskutimit për fisin e nënës tregoi: “Kur isha në shkollë 8-vjeçare isha shumë e talentuar në gjuhë të huaja dhe doja të shkoja ose në një gjimnaz të mirë në Tiranë ose në shollën e gjuhëve të huaja. Prindërit e mi ishin të dyzuar pasi e shihnin që isha e mirë për gjuhët, por i drusheshin opinionit të fisit dhe fqinjëve. Për të kërkuar ndihmë shkova tek dajat e mi, të cilëve u kërkova t’i mbushnin mendjen

tim eti që të më dërgonte në shkollë në Tiranë. Për çudinë time, jo vetëm që nuk më mbështetën, por i dhanë të drejtë frikës së prindërve të mi se po të shkoja në Tiranë do “u rrëshqisja nga radarët”. Njësoj si fisi i babait edhe fisi i nënës shfaqte një denduri të lartë paragjyquese për sjelljen dhe veshjen e vajzave. Të anketuarat që kishin ndjerë mbi supe peshën e të afërmeve të fisit të nënës janë 52.3 për qind. Edhe paragjykimet e përjavshme dhe të përmuajshme zënë një peshë specifike të konsiderueshme 36.4 për qind.

4.6.5. Të paragjykuara nga fqinjët


Fqinjët janë grupi i tretë në radhën e paragjyqesve për vajzat pas shoqërisë së shkollës dhe pas fisit. Fqinjët i paragjykojnë vajzat kryesisht për veshjen, sjelljen, aftësitë dhe cilësitë fizike. Të anketuarat pohojnë se janë ndjerë shumë të bezdisura nga shikimet paragjyquese të fqinjëve dhe nga fjalët apo “këshillat” e tyre. Pjesa më e madhe e paragjykimeve fqinjësore shkojnë në drejtim të veshjes së vajzave të fqinjëve. Për veshjen janë paragjykuar nga fqinjët 32.3 për qind e vajzave. Agjencia e thashemeve të fqinjëve është shumë vepruese në fshat për shkak të njohjes dhe afërsisë fizike. Çdo dalje e vajzave nga shtëpia shoqërohet me pyetjet e fqinjëve kureshtarë: “Ku po shkon, pse je veshur kështu, kur do kthehesh, etj.?”.

Kërshëria e fqinjëve për sjelljen e vajzave lidhet me detajet e daljes nga shtëpia. Vajzat që paragjykohen nga fqinjët për sjelljen përbëjnë 22.8 për qind të të peshës specifike. Më shumë paragjykojnë fqinjtat e papuna, të cilat mbushin me fjalë jo vetëm gratë e tjera por edhe burrat. Një pjesë e konsiderueshme e fqinjave shtëpiake të papuna qëndrojnë në oborr të shtëpisë për të biseduar përtej gardhit me njëra-tjetrën për “të rejat” e fshatit. Një grua e kujton kështu përgjimin e fqinjave të saj sa herë dilte nga shtëpia: “Kur hapja portën e shtëpisë për të dalë, pa nxjerrë këmbën jashtë, brofnin në krah tim fqinjtat e mia të cilat me shpoti më pyesnin se ku po shkoja. Edhe pse daljet ishin krejtësisht të padjallëzuara, për fqinjtat e mia ato ishin të qëllimshme, për të takuar ndonjë djalë e për të bërë dashuri rrugëve. Një herë, pas kursit të gjuhës së huaj, një shok kursi, të cilit i binte rruga nga shtëpia ime, më përcolli der tek hyrja e rrugicës dhe kjo u dha shkas gojëve të liga të fqinjave të flisnin se unë shkoja me një djalë. Në darkë nëna nuk më la gjë pa thënë se kisha turpëruar shtëpinë dhe nëpërkëmbur nderin tim. E gjithë kjo histori e neveritshme u sajua nga fqinjtat që, më shumë se për të më bërë keq mua, merreshin me fjalë se ashtu shtynin ditën”.

Fqinjët janë paragjykues edhe për aftësitë e vajzave. Ata shprehin veçanërisht paragjykime në lidhje punët shtëpiake, bujqësore dhe blegtorale që janë të zakonshme në fshat. Vajzat komentohen shumë nga ana e fqinjëve se sa punëtore janë dhe me këtë kanë parasysh angazhimin e tyre në pastrimin dhe mirëmbajtjen e shtëpisë. Për aftësitë janë paragjykuar nga fqinjët 13.4 për qind e vajzave. Gjithashtu, fqinjët bëjnë shumë komente për cilësitë fizike të vajzave duke vënë në shënjestër tiparet fizike si madhësinë, format e trupit dhe karakteristikat e fytyrës. Megjithëse paragjykimet në drejtim të cilësive fizike janë më të rralla krahasuar me ato për sjelljen dhe veshjen, ato janë shumë të hidhura për vajzat, të cilat ndihen të pafuqishme të ndryshojnë trupin apo fytyrën që t'u mbyllin gojën fqinjëve. Duke qenë në kontakte të përditshme me fqinjët, pjesa më e madhe e vajzave, 27.6 për qind e tyre, ndihen të paragjykuara për ditë nga fqinjët. Po kaq e lartë është edhe përqindja e atyre që paragjykohen çdo javë e çdo muaj, 27.5 për qind. Është e pamundur për vajzat që t'i shmangen shikimit kurioz dhe bezdisës të fqinjëve, për shkak se bashkëjetojnë me ta në mjedise fizike të afërta.

4.7. Paragjykimet për vajzat në shkollën e mesme

Vajzat në shkollë të mesme paragjykohen më shumë për sjelljen, veshjen, komunikimin me djemtë dhe për aftësitë. Paragjykimet për sjelljen prekin 32.5 për qind të vajzave në shkollë të mesme. Edhe pse vazhdon trysnia për t'iu përmbajtur normave kulturore gjinore për rolin e nënshtruar të vajzave dhe grave, vajzat në shkollë të mesme krijojnë një farë autonomie për sjelljen e tyre, që i bën ato më kritike ndaj rregullave shoqërore dhe ndikimit të prindërve.



4.7.1. Të paragjyqura për sjelljen

Shumë prindër e përjetojnë fazën e adoleshencës së fëmijëve të tyre si një shqetësim mendor, si një gjendje të çuditshme që ata nuk mund ta kontrollojnë dot dhe ndihen të pafuqishëm përpara furisë kundërshtuese të fëmijëve adoleshentë që arrin deri në revolta të dhunshme që dëmtojnë marrëdhënien me të tjerët ose veten e tyre. Normat tradicionale të së shkuarës nuk mund t’u vijnë shumë në ndihmë prindërve për të ushtruar kontroll në një shoqëri që po pëson ndryshime rrënjësore kulturore dhe në një kontekst shoqëror të ndryshëm nga ai i mëparshmi përse i përket përzjerjes subkulturore. Migrimi i brendshëm i ka shndërruar mjediset shoqërore të dikurshme nga homogjene në heterogjene. Ardhja e popullatës migratore, kryesisht nga veriu, në Farkë ka krijuar një alkimi subkulturore përmes procesit të difuzionit të ndërsjelltë subkulturor mes vendasve dhe të ardhurve. Siç e kanë vënë në dukje edhe sociologët Artan Fuga dhe Zyhdi Dervishi:

“Në kushtet e përzjerjeve shumëplanëshe të popullsisë me prejardhje nga shtresa sociale e subkultura rajonale të ndryshme, opinioni moral i zonës së banuar, qoftë kjo rurale apo urbane, dobësohet shumë dhe bëhet thujtë anonime... Banorët e socializuar në zonat rurale, me kujtesë kolektive dhe opinion publik mjaft veprues, përgjithësisht e ndjejnë veten disi bosh, pasi në periferitë e qyteteve ku instalohen, opinioni publik

është i venitur, mjaft i thërmuar. Një bashkësi e tillë ata i çorodit... Moraliteti ka qenë një nga mekanizmat më të rëndësishëm të integritetit të individit në jetën sociokulturore dhe të kontrollimit sistematik të sjelljeve të tij. Më shumë në fshat, por edhe në qytet, zbehja e këtij opinioni moral në shkallë problematike nuk mund të mos shoqërohet me rritjen e numrit dhe peshës specifike të modeleve të sjelljes deviante në shoqëri...” (2002:168).

Të rinjtë dhe të rejat në zonën e Farkës jetojnë në një realitet të dyzuar që ka përzierje të elementëve rurale me ata urbanë, për shkak të afërsisë me kryeqytetin dhe shkrirjes së kufijve administrativë, si pasojë e zgjerimit të kryeqytetit drejt rrethinave rurale. Subkultura rurale ka ndikime edhe nga mënyra e jetesës urbane. Zona e Farkës vizitohet rregullisht në fundjava nga kryeqytetasit që shkojnë në bar-lokalet dhe restorantet e zonës. Gjithashtu, zona ka një nga bizneset më të mëdha të tregtisë së mallrave të konsumit të përditshëm Tirana East Gate (TEG) që është destinacion thuajse i përditshëm për banorët e Tiranës për blerje.

Ndërkohë, pas vitit 2010, zona është bërë një vend i parapëlqyer për banesa lukzoze nga familje të pasura që largohen nga mjediset e ndotura dhe të zhurmshme të kryeqytetit, nën efektin e procesit të xhentrifikimit. Afërsia me kryeqytetin influencon pashmangshmërisht mendësitë e banorëve të zonës, ndër të cilët të rinjtë janë edhe më mendjehapurit për të përqaftuar një moral të ri. Është e vështirë për familjet rurale t'i ruajnë të rinjtë dhe të rejat të paprekur nga këto ndikime që konsiderohen shpesh si të dëmshme dhe degjeneruese, sidomos për vajzat. Kapja e famijarëve pas vlerave dhe normave tradicionale për t'i përdorur si kritere vlerësuese dhe si mekanizma kontrolli për të rinjtë dhe shpërfillja e moralit tradicional nga ana e të rinjve shkakton mjaft konflikte mes prindërve dhe të rinjve. Vajzat janë edhe më shumë të prekura nga trysnia e kontrollit familjar që synon t'i mbajë ato nën mbikqyerje të paprerë për t'u siguruar se vajzat janë ende brenda kornizave të moralit dhe nderit të familjes. Para vajzave të reja shtrihen shumë mundësi jashtë shtëpisë që ato rreken t'i shfrytëzojnë. Pikërisht larmia e zgjedhjeve krijon edhe më shumë perpleksitet tek vajzat se çfarë është mirë të marrin e të lenë. Vajzat në fshat, megjithë fuqinë joshëse që ushtrojnë mbi to mundësitë e shumta të qytetit dhe të migrimit, përmbahen të vrapojnë pas tyre. Studimet për kulturën nxjerrin në pah se: "Vajzat, si rrjedhojë e mënyrës më të mbyllur të jetës dhe të modelit kulturor që ka zgjedhur tradicionalisht shoqëria

shqiptare, e kanë më pak të zhvilluar shpirtin migrator... Ndodh kështu pasi në mendësitë e shumicës së banorëve të zonave rurale dëshira ose prirja e ligjshme e vajzave për të emigruar keqinterpretohet, paraqitet si pregatitje e tyre për t'u vetëkryqëzuar në kryqëzimet e rrugës pa krye të prostituimit" (Fuga, A. & Dervishi, Z., 2002:175). Sikurse pohohet në studimet për dukurinë e migrimit, vajzat dhe gratë edhe kur kanë migruar, kanë shkuar pas baballarëve dhe burrave të migruar.

Megjithëse në moshën e adoleshencës së vonë dhe rinisë së hershme vajzat përjetojnë një rritje të dëshirave seksuale dhe të prirjeve agresive për të kundërshtuar autoritetin prindëror dhe fisnor që i mban të shtypura, ato tregojnë një vullnet të lëvdueshëm për përshtatje. Kjo periudhë e jetës është kalimtare dhe shërben si trampolinë për hyrjen e tyre në botën e të rriturve. Nevoja për t'u shkëputur nga tutela prindërore legjitimohet pikërisht prej shtysës që ushtrohet mbi to për t'u sjellë si të rritura, që do të thotë se duhet të shfaqin aftësi se mund të jenë të pavarura. Por, siç e ka vënë në dukje studiuesja Carroll Gilligan, vajzat nuk lejohen të rriten për shkak të ndikimit kulturor që i mban ato në gjendje të parritur që të binden, nënshtrohen dhe t'i shërbejnë autoritetit mashkullor si gra (1990:94). Vajzat janë rritur me këtë moral, duke përvetësuar dhe zbatuar rregullat që u kanë mësuar prindërit, të afërmit dhe që vazhdojnë të mësohen edhe në shkollë. Vartësia e vajzave nga autoriteti prindëror, përgjithësisht nuk ndryshon me rritjen. Vajzat mësohen të jenë të varura prej autoritetit të të rriturve edhe kur ato fillojnë të rriten vetë. Gjendja e varësisë së vajzave nga të tjerët ngjan shumë me gjendjen e personit me aftësi të kufizuar, jo se vajzat janë të tilla porse kultura çaktivizon tek ato aftësinë për të qenë të pavarura dhe për t'ja dalë vetë në jetë (Blackwell-Stratton, M., Breslin, M. L., Mayerson, A. B. and Bailey, S., 1988: 143). Frika nga autoriteti ndëshkues i prindërve të afërme nuk zhduket automatikisht me rritjen në adoleshencë. Megjithatë, në adoleshencën e vonë vajzat fitojnë njëfarë autonomie për të vendosur nëse do t'i përmbahen ngurtësisht këtyre rregullave apo do t'i anashkalojnë. Pikërisht kësaj autonomie u tremben prindërit dhe të afërmit dhe prandaj rrisin vigjilencën ndaj sjelljes së vajzave adoleshente në shkollë të mesme. Për t'i mbajtur vajzat nën kontroll, mjedisi familjar rrit dozën e paragjykimeve me bazë moralin, për nderin dhe sjelljen e vajzave. Për këtë arsye, vajzat vihen pothuajse në gjendje alarmi për pasojat e veprimeve të veta, sepse nuk janë të sigurta nëse do marrin vlerësime pozitive apo negative për to.

4.7.2. Të paragjykuara për veshjen

Rreth 18.8 për qind e vajzave të anketuara janë gjykuar për mënyrën se si janë veshur në shkollën e mesme. Vajzat e reja janë shumë të preokupuara për pamjen. Ato përgjithësisht mendojnë se pamja ka rëndësi thelbësore në marrëdhënien me të tjerët dhe se nga pamja varet se sa sukses do të kenë për t'u martuar dhe për t'u punësuar. Vajzat dëgjojnë dhe shohin se beqaret e vonuara që nuk janë martuar shpesh fajësohen se nuk kanë qenë të “pamshme”, se nuk i ka dashur “as fati, as zoti”. Pritshmëritë shoqërore për vajzën në subkulturën rurale janë të orientuara drejt martesës dhe lindshmërisë. Vajzat që duan të kenë sukses shoqëror me pamjen nuk janë duke kundërshtuar pritshmëritë e subkulturës së tyre, përkundrazi ato janë duke i përmbushur rigorozisht. Përgjatë përvojave të shoqërizimit vajzat ushtrohen të vetdisiplinojnë dukjen duke përdorur trupin si objekt disipline. Kultura u mëson vajzave të përvetësojnë rregullat e moralit shoqëror të mjedisit ku jetojnë duke i brendësuar në ndërgjegje dhe duke i aplikuar në ndërveprimin me të tjerët. Mjeti me të cilin vajzat komunikojnë më së shumti janë trupat e tyre të mbështjellë me një mantel simbolik kulturor që komunikon vlera dhe norma. Sikurse theksojnë studimet në fushën e kulturës, veshjet në shoqërinë tradicionale shqiptare tregojnë hierarki shoqërore dhe veçanërisht në Shqipërinë e Mesme ku simbolika e shtrezimit klasor tregohet tek veshja përmes stolive të nuseve të reja, të cilave u varnin në qafë napolona ari për të simbolizuar pasurinë e familjes së dhëndrrit (Dervishi, Z., 2008:64). Kjo traditë veshje si simbol pasuror që vjen prej shekujve vazdon ende në zonën e Farkës. Në veshjet popullore që prodhohen në mënyrë artizanale në Farkë napolonat janë zëvendësuar me argjend, pasi kostumet popullore të grave vlerësohen tani më shumë si relike kulturore se sa si veshje të ritualit dasmor. Të puqura bashkë, simbolika e veshjes dhe normat kulturore për veshjen si fomë e hierarkisë pasurore, nxisin tek vajzat dëshirën për të pasur një veshje që bie në sy dhe që tërheq vëmendjen.

Vajzave u është mësuar të përvetësojnë një trup shoqëror që është objekt shikimi dhe diskutimi për të tjerët. Në analizën e bërë për dukurine shoqërore të sundimit mashkullor, studiuesi Pierre Bourdieu argumenton se shoqëritë kanë prodhuar dy nënkultura të ndryshme për gjinitë, ku njëri i mësojnë të sundojë dhe tjetri të nënshtrohet (2001:63). Normat kulturore trupëzohen, materializohen në trupa që komunikojnë kulturë në shumë forma ndër të cilat edhe veshja. Gjatë analizës për shprehjen e kulturës përmes trupit, Bourdieu vëren se:

“Marrëdhënia që vajza krijon me trupin e vet është imazhi i një trupi subjektiv që t’u pëlqejë të tjerëve. Perceptimi i të tjerëve për trupin e saj ndikon vetperceptimin e saj për trupin dhe marrëdhënien e saj me veten dhe me të tjerët. Trupi i perceptuar është produkt shoqëror. Ai është trupi që dëshirojnë të tjerët. Vajzat e dinë që trupi i tyre ekziston për sytë e të tjerëve prandaj nuk kundërshtojnë që ata t’ua shohin si objekt kënaqësie. Kjo sjellje i bën ato femërore në sytë e të tjerëve. Ato e përdorin trupin për t’u pëlqyer të tjerëve, kryesisht meshkujve, që presin që ato të jenë femërore, që do të thotë se duhet të buzëqeshin, të jenë miqësore, të dëgjueshme, të duruara, të nënshtruara, të përmbajtura dhe të përlulura. Ky quhet feminitet dhe nuk është asgjë më shumë se sa shfaqje e dobësisë së inferioritetit të tyre përpara superioritetit të supozuar të mashëhtisë së egos mashkullore.” (2001:66)

Vajzat nga fshati nuk kanë shumë kënaqësi prej jetës së varfër në fshat, e cila në vitet e tranzicionit passocialist është varfëruar edhe më shumë nga pikpamja e gjallërisë artistike dhe kulturore krahasuar me periudhën e regjimit socialist, kur në çdo fshat kishte qendër kulturore dhe grupe artistike. Të veshurit është ndër të paktat kënaqësi që vajzat i dhurojnë vetes brenda mundësive financiare të familjeve të tyre. Ato kursejnë paratë që prindërit u japin për mëngjesin për të blerë rroba të reja. Mosndërimi i rrobave i përball me përbuzjen e bashkëmoshatarëve, por edhe të mësueseve. Megjithatë ndërimi i veshjes përditë dhe ndjekja e modës, që ka vlerë për bashkëmoshatarët, nuk ka edhe aq për prindërit dhe të afërmit e fisit të cilët shqetësohen se vajzat me veshjen duan të bien në sy. Ndjekja e modës nuk gjen fare miratim, pasi në fshat banorët e konsiderojnë atë si shenjë të shthurjes morale. Paragjykimet për veshjen shkaktojnë tek vajzat jo pak bezdi dhe ankth. Nga njëra anë ato duan të jenë në rregull me pritshmëritë e bashkëmoshatarëve që të bien në sy për veshje moderne, dhe nga ana tjetër ruhen se mos veshja e tyre shkakton konflikte në familje dhe fis.

4.7.3. Të paragjykuara për komunikimin me djemtë

Në shkollë të mesme, shumica e të rinjve provojnë dashuritë dhe flirtet e para. Vajzat, sikurse edhe djemtë, në këtë moshë, priren të afrohen më shumë me gjininë tjetër. Edhe djemve u pëlqen që në shkollë të mesme të kenë më shumë miqësi me vajza sepse ajo i mbron nga paragjykimet homofobe, po të shoqërohen vetëm me djem. Miqësia vajzërore ofron më shumë intimitet emocional se sa miqësia mes djemve. Gjithashtu, shoqërimi me vajza i ruan djemtë nga kërcënimi i vazhdueshëm i shokëve dhe nga dhuna që fillon si lojë në orët e pushimit dhe përfundon në kacafytje pas shkollës. Miqësi të tilla shpesh krijojnë premisat e natyrshme për pëlqim të ndërsjelltë dhe intimitet më të ngushtë mes vajzave dhe djemve. Frika se mos miqësia vajzë–djalë mund të shndërrohet në një marrëdhënie intime seksuale bën që prindërit dhe të afërmit e vajzave të përpiqen t'i ndalojnë rreptësisht këto miqësi. Edhe persona të tjerë si mësuesit, fqinjët dhe të afërmit e interpretojnë shpesh miqësinë mes tyre si intimitet seksual, pavarësisht se mund të mos jetë i tillë.

Komunikimi dhe shoqërimi me djem paragjykohet si sjellje e pahijshme për vajzat edhe prej vetë nxënësve. Një vajzë që kishte pasur marrëdhënie shumë të mira me shokët e klasës në shkollë të mesme tregon: “Kur rrija me djemtë bisedat ishin më të gjalla dhe më tërheqëse, sepse kishin si objekt diskutimi politikën, qeverisjen, ekonominë, sportin, muzikën, teknologjinë, etj. Qëndrimi me ta më jepte, si të thuash, shumë informacion dhe më detyronte të merrja pjesë aktivisht në debat. Ata më vlerësonin si shok dhe jo si shoqe. Por, sa më shumë pranohesha prej tyre, aq më shumë përjashtohesha nga shoqet që mendonin se unë flirtoja me ta dhe u hiqja shansin atyre për t'u vlerësuar. Në fakt krejt e kundërta ishte e vërtetë, unë i pëlqeja shumë shokët, por jo në atë mënyrë që mendonin shoqet e mia. Më vonë ato u bindën për këtë, pasi prej shoqërisë me djem e pësova. Djemtë më vlerësonin si çun-harram dhe jo si vajzë e për rrjedhojë asnjë djalë nuk më donte për të dashur”.

Vajzat që qëndrojnë me djem gjykohen edhe sepse zhvillojnë tipare dhe sjellje mashkullore dhe njerëzit e kanë të vështirë t'i klasifikojnë për nga përkatësia gjinore: ata nuk i konsiderojnë as plotësisht vajza sepse shfaqin sjellje mashkullore dhe as djem. Këto vajza etiketohen si “çun harram” që do të thotë djalë i shkuar dëm. Edhe kur duket qartë se përveç shoqërisë së pastër me djemtë, nuk kanë qëllime të tjera, prindërit e vajzave “çun-harram” shqetësohen shumë se do t'u “ngelet vajza në derë” dhe nuk do t'ua kërkojë njeri për nuse. Nën

urdhërohen nga baballarët, vëllezërit e rritur dhe nga kushurinjtë e afërt që të fillojnë punën bindëse me vajzat dhe t'i udhëzojnë t'u rrinë larg djemve e të shfaqin sjellje të përshtatshme për vajzat, të jenë pasive. Një grua e re që kishte pasur për shumë vite mbi shpinë llogopin "çun-harram" kur ishte në shkollë të mesme, tregon me nota humori se si nëna e saj e kishte këshilluar të hiqte dorë nga çapënkllëqet e moshës dhe të shtrohej se përndryshe nuk do të gjente dot burrë: "Unë isha nxënëse shumë e mirë dhe kisha miqësi të mirë me djemtë e klasës, kuptohesha shumë mirë me ta dhe përdorja shpesh zhargonin e tyre në të folur. Ishte viti i fundit i shkollës së mesme dhe prindërit e mi bashkë me fisin po llogarisnin kohën e fejesës që edhe po të ikja në shkollë të lartë t'i kisha këmbët e lidhura dhe një roje që të më ruante nderin. Në seancën këshillimore, nëna më thotë që të mos hiqem shumë e zgjuar me meshkujt se ata nuk i duan femrat e zgjuara, se kanë frikë se mos mposhten: "Prit të flasë ai i pari, lëre të vendosë ai që të ndihet i rëndësishëm dhe i pushtetshëm". Mua nuk më mbajti vendi dhe kërceva përpjetë e xhindosur: "Po pse si dashke ti, të hiqem si budallaqe unë për të zënë një të dashur? Pastaj edhe sikur të hiqem si e tillë, kujt do t'i pëlqente të kishte në krah një shushkë. Leqë mua më njohin të gjithë që jam e shkathët dhe hazër-xhevap. Si të bëj tani? Të hiqem si viktimë, si e pazonja, që dikujt t'i vijë keq për mua, që të bëjë si hero e të vijë të më shpëtojë që të ndihet superior? E pamundur. Nuk shndërrohem dot në handikapate unë për të gjetur burrë!". Fjalët e kësaj vajze të re, që më pas pati një karrierë dhe martesë të suksesshme, flasin qartë për mesazhet kulturore që përcillen tek vajzat prej faktorëve shoqërizues për t'i bërë ato konformiste me normat e gjinizura shoqërore.

Në të gjithë edukimin që i jepet vajzës synohet që tek ajo të zhvillohet një ndërgjegje e të qenit inferiore dhe madje të brendësohet që të duket sa më e natyrshme. Por, sikurse ve në pah Simone de Beauvoir, përulësia e vajzës nuk vjen ngaqë ka lindur inferiore, përkundrazi, vajza vihet në pozita inferiore dhe më pas përulësia i krijon asaj aq shumë pengesa saqë e bëjnë atë të ndihet vërtetë inferiore (2002:63). Dhe më tej ajo argumenton se është pikërisht ky status inferior, në të cilin shoqëria e vendos gruan që e shndërron atë në seks të dytë, me të cilin nënkuptohet nënrenditja shoqërore ndaj meshkujve dhe mungesa e qytetarisë dhe privilegjeve që rrjedhin prej saj (2002:69).

4.7.4. Të parajgykuara si të paafta


Vajzat në shkollë të mesme parajgykohen edhe për aftësitë. Rreth 11.0 për qind e të anketuarave e pranojnë këtë fakt. Aftësitë e vajzave parajgykohen në dy drejtime: në formimin akademik dhe në përshtatjen me rolin femëror të të bërit punë shtëpie dhe bujqësie në fshat. Përgjithësisht, kur mësojnë në shkollë të mesme vajzat fillojnë ta humbin interesin për lëndët shkencore dhe t'i përkushtohen shkencave sociale. Kjo duket në zgjedhjet që bëjnë për lëndët me zgjedhje, kur shumica zgjedhin lëndët shoqërore. Ndërsa djemtë të nxitur ca nga nevoja për të bërë para dhe karrierë, ca edhe nga mësuesit, zgjedhin lëndët shkencore edhe pse janë më pak të përgatitur se vajzat në shkencat e natyrës. Përgjithësisht, vajzat janë më të mira se djemtë në mësimet në të gjitha lëndët. Këtë e pohuan mësuesit dhe drejtori i shkollës së mesme gjatë bisedave. Edhe një studim i mëparshëm i ndërmarrë në vitin 2002 nga sociologët Fuga dhe Dervishi konfirmon se vajzat janë më të interesuara se sa djemtë për shkollimin, përkatësisht 70.6 për qind përkundrajt 45.6 për qind (Fuga, A. & Dervishi, Z., 2002:52). Vajzat e humbin vetbesimin në aftësitë akademike jo se ato nuk kanë më interes për shkollimin, por sepse familjarët nuk kanë. Familjet rurale interesohen t'i fejojnë nga fundi i shkollës së mesme. Trysnia ndaj vajzave për të treguar shkathësi ndaj punëve të shtëpisë dhe ekonomisë familjare rritet shumë në këtë moshë, pasi vajzat përgatiten për martesën. Vajzat gjykohen më shumë për aftësitë e rolit gjinor të gruas shtëpiake se sa për ato akademike. Të rriturit që i rrethojnë, familja, fisi dhe fqinjët presin që vajzat të jenë të zonjat në bërjen e punëve të shtëpisë, të përkujdesjes për të tjerët dhe në punët bujqësore.

4.7.5. Shpeshësia e parajgykimeve

Vajzat që parajgykohen çdo ditë, javë e muaj përbëjnë shumicën e të parajgykuarave, 60 për qind. Parajgykimet prej familjes dhe fisit shfaqen me intensitet të shtuar tek vajzat në moshën 15-19 vjeç me qëllim parandalimin e ndodhive fatkeqe që mund të vijnë nga mungesa e kontrollit prindëror dhe fisnor. Të tilla konsiderohen marrëdhëniet intime dhe seksuale me djem, largimi nga shtëpia me një djalë ose rënia viktimë e mashtrimeve të meshkujve të panjohur që mund t'i joshin me premtimin për martesë dhe t'i nxjerrin në trotualet e perëndimit për postitumim. Numri i lartë i vajzave viktime të trafikut të prostitucionit i ka bërë edhe më syhapur

prindërit dhe farefisni në drejtim të ruajtjes së vajzave. Sipas të dhënave zyrtare të Policisë së Shtetit në vitin 2014, Republika e Shqipërisë ishte ende vend origjine për viktimat e trafikimit me vende destinacioni si: Itali, Belgjikë, Zvicër, Gjermani dhe Britaninë e Madhe (Policia e Shtetit, 2014). Mënyrat kryesore e rekrutimit janë martesat e rreme ose romancat që i joshin vajzat të shkojnë jashtë shtetit për t'i shfrytëzuar më pas për prostitucion. Pasi u sekuestrojnë dokumentet dhe abuzojnë me to fizikisht dhe seksualisht, trafikantët i detyrojnë të prostitutojnë duke i kërcënuar se nëse nuk pranojnë, do të hakmerren ndaj familjarëve të tyre (Gjermani, E., Taga, I., Tahsini, I. & Meshi, M., 2008:8). Mënyrat kryesore të rekrutimit janë shtuar dhe përveç martesës grupet kriminale mashtrojnë me oferta për punësim si: kamariere, banakiere, kërcimtare dhe këngëtare në vendet fqinje dhe atje i nënshtrojnë ato ndaj trafikimit për qëllime të shfrytëzimit seksual.


Denduria e paragjytimeve për vajzat në shkollën e mesme



Edhe raportet ndërkombëtare për trafikimin e qenieve njerëzore për vitin 2014, siç ishte raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit (DASH), e rendisnin Shqipërinë në vend origjine dhe tranziti të trafikimit (Shqiptarja.com, 20.06.2014, 16:59). Trafikimi sjell pasoja të dëmshme jo vetëm për vajzën si viktimë e drejtëpërdrejtë e tij, por edhe për familjen dhe fisin që dëmtohet tërthorazi. Një pjesë e familjarëve të vajzave të trafikuar kanë bërë vetëgjyqësi dhe janë përfshirë në konflikte me trafikantët, shpesh edhe me pasojë vdekjen.

4.7.6. Të paragjykuara më shumë nga shoqet e shkollës

Vajzat paragjykohen në shkollë të mesme prej shoqeve, fqinjëve, fisit nga ana e babait, mësueseve dhe shokëve të klasës.



Pjesa më e madhe, 33.2 për qind e vajzave të anketuara janë shprehur se janë paragjykuar nga shoqet. Vajzat janë shumë paragjykuese ndaj njëra-tjetrës në shkollë të mesme. Kjo ndodh pasi vajzat janë mbartëse të besimeve kulturore për gjininë që i vendos ato në pozita inferiore përse i përket aftësive dhe statusit. Në studimet gjinore theksohet shumë rëndësia që ka kultura në krijimin dhe mbajtjen gjallë të paragjykimeve kundrejt vajzave dhe grave. Besimet gjinore si produkte kulturore veprojnë në dy rrafshë: *i pari* është ai hierarkik që i jep meshkujve një status më të lartë shoqëror dhe kompetenca instrumentale dhe *i dyti* është rrafshi horizontal në të cilin krijohen dallimet kulturore mes dy gjinive sipas të cilave çfarë vlen për njërin gjini nuk vlen për tjetrën (Ridgway, B & Corell, Sh, 2004:527).

Vajzat i kanë brendësuar normat kulturore për gjininë dhe i zbatojnë ato në ndërveprimin e përditshëm me njëra-tjetrën dhe me të tjerët. Ato e marrin statusin e nënrenditur si rrjedhojë e këtyre moreve dhe përshtatja me statusin dytësor u lejon të qëndrojnë në strukturën e gjinizuar të shoqërisë (Risman, B, 2004:437). Shumica e paragjykimeve ndodhin gjatë veprimtarisë së përditshme në rutinën e aktiviteteve shkollore, përgjatë të cilave nga vajzat pritet të përmbushin pritshmëritë gjinore. Jo vetëm të tjerët mendojnë se vajzat janë më pak kompetente në aftësitë e tyre krahasuar me djemtë, por edhe vetë vajzat e besojnë këtë paragjykim. Për rrjedhojë edhe

vetbesimi i tyre se mund t'ja dalin të përballojnë me sukses kërkesat e shkollës së mesme është i pakët.

Vajzat e paragjykojnë shpesh veten gjatë kohës së shkollës së mesme. Janë 60.3 për qind vajzat që paragjykojnë prej shoqeve çdo dite, javë dhe muaj të vitit shkollor. Kjo denduri e lartë e paragjytimeve ka të bëjë me kontaktin e shpeshtë dhe afërsinë emocionale dhe fizike mes tyre. Duke qëndruar më pranë njëra tjetrës ato kanë mundësi të dinë shumë gjëra personale dhe t'i lejojnë vetes të gjykojnë sjelljen dhe qëndrimet e njëra-tjetrës. Shpeshtësia e paragjytimeve shkakton edhe konfliktim mes vajzave, të cilat përfshihen edhe në akte të dhunshme fizike për shkak të tyre. Paragjykimet i japin jetë tymnajës së thashethemeve në shkollë që përhapen me shpejtësi në të gjithë popullatën e nxënësve. Është shumë e vështirë për një vajzë të përgojuar të ndreqë pasojat e thashethemeve, sepse i duhet të provojë të kundërtën e tyre dhe kjo gjë i shteron energjinë dhe nervat. Një vajzë që kishte dëshmuar disa situata të tilla u shpreh: "Thashethemet janë si jastëku me pupla që po u ç'a i nxjerr puplat jashtë. Puplat i merr era dhe i shpërndan kudo. Edhe sikur të rendësh pas tyre gjithë ditën nuk mblidhen më. Kam përjetuar me trishtim vuajtjet e shoqeve të klasës, të cilat nga thashethemet kanë dashur të lenë edhe shkollën sepse ishte thuajse e pamundur të ndryshonin mendjet e shokëve dhe shoqeve vetëm me fjalën e tyre. Ishte e çuditshme se me sa lehtësi pranoheshin thashethemet e dikujt dhe me sa vështirësi besohej alibia e viktimave. Sa më shumë mundoheshin këto të fundit të dëshmonin të kundërtën e asaj që ishte thënë në dëm të tyre, aq më dyshues bëheshin shokët dhe shoqet. Dhe verdikti i gjykatësve të padrejtë të klasës ishte aludimi se "ku ka zë, s'është pa gjë."

Pjesa tjetër e vajzave, 39.2 për qind, paragjykojnë më rrallë se një herë në muaj, por pohojnë se paragjykimet nga shoqet lenë shije të hidhur që qëndron gjatë. Ato nuk kanë mundur t'i harrojnë paragjykimet në drejtim të tyre dhe as t'i falin shoqet që i kanë përfolur, pikërisht sepse nuk e kanë pritur një gjë të tillë prej tyre. Të paragjykuarat shprehen se shoqet që kanë përhapur fjalë për to janë treguar të pabesa, sepse në shumicën e rasteve objekt përgojimi kanë qenë gjërat personale që vetëm përgojueset i kanë ditur si: një lidhje dashurore, një simpati e ndërjelltë, një sekret personal, etj. Të djegurat nga këto lloj përvojash, vajzat e përfolura i kanë ndërprerë marrëdhëniet miqësore me ish-shoqet në shenjë ndëshkimi. Një grua që e kishte pësuar prej hapjes së zemrës një shoqes së shkollës së mesme tregon: "Kur isha në vit të fundit të shkollës së mesme u njoha me një djalë nga një shkollë tjetër përmes një veprimtarie artistike midis shkollash, për vënien në skenë të veprës dramatike "Shi në plazh". Kisha shumë ankth dhe

ekzaltim njëkohësisht kur e takoja atë djalin, më pëlqente shumë dhe doja t'ia komunikoja këtë sekret dikujt dhe kujt më mirë se sa shoqes sime. Nuk kaloi as një javë dhe gjithë shkolla ziente nga fjalët për mua. U befasova kur shoqet më hidhnin fjalë shpotitëse dhe përmendnin fakte që vetëm shoqja ime i dinte. U mundova të mbrohesha por më kot, gjithçka ato thoshin ishte çka kisha thënë unë për vete! U ndjeva e tradhëtuar dhe e poshtëruar njëkohësisht. I thashë shoqes sime se nga ajo ditë nuk kishim më punë bashkë, por ajo filloi të mbrohej me argumentin se të tjerat e kishin pikasur vetë se në lidhjen mes meje dhe atij djalit kishte diçka më shumë se sa roli artistik dhe m'u lut që të mos i bëja dalje. Por unë e vendosa: nuk doja t'ia jepja më kënaqësinë e përgojimit. Ajo vazhdonte të më kërkonte falje, por unë e kisha humbur besimin”.

Vajzat vetparagjykohen më shumë për sjelljen, veshjen dhe komunikimin me djem. Peshën më të lartë të paragjykimeve kundrejt vajzave nga shoqet e klasës e zënë ato për sjelljen që përbëjnë 34.5 për qind të peshës specifike të të anketuarave. Vajzat kanë kontakt të vazhdueshëm me njëra-tjetrën dhe kalojnë shumë kohë në prani të njëra-tjetrës. Askush nuk është në shkollë më afër vajzave se sa vetë ato me njëra-tjetrën. Ato, duke vigjiluar sjelljen e njëra-tjetrës, shërbejnë edhe si mekanizëm kontrolli për sjelljen vajzërore. Morali me të cilin janë rritur dhe që e kanë përvetësuar prej jetesës në mikromjedisin rural shërben si kriter për vetvlerësimin e sjelljes. Duket paradoksale situata në të cilën vajzat e vendosin veten si gjykuese të sjelljes së vet, ndërkohë që do të dukej më e logjikshme që ato të kundërshtonin çdo lloj kontrolli mbi sjelljen e tyre, prej kujt do që të ushtrohej. Vajzat jo vetëm që tregojnë se përshtaten me moret shoqërore për gjininë, por edhe e kontrollojnë sjelljen e njëra-tjetrës nëse është në përputhje me to. Nëse do të zgjidhnin të mos përshtateshin me sjelljen e gjinizar dhe vetkontrollin moral, vajzat do ta kishin të pamundur të jetonin në mjedisin shoqëror, i cili konformizmin me normat kulturore e shpërblen, ndërsa shkeljen e ndëshkon moralisht. Vajzat janë në pamundësi objektive për të ndryshuar kodet morale të mjedisit shoqëror në të cilin rriten, pasi çdo tentativë e tyre për të mos iu përmbajtur moralit sundues i përball me sanksione të ashpra që zbatohen nga faktorët shoqërizues si prindërit, fisi, mësuesit dhe bashkëmoshatarët.

Vajzat që paragjykohen për pamjen, ku përfshihen edhe cilësitë fizike dhe veshja përbëjnë 34.2 të peshës specifike të të paragjykuarave prej shoqeve. Në shkollë të mesme, tiparet fizike dhe përmasat trupore marrin forma thuajse të qëndrueshme për gjithë jetën dhe vajzat identifikohen me ato tipare dhe trup. Duke e ditur që do të vlerësohen në bazë të përputhshmërisë me tiparet gjinore, vajzat e ndërtojnë dukjen sipas rregullave kulturore për

gjininë për t'u siguruar se të tjerët i kategorizojnë në gjininë që u takon. Pritshmëritë gjinore ngjyrosin veprimtarinë e përditshme, pamjen e jashtme dhe identitetin e vajzave. Në sajë të këtyre pritshmërive vajzat nxiten të vishen dhe të përdorin makiazh që të identifikohen me gjininë. Dëshira për t'u dukur sa më e përshtatshme me imazhin kulturor për gjininë, i shtyn vajzat drejt investimit të kohës dhe parave për realizimin sa më mirë të këtij qëllimi. Standardet e bukurisë femërore janë ekzagjeruar shumë edhe nga media vizive, e cila i bombardon të rejtat me imazhe përsosmërie fizike të paarritshme. Në këtë moshë, vajzat fillojnë të përdorin veshje që theksojnë edhe më shumë tiparet femërore si bluza dekolte, këpucë me taka të larta, aksesore zbukurimi si vathë, byzlykë e varëse. Një simbolikë e tillë nuk është shumë e përshtatshme për një institucion burokratik siç është shkolla, prandaj edhe vajzat ekzpozohen ndaj kritikave për pamjen. Ato duan të bien në sy të njëra-tjetrës dhe të djemve prandaj preokupohen shumë të kapin standartet e bukurisë përkundrejt të cilave i vlerësojnë, sidomos djemtë. Por vajzat, në mjedisin rural, paragjykojnë shumë për shfaqjet moderne në aparencë, sepse morali fshatar shkon kundër prirjes moderne të suksesit vetjak, ndër të cilët manazhimi i pamjes është një element që komunikon vetrespekt dhe vetbesim. Vetë vajzat janë mbartëse të moralit fshatar, moret e të cilit i përdorin shpesh si peshore për të gjykuar dukjen e jashtme të njëra-tjetrës, prandaj paragjykimet për dukjen janë shumë të pranishme edhe tek vetë ato.

Një nga shkaqet paragjykuese për moralin është edhe komunikimi me djem prej të cilit paragjykojnë 16.2 për qind e vajzave në shkollë të mesme, ndër të cilat 10.3 për qind prej shoqeve të veta. Komunikimi me djem dendësohet përgjatë viteve të shkollës së mesme, pasi të dyja gjinitë, si djemtë ashtu edhe vajzat, ndihen më të çliruar nga presioni moralizues i moshës së pubertetit dhe adoleshencës së hershme, të cilën e kanë kaluar tashmë. Në moshën e rinisë së hershme, është e natyrshme dhe e pashmangshme vendosja e marrëdhënieve miqësore, intime dhe erotike ndërmjet të rinjve. Këto marrëdhënie janë një kusht i nevojshëm për përcaktimin gjinor dhe orinetimin seksual të tyre. Shpesh njohje të tilla përfundojnë edhe në histori romantike ose lidhje të qëndrueshme që zgjasin gjithë jetën dhe ndonjëherë përfundojnë edhe në martesë. Për shkak të intensitetit të lartë seksual që ngjyros marrëdhëniet mes të rinjve, komunikimi mes tyre shihet shpesh me lente dyshuese nga vetë bashkëmoshatarët, të cilët përgjithësisht i komentojnë komunikimet mes djemve dhe vajzave si qëllimisht erotike. Vorbulla e thashethemeve që ngrejnjë vetë të rejtat për shoqet është shumë aktive dhe nuk kursen asnjë formë komunikimi ndër-gjinor, përveç atyre mes të afërmeve, të cilat janë shumë të rralla gjithashtu. Ndonjëherë flakën e

thashethemeve e ndezin edhe shkëndijat e xhelozisë vajzërore, kur vajzat rivalizojnë njëra-tjetrën për të tërhequr vëmendjen e djemve. Ajo që arrin të jetë e parapëlqyera është njëkohësisht edhe shënjestra e sulmeve ziliqare të shoqeve rivale.

4.7.7. Të paragjykuara nga fqinjët

Vajzat në shkollë të mesme përballen edhe me paragjykimet e fqinjëve, që vijnë të dytët në radhën e paragjyksesve pas shoqeve të shkollës. Paragjykuar nga fqinjët janë 18.1 për qind e vajzave në shkollë të mesme. Ato dëshmojnë se, megjithë kujdesin që bëjnë, është pothuasje e pamundur që të ruhen nga fjalët e fqinjëve, pasi fqinjët janë kaq të pranishëm në jetën e tyre sa nuk mund t'u fshihesh. Në traditën rurale është normë kulturore komunikimi me fqinjët dhe vajzat e kanë për detyrë t'i përmbahen. Në analizën që i ka bërë stilit urban të jetesës krahasuar me atë rural, Claude Fisher përcakton edhe konceptin për fqinjësinë në fshat sipas të cilit ajo “është një grup shoqëror intim dhe aktiv që kanë detyrime të ndërsjellta për shkak të afërsisë dhe ndërvarësisë” (1976:113). Por kur ndërvarësia pushon së ekzistuari për shkak të pranisë së shërbimeve njësoj si në qytet, atëherë vetëm afërsia fizike nuk mjafton për ta mbajtur gjallë fqinjësinë. Fqinjësia në fshat është prekur nga ndikimet urbanizuese të ekonomisë dhe familjet nuk kanë më edhe aq ndërvarësi nga njëra-tjetra. Është e pamundur të gjenden bashkësi rurale krejtësisht të izoluar nga ndikimet kulturore dhe ekonomike urbane dhe Farka, për shkak të afërsisë me kryeqytetin, është e hapur ndaj zhvillimit urban prej mëse dy dhjetëvjeçarësh, që prej vitit 1990. Ndikimet kulturore urbane i kanë bërë të rinjtë të jenë më pak konvencionale dhe nënvleftësues të normave tradicionale por mendësitë, pavarësisht prirjeve urbanizuese të jetesës në fshat, ngelen shumë vepruese dhe të rinjtë e të rejtat që përqafojnë elementë të subkulturës urbane gjykohen si të pamoralshëm.

Përqindja e vajzave që ndeshen me paragjykimet e fqinjëve është shumë e lartë, 58.9 për qind. Vajzat ekspozohen ndaj komenteve paragjykesive të fqinjëve, çdo ditë (22.6 për qind), çdo javë (19.4 për qind), çdo muaj (16.1 për qind) dhe aq shpesh sa nuk e mbajnë mend (2.7 për qind). Edhe vajzat që paragjykohen më rrallë se një herë në muaj, që përfaqësojnë 41.1 për qind. Ndihen shumë të bezdisura nga komentet dhe gjykimet e fqinjëve, sepse shpesh ata aludojnë negativisht për nderin dhe moralin e vajzave.

Fqinjët i paragjykojnë më shumë vajzat për sjelljen, aftësitë dhe komunikimin me djem. Vajzat që paragjykojnë për sjelljen, përbëjnë edhe përqindjen më të lartë, 35.6 për qind. Sjelljet e vajzave të reja në fshat janë në lupën e shumëkujt, por veçanërisht në atë të fqinjëve. Fqinjët në fshat i përmbahen përgjithësisht standarteve konvencionale të sjelljes dhe presin që edhe të rinjtë, sidomos të rejtat të dëshmojnë përkushtim në respektimin e tyre. Në pozita të paragjykuara janë sidomos vajzat që tregojnë pak zell në përmbushjen e pritshmërive të të rriturve në fshat. Nga paragjykimet e fqinjëve janë të prekura njësoj, si vajzat vendase, edhe ato të ardhura. Të dyja palët, si vendasit ashtu edhe të ardhurit, tregojnë vigjilencë të lartë ndaj sjelljes së vajzave. Të ardhurit kapen fort pas vlerave tradicionale të nënkulturës së krahinës së origjinës, duke dashur të krijojnë një identitet të dallueshëm prej vendasve dhe i detyrojnë vajzat t'i nënshtrohen rregullave të moralit të nënkulturës së tyre. Ndaj vendasve, të ardhurit mbajnë qëndrime dyshuese për vigjilencën e treguar në kontrollin e moralit të vajzave. Vajzat e tyre ata i kufizojnë në shoqërinë me vajzat e tjera të shkollës sepse duan të kenë kontroll të plotë në njohjet, miqësitë dhe marrëdhëniet e tyre. Ndërsa vendasit janë shumë paragjykuar ndaj të ardhurve, elementët nënkulturorë të të cilëve i konsiderojnë si të papërshtatshëm për kontekstin dhe kohën. Duket sikur vendasit mbajnë qëndrime më liberale ndaj sjelljes së vajzave krahasuar me të ardhurit, që vijnë kryesisht nga veriu dhe kanë përcaktime më të rrepta për moralin e vajzave dhe grave. Në lidhje me qëndrimet e banorëve në zona me popullsi të përzier, sociologu Zyhdi Dervishi shprehet:

“Përzierja e popullsisë shpërfaqet problematike për shkak të diversitetit subkulturor të theksuar, të identitetit psikokulturor të veçantë të njerëzve me banim në zona të ndryshme të vendit dhe mund të shoqërohet me konflikte me natyrë subkulturore... Autoktonët në fshat konsiderojnë si të huaj të përhershëm ardhacakët që dëshirojnë të zenë një copë tokë për të jetuar disi më mirë se në krahinën ku kanë banuar më parë. Këto mendësi e praktika janë më vepruese sidomos në zonat me popullsi më të përzier si fshatrat e ultësirës bregdetare dhe veçanërisht në periferitë e qytetëve të mëdha si Tirana... Në këto zona vërehen prirje të grupëzimit të popullsisë kryesisht sipas përkatësisë së tyre subkulturore, si dhe ruajtja e njëfarë distance me anëtarët e subkulturave të tjera, me të cilët shpesh janë edhe fqinjë të afërt. Në zonat me popullsi më të përzier

marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve të subkulturave të ndryshme karakterizohen jo vetëm nga ftohtësia indiferente, por edhe nga fobia e ndërsjelltë” (2002:169-170).

Vajzat me origjinë nga veriu janë dyfish të paragjykuara. *Së pari*, ato janë të paragjykuara sepse janë vajza dhe *së dyti* paragjykohen si të ardhura nga zona të prapambetura. Vajzat e ardhura, edhe nëse janë rritur apo kanë lindur në Farkë, janë nën sulm të dyfishtë. Nga njëra anë, ato paragjykohen për sjelljen prej fqinjëve të ardhur nga zona e tyre që i konsiderojnë vajzat si pjesëtare të grupit të tyre shoqëror dhe e ndiejnë për detyrë t’u vigjilojnë nderin, dhe, nga ana tjetër, prej fqinjëve vendas që i shohin me dyshim se mund të shkasin më lehtë moralisht pikërisht për shkak të kundërshtimit të kontrollit moral të shtrënguar.

Vajzat e paragjykuara nga fqinjët për aftësitë përfaqësojnë 15.1 për qind të peshës specifike. Fqinjët në fshat janë shumë të pranishëm në jetën e vajzave pasi atyre u lejohet të vizitohen pa shumë protokoll familjet e njëri-tjetrit. Në shumicën e këtyre vizitave, fqinjët, sidomos fqinjtat, venë re nivelin e rregullit dhe të pastërtisë së shtëpisë së fqinjit. Punët e shtëpisë janë më së shumti objekt diskutimi mes fqinjash dhe vajzat komentohen kryesisht për të tilla aftësi në moshën 16-19 vjeç, që është moshë e fejesës për vajzat në fshat. Vlerësimet e fqinjëve ndikojnë shumë në mundësitë për fejesë pasi opinioni i tyre merret si i mirëqenë prej krushqive të mundshme. Komentet negative të fqinjëve mund të jenë vendimtare në përfundimin e një ujdje për fejesë, edhe nëse të rinjtë duhen. Fqinjët interesohen edhe për të rregulluar krushqi të fisit të tyre me vajzat e fqinjëve, kur këto konsiderohen si të afta në kryerjen e punëve të shtëpisë dhe në rolet femërore të shërbimit dhe përkuqdesjes. Vajzat e dinë që fqinjët në vizitat që kryejnë nëpër shtëpitë e tyre nuk gjerbojnë vetëm kafe, por edhe qëmtojnë aftësitë e vajzave në lidhje me punët e shtëpisë, prandaj bezdisen prej vizitave të shpeshta të tyre. Përveçse për punët e shtëpisë, vajzat paragjykohen edhe për aftësitë për të kryer punë bujqësore dhe blegtorale, nëse familjet e tyre kanë tokë dhe bagëti. Vajzat parapëlqehen të kenë shprehi të punës agrare, pasi një pjesë e mirë e familjeve në fshat jeton prej veprimtarisë bujqësore-blegtorale dhe do t’u leverdiste ekonomikisht të fusnin në shtëpi një nuse të “kualifikuar”, aq më tepër që në fshat shumica e punëve bujqësore bëhen nga gratë, që zenë 54.4 për qind të punonjësve të sektorit privat bujqësor në Shqipëri (INSTAT, 2013:33).

Komunikimi me djem është një tjetër shkak për të cilin 11.3 për qind e vajzave në shkollë të mesme paragjykohe nga fqinjët. Jeta e vajzave në fshat është shumë e ekspozuar ndaj vëshgimit të fqinjëve, për shkak të hapësirës së ngushtë fizike dhe intime mes tyre. Vajzat e kanë shumë të vështirë të ruajnë fshehtësinë në kontaktet dhe komunikimet me djemtë, pasi ato njihen prej pothuajse të gjithëve në fshat dhe potencialisht mund të përgojohen në çdo moment nëse nuk tregohen vigjilente. Fqinjët i veshin komunikimet e vajzave me djem me fantazi seksuale dhe paragjykimi ndodh pikërisht për shkak të seksualizimit të marrëdhënieve mes të rinjve. Vajzat dhe gratë kishin shumë histori të tilla nga shkolla e mesme. Njëra prej tyre kishte pasur një të tillë me fqinjën që e kishte shtëpinë ngjitur me shtëpinë e saj. Ajo tregon: “Kur isha në vit të parë të shkollës së mesme, një shok i shkollës që kishte shok tim vëlla kishte shumë simpati për mua. Unë nuk i kisha dhënë shkas të kuptonte se edhe unë ushqoja të njejtat ndjenja për të, pasi ruhesha shumë prej fjalëve të fqinjëve dhe zemërimit të tim vëllai. Ai vinte me kast nga lagja ime çdo pasdite për të më parë dhe takuar në fshehtësi se në shkollë ishte e pamundur, por unë i shmangesha. Ai bënte sikur do të takonte një fqinjin tim moshatar me të, me të cilin luanin futboll dhe rrinte para shtëpisë sime me minuta të tëra në pritje të ndonjë shenje nga unë. E dija që çdo levizje imja jashtë shtëpisë ishte e vëzhguar dhe nuk guxoja të bëja asnjë hap jashtë, kur ai ndodhej aty pranë. Një pasdite, në muzg, kur po kthehesha nga shtëpia e një shoqes sime, dy gardhe tutje shtëpisë sime, ai më zuri rrugën në një cep të padukshëm poshtë një peme dhe pa folur kush dëgjoj të kollitet fqinji im që rrinte deri vonë në bahçe për të vaditur perimet. Fqinji pa na parë se kush ishim bërtet me sa kishte në kokë: “Ikni prej aty të paudhë”. Unë fluturova me një frymë brenda portës dhe nga ajo ditë fqinji dhe gruaja e tij më ngjallnin fobi, më dukej se ai e dinte kush kishte qenë pranë bahçes atë natë dhe se ja kishte thënë të shoqes. Sa herë i shihja ata të dy, shmangia rrugën dhe bëja sikur rrëmoja në çantë që të mos i takoja nga frika se mos më thoshin ndonjë gjë”. Kjo histori tregon se sa ankth ka përjetuar kjo vajzë prej frikës së përgojimit nga ana e fqinjëve, pavarësisht gjithë përpjekjeve që kishte bërë për të mos u dhënë shkas gojëve të liga.

Ndërsa një grua tjetër tregon se ajo e kishte paguar shtrenjtë përfoljen e fqinjëve, të cilët duke e parë në shoqërinë e një djali e frynë kaq shumë lumin e fjalëve sa i “mbytën dy të rinjtë në martesë”: “Në klasë të dytë të shkollës së mesme m’u bë rrodhe në djalë që e kisha njohur në praktikën mësimore. I them të mos e zgjasë më kur kuptova që po binte për keq në sy të tjerëve dhe kur objekt thashethemesh do të isha unë. Për të më sqaruar se nuk kishte qëllime të këqija në

drejtimin tim, por përkundrazi kishte shumë respekt, pas praktikës, ai vendosi të më sqaronte rrugës për në shtëpi, megjithë paralajmërimet e mia se po më vinte në rrezik nderin duke ecur pranë meje, se ai e dinte që shoqërimi i një vajze me një djalë ishte turp. Në përpjekje për të më zbutur dhe për të më bindur se nuk donte të më lëndonte ai vazhdonte të ecte krah meje dhe të ngrinte zërin për ta dëgjuar. Kur po afrohesha tek rrugica e shtëpisë sime, unë përsheptova hapat, por ai më kapi prej krahu dhe më tha që ta dëgjoja deri në fund. Natyrisht unë nuk po dëgjoja më asgjë, se po më uturiniv veshët nga sikleti se po më shihte e gjithë lagja tej dritareve. Rruga deri tek porta m'u duk si kalvari i Krishtit me kryqin mbi shpinë. Fqinjat e mia, që vinin gjithë ditën tek ne, ja behën në derë dhe folën me nënën që po zinte faqet me duar. E kuptova se çfarë kishin thënë fqinjat për mua. Në darkë babai më mori në pyetje se kush ishte ai djali dhe më tha që nga ajo ditë nuk do vija këmbë në prag të portës po të mos vinte ai për të më kërkuar dorën që të lahej turpi me të cilin kisha përbaltur nderin e shtëpisë. Dhe ashtu ndodhi, u martova për shkak të fjalëve!”.

4.7.8. Të paragjykuara nga të afërm të fisit të babait

Vajzat që paragjykohen nga fisi atëror zenë 13.1 për qind të peshës specifike. Një pjesë e mirë e të afërmeve të fisit të babait janë edhe fqinj pasi jetojnë në të njëjtat lagje në fshat. Pësja e paragjykimeve rëndon shpesh mbi supet e vajzave, pasi 65.7 për qind janë paragjykuar për ditë, për javë dhe për muaj dhe vetëm 34.3 për qind më rrallë se një herë në muaj. Vajzat paragjykohen prej fisit kryesisht për veshjen dhe sjelljen. Pothuajse dy të tretat e tyre, 67.9 për qind, janë paragjykuar në shkollë të mesme nga anëtarë të fisit për sjelljen me synim ruajtjen e nderit. Nderi është një çështje që rregullohet nga normat kulturore tradicionale. Sipas tyre vajzat nuk duhet të dashurojnë dhe të krijojnë lidhje intime seksuale para martesës, pasi kjo gjë çnderon fisin. Sipas mendësive mbisunduese dhe normave kanunore të shoqërisë tradicionale shqiptare, vajzat konsiderohen të paafat të zgjedhin vetë bashkëshortin e ardhshëm, madje përpjekjet e tyre për të gjetur shokun e jetës trajtoheshin si diçka e turpshme, që çnderonte burrat e familjes dhe të fisit (Dervishi, Z., 2003:39).

Fisi vepron si një polici private për mbikqyrjen e sjelljes së vajzave në mjediset publike dhe brenda shkollës. Syri vigjilent i fisit i ndjek vajzat ngado, në çdo lëvizje të tyre jashtë shtëpisë, edhe kur shkojnë për vizitë nëpër shtëpitë e të afërmeve. Vajzat në moshën e rinisë së

hershme janë veçanërisht të rrezikuara nga ngacmimet seksuale të meshkujve të cilët mund të përfitojnë prej naivitetit dhe mirëbesimit të tyre. Lidhjet sipërfaqësore dhe njohjet e nxituara me djem dhe burra të panjohur mund t'i çojnë vajzat drejt rrugës së rrezikshme të prostitucionit, një martese të pa menduar mirë ose një shtatzanie të padëshiruar. Përhapja e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme mund t'i ekspozojë vajzat ndaj sëmundjeve veneriane dhe virusit vdekjeprurës të HIV AIDS-it. Për t'i ruajtur vajzat nga shkarja në dukuri të tilla, prindërit dhe të afërmit e fisit mobilizohen të “policojnë” çdo njohje dhe shoqërim të vajzave me dhe të panjohur. Ata i mbajnë vajzat nën vëzhgim të rreptë duke i mbyllur në shtëpi dhe duke shpërfillur botën e ndjenjave të tyre (Dervishi, Z, 2005:74-76).

4.7.9 . Të paragjykuara nga mësueset

Megjithëse më pak se të tjerët, edhe mësueset i paragjykojnë vajzat në shkollë të mesme, kryesisht për komunikimin me djem, për sjelljen dhe për aftësitë. Janë 9.7 për qind e peshës specifike, vajzat që janë paragjykuar nga mësueset gra. Mësuesit dhe mësueset vajza janë më pak paragjykes se sa mësueset gra. Vajzat ndihen shpesh të paragjykuara nga mësueset gra: 65.5 për qind e tyre tregojnë se janë pre e paragjykimit të mësueseve për ditë, për javë e për muaj dhe 34.5 për qind më rrallë se një herë në muaj.

Mësueset i kritikojnë shpesh vajzat dhe u bëjnë moral në drejtim të nderit. Ato i “këshillojnë” të mos kenë shoqëri me djem, pasi do humbisnin kohën e çmuar për të studiuar dhe do të shpërqëndroheshin nga mësimet nëse fillojnë flirtet dashurore. Pjesa më e madhe e paragjykimeve, 17.9 për qind, shkojnë për komunikimet e vajzave me djem. Mësueset gra janë banore të Farkës dhe i njohin mendësitë e zonës për moralin. Ato nën trysinë e vazhdueshme të prindërve, sidomos nënave, bëjnë në shkollë rolin e mbikëqyrëses për vajzat, njësoj si nënat që e bëjnë këtë rol jashtë shkollës. Mësueset gra përvetësojnë role mëmësore në praktikën pedagogjike dhe i lejojnë vetes të kritikojnë dhe shajnë vajzat që shoqërohen me djem me pretekstin se u duan të mirën sikur t'i kishin bijat e tyre. Por nxënëset i përjetojnë sharjet e mësueseve më shumë si paragjykime dhe ndërhyrje në jetën vetjake, se sa si kritika dashamirëse. Studimet tregojnë se të tilla paragjykime nga ana e personelit pedagogjik shkaktojnë konflikte të shumta mes nxënësve dhe mësuesve dhe krijojnë armiqësi, ftohje dhe çarje midis dy grupimeve. Në lidhje me këtë dukuri shqetësuese në shkollat e mesme, sociologu Zyhdi Dervishi me të drejtë

thekson se paragjykimet janë si demonët: “Raste të konfliktit për paragjykime nga ana e mësuesve në mjediset e shkollave të mesme nuk janë të rralla. Paragjykimet janë demonë të padukshëm që i nxisin mësuesit të konfliktohen me nxënësit, demonë që ua thajnë shpirtin e gjallë, taktin dhe komunikimet me nxënësit, që i pengojnë të afrohen me nxënësit, të njohin universin e veçantë të secilit prej tyre” (2005:158).

Edhe paragjykimet për sjelljen, që zenë 15.4 për qind të peshës specifike, shkojnë në drejtim të moralit. Mësueset pretendojnë se janë aty jo vetëm për të dhënë mësim, por edhe për t’u kujtuar të rinjve, sidomos vajzave, normat e moralit shoqëror. Ato pretendojnë t’i ndihmojnë vajzat të përshtaten më mirë me kërkesat morale sepse këto kanë hyrë në një stad moshor që i ofron ato më shumë me gratë. Mësueset i udhëzojnë shpesh vajzat që të mos sillen më si vajza të vogla, por të tregojnë përgjegjshmëri sociale. Gjithashtu, mësueset i kritikojnë vajzat të mos sillen si djem, pasi nuk identifikohn si vajza dhe kjo mënyrë të sjelluri u jep vlerësime negative. E lidhur me sjelljen është edhe dukja e vajzave që gjithashtu vihet në qendër të kritikave të mësueseve, të cilat mendojnë se veshja e papërshtatshme në shkollë kompromenton sjelljen dhe imazhin e vajzave në sytë e të tjerëve. Pësia specifike e paragjyqimeve për veshjen është 30.8 për qind. Mësueset janë veçanërisht paragjyquese për veshjet e ngushta, sportive dhe fundet e shkurtra në shkollë. Madje ato i shkurajojnë vajzat që të mos vishen ashtu as jashtë shkollës sepse tërheqin vëmendjen për keq në një mjedis jotolerant për sjelljen e vajzave. Më shumë të paragjykuara janë vajzat që përdorin makiazh në shkollë, të cilat për të mbuluar aknen e moshës e mbulojnë fytyrën me krem pudër dhe që të mos duken të zbehta përdorin edhe ndonjë ngjyre të ndezuar për sytë, buzët dhe fytyrën. Ndaj vajzave të tilla mësueset mbajnë qëndrim thuajse armiqësor dhe i përçmojnë sepse sipas tyre këto vajza kanë ardhur të bëjnë sfilatë bukurie në shkollë dhe nuk e kanë mendjen tek mësimet. Një pjesë të mirë të orës së mësimi mësueset e kalojnë me moralizime në drejtim të sjelljes, veshjes, pamjes së jashtme dhe shoqërive të vajzave. Vajzat e paragjykuara për cilësitë fizike lidhur me makiazhin, që përbëjnë 7.7 për qind të të paragjykuarave nga mësueset, pohojnë se i dëgjonin mësueset për minuta të tëra, jo vetëm para klasës kur i bënin objekt kritike dhe shembull për të tjerat, por edhe nëpër korridore kur flisnin me njëra-tjetrën dhe u hidhnin shikime përçmuese duke i përçgojuar. Në sytë e këtyre vajzave mësueset sado që të pretendonin se i shanin për të mirën e tyre, në fakt ishin hipokrite dhe madje edhe ziliqare për bukurinë e moshës, pasi përdornin kundrejt vajzave klisheën: “Nuk i latë gjë mangut tualetit, as neve që jemi gra nuk po na lini rradhë të dukemi që jemi gra!”.

Bashkëlidhur me sjelljen janë edhe paragjykimet për aftësitë, që zenë 12,8 për qind të peshës specifike të të anketuarave. Nga vajzat në shkollë të mesme pritet që të bëjnë shumë përpjekje për të pasur rezultate të mira në mësim sepse prej tyre varet nëse do shkojnë në shkollë të lartë apo jo. Vajzat në fakt përpiqen më shumë se djemtë në shkollë dhe kanë më shumë sedër. Mirëpo vajzat përpjekjet për t'ia dalë në mësim i bëjnë fare të vetme, pasi nuk kanë as ndonjë ndihmë të madhe në familje për të mësuar dhe as ndonjë inkurajim konkret nga ana e mësuesve, përpos kritikave të pareshtura për aftësitë akademike. Në shkollë të mesme, vajzat tregojnë më pak interes në shkencat e natyrës dhe më shumë në shkencat sociale, megjithëse janë më mirë se sa djemtë në të dyja drejtimet. Ato fillojnë ta humbin bashkë me interesin edhe vetbesimin në aftësitë e veta akademike, jo se janë më pak të afta në shkollë të mesme, por sepse një pjesë e tyre e përfundojnë marrëdhënien me shkollën me përfundimin e shkollës së mesme. Edhe ato që dëshirojnë të vazhdojnë rrugëtimin në universitet nuk shfaqin interes në disiplina akademike që mbahen si mashkullore: si shkencat e natyrës, inxhinieritë, informatika, etj. Studimet në vendet perëndimore tregojnë të njëjtën gjë, që vajzat në adoleshencë fillojnë ta humbasin zërin në shkencat e natyrës sepse nënvlerësojnë aftësitë e veta sidomos në fusha shkencore ku ka pak prani femërore (Kimmel, M., 2000:159). Megjithatë, disa vajza orientohen drejt shkencave të natyrës për shkak të mundësive më të mëdha që paraqet punësimi në sektorët ku aplikohen këto shkenca. Historikisht arsimiti ka qenë sektori i shërbimeve publike, në të cilin janë punësuar më së shumti gratë, aq sa mësuesia konsiderohet si "punë grash". Për shkak të gjinizimit të sektorit të punësimit, arsimiti në vitin 2013 ishte një domen që mbahej përgjithësisht prej grave që zinin 68.3 për qind të personelit mësimor (INSTAT, 2013:33). Një nga drejtimet pedagogjike që mund t'u sigurojë punë vajzave si mësuese janë shkencat e natyrës, të cilat për shumë vite nuk u frekuentuan fare dhe madje degët e këtyre profileve kanë pranuar pas viteve 1990 aplikantë me mesatare shumë të ulët që të mos mbylleshin degët, ndërkohë që para vitit 1990 në këto degë shkonin nxënësit më të mirë të shkollave të mesme. Në lidhje me këtë problem në një studim për arsimin, , sociologët Artan Fuga dhe Zyhdi Dervishi argumentojnë:

“Vajzat janë më të prirura nga shkencat e natyrës se djemtë. Në parapëlqimet e vajzave për shkencat natyrore ka motive iluministe dhe vizione pragmatike më realiste për karrierën e tyre profesionale. Mjaft vajza mendojnë se mund të ushtrojnë profesionin e mësueses në kushtet

kur zhvillimet anarkike të tregut të punës nuk u ofrojnë mundësi më të mira punësimi. Nën ndikimin e rrethanave të tilla gjatë viteve '90-të të shekullit XX është rritur gradualisht numri dhe pesha specifike e vajzave që studiojnë për shkenca natyrore në fakultete të ndryshme të vendit. Shumica e vajzave prirën të studiojnë në ato specialitete të cilat janë më të mundshme të ushtrohen në Shqipëri si mësuësia, drejtësia, ekonomia, shkenca sociale, etj.” (2002:118-119).

4.7.10. Të paragjykuara nga shokët

Përveçse prej njëra-tjetrës, vajzat paragjykohen edhe prej shokëve të shkollës. Vajzat që kanë përjetuar peshën e paragjykimeve të djemve janë 7.2 për qind të peshës specifike të të paragjykuarave në shkollë të mesme. Gati gjysma e tyre, 48.3 për qind janë përballur për çdo ditë, javë e muaj të vitit akademik me paragjykimet e shokëve dhe gjysma tjetër, 51.7 për qind, më rrallë se një herë në muaj. Djemtë i paragjykojnë vajzat më shumë për sjelljet, veshjen dhe komunikimin me djem të tjerë. Duke qenë banorë të fshatit, djemtë janë shoqëruar me normat e moralit rural. Ata janë edhe mbartës edhe shprehës të këtij morali në ndërveprimet e përditshme me vajzat. Madje për të vënë vajzat në provë dhe për t'i kategorizuar në “të mira” dhe “jo të mira” ata i provokojnë me ngacmime të shumta, me fjalë, shikime, prekje. Vajzat që ndihen të paragjykuara për sjelljen nga djemtë, përbëjnë 34.5 për qind të peshës specifike, pra diçka më shumë se një e treta. Paragjykimet për sjelljen bëhen në drejtim të moralit.

Vajzave përgjithësisht u zhvillohet trupi më shpejt se shokëve të tyre në shkollë të mesme. Karakteristikat e rritjes fizike i japin djemve edhe më shumë vetsiguri sepse posedojnë më shumë hapësirë dhe janë më të fuqishëm. Edhe tiparet dytësore zhvillohen tek djemtë adoleshentë në shkollë të mesme. Zëri u trashet dhe trupi e fytyra u marrin trajta burrërore. Djemtë i përdorin këto tipare mashkullore për t'iu imponuar vajzave hierarkinë në marrëdhënie. Ata me kast e trashin zërin kur flasin me vajzat për t'u dukur më burrërorë dhe përvetësojnë pamje serioze për të ngjasuar me meshkujt e rritur. Bashkë me dukjen imponuese, djemtë përdorin edhe fjalor seksual në drejtim të vajzave për të afimuar pozitat e tyre sunduese. Të ngacmuara nga djemtë, vajzat shmangen dhe nuk përgjigjen. Shumë prej tyre dëshirojnë t'ua kthejnë, por stepen se mos përfshihen në konflikte që mund të përshkallëzohen dhe të përhapen

përtej shkollës mes lagjeve dhe fiseve. Vajzat, me koston e tyre, edhe pse janë nën sulmin e vazhdueshëm të ngacmimeve nga djemtë, ruajnë paqen në shkollë dhe jashtë saj. Përvetësimi i shprehive proshoqërore, që është rrjedhojë e procesit shoqërizues, i bën vajzat më tolerante dhe pranuese, pavarësisht se këto sjellje paragjykojnë si dobësi (Ohrn, E., 2001:325). Vajzat edhe nëse duan, nuk mund të përfshihen në skenarët e ngacmimit mashkullor pasi qëllimi i ngacmimit është pikërisht t'i tërheqë vajzat në kurth. Përfshirja e vajzave në vallen e ngacmimeve seksuale të djemve do t'i ekspozonte ato ndaj masave ndëshkuese morale nga ana e vetë djemve. Edhe kur ngacmohen, vajzat duhet të rezistojnë dhe të provojnë që janë të moralshme sepse standardi i dyfishtë moral për gjinitë e ve mbi shpatullat e vajzave barrën e provës së moralit, dhe jo në përgjegjësinë e djalit. Edhe në shoqëri të tjera, mospërputhja e vajzave me karakteristikat e dëshiruara gjinore e njollos moralin e tyre, sepse normat gjinore janë urdhëresa morale dhe vajzat nuk kanë mundësi të zgjedhin t'i zbatojnë ose jo (Broniwyn, D., 2002:289).

Djemtë i pragjykojnë vajzat edhe për veshjen dhe për cilësitë fizike, për të cilat janë përfolur 34.4 për qind e tyre. Paragjykimet e djemve për pamjen e jashtme e rrisin edhe më shumë ankthin e vajzave për imazhin e vetes. Ato përpiqen të jenë tërheqëse dhe joshëse për të rënë në sy të djemve dhe për të pasur vëmendjen e tyre. Por, sa më shumë e teprojnë vajzat me veshje dhe makiazh, aq më shumë paragjykojnë prej djemve si “kukulla play-boy” që mundohen të tërheqin seksualisht meshkujt. Në fakt një pjesë e konsiderueshme e vajzave mund të mos kenë këtë qëllim kur përdorin veshje që bien në sy, por u është shndërruar në një sjellje rutinë dhe e kryejnë thujse mekanikisht pa reflektuar mbi qëllimin e veprimeve të tyre. Imazhi seksist për vajzat u është injektuar kaq thellë sa duket se e kanë brendësuar dhe e kanë bërë pjesë të rutinës së përditëshme. Sipas këtij imazhi, të propaganduar nga media vizive dhe të dëshiruara edhe nga djemtë, të cilët në fakt tregojnë një vëmendje të shtuar ndaj vajzave tërheqëse, vajzat lipset të jenë gjithmonë të bukura dhe të godasin shikimin e të tjerëve me pamjen.

Nën trysninë e këtij perceptimi shoqëror që gjendet me shumicë tek djemtë, vajzat janë, si të thuash, të shtyra drejt dukjes dhe bëjnë gjithçka për të rënë në sy. Në tabelën e qitjeve nuk janë vetëm vajzat që kurojnë imazhin, por edhe vajzat që nuk tregojnë kaq shumë preokupim për pamjen. Vajza të tilla paragjykojnë se nuk tregojnë vëmendje ndaj thirrjeve seksiste për të qenë tërheqëse dhe madje mungesa e interesit për t'u dukur përkthehet nga djemtë si mungesë respekti e vajzave ndaj vetes dhe ndaj djemve gjithashtu, të cilët e kanë për detyrë t'u venë vajzave nota për pamjen. Në komunikimin me këto vajza djemtë përdorin shprehje të tilla si “shko rregullo

pamjen që ta marrim vesh se çfarë je!” ose “a ke pasqyrë në shtëpi të shihesh?”. Fyerje të tilla, me sfond paragjykes seksist, i lëndojnë vajzat e thjeshta që mund të jenë të tilla për shumë arsye, si për shembull sepse kanë zgjedhur, sepse nuk kanë mundësi financiare të “gufosen me veshjen” ose të “pispillosen”, ose nuk lejohen të veprojnë kështu prej prindërve.

Duket paradoksale, por djemtë i paragjykojnë vajzat edhe për komunikimet e vajzave me to. Për komunikimin me djem janë paragjykuar 10.3 për qind e vajzave në shkollë të mesme. Paradoksi qëndron në faktin se djemtë janë ata që i ftojnë në komunikim dhe pastaj, po djemtë i paragjykojnë pse komunikojnë. Njëri prej shkaqeve se pse djemtë e paragjykojnë komunikimin e vajzave me djem të tjerë vjen nga normat kulturore që e pengojnë komunikimin mes gjinive dhe që shoqërimin dhe komunikimin e vajzave me djem e konsiderojnë si një akt të turpshëm.


Ndërsa një shkak tjetër është edhe rivaliteti mes djemve për shoqëri me vajza. Nisur nga perceptimi se vajzat janë më të qeta, miqësore dhe tolerante, djemtë në shkollë të mesme parapëlqejnë të rrinë me vajza, më shumë se ç’kanë ndejtur në shkollën 8-vjeçare, kur krijonin grupe thujse vetëm me djem. Shoqëria me vajza i mban ata larg dhunës së bashkëmoshatarëve. Vajzat që parapëlqehen më shumë për pamjen marrin edhe më shumë sulme paragjykes mbi vete për shkak se bien më shumë në sy dhe janë më të lakmuara. Djemtë rivalizojnë ashpër me njëri-tjetrin për shoqërinë dhe për sentimentalizmat për vajzat. Pasja e një vajze të bukur është shenjë e superioritetit ndaj djemve të tjerë që konsiderohen të pasuksesshëm. Edhe prindërit, sidomos nënat, e vlerësojnë pozitivisht shoqërimin e djemve me vajzat, pasi prania e vajzave në jetën e tyre sjell ndryshime të mbara si: u ul tonet e agresivitetit, i bën më të dëgjueshëm, i largon nga bota e sherreve, i mbledh. Është e habitshme se si me këtë efekt balsamik tek djemtë shoqërimi mes dy gjinive paragjykohet për keq. Në fakt vajzat paragjykojnë, jo djemtë; vajzat vuajnë pasojat e shoqërimit me djem, ndërsa djemtë gëzojnë frutet e ëmbla të shoqërimit me vajza, sepse djemve kulturalisht iu lejohet, madje edhe iu përlloraget si sukses gjinor pasja e të dashurave, ndërsa për vajzat dashuria vazhdon të jetë turp dhe të ndëshkohet moralisht.

4.8. Paragjykimet për vajzat në shkollën e lartë

Nga gratë e anketuara, 22.4 për qind janë me arsim të lartë, në profilet: shëndetësi 21.0 për qind, shkenca sociale 34.0 për qind dhe mësuesi 45.0 për qind. Po t’i shtojmë kësaj shifre

edhe një përqindje të shkencave sociale që në fakt të vetmin treg pune të sigurtë kanë mësuesinë për lëndët shoqërore, përqindja e të formuarave në mësuesi është më shumë se gjysma e atyre me shkollë të lartë. Kjo e dhënë është e përputhshme me statistikat zyrtare sipas të cilave, mësuesia në Republikën e Shqipërisë, në vitin 2013, ishte një profesion femëror, sepse 68.3 për qind e të punësuarve në këtë sektor ishin gra (INSTAT, 2013:34). Pra gratë me formim universitar punojnë kryesisht në sektorin e arsimit dhe të shëndetësisë dhe një pjesë e vogël si juriste dhe ekonomiste punojnë në sektorin e administratës vendore të komunës dhe shërbime të tjera publike.

Shkaqet e paragjytimeve për vajzat në shkollën e lartë



Në shkollë të lartë, vajzat dhe gratë paragjykohen për aftësitë, sjelljet, veshjen, origjinën krahinore dhe komunikimet me djemtë.

4.8.1. Të paragjykuara për intelektin dhe aftësitë

Pjesa më e madhe vajzave me shkollë të lartë, (27.3 për qind) janë paragjykuar për aftësitë e tyre. Duke qenë se ishin vajza nga fshati, ato paragjykoreshin se ishin më pak kompetente për t'u përballur me kërkesat e shkollës së lartë se sa vajzat nga qyteti. Gjithashtu ato mendoheshin si më pak të afta të përshtateshin me jetesën e pavarur në qytet, ku edhe janë shkollat e larta, krahasuar me vajzat që vinin nga qyteti. Aftësitë e tyre vihehin në dyshim edhe kur diskutohej dega që kishin zgjedhur. Peceptimet e njerëzve për aftësitë intelektuale të vajzave nga fshati kanë qenë për shumë kohë negative. Peceptimet lidhen me nivelin subkulturor të

njerëzve në fshat që gjykohet se është më i ulët se sa ai i njerëzve që jetojnë në qytet. Fshatrat përgjithësisht janë më të prapambetur krahasuar me qytetet, që shihen si qendra që emetojnë kulturë shpirtërore, materiale, dije dhe risi teknologjike. Për këtë arsye, edhe studentet me origjinë nga fshati janë paragjykuar si të paeksponuar ndaj elementëve të kulturës urbane dhe difuzionit të kulturës perëndimore që prek më shumë banorët e qyteteve. E lidhur ngushtësisht me veprimtaritë bujqësore dhe blegtorale në fshat, jeta e vajzave nga fshati është konsideruar si e varfër për nga pikpamja arsimore gjithashtu, pasi punët në fshat mund të mos kërkojnë kualifikim të lartë, aq më tepër kur këto punë janë pak të mekanizuara. Shumica e punëve bujqësore në fshat janë kryer dhe kryhen nga gratë, e, për pasojë, vajzat nga fshati janë parë më shumë në rolin e bujkeshës se sa të studentes. Vajzat nga fshati që kanë treguar performancë të mirë në shkollë të lartë janë paragjykuar sepse kanë thyer mendësitë sunduese se vajzat nga fshati janë të paafta për shkollë. Ato kanë mundur të kapërcejnë kufijtë paragjykses, brenda të cilëve i ka vendosur opinionin publik dhe me rezultatet e mira kanë përmbysur pritshmëritë e ulëta të të tjerëve për to.

4.8.2. Të paragjykuara për sjelljet dhe komunikimin me të tjerët

Edhe sjellja e vajzave nga fshati është shpesh e paragjykuar në shkollë të lartë. Kanë vuajtur paragjykimet në shkollë të lartë për sjelljen 19.5 për qind e të anketuarave. Sjellja është bërë objekt diskutimi si në rastet kur vajzat kanë treguar vetpërmbytje, ashtu edhe kur kanë thyer tabutë morale. Vajzat që kanë treguar vetpërmbytje paragjykohen si inferiore. Ato kanë refuzuar të shkojnë në veprimtari të organizuara nga kursi për arsye nga më të ndryshmet, ku morali kufizues i subkulturës së tyre ka qenë më i rëndësishmi. Shpesh vajzat nga fshati janë kërcënuar nga familjarët e tyre se nëse u dilnin fjalë gjatë kohës së qëndrimit në qytet për të studiuar do hiqeshin prej shkolle, dhe vetpërmbytja e tyre për të mos iu bashkuar shoqeve dhe shokëve të kursit është bërë në kushtet e detyrimit për të mos shkuar më shumë se sa të mungesës së dëshirës. Ato duke mos iu bashkuar festave të shoqërisë së kursit, si ditëlindje, festime fund-viti, eskursionet, mbrëmje argëtimi, etj., në fakt kanë sakrifikuar dëshirat e tyre në mbrojtje të një interesi më të lartë që ishte vazhdimi i shkollës së lartë. Në një intervistë, një grua 47 vjeç, u shpreh me shumë mall për kohën që kishte qenë në shkollë të lartë, pavarësisht se nuk kishte mundur të gëzonte të gjitha veprimtaritë argëtuese të kursit, madje të tilla ajo quante veprimtaritë

shkollore si stërvitjen ushtarake dhe aksionin vullnetar: “Koha e shkollës së lartë është periudha më e bukur e jetës sime, do kisha dashur ta ngrija kohën në ato vite dhe të mos dilja kurrë prej andej. Edhe sikur të kisha një jetë të dytë do doja ta bëja përsëri shkollën e lartë. Unë vija nga fshati dhe për mua ardhja në qytet në shkollë të lartë ishte një arritje e madhe, ndihesha shumë e lumtur që ja kisha dalë të ikja nga fshati dhe që do të merrja një diplomë që do më mundësonte qëndrimin në qytet. Unë nuk mund të merrja pjesë në festat e shoqërisë së kursit sidomos ato që kryheshin jashtë ndërtesës së konviktit, sepse kisha frikë se po të merrej vesh, prindërit dhe fisi do më hiqnin nga shkolla. Por, në ditëlindjet e vajzave të organizuara në konvikt, në sallën e televizorit ose në dhomën e shoqes që kishte ditëlindjen shkoja. Mirë që në kohën tonë në shkollë të lartë organizoheshin zboret dhe aksionet që të mos ndahesha nga shoqet e kursit. Për këto aktivitete njëherë nuk më hiqnin dot nga shkolla se ishin me detyrim. Në aksionin vullnetar që kryem në vit të parë në një fshat për fushatën e mbedhjes dhe zhveshjes së misrit unë dola e para dhe mora edhe fletë lavdërimiti. Kjo gjë bëri shoqet e kursit ziliqare. Ato u ankuan tek pedagogu që mbikqyrte njësinë tonë se vlerësimi për mua ishte i padrejtë, sepse sipas tyre unë atë punë dija të bëja më mirë si fshatare që isha. Mbase edhe kishin pak të drejtë, se unë isha rritur në mes të arës së misrit e grurit dhe punët bujqësore nuk i kisha problem. Por, pjesa më e ndritur e jetës shkollore në universitet ishte zbori, sepse stërvitjen e bënim në natyrë dhe kishim shumë mundësi të qëndronim pranë njëri-tjetrit dhe të njiheshim më mirë. Kjo kohë e artë më shërbeu mua të krijoja miqësi me shoqet e kursit nga rrethe të tjera dhe me djemtë gjithashtu. Ishte hera e parë që po më konsideronin si të barabartë dhe po tregoheshin të vëmendshëm ndaj pranisë sime. Megjithëse ishte lojë, zbori zhvillohej në kushte të rrepta dhe të mirorganizuara. Gjatë luftës së simuluar ne ndiheshim sikur ishim në luftë të vërtetë dhe ndjenim të na rritej ndjenja e atdhedashurisë. Zbori dhe aksioni na afruan me njëri-tjetrin dhe shumë nga ato njohje i kanë qëndruar kohës. Në zbor unë provova edhe rrahjet e para të zemrës nga dashuria për një shok të shkollës, dashuri që ishte e ndaluar se mos turpërohej familja. Luftova shumë me veten për ta mohuar atë dashuri për hir të nderit dhe frikës se mos më hiqnin nga shkolla po të merrej vesh. Njëra duhej sakrifikuar: o ndjenja, o shkolla. Unë sakrifikova ndjenjën dhe zgjodha të vazhdoj shkollën, jo se nuk doja të isha me djalin që dashuroja, por sepse e dija që pasojat e marrjes vesh nga fisi do ishin tragjike. Do më hiqnin nga shkolla dhe do më quanin edhe të përdalë në fshat. Do plaste furtuna e thashethemeve “Të çuam për shkollë e na turperove!”. Unë i përjetova si të vërteta këto ndëshkime dhe nuk guxova të ngrihesha mbi to. Ende mendoj që i

kam bërë vetes dhe ndjenjave një padrejtësi, për hir të nderit”. Kjo histori tregon se sa e vështirë ishte për vajzat nga fshati të bashkoheshin me shoqet e tyre të kursit nëpër veprimtari jashtëshkollore.

4.8.3. Të paragjykuara për veshjet

Jo vetëm sjellja, por edhe veshja ka qenë një shkak për paragjyime në shkollën e lartë. Pohojnë se kanë qenë të paragjykuara për veshjen 10.9 për qind e të anketuarave. Vajzat nga fshati e kanë vuajtur më shumë se askush tjetër peshën e paragjykimeve për veshjen. Për t’u përshtatur me jetesën në qytet dhe me imazhin studentor, vajzat nga fshati dhe provincat që vinin në shkollë të lartë duhej të ndërrojnë veshjen dhe pamjen e jashtme. Ishte e papërshtatshme që vajzat të vinin në qytet me veshjet tipike të gruas fshatare dhe, aq më keq, në një mjedis studentor ku moda ishte kryefjala e ditës. Vajzat kishin vështirësi praktike në ndërrimin e “lëkurës” kur shkonin nga qyteti në fshat për pushime. Jo vetëm, sepse kishin ndërruar garderobën, por edhe mendësitë dhe nuk pranonin të ktheheshin më në stilin fshtarak të veshjes. Veshja si vajza nga qyteti në fshat ishte e paparanueshme për banorët e fshatit, të cilët e interpretonin stilin qytetar të veshjes si të degjeneruar. Me këto lloj paragjykimesh vajzat ishin mësuar në fshat dhe e prisnin reagimin negativ të fshtarëve për ndryshimet që kishin pësuar. Por ajo që vuanin më shumë vajzat ishin paragjyimet nga vetë shoqet dhe shokët e kursit që përpyekjen e vajzave nga fshati apo provinca të thella për të ndryshuar sjelljen dhe veshjen në një mjedis të ri e interpretonin si kamuflim të identitetit, si hipokrizi, si shtirje sepse nën ato petka qëndronte gjithësesi një fshatare ose një provinciale. Paragjykimet i lëndonin psikologjikisht vajzat, që në kushtet e tyre ishin duke bërë një sakrificë të madhe për të përqaftuar stilin qytetar të jetesës edhe me koston e ndëshkimit moral nga të afërmit.

4.8.4. Të paragjykuara për origjinën fshatare

Të gjitha paragjykimet për vajzat nga fshati janë lidhur në një pikë, tek origjina e tyre fshatare. Për origjinën janë ndjerë të paragjykuara 10.2 për qind e tyre. Popullsia e Republikës së Shqipërisë ka qenë kryesisht rurale dhe vetëm në censusin e vitit 2011 popullsia në qytete ja kaloi asaj në fshatra me 7 për qind (INSTAT 2011:10). Por, sikurse theksojnë studimet për

migrimin e brendshëm, rritja e numrit të popullsisë urbane nuk shënon një urbanizim automatik të të ardhurve nga zonat rurale. Përkundrazi, të ardhurit i kanë ruralizuar qytetet (Dervishi, 2001:37). Me një përbërje kaq të lartë të popullsisë rurale, duket paradoksale që ndaj vajzave fshatare ka pasur kaq shumë paragjykime. Por, popullsia fshatare karakterizohet nga një shumëllojshmëri nënkulturash që i bëjnë komunitetet fshtare të dallueshme. Elementët e përbashkët të nënkulturës krijojnë përkatësi ndaj grupit dhe ndarje me grupet e tjera që i nënshtrohen procesit të tëhuajtësimit.

Mozaiku nënkulturor që shtrihet në të gjithë vendin paraqet një larmi ngjyrash me të cilat banorët vetidentifikohen sipas përkatësisë krahinore. Origjina fshatare dhe krahinore, bashkë me të folurin dhe dialektin, janë shkaqe thelbësore për paragjykimin e 37.5 për qind të vajzave në shkollë të lartë. Stereotipet e lidhura me origjinën e kategorizojnë popullsinë në të kulturuar ose jo. Kështu, stereotipet për jugorët i portretizojnë ata me nota pozitive, prandaj vajzat nga jugu, edhe pse fshatare, vlerësohen si më të emancipuara. Ndërsa, stereotipet për veriorët i portretizojnë ata negativisht, prandaj vajzat veriore paragjykohen më shumë, sidomos për aftësitë. Vajzat nga Shqipëria e Mesme e kanë ndjerë më pak përcaktimin hierarkik subkulturor, për shkak se banorët e Shqipërisë së Mesme përshkruhen me nota pozitive, si njerëz me karakter të butë dhe të qetë. Një tjetër arsye ka qenë edhe afërsia e shkollës me vendin e origjinës. Shkollat e larta në të cilat kanë studiuar vajzat nga Shqipëria e Mesme ndodhen në Tiranë dhe Elbasan, kështu që vajzave nuk u është dashur të ikin larg mjedisit të tyre nënkulturor. Megjithatë, origjina fshatare ka shërbyer si shkak për paragjykime, sidomos kur bëhen krahasime mes studenteve nga qyteti me ato nga fshati.


4.8.5. Të paragjykuara për komunikimet me djemtë

Reth 9.4 për qind e vajzave të anketuara, janë paragjykuar në shkollë të lartë edhe për komunikimin me djem. Shkolla e lartë është etapa finale e shkollimit për shumicën e të shkolluarve dhe, si e tillë, shënon edhe përfundimin e njohjeve shkollore. Një pjesë e madhe e studentëve krijojnë lidhje dashurore dhe miqësore në shkollën e lartë. Shpeshherë këto lidhje kanë përfunduar edhe në martesë. Për shkak të intensitetit intim dhe seksual që kanë marrëdhëniet mes dy gjinive në moshën 19-23 vjeç, ndër të cilët disa kanë edhe synime për lidhje serioze, është e kuptueshme se përse në shkollë të lartë lulëzojnë marrëdhëniet

ndërgjinore. Shumë prej vajzave janë të dashuruara dhe madje edhe fejohen me ata që duan që në shkollë të lartë. Megjithatë, edhe pse duket si e natyrshme që vajzat në shkollë të lartë të kenë lidhje dashurore, ato nuk janë të imunizuara ndaj paragjykimeve për këto lidhje. Shumë prej tyre vihen në ciklonin e thashethemeve të shoqeve të njohura që nga shkolla e mesme, me të cilat janë në shkollë të lartë. Vajzat i ruhen shumë përfoljes në shkollë të lartë, sepse ato mund t'i rrënojnë përfundimisht imazhin, duke menduar që janë në prag fejese, martese ose të një njohjeje me synime serioze. Gjithësesi, vajzat në shkollë të lartë gëzojnë një liri relative nga kontrolli familjar dhe ndihen më të pavarura në njohjet që krijojnë me të tjerët. Kjo liri veprimi bën që ato të ruhen më pak nga përgojimi paragjykues, por njëkohësisht edhe të ekspozohen më shumë ndaj tij. Ndryshe nga shkolla e mesme, ku i vetmi mjedis i përbashkët për djem e vajza ishte klasa, në shkollë të lartë studentët kanë të përbashkëta edhe mjediset e ngrënies, sallat e studimit, bibliotekën e fakultetit dhe hapësirën ku banojnë. Për rrjedhojë, kontaktet mes tyre janë shumë të shpeshta dhe shoqërimi dhe komunikimi është më i zakonshëm.

4.8.6. Denduria e paragjykimeve për vajzat në shkollë të lartë

Vajzat që paragjykohen në shkollë të lartë çdo ditë, javë dhe muaj përfaqësojnë 53.0 për qind, ndërsa ato që paragjykohen më rrallë se një herë në muaj janë 47.0 për qind. Paragjykimet janë shumë bezdisëse për vajzat në shkollë të lartë. Vajzat nuk i tolerojnë ato me të njejtën lehtësi që i toleronin në shkollë të mesme. Në shkollë të lartë ato jo vetëm që janë më të rritura, por edhe më të maturuara e të sigurta tek vetja. Fakti që kanë mbërritur deri në shkollë të lartë i bën ato të ndihen superiore krahasuar me vajzat e tjera që qëndrojnë në shtëpi.



Ato nuk para i gëlltisnin lehtë paragjykimet, pasi për të ardhur deri në shkollë të lartë u është dashur të kapërcejnë pengesa të mëdha morale që largimin e vajzës nga shtëpia e konsiderojnë të papranueshëm dhe sfidë ndaj normave kulturore patriarkale. Pavarësisht shpërfilljes së vajzave, paragjykimet në shkollë të lartë nuk rreshtin edhe kur vajzat tregojnë se janë shumë të afta. Vajzat në shkollë të lartë vuajnë peshën e paragjyqimeve nga shoqet, fqinjët, fisi, pedagogët dhe shokët e kursit. Por më të parat paragjykuara ato janë nga personat e afër të cilat vërtetë duken të dyshimshme për të përbërësit intelektualë të shkollës së lartë dhe aftësinë për t'u përballuar me jetën studentore dhe stilin e jetesës urbane në qytetet universitare.

4.8.7. Të paragjykuara më shumë nga shoqet

Më shumë se nga të gjithë, vajzat në shkollë të lartë, rreth 34.0 për qind, paragjyken nga shoqet për sjelljet, veshjen dhe origjinën. Ato sulmohen me paragjyqime të tilla si: “sado të mbahesh, fshatare je”, “nuk di të vishesh”, “mos u sill sikur je rritur në qytet”, etj. Paragjykimet për sjelljen dhe veshjen prekin 45.3 të vajzave. Ato u krijojnë shumë shqetësime vajzave nga fshati, të cilat, jo pa shkak, e përjetojnë si armiqësore atmosferën qytetare.



Në fakt për këtë fobi të vajzave ndaj qytetit flitet edhe në një studim të kryer nga Fuga dhe Dervishi ku theksohet: “Vajzat nga fshati që vazhdojnë shkollën në qytetet të mëdha janë më

të rrezikuara të pësojnë zhgënjim të thellë nga dallimet ndërmjet subkulturës, mënyrës urbane dhe rurale të jetesës dhe nga përpyekjet e pasuksesshme për t'u integruar në qytet” (Fuga, A. & Dervishi, Z., 2002:80).

Gjithashtu, nën peshën e rëndë të paragjyqimeve vajzat vihen edhe për shkak të origjinës dhe të folurit. Për këto shkaqe janë paragjykuar 30.2 për qind e vajzave. Origjina është një kufi ndarës mes studenteve nga qyteti dhe atyre nga rrethet. Studentet nga qyteti i konsiderojnë studentet e rrethëve si të huaja dhe të përkohëshme. Në përjetimet e vajzave të anketuara ndihen reminishencat e historive të së shkuarës që kanë lënë gjurmë në kujtesën e tyre edhe pasi ka kaluar shumë kohë. Gjtë bisedës, një grua mbi të 40-tat tregon: “Kur vinim në qytet, ne studentet nga fshati pësonim një lloj shoku kulturor. Nëse nuk kishe ndonjë shoqe nga fshati ishte e humbur. Mezi sa merrnim veten muajt e parë të shkollës nga shushatja, me jetesën vetëm, larg familjes në një mjedis të huaj ku nuk njeh askënd. Në fshat ishim mësuar të flisnim më këdo pasi njiheshim si një familje e madhe. Në qytet nuk të përshëndet kush dhe secili sheh punën e vet. Vajzave nga zona të latgëta u mungonin shumë këto lidhje dhe i merrte shumë malli sepse nuk shkonin dot në shtëpi sa herë të dëshironin. Megjithë sikletet e përshtatjes me mungesat në komunikim na duhej të dëgjonim edhe lloj-lloj paragjyqimesh nga shoqet e kursit që nuk linin rast pa na treguar origjinën ose pa na përqeshur për mënyrën e të folurit. Unë mërzhitesha shumë por e kaloja me humor, ndërsa dy shoqet e mia ishin më të brishta dhe e përjetonin keq përçmimin për shkak të origjinës. Një ditë e gjeta një të tjetër prej tyre duke qarë në dhomë sepse kur ishte ngritur në seminar kishte përdorur disa forma të lehta të dialektit geg që ajo nuk i shmange dot në fillim të shkollës. Shoqet e kursit kishin qeshur me të dhe situata ishte bërë aq komike sa që pedagogu kishte ndërprerë mësimin. Shoqja ime ishte fyer dhe larguar nga seminari. Pas këtij episodi ajo ishte dëshpëruar aq shumë sa që donte ta ndërpriste shkollën dhe të kthehej në fshat, të rrinte pranë njerëzve si ajo, ku nuk e përfliste kush për mënyrën e të folurit dhe për origjinën. M'u desh të bëja një punë të madhe bindëse që t'i mbushja mendjen të qëndronte se do të ishte turp edhe më i madh po të kthehej në fshat se do ta vinin në majë të hostenit për pazotësi. Para seminarit shoqes sime i fillonte një lloj takikardie. Ajo kishte shumë ankth se mos ngrihej në seminar dhe shoqet e tallnin përsëri për të folmen. M'u desh ta shoqëroja për disa muaj sepse kishte krijuar fobi nga kursi, i dukej se e persekutonin me sy gjithandej dhe sikur e përflitnin pas krahëve. Më vinte shumë keq për të se e shihja të trembur dhe fare të vetmuar në kurs”.

4.8.8. Të paragjykuara nga fqinjët

Një pjesë e vajzave të anketuara, 21.0 për qind, janë paragjykuar edhe nga fqinjët, kur kanë shkuar në shkollë të lartë. Më shumë, vajzat janë paragjykuar për aftësitë dhe për sjelljen, 54.5 për qind. Fqinjët vazhdojnë të kenë të njejtat pritshmëri ndaj vajzave kur këto shkojnë në shkollë të lartë sikurse në shkollë të mesme. Në lidhje me aftësitë, fqinjët presin që vajzat, pavarësisht se janë larguar për shkollim në qytet, të ngelen brenda kornizave të moralit dhe rolit gjinor. Pritshmëritë në këtë drejtim nuk shterojnë pasi edhe roli gjinor nuk merr fund. Sikurse me të drejtë pohojnë Candace West dhe Don Zimmerman: "Gjinia bëhet" dhe jo vetëm mësohet (1987: 147). Gjinia është një rol që praktikohet, krijohet dhe performohet gjatë gjithë jetës.

Sa herë vajzat kthehen në shtëpi për pushime, fqinjët kuriozë i pyesin për gjithçka. Nga njëra anë, kjo normë mirësjelljeje ka shumë vlerë për përkatësinë sociale, afeksionin dhe solidaritetin. Madje një pjesë e fqinjave zemrëmira u sjellin edhe ushqime që i kanë përgatitur kasten për vajzat që priten si mikeshat pasi kthehen nga qyteti. Por nga ana tjetër, kërkshëria e tepërt e fqinjave i vë vajzat në pozita të vështira sepse ato i pyesin për gjëra intime, për shoqërinë me djem, për të njohur të tjerë që mund të jenë në shkollë të lartë, se si sillen ata në atë qytet, etj. Pastaj, vizita të tilla janë shumë të shpeshta përgjatë kohës që vajza është në shtëpi, aq sa këto nuk kanë mundësi të rrinë vetëm me familjarët ose të lexojnë në sezonin e provimit ose të pushojnë, pasi sapo mbyllen në dhomë për të lexuar ose pushuar, ja beh në derë një fqinjë ose një i afërm për t'i takuar. Një e intervistuar tregonte me tone të përziera humori dhe ankese një situatë të ngjashme kur kishte qenë në shkollë të lartë: "Kur u largova për në shkollë të lartë më përcolli gjer tek autobusi i gjithë fshati. Kur kthehesha në shtëpi për sezonin e provimeve vinin për të më vizituar fisi, fqinjët madje edhe shoqe pune të nënës. Ishte e pamundur të rrija rehat, sepse shtëpia rrinte plot dhe ata vinin për të më takuar mua. Vizitat ishin pa orar dhe unë duhej t'i përshtatesha orareve të njerëzve. Dita e parë dhe e dytë shkonin mirë, por pastaj bezdiseshat, jo vetëm nga lodhja duke shërbyer qerasjet, por edhe ngaqë rrija vonë për të lexuar. Unë shndërroheshat në kamariere në kohën që isha në shtëpi, me pritje e përcjellje. Kur kundërshtoja të dilja të takoja njerëzit, nëna më qortonte duke më thënë: "Turp të të vijë, pse për mua kanë ardhur ata, për ty kanë ardhur, hajde bëj kafetë!" Dhe kur zgjatej shumë dalja ime, ata pyesnin pse nuk po dilja. Në darkë, pas kafeve të njerëzve dhe darkave tona duhej edhe të pastroja shtëpinë, ndërkohë që nëna gatonte për të nesërmen. Në mëngjes, kur dilte për punë, nëna më

zgjonte të merresha me pastrimin e oborrit, me pulat, me vaditjen e perimeve, etj. Kur e pyesja se pse më lodhte kaq shumë, më thoshte se duhej të më shihnin fqinjët që unë isha po ajo vajza e urtë e punëtore që kisha qenë para se të ikja në shkollë dhe se shkolla e lartë nuk më kishte modernizuar domethënë nuk më kishte prishur zakonet e mira më të cilat më kishin rritur prindërit. Edhe ashtu ishte, kur dilja në mëngjes të kryeja punët në kopësht dhe të fshija oborrit fqinjët më përgëzonin “Të lumtë moj bijë, kush tha që të ndryshon qyteti, si ne ke ngelur, si lum kush do të fusë në derë!”. Nervozohesha me këto komente, pasi për fqinjët më shumë vlerë kishte që pastroja se sa që mësoja. Madje më dukej se kisha bërë ndonjë turp që kisha shkuar në shkollë dhe se duhej ta laja duke bërë punë, pra sikur isha në pozitë e fajtorit që duhet të provojë fajësinë. Në sezonin e verës duhej edhe të ndihmoja me të korrat, që të më shihnin fshati se nuk kisha harruar se kush isha e nga vija. Viti i parë i shkollës së lartë ishte hera e parë dhe e fundit që e kreuva sezonin në shtëpi, të gjitha sezonet e tjera i bëra në konvikt. Nuk kisha kohë të tepërt për të dhënë shfaqje devotshmërie para fshatit që t’u mbushej mendja se isha e ndershme dhe punëtore dhe të mendonin nëse duhej të më fusnin në shtëpi si nuse apo jo. Madje as nuk munda t’ua jap këtë kënaqësi të fundit, pasi u martova me një shokun e kursit dhe të dy shkuam në një qytet tjetër për të punuar. Por, vizitat në fshat vazhdojnë njësoj me ndryshimin se tani kafetë i bëjnë nuset e shtëpisë dhe jo unë. Unë kunata shkoj si mysafire!”

4.8.9. Të paragjykuara nga të afërmit

Edhe kur shkojnë në shkollë të lartë, vajzat nuk shpëtojnë nga kontrolli i fisit që i mban nën tutelë për çështje nderi. Këtë e tregojnë edhe të dhënat e anketimit, sipas të cilave 41.7 për qind e vajzave ndihen të paragjykuara për sjelljen dhe 16.7 për qind për komunikimin me djemtë, që të marra së bashku shkojnë tek 68.4 për qind. Pra gati dy të tretat e vajzave në shkollë të lartë përndiqen nga fisi për ruajtjen e moralit përmes kontrollit të sjelljes dhe të komunikimeve me djemtë. Fisi merr edhe prerogativa prindërore ndaj vajzave, pasi meshkujt e fisit patrollojnë sjelljen e vajzave duke kryer investigime të vazhdueshme për sjelljen e tyre. Fisi tregon ashpërsi të madhe ndaj vajzave, edhe më të madhe se e prindërve, të cilëve edhe u dhimbset bija e vet, ndërsa meshkujt e fisit, të cilët janë të pamëshirshëm me kushërirat e tyre dhe aplikojnë ndëshkime drastike, nëse zbulojnë elementë të pamoralshëm sipas tyre. Një grua që e kujtonte me detaje persekutimin e fisit në shkollë të lartë tregon se ishte ndjerë aq e fyer nga ndërhyrjet e

njerëzve të fisit sa edhe pas 20-vitesh nuk ua falte shqetësimin dhe turpërimin para shoqeve: “Në shkollë të lartë shkova me bekimin e prindërve të mi, sidomos babait që ishte shumë krenar që njëra nga fisi ynë po shkonte në shkollë dhe me këtë donte t’u mbyllte gojën njerëzve të fisit se nuk kishte vajzë për të fejuar. Nëna ishte më skeptike dhe më e trembur ndaj presionit të fisit dhe luhatej mes krenarisë dhe ankthit se mund të përflitesha nga njerëzit. Duke parë trishtimin në sytë e saj dhe duke ndjerë pasiguri për jetën larg shtëpisë, unë e refuzova shkollën. Një shoqe imja, të cilës i kishte dalë e njejta degë si unë, vjen në shtëpinë tonë dhe në gëzim e sipër u thotë prindërve të mi se i ati ishte interesuar të na gjente një dhomë të dyjave dhe që kështu ne do rrinim bashkë. Babait i shndritën sytë nga gëzimi ndërsa nënës ju ngroh shikimi dhe e falenderoi shoqen time. Qëndrimi së bashku ishte fatlum për ne dhe prindërit tanë që nuk kishin më ankth për qëndrimin në një vend të huaj, pasi kishim njëra-tjetrën dhe ata do vinin të na shihnin me rradhë. Në shkollë na shoqëroi babai i shoqes sime, fqinji im, që iku vetëm pasi na rregulloi të dyjave në një dhomë. Unë e kisha me shumë pasion degën. Kaloja shumë kohë duke lexuar. Baballarët tanë vinin rrallë për të na sjellë ndonjë ushqim dhe për të na parë. Kur vinin ata, ne gëzoheshim shumë, sepse ata na nxirrnin në qytet. Kur shkoja me pushime në shtëpi, vinin njerëz të fisit për të më takuar dhe pyetur se ç’bëhej në qytet, si ishte jeta atje, a kisha zënë shoqëri të reja, etj. Që prej fëmijërisë unë kisha miqësi shumë të ngushtë me vajzën e xhaxhait e cila ishte e afërt në moshë me mua. Asaj i tregoja se sa e bukur ishte jeta në hapësirën studentore, se si na ngacmonin djemtë në mencë dhe në shkollë, se si na këndonin serenata, se si disa vajza dilnin me shokët e kursit poshtë godinës darkave dhe këndonin me kitarrë, se di disa shoqe të katit kishin filluar të dilnin me të dashurit që u vërshtëllenin poshtë dritareve. Kushërira ime nuk donte të flinte gjithë natën për të dëgjuar këto histori që i dukeshin si film që i mbushte jetën e varfër në fshat. Kaq flakë mbanin rrëfimet e mia sa ajo më kujtonte ti vazhdoja aty ku i kisha lënë herën tjetër. Ajo ëndërronte të vinte në shkollë si unë. Por një ditë marr një telegram nga familja ku thuhej se kushërirën time po e fejonte xhaxhai në fshat pa mbaruar të mesmen. U trondita nga ky lajm dhe u nisa më shumë për të ngushëlluar atë të shkretën se sa për t’iu gëzuar fejesës së saj të padëshiruar. Kur shkoj tek xhaxhai, ai m’u lut që të hyja në dhomën e së bijës dhe ta bindja të dilte që aty se kishte dy ditë që qe mbyllur brenda dhe as hante as pinte, por vetëm qante dhe thoshte se do vriste veten. Unë iu luta pas dere duke i thënë që isha me të dhe ajo ma hapi. Ishte shndërruar në një qenie mjerane, me flokë të shpupuritur dhe sy të skuqur nga të qarët, e lodhur dhe pa dëshirë për të folur. Ajo nuk fliste, por në sytë e saj lexoja lutjen “më shpëto!”. I vinte

shumë turp kur krahasonte veten me mua, por nuk ishte faji i saj; baballarët tanë ishin vëllezër, por nuk ngjanin. Babai im bëri një rën për të më çuar në shkollë, babai i saj bëri një rën për ta fejuar. Pas ikjes sime, në shtëpitë tona plas sherri. Xhaxhai që kishte pritur nga unë t'i mbushja mendjen së bijës për fejesën, më akuzonte se i kisha prishur punë me broçkullat e mia që i kishin ngritur mendjen së bijës për të shkuar në shkollë të lartë. Për t'i mbushur mendjen babait se unë nuk isha në rregull, ai e fton tim atë të vinte të shihte me sytë e vet se ç'punë të turpshme bëheshin në qytet dhe se si vajzat nga fshati kishin dalë duarsh. Im atë jo vetëm që nuk pranoi, por e dëboi nga shtëpia. Nëna ime iu lut të mos vinin të më turpëronin dhe se do fliste ajo më babanë që të më hiqte nga shkolla nëse duhej, por një nip ja pret: "Nëse kanë vdekur burrat në këtë shtëpi, ka burra në fis që ruajnë nderin. Po e gjetëm keq do ta sjellim zvarrë prej flokësh e do t'ja përdredhim kokën si të zogut. Nuk na duhet shkolla ne, por nderi". Nëna u lebetit, ndërsa babai i bërë meit i nxorri jashtë dhe u tha të mos shkelnin më për gjallë a vdekje në shtëpinë tonë. Kaq mjaftoi që xhaxhai të mobilizonte djemtë e fisit dhe si skuadër e armatosur gjer në dhëmbë me paragjykime të zeza për moralin tim të "shthurur" erdhën të më "pushkatonin" në flagrancë. Unë nuk gjendesha në konvikt kur ja kishte behur toga, por isha në bibliotekë duke studiuar. Atje kaloja pasditet, pasi në dhomë bëhej rrëmujë ngaqë shoqet herë lexonin, herë flisnin e herë ftonin vajza të tjera. Mungesa ime kishte përmbushur profecinë e tyre: "Vajza e filanit ka marrë rrugën e drejtë!". Xhaxhai nuk kishte lënë vajzë të konviktit pa pyetur për mua: si isha, si sillesha, me kë rrija, a kisha të dashur, me kë dilja, kush më shoqëronte, ku haja, a flija përnatë në konvikt, a flisja me djem, çfarë vishja, a bëja tualet, e lloj lloj-pyetjesh që i kishin çuditur kaq shumë shoqet e mia sa njëra i ishte kthyer dhe i kishte thënë: "Ik mor xhajë, se nuk është gocë për ty ajo, qenke edhe goxha burrë. Shko gjej një tjetër! Paskë gjet edhe më të mirën pale! Ku ja ke mësuar emrin?". I zënë në befasi nga dyshimi i shoqeve të mia, që duke e njohur bababin tim, këtë burrin e kishin marrë për ndonjë kandidat potencial si burrë a si dashnor, ai ishte detyruar të prezantohej që ishte xhaxhai që kishte ardhur të pyeste për mbesën. Shoqet e mia ishin habitur edhe më shumë dhe ja kishin kthyer: "Ama shumë e dashke mbesën mor xhaxha që i nxorre bojën duke pyetur tërë dynjanë". Ndërsa xhaxhai merrte në pyetje gjithë konviktin, djemtë e fisit kishin dalë nëpër lagje të kontrollonin lokalet se mos më gjenin në praninë e ndonjë djali. Fati nuk i ndihu dhe meqë u err u larguan për në fshat. Unë i mora vesh të gjitha këto nga shoqet e dhomës, të cilat me shihnin me pikëllim. Megjithëse nuk gjetën gjë, një rëzit e mi u kthyen ngadhnjmtarë në fshat me pretekstin që unë nuk isha në godinë dhe ata

kishin pritur të vija e kishin kërkuar gjithandej pa sukses. Madje, duke kërkuar për mua që nuk më gjetën, ata kishin zbuluar plot gjëra të turpshme në qytet që nuk ua nxinte goja si: kishin parë vajza të “lyera e zhgërryera” që dilnin nga godinat e që shkonin për seks me para, madje edhe nëpër rrugicat e godinave kishin parë vajza të shtrira sheshit të droguara dhe të harbuara! Kaq mjaftoi dhe plasi thashathemnaja në fshat, që bazohej në faktet që kishin ofruar kushurinjtë e mi. Xhaxhai e bëri këtë nga turpi që të mos prishte fejesën e së bijës, pra t’i mbushte mendjen asaj që realiteti që i tregojta unë ishte i gënjeshtërt. Por fshati i mori fjalët e xhaxhait tim për tjetër gjë, për të sulmuar familjen time me nderin tim, dhe këtë e kisha peshqesh nga fisi! Babai u hidhërua shumë, filloi të shmangte takimet me fisin dhe fqinjët. Por, fisi nuk ishte i kënaqur dhe nuk e la me kaq interesimin e “ndershëm” për nderin tim. Në shkollë unë kisha edhe dy djem nga fshati fqinj, me fiset e të cilëve kishim krushqi dhe i konsideroja si kushurinj. Një ditë, njëri prej tyre, si i zënë në faj më thotë që kushurinjtë e mi i kishin kërkuar të spiunonte për mua, se me kë rrija në shkollë. Madje ata edhe e kishin qerasur që t’i nxirrnin ndonjë fjalë dhe kushëriri i tij, dhe imi njëkohësisht, e kishte paralajmëruar t’i mbante sytë hapur dhe të më ndiqte këmba-këmbës se nëse do merrej vesh diçka për mua. Shoku im ia kishte kthyer se nuk ishte spiun. E terrorizuar nga paranoja përndjekëse e fisit tim nuk guxoja jo të zija të dashur në shkollë të lartë, por as t’i flisja ndonjë djali nga frika se do ta eskpozoi ndaj furisë hakmarrëse të fisit që mezi ç’priste të shkrepse armët që i mbante mbushur prej 4 vitesh. Shkollën e mbarova me rezultate shumë të mira dhe m’u ofrua një vend në administratën e fshatit, por kur e bisedova këtë gjë me prindërit e mi, nëna me gjysmë zëri më tha që fjalët për mua nuk ishin harruar dhe se babai ishte bërë lolo për faj të tyre, kështu që i binte më mirë të mos kthehesha në fshat se do hapja kapakun e një pusete që qe mbyllur dhe se do më kujtonin që kisha qenë e “përdalë”. U ktheva prapë në qytet dhe u sistemova në administratën vendore me rekomandim nga shkolla. Nga ajo kohë nuk u kam folur as xhaxhait as kushurinjtë të mi, që ndihen fajtorë për fjalët e zeza që thanë në adresën time dhe për përpjekjet për të më hequr nga shkolla!”

4.8.10. Të paragjykuara nga pedagogët

Në shkollë të lartë vajzat paragjykohen prej pedagogëve për mënyrën e të folurit dhe dialektin dhe për origjinën krahinore dhe fshatare. Të tilla paragjykime u përforcojnë vajzave ndjenjën e inferioritetit dhe u ulin vetbesimin. Zakonisht, paragjykimet për dialektin dhe

origjinën bëhen të dukshme kur vajzat përgjigjen në seminare. Ato ndihen si më të mbrojtura nga paragjykimet kur u qëllon të kenë mësim me ndonjë pedagog që përdor vetë forma dialektore, sidomos kur këto përkojnë me dialektin e vajzave. Vajzat nga veriu, duke mos iu përmbajtur me përpikmëri dialektit tosk, që është versioni zyrtar i gjuhës shqipe, paragjykojnë se flasin një variant deviant të gjuhës zyrtare. Duke e ditur që paragjykojnë për mënyrën e të folurit që dekonspiron edhe origjinën e tyre, vajzat stepen të marrin pjesë në diskutimet në auditor. Por, format dialektore depërtojnë në detyrat me shkrim, prej të cilave vajzat nuk shpëtojnë dot. Përdorimi i gërmës “q” në vend të “ç” bëhet shkas për kthimin e detyrës mbrapsht për redaktimin gjuhësor.

Një vajzë që kishte dëshmuar të tilla paragjykime nga ana e pedagogeve tregoi: “Në kursin tonë kishim vajza nga e gjithë Shqipëria, por më shumë ishin nga veriu, sepse fakulteti ynë ishte mundësia më e afërt për shkollimin e tyre. Edhe pse ishin shumicë në kurs, vajzat nga veriu nuk e hapnin gojën fare në seminar. Unë i kisha shoqe disa prej tyre dhe çuditësha se pse ato nuk merrnin pjesë në diskutim kur në fakt ishin përgatitur dhe kishin lexuar edhe më shumë se ne të tjerat. Një ditë e hapëm këtë bisedë dhe i pyeta vajzat se përse nuk merrnin pjesë në seminar. Përgjigja ishte befasuese. Ato thanë se për t’u përgjigjur duhej ta përshtasnin përgjigjen dy herë, njëherë që të ishte korrekt për pyetjen që shtrohej dhe njëherë të ishte korrekt në shqipen zyrtare, a thua se do flisnin në gjuhë të huaj. Kur i pyeta se përse nuk e shkrepnin përgjigjen ashtu si u vinte në dialekt, ato u përgjigjen se e folura në dialekt krijonte ilaritet në auditor dhe nxiste kritikën e pedagogëve, sidomos grave, në drejtim të gjuhës së folur standarde. Përveç kritikave për të folurën, vajzat kishin drojë se “gabimet” e të folurës në dialekt do zbulonin identitetin krahinor dhe rural dhe do t’i vinin përballë paragjyqimeve për përkatësinë subkulturore. Për t’i kyrsyer vetes përçmimin prej origjinës ato nuk flisnin fare, megjithëse kjo gjë i penalizonte në vlerësim, sepse nuk merrnin pikë nga seminare”.

4.8.11. *Të paragjykuara nga djemtë e kursit*

Djemtë e shkollës janë gjithashtu shumë paragjyqes për origjinën dhe dialektin; 56.3 për qind e vajzave shprehen se djemtë i komentojnë me nota përçmuese origjinën krahinore dhe rurale. Nëpër pushime orësh ata përdorin shprehje dialektore për t’i vënë vajzat në lojë ose për t’u kujtuar statusin inferior. Bazuar në stereotipet negative për origjinën krahinore dhe rurale

djemtë paragjykojnë edhe aftësitë akademike të vajzave. Ata i bëjnë objekt talljeje vajzat kur këto diskutojnë për lëndët e kursit, duke i qesëndisur me pyetje ironike të llojit: “Ku i keni vëzhguar këto gjëra, në fshat? Me cilët kafshë i keni kryer eksperimentet në fshat që flisni për njerëzit? Ku keni mësuar të bëni llogari, pas mullarit të barit?”. Insinuatat fyese të djemve kanë edhe konotacion seksual, pasi vajzat nga fshati konsiderohen si të shkrehura moralisht, si më pak të edukuara, që nuk janë në gjendje të vetkontrollohen. Vajzat dëgjojnë të flitet prapa shpinës së tyre për episode të supozuara erotike tek “mullarët e barit, në mes të arës, në stallë, tek të korrat e tek të shirat”. Djemtë e lëshojnë pa frena fantazinë erotike dhe komentojnë me fjalë fyese sjelljen e vajzave në fshat. Vajzat ndjejnë neveri nga komente të tilla dhe lëndohen shpirtërisht, por përgjithësisht i injorojnë me mospërfillje.

4.9. Krahasime të paragjykimeve për vajzat në shkollë

Vajzat paragjykojnë për shumëçka përgjatë periudhës së shkollimit në të treja nivelet : në shkollë 8-vjeçare, në shkollë të mesme dhe në shkollë të lartë.

Motivet	Shkolla		
	8-vjeçare	Mesme	Lartë
Për sjelljen	31.4	32.5	19.5
Për Veshjen	30.1	18.8	10.9
Për komunikim me djem	0.0	16.2	9.4
Për aftësitë	11.4	11.3	27.3
Për cilësitë fizike	10.1	7.1	2.3
Për origjinën krahinore	3.3	2.9	37.5
Për shkaqet e tjera	13.7	11.2	20.4
Gjithësej	100	100	100

4.9.1. Nën peshën e paragjykimeve të shumëllojshme në shkollë

Gjatë moshës shkollore, që nga shkolla e 8-vjeçare e deri në shkollë të lartë, vajzat paragjykojnë më shumë për sjelljen, veshjen, komunikimin me djem, aftësitë, cilësitë fizike dhe

originën. Për sjelljen, vajzat paragjykojnë më shumë në shkollë të mesme. Pasi i janë nënshtruar procesit të shoqërizimit, përmes të cilit kanë mësuar normat kulturore për gjininë, vajzat në shkollë të mesme pritet të tregojnë se i kanë përvetësuar këto norma dhe tashmë janë të gatshme t'i venë ato në jetë. Për t'i zbatuar normat me përpikmëri, vajzat mbahen nën një tutelë të rreptë morali që i ndëshkon, nëse dështojnë. Në moshën e shkollës së mesme, intensiteti i paragjyqimeve për moralin dhe nderin rritet dhe vajzat vihen nën një rregjim të rreptë gjinor për të mësuar të luajnë sa më mirë rolet sociale të përshtatshme me gjininë e tyre.

Paragjykimet për veshjen janë më të shpeshta në periudhën e shkollës 8-vjeçare, kur vajzat kalojnë një periudhë rritjeje dhe transformimesh të vullshme fizike dhe psikologjike. Rritja kalon nga faza e fëmijërisë, në pubertet dhe në adoleshencë. Në këtë stad të jetës, vajzat ndryshojnë jo vetëm karakteristikat trupore dhe tiparet fizike të fytyrës, por edhe veshjen. Ato nuk janë më vajza të vogla dhe veshja nuk mund të jetë më ajo prej fëmije. Vajzat pritet të vishen në mënyrë të tillë që të mbulojnë pjesët trupore erogjene, deri edhe krahët që të mos ngjallin kureshtjen dhe epshin e meshkujve të rritur. Prindërit dhe të afërmit bëjnë shumë kujdes me veshjen e vajzave, e kontrollojnë me ngulm atë për t'i shkurajuar vajzat të mos veshin rroba të papërshtatshme që i ekspozojnë ndaj ngacmimeve seksuale. Një shqetësim madhor që i jep jetë paragjyqimeve për veshjen është frika e prindërve se shtatlartësia e vajzave dhe zhvillimi i tipareve seksuale mund të tërheqë meshkujt drejt tyre dhe vajzat mund të bien pre e mashtrimeve për shkak të mungesës së përvojës dhe e naivitetit të moshës. Paragjykimet luajnë një rol frenues në lirinë e vajzave në marrëdhëniet me të tjerët, sidomos me meshkujt jashtë fisit. Shqetësimi prindëror është i justifikuar në kushtet e trafikimit të vajzave për t'i shfrytëzuar si prostitute. Sipas statistikave zyrtare, 70.0 për qind e viktimave të krimeve seksuale në Republikën e Shqipërisë, në vitin 2013, ishin vajza dhe gra të reja (INSTAT, 2014:47). Por, qasja që kanë prindërit ndaj kufizimit të lirisë së vajzave dhe dëshirave të tyre nuk është plotësisht e justifikuar, sepse krijon rezistencë dhe moskuptim për qëllimin e aplikimit të frenimit. Aq më tepër, kufizimi i lirisë dhe ndrydhja e ndjesive në këtë moshë i pengon ato të kenë kontroll mbi marrëdhëniet me të tjerët.

Këto shqetësime të prindërve dhe të anëtarëve të fisit rriten edhe më shumë kur vajzat shkojnë në shkollë të mesme, ku paragjykimi kryesor është ai i komunikimit me djem. Në moshën e adoleshencës së vonë është e natyrshme që vajzat dhe djemtë të kenë më shumë njohje dhe marrëdhënie të afërta me njëri-tjetrin, pasi i ndihmojnë të përcaktojnë identitetin gjinor dhe

seksual. Edhe djemtë dëshirojnë të rrinë me shumë me vajzat në këtë moshë, pasi miqësia me to i mbron nga dhuna dhe etiketimet homofobe. Në këtë fazë të jetës, miqësitë dhe njohjet transformohen në lidhje më të ngushta, në marrëdhënie erotike që finalizohen edhe në marrëdhënie seksuale. Sipas studimit të vitit 2013 të Institutit të Shëndetit Publik mbi shëndetin e fëmijëve të moshës shkollore në Shqipëri, marrëdhëniet seksuale nisnin që në moshën 14-15 vjeç, dhe prevalenca e marrëdhënieve seksuale tek nxënësit 15-vjeçarë është 14.5 përqind, që i bie një në shtatë nxënës.

Prindërit dhe fisi i ruhen komunikimit të vajzave me djem, pasi këto njohje mund t'i shtyjnë drejt marrëdhënieve seksuale me pasoja në jetën e vajzës siç janë: lëndimi nga dashuri të dështuara, mospërqëndrimi në mësim, mbipërqëndrimi tek marrëdhëniet dashurore, mbetja shtatzanë, infektimi me sëmundje seksualisht të transmetueshme dhe vdekjeprurtëse si HIV AIDS. Përveç pasojave për shëndetin, prindërit dhe fisi i shkurajojnë njohjet me djem edhe për arsye morali, pasi në shoqërinë patriarkale rurale njohja dhe shoqërimi i vajzës me djem jashtë fisit konsiderohen sjellje të pamoralshme. Prandaj fisi ndihet përgjegjës për kontrollin e sjelljes seksuale të vajzës dhe pastron mjedisin shoqëror të saj nga njohjet dhe komunikimet me djemtë.

Vajzat paragjykojnë më shumë për aftësitë në shkollë të lartë. Në këtë stad moshor ato konsiderohen të rritura. Në përcaktimin e psikologut të zhvillimit Erik H. Erikson, zhvillimi psikosocial në moshën 20-21 vjeçare korrespondon me hyrjen në botën e të rriturve (1968:136). Prandaj edhe pritshmëritë shoqërore ndaj vajzave në këtë moshë janë më të larta. Ato janë në prag të ndryshimeve të mëdha në jetë, siç janë përfundimi i studimeve të larta, fillimi i një pune dhe martesë. Për të menaxhuar këto ndryshime që vijnë njëherësh, vajzat lipset të tregojnë aftësi dhe përputhshmëri me rolin e mësuar përgjatë viteve. Aftësitë përkujdesëse dhe shërbyese të vajzave komentohen gjerësisht në këtë moshë pasi prej tyre varet suksesi që do kenë në gjetjen e bashkëshortit dhe krijimin e familjeje sipas normave kulturore patriarkale që kërkojnë përkushtim tërësor të gruas në martesë. Për këtë arsye aftësitë e tyre në lidhje me kompetencën shoqërore dhe performancën gjinore diskutohen shumë. Për shumikënd, qëndrimet dhe sjellja në këtë moshë parathotë ecimin e mëvonshme të vajzave në rolet e tjera si bashkëshorte dhe si nëna.

Vajzat paragjykojnë edhe për aftësitë e tyre intelektuale, si më pak të zgjuara dhe të interesuara për përparimin shkencor, pasi në bazë të stereotipeve objektivi i tyre primar është familja dhe jo karriera. Edhe nëse bëjnë shkollë, kjo nuk i shpëton nga nënrenditja shoqërore.

Duke e lidhur përgatitjen akademike të vajzave kryesisht me nevojën për të gjetur një punë që lejon përkujdesin për shtëpinë dhe fëmijët, opinioni publik mbështet gjerësisht qëndrimin se vajzat nuk duhet të kenë ambicie akademike. Ky perceptim lidhet edhe me rolet gjinore ku burri do jetë siguruës ushqimi ndërsa gruaja përkujdesëse. Edhe nëse do punojë të ardhurat e saj do plotësojnë të ardhurat e bashkëshortit dhe nuk do jenë burimi kryesor i financave të familjes. Ka plot fakte që i kundërthojnë këto paragjykime ku ndër më kryesorët veçohen dy. *E para*, statistikat zyrtare tregojnë se vajzat janë më ambicioze në shkollë të lartë dhe këtë e faktojnë shifrat, sipas të cilave studentet vajza përbëjnë shumicën. Në vitin akademik 2012-2013, të regjistruarit në universitete ishin 56 për qind vajza dhe 44 për qind djem, dhe po atë vit studentët që u diplomuan ishin 60.5 për qind vajza dhe 39.5 për qind djem (INSTAT, 2014:43). Siç duket edhe nga të dhënat, vajzat edhe regjistrohen më shumë në shkollë të lartë, edhe i përfundojnë studimet. *E dyta*, vajzat kanë përgjithësisht rezultate akademike më të mira se djemtë. Vajzat janë më serioze në angazhimet akademike dhe në punën studimore e kërkimore.

Studentë të diplomuar në vite sipas gjinisë: 2008-2013				
Vitet	Në numër		Në %	
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
2008-2009	7.777	10.550	42.4	57.6
2009-2010	7.943	14.415	35.5	64.5
2010-2011	8.301	14.513	36.4	63.6
2011-2012	10.383	18.728	35.7	64.3
2012-2013	10.641	19.724	35.0	65.0

Burimi: INSTAT, 2014:43

Origjina krahinore dhe rurale, bashkë me mënyrën e të folurit dhe dialektin janë shkaqet kryesore të paragjykimeve në shkollë të lartë. Kjo ndodh pasi në shkollë të lartë vajzat janë në një mjedis të huaj, ku më së shumti gjykohet preardhja krahinore. Vajzat kategorizohen në shkallën e hierarkisë kulturore sipas përkatësisë subkulturore. Një pjesë e vajzave të ardhura në universitet nga fshati dhe krahina të largëta ndihen të huaja në qytetet ku studiojnë dhe kanë fare pak ose aspak ndërveprim me banorët. Gjithashtu, edhe mjedisi studentor është armiqtësor me vajzat me origjinë nga fshati. Ankthi se mos tradhëtohen nga dialekti, e pastaj identifikohen për origjinën dhe përkatësinë subkulturore, ua mbyll gojën vajzave në shumë situata ku kërkohet

ndërveprim, madje edhe në mësim. Duke u përballur me paragjykimet për prejardhjen krahinore dhe rurale vajzat hezitojnë të iniciojnë njohjet me të tjerët dhe ndonjëherë edhe i refuzojnë nga frika se mos të tjerët i venë në pozita qesharake dhe denigruese. Në këto kushte, vajzat pranojnë të rrinë pa kontakte, por me dinjitet, se sa të shndërrohen në objekt talljeje. Mungesa e komunikimit dhe e kontakteve u sjell penalitete për pjesëmarrjen në leksione dhe seminare, sepse duke mos marrë pjesë ato bëhen të padukshme dhe perfitojnë më pak nga angazhimi akademik, në pozitat e dëgjueses. Edhe më ndëshkues është moskomunikimi për rezultatet akademike, të cilat vuajnë mungesën e pikëve të pjesëmarrjes në seminare. Vajzat e kompesojnë mungesën e komunikimit me gojë me kryerjen e detyrave të kursit dhe punimeve kërkimore, të cilat përgjithësisht i kryejnë me shumë pasion, përkushtim dhe rigorozitet.

4.9.2. Të paragjykuara në shumë drejtime gjatë moshës shkollore

Vajzat paragjykohen shpesh përgjatë gjithë moshës shkollore në të gjitha ciklet e shkollimit, por më shpesh, thuhet për ditë, paragjykohen në shkollën 8-vjeçare dhe të mesme, kur janë duke u rritur, me qëllim që të shkurohen të kryejnë veprime me mendjen dhe vullnetin e tyre. Ndërsa vajzat në shkollë të lartë paragjykohen më rrallë, pasi nuk janë në kontakt ditor me të afërmit, sepse janë larguar në një qytet tjetër për studime. Por, largësia nga shtëpia dhe fshati i ekspozon ndaj paragjytimeve të banorëve të qyteteve ku shkojnë për të studiuar.

Sa shpesh paragjykohen vajzat në shkollë?			
Shpeshtësia	Me arsim 8-vjeçar	Me arsim të mesëm	Me arsim të lartë
Çdo ditë	35.5%	22.3%	6.3%
Çdo javë	15%	20.2%	21.0%
Çdo muaj	16.4%	17.0%	25.0%
Më rrallë	32.3%	39.8%	46.9%
Nuk e di	0.8%	0.7%	0.8%
Gjithësej	100%	100%	100%

Paragjykimet më të shpeshta dhe më të dendura vajzat i kanë për veten e tyre. Këtë e vëtetojnë të dhënat e studimit, sipas të cilave vajzat janë në krye të listës së paragjyguesve si në llojshmëri edhe në denduri. Ndodh kështu, pasi vajzat janë mbartëse të stereotipeve gjinore,

zbatuese dhe rojtare të tyre. Ato marrin shpërblim moral për sjelljen konform normave kulturore gjinore dhe ndëshkohen nëse nuk përmbushin pritshmëritë. Vajzat kanë për detyrë shoqërore të mbajnë nën kontroll sjelljen e vet dhe të njëra-tjetrës.

Fqinjët janë shumë paragjykues gjithashtu, por përfolja dhe thashethemet e tyre janë veçanërisht të shpeshta në mungesë të vajzave, domethënë kur vajzat janë larguar nga fshati në shkollë të lartë. Duke mos i pasur parasysh, fqinjët sajojnë legjenda urbane për vajzat që janë larguar nga fshati dhe në fantazmagorinë e fqinjit rural vajzat janë personazhe që shturen moralisht kur janë larg shtëpisë sepse janë “lëshuar nga zinxhirët” dhe nuk ka kush t’i kontrollojë.

Vajzat paragjykohen shumë edhe nga pedagogët, shoqet dhe shokët e kursit në shkollë të lartë. Megjithëse intensiteti i paragjykitimit është më i rrallë, lloji i paragjykitimit është shumë lëndues, pasi në shkollë të lartë ato paragjykohen për origjinën dhe dialektin. Duke qenë larg fshatit, vajzat i përjetojnë më keq paragjykitimet e të huajve sepse i duken shumë poshtëruese dhe depersonalizuese. Lëndimi prej paragjykitimeve në shkollë të lartë është më vuajtës, pasi vajzat mendojnë se në kundërshtim me paragjykitimet prej prindërve dhe të afërmeve të fisit që janë dashamirëse, paragjykitimet e të huajve janë dashakeqe. Ato madje mundohen edhe ti justifikojnë paragjykitimet që kanë vuajtur prej prindërve dhe të afërmeve të fisit kur kanë qenë në shkollë 8-vjeçare dhe të mesme, sepse kanë vepruar si frena për të mos i lejuar të rrëshqasin në humnerën e zezë të plagëve të prostitucionit, shtatëzanive të padëshiruara, martesave të pamenduara dhe divorceve të shpejta. Edhe nëse i kanë paragjykuar, prindërit dhe të afërmit e kanë bërë për të mirën e tyre dhe në fakt, sipas vajzave i kanë mbrojtur prej të këqijave të jetës. Por, paragjykitimet për origjinën dhe dialektin nuk kanë të njëjtin efekt. Ato janë thjesht derogatore dhe synojnë t’i nënrendisin vajzat në një shkallë më të ulët të hierarkisë shoqërore dhe kulturore bazuar vetëm në përkatësinë e tyre rurale dhe ktrahinore.

Kush i paragjykon më shumë vajzat në shkollë?			
Paragjykuesit	Me arsim 8-vjeçar	Me arsim të mesëm	Me arsim të lartë
Shoqet	24.6%	32.2%	34.4%
Fqinjët	18.9%	18.1%	21.4%
Fisi babait	23.1%	13.1%	7.8%
Mësues/pedagogë	7.7%	9.7%	7.8%
Shokët	8.9%	7.2%	7.0%

Të tjerët	16.8%	19.7%	21.6%
Gjithësej	100%	100%	100%

Të afërmit e fisit janë veçanërisht paragjykses për vajzat në shkollën 8-vjeçare, pasi synojnë të ndrydhin që në fillim çdo tentativë për autonomi dhe liri personale. Fisi është i shqetësuar për çështjet e moralit që kanë të bëjnë me nderin e vajzave dhe i ruajnë të mos shoqërohen me meshkuj se marrin rrugë të keqe. Prindërit dhe të afërmit gjykojnë se nderi i vajzave është shumë i rrezikuar në këtë stad të jetës dhe përpiqen të shkurajojnë çdo afrim të vajzave me meshkuj. Ata janë veçanërisht të shqetësuar për virgjërinë e vajzës, e cila duhet ruajtur deri në shkollë të mesme, kur të fejojhet.

Mësuesit i paragjykojnë më shumë vajzat në shkollë të mesme, kryesisht për aftësitë akademike dhe sjelljen. Ata presin më shumë nga vajzat, pasi mendojnë se ato janë më të përgjegjshme për detyrimet vetjake në këtë moshë. Mësueset janë më paragjykes se mësuesit, pasi ndërsa mësuesit paragjykojnë më shumë kompetencën akademike dhe interesin shkollor të vajzave, mësueset paragjykojnë përveç aftësive edhe sjelljen, veshjen dhe komunikimin e vajzave me djem. Mësueset janë vetë banore të fshatit dhe mbartin stereotipe gjinore të cilat i përdorin si etalon matës për vlerësimin e sjelljes së vajzave, të cilat sipas tyre lipset të shfaqen të bindura, të nënshtuara dhe të pazëshme, si në komunikimet më mësuesit, ashtu edhe në komunikimet me djemtë.

Shokët e klasës janë më paragjykses gjatë shkollës 8-vjeçare, pasi në këtë cikël shkollor, vajzat kanë më shumë dukshmëri në shkollë, janë më të mira në mësim dhe përpiqen të bien në sy të mësuesve për mirë, ndërsa djemtë bëjnë shumë pak përpjekje për të mësuar dhe tërheqin vëmendjen për keq me sherret dhe dhunën ndaj njëri-tjetrit. Djemtë ndihen më pak të sigurtë në shkollën 8-vjeçare edhe për shkak të epërsisë fizike që paraqesin vajzat si pasojë e zhvillimit më të shpejtë hormonal se djemtë. Djemtë e fitojnë sigurinë në shkollë të mesme kur zhvillohen fizikisht. Djemtë, duke qenë të shoqërizuar me normat kulturore për gjininë dhe me praktikat patriarkale të trajtimit të figurës femërore në fshat, mbartin shumë paragjykime për vajzat, ndërkohë që vetë janë ngacmues dhe provokues. Ky standard i dyfishtë është produkt i gjinimit të sjelljes në bazë të normave të moralit që funksion ndryshe për djemtë dhe ndryshe për vajzat. Vajzave që komunikojnë me djem u del nami i keq si të pamoralshme ndërsa djemve që ngacmojnë vajzat u del nami i mirë, si meshkuj të zotë.

KAPITULLI V

PARAGJYKIMET NË FAMILJE

Paragjykimet janë mendësi që ndikojnë tek qëndrimet. Ato janë konstrukte psiko-sociale të formura në kohë e jo të dhëna një herë e përgjithmonë. Forca me të cilën shfaqen dhe godasin paragjykimet kushtëzohet prej shumë faktorëve ndër të cilët më i rëndësishmi është mjedisi shoqëror me elementët përbërës: normat kulturore (besimet, qëndrimet, vlerat), struktura dhe funksionimi i institucioneve shoqërore (familja, edukimi, puna dhe feja) si dhe ndërveprimi simbolik mes njerëzve që bashkëjetojnë në këtë mjedis. Në vendet ish-socialiste, pozita e grave është përkeqësuar sepse humbën një pjesë të të drejtave të fituara në socializëm, siç ishin: pjesëmarrja në punë, përfaqësimi në politikë dhe mbrojtja sociale për fëmijët. Pas vitit 1990, me rifillimin e funksionimit të ekonomisë së tregut marrëdhëniet shoqërore u marketizuan, mbrojtja shoqërore ra, mundësitë e jetës për gratë u përkeqësuan dhe barazia sociale u zhduk nga fjalori politik (Fraser, N., 1997:3).

Gjithashtu, regresi socio-ekonomik u shoqërua edhe me një rritje të valës së paragjykimeve kundër vajzave dhe grave duke justifikuar edhe heqjen e përfitimeve të mëparshme me pretekstin se u ishin dhuruar dhe nuk i kishin fituar me meritë. Një mendësi e tillë ka qenë përhapur edhe në vendin tonë, fill pas shpërbërjes së regjimit socialist. Në kushtet e transformimit të tellë të shoqërisë shqiptare gjatë viteve të tranzicionit pasocialist, paragjykimet për gratë u rikthyen me një forcë të shtuar goditëse. Për këtë realitet të hidhur studiuesi Zyhdi Dervishi shprehet se, në periudhën e tranzicionit paskomunist, paragjykimet u përhapën si një mjergull e dendur avujsh acide dhe helmuan ndjenjat, mendimet dhe përjetimet e vajzave dhe grave (2001:48).

Megjithëse përgjatë shekullit të XX, punësimi i grave përmirësoi pozitën e tyre në sferën ekonomike, juridike dhe shoqërore, sfera private e familjes u prek më pak nga këto ndryshime

(Pomeranz, K., 2009: 123; Wolf, M., 1985:125). Familja vazhdoi të ishte mbretëria e patriarkisë, ku vajzat dhe gratë vuanin më së shumti rrjedhokat e shumëanshme të paragjyqimeve shoqërore. Brenda mureve të shtëpisë, ende gratë vazhdojnë të mbajnë të vetme mbi shpatullat e tyre peshën kryesore të përgjegjësive të përkujdesjes dhe shërbimit.

5.1. Paragjykimet dhe normat e kodifikuara të kulturës

Në lidhje me paragjykimet në familje, konteksti shqiptar ofron një larmi të pasur normash morale që kontrollojnë sjelljen e vajzave dhe grave. Paragjykimet për vajzat dhe gratë justifikohen në kodet zakonore, të cilat reflektojnë pasqyrime të mendësive patriarkale të trashëguara nga e shkuara. Kanunet që janë përmbledhje e normave për familjen dhe bashkësinë fshatare kanë vepruar shpesh si kushtetuta lokale për çështje të së drejtës familjare. Megjithëse në formë të shkruar Kanunet janë dokumentuar në një periudhë të vonë, ato kanë ekzistuar në formë të pashkruar që në lashtësi dhe janë përcjellë brez pas brezi.

Prej trashëgimisë kulturore ilire vijnë artefakte të shumta, si figurina artistike, të mledhura prej arkeologëve, të cilat flasin për traditat familjare dhe vlerësimin e fuqisë riprodhuese të gruas. Ilirët popullonin pjesën e Ballkanit perëndimor. Ata ishin të organizuar në shoqëri agrare dhe merreshin me bujqësin e blegtori, si shumë popujt të tjerë në periudhën agrare. Bujqësia ishte e përhapur në Ballkan dhe Mesdheun Lindor që prej vitit 6000 p.e.r. (Bentley, J.H. & Ziegler, H. F., 2003:7). Në shoqërinë agrare, toka ishte burimi kryesor i pasurisë. Gratë u morën shumë me punët bujqësore, sepse puna bujqësore, duke qenë e lidhur me punimin e tokës për mbjelljen e farave, i mbante gratë afër vendbanimeve, ndërkohë që burrave iu duhej të shkonin nëpër ekspedita gjuetie për të siguruar ushqim shtesë (Barber, E., 1994:57). Pronësia mbi tokën siguroi pushtet të madh ekonomik për meshkujt, të cilët u bënë pronarë të mbiproduktit në prodhimet bujqësore dhe pasurisë së vënë prej saj, të cilin e trashëgonin tek meshkujt pasardhës, ndërsa gratë dhe fëmijët u bënë pjesë e pronësisë së burrave në shoqërinë agrare (Engels, F., 1976:85). Gjëja për të cilën vlerësoheshin më shumë gratë ishte aftësia riprodhuese që shprehej edhe në formë artistike tek figurinat e grave shtatzana që simbolizonin pjellorinë dhe perëndinë e fushave. Këtë e vërtetojnë artefaktet që datojnë që nga koha e neolitit siç janë vazot, figurinat prej balte dhe varret, të zbuluara pothuajse në të gjitha zonat

arkeologjike në Ballkan, ku janë gjetur statuja femërore të neolitit (Pomeroy, S., 2011:4). Shqipëria, si pjesë e Ballkanit, ka trashëguar nga kultura e qytetërimeve të hershme.

Në vlerat fetare, gjithashtu, gruas i jepej një vend i veçantë, sepse vazhdimësia e prodhimit bujqësor paralelizohej me aftësinë riprodhuese të saj, duke e shndërruar figurën femërore në perëndi të jetës (Giambutas, M.,2001:3). Pushtimet e shumta, shkëmbimet tregtare dhe dyndjet e popujve fqinjë krijuan një përzierje kulturore në trevat ilire, e cila ka mbërritur tek pasuesit e ilirëve, shqiptarët.

Një nga studiuesit më në zë të zonave arkeologjike të hapësirës shqiptare, Luigi Maria Ugolini, gjatë udhëtimit në Shqipëri në vitin 1924, në kërkim të gjurmëve të qytetërimeve të lashta në Ballkan, përmes zbulimit të copëzave të kulturës material, shprehet se Shqipëria është selia e gjinisë ilire: “Ky popull mbetet ruajtës i zakoneve, dokeve, traditave aq të lashta, sa për të gjurmuar zanfillat e tyre duhet zbritur në qytetërimin homerik dhe në epokën parahistorike” (2009:15). Më shumë përshtypje Ugolini i ka bërë karakteri i malësorëve, të cilët ai i cilëson si njerëz kryelartë, luftarakë e të armatosur, që duan besnikërinë dhe nderin, të cilin e kanë edhe pasurinë më të madhe. Për Shqipërinë e Mesme dhe të Jugut, Ugolini shprehet se ka një popullsi më të qetë, ku burrat punojnë më shumë se ata në veri dhe gratë punojnë punë të rënda në bujqësi (po aty:16). Ai gjeti gjëra me vlerë në veri të vendit, në Gur të Zi të Shkodrës, një figurinë femërore prej bronxi, e cila paraqet një priftëreshë të Artemisit të Efesit. Kjo tregon për nderimin që kishin paraardhësit e shqiptarëve, ilirët për figurën femërore në rolin e perëndeshës. Gjetjet në varre dhe gjermimet në sipërfaqë kanë nxjerrë një shumëllojshmëri objektesh si: sëpata, vazo, gjerdanë, zbukurime, etj., që tregojnë për shkëmbimet tregtare të ilirëve me grekët e lashtë, me egjiptianët dhe me romakët.

Kutura ilire vjoi të ruhej tek arbërit, te cilët me ndarjen e perandorisë romake, bënin pjesë në peradorinë bizantine. Tradita kulturore shqiptare vjen si trashëgimi e kulturës iliro-arbnore, përzier me elemente të kulturave greke, romake, bizantine, islame dhe sllave, të cilat janë rrjedhojë e pushtimeve dhe e marrëdhënieve tregtare (Tirta, M., 2001:12). Ndikimet e kulturës greke e romake u ndjenë më shumë në ultësirën perëndimore, në qytetet Vlorë, Durrës, Shkodër, Ulqin, dhe fare pak në pjesën kodrinore-malore të vendit. Sikurse pohojnë faktet jetësore, «duke kaluar më në thellësi të zonave fshatare, ndikimi i kulturave perëndimore ishte më i zbehtë; në krahina të tilla ruheshin më të forta traditat e kulturës ilire, arbërore e shqiptare në të gjitha aspektet dhe sidomos në sistemin e normave kulturore kanunore” (Devishi, Z., 2013 :39).

Transformimi i shoqërisë arbnore në shoqëri feudale i dha jetë lindjes së familjeve bujare, siç ishte ajo e Dukagjinëve në veri, të cilat kanë grumbulluar normat tradicionale të trashëguara prej kodeve të lashta iliire në kode të pashkruara të quajtura kanune. Për të dhënë një kuadër sado të përafërt për mënyrën e jetesës në shekujt XIII-XVIII, ka të dhëna mjaft të kufizuara që vijnë kryesisht nga gërmimet e pakta arkeologjike dhe monumentet e ruajtura deri me sot (Gjergji, A., 2002:9).

5.1.1 Ndikime të kulturës osmane

Një ndikim të konsiderueshëm në normat kulturore pati edhe kultura osmane që u përhap në vend prej pushtimit osman që zgjati pothuajse pesë shekuj. Islami u përhap në Ballkan nga osmanllinjët turq, të cilët e pushtuan shkallë-shkallë duke filluar që nga viti 1350, duke hyre nga Daradanelet (Bentley, J.H. & Ziegler, H. F., 2003: 361). Pushtimi osman i kufizoi shumë komunikimet e kulturës arbnore me kulturën perëndimore europiane, e cila mori një rrugë tjetër pas mesjetës, me Rilindjen kulturore. Me rënien nën pushtimin pesëshekullor osman, Shqipëria nuk pati mundësi të kalonte procesin historik të Rilindjes dhe Iluminizmit që patën ndikim në pjesën më të madhe të Europës, e për pasojë, moderniteti evropian që pasoi në shekujt e mëpasëm nuk u vendos në shtratin kulturor të saj (De Gaay, F., 2000:85). Pas pushtimit osman, pjesa më e madhe e popullsisë u islamizua. Sipas studiuesit Zyhdi Dervishi: “Elementet e kulturës osmane nuk difuzuan me të njëjtën shpejtësi në hapësirën e kulturës shqiptare; më shpejt ato u përhapën në veshje dhe në ritualet fetare ndër shqiptarët e islamizuar e paralelisht me to u përhapën në gjuhën shqipe edhe fjalë arabe e turke që i shenjonin... Nën trysinë sistematike të kulturës së pushtuesve osmanë, ndryshuan shkallë-shkallë dhe në masë më të konsiderueshme elemente të kulturës së jetesës së shqiptarëve, të mënyrës së organizimit të ceremonive të gëzimeve dhe hidhërimeve e deri të mënyrës së të menduarit... Strukturat e regjimit të pushtimit osman imponuan për të gjithë popullsinë elemente kryesore të kulturës juridike osmane, të legjislacionit osman, i cili në shumë aspekte përshkohej nga fryma e Kuranit (Dervishi, Z., 2013:68).

Me islamizimin, disa norma të kanuneve u përzier dhe madje u zëvendësuan me ligjet e Sheriatit (ligji i shenjtë islamik). Kanuni i Skendërbeut që kishte një shtrirje të gjerë në

Principatën e Arbërit dhe krahinën e Kastriotëve me ndikim në Dibër, Elbasan, Krujë, Durrës e deri në Ohër, pësoi ndryshime të normave kulturore nën ndikimin e kulturës fetare islame (Ilija, F., 1993:15). Kurani dhe Sheriati përforcuan sundimin e burrave mbi gratë. Në praktikë, ata njohën trashëgiminë vetëm në linjë mashkullore. Për të garantuar pastërtinë gjenaologjike dhe legjitimitetin e trashëgimtarëve, Kurani dhe Sheriati e vunë jetën shoqërore dhe seksuale të grave nën kontrollin tërësor të burrave: etërve, vëllezerve dhe bashkëshortëve. Burrave u lejohej të martoheshin me disa gra njëherësh, ndërsa grave vetëm me një burrë. Kurani dhe Sheriati çimentuan themelet e shoqërisë patriarkale islamike. Grave nuk u lejohej të dilnin kryezbuluar, madje gratë nga shtresa e pasur në qytet duhej të mbulonin edhe fytyrën. Gratë duhej të dilnin nga shtëpia vetëm në shoqërinë e meshkujve të familjes ose të fisit të afërm, që të shmangnin vëmendjen e meshkujve që nuk ishin te tyre. Nën ndikimin e normave sociale, juristët dhe interpretuesit e Islamit i vunë gratë gjithnjë e më shumë nën pushtetin kontrollues të burrave, duke iu ndaluar çdo veprimtari ekonomike jashtë ekonomisë familjare që njihet edhe nga Kurani (Shatzmiller, M., 1993: 362).

Normat tradicionale kulturore janë ngritur mbi një shtrat të vjetër kulturor, në të cilin janë mbivendosur edhe norma të huazuara nga kultura të tjera, sidomos orientale. Megjithëse ka disa versione kanunesh, ato janë shumë të ngjashme. Kanuni i Lek Dukagjinit konsiderohet si një dokument prej të cilit rrejdhin disa nënvariate të quajtuara gjithashtu kanune, por që mbajnë emra të ndryshëm si: Kanuni Skënderbeut, Kanuni i Lumës dhe Kanuni i Bendës. Të gjithë kanë pasur veprim në pjesën kodrinore dhe malore nga Shqipëria e Mesme deri në Veri, që ishte edhe pjesa e banuar e territorit. Pjesa fushore dhe bregdetare ishin moçalore, gjë që vërtetohet edhe nga regjistrimet osmane të shekujve XV-XVI, sipas të cilave, shumica e vendbanimeve gjendeshin në zonat kodrinore dhe në shpatet e maleve, a rrëzë tyre, si dhe përgjatë luginave të lumenjve (Gjergji, A., 2002:9).

Kanunet kanë shërbyer si udhëzues për sjelljen shoqërore dhe vet-qeverisjen vendore për shumë shekuj. Elementë të shumtë të tij lidhen me jetën familjare, me pozitën e burrit, të gruas, fëmijëve, me fejesën, martesën, dhe nderin. Në këto udhëzues përshkruhen imtesisht rolet gjinore brenda dhe jashtë familjes. Në tekstet e kanuneve ka nene të shumta për gruan dhe sjelljen e saj para dhe pas martesës. Përgjithësisht këto rregulla ligjërojnë pozitën e nënrenditur të gruas ndaj burrit duke theksuar se roli i saj brenda familjes është të nënshtrohet, të shërbejë, të durojë dhe të lindë e të rrisë fëmijë. Duke reflektuar tiparet e një shoqërie patriarkale, kanunet nuk njohin asnjë

rol a kontribut të gruas jashtë shtëpisë, domethënë në jetën publike, madje e konsiderojnë angazhimin e saj jashtë shtëpisë si sfidë ndaj nderit të familjes dhe normave kulturore patriarkale. Kanunet përcaktojnë statusin e grave në shoqëri, nën autoritetin superior dhe kontrollin e burrave. Normat kanunore i trajtojnë gratë më shumë si objekte për t'u përdorur se sa si qenie njerëzore me të drejta gjë që reflektohet edhe në shprehjen “Grueja asht shakull për me bajtë” (Gjeçov, Sh., 1998:19).

5.1.2. Vajzat dhe gratë: pronë e meshkujve të familjes

Lidhur me pozitën brenda familjes, vajzat dhe gratë kanë pasur një vend të nënrenditur ndaj burrave dhe madje janë konsideruar si pronë e meshkujve të familjes, përkatësisht e etërve, vëllezërve dhe bashkëshortëve. Përgjegjësia kryesore për rolin shoqëror të gruas në familje lidhej me riprodhimin njerëzor dhe është ruajtur pothuajse e pandryshuar në kohë. Edhe funksionet ekonomike shtëpiake të gruas, siç janë: puna bujqësore, përkujdesi për fëmijët e të moshuarit, gatimi, larja, pastrimi, përgatitja e veshmbathjes për njerëzit e shtëpisë, etj., janë parë ngushtësisht të lidhura me ekonominë shëpiake që është një punë e pashpërblyer financiarisht. Vetë martesë ishte një kontratë, parimi i së cilës ishte sjellja në jetë e fëmijëve, si domos e djemve. Nusja e re bëhej pjesëtare e familjes së dhëndrrit dhe shkëputte lidhjet me familjen e origjinës. Ajo i nënshtrohej pa kushte pjesëtarëve të familjes së gjerë të dhëndrrit. Që në ditën e martesës, nusja e re duhej të kryente rituale kulturore për të treguar nënshttrim total ndaj burrit dhe njerëzve të familjes së tij.

Gratë nuk mund të divorcoheshin, madje vriteshin nëse kishin lidhje me një burrë tjetër, kurse burrat mund të merrnin disa gra. Gratë nuk mund të kundërshtonin dot normat skllavëruese dhe praktikat poshtëruese që ushtroheshin ndaj tyre, kurse burrat kishin të drejtë t'i rrihnin ato për mosbindje ose për kthim fjale ndaj tij dhe familjarëve. Në kanunin e Bendës thuhet se burri ka tagër t'i bërtasë dhe ta rrahë gruen kur t'i kthehet fjala e kur s'i bindet (Goci, H., 2010:47). Në kanunin e Lumës, në paragrafin 130, rrahja e gruas sanksionohet kur ajo nuk e dëgjon burrin dhe familjarët e tij: “Burri ka të drejtë me e rrahë, me e lidhë, e mshelë (mbyllur) brenda gruen kur ia kthen fjalën e kur nuk ndigjon” (Hoxha, Sh., 2013:106).

Marrëdhëniet shumë të pabarabarta gjinore dhe pozita tejet e nënshtuar e gruas në këto kode sjelljesh shoqërore ka tërhequr vëmendjen e studiuesve të huaj, të cilët, gjatë vizitave të tyre në Shqipëri, kanë dokumentuar fakte nga jeta familjare, kryesisht e familjes fshtare që lidhen me dukuri të tilla si shit-blerja e gruas në martesë, rrahja dhe deri vrasja e gruas. Një ndër vizitorët më të vëmendshme ndaj normave tradicionale të familjes patriarkale shqiptare, Mary Edith Durham shpehet: "Sipas kanunit, burri është zot i plotfuqishem brenda shtëpisë së tij dhe ka të drejtë të vrasë të shoqen dhe këdo prej fëmijëve. Sidoqoftë, një burrë nuk mund ta vrasë të shoqen nëse më parë nuk ka marrë pëlqimin e familjes." (Durham, M. E, 1990:44).

Vrasja e gruas nuk ishte gjë e zakonit, pavarësisht se ka ndodhur. Gratë ishin shumë të nënshtuara dhe e njihnin pozitën e tyre të pambrojtur. Të rritura në një shoqëri patriarkale, gratë i dinin pasojat që mund të kishte kundërshtimi i normave tradicionale. Për pasojë, gratë shumë rrallë mund të vepronin me kokën e tyre dhe të rrezikonin jetën, duke shkelur normat që lidheshin me nderin e familjes dhe të burrit. Megjithatë, burrat e ushtronin shpesh dhe e quanin normale rrahjen e gruas, të cilës askush nuk mund t'i ofronte mbrojtje kur dhunohej prej bashkëshortit ose të atit. Gjeografja skoceze, Margareth Hasluck që jetoi në Elbasan për trembëdhjetë vjet (1926-1939), në veprën "Ligji i pashkruar në Shqipëri", ka analizuar ndikimin e kanuneve tek sjellja e shqiptarëve. Ndër të tjera, Hasluck shkruan: "Burri ka të drejtë prej kanunit të shajë dhe rrahë gruan dhe fëmijët ... Djali nuk mund ta mbrojë dot nënën sepse është e pafalshme në kanun që djali të hakmerret për gruan e të atit... Djali është krejtësisht nën autotitetin e t'et" (Hasluck, M., 1954:44). Brenda shtëpisë, sidomos kur ishte e martuar, pozita e gruas ishte shumë e ulët, nga pikpamja e hierarkisë familjare. Roli shoqëror i gruas, sidomos asaj të martuar, kufizohej tek detyrimet për shërbime ndaj familjarëve të burrit dhe ndaj fëmijëve.

Jashtë shtëpisë, gruaja ishte e paprekshme nga meshkujt e tjerë, jo për respekt ndaj saj, më shumë se sa për respekt ndaj meshkujve të familjes së saj. Gruaja nuk ishte subjekt me të drejta e, për pasojë, ngacmimet që *de facto* mund t'i bëheshin asaj, *de jure* cënonin nderin e meshkujve të familjes patriarkale, të cilët hakmerreshin ndaj ngacmimit për nderin e nëpërkëmbur të tyre. Vrasja e gruas jashtë shtëpisë nuk miratohej nga opinion shoqëror, madje ishte e ndaluar pasi gruaja nuk ishte subjekt i gjakmarrjes. Sipas kanuneve, vrasja e gruas shkaktonte gjakderdhje të dyfishtë: për vrasjen e saj hakmerreshin edhe familja e saj edhe i shoqi. Edhe vrasjet mes burrave dhe gjakmarrja ndaloheshin në prani të grave. Nëse një grua

kalonte pranë një vendi ku kishte kërcitur pushka, qitjet ndaleshin derisa të largohej ajo. Nëse një burrë në gjak ecte në prani të një gruaje ndaj tij nuk qëllohej derisa të ishte nën mbrojtjen e saj.

5.1.3. Dhunimi i gruas sipas normave kulturore kanunore

Për pozitën e poshtëruar të gruas shqiptare shprehen edhe vizitorë të tjerë që kanë kaluar dhe qëndruar në Shqipëri. Në një përmbledhje të përshtypjeve të të huajve për shqiptarët, titulluar *“Udhëtarët e huaj në Shqipëri gjer në fund të shekullit XIX”*, botuar nga viti 1909-1929, në Revistën *“Dituria”*, Mit’hat Frashëri, me pseudonimin Lumo Skëndo dokumenton dorëshkrimet e tyre, në të cilat, ndër të tjera, përmendet edhe gjendja e mjerueshme e gruas shqiptare. Në kujtimet e veta, botuar më 1820, në Paris, me titullin *“Udhëtim nëpër Greqi”*, François Pouqueville, ambasadori francez në pashallëkun e Janinës, nga viti 1805-1816, shkruan: ”Gratë shqiptare janë të bukura, por janë dënuar me punë të rënda e shëmtohen prej vuajtjeve ... që nuk premtojnë (lejojnë) zhvillimin e bukurisë; bukuria fizike humbet shpejt bash në moshën kur gratë e kombeve të tjera duken plot shndritje në fytyrë” (Skëndo L., 1999: 49). Pouqueville çuditet se sa pa mbrojtje ishin gratë në familjen patriarkale në Arbëri dhe se si “zakonet e martesës dhe fejesës e bënin gruan shumë fatkeqe që në djep”. Ai ve në dukje se gratë mund të vriteshin prej burrave edhe për dyshimin më të vogël dhe pa asnjë lloj gjykimi. Duke i cilësuar si barbarë dhe të egër burrat, Pouqueville thekson se në Arbëri: “Anarkia pjell despotizmin, domethënë të drejtën e të fortit mbi të dobët... Krimet janë të skuzuara (të falëshme) në favor të burrave dhe gjithë keqësia bie mbi gratë, të cilat me një dyshim të dobët, pa u gjykuar aspak, mund që të vriten” (Skëndo L., 1999: 50).

Edhe shoqëruesi i Lord Byron në Shqipëri, britaniku John Cam Hobhouse, në veprën *“Një udhëtim përmes Shqipërisë dhe provincave të tjera të Turqisë në Europë, Azi dhe Kostandinopojë gjatë viteve 1809 dhe 1810”*, botuar në Londër më 1813, shkruan se burrat shqiptarë janë të drejtë në ndëshkimet që i japin njëri –tjetrit: “Një dackë nuk lahet veç me vdekjen dhe një ushtari i presin kryet, por nuk e rrahin”. Por, kur vjen puna tek qëndrimet e burrave ndaj grave, Hobhouse shprehet se nuk “ndjen ndonjë pëlqim për moralin e tyre”, pasi ata i rrahin dhe i shesin gratë (për martesë – M.P). Më tej ai shkruan: “Gratë... janë pa edukatë (të parsimuara – M.P) dhe shikohen si kafshë pune: punojnë çdofarë punimi dhe shpeshherë rrihen... Kur pyetëm një të ri, a ishte i martuar, ai tundi kryet dhe na tha se nuk ishte mjaft i

pasur. Pas ca ditësh, atij i erdhi me një letër, ku i ati i shkruante: Eja se të kam blerë një grua! Sikur t'i thoshte: Eja se të kam blerë një lopë!” (Skëndo, L., 1999:65).

Tradita e rrahjes së gruas përmendet edhe në veprën e një çifti gazetarësh britanikë, John dhe Cora Gordon, “*Dy endacakë në Shqipëri*”, botuar në vitin 1927. Gazetarët takojnë në Shkodër një hoxhë, të cilit i kërkojnë leje për t’i bërë portretin, dhe ky, ndërsa pozonte, shikonte me ngulm gazetaren dhe në fund, duke psherëtitur thotë: “Duket se ju të dy shkoki fort mirë. Plaka ime vdiq dymbëdhjetë muaj më parë, se unë e rrihja keq. Tani po e shoh se paskam bërë liksht” (Skëndo, L., 1999:87). Edhe Mary Edith Durham vëren se rrahja e gruas ishte një gjë e zakonshme. Në një shënim ajo tregon se burrat i rrahin gratë pasi sipas tyre, gratë qenë mjaft të pabindura, ndaj dhe kishin nevojë për dru. Kur Durham u thotë se në Angli, “rrahja e gruas dënohej me burg, burrat, përfshirë edhe padren, u tronditën, sepse nuk arrinin dot ta besonin se ligësia e një gruaje do të arrinte deri aty sa të shkante të qahej tek valiu, që ky të dërgonte suvarinjte për të kapur të shoqin!” (Durham, M.E., 1990:198).

Përveçse rriheshin, gratë në Shqipëri trajtoheshin edhe si skllave, si pronë e burrit dhe e familjes së tij. Këtë fakt e konstaton edhe shkrimtari Ami Boué, në veprën “*Turqia Europiane*”, botuar në Paris, në vitin 1840. Shkrimtari francez e vizitoi Shqipërinë në vitin 1836 dhe i përshkruan shqiptarët si “popull i bukur por, që nuk gëzojnë ndonjë qytetërim siç u ka hije”, ndërsa për gruan shqiptare shprehet: “Shqiptarka s’është veçse një skllave e të shoqit: të ronguarët që në mituri, punimet e rënda e bëjnë të vyshket, rrudhet shumë shpejt dhe i digjet lëkura si edhe e burrave. Shumë herë burri edhe e rreh të shoqen...” (Skëndo, L., 1999: 131).

Udhëtarët e huaj kanë vënë re se gratë bëjnë punët më të rënda, sidomos ato të mbajtjes së peshave, të mbajtjes së druve mbi shpinë lidhur me tërkuzë, të kotruves së ujit bashkë me djepin në kurriz, ndërkohë që tjerrin leshin në furkë e thurin veshje me shtiza. Në shënimet e tij “*Eskursione në Shqipëri*”, botuar në Londër në vitin 1842, kapiteni anglez J. Best që kishte ardhur për gjueti në vitin 1838, shkruan se si gratë përdroreshin nga burrat për të mbajtur pesha të rënda, pasi burrat e kishin për turp, sepse u binte prestigji dhe çburrëroheshin në sy të botës. Duke lëvduar bukurinë fizike të grave, Best nuk le pa përmendur edhe “fuqinë e jashtëzakonshme të tyre për të bartur pesha të rënda mbi supë”, duke rrëfyer: “Një ditë kishim vrarë një derr të egër dhe kërkonim një kalë për ta shpënë tek anija, tri orë larg. Ata (burrat) që kishim pranë thanë se nuk gjenin dot kalë, por sollën një grua, e cila e mori thinë (derrin) në sup dhe e mbarti pa ndonjë mundim: e varfra mbase edhe u çudit duke marrë një shpërblim që s’i

dukej në barazim (që i dukej i tepërt – M.P) me një punë që e bënte çdo ditë (Skëndo, L., 1999:119). Të njejtin fakt sjell në shënimet e veta edhe piktori anglez Edëard Lear, në veprën “*Ditari i një piktori peisazhesh në Shqipëri*”, botuar në vitin 1851 në Londër, i cili kur vizitoi hapësirën shqiptare, gjatë vitit 1848, me keqardhje vuri re se niveli i qytetërimit ishte shumë i ulët dhe pozita e grave tejet e poshtëruar dhe shprehet se gratë përdoren si mushka për të mbartur barrë, sadoqë janë fort të bukura (Skëndo, L., 1999:153).

5.1.4. Paragjykimi se gratë janë krijesa të djallit

Të huajt kanë konstatuar se pozita inferiore e gruas buronte nga besimi se gratë janë të djallëzuara. Gruaja konsiderohej si një qenie e dobët, si për nga fiziku, ashtu edhe nga karakteri, prandaj mund të përdorej nga “djalli për punë të liga”. Këtë fakt e përshkruajnë me humor dy udhëtarë anglezë, Thomas Smart Hughes dhe Robert Twonley Parker, në veprën “*Udhëtime në Sicili, në Greqi dhe në Shqipëri*”, botuar në Londër në vitin 1820. Gjatë pritjes tek Ali Pashai, ata u udhëzuan të takojnë Psalidhën, një burrë që mbahej për dijetar e profesor, për të cilin Hughes thotë se më të madhe kishte famën se sa diturinë, të cilën në fakt e kishte më pak se gjysmake. Anglezët i shkuan në shtëpi “profesorit”, i cili i priti sipas zakonisht. E shoqja e profesorit nxorri kafetë, por pa ndenjur me mysafirët dhe kur këta shprehën keqardhjen për ndarjen e grave nga shoqëria, “profesori” përgjigjet se gruaja është e djallit, dhe në iu dhëntë liri do të abuzojë (Skëndo, L., 1999:92).

Edhe Mary Edhith Durham e përmend në shënimet e saj se burrat besonin se “gratë ishin të liga për nga natyra dhe për këtë duheshin rrahur”. Në një debat me burrat për çështje të “gjakut”, burrat pohuan njëzëri se gjakmarrjet ndodhin pothuajse gjithmonë për faj të grave, sepse gratë janë mjaft të liga, dhe se vetëm keq kishe po ta lije gruan të bënte si të donte, e për fat të keq, edhe prifti ishte në një mendje (Durham, M.E, 1990:198). Perceptimi se gratë ishin të djallëzuara mbase vjen prej rrëfimit biblik, sipas të cilit Eva, e mashtruar nga djalli që iu shfaq si gjarpër, e nxiti Adamin të kafshojë mollën e ndaluar në kopshtin e paradysës (Bibla, Dhjata e Vjetër dhe Dhjata e Re, Zanafilla, 3/8-17). Përhapja e islamit, që kishte huazuar nga bibla rrëfenjën e krijimit dhe mëkatit fillestar, e përforcoi idenë e fajësisë femërore duke mbështetur variantin biblik të krijimit të gruas, Havasë (Eva biblike) nga brinja e Ademit (Adami biblik) dhe ngjarjen e pemës së ndaluar, për të cilën fajësohet Havaja se tregoi një zell të papërmbajtur ndaj

joshjes së djallit (Topalloglu, B., 1997:14). Besimi se gruaja është mëkatore është materializuar edhe në praktikën e varrimit të myslimanëve në Shqipërinë e Mesme, të cilët varret e grave i bënin më të thella se sa të burrave, nga frika e supozuar se mos ajo ringjallej pas vdekjes dhe dilte nga varri. Sipas studiuesit Alex Vini “Gruas i bëhet gropa e varrit deri tek gjoksi, “ajo varroset më thellë se burri se është djall, kurse burrave u bëhet gropa deri tek beli” (Vini, A., 2010:83).

Paragjykimi se gratë janë krijesa të djallit ka qenë shumë i përhapur edhe në Europë. Duke e besuar si të vërtetë këtë paragjykim, Europa modern, përgjatë shekullit 16-17, përjetoi një luftë të dhunshme dhe shkatërrimtare kundër grave: gjuetinë e shtrigave, gjatë të cilës rreth 110.000 gra u gjykuan si të dyshuara për shtrigëri dhe rreth 60.000 u mbytën, u vranë e u dogjën në turra drush në vende publike (Levack, B. L., 2013:24). Teologët e shekullit të 15-të ngritën tezën se gratë shtriga e merrnin fuqinë nga djalli. Në fakt, gratë që u shpallën shtiga ishin gra të varfra, të vetmuara, të veja, të vjetra, lypëse dhe beqare pa mbrojtje, që jetonin në kufijtë e skamjes dhe për këtë arsye ishin viktimat të lehta.

Mbështetur në besimin se gratë janë krijesa të djallit, ekziston opinioni se gratë durojnë shumë dhe nuk i gjen gjë. Madje ekziston edhe një shprehje popullore se “Gratë kanë shtatë shpirtra”. Asnjë krijesë njerëzore nuk është e paisur me këtë pasuri, përveçse dikush që është vepër e së keqes. Kjo shprehje i ka bërë përshtypje edhe të huajve të cilët e kanë ndeshur dendur në bisedat që kanë patur me vendasit për normat zakonore. Një studiuese amerikane, Susan E. Protchett Post, që jetoi për disa vite në Shqipëri (1993-1998), tregon se këtë thënie e haste thujtë në çdo intervistë me gratë, të cilat, kur pyeteshin se si ja dëlnin të bënin gjithçka pa asnjë ndihmë nga familja dhe shteti, përgjigjeshin me thënien *klishe*: “Gruaja ka shtatë shpirtra”. Në fakt, me këtë përgjigje ato nuk përlligjin konceptin fetar dhe shoqëror se gratë janë krijesa djallëzore, por shprehnin aftësinë e grave për të duruar edhe mundimet më të rënda, sidomos sakrificën vetjake për t’i shërbyer me përkushtim familjes (Post, S.E, 1998:273). Për ta ilustruar punën e pandalur të grave shqiptare për mirëqenien e familjeve të tyre në kushte spartane në vitet 1990, ajo tregon bisedën që pati me një grua që punonte në një zyrë ministrie si ekonomiste me shkollë të lartë:

“Gratë shqiptare kanë shumë shqetësime në jetesën e përditshme. Njëra prej tyre më tregoi se në pallatin e saj uji vinte vetëm njëherë në ditë në orën 4 të mëngjesit. Uji nuk arrinte me presion në çesme sepse apartamenti i saj ndodhej në katin e pestë dhe

asaj i duhej të bënte roje çdo ditë kur vinte uji për të mbushur kovat dhe bidonat. Kur e pyeta se pse ngrihej gjithmonë ajo për të mbushur ujë dhe jo i shoqi, ajo më tha se ishte detyra e saj të mbushhte ujë, nërsa detyra e tij ishte vetëm të shkonte në punë. Pasi mbushte ujë, ajo përgatiste mëngjesin dhe bënte gati fëmijët për në shkollë dhe pastaj shkonte në punë. Pas pune, ajo i përvishej punës në shtëpi, gatuate, servirte ushqimin, pastronte, kujdesej për fëmijët.” (Post, S.E., 1998:23).

5.1.5. Dukuria e virgjinave

Duke parë se sa e vështirë ishte jeta për gruan shqiptare, disa studiues të huaj kanë hamendësuar se dukuria e “Virgjinave” ka qenë një justifikim për vajzat e reja për të mos u martuar, aq më tepër me burra që nuk i njihnin, me të cilët i kishin fejuar që në djep a i kishin shitur kur ishin fëmijë. Arsyeja kryesore mund të ketë qenë shmangia e poshtërimit, mundimit dhe skllavërimit si gra të martuara që e kishin dëshmuar tek nënat e tyre. Dukuria e “Virgjinave”, sipas Kanunit, nënkupton të drejtën e vajzës të zgjedhë të mos martohet me dikë që nuk e njeh duke u betuar që do rrijë beqare për gjithë jetën. Shkelja e betimit shkakton gjakmarrje, si për familjen e vajzës që e shkel betimin, ashtu edhe për burrin që e merr, sepse vajza i është premtuar më parë një tjetri. Për këtë dukuri, antropologja Micaela di Leonardo thekson: “Instituti i virgjinës është një arratisje nga detyrimet e rënda të ekonomisë dhe kulturës tribale për gruan. Përbetimi si virgjëreshë ka qenë mundësia e vetme për një vajzë për të qëndruar jashtë martesë. Prishja e betimit, për t’u martuar me një burrë tjetër, ishte prishje e fejesës së parë dhe çonte automatikisht në gjakmarrje. Burrat nuk i propozonin për martesë një virgjine sepse binin në gjak me të fejuarin e parë” (Di Leonardo, M., 1997:147-8).

Vajzat vendosnin të ktheheshin në virgjëresha, jo vetëm që të shpëtonin nga statusi i ulët i gruas dhe nga punët e rënda në martesë, por edhe për të siguruar krahë pune për familjen e origjinës. Babai vendoste ti jepte një pjesë prej vajzave attribute të statusit të djalit, për të siguruar mbijetësinë e familjes dhe drejtimin e shtëpisë në mungesë të djalit. Me vdekjen e saj, toka dhe pasuria e familjes i kalonin fisit, përmes trashëgimitarit më të afërt mashkull. Shndërrimi i vajzës në virgjinë ishte në dobinë ekonomike dhe shoqërore të familjes pa djalë, pasi ajo mund të kryente punët e mashkullit jashtë shtëpisë, të përfaqësonte familjen dhe ta mbronte duke marrë gjak, gjë që lejonte armëmbajtjen. Përveç detyrimeve familjare dhe shoqërore si burra,

“shndërrimi” shoqëror në burra u jepte atyre liri të madhe lëvizjeje dhe të drejta që gratë e tjera nuk i kishin, me përjashtim të së drejtës së riprodhimit.

Për të mos rënë nga statusi i privilegjuar i burrit, virgjinat, edhe pse ishin gra, nuk mund t’i kryenin vetë punët e grave, pasi do të çnderonin statusin mashkullor që kishin përvetësuar. Atyre u nevojitej një grua për t’u bërë punët e shtëpisë. Studiuesja e dukurisë së virgjinave në Shqipëri, Antonia Young ka vizituar dhe intervistuar disa virgjina nga viti 1989 deri në vitin 1999 dhe ka konstatuar se gratë virgjina mbanin një grua në shtëpi për t’u bërë punët, sepse ato vetë ishin shoqërisht burra dhe nuk u lejohej të bënin gruan. Por, duke qenë se ishin shndërruar shoqërisht në burra, ato bënin të gjitha punët prodhuese që sipas traditës ishin punë burrash, si: prerja e druve në pyll, punimi i tokës, mbjellja dhe korrja e drithrave, mbrojtja e bagëtisë dhe mbi të gjitha përfaqësimi dhe mbrojtja e nderit të familjes edhe përmes gjakmarrjes (Young, A. & Rice, J., 2012:164). Me tej Young argumenton se për virgjinat, veshja si burra është tregues i qartë emancipimi, sepse u lejon atyre të sillen si burra dhe qëndrojnë me burrat duke u falur një status superior krahasuar me gratë. Virgjinat i nënshtrohen një trysnie të madhe shoqërore për t’u dukur si burra. Ato duhet të përvetësojnë dhe të tregojnë në praktikë se janë burra: të vishen si burra, të presin flokët shkurt, të pijnë duhan e alkool, të shoqërohen me burra, të sillen vrazhdë, të disiplinojnë trupin me manierizma mashkullore, të flasin dhe të shfaqin tipare burrërore (Young, A., 2000: 11). Për të përshkruar “shndërrimin” shoqëror të një gruaje në burrë, Young rrëfen takimin me një prej tyre, gjatë një ceremonie martesore në Theth, në vitin 1996. Virgjina që takoi, quhej Pashk(a) dhe ishte rreth të gjashtëdhjetave. Ajo qëndronte në krye të vendit, si zot shpie, në një dhomë mbushur plot me njerëz. Young e përshkruan takimin me detaje: ”Kur hyra në dhomë, vura re Pashkën që i gëzohej rolit të burrit, ulur në krye, me një gotë verë në dorë, me cigaren pas veshit, veshur si burrë me pantallona e këmishë. Me një buzëqeshje dashamirëse, më ftoi të ulesha pranë saj dhe menjëherë filloi të jepte urdhra që të më qerasnin dhe të më sillnin ushqim me bollëk. Në qoshe të dhomës, siç e donte tradita, qëndronte nusja; ajo rrinte në këmbë, me sytë përdhe, shenjë kjo e nënshtimit dhe gadishmërisë për të shërbyer me përulësi. Kur Pashka dhe burrat ja nisën me pijet, nusja, femijët dhe gratë dolën nga dhoma, ndërsa mua Pashka më mbajti në dhomë si mik. Ajo ngulte këmbë që të ngrija dolli që nusja të bënte sa më shumë djem” (Young, A., 2000:9).

Madje, duke përvetësuar jo vetëm pamje, por edhe botëkuptim mashkullor, virgjinat tregonin përcimim për statusin e gruas si edhe burrat. Mary Edith Durham ra pre e një përcimimi

të tillë kur takoi një virgjëreshë në prani të burrave, e cila, pasi e përshëndeti sa për mirësjellje, i ktheu shpinën me përbuzje, për të vetmen arsye se e huaja ishte grua dhe ndërkohë vazhdoi të fliste me burrat. Durham ofron një përshkrim të hollësishëm të sjelljes shoqërore prej burri të virgjinës:

”Në mëngjes u nisëm për në Selcë-Kelmend. Aty takuam një virgjëreshë shqiptare të veshur si burrë... Qe një grua dyzet e shtatë vjeçe, e gjallë, me trupin të thatë, por të lidhur, e veshur me një palë tirqe e një xhaketë krejt të rreckosura. Ajo u zbavit shumë kur e fotografova, teksa burrat zunë ta ngacmonin për “bukurinë” e saj. Na tregoi se kishte qenë ajo vetë që kishte dashur të vishej si djalë që kur kishte qenë fëmijë dhe i ati e kishte lejuar. Kur ra fjala tek martesja, foli me mjaft ironi – të gjitha motrat i kishte të martuara, por ajo vetë qe treguar e zgjuar. Me mua ajo u soll me të njejtin përçmim që, sipas saj, meritonte kushdo që mbante veshur fustan; më ktheu kurrizin dhe shkëmbeu duhan me burrat, me të cilët dukej që i hahej më mirë muhabeti” (Durham, M. E., 1990:91).

Studiuesja e dukurisë së virgjinave në Ballkan, Mildred Dickemann argumenton se, pavarësisht se vajza “dënohej” me beqari të përjetshme në emër të së mirës së familjes për të zëvendësuar djalin e munguar, në fakt shndërrimi shoqëror në burrë nuk ishte dënim, por shpëtim: burrërimi ishte çlirim nga vargonjtë e skllavërisë femërore dhe gëzim i privilegjeve mashkullore, përjashtuar jetën seksuale. Dickemann liston një sërë arsyes se përse një vajzë në fshat nxitej të zgjidhte statusin e virgjinës, në vend të rolit të gruas së martuar, duke argumentuar: “Trajtimi klasik patrilinear (gruaja le shtëpinë e vet dhe shkon tek e burrit), ndarja e punëve rreptësisht sipas gjinisë ku punët më të rënda u liheshin grave, ruajtja me fanatizëm e virgjërisë dhe e besnikërisë bashkëshortore, shkelja e të cilave dënohej me plumb mbas shpine, puna e rëndë fizike pa ndërprerje, lindja dhe rritja e shumë fëmijëve, nënshtrimi pa kushte që iu diktonin meshkujt, rrahja për hiçmosgjë nga etërit dhe burrat e tyre, i kanë shtyrë me siguri disa vajza të zgjedhin jetën shoqërore mashkullore në vend të asaj femërore (Dickemann, M., 1997:204).

Margaret Hasluck hamendëson gjithashtu se zgjedhja për t’y kthyer në burrë për disa vajza ka qenë shpëtim i vërtetë nga zgjedhja e padurueshme, nën të cilën viheshin gratë e

martuara në Shqipëri, duke u shprehur: “Meqë vajza fejohej që në djep dhe madje që në bark të nënës, meqë jeta pasmartese e detyronte t’u shërbente e të jetonte vetëm me fisin e burrit dhe meqë puna e grave ishte shumë më e rëndë se e burrave dhe pozita e gruas shumë inferiore, nuk është çudi që si shpjegim për dukurinë e burrneshave të ketë shërbyer shmangia e martesës që ishte zgjedhë për gruan” (Hasluck, M., 1954:25).

Studiuesja e dukurisë së virgjinave, Antonia Young, në përmbyllje të intervistave me virgjinat shqiptare u drejtoi atyre një pyetje të fundit: A ishin penduar ato që ishin bërë burra? Përgjigjet që mori ishin të gjitha negative; asnjëra nuk ishte penduar që kishte ndërruar gjini, madje të gjitha kishin jetuar përvoja shumë pozitive si virgjina. Ato nuk kishin ndryshuar asgjë në kulturën e tyre, duke u shndërruar në burra, përkundrazi kishin përmbushur pritshmëritë shoqërore ndaj tyre, për rrethanat specifike në të cilat ishin ndodhur familjet e tyre. Megjithatë, njëra prej tyre, më e vjetra, shprehu njëfarë keqardhjeje: “Më vjen keq që u desh të bënim këtë lloj jete, falë rrethanave familjare. Koha nuk kthehet më prapsht. Megjithatë, të bëje një jetë burri ka qenë kënaqësi se të qenët burrë të jep prestigj të madh, pavarësisht se kjo zgjedhje të detyron të heqësh dorë nga jeta seksuale, martesa dhe fëmijët. Pastaj, a keni dëgjuar ndonjëherë që ndonjë burrë të dojë të bëhet grua? Natyrisht që jo, sepse burri është më i privilegjuar” (Young, A., 2000:91).

5.2. Paragjykimet për gratë gjatë regjimit socialist totalitar

Paragjykimet me të cilat ndesheshin vajzat dhe gratë nuk morën fund as në periudhën e regjimit socialist totalitar, gjatë të cilit, sidomos në vitet 1967-1970, u ndëmorri një fushatë e gjerë ndërgjegjësuese për emancipimin kulturor të shoqërisë dhe të vetë vajzave dhe grave. Përpjekjet e bëra gjatë regjimit socialist janë pasqyruar gjerësisht në gazetatat e kohës. Problemet e shumta me të cilat luftonin gratë dhe vajzat vinin nga paragjykimet në lidhje me punësimin, drejtimin në prodhim dhe në veprimtari të tjera, e deri tek ato për jetën brenda familjes dhe marrëdhënieve në martesë. Nga shkrimet e shtypit të kohës, del se realiteti shoqëror i grave dhe vajzave në socializëm, ishte i mbushur me pengesa patriarkale që buronin prej qëndrimeve dhe normave tradicionale në lidhje me pozitën shoqërore të gruas, me statusin e saj. Normat kulturore ishin një pengesë reale për emancipimin dhe ishte e vështirë të çrrënjoseshin nga vetëdija

shoqërore. Funksionimi i zakoneve të trashëguara nga e kaluara e vështirësonte përparimin shoqëror të grave. Të tilla zakone sanksiononin të drejta patriarkale të pronësisë së burrit mbi gruan dhe ndalesa të shumta për gruan që i mohonin asaj të drejtat dhe liritë themelore siç ishin e drejta e jetes, pronës, liria e fjalës dhe vetvendosjes. Për të ndryshuar gjendjen e mjerueshme në të cilën ndodhej gruaja shqiptare, u ndërmorren veprimtari të shumta shoqërore me karakter ndergjegjesues. Përmes mbledhjeve të hapura dhe takimeve derë më derë, organizatat shoqërore arritën të nxisin ndryshime në vetëdijen e njerëzve në linjën e emancipimit të përgjithshëm.

5.2.1. Lëvizja për emancipimin e vajzave dhe grave në vitet 1967-1971

Në vitet 1967-1970, emancipimi i gruas u konsiderua si një detyrë parësore e revolucionit socialist. Arsyeja se pse duheshin emancipuar vajzat dhe gratë gjendej në ideologjinë komuniste, sipas së cilës komunizmi nuk mund të ndërtohej pa gratë. Emancipimi, po të shpreheshim me termat e Michel Foucault, lidhej me rëndësinë që kishte gruaja për prodhimin dhe riprodhimin (1970:43). Sikurse në shtëpi, edhe jashtë saj, gruaja shihej më e përshtatshme në funksione shërbimi përkujdesës ndaj të tjerëve, prandaj gratë ishin më mbizotëruese në sektorët e shërbimit arsimor, shëndetësor, përkujdesit, tregëtisë, shitjes, etj.

Gruas i njihej edhe roli edukues i brezit të ri me idealet e komunizmit dhe që ato të ishin në gjendje ta bënin këtë lipsej të edukoheshin vetë të parat. Bazuar në parimet komuniste të punës së përbashkët për krijimin e burimeve të jetesës dhe rishpërndarjen e tyre, ideologjia socialiste nxiti pjesëmarrjen e vajzave dhe grave jo vetëm në prodhimin e të mirave materiale dhe shërbimeve publike, por edhe në vendimarrjen publike (Sadikaj, D., 1982:10).

Emancipimi i vajzave dhe grave konsiderohej jetik për fatet e atdheut dhe ato u vunë në shërbim të interesave të kombit. Për zbatimin praktik të idealit emancipues të shoqërisë u ndërmorren veprimtari të shumta, në disa nivele: politike, ligjore, ekonomike dhe kulturore. Veprimtaritë në nivel politik për emancipimin e gruas nisën me anëtarësimin e tyre në strukturat partiake dhe nxitjen e përfaqësimit të tyre në organet drejtuese partiake dhe mbështetjen e kandidateve gra si përfaqësuese të popullit në Kuvendin Popullor. Ndërsa, për të mbështetur ligjerisht të drejtat civile, sociale dhe politike të vajzave dhe grave u bëbë përmirësime në ligjet themelore. Vajzave dhe grave iu njoh e drejta e pronësisë dhe e trashëgimisë mbi pasurinë e përbashkët familjare. Megjithatë, pavarësisht nga rregullimet ligjore që iu bënë statusit ligjor të

tyre, zbatimi praktik i të drejtave të njohura me ligj ndeshte në një rezistencë të madhe kulturore. Një problem i madh mbetej praktika patriarkale e shitblerjes së vajzave për qëllim martesë. Të drejtat pronësore të grave shpërfilleshin krejtësisht, pasi prona trashëgohej nga babai tek djali, ndërsa vajzat perjashtoheshin nga kjo e drejtë.

Ndërhyrja për fuqizimin ekonomik të vajzave dhe grave u përqendrua në punësimin e tyre jashtë ekonomisë familjare, në punë me pagesë në sektorët e prodhimit dhe shërbimit. Gjithashtu, për të çliruar gratë nga barra e rëndë e punëve fizike dhe koha kushtuar mbarëvajtjes së ekonomisë shtëpiake dhe përkujdesjes për fëmijët u ndërtua një rrjet i mirëqenies dhe mbrojtjes sociale si: menca, lavanderi, çerdhe, kopshte për fëmijë, etj.

Emancipimi nuk ishte një lëvizje shoqërore vetëm e vajzave dhe grave. Emancipimi kërkonte edhe përfshirje të burrave në projektin e ndryshimit të mendësive patriarkale. Për emancipimin u pa e nevojshme të arsimohej i gjithë populli. Përmes arsimimit synohej zhdukja e analfabetizmit dhe përgatitja e grave dhe vajzave për veprimtari të ndryshme prodhuese, shoqërore dhe kulturore. Ngritja arsimore, profesionale dhe kulturore u shpallën si synimet kryesore të emancipimit. Fjalimi «Revolucionarizimi i mëtejshëm i partisë dhe pushtetit», mbajtur prej Enver Hoxhës, më 6 shkurt 1967, i dha shtysë iniciativave për emancipimin e vajzave dhe grave. Këto iniciativa u intensifikuan shumë përgjatë vitit 1967 që, nga shtypi i kohës, u quajt një “etapë e re për gruan, sepse në këtë periudhë u shënuar një hop cilësor dhe në disa drejtime u bënë përmbyesje kulturore për gjendjen e gruas” (Sadikaj, D., 1982:10). Të tilla konsideroheshin arsimimi i vajzave dhe grave dhe pjesëmarrja e tyre në fuqinë punëtore dhe vendimmarrjen publike.

Megjithëse e shpalli emancipimin e gruas pjesë organike të revolucionit kulturor e ideologjik, regjimi socialist nuk mundi ta finalizonte këtë projekt, për shkak të pengesave kulturore e paragjyqimeve patriarkale dhe ndërgjegjësimit të pamjaftueshëm të popullsisë për barazinë mes gjinive. Lëvizja për emancipimin e gruas vuri në shënjestër normat kulturore dhe praktikat patriarkale që padrejtesisht e ulnin pozitën shoqërore të gruas duke e nënrenditur atë ndaj burrave, si në sferën private, edhe në atë publike. Megjithë përfshirjen e shumanshme në Luftën Nacional-Çlirimtare dhe pjesëmarrjen masive, gati 25-vjecare, të vajzave dhe grave në ‘ndërtimin e socializmit’, normat patriarkale tradicionale çrrënjoseshin me vështirësi. Fjalimi i 6 shkurtit 1967 u konsiderua si një thirrje popullore për të luftuar me forcë “zakonet prapanike” dhe për të mbrojtur dinjitetin e grave nga konceptet patriarkale dhe paragjyqimet. Kjo ishte

lëvizja më frontale e ndërmarrë prej regjimit socialist për emancipimin e gruas (Sadikaj, D., 1982: 12). Ne të u angazhuan gratë dhe të rinjtë, organizatat e masave si: Bashkimi i Grave të Shqipërisë, Bashkimi i Rinisë, Bashkimet Profesionale dhe Fronti Demokratik, të cilët u drejtoheshin më së shumti burrave, sidomos atyre të moshuar për të mbështetur luftën kundër konservatorizmit që karakterizonte brezin e vjetër dhe i angazhoi ata në kuvende pleqësish popullore për të demaskuar publikisht “zakonet e vjetra”. Lëvizja u karakterizua nga faktorë të shumtë si ato: nënkulturore, krahinore, urbane, rurale, edukative e profesionale. U bënë shumë përpjekje për të minimizuar efektet negative që kishte kultura tradicionale tek angazhimi i vajzave dhe grave në veprimtari jashtështëpiake, siç ishin arsimimi, punësimi dhe pjesëmarrja politike. Një vëmendje e veçantë iu kushtua demokratizimit të marrëdhënieve martesore, lehtësimit të gruas nga përgjegjësitë epërkujdesjes dhe punëve të shtëpisë, mbështetjes së të rinjve për të krijuar familje në bazë njohjeje personale dhe prishjes së fejesave në djep.

5.2.2. Paragjykimet mbi punësimin e grave: gruaja e ka vendin në shtëpi?!

Megjithë nxitjen që pati emancipimi i grave dhe vajzave nga regjimi socialist, zhvillimi shoqëror i tyre pengohej nga mendësitë patriarkale. Normat tradicionale e shkurajonin punësimin e gruas dhe e mbanin atë të lidhur pas punëve të shtëpisë dhe përgjegjësisë së përkujdesjes në familje. Modeli kulturor i «burrit-sigurues-ushqimi» dhe «gruas-sherbyese-shtëpiake» e konsideronte punësimin e gruas si të panevojshëm, pasi të ardhurat sigurohen prej punësimin të burrit, ndërsa vendi i paracaktuar i gruas ishte shtëpia. Gjithësesi, kufizimi drastik i pronës private dhe i ekonomisë shtëpiake e bëri të domosdoshëm punësimin e vajzave dhe grave. Gjithashtu, zhvillimi bujqësor dhe industrial kërkoi krahe pune, prandaj vajzat dhe gratë u punësuan me pagesë jashtë ekonomisë familjare. Edhe pse pati një nxitje të punësimin për arsye ekonomike, punësimi i tyre jashtë shtëpisë binte ndesh me normat kulturore patriarkale.

Ndonëse kundërthënës për normat kulturore, faktori ekonomik e nxiti pjesëmarrjen e gruas në punë me pagesë. Pjesa më e madhe e fuqisë punëtore në industrinë e rëndë dhe mekanike përbëhej nga meshkujt, të cilët erdhën kryesisht prej zonave rurale për të punuar në zonat industriale të cilat filluan të urbanizohen. Largimi i meshkujve në moshë aktive për punë, nga zonat rurale në ato urbane, ndikoi që mjaft punë në sektorin e bujqësisë të kryheshin prej

vajzave dhe grave. Kjo dukuri pasqyrohet gjerësisht në median e shkruar të vitit 1967. Gratë e Gollobordës shpreheshin: «Ne ishim vetëm në fshat se burrat tanë u shpërndanë në të katër anët e Shqipërisë duke ndërtuar veprat e mëdha të pesëvjeçarit. Ne gratë menduam t'ja dalim vetë punës në fshat... Ne tani përbëjmë 80 për qind të krahëve të punës.» (Gazeta «Bashkimi», 4.10.1967:2).

Megjithatë, aktivizimi i grave në punë jashtë ekonomisë shtëpiake u shoqërua nga një thashethemnjë masive prej burrave dhe vetë grave, sidomos atyre të moshuara që e konsideronin si të turpshëm punësimin e vajzave dhe grave, pasi i nxirrte ato nga shtëpia, gjë që ishte e palejueshme nga normat kulturore që kufizonin lirinë e gruas dhe gjithashtu sfidonte prestigjin mashkullor të burrit-sigurues-ushqimi. Gratë e punësuara përfliteshin prej opinionit se ishin të pandershme, gjë që çonte më pas në tërheqjen e grave nga sektori i prodhimit (Gazeta «Bashkimi», 4.10.1967:2). Veçanërisht e rënduar nga thashethemet ishte pozita e gruas malësore, e cila vuante një diskriminim të shumëfishtë në plan individual dhe kolektiv. Shpesh, mediat e kohës percillnin në faqet e shtypit të përditshëm, vështiresitë me të cilat luftonin gratë malësore për t'u aktivizuar në punë jashtë shtëpie. Gratë mirditore, të mbledhura në një takim të Bashkimit të Grave të Shqipërisë (BGSH) për të nxitur dhe mbështetur punësimin e grave malësore, shpreheshin: «Ne, gratë malësore, dritën e diellit dhe ngrohtësinë e tij e pamë dhe e ndjemë vetëm pas çlirimit... Nanat tona na kujtojnë shpesh të kaluemen duke na thanë se n'ato kohë të zymta vdekja ishte ma e ambël se jeta. Të mësojmë, punojmë e drejtojmë ekonominë na duket si një andërr, sepse as ne, as prindët tanë e as burrat nuk e kuptonin këtë...sepse zakonet prapanike që kishin randue mbi kurriz tonë për shekuj me rradhë i kishin rranjët e thella» (Gazeta «Bashkimi», 4.10.1967:2).

Një tjetër rrëfim në këtë gazetë vjen prej një gruaje të re, Lezes, që edhe pse kishte mbështetjen e familjes dhe bashkëshortit për të punuar dhe për t'u aktivizuar në veprimtaritë shoqërore në punë dhe lagje përballë me thashethemet që e shoqëronin kudo: « Une e kam provue vete. Tuj pas burrin dhe prindët me ndjenja përparimtare, mora kurajo të aktivizohem me organizatën e grues... por u ndodha para shumë vështirësive. Disa burra të mykun nga zakonet prapanike filluen të llomotitin se Lezja breddh nalt e poshtë « si grue pa burrë» e « iu grin sallatë grave » e « nuk pyet se ka shtëpi e fëmij ». Kur ndigjoja kësi përshpëritjesh, shkoja me frikë ke shtëpia se mos i kishin thanë ndonjë fjalë tim shoqi » (Gazeta «Bashkimi», 4.10.1967:2)

Mendësite patriarkale patën ndikim edhe në ndarjen e llojeve të punëve: në punë burrash dhe punë grash. Disa sektorë prodhimi, sidomos në industri, nuk shiheshin të përshtatshme për gratë. Në sektorin e prodhimit industrial, drejtuesit e ndërmarrjeve refuzonin të punësonin gra me pretendimin se fiziologjia femërore nuk përballon kërkesat e punës fizike në industri, gjë që nuk ishte e vërtetë pasi puna industriale ishte e mekanizuar dhe teknologjia e kishte minimizuar punën manuale që kërkonte forcë fizike. Në sektorin bujqësor, gratë në prag martesë ose të sapomartuara rrinin me muaj të tërë pa punë për të ruajtur «nurin e nusërisë» që ishte një zakon i trashëguar patriarkal. Në të vërtetë, gratë mbaheshin të mbyllura jo për të qenë të nurshme, por për të kryer punët e rënda të ekonomisë shtëpiake në fshat dhe për t'i shërbyer të rriturve dhe të vegjëlvë në familjet patriarkale shumëkurorëshe. Ndërsa gratë që dilnin në punë, relizonin më pak ditë pune në vit dhe, për pasojë, paguheshin më pak se burrat.

5.2.3. Të parajkykuara si të paafta për drejtim

Mendësitë patriarkale mbaheshin edhe në vetëdijen e vajzave dhe të grave, të cilat ishin edukuar të ishin inferiore ndaj burrave si në sferën private edhe në atë publike. Këto mendësi pengonin edhe marrjen e përgjegjësisë drejtuese nga gratë sepse këto konsideroheshin të përshtatshme vetëm për burrat. U desh një punë e madhe nga ana e organizatave shoqërore për të çrrënjësuar nga mendjet e grave dhe të burrave parajkykimet që përçmonin aftësitë drejtuese të grave. Fronti Demokratik ndërmori mbledhje të hapura dhe takime nëpër shtëpi për të luftuar shpërfilljen e vajzave dhe grave. Bashkimi i Grave të Shqipërisë, përveç takimeve nëpër rrethe, organizoi shkëmbime përvojash mes vajzave dhe grave nga zonat urbane dhe rurale, nga veriu në jug. Shumë vajza dhe gra, nga Tirana dhe nga qytetet e mëdha, shkuan në zonat fshatare të veriut për t'u mësuar vajzave dhe grave gatimin e zarzavateve, ushqyerjen me lugë e pirunj, higjienën shëndetësore të banesës dhe trupit, veshjen e përshtatshme sipas stinëve, etj. Shumë gra nga krahinat fshatare të veriut shkuan në Shqipërinë e Mesme dhe të Jugut për të mësuar shërbime dhe profesione të tilla si: rrobaqepësi, kulinari, pedagogji parashkollore, etj.

Organizata e Rinisë mobilizoi në aksione vullnetare për ndërtimin e veprave të mëdha publike si: rrugë, hekurudha dhe hidrocentrale, shumë vajza e gra nga e gjithë Republika e Shqipërisë, ndërsa Bashkimet Profesionale punuan për të zvogëluar disnivele të teknik profesional të vajzave dhe grave, duke nxitur pjesëmarrjen e tyre në kurse kualifikimi teknik. Vajzat dhe

gratë u punësuan në sektorë të industrisë së rëndë dhe të ndërtimit, nëpër profesione që deri atëherë ishin ushtruar vetëm prej burrave. Në vitin 1967, gratë u punësuan si: vinçiere, pompiste, prodhuese pjesësh këmbimi, aparatësh elektrike, makinerish, si traktoriste, muratore, tornitore, etj.

Edhe në sektorin e prodhimit bujqësor ku gratë përbënin shumicën dërrmuese të fuqisë punëtore, drejtimi i kooperativave bujqësore u besohej burrave. Kur gratë guxonin të propozonin gra në drejtim ato përqesheshin dhe situatat perfundonin në tallje kolektive, ku ridikulizoheshin aftësitë drejtuese të grave. Media e shkruar në vitin 1967, vit në të cilin pati një aksion kombëtar për aktivizimin e vajzave dhe grave në sektorin e prodhimit bujqësor e industrial dhe në drejtimin e ekonomisë socialiste, raporton për pengesa të shumta që hasnin gratë për të marrë përgjegjësi drejtuese. Lezja, një e re e punësuar në kooperativë, tregon për gazetën: «Në një mbledhje të kryesisë së kooperatives propozuen të vinin brigadierë vetëm burra. Atëherë nuk m'u durue dhe pyeta: Pse mendoni të caktoni brigadierë vetëm burra, a nuk ka edhe gra të afta me drejtue? E atëherë për të më tutun më thanë: Po të bajme ty brigadiere, pra!» (Gazeta «Bashkimi», 4.10.1967:2). Në një rast tjetër, një grua e re, e zgjedhur brigadiere, tregon se si puna e saj përflitej prej burrave të kooperativës, të cilët ankoheshin me zë të lartë: «Mjerë në duar të kujt kemi ranë!» e për çdo gjë të vogël e “bënin mizën buall” për të diskredituar aftësitë e saj si brigadiere (Po aty). Angazhimi i grave në punë prodhuese, sidomos në fshat, u kundërshtua ashpër nga opinioni patriarkal. Gratë në sektorin bujqësor, u përballen me një luftë të ashpër paragjykimesh. Te tilla ishin sidomos gratë traktoriste, morali i të cilave përflitej pa pushim prej thashethemeve të fanatikëve, sepse kishin përvetësuar një profesion mashkullor. Jo më pak përfliteshin edhe gratë që punonin në sektorin e mekanikës bujqësore si axhustatore dhe tornitore. Atyre u duhej të duronin edhe thashethemet e kolegëve meshkuj, edhe presionin që u bënin drejtuesit e ndërmarrjeve për t'i larguar nga këta sektorë. Punët më të lehta dhe që paguheshin më mirë mbaheshin prej burrave. Edhe punët me ditë e pagë fikse ziheshin më shumë prej burrave.

5.2.4. Të shitura në martesë me mblesëri

Edhe pse kishin kalur mbi njëzet vite nga instalimi i regjimit socialist, në vitin 1967, dukuria e shitblerjes së vajzave ishte akoma shqetësuese. Megjithë propagandën e madhe kundër

këtij zakoni, përgjatë dy dhjetëvjeçarëve, ai nuk po zhdukej. Për këtë arsye, në vitin 1967, Plenumi i dytë i Komitetit Qendror të PPSH i dha një rëndësi të veçantë zhdukjes së zakonit të shitblerjes së vajzave për martesë, si një dukuri mesjetare që nuk kishte justifikim për kohën sepse e kishte lënë gruan në pozitat e skllaves. Sipas zakonit, vajzat fejoreshin që në djep ose në moshën e pubertetit, rreth 10-12 vjeç, nga baballarët e tyre. Fejesat rregulloheshin nga institucioni i shkuesisë që ndërmjetësonte martesën midis dy të rinjve. Madje në disa raste, ndonëse të pakëta, vajzat martoheshin me burra të shtyrë në moshë, të cilët kishin edhe moshën e baballarëve apo të gjyshërve të tyre. Për më tepër, zakoni legjitimonte edhe poligjininë, e cila në kulturën shqiptare u përshfaq me shumë në formën e bigamisë ose bigjinisë, martesë e një burri me dy gra njëkohësisht. Rregullimi i institucionit të martesës në të drejtën zakonore njihte të drejtën e burrit të martuar për të marrë grua “mbi kunorë” për të lindur femijë, sidomos fëmijë meshkuj (Gjeçov, Sh., 1993).

Gazetat e kohës raportojnë raste të shumta të fejesave në djep të cilat dëshmojnë për pozitën e skllavëruar të vajzave dhe mungesën e lirisë për të vendosur për jetën e tyre. Në Gazetën “Bashkimi” raportohet një rast fejese me diferencë të madhe moshe dhe me kusht që nusja të lindëte djem: “Në fshatin Bilaj, ishte fejuar një vajzë 18-vjeç me një plak 70-vjeç. Vajzën e kishte fejuar i ati, i cili në fakt e kishte shitur. Plaku, nga Mali i Thatë, po donte të martohej prapë, sepse gruaja i kishte bërë vetëm vajza. Prandaj ky kërkonte një grua me kusht, që t’i lindte vetëm djem” (Gazeta “Bashkimi”, 18.1.1967:2).

Një formë tjetër e përhapur fejese, pa marrë pëlqimin e vajzave, ishte edhe fejesa me shkëmbim, kur djali fejohej me vajzën me kusht që motra/vëllai i saj të fejohej me të vëllain/motrën e djalit. Këto fejesa në disa raste, kur njëri prej çifteve konfliktohej e përfundonte keq, krijonin fatkeqësi edhe për çiftin tjetër në formë hakmarrjeje familjare. Një veprimtare tregon për gazetën: “Ende ka raste kur vajzat i bëjnë “tram”, sikur ato të ishin mall për shkëmbim, duke e fejuar vajzën për djalin e një shtëpie me kusht që të marrin prej saj një vajzë. Por në këto “shkëmbime” nuk merret fare parasysh dëshira e të rinjve që do lidhin jetën” (Gazeta “Bashkimi”, 10.2.1968:3). Një rast tjetër dëshmon dramën bashkëshortore që pësoi një çift për shkak të ndarjes së vëllait të tij të martuar me motrën e saj dhe shtrëngimit të vajzës nga familja e vet për ta lënë bashkëshortin në shenjë hakmarrjeje për motrën: “Në gjykatën popullore të rrethit të Fierit u paraqitën për zgjidhje martesë A.H. dhe S.H. Gjatë gjykimit u provua se dy vëllezër ishin martuar me dy motra dhe meqë vëllai i vogël kishte ndarë gruan, prindërit e vajzës, duke e

ndjerë veten të fyer, menduan të hakmerreshin me familjen e djemve. Pas shumë mundimesh ata ia mbushën mendjen A.H. që edhe ajo ta linte të shoqin” (Gazeta “Bashkimi”, 20.3.1970:2). Por, kishte raste të rralla që fejesat në djep bëheshin mes një vajze më të madhe me një djalë më të vogël në moshë. Një rast i tillë vjen nga rrëfimi i një vajze të vogël, e cila, kur ishte në klasë të katërt në shkollë, mësoi se ishte fejuar me një djalë në klasë të parë dhe për këtë arsye u bë gazi i shkollës. Kur u rrit nuk pranoi të martohej me djalin që e kishin fejuar pa e pyetur. Ajo rrëfen për gazetën: “A duhej te lejoja unë dhe shoqet e mija që të rrinim të fejuara me ata që na kishin dhanë prindërit kur ishim të mitur? Ne nuk duhet të ndrydhemi prej zakonit te keq të fejesave në moshë të mitur. Mua më kanë fejuar kur isha 6 vjeç me një tre-vjeçar, dhe unë nuk pranova kur u rrita ta marr atë, pavarësisht kërcënimeve nga familja ime dhe e tij” (Gazeta “Bashkimi”, 3.1.1967:2).

Në vitet 1960-1970, pati një mobilizim vullnetar në shkallë kombëtare për ndërtimin e veprave publike si hekurudha, rrugë, uzina, fabrika, hidrocentrale dhe mjedise kolektive banimi. Në ndërtimin e tyre u aktivizuan shumë të rinj nga i gjithë vendi. Përveç marrëdhënieve të punës, këta të rinj krijuan edhe lidhje miqësore dhe dashurore që përfundonin në martesë. Por, lidhjet dashurore të të rinjve që u njohën në kolektiva pune pengoheshin shumë prej mendësive patriarkale që nuk lejonin as dashurinë e as martesën romantike. Te rinjtë, sipas normave tradicionale, nuk duhej të kishin kontroll mbi jetën e tyre dhe as të dreja mbi trupin dhe seksualitetin. Sjellja seksuale rregullohej në mënyre strikte nga heteronormativiteti patriarkal që të vetmin lejim seksual konsideronte bashkimin “mes një burri dhe gruaje” për riprodhim, dhe që ndalonte me forcë çdo lloj forme tjetër të seksualitetit, që nga marrëdhënia paramartesore e jashtëmartesore, e deri tek marrëdhënia seksuale për kenaqësi.

Vajzat që guxuan të kundërshtonin fejesat në vegjëli u ekspozuan ndaj sulmeve të thashethemeve dhe ndaj dhunës së familjarëve të tyre dhe krushqive potenciale. Familjet, për të ruajtur nderin e fisit, ndërmerrenin akte ekstreme dhune ndaj vajzave si: rrahja, izolimi, lidhja, poshtërimi, etj., për t’i bindur të hiqnin dorë nga lidhjet dashurore dhe kur nuk ia arrinin i martonin forcërisht, duke organizuar dorëzimin e vajzës tek ndonjë përfaqësues i krushqisë përgjatë natës që të mos shihej nga ndokush. Gazetat e vitit 1967, janë të mbushura me dëshmi të tilla, ku në mjaft raste vajzat rrëfejnë historinë e vuajteve të tyre për të shpëtuar nga kontratat e shitblerjes të bëra prej baballarëve të tyre. Gazeta “Bashkimi” (5.10.1967:2), sjell rastin e një vajze të re, Avdijes nga Gështenja e Kukësit, e cila ishte njohur në punë me një djalë nga fshati,

Saliun dhe ishte dashuruar me të. Kur i tregoi prindërve për simpatinë që kishte për Saliun, i ati u alarmua dhe filloi të kerkonte shkesë për të gjetur burrë për vajzën. E tronditur nga ky veprim i të atit, Avdija shprehet: “Unë vendosa të mos i nënshtrohem zakonit të poshtër... e të mos humb rininë time, jetën time. Kisha degjuar për shoqet e mija që i kishin fejuar me zor, pa i pyetur, në fshatra të largët... nuk doja të isha si ato. Pyesja veten: Po fati im si do jete? Dëgjoja fshehurazi babën që kishte takue njerëz me më martue e që bante llogari, sa pare, sa tesha... e një mbramje baba me thotë: Avdije, tash u rrite, po t’afro ditë me shkue ke burri! Ika rrembimthi prej dhome dhe njoma jastikun tanë natën me lot. Të nesërmen u them prindërve: Bani ç’ të doni me mue, por unë do martohem me Saliun! Me pas, në shtëpi u mlodhën të afërmit që e urdhnuen babën të më ndalonte ndjenjat dhe të mos lejonte të shkelja zakonin se do korisja fisin : Ku asht pa që cuca të veprojë me krye të vet – i thoshin babës - ku asht nderi për ty? ». Edhe pas presionesh të shumta, Avdija nuk u bind dhe i ati e la të shkonte, por nuk i bëri asnjë ceremoni gëzimi që të mos inatosej fisi dhe i nderpreu marrëdhëniet me të bijën: nuk e takonte e as e priste si bijën e shtëpisë. Të nesërmen shpertheu thashathemnaja se “e bija e Hamdiut ka koritë fisin e ka thy zakonin”. Çiftit të ri nuk i flisnin në fshat sepse kishin thyer zakonin dyfish: së pari, sepse dy të rinj ishin dashuruar dhe kishin guxuar të martoheshin me dashuri pa aprovimin e fiseve përkatëse, dhe së dyti sepse këta të rinj permbyshën normën e martesës ekzogame, duke qenë të dy prej të njëjtit fshat. Norma tradicionale e ekzogamisë e pengonte martesën brenda fshatit sepse bashkefshatarët përgjithësisht konsideroheshin se kishin lidhje të afërta fisnore ose gjaku nga linja e babait (Dervishi, Z., 2009:173).

Edhe pse u shpallën si të padëshirueshëm për fshatin, shumë gra të reja e pershëndesnin fshehurazi Avdijen dhe e përgëzonin që e zgjodhi vetë shokun e jetës dhe që theu zakonin e ulët të shitjes së vajzave. Ky rast shërbeu si shembull për të rinjtë e tjerë në fshat, të cilët, përmes Frontit Demokratik, organizuan një mbledhje të hapur për të denoncuar shitblerjen e vajzave dhe për t’i dhënë fund fejesave në djep. Pas mbështetjes që organizata e gruas, e rinisë dhe e frontit demokratik i dhanë të rejave për të folur dhe për t’u aktivizuar në punë prodhuese, shumë vajza ndoqën shembullin e Avdijes nga Gështenja: prishën fejesat në djep e shkuan vullnetare në aksionin për ndërtimin e hekurudhës Rrogozhinë-Fier ose hynë në punë në kooperativë.

Ndryshimet që impononte zhvillimi ekonomik dhe shoqëror ngadalesoheshin nga pengesat konservatore që rëndonin pozitën shoqërore të grave dhe vajzave. Një tjetër rrëfim vjen nga një vajzë e re, Fatimja, që merrej me veprimtari kulturore në Elbasan. Ajo luante pjesë në të

cilat demaskonte shtypjen që i bëhej gruas që e kishte dëshmuar vetë: “Që e vogël, Fatimja kishte parë në dasma se si nusja, nën forcën e zakonit, detyrohej të pinte ujin me të cilin ishte rruar dhëndërrin. Kishte dëgjuar se nuses nuk i jepej të hante natën e parë, sepse një gjë e tillë sillte fatkeqësi në jetë. Kishte parë se si gratë nuk dilnin kurrë në dhomën e miqve për t’i përshëndetur. Kishte parë se si nusja, e gratë në përgjithësi, e kishin për turp të hanin bashkë me burrat” (Gazeta “Bashkimi”, 6.2.1968:3).

Gratë punonin shumë brenda ekonomisë shtëpiake, por puna e tyre nuk vlerësohej dhe ato shiheshin si qenie inferiore ndaj burrave. Dila, një grua e thyer në moshë, tregon: “Gjithë jetën, që kur kemi qenë fëmijë e deri sot që jem moshue, jemi roptue nga mëngjesi në mbramje nëpër punë të randa, e megjithatë, për hatër të Kanunit, burrat silleshin me ne jo si të ishim njerëz, por kafshë, e na trajtonin si bagëti e shtëpisë” (Gazeta “Bashkimi”, 28.3.1967:4).

Që të vogla, në gjirin e familjes, vajzat shoqërizoheshin me rolet sociale që do të ndërmerrnin si të rritura. Ato i nënshtroheshin detyrimit për të bërë punë të rënda për shtëpinë, kujdeseshin për më të vegjëlit dhe të moshuarit dhe qëndronin në këmbë, sikurse nënat e tyre para burrave të shtëpisë. Në një mbledhje rinie, të organizuar në një shkollë fillore të Kurveleshit, vajzat e kësaj shkolle pohuan “Ne ngarkohemi me dru në shpinë sa na këputet mesi e supet. Kështu bëjnë edhe nënat tona” (Gazeta “Bashkimi”, 29.3.1967:3).

Gjithashtu, një tjetër zakon poshtërues për gratë ishte që të mos u drejtoheshin në emër bashkëshortëve por me tituj si: aga, zotëri, imzot dhe të mos i shihnin burrat në sy. Kurse burrat për t’u treguar grave se ishin inferiore nuk u drejtoheshin në emër, por me shprehje të tilla si: oj, ti, moj, që janë denigruese për personalitetin e një gruaje. Vajzat nga Kurveleshi treguan se atyre u mësohej të mos i thërrisnin djemtë në emër se ishte turp, kështu vepronin edhe nënat e tyre me baballarët dhe meshkujt e tjerë. “Nënat tona nuk i flasin kurrë në emër burrave të tyre. Ato u drejtohen atyre me “aga” e “xhaxha”...as baballarët nuk i thërrasin në emër por: “Oj ti” (Po aty). Një tjetër dëshmi vjen nga aktivistet e Bashkimit të Grave të Shqipërisë (BGS) së malësisë së Tiranës të mbledhura në një aktiv, ku pohuan: “Vullneti ynë ndrydhej. Sa dëgjonim zërin e burrit dridheshim nga frika e brofnim në këmbë... e thoshim “s’ke ç’i bën, kështu ka qenë e do jetë mot e jetë”. Një shoqja jonë, A.R ka gjithë jetën që duron hurin e të shoq e nuk bën zë... ky edhe plak, pas dyzet vjet martese, i bërtet me shkop në dorë: Çohu shpejt, luj vendit oj ti, se të kam ble me pare” (Gazeta “Bashkimi”, 25.3.1967:2). Ndërsa gratë e Shupalit, duke diskutuar në mbledhjen e frontit për zakonet e ngarkesës së druve thanë se: “Ne, gratë, e kemi vuajtur shumë

zakonin e ngarkesës, na dhimbte kurrizi nga barra e rëndë dhe na vinte turp nga fshati po të ngarkonim më pak mbasi do përgojoheshim se nusja e filanit qenka dembele”(po aty). Kaq të trysnuara ndiheshin gratë nga thashethemet në lidhje me angazhimin e tyre me punë shtëpisë saqë, edhe kur nuk kishin punë me rëndësi për të bërë, rrinin gjithë kohën në këmbë për t’u marrë patjetër me diçka, përndryshe përgojoheshin si përtace. Duke qenë të ngarkuara gjithë ditën me punë, brenda e jashtë shtëpie, pa kohë për çlodhje e për argëtim, si edhe të përfolura për sjelljen, gratë bënin një jetë të mundimshme. Atyre u shkruhej mundimi në fytyrë nga rrudhat e parakohshme që në moshë të re. Ja si e përshkruajnë disa gra nga fshatrat e Tiranës ndikimin që kishte jeta me privime në pamjen e tyre edhe pse të reja: “Puna e randë ne grave na ka rrëzuar shumë... Burrat tanë, edhe pse ma të mëdhenj, duken shumë ma të rinj... ne kemi vuajtur aq shumë sa jemi ba si nanat e tyre” (Gazeta “Bashkimi”, 23.3.1997:2).

Falë mbledhjeve të hapura në publik, nëpër kuvende e takime që organizonin organizatat shoqërore, vajzat dhe gratë morën guximin të flisnin për nëpërkëmbjen e tyre. Këto veprimtari patën një ndikim pozitiv për ndërgjegjësimin e shoqërisë, për padrejtësitë që u bëheshin vajzave dhe grave, duke u shkelur të drejtat dhe liritë themelore, që nga e drejta e jetës e deri tek liria e zgjedhjes dhe e lëvizjes. Si pasojë e këtij ndërgjegjësimi, edhe me mbështetjen e organeve shoqërore, vetëm në Malësinë e Tiranës në vitin 1967 u prishën 317 fejesa, ndër të cilat 136 fejesa në moshë të vogël, 83 fejesa me kusht, 91 fejesa me ndërresë (këmbim) dhe 7 fejesa me diferencë të madhe moshe (Gazeta “Bashkimi”, 25.3.1967:2).

Gjithësesi, edhe pse pati një angazhim masiv kundër normave tradicionale që poshtëronin gruan, ato nuk u zhdukën, madje mbijetuan në gjirin e familjes. Gazetat sjellin shumë fakte për funksionimin e normave patriarkale brenda familjes. “Në zonën e Selishtës, Lurës dhe Zallë-Dardhës e quajnë për turp që gratë të shtrohen për të ngrënë bashkë me burrat. Burri e ka për turp të zërë punë me dorë në shtëpi. Edhe pse kthehet nga puna bashkë me gruan, ai ze qoshen e oxhakut, kurse gruaja i përvishet një pune edhe më të lodhshme në shtëpi pa ndihmën e askujt. Me zakone të tilla edukohen edhe fëmijët. Në mjaft familje bëhet dallimi i vajzës nga djali në trajtim. Ata vijnë të dy nga shkolla, por ndërsa djali ulet të mësojë, vajzën e venë të bëjë punët e shtëpisë, madje diferencohen edhe në ushqim dhe veshje” (Gazeta “Bashkimi”, 24.1.1967:3).

Paraqytime të shumta kishte edhe për shoqërinë mes djemve dhe vajzave, e cila konsiderohej si një mardhënie moralisht e “papastër”. Një artikull tregon se si ndëshkohet një vajzë për miqësinë me një djalë nga një shkollë tjetër e një qyteti tjetër. Djali i shpreh gëzimin

për njohjen vajzës përmes një letre që ia dërgon në shkollë. Letrën e hap mësuesja, e cila e qortoi vajzën në sy të klasës. Kjo histori u raportua në gazetë dhe maturantet e pyetura për shoqërinë mes vajzave dhe djemve thanë: “Këtu, në shkollë, është e vështirë të bisedosh me një djalë apo që djali të bisedojë me një vajzë, sepse menjëherë fillojnë thashethemet që të hajnë shpirtin, prandaj shumë vajza nuk flasin me bashkëmoshatarët e tyre. Natyrisht, thashemeve u ndruhen edhe djemtë. Ndruhemi nga syri i rreptë i njëri-tjtrit dhe i mësuesve” (Gazeta “Bashkimi”, 15.1.1967:2).

5.2.5. Nën peshën e përgjegjësive familjare

Gratë janë përballur me shumë paragjykime përcmuese në lidhje me jetën familjare dhe përgjegjësive që ato kishin për mbarëvajtjen e punëve të shtëpisë dhe përkujdesjes për fëmijët dhe të moshuarit. Roli social i gruas shihej ngushtësisht i lidhur me familjen dhe përgjegjësitë e vetme të saj ishin shërbimet ndaj të tjerëve. Për ruajtjen e qëndrueshmërisë familjare, barra e sakrificës rëndonte mbi gruan, e cila nuk duhej ta mendonte veten jashtë marrëdhënies martesore si për arsye nderi, ashtu edhe për shkaqe ekonomike. Duke qenë shoqëri “nderi”, normat patriarkale bënë me faj gratë më shumë se sa burrat për prishjen e familjes. Grave iu analizohej jeta martesore dhe marrëdhëniet me të tjerët në detaje për t’i gjykuar nëse u përmbaheshin udhëzimeve normative për sjelljen, ndërsa për burrat kontrolli social pothuaj nuk ekzistonte.

Gratë në kulturën patriarkale konsiderohen si pronë e burrave dhe ndaj tyre ushtrohet shumë trysni nga ana e shoqërisë për të mos kundërshtuar pozitën shoqërore të nënrenditur. Madje, kur guxonin të shfaqnin mospëlqimin e tyre për trajtimin si “plaçkë”, gratë dhunoheshin dyfish: brenda familjes prej bashkëshortit dhe jashtë familjes prej shoqërisë. Këto pengesa ishin pothuaj të pakapërcyeshme për gratë, të cilat mbaheshin të izoluar nga shtypja shoqërore, prandaj edhe mundësitë për organizim shoqëror ishin fare të pakta.

Në vitin 1967, pas Plenumit të 2-të të Komitetit Qendror të PPSH-së, u ndërmor një aksion mbarëkombëtar për të “çliruar gratë nga vargojtë e roberisë” me qëllim që ato të bënin një jetë më dinjitoze përkrah burrave. Megjithë aktivizimin shoqëror masiv, në nivel organizativ dhe personal, normat patriarkale bënë shumë rezistencë ndaj ndryshimit. Në shtypin e përditshëm të vitit 1967, krahas veprimtarive të ndërmarra nga organizatat shoqërore në favor të emancipimit të gruas, sillen edhe shumë shembuj të rezistencës kulturore ndaj emancipimit të gruas. Rastet

janë të shumta dhe variojnë nga dhuna që ushtrohet ndaj grave brenda familjes në formë fizike dhe psikologjike për të mos kundërshtuar pozitën e diskriminuar në të cilën ndodheshin, e deri tek diskriminimi shoqëror ndaj grave aktiviste që guxonin të sfidonin normat kulturore që punonin në disavantazh të grave. Gazeta “Bashkimi”, 3.10.1967, denoncon një rast dhune bashkëshortore, ku bashkëshorti, Mëhilli, dhe familjarët e tij frikësojnë gruan e Mëhillit, Martën, që ajo të mos kundërshtonte martesën e tij me një grua tjetër. Në artikull shkruhet: «Ky tiran patriarkal ia bëri asaj jetën të padurueshme dhe që të mos i dëgjohej zëri e ndaloi atë për vite të shkonte tek dera e prindërve. Për ta poshtëruar sajoi një histori bashkë me të motrën e tij sikur e shoqja paskësh vjedhur xhaketen e një miku të tyre dhe me këtë veprim sipas kanunit kishte korit burrin » (fq.2). Në gjyq, pasi u përball edhe me praninë e bashkëfshatarëve, të cilët i njihnin mirë atë dhe të shoqen, bashkëshorti e tërhoqi akuzën për vjedhje dhe pretendimin për t’u martuar njëkohësisht edhe me një grua tjetër, kështu që gruas iu desh të bashkëjetonte përsëri me të. Por, i shoqi nuk hoqi dorë, as vete as familjarisht nga keqtrajtimi poshtërues që i bënte gruas, e cila, edhe kur rrëfente mundimet që po hiqte në atë shtëpi, këshillohej të duronte në emër të nderit, të fëmijëve dhe të vështirësive ekonomike që mund të ndeshte një “grua e ndarë nga burri”. Durimi i saj, jo vetëm që nuk u shpërblye prej bashkëshortit, por u ndëshkua sistematikisht. Për vite, familja e vajzës nuk reagoi për dhunën që pësonte ajo në shtëpinë e të shoqit, pasi ruhej nga thashethemet, nga turpi se “do t’ju mbetej vajza në derë” dhe nga pasiguria se me se do te jetonte nëse nuk ushqehej prej të shoqit. Por, pas ribërjes së gjyqit për ndarje, i ati i vajzës u detyrua ta merrte atë dhe ta strehonte përkohësisht në shtëpinë e vet duke thënë: «Ma mirë e mbys vajzën në duart e mija, se ta mbysin njerëzit e burrit !». Marta qëndroi në shtëpinë e të atit për aq kohë sa u krye divorci dhe, më pas, bashkë me fëmijët u sistemua në qytezën industriale të Rubikut, ku asaj iu ofrua prej shtetit pune si laborante, një apartament dhe arsim për fëmijët (Gazeta “Bashkimi”, 3.10.1967: 2). Kur u pyet se si ndihej pas divorcit, Marta u përgjigj se “shpëtoi nga thundra e atij satrapi që e kishte shndërruar në zhele dhe se me qëndrimin e saj prej robine kishte keqedukuar edhe djemtë të mos bënin zë dhe të nënshtroheshin ndaj autoritetit të të atit dhe të njerëzve të tjerë të familjes”. Përmes gazetës, ajo i bëri thirrje grave të luftojnë vetë për të drejtat e tyre dhe të mos rrinë të nënshtroara siç ndenji ajo se nuk fitojnë gjë, përveç poshtërimit dhe vuajtjeve fizike dhe shpirtërore.

5.2.6. Paragjykime me sfond moralizues

Për të mundësuar emancipimin e grave nuk mjaftonin vetëm takimet dhe fushatat ndërgjegjësuese, e as shkëmbimet e përvojave dhe nxitja e punësimit. Gratë lipsej tëlehtësoheshin nga ngarkesa e madhe e punëve fizike që kryenin në shtëpi dhe nga detyrimi i përkujdesjes për të vegjëlit dhe të rriturit në familje. Për të lehtësuar kohën fizike grave në rolin përkujdeses, u ngritën çerdhe dhe kopshte, menca e lavanderi. Por, edhe përdorimi i këtyre lehtësive për gratë, u vu në shënjestër të thashethemeve. Gratë nuk mund të hanin ushqim në menca ndermarrjesh, sepse konsideroheshin edhe si të pamoralshme, edhe si të pazonjat për t'u kujdesur për shtëpinë, kërkesë parësore kjo e normave tradicionale. Po ashtu, gratë nuk mund të përfitonin nga lavanderitë e përbashkëta sepse përfliteshin si të papastra nëse nuk i lanin teshat me dorë në shtëpi. Gjithashtu, sidomos në fshat, gratë ngurrnin t'i dërgonin fëmijët në kopshte si pasojë e thashethemeve se nuk dinin të rrisnin fëmijë dhe, për pasojë, nuk ishin nëna të mira. Pra, sadoqë për gratë u krijuan disa lehtësi, ato përsëri nuk mundeshin t'i përdornin, për shkak të paragjykimeve mbi rolin e shtëpiak të gruas. Për pasojë, gratë e punësuara, përballuan të vetme, nën thundrën e paragjykimeve, edhe punën jashtë shtëpie, edhe atë brenda shtëpisë. Ato nuk u ndihmuan prej bashkëshorteve në ndarjen e përgjegjësive familjare për shkak të presionit të madh që ushtronin normat kulturore, ruajtja e të cilave brenda gjirit të familjes ndikoi në edukimin e brezit të ri me të njejtat norma sikurse të prindërve të tyre. Puna që bëhej jashtë shtëpie nga organizatat shoqërore për përmirësimin e pozitës së gruas në sektorin publik dhe atë privat nuk u pasua nga po të njejtat përpjekje brenda shtëpisë, përkundrazi, ajo ç'ka bëhej jashtë shtëpisë për emancipimin e gruas, minohej brenda shtëpisë. Përpjekjet e vajzave dhe grave për të kapërcyer murin e trashë të partiarkisë drejt lirisë së tyre thyheshin brenda shtëpisë. Për këtë arsye përpjekjet jashtë shtëpisë për mbështetje të emancipimit të gruas nuk dhanë rezultatin e shumëkërkuar.


5.3. Paragjykimet në familjen e bashkëshortit

Në Farkë, popullsia ka përbërje heterogjene: me vendas nga pjesa kodrinore dhe malore e Tiranës dhe me të ardhur kryesisht nga rrethet e Kukësit dhe të Dibrës. Megjithëse në mendësitë e shumicës së banorëve veprojnë norma kulturore të krahinës së Tiranës, ekziston edhe një përzierje e ndërsjelljte nënkulturash mes vendasve dhe të ardhurve për shkak të bashkëjetësës disavjeçare në të njëjtin territor. Edhe pse mund të mos kenë ndikimin e dikurshëm, normat tradicionale, të mbartura ndër shekuj dhe të përmbledhura në kode sjellore, veprojnë ende dhe shërbejnë si rregullatore të sjelljes në familje dhe bashkësi. Kanunet me më shumë ndikim janë: Kanuni i Bendës për vendasit, Kanuni i Lumës për banorët me origjinë nga qarku i Kukësit dhe Kanuni i Skenderbeut për banorët e malësisë së Tiranës dhe Dibrës. Të tre kanunet kanë shumë ngjashmëri me Kanunin e Lekë Dukagjinit, aq sa duken si nënvariate të tij. Kanunet kanë pasur shumë ndikim në mendësitë dhe sjelljen e banorëve të zonave rurale dhe kanë shërbyer si *ligje* për banorët. Ndikimit të tyre nuk i shpëtonte dot asnjë familje pa u ndëshkuar moralisht nga bashkësia. Agjencia e kontrollit kolektiv ka shërbyer si mekanizëm për zbatimin dhe ruajtjen e normave kanunore deri në ditët e sotme. Sikurse thuhet në Kanunin e Skënderbeut “Kanuni asht ligj për të gjithë, përndryshe ndahesh prej shoqnisë” (Ilija, F., 1993:17). Ndëshkimet për moszbatim të normave kanunore nuk ishin vetëm morale, por edhe materiale, si: djegje shtëpie, grimja katundarisht e pjesëtarit të familjes që nuk zbatonte kanunin, lëçitja ose dëbimi i familjes nga vëllazëria e katundi, djegja e shtëpisë dhe rrënimi i pasurisë, gjobat, etj.

Megjithë ngjashmërinë mes tyre, kanunet dallojnë për nga ngjyresat nënkulturore që kanë ndikim tek banorët mbi të cilët zbatohet. Të ardhurit në Farkë, duke qenë nga Kukësi dhe Dibra, kanë rrjetin e tyre simbolik të vlerave nënkulturore, i cili ndryshon paksa nga ai i nënkulturës tiranase. Të ardhurit janë të lirë t’i përmbahen vlerave të nënkultureës së tyre, për aq kohë sa nuk janë në kundërshtim me normat vlerore të vendasve. Për ruajtjen e traditës nënkulturore nga komunitetet e ardhura në një zonë pritëse, si pasojë e migrimit të brendshëm Zyhdi Dervishi shprehet: “Në shoqërinë tradicionale shqiptare, komunitetet e vogla të banorëve të një fisi ose fshati kishin hapësirë të konsiderueshme të zhvillonin traditat e veta nënkulturore, me kusht që të mos çënonin normat kryesore kulturore dhe interesat e grupimve shoqërore më të mëdha si banorët e bajrakut” (2013:35). Gjithashtu, etnografja shqiptare Andromaqi Gjergji që ka studiuar me imtësi mënyrën e jetesës së banorëve të fshatrave, vëren se “në jetën e përditshme


marrëdhëniet e jetës familjare në fshat rregulloheshin nga norma e zakone të pashkruara kanunore” (2002:48).

Në studim 72.0 për qind janë gra të martuara, të cilat dëshmojnë se kanë qenë pre e paragjytimeve të shumta në të gjitha fazat e jetës bashkëshortore që nga fejesa e deri sa janë bërë nëna. Edhe pse janë paragjykuar më shumë në martesë, gratë pohojnë se me paragjykimet në familjen dhe fisin e bashkëshortit janë përballur më herët, që në fejesë, 21 për qind e grave janë paragjykuar si të fejuara dhe 23 për qind janë paragjykuar si nëna. Përqindja relativisht më e ulët e paragjytimeve në kohën e fejesës ka të bëjë me faktin se, gjatë kohës që janë të fejuara, vajzat nuk jetojnë në shtëpinë e bashkëshortit e, për pasojë, familjarët dhe të afërmit e tij nuk kanë mundësi të kenë kontakte, ndërveprim dhe komunikim të përditshëm me to.



Si të fejuara, ato më shumë vëzhgohen së largu, për mënyrën se si sillen në lagjen ku banojnë, në vendin e punës, në marrëdhëniet me fqinjët, etj., se sa të afërmi. Marrëdhëniet me familjarët e të fejuarit janë të pakta, ndodhin kryesisht gjatë vizitave të nuses së ardhshme në shtëpinë e djalit, dhe në këto vizita të dyja palët, si nusja edhe familjarët e dhëndrit mundohen t'i bëjnë përshtypje të mirë njëri-tjetrit. Në këto takime, vajza e fejuar është më shumë në statusin e mikeshës se sa të nuses së shtëpisë. Duke qenë se vizitat janë të rralla dhe zgjasin pak, asnjëra palë nuk ka mundësi të vendosë një raport të çlirët marrëdhëniesh familjare dhe të jetë vetvetja. Ceremoniali i vizitës nuk lejon shkrirjen e plotë të akullit që imponon përkohshmëria. Vetëm bashkëjetesa e përditëshme nën të njejtën çati do mund të hiqte velin me të cilin mbulohet sjellja e vertetë. Mosnjohja e thellë bën që familjarët e të fejuarit të jenë paragjykuar për cilësitë dhe

aftësitë e nuses së ardhshme, parë në dritën e pritshmërive kulturore që ata kanë për të si nuse zakoni.



5.3.1. Paragjykuar nga familjarët e të fejuarit

Fejesa i paraprin martesës. Qëllimi i fejesës është që t'i shërbejë njohjes dhe përgatitjes së dy të rinjve për aktin e martesës që do lidhë ata idealisht për të gjithë jetën. Gjatë fejesës, jo vetëm dy të rinjtë, por edhe familjet e tyre të lidhura me krushqi njihen më mirë. Gjithashtu, me hyrje-daljet e të rinjve në shtëpitë e njëri-tjetrit, familjarët e tyre kanë mundësi të njohin nusen dhe dhëndrrin e ardhshëm. Megjithëse ligjërisht fejesa nuk është zyrtare, për familjet që kanë lidhur krushqi *de facto* është. Fejesa nuk shërben vetëm për përgatitjen emocionale dhe njohjen e dy të rinjve me njëri tjetrin dhe të familjeve me të cilat do lidhin miqësi, por edhe për përgatitjen psikologjike të të rinjve për krijimin e familjes së re pas martese.

Meqë fejesa është pothuajse një zyrtarizim i një lidhje të mëpasme në martesë e dy të rinjve dhe me miqësi e dy familjeve, është me shumë rëndësi njohja e ndërsjelltë e familjeve respektive përpara fejesës. Prandaj, përpara se të lidhin krushqi, familjet e dy të rinjve, pavarësisht faktit nëse këta duhen apo jo, fillojnë kërkimet për krushqinë. Për vajzën dhe familjen e saj pyetet më shumë se sa për djalin dhe familjen e tij. Familjarët e djalit interesohen që vajza të vijë nga një “derë” e mirë duke pasur parasysh me këtë një familje, në të cilën respektohen normat tradicionale, gjë që parathotë se nusja e ardhshme do të dijë të sillet në

shtëpinë e dhëndërrit. Interesimin më të madh familjarët e shfaqin para fejesës, për t'u siguruar se miqësia që po lidhin do jetë e suksesshme dhe se lidhja mes të rinjve do të jetë e qëndrueshme. Që familjet shfaqin më shumë interesim përpara fejesës për njohjen e ndërsjelltë të të rinjve që do fejohen është e kuptueshme, për shkak të rëndësisë që ka akti i fejesës në marrëdhëniet e mëpasme mes dy familjeve dhe fiseve. Edhe të dhënat tregojnë se niveli i paragjykimeve është më i lartë përpara se sa gjatë fejesës. Rreth 57.0 për qind e të anketuarave pohojnë se janë ndjerë më shumë të paragjykuara nga familjarët e të fejtuarit para fejesës, ndërsa 43.0 për qind pas saj. Interesimi i madh i familjarëve të djalit para fejesës përkon me dëshirën e tyre që të zgjedhin një nuse sa më të mirë për djalin e tyre. Dëshira ua do që nusja e ardhshme të ketë sa më shumë cilësi që të kënaqin edhe shijet estetike të familjarëve edhe kërkesat morale sipas normave zakonore. Ata presin që nusja të jetë e re, e bukur, e shëndetshme, punëtore, e pafjalë, e urtë, kokëulur dhe e ndershme. Për të ditur nëse vajza që do marrin i ka apo jo këto cilësi, ata pyesin të njohurit, njerëzit që kanë miqësi me familjen e vajzës dhe sidomos fqinjët e shoqet e saj. Duke qenë se nuk e njohin vetë vajzën, familjarët e djalit ecin me paragjykime bazuar në thëniet e të tjerëve për cilësitë dhe familjen e saj.

Shkalla e lartë e paragjykimeve para fejesës shpjegohet së paku me dy arsye: *e para*, familjarët e djalit nuk e njohin vetë vajzën dhe familjen e saj dhe i ndërtojnë përshtypjet e veta mbi opininet e të tjerëve, dhe *e dyta*, një vajzë mund të mos i ketë të gjitha cilësitë e dëshiruara dhe, për pasojë, familja e djalit mund të jetë paragjykuese. Dy të rinj mund të duhen dhe madje mund edhe të bashkëjetojnë duke konsumuar martesën *e faktit*, por për familjen dhe fisin ata nuk quhen as të lidhur dhe as të martuar nëse lidhja e tyre nuk është njohur nga familjet respektive të tyre, siç e do zakoni, që do të thotë të jenë fejuar dhe martuar nga prindërit ose me dijeninë dhe miratimin e këtyre. Prandaj, fejesa është përgjithësisht një akt i traditës kulturore që nuk anashkalohet. Ajo përbën momentin kyç të lidhjes së mëpasme, që është martesa dhe është mundësia e vetme që familjet të njihen para se të rinjtë të kurorëzojnë një lidhje afatgjatë. Familjarët e djalit, sidomos prindërit e tij, dëshirojnë që fejesa të jetë prelud i një martese të suksesshme, prandaj kërkojnë shumë garanci që ajo do të jetë e tillë përpara se të ndodhë, dhe garancitë kërkojnë tek familja e vajzës. Të anketuarat janë ndjerë më shumë të paragjykuara para se sa pas fejesës, për shkak se familjarët e të fejtuarit kanë pasur mundësi ta njohin direkt vajzën dhe kanë mundur të konfirmojnë përshtypjet e krijuara nga informacioni paraprak i ofruar nga të tjerët dhe kanë mundur të shtojnë informacion të ri. Shumica e paragjykimeve gjatë

fejesës shkaktohen nga mospërputhja mes pritshmërive që kanë prindërit e djalit për nusen e ardhshme me cilësitë e vajzës, e cila mund të mos jetë shumë e konformuar me traditat zakonore.

5.3.1.1. Fejesa me blerje dhe shkuesi: dashuria është turp!

Të rinjtë e sotëm në fshat nuk kanë pengesa aq të forta morale për njohjen me njëri-tjetrin sa ç'kanë pasur brezat para tyre, por kanë një pengesë objektive që është pamundësia për t'u njohur. Moshë e fejesës si rregull është përmbi 18 vjeç dhe përkon me përfundimin e shkollës së mesme. Vajzat që nuk shkojnë në shkollë të lartë mbyllën në shtëpi në pritje të kërkesave për fejesë. Të anketuarat e punësuarat punojnë në mjedise kryesisht me vajza e gra. Ndërmarrjet artizanale të fasonerisë që kanë lulëzuar në fshat janë gjithashtu të populluara nga punonjëse gra dhe vajza. Dikur, në periudhën e regjimit socialist, puna në ndërmarrjen bujqësore "Gjergj Dimitrov" i ofronte më shumë mundësi njohjeje të rinjve që punonin në një brigadë dhe natyrshëm mund të dashuroheshin dhe të martoheshin. Megjithatë, edhe pse martesë me dashuri ishte e mundur në socializëm, forma më e përhapur e martesës sipas pohimeve të të anketuarave në fshat ka qenë martesë me shkuesi (mblesëri). Fejesa me shkes është forma më e përhapur e fejesës, pas përmbysjes së regjimit socialist dhe mbylljes së ndërmarrjes bujqësore. Pamundësia për të krijuar njohje në punë dhe mosshkuarja në shkollë të lartë e le në dorën e familjarëve dhe të afërmeve gjetjen e një kandidati për martesë.

Fejesa me shkes ose me marrëveshje të prindërve është një ripohim i traditës së fejesës. Dikur, sipas normave kanunore, fejesa quhej e kryer kur familja e djalit i jepte familjes së vajzës një shumë të hollash që quhen nishan, shejë, fe, për ta parablerë vajzën. Me pagesën e kryer, vajza quhej e fejuar dhe familja nuk mund ta kundërshtonte fejesën e lidhur. Fejesa vetëm me fjalë goje nuk pranohej nga kanuni; "Fejesa bëhet me para" (Ilia, Frano, 1993:26). Në fejesë jepej kësti i parë i parave, ndërsa kësti i dytë jepej në martesë, ditën e dasmës kur merrej nusja. Normat tradicionale kanunore kanë pësuar disa ndryshime. Në momentin e fejesës, siç edhe u pohua nga të anketuarat, familja e djalit nuk jep më para, por vjen me dhurata për familjarët e nuses dhe nusen dhe me nishanin (unazën) për nusen. Gjatë fejesës, familja e djalit mund t'i japë një pjesë të hollash familjes së vajzës që shërbejnë për përgatitjen e pajës së nuses, e cila i jepet vajzës me vete kur martohet.

Kusht për fejesën sipas normave kulturore kanunore ka qenë miqësia mes familjeve dhe jo dashuria mes të rinjve. Madje, dashuria ishte turp i palejueshëm që e çnderonte vajzën dhe familjen e saj. Vajzat fejojeshin pa vullnetin e tyre. Në kanunin e Lumës, në paragrafet 75, 76 dhe 87 thuhet se “kanë tagër me dhanë cucë e me zanë nuse, veç meshkujt e shpisë; djali e cuca me prind gjallë s’kanë tagër me lyp martesë; nusja zihet me të folme ball për ball të baballarvet që dojnë m’u ba miq, kur çojn groshin (pagesën) e zakonit” (Hoxha, Sh., 2013: 96). Në mendësitë fshatare, dashuria nuk ka lidhje fare me martesën, aq më tepër që dashuria shihet si dobësi karakteri dhe ndëshkohet moralisht. Sidomos vajzat, duke qenë se konsiderohen si qenie të brishta, naëve e me karakter të dobët, mendohet se mund të bien viktimë e ndonjë mashtrimi nga djemtë që duan të përfitojnë nga çiltërsia e tyre, prandaj duheshin ruajtur që të mos binin në dashuri. Dashuria konsiderohet si një akt i turpshëm që çnderon vajzën dhe familjen e saj. Familja vihet nën presionin e akuzave kolektive të bashkësisë fshatare si fajtorja kryesore që nuk ka ditur të edukojë një vajzë të ndershme. Që të mos vuajnë ndëshkimin e tërë bashkësisë mbi vete dhe për të ruajtur vajzat nga përfolja për imoralitet, familjet tregojnë zell të madh në zbatimin e normave kanunore. Rënia në dashuri nuk pranohet as për burrat, sepse dashuria është dobësi femërore dhe burrat që bien në dashuri nuk janë më burra; burrat e vërtetë nuk duhet të tregojnë asnjë interes seksual (Young, A., 2000:22).

Ndërsa ndjenjat dashurore paragjykohe si dobësi e karakterit njerëzor, marrëdhëniet seksuale jashtëmartesore ndëshkohen skajshmërisht. Sikurse shprehet studiuesi i kulturës, Zyhdë Dervishi: “Në shoqërinë tradicionale shqiptare kanë qenë shumë-shumë të rralla marrëdhëniet paramartesore dhe jashtëmartesore. Funksiononin disa norma kulturore kanunore që i ndalonin dhe që i nxisnin shqiptarët të ndëshkonin në mënyrë përçmuese personat që kryenin marrëdhënie të tilla, madje dhe t’i vrisnin” (2013:60). Sipas traditës, vajza jepej për martesë që në moshë të vogël, që në djep, madje në shumë raste që pa lindur, prandaj nuk kishte sesi fejohej dy herë: edhe me shkes (nga familja), edhe vetë (me dashuri). Po të dashuronte një djalë dhe të ikte me të, ajo i sillte gjakderdhje familjes së saj, sepse vajza ishte e blerë dhe ishte pronë e familjes së djalit.

Në fshat, kriteri kryesor për fejesën ishte që vajza të kishte fizik të fortë për të kryer punë të rënda dhe për të lindur fëmijë, pra lidhja në martesë ishte për të shtuar krah pune në shtëpinë e dhëndrit e për të siguruar vazhdimësinë e ekzistencës së familjes. Këtë fakt e sjell në vëmendje edhe etnografja Andromaqi Gjergji, e cila shkruan se ” kërkesa e parë për nusen ishte që vajza të

ishite e shëndetshme dhe punëtore e mirë.” (Gjergji, A., 2002:238). Një arsye tjetër për fejesë me njohje familjesh ishte edhe vendosja e miqësive mes familjeve përmes bashkimit të tyre në krushqi. Normat kanunore e theksojnë qartë se çfarë kuptohet me fejesë, duke nxjerrë në pah elementin miqësor mes familjeve. Sipas Kanunit të Bendës, që ka edhe ndikimin më të madh në Farkë: “Me u fejue, domethanë se dy shpi i kanë dhanë fjalën njana-tjerës përmes shkesit për m’u ba miq, kur njana palë premtan me i dhanë gocën palës tjetrër. Veç i pari i shpis kujdeset për fejesë të robve të vet” (Goci, H., 2010:15). Lidhjet e krushqisë në fshat, sipas normave kanunore vendoseshin edhe për t’i dhënë fund hasmërive mes fiseve dhe sidomos gjakmarrjes. Për dukurinë e pajtimit përmes krushqisë, Zyhdi Dervishi argumenton: “Pajtimi i familjeve në gjak blindohej edhe me lidhje krushqie... Si rregull, familja e vrasësit ose një familje shumë e afërt me të dërgonte nuse në shtëpinë e të vrrarit ose në një familje me lidhje gjaku më pranë saj një nga vajzat më të mira, më dinjitoze, më të zgjuara, e cila do të dinte ta luante më mirë rolin e amortizatorit të tensionimeve psikologjike, të trashëguara kur dy familjet ose fiset kishin qenë në hasmëri. Fëmijët që lindin nga martesat të tilla kishin gjak të përzier të dy fiseve që më parë kishin qenë në hasmëri. Sipas normave kulturore kanunore, fëmijët me gjak të përzier bllokoni përgjithnjë çështjen e gjakmarrjes ndërmjet burrave të fisit të babait dhe burrave të fisit të nënës” (2013:60).

Miqësinë në fejesë e lidhin meshkujt më të mëdhenj të familjes, jo vetëm për nga mosha, por edhe nga statusi: fejesën e bënte i zoti i shtëpisë, i cili synonte që përmes fejesës të forconte pozitën e familjes me një krushqi të mirë. Siç shprehet edhe Andromaqi Gjergji: “Martesat në fshat ishin çështje krejtësisht e prindërve, me anë të së cilës i zoti i shtëpisë synonte të lidhte aleanca me familje të forta për të fuqizuar familjen e vet. Të rinjtë, si djali, si vajza, nuk pyeteshin fare” (2002:49). Studiuesit e familjes pohojnë se fejesa me shkëmbim është një dukuri e njohur në kulturat paramoderne. Antonia Young, një studiuese e jetesës së banorëve të fshatit shqiptar ka vënë re se përmes fejesës me shkëmbim: “Gruaja i jepet një burri nga një burrë tjetër, që është zakonisht babai ose vëllai. Shkëmbimi i grave i shërben interesave të burrave, të cilët përmes tij forcojnë lidhjet e tyre miqësore në grup si meshkuj, pa marrë parasysh dëshirën e gruas” (Young, A., 2000:22). Njësoj nuk merret parasysh as mendimi i djalit që do fejohej, por djali në kundërshtim nga vajza edhe mund ta mohojë fejesën, ndërsa vajza jo.

Edhe sikur të donte ta gjenin vetë shokun ose shoqen e jetës, të rinjtë në fshat, e kishin thuar se të pamundur sepse normat tradicionale e pengonin njohjen mes tyre. Pengesat që u

viheshin të rinjve ishin të shumta, por më kryesoret ishin tre: (i) *e para*, njohja pamundësohej nga veçimi i vajzave prej djemve që në moshë të vogël; (ii) *e dyta*, të rinjtë fejohehin që në moshë të vogël, djali fejohen në moshën kur i lindëte e drejta të mbante armë dhe vajza në moshën e pubertetit; dhe (iii) *e treta* ishte ekzogamia.

5.3.1.2. Veçimi i vajzave nga djemtë

Në fshat, djemtë dhe vajzat nuk rrinin bashkë pas moshës femërore. Edhe sikur të donin të njiheshin e kishin të pamundur, pasi vajzat mbaheshin mbyllur në shtëpi, brenda ekonomisë familjare, që nga mosha e pubertetit dhe djemtë nuk kishin më kontakte me to. Në fshat, sapo mbushnin shtatë vjeç, vajzat ngarkoheshin me punë shtëpie, bujqësie e blegtorie. Në kanunin e Lumës thuhet se “si të bahet cuca shtatëvjeçe, ungj (ul) shaminë nën vetull, thyen duert me gjylypanë, gjypnyer, furkë e vek (vegje), lshon gjan e gjall, e i bahet krah shpis dhe merr udhën me një njeri para” (Hoxha, Sh, 2013:122). Pra, që në moshën 7 vjeç vajzat në fshat mbylleshin në shtëpi dhe merreshin me punë njësoj si gratë e rritura. Në shoqëritë tradicionale paramoderne, deri dy shekuj më parë, të vegjlit kalonin drejtpërsëdrejti nga një foshnjëri e zgjatur në role pune brenda bashkësisë, madje në shumicën e vendeve perëndimore fëmijët futeshin në punë që në moshë të hershme (Giddens, A., 1997:90). Fëmijët në shoqërinë paramoderne nuk kanë njohur as “lodrat”. Të drejtat e fëmijëve dhe “puna e ndaluar” për fëmijët janë koncepte të vona të zhvilluara nga fundi i shekullit XX.

Nën ndikimin islam dhe kanunor, familjet i detyronin vajzat të shkëpusnin marrëdhëniet me bashkëmoshatarët që në pubertet (mosha në të cilën një individ bëhet i aftë për aktivitet seksual dhe për riprodhim). “Deri në moshën të vogël fëmijët, vajza dhe djem, rrinin dhe luanin bashkë. Pastaj vajzat veçoheshin nga djemtë dhe u flisnin vetëm djemve të mëhallës, e më pas vetëm kushurinjtë deri sa rrethi ngushtohej gjër në martesë” (Gjergji, A., 2002:238). Vajzat e rritura nuk lejoheshin të dilnin nga shtëpia të pashoqëruara; një mashkull i fisit duhej t’u printe atyre në rrugë. Vajzat e shoqëruara nga meshkujt e fisit nuk kishin asnjë mundësi njohje dhe kontakti me djem. Të dyja gjinitë mbaheshin rreptësisht të veçuara me qëllim që të ndaleshin njohjet personale dhe ndjesitë dashurore tek të rinjtë. Për më tepër takimet dhe propozimet për dashuri ishin dhe janë ende koncepte të papranuara në mendësitë e banorëve të zonave rurale. Në fshat, është moralisht i ndaluar shoqërimi i vajzave me djem dhe ca më tepër marrëdhëniet

seksuale. Vajzat mbahen në shtëpi dhe zihen me punë, ndërsa djemtë janë të lirë të bredhin me shokë tërë ditën. Në mjedisin fshatar njohjet e të rinjve realizoheshin me vështirësi, sepse flirti dhe takimet erotike shiheshin si akte të trupshme për vajzat.

5.3.1.3. Fejesa në moshë të vogël

Sikurse vajza, edhe djali ishte fejuar në moshë të vogël, pra për ta kishin zgjedhur të tjerët, sepse ajo nuk kishte njohje me njeri që të mund ta zgjidhte vetë. Sikurse thekson edhe kanuni i Skënderbeut, paragrafi 160, “vajza asht e turpshme dhe nuk ka mundësi me njohë njerëz të largët e të përshtatshëm për fatin e vet. Ajo ka nevojë për mbrojtjen e nderit të vet e të shtëpisë, që të mos korisë as veten e as shëpinë, e sidomos ka nevojë për krahin e burrave që ta mbrojnë nderin me armë” (Ilia, F., 2013:47). Vajzat nuk mund të kundërshtonin fejesat e rregulluara nga baballarët e tyre. Aq më tepër që fejesa kishte implikime financiare pasi familja e djalit e kishte paguar këstin e parë të blerjes në fejesë. Nëse fejesa prishej, paratë e dhëna për fejesën humbnin prandaj edhe quhet “sheji hupës” në gjuhën e kanunit. Djali edhe mund ta kundërshtonte fejesën pa pyetur askënd, kurse vajza nuk mund ta prishte. Që të mund të kundërshtonte fejesën, vajza duhej të kthehej në virgjinë, duke u betuar përpara 12 paronikëve (provëtarëve) për beqari të përjetshme. Nëse e prishte premtimin si virgjinë, duke u martuar me një burrë tjetër, vajza shkaktonte gjakderdhje për burrat e familjes së saj.

5.3.1.4. Ekzogamia: pengesë për martesat me dashuri

Arsyeja e tretë dhe më kryesorja për pengimin e martesave me dashuri ishte ekzogamia. Edhe sikur të njihje një vajzë në fshat dhe të donte ta merrte për grua, djali nuk mund të fejohej dot me të për shkak të ekzogamisë, sipas të cilës banorët e një bajraku konsiderohen të gjithë kushurinjtë. Fiset shqiptare kanë qenë organizuar në katunde brenda sistemit të pronësisë dhe brenda katundit lidhjet fisnore ishin të afërta në gjak (Canaj, E., 2008:19). Ekzogamia ve në jetë parimin e patrilokalitetit që është martesë e vajzave jashtë fshatit dhe vendosja e tyre në shtëpinë e burrit. Qëllimi është të shmangen martesat brenda lidhjeve të gjakut. Sipas studiuesit Zyhdi Dervishi: “Shoqëria shqiptare tradicionale përgjithësisht mund të konsiderohet si shoqëri e lidhjeve martesore skajshmërisht ekzogame në linjë fisi. Ndoshta asnjë popull tjetër në botë nuk

ka pasur norma kulturore që të përcaktojnë një ekzogami kaq të skajshme... dhe pothuajse çdo krahinë kishte rrezen e vet të ekzogamisë që përcaktonte rrethin e të rinjve dhe të rejave që nuk mund të martoheshin në sistemin e lidhjeve fisnore” (2013:63). Edhe Faik Konica, në veprën e tij e ka trajtuar zakonet e martesës tek shqiptarët duke theksuar se “ndalohet martesë ndërmjet dy vetave që i përkasin të njëjtit bajrak, duke e quajtur inçest, edhe kur dy personat kanë shumë të largëta ose kur nuk kanë asnjë lidhje; kështuqë të gjitha nuset merren nga jashtë fshatit” (1993:477). Në krahinën e Tiranës, fejesa lejohet nëse djali dhe vajza nuk janë farefis nga ana e babait deri në 100 breza dhe nga ana e nënës deri në 7 breza (Goci, H., 2010:36)

5.3.1.5. Prejardhja familjare: kriter me rëndësi për fejesën

Për të bërë një fejesë, familjet e bashkëshortëve të ardhshëm, tregojnë kujdes të marrin gjithë informacionin që iu duhet për njëra-tjetrën. Familja e vajzës interesohet më shumë për personalitetin e djalit dhe pasurinë e familjes së tij, pasi vajza e tyre do jetojë atje. Ndërsa familja e djalit interesohet më shumë për familjen e vajzës dhe sidomos për nënën pasi nëna ka rol parësor në edukimin e fëmijëve dhe nëse nëna është grua e mirë do ta ketë edukuar edhe vajzën me norma tradicionale dhe do ta ketë modeluar sipas shembullit të vet, prandaj në fjalorin e banorëve qarkullon fjala e urtë “*Copës shihi anën, vajzës shihi nanën!*”

Kur jepej vajzë, prindërit e saj shikonin më shumë gjendjen ekonomike të familjes së djalit, ndërsa kur merrej nuse për djalin, prindërit e tij shihnin origjinën shoqërore të vajzës, pavarësisht nga gjendja ekonomike. Në kanunin e Skënderbeut, në paragrafin 154, thuhet se “kur mendojnë me fejuë djalin, prindët kanë parasysh së pari shtëpinë e mirë të vajzës e mandej vetitë e mira të saj” (Ilia, F., 1993:156). Me shtëpi kuptohet familja, e cila duhet të ketë një emër të mirë në bashkësi.

Shtëpitë në shoqërinë shqiptare tradicionale kanë funksionuar si minishtete të vogla me marrëdhënie të mirëpërcaktuara me të tretët dhe me hierarki dhe detyrime të qarta për anëtarët e tyre. Në marrëdhëniet me të tjerët, familjet kanë vepruar me protokoll të përpunuar përfaqësimi, komunikimi, takimesh, marrëveshesh e pajtimesh. Pushtimi osman e përforcoi këtë mendësi kanunore, pasi në islam familja shihet si një shtet i vogël që vendos marrëdhënie me njësi të tjera shoqërore, përfshi këtu edhe vetë shtetin (Topalloglu, B., 1997:140). Djalit i shihej statusi ekonomik i familjes për të garantuar se vajza nuk do ishte e varfër dhe do jetonte mirë.

Zakonisht, shtëpitë në gjendje të mirë ekonomike konideroheshin ato me oxhak të lartë ose portë të madhe, që në gjuhën popullore thirreshin “shtëpi oxhaku” ose “derë e parë”. Simbolika e oxhakat dëshmonte mborthësinë pasurore, mundësitë për të mirëpritur miq e deri rëndësinë që kishte ajo familje në bashkësi për zgjidhjen e problemeve të anëtarëve të bashkësisë vendore (Dervishi, Z.,2008:67).

Nuses së ardhshme, përveç familjes, i shihej edhe personaliteti dhe aftësitë për të punuar. Rangu i lartë ekonomik nuk ishte kusht për marrjen e nuses, sa ç’ ishte për dhënien e vajzës. Madje, parapëlqeheshin nuset nga një origjinë shoqërore më e ulët sepse gruaja do ishte shumë më modeste dhe e bindur në familjen e burrit, ndërsa “nëse gruaja do të vinte nga një derë e pasur në derë të varfër do t’i mbante kryet përjetë, do ishte shumë krenare, do kishte pretendime, nuk do shtrohej lehtë dhe do kujtonte me fodullëk derën e babait e do t’u hakërrehej kunatave “ (Gjergji, A., 2002:48).

5.3.1.6. Tradita e blerjes së nuses

Sipas traditës, për të zënë nuse për djalin, familja e tij paguante një çmim me dy këste: pjesa e parë jepet kur pritej fjala për fejesë dhe e dyta kur bëhej dasma. Zakoni i blerjes së nuses ka ekzistuar deri në vitin 1967 në Shqipëri dhe ishte bërë një barrë e rëndë financiare për familjet fshtare që nuk kishin mjaftueshëm të holla të paguanin. Për t’i shpëtuar detyrimit për pagesë djemtë nga familje të varfra i rrëmbenin nuset ose i merrnin kundrejt shkëmbimit të tyre me bagëti. Sikurse konstaton Andromaqi Gjergji: “Në pjesën më të madhe të vendit, për të marrë nuse, familja e djalit do t’i jepte familjes së vajzës një shumë të hollash, një bagëti të trashë a një send tjetër sipas marrëveshjes dhe kur një familje ishte e varfër e me shumë djem, e rrëmbente vajzën” (2002:49). Por, rrëmbimi ishte punë e vështirë sepse norma kulturore e ekzogamisë e detyronte familjen e djalit të gjente nuse jashtë fshatit, pasi brenda tij njerëzit konsideroheshin me lidhje faresfisnore. Që djali të njihte dikë personalisht në një vendbanim ku nuk banonte vetë ishte krejtësisht e pamundur, por në periudhën e regjimit socialist kjo pengesë ra, sepse puna bujqësore në kooperativa dhe ndërmarrje shtetërore, krijoi kolektiva të mëdhenj punonjësish, me shumë djem e vajza dhe i ofroi shumë të rinjtë në mjedisin e punës. Rrëmbimi ishte i palejueshëm në kanun sepse vajza, sipas normave kulturore kanunore, nuk ishte e lirë që të vinte ta merrte dikush nga jashtë. Vajza, edhe po të mos ishte e fejuar, do jepej në fejesë nga familja e

saj dhe nuk do mund të fejohej vetë, sepse kjo nuk ishte një e drejtë e saj. Përveç pengesave kulturore, rrëmbimi vështirësohej edhe nga pengesa infrastrukturore siç ishte distanca relativisht e largët midis fshatrave dhe mungesa e mjeteve të shpejta të transportit rrugor.

5.3.1.7. Tabuja e virgjërisë

Praktika e blerjes së nuses mbase nuk u zhduk krejtësisht gjatë regjimit socialist, por u ndalua me ligj. Fejesa me shkes vazhdoi të ekzistonte krahas fejesës me njohje personale. Në intervistat që pata me vajzat dhe gratë, ato pohuan se ka një rikthim të traditës së pagesës që jepet si kapar për të mbyllur “muhabetin” për fejesë. Kjo praktikë kryhej përmes shkëmbimit të duhanit ndërmjet babait të djalit dhe të vajzës ose ndërmjet meshkujve të rritur të fisit. Numri i cigareve të servirura nga familjarët e djalit tregonte edhe shumën që duhej paguar për vajzën në mijëshe (kryesisht në pound britanikë dhe më rrallë në euro). Nga pohimet e të intervistuarave rezultonte se shifra e paguar shkonte deri në 10 cigare, që korrespondonte me 10 mijë pound britanikë. Vajzat që fejoreshin në këtë mënyrë ishin në moshën 15-17 vjeç. Ato fejoreshin jashtë vendit, kryesisht në Angli. Kjo praktikë fejese kishte rezultuar në largimin e disa vajzave nga shkolla e mesme. Dhëndurrët dhe familjartët e tij, me pagesën e kaparit të fejesës u kishin kërkuar prindërve të vajzave t’i hiqnin ato nga shkolla, nga frika se ato mund iknin me ndonjë djalë tjetër dhe humbnin virgjërinë. Disa familje të ardhurish nuk i kanë lejuar vajzat që të ndjekin shkollën e mesme pasi i kishin fejuar. Një rast të tillë pata mundësi ta dëshmoja përmes intervistimit të një gruaje, nënë e dy vajzave adoleshente, të fejuara në këtë formë. Ajo jetonte e vetmuar në një vilë të madhe në majë të kodrës që të jepte përshtypjen e një burgu. Në sytë e saj lexohej një pikëllim i thellë që zor se mund të përshkruhet me fjalë. Me tone të ulëta dhe me një zë ankues përmbloodhi arsyen e atij mjerimi shpirtëror: “Isha shumë e re kur erdha këtu në Farkë nga fshati im, me burrin që ngrinti një shtëpi këtu. Erdhëm për një jetë më të mirë. Ai bleu një copë tokë pranë njerëzve të tij që kishin ardhur disa vite para nesh. Unë u bëra nënë shumë shpejt me dy vajza. Burri punonte shumë po paratë për të jetuar dhe për të larë borxhet nuk dilnin. Ai vendosi të ikte në Angli tek disa kushurinjtë të tij dhe zuri punë në ndërtim. Unë kam jetuar vetëm me vajzat. Burri do kthehet kur të rregullojë letrat e qëndrimit. Vajzat shkuan në shkollë, mësonin dhe mësuesit i lavdëronin. Më ndihmonin me punët e shtëpisë, kopshtin, pulat dhe lopën. Kur mbaruan shkollën nëntëvjeçare, burri nuk i la vajzat në shkollë të mesme se “Cucat

ishin ba për burrë”. Ai i fejoj të dyja dhe nuk i la të dilnin nga shtëpia, që të mos i shihte më njeri. Ai tutej se mos vajzat njihnin ndonjë djalë dhe martoheshin pa e pyetur atë. Vajza e madhe është martuar, është bërë nënë dhe bën jetën e zakonshme të një fshatareje. Edhe burri i saj është larguar në Angli për punë. Vajza e vogël është fejuar me një shqiptar në Angli, sa dyfishi i vajzës, shok me burrin. Ajo do iki në Angli. Të paktën nuk do bëjë jetë fshatareje. Mbase i shoqi e le të vazhdojë shkollën”. Prindërit, sidomos baballarët në fshat, hezitojnë t’i lenë vajzat të ndjekin shkollën nga frika se mos ato bien në dashuri dhe martohen me mendjen e tyre. Pasi hiqen nga shkolla, vajzat mbahen në shtëpi që të mos kenë kontakte me djem.

5.3.1.8. Moskundërshtimi i vajzës

Sipas normave kanunore, shprehur edhe në paragrafin 15 të Kanunit të Skënderbeut, vajza nuk ka asnjë të drejtë të mendojë dhe të japë pëlqimin për fejesën e vet; këtë të drejtë e kanë vetëm meshkujt e familjes: babai, vëllzërit, vëllezërit e babait ose dajat nëse nuk ka meshkuj nga fisi i babait: “vajza do të marrë atë burrë që do t’i japë prindi” (Ilia, F., 1993:27). Vajza nuk mund ta kundërshtojë dot fejesën, edhe nëse burri ka një grua tjetër, sepse sipas normave kanunore: “Vajza e mirë nuk qet za, i bindet fatit” (Goci, H., 2010:51). Djali mund ta lerë vajzën nëse asaj i dalin fjalë për nderin, edhe kur fjalët vështirë të provohen. Sipas Kanunit të Lumës, paragrafi 120, “Cuca ndër sheja lëshohet, djali jo, edhe po muer gru tjetër. Po nuk pranoi cuca të martohet me atë burrë që i asht fal, çon gjak ke të vetët (Hoxha, Sh., 2013:104). Nëse vajza ngelet shtazanë gjatë fejesës, vritet nga babai, nëse ka dyshime se babai i fëmijës nuk është i fejuari, ndërsa nëse vajza e fejuar ngelet shtazanë gjatë fejesës më të fejuarin përshpejtohet dita e dasmës. Nëse vajza e lë të fejuarin dhe ikën për t’u martuar më një burrë tjetër, ajo vritet sepse ka çnderuar miqësinë dhe ka prerë në besë familjen e djalit që ka paguar çmimin e nuses (shenjën e fejesës). Në krahinën e Tiranës, Kanuni i Bendës, në paragrafët 46, 47 dhe 51, e rregullon kështu lëshimin e vajzës ndër sheja (nën shenjë fejese, unazë): “Në rast se vajzës i dalin fjalë për nderin, atëherë djali e lëshon. Me dal goca me barrë, ha plumbin kres nga i ati. Në rast se goca nën unazë ikën me një burrë tjetër, kët e lan pushka, fishekun e ka prindi i saj” (Goci, H., 2010:36).

Vajzat, por edhe djemtë, e kishin rreptësisht të ndaluar të dashuronin dhe të martoheshin në bazë të ndjenjave dhe tërheqjes erotike të ndërsjelltë. Dashuria është parë si sjellje e tupshme

dhe çnderuese nga normat kulturore kanunore. Për ndalimin e dashurisë, studiuesi Zyhdi Dervishi shprehet “Në shoqërinë tradicionale shqiptare një nga brengat më traumatizuese ka qenë dashuria e porealizuar e të rejave dhe të rinjve, kjo ndjenjë e brishtë gati hyjnore që i paraprin formimit të familjes, krijimit të jetës, që ndikon fuqishëm në fismërimin e humanizimin e çdo individi, të gjithë shoqërisë. Madje funksiononin mjaft tabu që i detyronin të rejtat dhe të rinjtë të mos i artikulonin ëndrrat e tyre për djalin ose vajzën e zemrës, jo vetëm në mjedise publike të gjera, por as edhe ndër miqtë më të afërt. Pothuajse në çdo rast artikulime të tilla konsideroheshin si shfaqje imoraliteti, si mungesë burrërie, etj. Publikimi i një dashurie, qoftë edhe në mënyrë të tërthortë, mund t’i përfshinte në konflikte të ashpra deri në viktimizime familjen e djalit me anë të vajzës, si dhe fiset e tyre” (2008:90).

Kundështimi i fejesës nga vajza mund të bëhej vetëm nëse ajo vendoste të qëndronte përgjithmonë beqare sepse, përndryshe, shkaktonte gjakderdhje. Vajza virgjinë edhe pse nuk dëshironte ta marrte të fejuarin, ngelej e fejuara e tij. Vajza nuk detyrorej me pahir ta marrte të fejuarin, prandaj kur ajo e refuzonte fejesën, familjes së djalit i “shkonte sheji hup” (i humb pagesa e bërë në fejesë), por shtëpia e vajzës detyrohej “me iu la be shpis së djalit me 12 provëtar dhe po u shkel beja baba i vajzës bie në gjak se i ka mikut një gjrue borxh” (Hoxha, Sh., 2013:105). Andromaqi Gjergji, studiuese e normave zakonore, ka vërejtur se dukuria e virgjinave ka ekzistuar deri në vitin 1960 nëpër malësitë e Veriut deri në Mat e Çermenikë (Gjergji, A., 2002:50).

Në krahinën e Tiranës nuk janë gjetur dëshmi të dukurisë së virgjinave. Edhe në zonat e islamizuara në veri të vendit, kjo dukuri nuk ka qenë shumë e përhapur, pavarësisht se parashikohej në normat dokësore. Në Kanunin e Bendës, vajza që shmderrohej në burrë quhet djaloshe, pikërisht sepse zevëndësonte djalin e munguar në shtëpi: “Djaloshja ash një vajzë që asht betu mos martohet sa të jetë gjallë; ajo vishet si burrë, me brekushe e xhoke, ngjesh kësul të bardh, mban sahat me qostek, kuti duhani, çibuk, unur dhe eshkë. Djaloshja mban dhe armë e qëndron me burra në kuvend, por veç me ndigjue se kanuni e ndalon zanin e grus në kuvend” (Goci, H., 2010:40). Në kanunin e Skënderbeut, në paragrafin 983, pozita e vajzës virgjinë është e njëjtë me atë të Kanunit të Bendës, “ajo është zot shtëpie kur shtëpia e saj nuk ka burrë, po në kuvend burrash e pleqsis nuk ka za” (Ilija, F., 1993:74). Në krahinën e Lumës, vajza virgjinë quhej cucë-burrë ose vejane (beqare). Ajo mund të ishte *zot shtëpie* dhe të kishte “za në kuvend të barkut (të shtëpisë së vet) dhe të fisit” (Hoxha, Sh., 2013:37). Më e pranishme, dukuria e

virgjinave ka qenë në Malësinë e Mbishkodrës dhe krahinën e Dukagjinit, që përfshin një pjesë të Shqipërisë së Veriut dhe Kosovës, kryesisht në familjet katolike, vajzat e të cilave të shtyra nga rrethanat familjare në mungesë djemsh, merrnin rolin e mashkullit, për të vazhduar funksionet shoqërore të familjes si: menaxhimi i pronës për të ushqyer pjesëtarët e familjes, marrja e gjakut, përfaqësimi i familjes, lidhja e fejesave për vajzat e shtëpisë, punët e burrave jashtë shtëpisë, etj. Përvec virgjinës, (ri)martësën mund ta kundërshtonte edhe gruaja e ve, e cila vendoste vetë për martesën e dytë. Sipas Kanunit të Lumës, paragrafi 206, nëse gruaja e ve nuk pyetej nëse donte të martohej dhe martohej pa dëshirën e saj, ajo “*t’i kthente krushqit n’udhë*” (Hoxha, Sh., 2013:117).

5.3.1.9. E huaj në shtëpi të prindërve

Në shoqërinë tradicionale shqiptare, vajza sa ishte në shtëpi të vet punonte shumë, që në moshë të vogël dhe mësonte prej nënës së saj dhe grave të tjera të familjes rolet shoqërore të gruas në familjen patriarkale. Në fshat, vajzat bënin punë të rënda në shtëpi, në bujqësi e blegtori, njësoj si gratë e rritura. Vajzat përgatiteshin kësisoj për jetën e ardhshme si gra të martuara. Në mendësitë e shoqërisë tradicionale ishte gjerësisht i përhapur opinionimi se vajza sa kohë është në shtëpi të prindërve është në shtëpi të huaj. Vetëm pasi martohej vajza konsiderohej se shkonte në shtëpi të vet, gjë që shprehet në thëniet popullore “shkoi në shtëpi të vet, në fat të vet”, “shkoi të hajë bukën e vet, shkoi në derë të vet” (Dervishi, Z., 2008:204).

5.3.1.10. Të rinjtë e fejuar nuk shikoheshin me njëri-tjetrin as në fejesë

Sipas traditës kanunore fejesa nuk ka as kufij moshe dhe as afat për martesë. Vajza mund të fejohej që pa lindur, por si rregull fejohej pasi kishte lindur, kur baballarët i jepnin fjalën njëri-tjetrit se do bëheshin miq përmes krushqisë. Vajza kërkohet me anë të shkesit që dërgohej nga shtëpia e djalit dhe përgjigja i jepej atij: “Leu djali kërkoi nuse, leu goca, të erdhi kush në derë e ta kërkoi jepe. Fejesa nuk ka vade (afat), zgjat aq sa e shofin palët të arsyeshme” (Goci, H., 2010: 33). Të fejuarit nuk shiheshin, sepse në kanun parja është e pamoralshme dhe ndëshkohet. Në Kanunin e Lumës, paragrafet 118 dhe 119 përcaktojnë ndalimin për vajzën e fejuar për të mos e parë as të fejuarin, as familjartët e tij: “Cuca ndër sheja nuk duhet m’u pjekë a me folë me

djalit që e ka zanë nuse as me gjindjen e tij; nuk duhet me shkue në katund të tij; nuk duhet me zanë në gojë emrin e djalit që e ka zanë. Bani cuca e i shkelli këto culle (ndalime) i qet emën te keq vetes e zhburrnon babë e vlla” (Hoxha, Sh.,2013:204). Kanuni i Skënderbeut, në paragrafin 135, shprehet se vajza e fejuar, sado e vogël të ishte nuk mund të dilte më nga shtëpia që të mos e shihnin të tjerët, prandaj ishte e detyruar të “mërtyssetj (fshihet prej syrit) dhe të mbulonte fytyrën që të mos e shihnin (Ilia, F., 1993:50). Nëse vajza e thyente ndalimin e të parit, ajo edhe mund të lëshohej (ndahej) prej të fejuarit.

Me kalimin e viteve ky zakon është zbutur sepse një vajzë mund të mos ishte e fejuar kur kishte mbushur 14 vjeç dhe një djalë që e dinte se ajo ishte e lirë mund ta zinte duke i hequr mbulesën e kokës ose duke i vënë një varëse. Në zonën e Tiranës, nëse djali e pëlqente vajzën ai lejohej prej Kanunit të Bendës, ta “zinte” për fejesë: ”Nëse djalit i pëlqen një gocë dhe ky përgjon rastin e i heq napën e kresë ose i var në qaf një pare sermi, vajza asht e lidhme.” (Goci, H., 2010:33). Megjithë zbutjen e normave kulturore kanunore, të rinjtë që pëlqeheshin e kishin shumë të vështirë të kontaktonin dhe të njiheshin nga afër. Ata e kishin të ndaluar të komuniikonin se përndryshe bëheshin “kurban” i ndëshkimit të opinionit publik që e shkurajonte shfaqjen e dashurisë. Sipas studiuesit Zyhdi Dervishi: “Në shoqërinë tradicionale shqiptare, komunikimi i të dashuruarve nëpërmjet fjalës së folur, dhe sidomos të shkruar, paraqiste vështirësi dhe rreziqe të shumëllojshme. Fjalët e folura mund të shumëfishoheshin dhe të keqpërdroreshin nga agjencia e thashethemeve. Ndërkohë, letrat si mjet komunikimi ndërmjet të dashuruarve përdroreshin shumë rrallë, jo vetëm sepse shumica ishin analfabetë, por edhe ngaqë letra e shkruar ishte një fakt më provokues për konflikte ndërmjet familjeve ose fiseve të të dashuruarve. Në rrethana të tilla, të dashuruarit komunikonin në distancë me njëri-tjetrin, me simbole, me shenja, të cilat në gjuhën e përditëshme quheshin isharete” (Dervishi, Z., 2008:91).

Martesa me dashuri nuk lejohet në kanun. Vajza i është dhënë dikujt dhe nuk është e lirë të martohet me tjetër bashkëshort, përveçse me atë që e ka fejuar familja. Martesa me dashuri quhet tradhëti bashkëshortore për të fejuarin e parë që e ka blerë dhe ndëshkohej me vrasjen e të dyve: edhe të vajzës edhe të djalit që e merrte me dashuri. Vrasjen e kryente familja e vajzës, babai ose vëllai, ose i fejuari i parë, të cilit familja e vajzës i jepte fishekun për ta vrarë vajzën që ikte. Nëse vajza ikte me dijeni të familjes ose familja e shiste edhe tek një burrë tjetër, atëherë i fejuari kërkonte gjak tek familja e vajzës, duke i vrarë babain ose njërin nga vëllezërit.

5.3.1.11. Paja e nuses

Në Kanunin e Bendës thuhet se pajën e nuses e paguan familja e djalit (Goci, H., 2010:39). Ato para do shkojnë përsëri në shtëpinë e djalit në formën e veshjeve që nusja do pregatisë për vete, për burrin dhe për shtëpinë (dyshekë, jorganë, çarççafë, jastëkë, qylyma, etj). Në fakt Konica ka një opinion tjetër për paratë që paguan familja e djalit. Ai mendon se këto para nuk i jepen nuses që kjo të sjellë në shtëpinë e burrit një pjesë pasurie që do ngelet në pronësi të shtëpisë së burrit, por janë çmimi i nuses, që babai i djalit jep për të blerë grua për djalin: "Martesa me pagesë nuk nënkupton blerjen e një pjese të pronës, por kujdestarinë mbi gruan dhe të drejta të tjera që martesa ia jepet burrit të saj (Konica, F., 1993: 477). Në martesën me blerje Konica sqaron se pagesa nuk nënkupton blerjen e vajzës si pjesë e pronës së babait, por vetëm të drejtat e kujdestarisë dhe të përdorimit të gruas, të cilat me blerjen kalojnë nga babai tek burri. Konica thekson se ky zakon ka pas ekzistuar edhe në popujt e lashtë teutonë, të cilët me pagesën blinin *Mund*-in (në gjuhën teutone), që në shqip Konica e ka përshtatur si kujdestari, por që në shqip mund të shkonte edhe ashtu siç është në teutonisht, *mund*, që do të thotë *punë*, mundim, lodhje prej punës. Pra burri i paguante babait të vajzës *mundin* e gruas, krahun e punës që do t'i shtojë familjes së tij. Dhe në fakt, nga normat kanunore kuptohet qartë se çmimi jepet për nusen, jo për placçkat që do sjellë ajo në shtëpi, ai quhet "çmimi i nuses" dhe ndahet në dy këste, i pari jepet ditën e fejesës, kur zihet nusja dhe i dyti ditën e martesës, kur merret nusja. Në Kanunin e Lekë Dukagjinit, në paragrafin 28, është sqaruar edhe përcaktimi i martesës: "M'u martue me kanun do me thanë m'u ba shpi, me i shtue shpis një rob ma tepër, sa për krah të punëve, sa për të shtuem të fëmijëve" (Gjecov, Sh., 1998:10). Është e qartë se martesa me pagesë blen një krah pune, i shton shtëpisë një njeri më shumë që është gruaja e blerë, e cila pritet t'i shtojë familjes së burrit edhe krahë të tjerë pune, me lindjen dhe mirërritjen e fëmijëve. Pra, normat kanunore theksojnë shumë qartë se pagesa bëhet për arsye ekonomike. Gjithashtu sqarohen edhe funksionet që ka gruaja në martesë: gruaja martohet për të përmbushur *funksione prodhuese*, duke i shtuar krahun e vet të punës ekonomisë familjare të burrit, dhe *funksione riprodhuese*, duke lindur fëmijë që do t'i shtohen fuqisë punëtore të ekonomisë së familjes e do të sigurojnë vazhdimësinë e familjes dhe mbijetesën ekonomike të saj.

Për të siguruar kontrollin e burrit mbi gruan, në rast se vajzës së fejuar mund t'i kishin dalë fjalë për moralin, babai i saj i jepte në pajë edhe një fishek që dhëndrri ta vriste, nëse ajo çnderonte familjen e tij duke bërë tradhëti bashkëshortore ose duke prerë mikun në besë. Një ndër arsyt e dhënies së fishekut në pajë ishte edhe çlirimi i anëtarëve të fisit nga përgjegjësia për vepra deviante që mund të kryente e afërmja e tyre (Dervishi, Z., 2008:163). Duke i dhënë fishekun dhëndrrit, për të vrarë bijën e tyre në rast të shkeljes së kurorës ose largimit nga shtëpia, meshkujt e famijes së vajzës, babai dhe vëllezërit e saj nuk binin në gjak. Familja shkarkohej nga përgjegjësitë morale dhe shoqërore për sjelljen e gruas së martuar.

5.3.1.12. Paragjykimet në fejesë nga të afërmit e të fejuarit

Të anketuarat tregojnë se kanë qenë pre e paragjykimeve jo vetëm të fëmijarëve të të fejuarit, por edhe të të afërmeve të tij gjatë kohës së fejesës. Të afërmit kanë një status të privilegjuar në familjen shqiptare, të cilin ua jep të qenët fis. Të gjithë anëtarët e fisit ndihen aq të afërt sa që e ndjenjnë për detyrë të interesohen në emër të njeri-tjetrit. Njërëzit e fisit përbëjnë një bashkësi shumë të lidhur mes tyre më fije shpirtërore dhe me interesa të ndërsjellta ekonomike të domosdoshme për mbijetësën e fisit. Anëtarët e fisit mendojnë se çdo gjë që i përket një pjesëtari të fisit, i përket apriori të gjithëve. Interesat e çdonjërit mbrohen kolektivisht prej fisit. Sikurse pohon studiuesja e jetës rurale, Elidiana Canaj: “Mendësitë fisnore egzistojnë kryesisht për shkaqe shpirtërore, për inerci në trashëgiminë e së kaluarës, për arsye të një jete komunitare relativisht të mbyllur e me një numër jo të madh njerëzish” (2008:237).

Në studim, të anketuarat janë ndjerë më shumë të paragjykuara nga të afërm të fejuarit pas fejesës: 38.4 për qind para fejesës dhe 61.5 për qind gjatë fejesës. Të afërmit kanë përgjithësisht informacion të kufizuar për nusen e ardhshme dhe familjen e saj, i cili u vjen përgjithësisht prej burimeve të jashtme siç janë krushqitë, miqësitë dhe të njohurit jashtë fisit. Mosnjohja e drejtëpërdrejtë me vajzën dhe familjen e saj bën që të hamendësojnë rreth vetive të nuses që do të hyjë në fisin e tyre. Edhe të afërmit e të fejuarit, njësor si familjarët e tij, interesohen më shumë për cilësitë e familjes së vajzës se sa për vetë vajzën, pasi merret si i mirëqenë fakti që nëse familja është e mirë, me norma tradicionale, edhe vajza do jetë patjetër e tillë, për shkak të edukimit që ka marrë në familje. Ana ekonomike e familjes së vajzës nuk merret shumë në konsideratë sa ç'merret edukimi i saj me normat zakonore, sepse situata


ekonomike e familjes së vajzës nuk do ketë ndikim në ekonominë e familjes së djalit e, për pasojë, as në atë të fisit, pasi vajza, në të shumtën e rasteve, nuk trashëgon gjë sipas kanunit.

Ajo që ka rëndësi për të afërmit është shëndeti i vajzës për të punuar dhe për të lindur fëmijë dhe modestia e saj për të qenë e përlurur dhe e bindur. Të afërmit e bashkëshortit shohin gjatë fejesës cilësi të tilla si sjellja, komunikimi, aftësitë për të punuar, etj. Megjithëse pamja estetike e vajzës mund të jetë një kriter pëlqimi për të afërmit, ajo nuk është parësore në raport me shkathhtësinë për punë. Nusja nuk merret se është e bukur, por për të shtuar një krah pune në shtëpinë e burrit prej të cilës përfiton në mënyrë të ndërsjelltë edhe fisi. Aftësia për punë ka rëndësi parësore, gjë që e dëshmon edhe shprehja: "Grus mos i shih hunën, por punën" (Goci, H., 2010:34).

5.3.2. Shpeshësia e paragjyqimeve në familjen e bashkëshortit

Gratë janë ndodhur para rrebeshit të paragjyqimeve çdo ditë 23.3 për qind, çdo javë 19.8 për qind, çdo muaj 20.2 për qind dhe më rrallë se një herë në muaj 36.5 për qind. Sikurse shihet nga të dhënat, paragjykimet që ndodhin çdo ditë, javë e muaj zenë edhe përqindjen më të madhe të marra sëbashku, 64.5 për qind krahasuar me paragjykimet që ndodhin më rrallë se një herë në muaj. Nën sulmin e paragjyqimeve vihen më shpesh gratë e reja, të cilat bashkëjetojnë ose kanë bashkëjetuar për një kohë të gjatë me familjarët e burrit dhe në fqinjësi me të afërmit e tij. Më pak paragjykojnë gratë që janë moshuar dhe që janë shkëputur nga bashkëjetesa me njërëzit e bashkëshortit.

Denduria e paragjytimeve ne familjen e bashkëshortit



Gratë shprehen se shpeshësia me të cilën ato paragjykojnë i ve ato në një gjendje alarmi dhe ankthi se janë gjithë kohës nën mbikqyrje për t'u kapur në gabim ose për t'u qortuar me patjetër. Ato pohojnë se u është bërë frika nga paragjykimet e shumta, që mund të përdoren pa shkak kundër tyre dhe mund të shërbejnë si justifikim për t'i ndëshkuar moralisht dhe fizikisht. Gratë ndihen të pafuqishme të përballen me morinë e paragjytimeve dhe përpiqen vazhdimisht të provojnë veten kundër paragjytimeve të njerezve me të cilët ndajnë jetën si: bashkëshorti dhe familjarët e tij. Gratë që paragjykojnë çdo ditë në punën, sjelljen, komunikimin, veshjen e tyre ndihen veçanërisht të acaruar për shkak të bezdisë që u shkaktojnë paragjykimet dhe u duhet të luftojnë të vetme përditë me to. Ato nuk janë të qeta të sillen lirshëm ose të komunikojnë pa pasur frikë se po paragjykojnë dhe kjo gjë u shkakton ankth të vazhdueshëm.

Edhe pse janë më pak të paragjykuara, gratë që paragjykojnë çdo javë janë njësoj të frustruara, sepse në vend që të lëvdohen për sjellje të mirë, a për punë të dobishme, a për shërbim të devotshëm, përballen me mosmirënjohje dhe me deklarata të llojit “për detyrë e ke, prandaj je nuse që të na shërbesh, nuk të takon të flasësh se je e huaj” , etj. Ato fajësohen për shumçka ndodh në familjet e burrit edhe për gjëra që nuk kanë pasur të bëjnë fare me to. Ato shpesh revoltohen me sjelljen e familjarëve që në vend t'i përgëzojnë se u shërbejnë pa pushim, edhe duke neglizhuar veten dhe fëmijët, marrin si shpërblim kritika dhe sharje. Më pak të paragjykuara ndihen gratë që e kanë kaluar stazhin e nusërimit dhe që janë bërë vetë vjehrra pasi kanë nusëruar tërë jetën. Ato shprehen se edhe pse janë moshuar, janë përsëri pre e

paragjytimeve më rrallë se një herë në muaj, të cilat i dëgjojnë vetë ose ua thonë të tjerët. Megjithëse marrin role të reja në ciklin e jetës, nga nuse, nëna, vjehrra e gjyshe, paragjykimet për to nuk reshtin sepse paragjykimet për gratë nuk kanë fund.

5.3.3. Përshatja me normat kulturore për martesën

Me ardhjen në shtëpinë e burrit, gruaja e re i shtohet fuqisë punëtore të ekonomisë shtëpiake të burrit. Ajo pritet të punojë shumë dhe të lindë fëmijë. Sipas normave kanunore të Kanunt tëi Skënderbeut, paragrafi 138, “martesa asht bashkim i përjetshëm i burrit dhe grues, për me pas fëmijë, për t’i rritë ata dhe për ndihmë të njani-tjetrit në punë të jetesës”(Ilia, F., 1993:26). Gruaja e martuar duhet të shfaqë gjithë aftësitë e të nusëruarit (të berit gruan e martuar). Ajo i ka mësuar shprehitë e rolit shoqëror të gruas së martuar duke punuar në shtëpinë e vet dhe duke marrë si shembull nënën e saj. Pavarësisht se sa e mësuar vjen, gruaja e re i nënshtrohet procesit të “granimit” në shtëpinë e burrit, duke bërë gruan e martuar në atë shtëpi sipas normave zakonore të asaj krahine, rol që ia mëson vjehrra.

Sipas normave kanunore, shprehur edhe në Kanunin e Skënderbeut, paragrafi 142, “mosha për martesë të djalit asht mosha e armvet, 16 vjetësh, kurse për martesë të vajzës asht kur mrrin me krye punët e shpis, 14-15 vjeçe” (Ilia, F., 1993:26). As vajza as djali nuk pyeteshin fare sepse martesa ishte çështje që prindërit e kishin vendosur që me fejesën e tyre. Martesë zyrtare, në Kanunin e Skënderbeut, paragrafi 140, konsiderohej kurora fetare që “njihej prej feje e kanuni, ndërsa martesa pa kunorë feje asht e paligjshme” (Ilia, F., 1993:26). Në martesë, sipas traditës, gruaja sjell edhe pajën që e ka përgatitur gjatë viteve të fejesës: “Nusja duhet të sillte në pajë sëndukun (arkën) me rroba të brendshme për vete dhe për burrin, peshqeshe si çorape për të afërmit e burrit, qylym e rrugica të qëndisura me dorë, velenxa dhe jorgan, jastëkë dhe dyshekë leshi, 4-5 fustane dhe çibunë. Për të caktuar se çfarë do sillte nusja në pajë, bëhej një marrëveshje mes palëve” (Gjergji, A., 2002:235).

Gjatë regjimit socialist, të rinjtë kishin mundësi njohje në mjediset e përbashkëta të punës dhe mund të martoheshin me dashuri. Megjithëse dashuria u legjitimua si kriter i rëndësishëm për jetën bashkëshortore nga strukturat shtetërore që ishin përgjegjëse për kryerjen e ceremonisë së martesës, opinioni shoqëror në fshat vazhdonte të ishte armiqësor ndaj martesave me dashuri. Në një nga bisedat që pata për martesat me dashuri në fshat, një agronome rreth të 50-tave më

tregoi se si ajo vetë ishte viktimizuar dyfish nga familja e saj dhe familja e bashkëshortit, sepse ishte martuar me dashuri: “E njoha bashkëshortin tim gjatë kohës që isha studente, ne studionim të njëjtën degë dhe u dashuruam në shkollë të lartë dhe vendosëm të martohemi. Babai im nuk ishte dakord me këtë martesë, jo se kishte gjë kundër familjes së bashkëshortit tim, por sepse ishte inatosur me mua që e kisha turpëruar duke e zgjedhur vetë burrin tim. Kisha edhe fisin e babait kundër, që dëshironin një fejesë sipas zakonisht dhe jo me dashuri. Po ashtu, edhe fqinjët në mëhallë flisnin poshtë e lart për mua duke më etiketuar si të pandershme dhe se kisha zhburrëruar babain tim duke u martuar me dashuri. Unë nuk bëra dasëm, sepse babai nuk pranoi të martohesha me tim shoq, përkundrazi më urdhëroi të ndahesha prej tij dhe të më fejonte sipas traditës me shkes. Unë ika tek shtëpia e bashkëshortit tim vetëm me rrobat e trupit. Babai më bëri lanet dhe nuk më foli deri sa vdiq. I vetmi që interesohej për mua ishte vëllai i vogël që më takonte fshehurazi. Nëna nuk mund të dilte hapur pro meje sepse kishte frikë se do akuzonin atë për turpin që kisha bërë unë. Babai i kujtonte shpesh se ajo nuk duhej të përzihej në punë martese tek fëmijët. Në shtëpinë e tim shoqi gjeta një varfëri të skajshme. Ata ishin shumë njerëz në shtëpi. U prita ftohtë prej tyre dhe hoqa shumë, jo vetëm për shkak se ishin të varfër e s’u dilte të ngopeshin me bukë, por edhe sepse ishim martuar me dashuri Familjarët e tij kishin mendësi shumë të prapambetura për gratë. Ata më paragjyquan ashpër si grua jo shumë e ndershme, sidomos vjehrra dhe kunatat e martuara para meje, sepse e kisha marrë burrin vetë dhe kisha shkuar në shkollë të lartë. Për të më treguar se isha njësoj si gratë e tjera në atë shtëpi dhe se arsimit nuk kishte fare rëndësi për njerëzit e asaj familje, vjehrra më vinte të laja këmbët e të gjithë njerëzve të shtëpisë, detyrë kjo e nuses më të re. Ngrihesha që në 4 të mëngjesit dhe ndizja zjarrin, bëja kafetë për vjehrrin dhe vjehrrën, fshija oborrin dhe qëroja ndonjë perime për drekën. Në punë gjeja rehatinë dhe respektin njerëzor që më mungonte në shtëpi. Kur kthehesha në shtëpi, mezi i zvarrisja këmbët që nuk më bindeshin të shkoja atje. Në shtëpi, shndërrohesh nga agronomja e nderuar në shtëpiaken e poshtëruar nga zakonet prapanike të traditës kanunore që mbahej fort brenda mureve të shtëpisë, në kokat dhe veprimet e njerëzve të bashkëshortit. Kur hynte vjehrrin dhe kunatën në shtëpi, duhej të lija çdo punë që kisha në dorë dhe të qëndroja gatitu me sytë përdhe, në shenjë përlulje deri sa ata të largoheshin. Kur lindi djalin mendova se do më linin të merresha me të dhe nuk do më mundonin aq shumë, por e kisha gabim. Për gjashtë muaj rresht unë nuk e lava dhe as e ndërrova njëherë fëmijën tim, sepse vjehrra dhe kunata e madhe më thanë që nuk ishte punë për mua të laja fëmijën tim, e përkëdhelja vetëm kur i jepja

gji. Unë që i laja këmbët dhe rrobat gjithë njëzëve të shtëpisë nuk mund të laja dhe ndërroja fëmijën tim... Edhe me bashkëshortin tim e kisha të vështirë të komunikoja në sy të tyre, kishim përpunuar një repertor gjestesh dhe mimike për të folur heshturazi në sy të tyre. Ai nuk më mbronte dot nga trajtimi poshtërues që më bënin njerëzit e tij sepse edhe atë nuk e përfillnin shumë se ishte me shkollë të lartë dhe se ishte treguar i dobët duke u martuar me dashuri dhe jo me ndonjërin që duhej t'i kishte gjetur i ati. I kujtonin shpesh se unë kisha ardhur me rroba trupi, pra nuk kisha sjellë pajë në atë shtëpi, se ata më kishin dhënë bukë për të ngrënë kur të mija më kishin nxjerrë prej shtëpie dhe nuk interesoheshin më në isha gjallë a vdekur. Pra duhej t'i isha mirënjohëse që më kishin hapur derën e shtëpisë. Kam ngrënë bukë me lot në atë shtëpi...". Ajo e ndërpreu rrëfimin pasi u ngashërye. Vuajtjet që kishte kaluar e kishin dobësuar psikologjikisht. Kujtimet e dërgonin në një kohë që nuk kishte më dëshirë t'i kthehej pas. Mësua prej vëllait të saj, se pas ardhjes së demokracisë, kunetërit ishin larguar në Itali dhe ajo bashkë me të shoqin kishin ndërtuar një shtëpi në tokën e familjes së saj, që vëllai i vogël i kishte dhënë së motrës në shenjë shpërblimi për sakrificat që kishte kaluar gjatë gjithë rinisë.

5.3.4. Dasma

Dasmat bëheshin në shtator kur kishin mbaruar punët e mëdha bujqësore dhe kur gjendja ekonomike e familjes ishte më e mirë për shkak të të korrave dhe vjeljeve. Ritualit i dasmës ishte shumë i zgjatur, një javë rresht. Nusja merrej me kuaj. Në simbolikën e dasmës edhe pse është ngjarje e gëzuar, sidomos për familjen e djalit, dhe festohet një javë rresht, ceremoniali i gëzuar i martesës ka dy momente hidhërimi: *i pari* është largimi i vajzës nga shtëpia dhe *i dyti* është nusërimi tek shtëpia e dhëndërrit. Nusja, prindët, vëllezërit e motrat e saj qajnë për largimin e saj nga shtëpia sikur po ikën në banesën e fundit dhe jo sikur po nis një jetë të gëzuar. Edhe studimet për kulturën e kanë vënë në pah këtë dukuri: "Në shoqërinë tradicionale shqiptare kur martohej një vajzë, përgjithësisht të afërmit e saj, sidomos vëllai ose vëllezërit, paraqiteshin të brengosur në mjedise publike" (Devishi, Z., 2008:107). Ata qajnë fatin e saj si grua e martuar dhe mundimin që do heqë në derë të huaj, pa mbrojtje dhe pa respekt, pavarësisht se përdoret dëndur shprehja se "Po shkon në derë të vet, të hajë bukën e vet", etj. E verteta është se kur martohet, vajzën dhe familjen e saj i kaplon një dhimbje e thellë për largimin e saj nga gjiri i familjes, që


përjetohet si humbje e pashlyeshme, aq sa në kanun të Bendës thuhet: “Dalja e gocës asht barabar si me të vdek një rob shpie!” (Goci, H., 2010:45).

Pozita e gruas në familje dhe në shoqëri ishte më e ulët se ajo e burrit. Nënrenditja e gruas ishte bërë pjesë edhe e ceremonialit të dasmës në të cilin nusja duhej të tregonte gadishmëri nënshtrimi për t’u quajtur nuse e mirë sipas zakonit. Andromaqi Gjergji, nga ekspeditat që kryente nëpër fshtra, për të qëmtuar zakonet e dasmës, tregon se si duhej të sillej nusja kur hynte në shtëpinë e dhëndërrit: ”Ditën që martoheshin, kur dhëndrri shkonte të merrte nusen, do t’i afrohej kalit të saj dhe do t’i binte me grusht tri herë në kurriz nuses, në shenjë nënshtrimi. Kur nusja hynte në shtëpi të dhëndërrit, ai do t’i lidhte në qafë frenë e kalit dhe duke e tërhequr do t’i përpiqte kokën tek oxhaku dhe tek tre muret e shtëpisë. Kur vinin kurorë, dhëndrri do t’i shkelte këmbën nuses, domethënë që e konsideronte nën vete” (Gjergji, A., 2002:235). Familja e djalit e përshfaqte gjandjen pasurore me anë të florinjve që i vendoste nuses ditën e dasmës në qafë ose në ballë. “Në shoqërinë tradicionale shqiptare, deri në çerekun e parë të shekullit XX, hierarkia shoqërore shprehej simbolikisht edhe përmes ... bizhuterive të arta që mbanin gratë. Veçanërisht, në Shqipërinë e Mesme, nuseve të reja u varnin në qafë napolona ari. Përgjithësisht sa më shumë napolona ari të mbante në qafë një nuse e re, aq më e pasur ishte familja e bashkëshortit dhe e përkundërta.” (Dervishi, Z., 2008:64).

5.3.5. Shkaqet e paragjykimeve në martesë

Vajzat dhe gratë e kanë të vështirë të përshtaten me kërkesat e normave kulturore dhe sjelljen prej skllaveje të gruas në familjen e bashkëshortit. Ato janë të arsimuara, një pjesë edhe me shkollë të lartë.

Shkaqet e paragjytimeve në familjen e bashkëshortit



Ky brez i mirarsimuar nuk e gjen veten tek përkufizimet tradicionale të normave kulturore për vajzën dhe gruan dhe përpiqen t'i kundërshtojnë normat. Përplasja mes kërkesave të traditës së kaluarës, që e mbanin gruan të ndrydhur dhe të shtypur nën autoritetin mashkullor brenda familjes dhe kërkesave të kohës për sukses personal, autonomi dhe vetmjaftueshmëri ekonomike është një burim i nxehtë konflikti mes brezit të vjetër dhe vajzave dhe grave që jetojnë në shoqërinë pasmoderne.

Megjithëse me rënien e regjimit socialist totalitar, pozita e gruas pësoi regres përse i përket të drejtave si individ brenda dhe jashtë familjes, tradita kulturore kanunore e rikthyer me forcë, nuk ka mundur të ç'bejë ndryshimet që solli regjimi socialist. Rikthimi tek normat kanunore ndodhi në një moment kur shteti u shpërbë, dhe kur shoqëria u ndodh në kushtet e anomisë vlerore. Kapja pas vlerave të së shkuarës ishte si një varkë shpëtimi për familjen e gjendur në dallgët e pamëshirshme të ndryshimeve shoqërore. Rënia e regjimit socialist u pasua nga shembja e sektorit të prodhimit bujqësor dhe industrial në vend, gjë që shkaktoi shpunësim masiv të popullatës sidomos të vajzave dhe grave, të cilave papunësia u hoqi privilegjin ekonomik që kishin gëzuar në socializëm, duke i hedhur në varësinë ekonomike dhe shoqërore të meshkujve të familjes, të cilët të shtyrë edhe nga rritja e kriminalitetit e rritën vigjilencën për ruajtjen e nderit të vajzave dhe grave. Përhapja e trafikut të qenieve njerëzore, ku vajzat e trafikuar furnizonin tregëtinë e “mishit të bardhë” e justifikoi kontrollin familjar të meshkujve

mbi liritë e lëvizjes dhe seksuale të vajzave dhe grave. Mosfunksionimi i strukturave shtetërore të rendit publik bëri që rolin ruajtës për sigurinë e vajzave dhe grave ta merrte familja, kryesisht meshkujt. Kundërshtimi i vajzave dhe grave ka hasur në përgjigje të dhunshme nga ana e familjarëve meshkuj të cilët e kanë përdorur dhunën ndaj grave si mjet bindjeje me qëllim parandalimin e “shkarjes në dërrasë të kalbur”. Përdorimi i forcës për t’i mbajtur vajzat dhe gratë të izoluar brenda mureve të shtëpisë bëhej me qëllim ruajtjen e nderit për familjen. Vetpërcaktimi i shoqërisë shqiptare si shoqëri “nderi” u ruajt edhe në vitet e demokracisë. Në vitet e regjimit socialist, pavarësisht se propogandohej si arritje dashuria mes të rinjve, ajo nuk duhej të shfaqej sheshit, por duhej të qëndronte e ngujuar brenda mureve të dhomës së gjumit dhe në errësirën e natës, kur të rinjtë mund të shkëmbenin ndonjë përqafim a puthje. Për dyzimin e opinionit në lidhje me dashurinë në regjimin socialist, studiuesi Zyhdi Derishi shprehet se kishte dy qëndrime, njëri ishte kundër shfaqjes së dashurisë si shprehje e degjenerimit të mënyrës borgjezo-revizioniste të jetesës dhe tjetri pro dashurisë si shfaqje e modernitetit perëndimor, që mbartej në mendësitë e të rinjve si shprehje e çlirimit nga traditat ndrydhëse të së kaluarës (2008:401). Pamundësia e strukturave shtetërore për të marrë në mbrojtje vajzat dhe gratë e dhunuara ndikoi në rritjen e dhunës brenda familjes.

Në studim, vajzat dhe gratë dëshmojnë se janë përballur në mënyrë sistematike me dhunën psikologjike dhe fizike. Konfliktet me familjarët kanë qenë shumë të pranishme përgjatë gjithë jetës së tyre dhe si fitil kanë shërbyer paragjykimet që i kanë penguar për të lëvizur të lira jashtë shtëpisë, për t’u arsimuar, punësuar, për të pasur jetë sociale dhe familjare me zgjedhjen e tyre. Paragjykimet për vajzat dhe gratë janë të shumta dhe flenë në shtratin e normave kulturore që e nënrendisin gruan brenda familjes, duke e kufizuar në shërbime ndaj të tjerëve lindje fëmijësh. Ndër shkaqet kryesore për paragjykimet ndaj vajzave dhe grave janë: sjellja, aftësitë, veshja, komunikimi dhe kujdesi për fëmijët.

5.3.6. Të paragjykuara për sjelljen

Shumica e paragjytimeve ndodhin për shkak të sjelljes. Janë paragjykuar për sjelljen 24.8 për qind e grave të martuara. Opinioni shoqëror në fshat, përgjithësisht, mbështet normat kulturore që kërkojnë bindje të gruas ndaj bashkëshortit dhe ndaj familjarëve të tij. Në fshat, ka pak rëndësi se sa e arsimuar dhe profesionale është gruaja; brenda shtëpisë ajo është thjesht

shërbëtore. Gratë e martuara në fshat, dashur pa dashur, e kanë pranuar këtë rol. Por, sado mirë të sillen ato, paragjykimet nuk i lenë të qeta. Sjellja e tyre është vazhdimisht e vëzhguar nga familjarët e bashkëshortit dhe të afërmit e tij dhe e mbushur me qortime. Shumë prej tyre pohojnë se ndihen të huaja në shtëpinë e bashkëshortit edhe pse janë rritur me idenë se kur martohen shkojnë në shtëpinë e tyre. Familjarët e bashkëshortit u kujtojnë shpesh se janë “rob i huaj” në shtëpi të tij, se nusja nuk është bijë e shtëpisë, etj. Konsiderimi i huaj në shtëpinë e origjinës dhe në familjen e bashkëshortit shprehej edhe tek trashëgimia. Sipas normave kanunore, të shprehura edhe në Kanunin e Skënderbeut, paragrafi 1287, gratë nuk trashëgojnë “as tek prindja e as tek burri kurrnji pasuri të patundshme; ato marrin pjesë në çka ndahet për goje” (Ilia, F., 1993:92). Gratë e fitojnë statusin e të qenit në shtëpi të vet vetëm me moshimin kur bëhen zonja shtëpie. Edhe normat kulturore kanunore e shprehin këtë status prej të huaje të nuses në shtëpinë e bashkëshortit. Në kanunin e Lumës thuhet se “nusja vjen pas bijës, se nusja bijë nuk asht” (Hoxha, Sh., 2013:108). Studiuësja e kulturës shqiptare Susan Pritchett-Post në analizën që ka bërë për familjen shqiptare dhe pozitën e gruas thekson: “Është e qartë se kanuni i trajton gratë më shumë si sende pune se sa si njerëz dhe përshkruan me imtësi rolin e tyre të paracaktuar dhe të kufizuar. Qëllimi i kanunit ishte vendosja e gruas në një pozicion inferior shoqëror ndaj burrit dhe burrave të tjerë për të kufizuar mundësitë e saj për zhvillim, arsim, punësim, pavarësi, etj. E vetmja mundësi për t’i shpëtuar martesës dhe statusit të ulët shoqëror të gruas së martuar ishte beqaria” (1998:54).

Duke qenë gjithë kohës të vëzhguara se si sillen, komunikojnë, punojnë e përkujdesen, gratë e martuara përjetojnë një tension të vazhdueshëm nga mbikqyrja Që në vogëli, nënat e tyre u kanë thënë të mësojnë të sillen mirë se do shkojnë në derë të burrit dhe atje do “t’u vënë notën” për sjelljen. Gratë përjetojnë një ndjenjë pasigurie në lidhje me përkatësinë pasi nuk kanë një shtëpi të tyre ose një vend ku ato të mos jenë të huaja. Sa janë pa martuar janë të huaja në shtëpi të tyre dhe mezi presin t’i martojnë, kur martohen dhe shkojnë në shtëpinë e bashkëshortit u thuhet se janë të huaja e nuk janë bija. Faik Konica e përmend pozitën e vajzës si të tepërt të në shtëpinë e babait deri ditën që martohet:

“Nuk është e nevojshme të thuhet se vajza e shtëpisë zë pozitën inferiore. Ky ligj i pashkruar i familjes ndoshta mbështetet në idenë se femra është pjesë e familjes sa kohë nuk është martuar... Kur vjen koha që vëllezërit hapin shtëpitë e tyre, gjithë pasuria e prindërve ndahet barazisht mes tyre. Vajzat nuk marrin pjesë në pasuri. Në Shqipëri,

pothuaj nuk njihen testamentet e bëra nga babai. Nënës nuk i merret mendim për zotërimin e pronës” (Konica, F., 1993:137).

Pasiguria e përkatësisë dhe e pasjes së një vendi që mund ta quajnë të tyrin dhe ku nuk quhen të huaja i bën shumë të ndjeshme ndaj opinioneve paragjykuese. Ato janë thuajse gjatë gjithë jetës në provë për të treguar se meritojnë respekt për sjelljen e devotshme ndaj familjes: fëmijëve, bashkëshortit, familjarëve e të afërmve të bashkëshortit.

5.3.7. Pozita e nënshtruar e gruas në familje

Treguesi më i qartë i sjelljes së mirë është bindja e gruas së martuar ndaj bashkëshortit dhe familjarëve të tij. Ajo duhet të bindet jo vetëm për të fituar besimin e tyre se është nuse e mirë, por edhe për t'i dhënë emër të mirë familjes së origjinës. Këtë fakt e ve në dukje edhe Faik Konica, i cili ve re se grua e mirë në Shqipëri është ajo që i bindet me përkushtim traditës zakonore:

“Tipari kryesor i gruas shqiptare është dashuria e saj për shtëpinë si dhe përkushtimi ndaj traditave të vjetëruara. Këtu fshihet fuqia dhe dobësia e saj, sepse kjo frymë konservatore e bën atë të dyshojë për idetë e reja. Që në moshë të vogël, vajza nis të përgatitet për ditën kur do të bëhet nuse, bën qëndisimat e rrobat që do të jenë paja e saj. Kjo punë kërkon mjaft vjet. Ajo ka pasoja të dyfishta: e pasuron shtëpinë e ardhme me sende artistike e njëkohësisht ka vlerë morale duke e përqendruar vëmendjen e vajzës së re tek rëndësia e jetës që do bëjë si zonjë shtëpie. Kam frikë se kjo ka edhe një pasojë të keqe: i bën vajzat e reja shumë serioze, nuk i le të merren me lojëra të shëndetshme e të qeshin lirisht: kjo u jep vashave shqiptare një pamje prej murgeshash” (Konica, F., 1993:437).

Roli i gruas në shtëpi është të punojë pa bërë zë dhe të sigurojë gjithë shërbimet që kërkohen prej saj nga familjarët e burrit. Prindërit e saj nuk ndërhyjnë, por mbajnë përgjegjësi dhe duhet të japin llogari për sjelljen e saj. Për pozitën inferiore të gruas në shtëpinë e

bashkëshortit shprehen edhe normat kulturore kanunore. Në Kanunin e Skënderbeut, paragrafi 95, thuhet se nusja renditet e fundit në shtëpi të burrit: “Burri vjen para grues se mashkullimi para femnimit, cuca vjen pas djalit, nusja vjen pas cucës... Të drejtat i jep mosha, seksi dhe puna.” (Ilia, F.,1993:65). Nëse nusja nuk tregon devotshmëri dhe pranim të statusit inferior, ajo përballet me sanksione të rrepta në familjen e bashkëshortit si: qortimi, trembja, rrahja dhe dënimi për të mos parë njërezit e familjes së saj.

Shumë gra dëshmojnë se atyre nuk u dëgjohej zëri në shtëpi dhe se mendimi i tyre shpërfilet nga familjarët e burrit. Atyre nuk u lejohet të flasin në prani të familjarëve të burrit; janë aty për të dëgjuar dhe jo për të folur. Njëra nga të anketuarat u shpreh se kur kishte dashur të merrte pjesë në një diskutim që bëhej në shtëpi, në të cilin përfshihej edhe ajo, vjehri dhe kunetërit ia kishin mbyllur gojën me forcë: “Kur u martova isha me shkollë të mesme dhe kisha dëshirë të vazhdoja shkollën e lartë që të hyja në punë si mësuese. Bashkëshorti nuk më kundërshtoi, por më tha se do ta diskutonte më njëzë e familjes së tij. Ditën që do diskutohesh, ishim mbledhur të gjithë në dhomën e zjarrit (ndenjes) dhe i pari e hapi bisedën burri im. Ai u tha se meqë unë kisha qenë nxënëse e mirë në shkollë të mesme, kisha mundësi të vazhdoja shkollën e lartë. Kjo kërkesë u ra si rrufe në kokë. Ata filluan të kundërshtojnë të gjithë në kor dhe imshoq u mbledh sa një dorë nga sulmet e tyre. Unë desha ta mbroja dhe të thosha se nuk ishte ideja e tij, por e imja dhe se isha gati të hiqja dorë, por ata m’u kthyen si skuadër pushkatimi: Ti mos fol kur flasim ne, mbylle gojën!”.

Një tjetër zakon i përhapur ka qenë edhe qëndrimi i nuses në këmbë kur vinin njerëz të familjes ose të fisit për vizitë. Ajo duhej të qeraste dhe gjatë kohës që ata konsumonin pijet ose kafetë, nusja qëndronte në këmbë. Shumë gra të anketuara pohuan se ende sot vazhdon të ekzistojë kjo traditë. Në fshat hyrje-daljet nëpër fis e fqinj janë të shpeshta gjatë ditës dhe grave të reja u duhet të shpenzojnë shumë kohë duke pritur e përcjellë me tabaka në dorë. Ndodh që vjehri i mban të afërmit edhe për darkë dhe asaj i duhet të pregatisë darkën për aq vetë sa vijnë dhe duhet të përpiset që darka të dalë e mirë. Përveç gatimit, ajo duhet ta shtrojë ushqimin dhe t’u shërbejë ujë të ftuarve nga ku ka dalë edhe shprehja “Nuse shtamën!”. Kur burrat vijnë në shtëpi, gruaja duhet të ngrihet në këmbë dhe të qëndrojë në këmbë, deri sa ata të largohen. Vjehrit dhe kunatit të madh duhet t’i dalë përpara dhe ta përshëndesë më gjysëm zëri, pa i ngritur sytë nga toka dhe të qëndrojë më këmbë deri sa të largohen. Këto sjellje duhen kryer

sipas zakonit, përndryshe nusja shahet për sjellje të pahijshme, për mospërfillje të burrave, për mendjemadhësi, etj.

Gratë e moshës mbi 45 vjeç treguan se kishin qenë të detyruara, sipas traditës, t'u lanin këmbët familjarëve të burrit. Larja e këmbëve ishte një formë tejet fyese për gruan, kur njerëzit ishin në gjendje të kujeseshin vetë për higjenën. Njëra nga gratë e moshuara ma përshkroi me hollësi praktikën e larjes së këmbëve. Ajo kishte shkuar nuse në moshë të re dhe u kishte larë këmbët njerëzve të burrit, që nga më i madhi e der tek i vogli, për shumë vite deri sa erdhi një nuse më e re se ajo në shtëpi: “Unë shkova nuse pa bërë 15 vjeç, isha fëmijë për vete, por duhej të punoja shumë se isha nuse e re dhe zakoni nuk pyeste sa vjeç ishe. Po të ishe martuar, si e vogël si e madhe, njësoj do trajtoheshe. Çohesha herët në mëngjes dhe ndizja zjarrin, merrja shkarpat jashtë pa zbardhur akoma. Kur ishte shumë ftohtë më ngrinin duart duke marrë shkarpa. Pastaj vija një gjym me ujë për të zier mbi shkarpa. Ujin e kisha mbushur gjatë ditës dhe e kisha lënë gati. Kur vinin njerëz, uji edhe mbarohej dhe duhej të shkoja me mëngjes për të mbajtur ujë me shtamë mbi sup. Pastaj iu bëja kafënë vjehrrit dhe vjehrrës, dilja fshija oborrin dhe bëja punët e shtëpisë. U jepja ushqim bagëtive dhe milja lopën. Nuk bëja një minutë pushim gjithë ditën. Punoja edhe në arë se isha në punë. Më binte bretku deri në darkë, edhe bukë haja kur kishin mbaruar të tjerët, haja çfarë të ngelej. Në darkë u laja këmbët me rradhë të gjithëve, pa bërë zë. Vazhdova kështu pesë vjet deri sa erdhi një nuse më e re se unë në shtëpi që e bënte këtë punë. Nga punët e pafund dhe temenatë për t'u ndejtur “me kandar në brez” njerëzve të burrit më binte të fikët. Unë bija e fundit se isha e reja dhe nuk më takonte me fjetë pa fjetë burri im dhe burrat e tjerë të shtëpisë. Nga lodhja e madhe nuk ngopesha me gjumë. Mezi çohesha në mëngjes kur këndonte gjeli. Kur zbardhte dita e mallkoja diellin që lindte aq shpejt se doja të flija prapë. Nga stërmundimi për pesë vjet nuk bëra dot fëmijë. Isha shumë e dobët, kockë e lëkurë dhe nuk kisha si të vija mish se nuk më dilte koha as për bukë e as për gjumë”.

Mbajtja e kokës ulur dhe të mosparët në sy kanë qenë gjithashtu sjellje të pëlqyeshme për çdo grua. Këto qëndrime pasqyronin statusin e saj të nënrenditur ndaj burrave dhe respektin e njëanshëm të saj ndaj tyre. Gruaja duhej të qëndronte me kokën ulur para vjehrrit, kunetërve dhe bashkëshortit edhe kur ata i drejtoheshin asaj për ndonjë punë. Ata nuk i drejtoheshin në emër por e thërrisnin “oj nuse, oj ti, oj e filanit (për burrin)”. Të mos thirrurit në emër shkaktonte një ndjenjë revolte tek gratë, sepse dukej se për familjarët e bashkëshortit ato ishin askushi, njerëz pa emër që nuk ekzistonin fare.

Pozita e gruas brenda shtëpisë rëndohej akoma më shumë kur normat kanunore i hiqnin asaj çdo të drejtë vendimmarrje për veten dhe për fëmijët. Ajo ishte në shtëpi të burrit sa për punë dhe për të lindur fëmijë, domethënë ajo kishte vetëm detyrime dhe kurrfarë të drejtash si qenie njerëzore. Ja si shprehet Kanuni i Bendës, për “Detyrat e gruas” ndaj burrit; “ Gruja s’ka tagër mbi burrë e fmi. Ajo pjell për me shtu shpin, punon me i ardhë krah burrit. Grus jepi të haj dhe dajakun mos ja ndaj. Gruaja duhet të ulë kryet, ta mbyllë gojën e t’i bindet burrit për çdo punë” (Goci, H., 2010:19). Kanuni i Lumës përcakton detyrime të njëjta për gruan si dhe Kanunet e tjera. Në Kanunin e Lumës, që ka zbatim tek banorët e ardhur nga Kukësi, në paragrafin 48, thuhet: “Grueja ka këto detyra në shtëpi: me iu bindë të zotit dhe të zonjës së shtëpisë e me punue si t’i thonë ata; mos me iu kthye fjalën vjerrit e kunatisë, fjala e resë si kokrra e rrfes (rrufesë); me mshilë (mbyllë) gojën e sytë; me mirëmbajtë odën e zjarrit, odën e vet dhe oborrit; me la e shpëla, me arnue e thurr petkat e shpis; me pllenu e me shumue shpin, me rujt pjellen prej së keqes; me punue ndër ara e livadhe, me mjelë bagëtinë; me tjerre e me punue me vegë për shpi.” (Hoxha, Sh., 2013:91). Kanuni i Lumës vazhdon të detajojë detyrimet e gruas në shtëpinë e bashkëshortit edhe në paragrafin 50, duke u shprehur se” nusja e re në shtëpi ka këto detyra: me u çue e para dhe me ra e fundit; me kall zjarrin në none (në të gdhirë) dhe me e mbulue si të bjerë gjindja me fletë (fjetur); m’u ungjë (ulur) e fundit në sofër e m’u çue e para; me shtrue e me ngritë sofrën, me la enët, me pastru shpin, odën e miqve, kurtin (oborrit) e shpis; me la, me arnue petkat e hises së shpis; me lidhë e me zgjidhë qenin” (Hoxha, Sh., 2013:92). Ky përshkrim i detajuar i detyrave që kryen gruaja në ekonominë familjare në fshat ngjason shumë me një manual përdorimi të një makinerie pune, në të cilin përshkruhen funksionet me detaje. Nëse makineria nuk punon, ajo goditet që të punojë, “Grus jepi të haj e dajakun mos ja ndaj!” (Goci, H., 2010:19). Kur nuk punon si duhet, gruaja ndahet dhe kthehet tek prindërit njësoj siç kthehet makineria tek shitësi kur është e prishur, ose zëvendësohet me një të re.

Nuk ka asnjë përcaktim në kanune për punët që duhet të kryejë burri në shtëpi dhe jashtë saj. I vetmi detyrim i burrit është t’u sigurojë ushqim gruas dhe fëmijëve, por nuk thuhet se si. Në ekonominë familjare duket se një pjesë të madhe të prodhimit për konsum ushqimor dhe për veshje e siguron puna e gruas, që nga vezët, mishi, bulmeti, buka, misri, gruri dhe veshjet. Nuk është e qartë se çfarë bën burri për të siguruar produkte bujqësore dhe blegtorale për konsum familjar dhe për shitje. Mbase me paratë që merrte nga shitja e prodhimeve të ekonomisë

familjare burri blinte ushqime të tjera që nuk prodhoheshin në familje dhe veshmbathje që nuk bëheshin në vegjë e furkë. Gjitashtu, nuk ka asnjë përcaktim në lidhje me sjelljen e burrit ndaj personave të tjerë në familje, sidomos në lidhje me gruan dhe fëmijët, përveç detyrimit ushqimor, që duket se sigurohet nga puna e gruas në ekonominë familjare. Kanunet e nënkuptojnë pozitën superiore të privilegjuar të burrit në hierarkinë familjare dhe shoqërore.

Disa nga praktikat poshtëruese për gruan e martuar si: larja e këmbëve, të mos thirriurit në emër, qëndrimi në këmbë në prani të vjehrrëve dhe kunetërve, qëndrimi me sy ulur dhe brofja me vrap në derë sapo ata hyjnë në shtëpi, etj., nuk praktikohen më. Por, reminishencat e normave kanunore ndihen tek pritshmëritë që familjarët kanë për gruan e martuar, siç janë: nënshtrimi, të mos folurit, shërbimi pa fjalë, dalja me leje të vjehrrës nga shtëpia, vizitat me leje tek familjarët e vet, etj. Paragjykimet kundrejt grave për sjelljen mundohen t'i mbajnë gratë e martuara në statusin e nënrenditur në familje, nën pushtetin e bashkëshortëve dhe familjarëve të tyre duke shkaktuar jo pak mospëlqim dhe revoltë tek gratë, sidomos tek më të rejtat.

5.3.8. Pozita e gruas jashtë mjediseve familjare: paprekshmëria, atribut i gruas apo i burrit?

Në familjen e burrit, gruaja është personi më inferior, ndërsa jashtë shtëpisë ajo është e paprekshme, jo në shenjë respekti për të si person, por në funksion të ruajtjes së nderit të burrave të familjes, i cili shkaktonte gjakderdhje nëse prekej. Sikurse shprehet Kanuni i Skënderbeut, në paragrafin 160: “Grueja ka nevojë për mbrojtjen e nderit të vet e të shtëpisë, që të mos korisë as veten e as shëpinë, e sidomos ka nevojë për krahin e burrave që ta mbrojnë nderin me armë. Gruja asht ndera e prindve dhe e shpis së burrit të vet” (Ilia, F., 1993:47). Gruaja udhëton gjithmonë e shoqëruar nga meshkujt e familjes që atë të mos e ngacmojë kush dhe ajo të mos ketë kontakte, gjë që kundërthotë paprekshmërinë në thelb, sepse nëse do ishte vërtet e paprekshme atëherë nuk do kishte nevojë të shoqërohej nga burrat. Përsa i përket të ecurit pas një mashkulli, qoftë ky edhe fëmija i saj, rradha e ecjes është shenjë e nënrenditjes së gruas ndaj mashkullit. Në Kanunin e Skënderbeut, tek paragrafi 720, thuhet se “grueja tue udhëtue edhe me fëmijë djalë, ky do t'i prijë kurdoherë edhe me qenë djali i saj” (Ilia, F., 1993:60). Gruaja shoqërohej prej meshkujve të familjes që asaj të mos i cënohej nderi nga meshkuj të tjerë në rrugetim. Çështja e nderit ishte më rëndësi kapitale: “Kush humb nderin quhet i vdekun” në kanun thuhet në Kanunin e Skënderbeut, në paragrafin 3351 (Ilia, F., 1993:209). Cënimi i nderit

të gruas në udhë ishte çnderim jo vetëm i saj, por edhe i familjes së saj. Sipas normave kanunore, paragrafi 3352 i Kanunit të Skënderbeut, “Grues i merret ndera tue e prekë, tue i marrë gja me dhumë, tue i ra, tue e sha, tue shpifë. Nderën e grues e çojnë në vend burri e prindët e saj. Ndera e marrme, kthehet me gjak” (po aty:209).

Një ndër funksionet e ecjes së gruas pas një mashkulli të familjes ka qenë edhe funksioni i saj mbrojtës ndaj gjakmarrjes, pasi burri që ecte në shoqërinë e një gruaje nuk qëllohej, për shkak të pranisë së gruas krahe tij. Sipas Kanunit të Skënderbeut, paragrafi 2763, “asht kundra burrnisë e kanunit me shti pushkë ndër gra, qoftë edhe e gjaksit” (Ilija, F., 1993:179). Këtë funksion mbrojtës ndaj gjakmarrjes e ka evidentuar edhe studiuesi i kulturës Zyhdi Dervishi, i cili e argumenton kështu ecjen e gruas pas një burri:

”Detyrimi për t’i lënë gjithnjë gratë prapa burrave ndër shqiptarët është interpretuar si dëshmi simbolike e shpërfilljes dhe deri e përçmimit të vajzave dhe grave. Por, përtej një interpretimi të tillë, ecja e gruas gjithnjë prapa, e shndërronte atë në një mburojë natyrore, shumë të sigurt për bashkëshortin ose çdo burrë të fisit të saj ose të bashkëshortit që i printe në rrugët plot rreziqe të krahinave fshatare” (Dervishi, Z., 2008:47).

Gjithësesi, sikurse shprehet Kanuni i Skënderbeut, paragrafi 723, edhe pse udhëtonte në prani të meshkujve të familjes, prania e gruas nuk anashkalohej nga burrat që e përshëndesnin në rrugë “oj fisnike” (Ilija, F., 1993:60). Kjo shprehje përmbledh në vetvete vlerësimin e lartë moral për figurën e gruas në kulturën shqiptare: të qenët grua e shndërron atë në qenie shumë të lartësuar, fisnike. Ky është një epitet që përdoret në shenjë respekti maksimal ndaj një personi që ka një integritet të lartë moral dhe dinjitet. Për ta lartësuar në statusin e privilegjuar të burrit, në Kanunin e Skënderbeut, në paragrafin 3359, thuhet se gruan me karakter të vendosur e thërrasin “*burrneshë*” (Ilija, F., 1993:209). Në përforcimin e normave morale për nderin e gruas ka luajtur rol edhe islami. Sipas sheriatit, faji i kryer kundër gruas, personit, nderit dhe reputacionit të saj ndëshkohet sikur të ishte kryer kundër një burri të familjes së saj (Topallgu, B., 1997:27).

Në Kanunin e Lumës, paragrafi 133 thotë se “gruaja e ka për detyrë t’i ruajë erzin burrit” (Hoxha, Sh., 2013:106). Ajo nuk duhet të tolerojë asnjë ngacmim që nëse ndodh, rëndon pozitën e saj. Gratë në zonat rurale, për të mos i marrë erzin burrave, nuk shkonin të kontrolloheshin as

tek mjekët. Për këtë dukuri, Zyhdi Dervishi shprehet se kjo mendësi ishte e përhapur edhe në periudhën e regjimit socialist:

”Për arsye të ndryshme kryesisht shoqërore, shumica e mjekeve femra e ushtronin profesionin në qytetet e mëdha. Ndërsa në qytetet e vogla periferike dhe krahinat e thella malore punonin mjekë të rinj, ndërkohë që në këto zona ishte mjaft imponuese mendësia fanatike se femrën e rritur nuk duhet ta prekë asnjë mashkull tjetër përveç burrit të saj. Nën trysinë e kësaj mendësie, në jo pak raste në krahinat fshatare më të prapambetura, burrat i linin gratë e tyre të vdisnin edhe nga sëmundje të shërueshme, ngaqë nuk mund të kapërdinin çburrërimin që do t’u vinte po t’ua vizitonte, pra po t’ua prekte mjeku gruan. Për mjaft burra të pashkolluar që banonin në zonat fshatare më të prapambetura ishte më e lehtë të pranonin vdekjen e bashkëshortes se afrimin e saj në distancën intime me mjekun, qoftë edhe në prani të bashkëshortit” (Dervishi, Z., 2008:424).

Për t’i ruajtur nderin burrit, kanunet ushtrojnë trysni edhe mbi prindërit dhe vëllezërit e gruas, të cilët janë të detyruar të zbatojnë normat kanunore për nderin e gruas. Edhe nëse dhunohet, gruaja nuk ka të drejtë të largohet nga burri, sepse normat kulturore kanunore ia mbyllin derën e shtëpisë së prindërve dhe ajo nuk ka se ku të shkojë. Madje edhe kur ajo ikën prej dhunës së të shoqit, prindërit kanë për detyrë ta kthejnë bijën e ikur mbrapsht tek bashkëshorti dhunues. Po qe se vajza martohet me dashuri, me një burrë që e ka zgjedhur vetë, Kanuni i Bendës i detyron prindërit e saj të mos e pranojnë më bijën në shtëpi, duke u shprehur “mos me pasë të hyme e të dalme me atë që e ka marrë dhe me e ba lanet të bijën” (Goci, H., 2010:50). Sipas kanunit të Bendës, prindërit mbahen përgjegjës nëse vajza nuk i bindet kodeve kanunore. Edhe sipas Kanunit të Lumës, prindërit janë të detyruar ta garantojnë zbatimin e kanunit me jetën e vajzës së tyre, sepse përndryshe turpërohen, “lëqiten prej vllaznie, bien në gjak, iu fiket nderi” (Ilia, F., 1993:114). Madje, kaq e panatyrshme është norma shoqërore, e shprehur në Kanunin e Lumës, paragrafi 183, sa i detyron prindërit të vrasin vajzën e tyre me plumbin që i japin burrit të saj ditën e martesës, përndryshe do vritet një nga djemtë e tyre për gjak nëse vajza ikën prej burrit (Ilia, F., 1993:114). Po qe se vajza vritet nga bashkëshorti ose

dikush tjetër, familja e saj kërkon pagesë nga vrasësi dhe jo gjak, sepse sipas Kanunit të Skënderbeut “gjaku i grues asht gjys gjaku burri, se gruaja nuk asht burrë” (po aty:114).

Çështja e nderit i ka penguar gratë të punësohen jashtë shtëpisë, me pretekstin se mund të ngacmohen seksualisht nga pronarët, drejtuesit, kolegët e njëjësive ku mund të punojnë dhe nga klientë meshkuj ose burra të panjohur. Njëra prej grave të anketuara, kur po bisedonte për mundësitë e punësimit për gratë brenda ose jashtë fshatit tregoi se ishte penguar prej familjarëve të burrit të punonte se mos e ngacmonin burrat: “Jemi hollshëm nga gjendja ekonomike se vetëm burri im punon dhe na mban 6 vetë. Për të pasur edhe një rrogë më shumë, unë i thashë tim shoqi që të më gjente një punë tek të njohurit e tij, çfarëdo të ishte: pastruese, pjatlarëse, ndihmëskuzhiniere, etj. Atij sikur iu mbush mendja, por kur pyeti prindërit e tij ata ia prenë shkurt se “nuk kanë vdekur burrat në shtëpinë tonë që të hamë nga duart a grave”. Ata e kundërshtuan edhe me justifikimin se po të shkoja në punë do më ngacmonin burra të panjohur dhe do çneroheshim si shtëpi, “më mirë me barkun thatë se sa pa nder” dhe kështu nuk më lanë të hyja në punë”.

Shkelja e normave kanunore i kushton familjes nderin pa të cilin do ta kishte të vështirë të jetonte në bashkësi, pasi do nëpërkëmbej dhe do t’i dilte nami i keq. Në familjet e gjera, me një numër të konsiderueshëm pjesëtarësh të rinj, cënimi i nderit do të thoshte pakësim i mundësive për t’i martuar ata dhe për të pretenduar kandidataë nga dyer të mira. Për të shmangur efektin shkatërrues të fjalëve të liga, familjet tregoheshin shumë vigjilente ndaj vajzave duke iu zhdukur pothuajse çdo mundësi për kontakte me meshkuj jashtë shtëpisë. “Në mendësitë e shoqërisë tradicionale shqiptare, fjala e ligë shponte si thikë zemrën dhe helmonte ndjenjat më të fisme, vriste si plumbi, si shpata e hapte varre, fjala e keqe priste çelik, rrëzonte male e përmbyste mbretër dhe, mbi të gjitha, fjala e ligë hapte plagë të pashërueshme, veçanërisht në botën e trazuar emocionale të individëve. Plagë të tilla dhimbnin shumë...” (Dervishi, Z., 2008:123). Vetëm me moshimin gruaja fitonte njëfarë statusi dhe nderimi në rrethin e burrave, sikurse shprehet Kanuni i Skënderbeut: “Me ardhë në rreth të burrave ndonjë grue e vjetër, sidomos po kje bijë a mikeshë, të gjithë çohen në kambë dhe i marrin dorën” (Ilia, F., 1993:115).

Pjesa më e madhe e paragjykimeve për sjelljen burrojnë nga normat kulturore tradicionale që e shohin gruan vetëm në rolin e shërbëtores. Gratë paragjykohen për mosbindje dhe për mosrespektim të zakoneve. Disa gra pohojnë se deri para disa vitesh i kanë larë këmbët vjehrrit dhe vjehrrës dhe se kjo praktikë ka qenë shumë poshtëruese për to. Kur gratë kanë

kundërshtuar të zbatojnë normat kanunore të larjes së këmbëve dhe zakone të tjera ato kanë hasur në fyrye, sharje dhe ndëshkime trupore nga familjarët e bashkëshortit. Gratë që kanë dashur të vazhdojnë shkollën janë penguar nga familjarët e burrit ose prej vetë atij me justifikimin se gruas së martuar nuk ka se çfarë i duhet shkolla, se gruas i duhen aq mend sa për të bërë punët e shtëpisë dhe t'u shërbejë të tjerëve. Pengimi për të vazhduar shkollën për gratë e reja ka qenë humbja më e madhe për to në martesë. Duke shpresuar se do të shkolloheshin, gratë e reja kanë menduar se do t'i shpëtonin rutinës mbytëse të punëve të rëndomta të shtëpisë dhe listës së gjatë të urdhrave të familiarëve të bashkëshortit dhe se do të bënin diçka të dobishme për veten e tyre; përmes arsimit do të mund të punësoheshin. Punësimi jashtë shtëpisë është parë si një “jelek shpëtimi” prej konflikteve dhe monotonisë shtëpiake.

Në fshat gratë vazhdojnë të paragjykoen se nuk përmbushin disa detyrime të përcaktuara në normat kulturore dhe të praktikuara tradicionalisht deri në ditët e sotme. Këto detyrime janë ngritja herët në mëngjes për kafetë dhe për të fshirë oborrin. Gratë e reja e kanë të vështirë të përshtaten me këto kërkesa që ato i konsiderojnë si të “dala boje” dhe e përkthejnë këmbënguljen e vjehrrës për të bërë këto detyra si prirje për t'i poshtëruar, për t'u treguar vendin si nuse ose për t'i lodhur qëllimisht që të venë autoritetin mbi të rejat. Gratë ankohen se janë nën urdhëra gjatë gjithë ditës dhe nuk kanë mundësi të pushojnë se u vjen turp të ulen pasi paragjykoen si përtace, se të tjerëve do t'u duket se ato nuk po bëjnë gjë, se nuk po sillen ashtu siç e do zakoni dhe njerëzit e shtëpisë. Madje disa prej tyre tregojnë se kur duan të ulen dhe të çlodhen ato qortohen si dembele dhe urdhërohen të çohen në këmbë dhe të qëndrojnë në këmbë gjatë gjithë ditës, se shtëpia ka punë plot dhe gruaja nuk ka leje të ulet.

5.3.9. Të paragjykuara si të paafta për punë në familjen e bashkëshortit

Paragjykimet për aftësitë zenë vendin e dytë, 19.3 për qind, tek shkaqet e paragjykimeve në martesë. Gratë e martuara pritët të shërbejnë mirë që ditën që hyjnë nuse në shtëpi të bashkëshortit Sipas opinionit shoqëror në fshat, ato kanë pasur gjithë kohën që u është nevojitur për t'u përgatitur për t'u bërë gra gjatë periudhës së vajzërisë dhe të fejesës. Një ndër kriteret kryesore për marrjen e gruas për nuse, përveç emrit të mirë të familjes, është edhe aftësia e saj për të kryer punë të rënda në fshat. Fiziku i shëndetshëm është një parakusht për t'u fejuar, pasi qëllimi i martesës është të punojë në shtëpi të bashkëshortit. Në përgjithësi jeta martesore e gruas

në fshat drejtohet nga normat kulturore tradicionale. Kanunet i përkufizojnë imtësisht detyrat e gruas së martuar. Në Kanunin e Bendës, në paragrafin me titull “Detyrat e gruas” thuhet: “Mrena shpije gruaja ka për detyrë të fshij, laj, pastojë shpinë; laj e shpëlaj, qepë e arnojë burrin e kalamajt; t’i lajë kamt burrave të shpis, miqve dhe grave më të mëdhaja në moshë dhe fëmijëve; t’u shtijë ujë për me la durt; t’u shtojë bukë e ujë sa herë ta kërkojnë; të çohet me gjelat e mëngjesit, të ndezi zjarrmin, t’i japë me ngranë fëmijve, të mbush ujë në kru, të shkojë në punë (Goci, H., 2010:19). Detyrat e gruas janë pothuajse të njëjta edhe në Kanunin e Skënderbeut, edhe në Kanunin e Lumës.

Megjithëse roli social i gruas në familjen fshtare është drejtpërdrejt i lidhur me punët e shumta brenda shtëpisë, gruaja punon edhe në ara dhe ruan edhe bagëtinë. Në normat kulturore shprehet qartë qëllimi i martesës dhe dobia që i sjell ekonomisë së familjes shtimi i një krahu pune. Në Kanunin e Skënderbeut, në paragrafin 1272, thuhet se “në shtëpitë e mëdha e me shumë rob kanë punë edhe gratë, sidomos punët që duen shumë krahë pune përnjiherë si shati, korra, zbardhja” (Ilija, F., 1993:91). Sipas kanunit të Bendës, “jashtë shtëpie gruaja punon në arë, mbjell e mif, mban dru e dushk, mbledh pemët e i çon me kosha në shpi, del n’pazar me leje të zotit të shpisë me ble enë për gjellë e basëm për rrobe; shet vezë, pula, djath e gjizë. Koshin e tërkuzën i ka në shpinë sa her del jashtë shtëpisë” (Goci, H., 2010: 18). Edhe pse kishte një peshë të madhe në ekonominë e familjes puna e gruas nuk llogaritej. Ajo nuk kishte të drejtë të shprehej për asgjë, as për vete, as për fëmijët që, sipas zakonisht, konsideroheshin të burrit.

Shumë prej punëve që numërohen në kanune vazhdojnë të jenë ende detyra të gruas së martuar dhe kryhen me të njëjtin ritual edhe sot, me përjashtim të disave. Ngrohja kryhet me dru zjarri, por gratë nuk shkojnë më në pyll për të mbledhur shkarpa e dru. Uji rrjedh në rubinetat e shtëpisë. Gatimi i bukës vazhdon të kryhet në shtëpi, sidomos kur gratë janë shtëpiake, por në fshat ka furrë buke dhe dyqane ku tregtohen mallrat e konsumit të përditshëm ushqimor. Shumica e grave e bëjnë bulmetin vetë sepse në fshat mbahen lopë për qumësht për të mbuluar nevojat ushqimore të familjes dhe teprica shitet tek banorët e fshatit që nuk kanë lopë në shtëpi. Për nënat e reja që punojnë në fshat ka kopësht fëmijësh. Veshmbathja blihet në njësitë tregtare dhe nuk prodhohet më nga puna e dorës me vegjë e furkë në shtëpi. Gjithësesi detyrat e tjera që nga punët e shtëpisë e deri punët bujqësore bëhen nga gratë.

Megjithëse gratë punojnë shumë në fshat, ato paragjykojnë për aftësitë e tyre. Shumë nga të anketuarat pohojnë se paragjykojnë si të paafta për të punuar brenda e jashtë shtëpisë. Njëra

prej të anketuarave u shpreh se gruas në fshat i vihet re gjithçka: “Unë jam martuar shumë e re se nuk shkova në shkollë, megjithëse në fshat njësoj ishte si të shkoje, si të mos shkoje në shkollë, sepse shkollimi nuk krijonte ndonjë privilegj për gratë brenda shtëpisë. Kur erdha nuse në shtëpi të burrit bëja punët që më thoshin. Punoja shumë, por nuk më thonin kurrë një fjalë të mirë. Rrinin të ngrysur dhe dukej se ishin të pakënaqur me punën time. Mundohesha shumë të krijoja përshtypje të mirë, por ishte e kotë. Në vend që të vlerësohesha, vjehrra dhe kunata më tallnin me ironi se nuk po bëja ndonjë gjë të madhe, se ato kishin bërë shumë më tepër sakrifica dhe këto punët që bëja unë ishin fare të zakonshme. Unë shkoja punoja tokën e milja lopën dhe vija e rraskapitur nga puna por asnjëherë një fjalë e mirë, përkundrazi më thoshin që për punë më kishin marrë e jo për të bukur. Përveç punëve në shtëpi e në arë, duhej të sillesha edhe si nuse zakoni në shtëpi, të rrija me tabaka në brez, të prisja e përcillja njerëz dhe të bëja kafetë që pa gdhirë për vjehrrin e për vjehrrën. Më duket se kam lindur nuse, u bënë 40 vjet që nusëroj, dhe prapë plaç. Jam lodhur shumë duke nusëruar”. Kjo histori tregon se sa të paragjykuara janë gratë edhe kur punojnë me devocion për të përmbushur funksionet e rolit shoqëror të gruas së martuar në fshat. Përveç lodhjes fizike nga punët e rënda ato janë të pavlerësuara, madje jetojnë për një kohë të gjatë nën stresin e shkaktuar nga mbikqyrja e rreptë që i mban ato në gjendje alarmi për të mos rënë pre e qortimeve, sharjeve dhe ndëshkimeve trupore.

Një grua tjetër tregoi se paragjykimet për aftësitë dhe konfliktet banale për punët e shtëpisë kishin shkatërruar martesën 10-vjeçare: “Kur u martova gjeta shumë njerëz në shtëpinë e burrit. Unë e dija rolin tim dhe punoja pa bërë zë. Në atë shtëpi, gjithçka pritej të kryhej nga unë, megjithëse edhe vjehrra ndihmonte nga pak, me gatimin kryesisht, por punët e tjera binin mbi shpatullat e mia, vetëm me të larë nuk ia dilja dot. Më shihnin si shërbëtore dhe silleshin shumë vrazhdë. Megjithatë, vjehrra dhe kunatat më përgojonin se doja të dukesh, se e bëja për të rënë në sy. Filluan të fryjnë me fjalë tim shoq dhe futën sherr mes nesh. Unë isha shumë e inatosuar me tim shoq që më thoshte të dëgjoja vjehrrën dhe kunatat. Ai shqetësohej për harmoninë në familje dhe ishte i pafuqishëm t’u mbyllte gojën atyre. Një ditë, kur njëri nga kunetërit rrëshqiti në dyshemenë e lagur të banjës, vjehrra me kunatat më qëlluan se unë nuk e kisha tharë banjën dhe për fajin tim u vra “gjithë ai burrë”. Kur erdhi im shoq, vjehrra i tha se më rrahën që t’i bëja mirë punët e shtëpisë. U largova nga shtëpia dhe kërkova divorc. Im shoq m’u lut të kthehesha, por unë nuk pranova”.

5.3.10. Të paragjykuara për veshjen në familjen e bashkëshortit

Veshja renditet e treta në rradhën e shkaqeve të paragjykimeve, 13.5 për qind. Në fshat ka dy qëndrime përsa i përket veshjes. Qëndrimi *i parë*, që mbështet veshjen tradicionale të gruas në fshat me pantallona, fund, bluzë me krahë të gjatë dhe shami në kokë, përfaqësohet nga një pjesë e banorëve vendas dhe të ardhur të cilët e mbajnë edhe vetë këtë veshje. Ndërsa, qëndrimi *i dytë*, që mbështet veshjen civile të stilit borgjez modern, mbahet nga të rejtat dhe nga një pjesa dërrmuese e grave nën të 45-sat. Vajzat dhe gratë e fshatit kanë mundësi të zgjedhin një larmi veshjesh nga garderoba që serviren në dyqanet e veshjes, madje vajzat e reja janë krejtësisht të konformuara me prirjet e modës. Veshja moderne i bën vajzat dhe gratë të bien pre e paragjykimeve në fshat. Paragjykimet më të shumta vijnë prej banorëve më të vjetër në moshë, sidomos grave të cilat dëshirojnë që nuset e tyre të mbulojnë kryet me rizëm (shami koke) dhe të mbajnë veshje tipike fshatare me ngjyrë të errët, me pantallona e fund dhe bluza me mëngë deri tek kyçet e duarve. Edhe një pjesë e grave dhe burrave më të rinj në moshë janë paragjykues për veshjen e grave që e konsiderojnë si të papërshtatshme për në fshat. Pre e këtyre paragjykimeve bien sidomos gratë e reja që, të ndikuara nga moda, përdorin veshje vajzërore edhe pasi janë martuar, si funde disi të shkurtra, bluza e fustane dekolte, zhapone, veshje të zbukuruara me xixa, përdorim aksesorësh, etj. Veshja është një simbol i rëndësishëm që flet për statusin e personit që e mban atë. Studiuesi i kulturës shqiptare, Zyhdi Devishi e ka analizuar në thellësi simbolikën e veshjes dhe shprehet:

“Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, të rinjtë e sidomos të rejtat i kushtojnë vëmendje të veçantë veshjes, përpiqen të kenë një garderobë të pasur, me veshje të modës së fundit... Në shoqërinë shqiptare janë mjaft të përhapura mendësitë se bukurisë së rinisë duhet t’i përgjigjet edhe bukuria e veshjeve. Përgjithësisht në kulturën shqiptare, sidomos pas Luftës së Dytë botërore, përkujdesi për një veshje sa më cilësore konsiderohet respekt për veten... Njeriu që nuk i kushton vëmendjen e duhur veshjes qysh në vitt e rinisë, shikohet si démodé pa e nisur jetën. Me kalimin e moshës, shqiptarët, madje edhe gratë, i kushtojnë gjithnjë e më pak kujdes veshjes. Shumica e pleqve dhe e plakave në vendin tonë kanë garderobë fare të varfër, me veshje përgjithësisht të prera e të qepura pa kujdes, me

*ngjyra të errëta, ndër të cilat mbizotëron kaffja e sidomos e zeza “
Dervishi, Z., 2008:190).*

Gratë e reja, por edhe ato në moshë të pjekur nuk e përkrahin më veshjen tradicionale fshatare për gruan. Ato mendojnë se veshja fshatare përfaqëson një kohë të shkuar kur njerëzit nuk kishin çfarë të vishnin. Ajo ishte e përshtatshme për punët në shtëpi e sidomos në arë, ku mbajtja e pantallonave dhe këmishave me krahë të gjatë luanin një funksion të rëndësishëm që ishte mbrojtja nga insektet dhe gërvishjet e bimëve të arës si misër, grurë e kultura të tjera bujqësore.

Edhe në shtëpi, për punët e pastrimit dhe larjes së dyshemesë është më e përshtatshme veshja e poshtme me tuta për të mos gërvishtur gjunjët në dysheme dhe për të mos ekspozuar pjesët intime të trupit, kur në shtëpi ka edhe njërëz të tjerë. Gratë mbajnë veshje të tillë në shtëpi, ato qëndrojnë me veshje të rehatshme për punë shtëpie si tuta, bluza sporti dhe veshje pambuku, të cilat i përdorin edhe për të punuar jashtë shtëpisë në parcela, vreshta dhe për të mjelë lopën. Gratë e reja thanë se për veshjen me tuta sporti kishin hasur kundërshtinë e familjarëve të bashkëshortit sepse tutat, u ekspozonin format e trupit dhe tërhiqnin vëmendjen e meshkujve të tjerë të familjes së bashkëshortit. Disa prej tyre ishin detyruar edhe t'i hiqnin tutat nga përdorimi, pasi veshja e tyre që etiketuar si provokuese nga bashkëshorti dhe familjarët tij, prandaj edhe ishin detyruar të vishnin pantallona dhe fund.

Por, paragjykimet më të mëdha shkojnë për veshjen që përdoret për të dalë jashtë shtëpisë, pasi ajo është edhe më shumë objekt vëshgimi prej syrit të banorëve të fshatit. Gratë tregojnë se veshja e tyre paragjykohet nga familjarët e bashkëshortit, të afërmit e tij dhe nga fqinjët. Ato pohojnë se, sa herë vishen, duhet të mendohen se çfarë reagimi do shkaktojë stili i veshjes së tyre tek njerëzit përreth. Betejën më të fortë me paragjykimet e kanë brenda mureve të shtëpisë, ku pengesë kryesore bëhet bashkëshorti dhe familjarët e tij. Njëra prej grave tregoi se si i shoqi ia kishte grisur fustanin sepse i ishte dukur dekolte dhe për shkak të qortimeve që nusja kishte marrë edhe nga vjehrra: “Kisha qepur një fustan të ri për të dalë, me grykën jakë libri, domethënë pak dekolte. Vjehrra më tha se ishte shumë i hapur. Fustani më këndontë në trup, por atyre iu duk shumë ekstravagant. Bashkëshorti, i ndikuar nga opinion i vjehrës e grisi, duke m’u hakërryer se: “do vishesh si të dua unë!”.

Veshja e grave gjykohej prej familjarëve të bashkëshortit për arsye se mund të jetë objekt diskutimesh në lidhje me moralin e gruas. Sipas familjarëve, veshjet moderne i ekspozojnë gratë e reja ndaj syve të burrave të panjohur dhe gratë mund të shndërrohen në viktima të ngacmimeve seksuale, duke çnderuar kësisoj edhe bashkëshortët. Për të shmangur konfliktet në të cilat mund të përfshihen burrat e shëpisë për shkak të thashethemeve dhe përgojimit të nderit të gruas dhe familjes, bashkëshortët dhe familjarët e tyre ushtrojnë kontroll të rreptë edhe mbi veshjet e grave. Grave u bëhet presion për t'u mbuluar sa më shumë. Ato tregojnë se urdhërohen sidomos prej vjerrave: “Mos i zbulo krahët! Mbulo kryet me lëvere (shami)!”. Paragjykimet për veshjen ishin shumë bezdisëse për gratë sepse kufizonin dëshirat e tyre për t'u veshur bukur dhe “sipas kohës”. Për shkak të paragjyqimeve për veshjen lindin konflikte të vazhdueshme mes grave dhe bashkëshortit e familjareve të tij.

5.3.11. Paragjykuar për mënyrën e komunikimit në familjen e bashkëshortit

Komunikimi është shkak i katërt në rradhën e paragjyqimeve dhe ze 12.1 për qind. Paragjykimet për komunikimin janë të shumta. Në kulturën tradicionale shqiptare, sidomos në atë fshatare, komunikimi i gruas rregullohej në bazë të normave kulturore kanunore që e kufizonin shumë komunikimin e saj me të tjerët. Gruaja e kishte pothuajse të ndaluar të komentonte detyrat dhe urdhërat që i jepeshin nga familjarët e burrit. Edhe komunikimi joverbal i gruas ishte shumë i kontrolluar, madje ajo edhe me bashkëshortin e kishte të ndaluar të komunikonte deri sa ishte nuse e re, dhe e tillë ishte për aq kohë sa nuk zëvendësohej nga një nuse më e re. Në kanunin e Bendës komunikimi mes bashkëshortëve të sapomartuar ishte i ndaluar: “Burri i sapomartue nuk flet me të shoqen para njerëzve të shtëpisë“ (Goci, H., 2010:19). Nusja e re nuk duhej të komunikonte as me shikim dhe as me mimikë. Në prani të burrave të rritur të shtëpisë ajo duhej të qëndronte në këmbë, me sytë ulur poshtë, në shenjë respekti dhe nëndshtrimi ndaj tyre. Qëndrimi trupor dhe sytë e ulur poshtë janë simbole të komunikimit joverbal që përcjellin statusin e nënrenditur dhe të poshtëruar të gruas si qenie inferiore në shtëpinë e bashkëshortit. Normat kanunore kanë ndikuar për një kohë të gjatë në komunikimin mes pjesëtarëve të familjes. Ndikimet e tyre ndihen ende tek banorët e fshatit. Sipas Kanunit të Lumës, paragrafi 48, pritet që “nusja të mbyllë edhe sytë edhe gojën në shtëpi të

burrit, mos me iu kthye fjalën vjehrrit e kunatis, me iu bindë të zotit e zonjës së shtëpisë” (Ilia, F., 1993:91).

Sipas normave kulturore tradicionale, gratë e reja nuk mund t’i thërrisin bashkëshortit në emër, por i drejtoheshin me terma që tregonin hierarki mes bashkëshortëve si “imzot”, “aga”, “zot”, etj. As gruaja nuk thirrej në emër. Ditën që martohet nusja merrte ermin e familjes së burrit dhe nuk thërritej më në emër të saj, por me emrin e burrit, “oj ti e filanit”. Studiuesi i kulturës Zyhdi Dervishi e ka përshkruar kështu këtë dukuri:

“Bashkëshortët e rinj, para dhe disa vite pas martesës, nuk flisnin me njëri-tjetrin në prani të të tjerëve, por komunikonin me gjeste të caktuara dhe lëvizje të pjesëve të trupit. Nusja e re, për një vit nuk nxirrte zë për të folur dhe merrej vesh me shenja. Kësisoj, duke qenë se traditat kulturore, ua hiqnin të drejtën e të bashkëbiseduarit në prani të të tjerëve, bashkëshortët e rinj detyroheshin të zhvillonin një repertor të pasur elementesh të komunikimit simbolik me njëri-tjetrin” (Dervishi, Z., 2008:359).

Gratë, në prani të familjarëve të tjerë, i drejtoheshin bashkëshortit me zë të ulët. Edhe etnografja Andromaqi Gjegji që ka vëshguar jetesën e banorëve në fshat, shprehet për gruan se “sa ishte e re, zakoni e ndalonte edhe të bisedonte me burrin në prani të tjerëve, qofshin këta edhe njerëz të familjes së tij. Me burrat e tjerë të familjes ajo mund të bisedonte vetëm në shtëpi dhe jo jashtë” (2002:235).

Një nga paragjykimet më të shpeshta, bazuar në normat kulturore, është se gratë e sotme nuk veprojnë më sipas traditës, ato nuk janë më si gratë e dikurshme që bindeshin, që mbyllnin sytë e gojën, që mbanin qëndrim gatitu, me sytë përtokë. Moskomformizmi i grave të sotme me normat kanunore përket si çthurje morale, si mosbindje ndaj rregullave zakonore dhe shkakton jo pak konflikte mes grave dhe personave të familjes së bashkëshortit. Gratë mundohen t’i kundërshtojnë këto norma, por ndeshin në murin e trashë të paragjykimeve përkundrajt të cilit përjekjet e tyre thyhen si krahë fluturash. Ato tregojnë se vihen nën një trysni të madhe për të mos kundërshtuar dhe as për të dhënë ndonjë opinion të tyre në familjen e burrit. “Gruaja duhet të bindet” është shprehja që e thonë thujtë të gjitha si refren. Kjo është përgjigja shabllon që iu jepet nga bashkëshorti dhe familjarët e tij, sa herë që ato provojnë të flasin. Kur ato mundohen ta


diskutojnë padrejtësinë e ketyre qëndrimeve prapanike me prindërit e vet, ato këshillohen të durojnë dhe të mos nxjerrin zë në shtëpi të burrit se çnderojnë veten dhe prindërit. Disa prej tyre pohuan se kur u është dashur të ndërhyjnë për çështje që kishin lidhje me ato vetë, si punësimi, shkollimi, veshja, punët e shtëpisë, të vizituarit e prindërve, etj., atyre iu është dhënë përgjigja: ”Pusho, mos fol se je e huaj këtu!”. Gratë nuk kanë mundësi të flasin as për veten e tyre, as për bashkëshortët dhe as për fëmijët, sepse familjarët i përmbahen privilegjeve që u ka siguruar norma kanunore në krahasim me gratë. Sipas Kanunit të Bendës “gruaja nuk ka tagër as me fol për vete e as mbi fëmi” (Goci, H., 2010:17).

Kur ka njerëz të tjerë në shtëpi, gratë nuk guxojnë të flasin as në prani të bashkëshortëve, sepse paragjyken se po flasin para burrit dhe poshtërohen më shprehje të tilla si: “kush të dha leje me fol”, “kush të kërkoi mend ty”, “ul kokën aty, mos fol, mos nxirr zë, mos kundërshto”, “nuk e kemi zakon të dëgjojmë gratë në këtë shtëpi”, “nuk kakarisin pulat tek ne se ua këpusim kokën”, “mëso rregullat tona, mos fol, mos na jep mend”, “mbylle gojën se nuk të kemi marrë për mend, por për punë”, “mos fol para nesh, veri mend punës dhe mbyll gojën”, etj. Është e vështirë që, në një mjedis ku bashkëjtohet me njerëz, komunikimi të jetë i njëanshëm, pra vetëm nga ana e familjarëve të bashkëshortit dhe gruaja të bëjë shurdh-memecen. Ka ndodhur që kurajoja për të folur është keqinterpretuar si mungesë respekti nga ana e nuses dhe guxim i tepruar i saj për të folur para personave të rritur në shtëpi.

5.3.12. Paragjykuar për kujdes të pamjaftueshëm për fëmijët në familjen e bashkëshortit

Kujdesi për fëmijët është një tjetër paragjykim që rëndon mbi gratë dhe ze 11.5 për qind të shkaqeve paragjykuese. Mëmësia është një moment fatlum për gruan në fshat. Në familjen patriarkale fshtare gruaja vlerësohet kur bëhet nënë. Lindja e fëmijëve, sidomos djem shoqërohet me gëzim të madh. Dikur lindja e djalit shoqërohej edhe me të shtëna pushke që ta marrë vesh i gjithë fshati se shtëpia u shtua me djalë. Ndërsa lindja e vajzës kalon në heshtje. Vajzën e pret një fat i vështirë sepse do bëhet grua dhe nga dhimbsuria për vuajtjet që do heqë në jetë si femër, për të “qajnë dhe trarët e shtëpisë”.

Numri i fëmijëve për nënë në përqindje



Shumica e grave kanë dy deri në tre fëmijë. Ato pohojnë se janë paragykuar si nëna, sikur nuk kanë ditur të kujdesen sa duhet për të vegjlit e tyre dhe sikur nuk kanë pasur njohuritë e nevojshme për të rritur fëmijë. Nënmat e reja, përveç dhënies së gjirit, nuk kishin kontakte të shpeshta me foshnjën, sepse për të kujdesej vjehrra. Andromaqi Gjergji, e ka konstatuar vetë këtë dukuri gjatë ekspeditave etnografike nëpër fshatra duke pohuar: “Nëna nuk duhet t’i jepte gji fëmijës në sy të të brenda shtëpisë. Ajo as duhet ta lante e ta vishte. Këtë punë do ta bënte vjehrra a një nga kunatat.” (Gjergji, A., 2002: 237). Me lindjen e fëmijës së dytë dhe të tretë, nënat lejoheshin të kujdeseshin vetë pasi kishin fituar njëfarë përvoja nga vëzhgimi i vjehrrës dhe kunatës më të madhe. Në fakt nënat nuk mund t’i përkëdhelin shumë fëmijët në sy të të tjerëve, sepse sipas traditës, po të përkëdhelen fëmijët llastohen dhe bëhen të pabindur ndaj autoritetit prindëror. Të mospërkëdhelurit dukej jo vetëm në mungesën e gjesteve ledhatuese, por edhe në distancën që ruhej mes pjesëtarëve të shtëpisë, qoftë edhe mes nënës dhe fëmijëve, ose mes burrit dhe gruas. Për mungesën e shprehjes së përkëdhelive mes anëtarëve të familjes, studiuesi Zyhdi Dervishi shprehet:

“Në shoqërinë tradicionale shiptare, distanca intime nuk funksiononte në mjedise publike për të shprehur ledhatimet dhe dashurinë, jo vetëm të të fejuarve, të bashkëshortëve për njëri-tjetrin, por as edhe të prindërve për fëmijët që kishin hyrë në moshën e adoleshencës. Në këtë shoqëri prindërit, gjyshërit, përgjithësisht të rriturit ishin mjaft të kuryser në përkëdheljen e fëmijëve të vegjël. Në këtë shoqëri ka qenë mbizotëruese mendësia se përkëdheljet e tepërta të prindërve për fëmijët e tyre,

veçanërisht për djemtë, dëmtonin shoqërizim e tyre me karakter të fortë, të domosdoshëm për të përballuar sfidat e rënda të jetës, deri dhe i nxisin ata drejt sjelljeve deviante e kriminale” (Dervishi, Z., 2008:421).

Gratë që nuk kishin lindur fëmijë gjatë viteve të para të martesës ishin përballur me fyrije të rënda si “mushkë, shterpë”. Ato kishin qenë shumë të stresuara, pasi ishin qesëndisur nga familjarët dhe të afërmit e bashkëshortit për shterpësi që nënkuptonte ndonjë difekt të gruas. Stresi që kanë përjetuar nga etiketime të tilla dhe sharjet e përditshme si qenie difektoze i kanë acaruar shumë ato, aq sa ato mendonin se nuk ngeleshin shtatzana pikërisht nga stresi dhe ngaqë e dëshironin me padurim të kishin fëmijë. Njëra prej tyre që tani ka katër fëmijë, prej të cileve dy janë binjakë, u shpreh se “Ankthi se nuk po mbetesha shtazanë në vitin e parë të martesës ishte mbytës aq sa nuk lashë vend pa shkuar për të gjetur derman për shtazaninë, ndërkohë që mjekët më thoshin që ishte normale të mos kisha fëmijë dy vitet e para të martesës, por më stresuese ishin fjalët e njërzëve të burrit se isha shterpë dhe se tim shoqi i kishte shkuar mundi kot me mua, se nuk do t’i jepja kurrë fëmijë. Kur lindi fëmijën e parë, vajzën, u gëzova shumë, sepse lindi, që do të thoshte se nuk isha shterpë. Por, njerëzit e burrit nuk u gëzuan shumë se “njëçikë gocë kisha bërë”, nuk i kisha gëzuar me një djalë të fortë. Më pas lindi djali dhe pas tij binjakët.”

Gratë që kanë fëmijë paragjykojnë se nuk dinë si t’i rrisin dhe t’i edukojnë. Ato fajësohen si gra të ngathëta që nuk dinë të bëjnë shumë gjëra njëherësh, ndërkohë që kujdesen për fëmijët. Për gratë e punësuar paragjykimet për rolin e mëmësisë janë edhe më të shpeshta; ato paragjykojnë se i lenë fëmijët pas dore në emër të karrierës. Njëra prej tyre tregoi se vjehrra kishte ngulur këmbë që ajo të mos kthehej më në punë, pasi kishte lindur, duke i thënë të birit se “nusja nuk ka më punë jashtë shtëpisë, të rrijë në shtëpi tani, të rritë këtë dhe të lindë fëmijë të tjerë”. Në fakt gratë e punësuar ndihen fajtorë që janë në punë dhe kanë fëmijë të vegjël për të rritur. Ato i bren ndërgegja se duke punuar u kanë hyrë në hak fëmijëve duke marrë nga koha e rritjes së tyre. Këtë ndjesi faji ia përforcojnë edhe paragjykimet në fshat për nënat e punësuar si nëna të papërgjegjshme. Atyre u vihet përballë shembulli i grave shtëpiake, si nëna shembullore, që kanë përparësi fëmijët dhe jo punën. Ato tregojnë se konfliktet me kunatat shtëpiake për mëmësinë janë të shpeshta, pasi kunatat u mburren se dinë të rrisin fëmijë më të mirë ngaqë rrinë me to, ndërsa fëmijët e nënave të punësuar “marrin rrugët”.

Megjithëse nuk kishin tagër mbi fëmijët e tyre, nënat konsiderohen si faktor i rëndësishëm shoqërizues për fëmijën nga normat kulturore kanunore. Në Kanunin e Lumës, paragrafi 48, thuhet se është detyrë e nënës ta ruajë “pjellën e vet prej së keqes” (Ilia, F., 1993:91). Me të keqe nuk nënkuptohen vetëm rreziqet që mund t’i kanosen fëmijës së vogël për jetën dhe shëndetin, por edhe sjellja e keqe, pra të mosmarrurit e një rruge të keqe. Nëna e edukon fëmijën se si t’i shmanget veseve morale dhe të bëhet njeri i virtytshëm. Pergjithësisht, edukimi i fëmijëve në shoqërinë shqiptare është kryer nga nënat, të cilat u kanë qëndruar më pranë fëmijëve se sa baballarët. Ato u mësonin rolet shoqerore edhe vajzave, edhe djemve. Sidomos vajzave, nënat u mësonin rolin e ardhshëm dhe pozitën e nënshtruar të gruas së martuar dhe i vinin që të vogla të bënin punë shtëpie e qëndisje. Andromaqi Gjergji ka shkruar:

“Mbi supet e gruas rëndonte plotësisht edukimi i fëmijëve që përmbli dhej në ushqyerjen, kujdesjen dhe shëndetin e tyre. Nënat duhet t’i mësonin vajzat të punonin, që në moshë fare të vogël, t’i stërvisnin për punët e shtëpisë. E tërë edukata familjare ishte e tillë që t’u ngulitej mirë në mendje vajzave se janë “derë e botës” ndërsa djemve të vegjël se “janë zot shtëpie”. Vajzat sa rrinë në shtëpi të babait kanë për detyrë të punojnë e t’u shërbejnë meshkujve të familjes edhe vëllezërve më të vegjël. As në shkollë nuk i shpinin fshatarët vajzat, por vetëm djemtë, deri para çlirimit (para vitit 1944 – M.P). Nuk ka ç’u duhet shkolla vajzave - mendonin fshatarët - djemve po, këta duhet të bëjnë hesape!” (Gjergji, A., 2002:237).

Nënat kanë një pozitë të privilegjuar në sytë e fëmijëve, të cilët i kanë parë ato të bëjnë shumë përpjekje gjatë përkujdesjes. Sikurse shprehet studiuesi Zyhdi Dervishi: “Gruaja si nënë kishte status mjaft të ngritur në raportet me vajzat dhe djemtë, qofshin këta edhe në moshë madhore, prindër a me fëmijë të rritur” (2008:372).

5.3.13. Origjina si shkak i paragjyqimeve

Edhe pse zënë një përqindje relativisht të vogël, 6.9 për qind, origjina krahinore dhe fshatare janë shkaqe për paragjyqimeve. Të paragjykuara për origjinën janë si gratë nga Farka,

ashtu edhe gratë e ardhura në Farkë, përmes martesës ose migrimit me familjet e origjinës. Gratë që janë nga Farka paragjyken për origjinën e tyre fshatare sepse janë nuse të ardhura nga fshatra të tjerë të komunës. Rregulli i ekzogamisë dikton që vajzat të mos martohen brenda fshatit, por jashtë tij, për arsye se njerezit brenda fshatit janë me lidhje gjaku. Komuna e Farkës ka gjashtë fshatra: Farkë e Madhë, Farkë e Vogël, Sauk Selitë, Lundër dhe Mjull-Bathore. Fshatrat kanë lagje që janë të organizuara në bazë fisi kryesisht, megjithëse vitet e fundit lagjet janë përzier me të ardhur që kanë blerë tokë për shtëpi nga vendasit. Në disa raste të ardhurit kanë krijuar edhe lagjet e tyre, siç janë lagja e kuksianëve dhe lagja e dibranëve. Nuset e ardhura nga fshatra të tjerë të Komunës Farkë paragjyken si të huaja, si fshatare. Çdo fshat pretendon se ka zakone më të mira se fshatrat e tjerë, se i ka qëndruar më besnik traditës, etj., për pasojë nusët e ardhura nga fshatrat e tjerë nuk kanë të njëjtin formim nënkulturor si banorët vendas. Gjithësesi nusët që vijnë nga fshatrat e komunës janë më pak të paragjykuara se ato që vijnë nga fshatra të tjerë fqinjë me komunën si për shëmbull nga fshatrat e Komunave: Petrelë, Dajt, Kashar, Pakuqan, etj. Nusët që vijnë nga pjesa e malësisë së Tiranës konsiderohen si të prapambetura, sepse malësia ka qëndruar e izoluar e pandikuar nga zhvillimet nënkulturore të pjesës kodrinore dhe fushore. Nusët nga malësia e Tiranës, sipas opinionit të vendasve, janë me më shumë fat që janë martuar në Farkë se kanë përfituar nga mundësi më të mira jete.

Më të paragjykuara për origjinën janë gratë që vijnë nga Veriu i Shqipërisë, nga Kukësi dhe Dibra, që janë dy komunitetet mbizotësuese të të ardhurve. Nëse gratë nga Tirana paragjyken kryesisht për origjinën fshatare, gratë e ardhura nga veriu paragjyken për origjinën krahinore. Gratë veriore në fakt jetojnë në komunitete të mbyllura të bashkësisve të tyre të migruara, të stabilizuara me banim në Farkë përgjatë këtyre 20 viteve të fundit. Gratë e ardhura paragjyken si të paqytetëruara, sepse nuk kanë pasur kontakte të hapura me vendin dhe nëkulturat e tjera, për shkak të izolimit malor dhe atij infrastrukturor, që pamundësonte lëvizjen e njerëzve. Gratë e ardhura nga Kukësi dhe Dibra thirren shpesh me nofkën përcmuese “maloke”, për t’i dalluar nga pjesa tjetër e popullsisë vendase. Në 20 vite bashkëjetesë, këto mendësi denigruese janë ende të pranishme ndër banorët vendas. Më shumë paragjykimet për origjinën krahinore i vuajnë vajzat e ardhura, që janë martuar me djem nga Farka, të cilat përballen përditë me sulme denigruese për origjinën krahinore në shtëpinë e burrit dhe prej fisit të tij. Më e mprehtë bëhet situata denigruese kur këto nuse tallen për dialektin verior. Ato përballen me fryerje të tilla si: “fol shqip; mëso shqip; ti do përkthyes që të marrim vesh”.

Siç duket edhe nga të dhënat e anketimit, paragjykimet për origjinën edhe pse nuk janë në vend të parë janë shumë shqetësuese për natyrën denigruese të tyre. Paragjykimet bëhen shkak që banorët vendas t'i trajtojnë gratë me origjinë të ndryshme nga e tyre si më pak të edukuara, si më pak të zonjat për punë, si të paditura për zakonet e fshatit, si më të ulëta në rangun e hierarkisë nënkulturore. Sa më e largët origjina fshatare dhe krahinore e grave, aq më të paragjykuara janë ato.

5.3.14. Të paragjykuara për cilësitë fizike

Cilësitë fizike zenë vendin e fundit në shkaqet e paragjykimeve kundër grave, 4.8 për qind. Kjo përqindje relativisht e vogël paragjykimesh për cilësitë fizike nuk do të thotë se banorët e Farkës nuk janë të interesuar për pamjen estetike të grave, përkundrazi ata janë dhe këtë e tregojnë përpjekja që bëjnë gratë të vishen bukur. Por, në fshat, tipari fizik që çmohet më shumë është shëndeti që duhet për të bërë punë fshati. Prandaj, fshatarët janë më të interesuar për fuqinë fizike që parathotë aftësitë për të bërë punë të rënda se sa për delikatësen femërore që më shumë shikohet si dobësi fizike se sa si shije estetike. Një grua, që vinte shumë e hajthme nga fiziku, tregonte se nuk kishte si vinte shëndet prej lodhjes fizike në shtëpi dhe punë “Punoj aq shumë sa nuk më del koha as për të ngrënë, e as për të fjetur; fshati ka shumë punë, nga nusja pritet të bëjë gjithçka ose shumicën e gjërave. Vjehrra më ndihmon me fëmijët, ajo i sheh për të ngrënë kur unë jam në punë. Unë ngrihem e para dhe bie e fundit, pasi kam bërë gjithë punët, kam gatuar për të nesërmen, kam mbushur ujë, kam larë rrobat dhe fëmijët... Jam trupvogël dhe e zbehtë prandaj shtëpia dhe fisi i burrit më paragjykojnë si të sëmurë, shëndetligë. Edhe punët m'i venë re, sepse nuk besojnë se mund t'ja dal me këtë trup të pakët. Do doja edhe vetë të isha më e shëndoshë, por nuk e kam në dorë.”


Edhe pse pëlqehet shëndeti, femrat mjaft të shëndosha nuk para pëlqehen. Edhe ato janë objekt sulmi paragjykues dhe etiketohen me fjalë përçmuese. Gratë mbipeshë paragjykohen si të pazonjat të kujdesen për trupin e tyre dhe si gra pa vullnet “për t'i vënë fre gojës”. Një grua që kishte lindur disa herë dhe që kishte marrë shumë peshë u shpreh: “Të qenët më barrë më është bërë si trup i dytë, por njerëzit e shtëpisë dhe të afërmit e burrit me hedhin fjalë fyese ndonjëherë në sy, ndonjëherë pas krahëve. Më vjen shumë keq që më shajnë, por më ngushtë ndihem kur venë edhe fëmijët kundër meje të më shajnë me fjalorin e tyre për shëndetin e tepërt”. Megjithatë

gratë përleqet të jenë të bukura, për banorët e fshatit rëndësi ka që ato të jenë estetikisht të pranueshme. Kriter kryesor për cilësitë fizike nuk është pamja por shëndeti i mirë për të përballuar ngarkesën e punëve të shumta dhe të rënda në fshat nga ku vjen edhe shprehja: “Gruas mos i shif hunën, por punën!”.

5.3.15. Të paragjykuara në disa fronte njëherësh në familjen e bashkëshortit


Gratë sulmohen nga disa fronte paragjykimesh njëherësh: 60.5 për qind e paragjykimeve vijnë nga familjarët e bashkëshortit, 14.5 për qind nga të afërmit e bashkëshortit, 7.8 për qind nga bashkëshorti dhe 6.1 për qind nga fqinjët. Siç tregojnë edhe të dhënat e anketimit,, gratë paragjykohen më shumë prej familjarëve të bashkëshortit se nga grupe të tjera njerëzish. Familjarët janë në kontakt të vazhdueshëm me gratë, pasi këto ose bashkëjetojnë me ta në një shtëpi ose kanë bashkëjetuar më parë.

Paragjykar më shumë në familjen e bashkëshortit



Familjarët e bashkëshortit janë shumë të pranishëm në jetën e gruas në fshat, sepse jeta në fshat është e organizuar në mënyrë të tillë që të afërmit jetojnë në afërsi të njeri-tjetrit. Shtëpitë e zjarrmit (barku) - që përbëhen nga fëmijët e lindur prej një nëne e babai – qëndrojnë të bashkuara derisa të rriten bijtë, të martohen dhe të dalin më vetë. Ata ndëtojnë shtëpi ngjitur me shtëpinë e zjarrmit, pra shtëpinë e prindërve, dhe krijojnë vëllazëritë. Disa vëllazëri formojnë një lagje (mëhallë) dhe me rritjen e numrit të familjeve të të një trunq formohet fisi që popullon një

katund, që përdoret rëndom në gjuhën popullore në vend të fjalës fshat që ka hyrë në përdorim vetëm pas çlirimit (Gjergji, A., 2002). Gruaja e martuar është e rrethuar nga familjarët e bashkëshortit dhe të afërmit e tij. Bashkëjetesa dhe komunikimi i përditshtshëm me familjarët e bashkëshortit i ekspozon gratë më shumë ndaj paragjytimeve të tyre. Ndërsa, ndërveprimet me të afërmit janë më të rralla, në raste vizitash dhe ceremonish familjare. Të afërmit janë më pak paragjykuar, sepse kanë më pak kontakte me gratë e fisit, se sa kanë familjarët e bashkëshortit.



5.3.15.1. Paragjykuar në fejesë

Gratë pohojnë se në fejesë janë paragjykuar më shumë nga familjarët e bashkëshortit 68.5 për qind se sa nga të afërmit e tij 27.3 për qind. Është e kuptueshme se përse niveli i paragjykit ka qenë më i lartë tek familjarët e bashkëshortit që janë prindërit, motrat dhe vëllëzërit e tij se sa tek të afërmit e bashkëshortit. Nusja e ardhshme do t'i shtohet shtëpisë së bashkëshortit dhe jo të afërmeve të tij, prandaj është e logjikshme që interesimin më të madh për të ta kenë familjarët dhe jo njëri prej të afërmeve. Të afërmit preken në mënyrë të tërthortë prej krushqisë që bën një pjesëtar i fisit të tyre dhe kanë edhe ata një interes në gjetjen e një kandidateje të mirë për nuse për të afërmin e tyre. Vërtetë nusja e ardhshme do t'i shtohet si krah pune njëri prej të shtëpisë së burrit,

por mirëqenia materiale e shtëpisë së saj ka njëfarë rëndësie edhe për fisin, i cili ka përgjegjesi për të ndihmuar pjesëtarët e vet dhe shtëpitë e tyre kur ata nuk kanë mirëqenie të mjaftueshme. Prandaj, gjetja e një nuseje të përshtatshme për nevojat ekonomike të familjes ka rëndësi edhe për fisin.

Nusja e ardhshme nuk do t'i shtojë vetëm krahun e vet të punës ekonomisë familjare të bashkëshortit, por do shtojë edhe krahë të tjerë me lindjen e fëmijëve. Prandaj, nuses se ardhshme i shihet mirë familja e origjinës dhe shëndeti i të afërmeve. Këto cilësi të familjes dhe fisit të nuses janë tregues që parathënë se sa mirë do ta përmbushë funksionin riprodhues nusja, a do lindë ajo fëmijë të shëndetshëm që do jenë krah punë për shtëpi nesër apo jo? Të afërmit e bashkëshortit, sikurse edhe familjarët, interesohen shumë për këto cilësi të nuses, pasi synojnë që të bëhet një zgjedhje sa më e dobishme për ekonominë e familjes dhe mirëqenien materiale të fisit në përgjithësi.

Gjithashtu, paragjykimet në fejesë nuk prekin vetëm cilësitë e vajzës që do të fejohej, por edhe emrin e familjes së saj. Përgjithësisht, nga reputacioni që ka familja varet edhe vlera e krushqisë. Një familje me reputacion të mirë mendohet të ketë edukuar fëmijë të mirë dhe vajza do ketë vetitë e kërkuara nga familja e bashkëshortit të saj. Një rëndësi parësore në vlerësimin e familjarëve të nuses merr nëna e saj, prej nga ku rrjedh edhe shprehja “copës shifi anën, gocës shifi nanën”. Nëse nëna e saj gëzon një emër të mirë, atëherë edhe vajza do jetë një kopje e mirë e saj dhe krushqia ja vlen të bëhet.

Mendojnë se bashkëshorti është më pak paragjykes në fejesë 4.2 për qind e të anketuarave. Ndërsa në martesë burrat janë më paragjykes. Kështu janë shprehur rreth 14.2 për qind e të anketuarave. Në fejesë, bashkëshorti ai është akoma në stadin e njohjes dhe duke eksploruar shoqen e jetës. Si të fejuar ata nuk njihen ende mirë, aq më tepër që ata nuk konsumojnë shumë kohë bashkë, përveçse disa daljeve me leje të prindërve të vajzës dhe disa vizita në shtëpinë e tij me kërkues të prindërve të vet. Edhe vajza e fejuar nuk është vënë ende në rolin social të gruas gjatë periudhës së fejesës dhe personaliteti i saj nuk ka si të shfaqet i plotë nëpërmjet disa takimeve të që nuk zgjasin shumë.

5.3.15.2. *Paragjykuar në martesë*

Martesa e sjell gruan në shtëpinë e bashkëshortit që bëhet edhe banesa e re e saj, ku mund të kalojë pjesën më të madhe të jetës së saj. Në shtëpinë e burrit, nusja bëhet pjesëtare e familjes së tij. Që në fejesë familjet e të fejuarve kanë deklaruar se tani ata u bënë një shtëpi, përmes miqësisë së lidhur me fejesën e fëmijëve të tyre. Në martesë, gruaja, bashkëshorti dhe familjarët e tij janë në një marrëdhënie shumë më të ngushtë se sa në fejesë. Gjatë bashkëjetesës me gruan, familjarët e bashkëshortit kanë mundësi të konfirmojnë paragjykimet dhe hamendësimet mbi karakterin dhe sjelljen e saj. Gratë janë ndër të thuajse njësoj të paragjykuara nga familjarët e bashkëshortit në martesë, 65.4 për qind, pothuajse sa edhe në fejesë, 68.3 për qind.

Paragjykimet në martesë janë të një natyre tjetër nga paragjykimet në fejesë. Nëse në fejesë, familja e djalit interesohej për familjen e vajzës, më shumë se sa për vajzën, për të lidhur një krushqi të mirë, në martesë ajo që vihet në shënjestër të paragjykimeve është vajza si grua e martuar tashmë, e cila vihet në provë për të vërtetuar nëse krushqia ja ka vlejtur apo jo, pra gruaja e martuar tregon edhe vlerën e familjes së saj. Paragjykimet në martesë përkundrejt grave bëhen më shumë në drejtim të sjelljes dhe shkathtësisë për punë. Këto kanë qenë edhe kriteret mbi të cilat nusja është marrë, shëndeti i mirë për të punuar dhe sjellja e mirë për të duruar. Sikurse thuhet edhe në Kanunin e Bendës: "Gruja e mirë nuk qet za" (Goci, H., 2010:49). Paragjykimet ushqehen nga tradita kulturore, sipas së cilës gruaja duhet të durojë shumë dhe shërbejë mirë. Gratë e sotme mund të mos i përmbushin krejtësisht këto pritshmëri të familjarëve të burrit, sado të sjellshme dhe punëtore të jenë. Ato nuk mund të sakrifikojnë personalitetin e tyre për hir të normave të lindura në shekujt e kaluar dhe që i vendosin gratë në pozitë shumë inferiore në familje, më të ulët edhe se të një fëmije, megjithë zbatimin e tyre deri pak dekada më parë. Prandaj, gratë paragjykohen si për sjelljen ashtu edhe për aftësitë e tyre për të shërbyer me përpulësi nën urdhërat e familjarëve të bashkëshortit.

5.3.15.3. *Paragjykuar si nëna*

Gratë janë paragjykuar më shumë kur kanë qenë nuse të reja sa pa patur fëmijë. Gjatë kohës që janë bërë nëna ato janë paragjykuar më pak, 50.0 për qind, pasi duket se e kanë plotësuar edhe pritshmërinë e familjarëve për të lindur fëmijë. Deri në momentin e lindjes së

fëmijës gruaja nuk ka kurrëfarë vlerësimi si qenie njerëzore në familjen e burrit. Fëmija i jep asaj njëfarë vlerësimi që lidhet me aftësinë e saj për të shtuar shtëpinë me fëmijë që do jenë krahë pune për ekonominë familjare kur të rriten.

Megjithatë, edhe kur bëhen nëna, gratë nuk i shpëtojnë sulmeve paragjykuese që vijnë nga famijarët dhe të afërmit e bashkëshortit. Ato paragjykojnë se nuk kanë shprehitë e duhura për t'u përkujdesur, për të rritur dhe për të edukuar fëmijët. Sidomos për fëmijën e parë ato edhe nuk lejohen të përkujdesen shumë, pasi vjehrra përkujdesjet më shumë për foshnjën. Për fëmijën e parë nëna paragjykohet si krejtësisht e paditur dhe e paaftë të merret me larjen dhe veshjen e foshnjës, gjë që është pjesërisht e vërtetë, pasi ajo nuk ka qenë nënë më parë. Gratë ndihen disi të frustruara që nuk e shijojnë sa duhet mëmësinë për fëmijën e parë. Ato vihen të bëjnë çfarëdolloj punësh, përveçse të merren me fëmijën. Lindja e fëmijës së dytë nuk e privon më nënën nga përkujdesja, pasi nëna konsiderohet si më me përvojë nga lindja e parë.

Gratë pohojnë se ato paragjykojnë edhe si të dhunshme ndaj fëmijëve të vegjël, sidomos nga vjehrrat. Një grua e përmbloodhi në mënyrë shumë lakonike përjetimin e këtij paragjykimi: “Kur u bëra me fëmijë, u gëzova shumë dhe përpiqesha t'i mbaroja punët shpejt që të merresha me të. Ishte sfilite të punoje gjithë ditën në shtëpi dhe në punë dhe në darkë të mos flije se djali qante shumë natën dhe duhej ushqyer me gjë e duhej ndërruar. U bëra si njeri i kotë për tre vjet nga mungesa e gjumit, nuk përqendrohesha dot dhe dremisja në këmbë. Ditën, kur isha në punë, me djalin merrej vjehrra, por kur vija nga puna merresha edhe me punët e shtëpisë edhe me përkujdesin për fëmijën edhe me gatimin. Kur djali u bë tre vjeç, sikur u qetësua dhe nuk më shqetësonte më natën, por ma beri ditën natë se ishte shumë i prapë dhe më duhej ta gjurmoja nga pas, që ta ruaja se mos vritej. E lodhur tej mase nga punët dhe e pafuqishme për ta ndjekur, unë e shaja ose i fusja ndonjë dackë syve. Vjehrra, kur më shihte që i bërtisja dhe qëlloja djalin thërriste me sa kishte në kokë: “Mos e prek djalin. Ah kur të dha zoti fëmijë ty! Ku di ti c'është nëna! Po ku je nënë ti moj, katile zemërzezë! Dhe ma rrëmbente djalin nga duart duke vazhduar të më shante si nënë e padenjë. Historia nuk mbyllet këtu. Ajo do t'i raportonte tim shoqi dhe tim vjehri që kisha rrahur djalin dhe m'i ndërsente edhe ata kundër. Kujt do që takonte nëpër fqinj e të afërm do t'i ankohej për pazotësinë time për të rritur një fëmijë dhe për fatin e pamërituar të isha nënë”.

5.3.16. Paragjykuar nga fqinjët

Fqinjët janë pak të përfaqësuar në shkallën e paragjykuesve, jo se nuk paragjykojnë, por sepse kanë distancë shoqërore më të largët me gratë, krahasuar me familjarët e bashkëshortit. Gjithashtu, një pjesë e fqinjëve janë të afërm të bashkëshortit, vëllazëri ose kushurinjtë të parë, prandaj nuk ka shumë prani fqinjësh të huaj. Kjo është edhe një arsye se përse fqinjët dalin me një shifër të ulët përfaqësimi në shkallën e paragjykimeve për gratë. Fqinjët nuk shfaqin edhe aq paragjykime ndaj grave gjatë kohës së fejesës dhe martesës pasi ata nuk i njohin nuset që vijnë nga fshatra të tjerë dhe nuk mund të informohen mbi jetesën e grave brenda mureve të shtëpisë, kur këto janë të martuara. Por, fqinjët janë paragjykuar për aftësitë përkujdesëse të grave për fëmijët dhe sidomos për edukimin e tyre. Fqinjët kanë mundësi të kenë kontakte me fëmijët e njëri-tjetrit, pasi fëmijët në fshat ndajnë shumë kohë me njëri-tjetrin, jashtë shtëpisë dhe luajnë në oborret dhe kopshtet e shtëpive të njëri-tjetrit. Duke e vëzhguar sjelljen e fëmijëve nga afër, fqinjët kanë mundësi të informohen se si janë edukuar ata dhe duke qenë se rolin parësor në edukim e luan nëna, nëse fëmijët nuk sillen sipas normave të lejuara atëherë për sjelljen e tyre të papëlqyeshme fajësohen nënat. Meqë fëmijët nuk kanë korniza të ngurtësuara sjelljeje e paragjykimesh, ata rrinë lirshëm në shtëpitë e njëri-tjetrit, ku edhe mund të ushqehen, luajnë, shohin filma, ndojëherë edhe të flenë. Gjatë këtyre vizitave fqinjët shohin se si qëndrojnë fëmijët në tryezë, mënyrën se si ushqehen, higjenën personale dhe kujdesin vetjak për të, etj. Duke vëzhguar sjelljen e fëmijëve, fqinjët vlerësojnë aftësinë e nënave për t'i edukuar.

Komunikimi është një tjetër aspekt, për të cilin fqinjët i paragjykojnë gratë. Në fshat, është rregull të komunikohet dhe përshëndetet me gjithësecilin, madje edhe me të panjohurit. Të njohurit në fshat, përgjithësisht tregojnë edhe një interesim të shtuar përkundrejt tjetrit, duke e pyetur për shëndetin personal, për atë të njerëzve të shtëpisë, për rritjen e fëmijëve, për ecurinë e të mbjellave, etj. Nëse një grua nuk qëndron gjatë dhe të kryejë ceremonialin e shkëmbimit të informacionit dhe ta pyesë tjetrin për të njëjtat gjëra, atëherë ajo paragjykohet si mendjemadhe dhe mospërfillëse, në rastin më të mirë, dhe si e paedukatë dhe “pa tabiate” (pa zakone të mira) në rastin më të keq. Gratë që ishin e etiketuar si të tilla u munduan të jepnin një sqarim se përse kishin rënë pre e etiketimit të fqinjëve. Ato u shprehën se procedura e dhënies dhe marrjes së informacionit të ndërsjelltë për shtëpinë e njerëzinë është e zgjatur dhe e përsëritur. Sipas tyre, është fare e kotë ta pyesësh tjetrin përditë, ndonjëherë edhe dy herë në ditë, për të njëjtat gjëra.


Aq më tepër, që një informacion i tillë nuk kishte ndonjë rëndësi për jetën e tyre dhe e konsideronin një “adet për të larë gojën” madje disa herë ishte edhe hipokrizi nga ana e fqinjëve, kur bënë sikur interesoheshin. Me sa duket, pyetje të tilla, të përsëritura shpesh dhe pa ndonjë informacion të ri, i bezdisnin gratë që nuk kishin kohë të tepërt për të tjerë biseda pa vlerë, që nisnin si një përshëndetje dhe përfundonin në thashetheme për të tjerët.

Gratë e dinin që nga fqinj të tillë, edhe ato përgojoheshin njësoj, sapo të kthenin shpinën dhe vendin e tyre ta zinte një grua tjetër. Njëra prej grave gjatë një bisede për paragjykimet e fqinjëve tregoi se “Sa herë hapja portën e shtëpisë, në portën tjetër ja behte fqinja që bënte sikur po dilte kot për të parë rrugën! Pas kurrizit të saj ja behnin edhe dy a tri fytyra të tjera grash. Fqinja më përshëndeste dhe unë gjithashtu, dhe pastaj fillonte të më pyeste si kishim fjetur e si ishim gdhirë, a ishim të gjithë mirë, a shkonte gjithçka mirë nga toka, çfarë kishim mbjellë, çfarë kishim korrur, a kishim shitur, sa kishim fituar, etj. Më dukej vetja si në kuesturë. Po kulmi ishte kur më merrte në pyetje se ku po shkoja, sa do rrija dhe kur do kthehesha. Një ditë nuk m’u durua dhe iu ktheva ”Ikja dihet, ardhja s’ dihet”. Mendova se do e kuptonte mesazhin e përgjigjes sime, por ajo hiç., vazhdonte të më pyeste për qëllimin e daljes sime nga shtëpia dhe se kë do të takoja. Me një fqinjë të tillë si zor ta shtysh mirë dhe do biesh patjetër pre e gjykimit therës dhe fjalëve shpotitëse si “fodulle, noprane, hundpërpjetë, katundare” që unë i mësoja nga fqinjtat e tjera të cilave ajo u çonte çdo informacion që merrte nga unë dhe nga ndonjë tjetër”.

5.3.17. Paragjykuar më shumë nga vjehrra

Meqë familja e bashkëshortit është në vendin e parë për paragjykimet kundër grave, u pa e udhës që të analizohen më imtësisht personat më paragjykues në familje dhe arsyet që qëndrojnë pas këtyre paragjykimëve.

Cili ka paragjykuar më shumë në familjen e bashkëshortit?



Siç duket edhe nga të dhënat e anketimit, vjehrra është personi më paragjykuar në familje, kundrejt gruas. Kështu janë shprehur 42.0 për qind e të anketuarave. Kjo ndodh për arsyen se nusja ka vartësi të drejtëpërdrejtë nga vjehrra dhe është në kontakt më të ngushtë me të, përse i përket angazhimit me punë shtëpiake. Nusja merr urdhërat nga vjehrra për punët që do bëjë dhe vlerësohet prej saj nëse i ka kryer mirë apo jo. Tensioni vjehrrë-nuse është i dukshëm nga të dhënat e anketimit. Ai shpreh luftën për pushtet brenda gjinisë. Gratë nuk konkurojnë për pushtet me burrat në familje, kundrejt të cilëve ato kanë të gjitha një pozicion inferior, por konkurojnë mes njëra-tjetrës, megjithëse nusja është në pozita më inferiore ndaj vjehrrës për disa arsye. *E para*, vjehrra është zonjë shtëpie, ndërsa nusja konsiderohet e ardhur; *e dyta*, vjehrra është më e moshuar se nusja dhe statusin ia jep edhe moshja, jo vetëm roli social; *e treta*, vjehrra është nëna e bashkëshortit dhe ka një pozitë të privilegjuar në raportet me djalin e vet, të cilin mund ta influencojë kundër nuses; dhe *e katërta*, vjehrra ka pavarësi nga nuset, ndërsa nuset kanë varësi nga vjehrra dhe i japin asaj llogari, e për më tepër, vjehrra mban përgjegjësi vetëm ndaj të zotit të shtëpisë, që është thujse gjithmonë i shoqi dhe me përjashtime shumë të rralla mund të jetë edhe djali i saj i madh, mbi të cilin mund të ketë edhe më shumë pushtet. Në luftën për pushtet me vjehrrën, nga pikpamja e normave kulturore kanunore për vjehrrën si zonjën e shtëpisë dhe si mbikqyrëse e nuseve, nusja e ka të humbur betejën që në fillim. Aq më tepër, që nusja është e ardhur dhe personi i vetëm që mund të ketë në krah mund të jetë i shoqi, nëse nuk ndikohet shumë nga e ëma dhe familjarët e tjerë.

Vjehrra si zonja e shtëpisë qëndron përtej pozicionit të zotit të shtëpisë, që është vjehrra, autoriteti i të cilit është i padiskutueshëm. Vjehrra si gruaja më e vjetër dhe zonja e shtëpisë drejton gjithë punët brenda shtëpisë dhe garanton që të gjitha gratë e tjera t'i binden vullnetit dhe autoritetit të zotit të shtëpisë. Në traditën kulturore, “zonja e shtëpisë u ndante punët grave dhe i mbikqyrte” (Gjergji, A., 2002:48). Në kanunin e Bendës, zonja e shtëpisë quhet amvisë dhe është gruaja më e madhe për nga mosha që drejton gratë e shtëpisë dhe me vdekjen e saj zonjë shtëpie bëhet nusja e djalit të parë. Kur amvisa nuk është e zonja të drejtojë, në vend të saj vihet një me re. Amvisa nuk bën punë jashtë shtëpisë sepse, sipas Kanunit të Bendës, asaj “nuk i përket as bulera, as shati e as tërkuzat” (Goci, H., 2010:19). Brenda shtëpisë, vjehrra kujdeset për fëmijët, kur gratë janë në punë, në arë, e në pyll për të mbledhur shkarpa dhe ndihmon në punët e shtëpisë. Amvisa urdhëron gratë të bëjnë punët e shtëpisë, të gatujnë, lajnë, pastrojnë, të mbushin ujë, të mbajnë dru dhe të punojnë kopshtin. Amvisa pret miq kur nuk ka mashkull në shtëpi. Ajo përgjigjet para zotit të shtëpisë për çdo gjë. Edhe sipas kanunit të Lumës, paragrafi 41, “shpin e mban grueja ma e vjetër që asht zoj shpie, e cila urdhëron nuset për punë e i mëson “granimin” (si të përmbushin rolin e gruas) dhe “cullnimin” (si të prindërojë). Ajo urdhëron nuset për përgatitjen e ushqimit (zënien e bukës dhe bulmetit) dhe ndarjen e tij, për ndezjen e zjarrit dhe punët jashtë shtëpisë. Vjehrra u prin nusesve kur shkojnë tek farefisi i tyre. Vjehrra nuk ka të drejtë të verë dorë mbi nuset dhe as t'i lerë pa ngrënë” (Hoxha, Sh., 2013:92).

Gratë pohojnë se vjerrat janë shumë paragjyqese për sjelljet e tyre. Ato presin që nuset të kryejnë ritualet zakonore të përshkuara në kanune, por kjo gjë kontestohet nga nuset. Vjerrat i paragjykojnë gratë sidomos për mungesën e gadishmërisë për t'u përshtatur me përcaktimet kanonore që kërkojnë nga nuset shumë mundim për të qëndruar gjithë ditën në këmbë për të bërë punë shtëpie, punë në kopësht e arë dhe për të pritur e përcjellur njëri-tjetër. Megjithëse në fshat dera rri hapur për vizita dhe nuset janë gjatë gjithë kohës duke u shërbyer, siç e do zakoni, me pije, qerasje e kafe, vjerrat ankohen se nuset nuk janë të shkathëta dhe nuk bëjnë dot disa punë njëherësh. Gratë e paragjykuara shprehin se “vjehrrat presin prej tyre që ato të jenë supergra, të kryejnë dhjetra funksione njëherësh”. Njëra nga gratë e përmbloodhi fare shkurt ditën e saj të zakonshme dhe pakënaqësinë e vjehrrës ndaj saj, megjithë përpjekjet e nuses për t'i bërë gjërat si duhen, në kohë: “Unë jam mësuese fillore dhe nuk e kam shumë të zënë ditën, siç e kanë gratë e tjera që punojnë 8 orë. Para se të shkoj në punë, unë ngrihem herët pa zbardhur, ndez zjarrin kur

është dimër ose hap dyert e jashtme kur është verë. Shkoj mbush kovat dhe fuçine në oborr me ujë, i vij oborrit vërdallë e pastroj dhe ve në vend stolat ose heq mbeturinat, ndërkohë vjehrra dhe vjehrrri ngrihen dhe u bëj kafënë atyre. Pres që ata të mbarojnë kafënë që të pastroj dhomën ku rrimë, sepse aty mund të vijnë njerëz për vizita gjatë ditës. Ngre fëmijët, i shoqëroj në banjo, i ndihmoj të vishen dhe u jap mëngjesin. Nderkohë nxitoj të vishem vetë, dhe kur bëhem të dal, ja beh në derë ndonjë nga fqinjat tona, që janë kushërira, moshataret e vjerrës që vijnë të pijnë kafen e mëngjesit dhe vjehrra më thotë të bëj kafen shpejt, pastaj të iki. Kur vij nga puna, filloj të pastroj perimet për drekën, laj enët e bëra gjatë paraditës, shtroj drekën, dhe pres të ulen të gjithë që t'u jap ujë e bukë, pastaj ulem vetë në fund dhe ndodh që sapo filloj të ha të vijë ndonjë fis që e kemi afër, për të na parë a për të marrë ndonjë gjë që i duhet dhe vjehrra më thotë të shkoj ta marr atje ku e ka lënë ajo, pastaj e mban për muhabet dhe më thotë të filloj ta qeras dhe gjatë qerasjes unë duhet të rri me tabaka në dorë, deri sa të mbarojnë dhe në fund i bëj kafënë. Oreksi më ka ikur ndërkohë, duke u marrë me një të afërm që ka ardhur mu në vakt dreke dhe rri për shtatë palë qefe. Vjehrra më thotë të ngre tavolinën se mos vijnë njerëz të tjerë dhe të pastroj vendin e ngrënies që të mos na gjejnë shtëpinë të parregullt. Më thotë të shkoj të laj hajatin e shtëpisë se vjehrrri ka hyrë disa herë me çizmet me baltë në shtëpi, dhe meqë e kam shtupën në dorë, më thotë të laj gjithë dyshtemenë. Ndërkohë, ka ardhur pasditja dhe unë duhet të bej ditarin për ditën e nesërme dhe po pata kohë të ndihmoj edhe djalin për mësimet dhe të kujdesem për vajzën e vogël që nuk e kam prekur dot me dorë që kur jam kthyer në shtëpi, se jam marrë me urdhrat e vjehrrës. Futem në dhomën time për të bërë ditarin dhe ja beh vjehrra, më thotë t'i bëj vajzës ndonjë gjë për të ngrënë se po shkon darka duke më kujtuar se kam fëmijë për të ushqyer “ngrehu, leri librat, me to ishe gjithë ditën, ka punë shtëpia, ke fëmijë për të rritur”. Ngrihem ti bëj vajzës për të ngrënë dhe sapo filloj ta ushqej vijnë nja dy-tre çifte të afërmish, vëllezërit e vjehrrit me gratë dhe me djemtë e martuar e nusët. Iku ditari bashkë me vajzën. Vjehrra më thotë t'i qeras, t'u nxjerr raki e t'u bëj kafe. Unë vazhdoj të bëj ritualin e qerasjes për të disatën herë në ditë, duke mbajtur mendjen në vend për të parë se çfarë u duhet miqve, që na vijnë përditë vakt e pa vakt. Kërkojnë ujë, u jap; kafen e duan me pak sheqer, shkoj u bëj tjetër; ankohen se rakia është e fortë dhe nuk shtyhet pa gjë, vjehrra më urdhëron të bëj meze për raki; vjen vjehrrri nga pazari ose nga punët në parcelë dhe kur i gjen vëllezërit aty bashkë me gratë, djemtë dhe nusët kënaqet shumë dhe urdhëron vjehrrën të bëhet darkë se do t'i mbajmë për darkë. Darka ka ardhur, unë filloj gatuaj, vjehrra më thotë shko merr këtë, qero këtë, ver këtë në zjarr, gatuaj,

shiro tavolinën, ulen të gjithë të hanë e pinë, unë nuk kam ngrënë ende drekë. Kujtohem t'i jap djalit për të ngrënë para se ta zerë gjumi në divan nga lodhja dhe zhurmat e hareshme që duken më shumë si ndonjë sherr mes burrash. Flasin të gjithë me zë të lartë, vajza ankohet se do ta çoj në banjo. Mendojem ti çoj djalit diçka për të ngrënë, vjehrra më kthen duke kërkuar ujë për miqtë. Djalin e ze gjumi pa ngrënë, vajza grindet se do të flerë, nuk ka kush e dërgon në shtrat. Im shoq është shtruar bashkë me kushurinjtë në tavolinë me të ngrëna e me të pira. Mua më priten këmbët nga lodhja, ka shkuar mesnatë. Jam ngritur pa zbardhur. Më mbeten pesë orë për gjumë. Vjehrra më thotë të shtoj mezet, të ve ca vezë të tjera për të zier, më thotë të shkoj nëse është zënë djathi në napë, më thotë të shkoj të marr ca domate, i bëj të gjitha këto veprime si robot. Po me ze gjumi në këmbë. Truri nuk merr më komanda. Nuk kam leje të fle. Dal jashtë që të freskohem. Hyj brenda dhe u shërbej ujë. Në tavolinë nuk ka vend për mua, edhe im shoq është ulur në një stol që e ka sajuar aty për aty. Pres të ikin. Gratë ankohen se ka shkuar vonë. Vjehrra u thotë të rrinë edhe ca. Gratë ngulmojnë dhe ngrihen të gjithë. Sapo kaloi mesnata. Vjehrra më urdhëron të pastroj tryezën. Nuk kam fuqi të laj enët, do i le për mëngjes. Mëngjesi ka ardhur, kam vetëm katër orë për të fjetur. Bie në shtrat, ndihem shumë fajtorë, nuk i dhashë djalit për të ngrënë, nuk e vura vajzën në gjumë, nuk bëra ditarin, po sikur të kem kontroll, etj, etj...Zbardh dita!” Në këtë histori të rrëfyer vetëm në dritën e fakteve dhe pa përshkrime emocionale, vihet re se sa e ngarkuar është dita e një gruaje që jeton në një familje më prindërit e burrit dhe me të afërmit e tij pranë shtëpisë. Shkakët për të cilat vjehrra e paragjykon, megjithë gadishmërinë e nuses për të shërbyer gjithë ditën në këmbë, lidhen me shkathtësinë e saj për të kryer disa punë njëherësh, si të lajë, shpëllajë, gatujë, ushqejë fëmijët, presë njerëz, etj.

Një tjetër shkak është edhe predispozita e nuses për të pritur njerëz dhe për të qëndruar gjithë pasditen me tabaka në dorë. Vjehrra e paragjykon se nusja nuk ia “sajdis” (nuk ia merr me të mirë) sa duhet njëherëz që vijnë për kafe, të cilëve edhe u ankohet për nusen se nuk kujdeset sa duhet për fëmijët: se djali është kockë e lëkurë, kurse vajza qan shumë! Kur sheh fëmijët e të afërmit, të shëndetshëm dhe faqekuq, vjehrra e fajëson nusen se nuk di të mbajë fëmijët e saj, se nuk kujdeset sa duhet, se nuk merret fare me ta dhe se harron t'i ushqejë. Në të gjitha këto paragjykime dhe ankesa për nusen vihet re se shkak është sjellja, komunikimi, aftësitë dhe përkujdesi për fëmijët. Vjehrra e quan veten të çliruar nga punët e shtëpisë dhe merret me përkujdesjen për vajzën e vogël kur nusja është në punë; me kaq e ka kryer detyrën sipas traditave nënkulturore fshatare.

Nga shkuarja e nuses me vjehrrën varet edhe vizita e nuses tek njerëzit e vet. Disa gra thanë se në shenjë hakmarrje, vjehrrat nuk i linin të shkonin tek prindërit. Ato u thoshin edhe djemve të mos i linin nuset të shkonin në të parë. Vjehrra lejohet me kanun që të shoqërojnë nusen tek shtëpia e vet, për të takuar të afërmit. Por, vjehrrat që donin t’i ndëshkonin nuset, përdornin lloj-lloj justifikimesh për të mos i lejuar nuset të shkonin tek prindërit, kur nuset nuk kishin zbatuar urdhërat ose nuk i kishin zbatuar mirë. Njera nga gratë tregoi se kishte gati një vit pa shkuar të shihte nënën, sepse vjehrra nuk i jepte leje: “Unë bëja çdo gjë që më urdhëronte vjehrra dhe kur e pyesja nëse do shkoj tek shtëpia ime ma kthente se kisha punë të tjera për të bërë. Unë e pyesja nëse do shkoja ta shihja nënën po t’i mbaroja punët që kisha për të bërë, ajo ma priste: “të shohim deri atëherë”. Por, punët nuk mbaronin kurrë dhe vjehrra gjente përditë punë të reja për të bërë. Do shqepnim dyshekët e jorganët, rrihnim qylymat, lyenim muret e oborrit, do milej lopa, do zihej bulmeti dhe kështu iknin ditët. Ajo më thotë të presim deri nesër, por e nesërmja nuk vjen kurrë”.

Por, ka edhe raste, më të rralla, kur vjehrra ka qenë aleate e nuses. Njera nga gratë tregon se kur duhej të vazhdonte masterin e mësuesisë për të ruajtur vendin e punës, vjehrra e ndihmoi shumë: “Unë jam mësuese dhe për të ruajtur vendin e punës kisha nevojë të kualifikohesha që të kisha kreditet e dukura. Fola me tim shoq dhe ai hezitoi të më mbështeste, sepse kishim dy fëmijë të vegjël njëri pas tjetrit dhe po të filloja masterin nuk do isha për fëmijë e për shtëpi për aq kohë sa zgjaste masteri, sepse paradite do shkoja në punë dhe pasdite në master deri natën vonë. I thashë nënës sime të më ndihmonte, por nuk pranoi duke më thënë se kishte shumë punë vetë: “Të t’i mbajë vjehrra! - më tha”. I thashë vjehrrës që më duhej patjetër masteri që të qëndroja në punë dhe ajo e mirëpriti: “Shko, mbaroje masterin, mbaje mendjen tek mësimet se fëmijët i shoh vetë”! U befasova nga mirëkuptimi dhe përkrahja e saj pa hezitim, vjehrra bëri atë që nuk bëri nëna ime. I jam thellësisht mirënjohëse, po të mos ishte ajo nuk do ta kisha bërë masterin dhe nuk do isha në punë. Ajo është një grua e mrekullueshme, edhe fëmijët i ka edukuar shumë mirë edhe pse vetë nuk ka pasur shkollë. I ka rritur me shumë dashuri dhe me norma morale. Nuk di si t’ia shpërblej mundin që bëri për dy vite rresht pa m’u ankuar njëherë. Madje nxiste edhe tim shoq që të merrej me pazaret e me fëmijët që unë të isha e qetë dhe të studioja. Do t’ja di për nder gjithë jetën.”

5.3.18. Vjehrrri: më pak paragjykues se vjehrra

Vjehrrri, bashkëshorti dhe gruaja e vëllait janë njësoj paragjykues. Kështu janë shprehur rreth 13.7 për qind e të anketuarave. Vjehrrri është zot shtëpie: hierarkia familjare drejtohet nga i “zoti i shtëpisë” që ka kontrollin tërësor mbi jetën e familjes: ushqimin, veshmbathjen, arsimimin, punësimin, martesën, etj. Etnografja Andromaqi Gjergji, pas shumë vitesh hulumtimi të mënyrës së jetesës në fshat, shprehet se “Jeta familjare karakterizohet nga marrëdhënie varësie midis pjestarëve të saj. Familja drejtohet nga “zoti i shtëpisë” që ishte zakonisht babai ose vëllai më i madh që caktonte punët në familje, priste miqtë e lidhte krushqitë” (2002:48).

Çdo shtëpi, sipas traditës, drejtohet nga një burrë që është përgjegjës për ndarjen e pasurisë dhe punës për të tjerët. Sikurse vëren Faik Konica: “Në Shqipëri, familja është një njësi shoqërore që ze vendin e shtetit në mendimin e njerëzve. Fëmijët rriten me tradita patriarkale për të respektuar të mëdhenjtë e mbi të gjitha babanë, fjala e të cilit është ligj” (1993:436). Kryefamiljari përfaqëson familjen në sytë e të tjerëve dhe ka interes që familja e tij të gëzojë respekt tek të tjerët. Ky lloj burri, i zoti i shtëpisë, luan një rol të rëndësishëm për të lidhur normat e shoqërisë së vjetër që përfaqëson kanuni me ato të botës së jashtme moderne jashtë shtëpisë (Young, A., 2000:16). Zakonisht zot shtëpie është një burrë i martuar dhe me fëmijë, i cili jeton nën një çati me djemtë e martuar dhe fëmijët e tyre, si dhe me vajzat e veta të pamartuara. Sipas normave kulturore, kryetari i familjes është babai ose më i zoti nga vëllezërit. I zoti i shtëpisë ishte edhe përfaqësues i familjes për të tjerët, ai priste e përcillte miqtë në familje. Nusja i shërbente posaçërisht të zotit të shtëpisë, domethënë vjehrrit, kur ky priste miq, ajo shërbente në odën e miqve. Në Kanunin e Bendës thuhet se “nusja e re ka përgjegjësi për dhomën e miqve që asht dhoma e zotit të shpis; nusja ngehet herët e ndez zjarrin në odën e miqve; ajo ka për detyrë t’u laj kamët e t’u shtijë ujë durvet miqvet, t’u shtrojë meze e raki; të shtrojë sofrën kur ta kërkojë i zoti i shpisë; ta furnizojë zjerrmin me dru; t’u shtroj me fjet të zotit të shpis e miqve; nusja asht gjithnjë nën urdhrat e të zotit të shpis (Goci, H., 2010:19).

Krahasuar me vjehrrën që rri në shtëpi, vjehrrri ka një marrëdhënie më të distancuar me nusen e djalit, sepse nuk është gjithë kohës në shtëpi. Edhe kur është, ai nuk merret me hollësitat e punëve të grave, sepse me to merret e shoqja. Megjithëse vjehrrët nuk janë shumë të pranishëm në hapësirën fizike të grave, ata janë shumë të pushtetshëm dhe kanë shumë autoritet mbi to vetë dhe mbi gratë e djemtë e vet. Gratë rrëfejnë se vjehrrët që qëndrojnë në shtëpi janë shumë

zevzekë dhe ndërhyjnë në punët e tyre. U bien nuseve më qafë për çdo punë dhe i qortojnë pa shkak. Ja si e përshkruan një grua marrëdhënien e saj me vjehrrin: “Familja e burrit ishte shumë e madhe, bëheshim reth 30 vetë. Vjehrrin na ndante punën të gjithëve tek ara, kopshtet dhe bagëtitë, kurse vjehrra na ndante ne nuseve edhe punët në shtëpi. Gratë punonin dyfishin e burrave, edhe në bujqësi, edhe në shtëpi. Vjehrrin ishte një burrë shumë grindavec, na shante për çdo gjë, nuk kënaqej kurrë me punën tonë, ndërhynte gjithandej. Ndihesha shumë e nervozuar prej kontrollit të tij pa vend. Por, më keq akoma ishte vjehrra, sipas së cilës nuset nuk kishin të drejtë të pushonin. Vjehrra na urdhëronte ne nuseve të bënim punët dhe të gatanim, të pastronim e të lanim, të arnonim e të qepnim, Edhe ajo ishte shumë e sertë, na rrinte tek kryet, na nervozonte shumë me ndërhyrjet e saj dhe qortimet pa fund. Nuk na tha njeherë një fjalë të mirë. Ne lepe-peqe (urdhëro), ata plaç!”.

Gratë e kishin të vështirë të kërkonin të blinin sende vetjake që i duheshin, pasi duhej t’i thoshin vjehrrës për këtë dhe ajo t’i thoshte vjehrrit dhe ky të çelte qesen. Financat e shtëpisë drejtohen dhe mbahen nga i zoti i shtëpisë. Sipas Kanunit të Lumës, paragrafi 35, thuhet se “i zoti i shpis mban qesen” (Hoxha, Sh., 20`3:87). Ai e merrte qesen me vete kur shkonte në pazar, shiste dhe blinte për nevojat e të gjithë familjes, si ta shikonte të arsyseshme. Kuri kthehej në shtëpi, vjehrrin ja dorëzonte qesen të “zonjës së shtëpisë”, e cila e kyçte në sëndukun e saj (Gjergji, A., 2002:234). Gratë që ishin në varësinë ekonomike të vjehrrit, sajnin blerje orendish shtëpiake për të blerë gjëra që u duheshin për higjenën personale dhe veshmbatjen intime. Ndërsa një pjesë ia kërkonin paratë bashkëshortëve.

Sipas të dhënave të anketimit, vjehrrin është më shumë paragjykes për sjelljen dhe komunikimin e nuses, se sa për përkudetin e saj për për fëmijët. Sikurse u shpreh me humor njëra prej grave: “Vjehrrin donte t’i çoheshim në këmbë e të dilnim me vrap tek dera, sikur po vinte nga jashtë shtetit. Ai atë punë kishte, hynte e dilte me dhjetra herë në ditë. Po të mos e kishim mendjen, vinte na qëllonte me shkop dhe thoshte “luj moj vendit, se të kemi ble me pare!”. Por jo të gjithë vjehrrët janë të rëndë, të frikshëm dhe shtypës. Ka edhe përjashtime.

Shumë gra pohuan se me vjehrrin kishin pasur marrëdhënie shumë të mira dhe madje, kur e kishin parë të udhës, ishin marrë në mbrojtje prej tyre kur ishin sulmuar nga fjalët e vjehrrav dhe bashkëshortëve dhe për këtë ato u ishin mirënjohëse. Njëra prej tyre tregoi se vjehrrin e kishte në vend të babait në shtëpinë e burrit, ai i kishte dalë krah, sa herë atë e kishin venë përfund familjarët: “Unë u martova me dashuri dhe hyra nuse në një shtëpi me shume vetë. Si

nuse, u futa në rol dhe kryeja pak a shumë gjithçka pritej prej meje, por me kalimin e kohës njerëzit u mësuan keq, sepse prisnin gjithçka nga unë dhe më urdhëronin të gjithë, nga më i madhi e deri tek më i vogli, pa të keq. Njerëzit e burrit silleshin shumë keq me mua, nuk tregonin kurrfarë respekti dhe flisnin pa takt. Unë lëndohesha shumë dhe mbyllesha në dhomën time dhe qaja për fatin tim. Im shoq nuk ndërhynte, pasi e ëma ia vinte të gjithë kundër dhe ai për të shmangur sherret thoshte që më mirë të duroja unë se të plaste sherri. Nuk kisha kujt t'i ankohesha për fatin tim, të mijtë nuk kishin qenë dakord me atë martesë dhe po te ankohesha do fërkonin duart gjithë qef duke ironizuar “mirë të të bëhet; koka bën koka pëson”. Pas disa kohe në këtë gjendje vendosa t'i hapem vjehrrit, i cili nuk ishte i pranishëm në shtëpi gjatë ditës, sepse punonte. Edhe kur vinte ishte fjalëpak. Si më dëgjoi me shumë kujdes ai më pyeti se ç'kisha ndër mend të bëja pas kësaj. I thashë që zgjidhja e vetme ishte të ndahesha, ishte e kotë te rrija dhe të haja dru nga njerëzit e shtëpisë, ata do vazhdonin me të tyren. Ai m'u lut të mos ndahesha se do përpiquej t'i zgjidhte gjërat. Më tha të shkoja nja dy ditë tek njerëzit e mi dhe më pas do më çonte fjalë të vija. Ashtu ndodhi vertet, u ktheva tek shtëpia e burrit pas dy ditësh. Vjehrrin po më priste vetë, i kishte vënë në rresht edhe të tjerët, të cilët nuk më bënte zemra t'i takoja po ai ma bëri me shenjë. U ul dhe u tha të gjithëve: “Në këtë shtëpi kemi marrë një nuse shumë të mirë që ju ka dashur dhe shërbyer të gjithëve, tregojini respekt sepse ajo është e huaj këtu, ndërsa ju në shtëpinë tuaj. Lëreni të qetë e mos i bini më në qafë”. Kaq u desh dhe rashë rehat, jo se njerëzit e burrit u qytetëruan brenda natës, por i ruheshin autoritetit të madh të babait. Unë u rrita në atë shtëpi. Vjehrra ishte shumë grindavece, por nuk e linte i shoqi. Vitet e fundit të jetës, vjehrrin u paralizua dhe unë i shërbeva me shpirt. E laja si fëmijë në banjo, qëndroja me të tek shtrati, i pastroja plagët... Vajzat dhe nuset e tjera vinin një herë në muaj ta shihnin. Kur unë lodhesha shumë, më ndihmonte im shoq dhe im bir. Vjehrrin kishte besim vetëm tek unë, ngazëllehej si fëmijë kur më shihte. Vdiq në duart e mia.”

5.3.19. Paragjykuar nga bashkëshorti

Janë paragjykuar nga bashkëshorti 13.7 për qind e të anketuarave. Pozita e burrit ndaj gruas në traditën kulturore kanunore ze një vend të veçantë. Për arsye se shumica e paragjykimeve për gruan burojnë nga mënyra se si është rregulluar marrëdhënia burrë-grua në normat kanunore, është në interes të studimit të parashtrihen për analizë këto rregullime.

Bashkëshorti është personi më të cilin gruaja ka një marrëdhënie të drejtëpërdrejtë dhe natyra e kësaj marrëdhënie në norma dhe në realitet meriton një vëmendje të veçantë. Mospbatimi me përpikmëi i normave kanunore në jetën e përditshme shkakton një mori paragjykimesh kundrejtë grave të martuara. Edhe paragjykimet e të tjerëve ndaj gruas lidhen shpesh me qëndrimet e saj ndaj normave kanunore në marrëdhëniet me bashkëshortin.

“Në familjen patriarkale, burri ze vendin kryesor në veprimtarinë ekonomike, ndërsa gruaja nuk ka rol as në ekonomi, as në shoqëri” (Tirta, M., 2001:232). Bashkëshorti ka një vend të privilegjuar në familjen shqiptare, sipas traditës kulturore. Në të gjitha kanunet, burri njihet si i pari i shtëpisë dhe si autoriteti i padiskutueshëm para gruas dhe fëmijëve. Vetëm burrit i lejohej të ketë jetë shoqërore, jashtë shtëpisë dhe të marrë pjesë në pleqësi e kuvend. Në normat kulturore kanunore ka pasur ndikim të madh edhe feja islame, sipas së cilës: “Burri është më i pushtetshëm se gruaja, për dy arsye: e para, për shkak se është më i fuqishëm dhe e dyta për shkak se ka përgjegjësinë për institucionin e familjes. Prej kësaj buron pozita e privilegjuar e burrit si udhëheqës i familjes dhe pozita e nënrenditur e gruas si qenie e varur nga burri. Sipas islamit, vatra familjare është si një shtet i vogël ku burri gëzon të drejta të pakufishme ndaj gruas, sepse është zot shtëpie, përgjegjës i familjes, autoriteti i shtëpisë; pas tij janë të lidhur gruaja dhe fëmijët, ndërsa gruaja i bindet zotit të shtëpisë. Studiuesi i të drejtës së familjes, Beqir Topalloglu ka vënë në dukje”

Në Kuran, burrat drejtojnë, ndërsa gratë binden. Edhe sipas koncepteve të sotme juridike, në institucionin e familjes burri zotëron të drejta prioritare në raport me gruan. Gruaja mban mbiemrin e tij dhe e ndjek pas, ai vendos për shtëpinë dhe përfaqëson familjen, pa lejen e tij gruaja nuk mund të merret me ndonjë punë, ajo nuk përzihet në punë të fëmijëve përveç rritjes dhe edukimit të tyre.” (Topalloglu, B., 1997:90).

Sipas normave kanunore, e vetmja detyrë e burrit ndaj gruas është t’i sigurojë asaj dhe fëmijëve ushqim. “Burrat nuk punojnë në shtëpi, ata shërbehen për çdo gjë prej grave, të cilat u lajnë edhe këmbët” (Young, A., 2000:22).

5.3.19.1. Intimitet i ndaluar

Në mendësitë fshatare ishte e ndaluar të flitej për marrëdhëniet seksuale, sepse seksi ishte tabu. Faik Konica shprehet se “për jetën seksuale të shqiptarëve mund të thuhet pak gjë. Kur do bëhej një martesë që zakonisht lidhej mes dy të rinjve nën 20 vjeç, me një thjeshtësi baritore, një anëtar mashkull, më i moshuari i familjes, do t’i shpjegonte djalit anën fizike të martesës, ndërsa një femër e farefisit do të vizantonte me një copë gëlqere a qymyr një rreth të vogël përçark *depilata virginis...* Burrat shqiptarë priren t’i mbajnë gratë më tepër si nëna, se sa si gra të dashura” (1993:440). Sipas normave të shoqërisë tradicionale, burri dhe gruaja e kishin të ndaluar shprehjen e afeksionit jashtë dhomës së gjumit, pasi shikohej si shfaqje e dëshirës për marrëdhënie seksuale në sy të tjerëve.

Edhe brenda mureve të shtëpisë, shfaqja e dashurisë për njëri-tjetrin ishte e papranueshme, pasi personat e tjerë të rritur të familjes e keqinterpretinin si imoralitet, si sfidë ndaj pranisë së të tjerëve, si turp të madh. Sociologu Zyhdi Dervishi argumenton se “në shoqërinë tradicionale shqiptare, veçanërisht në segmentet e saj që jetonin në zonat rurale, prekjet intime ishin rreptësisht të ndaluara në mjediset publike, pasi opinionin shoqëror i konsideronte ato si shprehjet të “imoralitetit, të pushtillëkut, si kurvërim në sy të të tjerëve, si imoralitet faqe dynjasë, si veprime burracakësh ose femrash të përdala” (2008:401).

5.3.19.2. Rrahja e gruas

Gruaja në kanun nuk trajtohet si një qenie madhore me të drejta si të burrit. Ajo ka një pozitë thujse fëminore në shtëpi, përse i përket të drejtës së fjalës dhe vetëkontrollit. Edhe në gjuhën jo verbale gruaja detyrohet prej normave kanunore të mbajë një qëndrim trupor dhe pamor prej të nënshtruarë (qëndrim gatitu në këmbë, me kokën ulur dhe sytë përtokë) në shenjë përuilje ndaj autoritetit mashkullor, kushdo qoftë ai: bashkëshorti, babai, vëllai më i madh, vjehri, kunetërit, etj. Për këtë dukuri shprehet edhe studiuesi i kulturës shqiptare Zyhdi Dervishi: “Në shoqërinë tradicionale shqiptare, vajza ose gruaja kur bisedonte me babain, vëllain më të rritur dhe sidomos me bashkëshortin, nuk i shikonte në sy, por e mbante kokën dhe shikimin ulur. Një model sjelljeje i tillë, ndonëse shprehte status të nënrenditur të vajzës ose gruas, konsiderohej si respekt i tyre për babain, vëllain e rritur ose bashkëshortin” (2008:372). Burri

mund ta shajë, qortojë dhe ndëshkojë me fjalë dhe më dhunë fizike gruan nëse e sheh të arsyeshme.

Normat kanunore e ndalojnë gruan t'i kthejë fjalë burrit dhe ajo duhet të bëjë si t'i thotë ai. "Rrahja e gruas kur shihet e arsyeshme vlerësohet si një mënyrë e vënies se të drejtës së burrit në vend nga ana e kanunit" (Young, A., 2000:22). Kur gruaja i kthen fjalë burrit, ajo quhet e *pasoj*, pra nga familje jo e mirë. Ndaj gruas ushtrohet një trysni e dyfishtë për t'u sjellë mirë sipas kanunit, pra t'i bindet pa kushte burrit dhe familjarëve: *e para* nderon veten dhe *e dyta* nderon sojin, familjen e saj.

Në kanunin e Bendës thuhet se "burri ka tagër t'i bërtasë dhe ta rrahë gruen kur t'i kthehet fjala e kur s'i bindet" (Goci, H., 2010:47). Në kanunin e Lumës, në nenin 130, rrahja e gruas ligjërohet kur ajo nuk e dëgjon burrin dhe familjarët e tij: "Burri ka të drejtë me e rrehë, me e lidhë, e mshelë (mbyllur) brenda gruen kur ia kthen fjalën e kur nuk ndigjon" (Hoxha, Sh., 2013:106). Nëse gruaja ankohet tek prindërit e saj për dhunën e të shoqit, këta mund t'i kërkojnë arsyen dhëndrrit se ërpse ia dhunon vajzën që ata ia kanë dhënë "për rrnës, jo për kmës"(për të jetuar, jo për ta mbytur), dhe po qe se ky nuk pranon të japë shpjegime, atëherë çështja del në pleqni. Por, sipas Kanunit të Lumës, paragrafi 168, kur gruaja ikën prej burrit, sepse ai "ja nxin jetën", prindërit e saj ja çojnë prapë burrit në derë, nëse binden se ajo ka faj dhe e sigurojnë burrin se ajo "s'ka me ba ma faj" (Hoxha, Sh., 2013:112). Po qe se gruaja nuk pranon të kthehet më tek burri, shtëpia e saj bie në gjak më burrin. Dhuna mund të shkojë deri aty sa burri mund edhe ta ndëshkojë gruan me "çupim", dëmtim të fytyrës si prerja e hundës, e buzëve dhe plagë të tjera që lenë shenja të pashlyeshme. Megjithëse parashikohet në Kanun, një ndëshkim i tillë nuk është zbatuar në praktikë.

5.3.19.3. Vrasja e gruas sipas normave kulturore kanunore

Kanuni i Bendës i jep të drejtë burrit ta vrasë gruan "për nder të prish për dy punë: për kurvni e për mik të premë" (Goci, H., 2010:47). Gjithashtu, burri e vret gruan edhe kur ajo vjedh pasurinë e shtëpisë dhe e ndan atë tek të tjerët. Në rast se nusja ikën me një burrë tjetër, prindërit e saj bien në gjak me shtëpinë e dhëndrrit të parë (Po aty:52). Edhe në Kanunin e Lumës, lejohet vrasja e gruas kur ajo "zihet nja më nja (njëri përmbi tjetrin) me një burrë të huej", kur vret fëmijën e saj dhe kur pret mikun në besë (Hoxha, Sh., 2013:100). Fëmijët nuk i përkasin nënës

me kanun, por babait, përmes linjës së gjakut, prandaj nëna që vret fëmijën, vritet sepse ka vrarë fëmijën e burrit, pra i ka një gjak borxh familjes së burrit, i cili lahet vetëm më gjak. Ndërsa babai që vret fëmijët e vet nuk i ka gjak kurrkujt se ka vra “pjellën e vet”. Në Kanunin e Skënderbeut, gruaja vritet për dy arsye: për tradhëti bashkëshortore dhe për mik të premë në besë. Gruaja konsiderohet se ka kryer tradhëti bashkëshortore nëse ajo kapet në flagrancë dhe jo kur i dalin fjalë. Nëse i dalin fjalë, që është mirë të vërtetohen, ajo ndahet nga burri, por normat kanunore e lejojnë ndarjen me fjalë edhe po nuk u vërtetuan ato. Gruan që kryen tradhëti ndaj burrit e vret si rregull i shoqi, por nëse ajo zihet në akt e sipër me ndonjë, ajo vritet prej atij që e sheh. Në Kanunin e Skënderbeut, në paragrafin 175, thuhet se gruaja që vritet për imoralitet nuk ka të drejtë varri, trupi i saj i hidhet kafshëve ta hanë: “Gruen e shnjërueme (e përdalë) që gjendet nja më nja me një burrë të huej e vret kush e gjen për seri, ajo nuk ban gjak, nuk shtihet në dhe, xhenazen (kurmin) le t’ia hanë sorrat” (Ilia, F., 1993:113). Për gruan e martuar, fishekun e japin prinderit e saj tek burri, që ky ta vrasë nëse ajo ikën nga shtëpia dhe nëse pret mikun në besë. Ndërsa në paragrafin 1889, thuhet se gruaja dhe vajza në moshë martese vriten “kur zihen keq dhe fishekun e lëshon vetë katundi në shpinë të saj” (Po aty:149). Gruaja vritej edhe kur lindte fëmijën e parë para kohe. Për lindje të parakohshme, në muajin e shtatë të shtazanisë me sa duket nuk kishte njohuri, dhe gruaja vritej pasi, sipas kanunit, fëmijën e kishte konceptuar në marrëdhënie paramartesore ose jashtëmartesore me një burrë tjetër. Në Kanunin e Bendës thuhet: “Nëse u martu e lind gruaja para kohe, burri ka të drejtë me i futë fishekun pas shpine” (Goci, H., 2010:48).

5.3.19.4. Ndarja e gruas nga bashkëshorti

Në normat zakonore ka ndikime të shariatit i cili ndonjëherë ka zëvendësuar normat kulturore dhe nënkulturore paraislame. “Meqë burri njihet në kuran si udhëheqës i familjes edhe e drejta e shkurorëzimit i takon atij, ndërsa gruaja nuk ka asnjë forcë ligjore që të mund ta përdorë kundër burrit për shkurorëzim. Ajo mund ta ndajë burrin vetëm për impotencë seksuale” (Topalloglu, B., 1997:80). Në Kanunin e Bendës, kur burri është seksualisht i paaftë, gruaja e ndan dhe prinderit e saj i thonë burrit “Ti nuk je burrë, gjersa të ikën gruaja” (Goci, H., 2010:52). Kanuni i Bendës thotë se “burri e lëshon gruen kur nuk e gjen të virgjër, ia kthen shkuesit e i thotë ta çojë ku e ka marrë”. Por, nëse bashkëshorti nuk jep arsye se përse e ndan gruan, “ai i ka

prinderve të gruas një gjak borxh, sepse nderi lahet me gjak” (Goci, H.,2010:52). Gruaja e ndarë nuk rimartohet, “shtama e thyme nuk ngjitet, gruaja e lshume nuk mirret”.

Virgjëria ishte një aspekt i rëndësishëm i pastërtisë morale të vajzës dhe prindërit tregonin kujdes të shtuar kur ajo i afrohej moshës për martesë. Mungesa e virgjërisë, në kushtet e munguara të njohurive anatomike të trupit të gruas dhe ndërtimit të aparatit riprodhues femëror, konsiderohej si deflorim paramartesor dhe vinte në dyshim, jo vetëm ndershmërinë e vajzës, por edhe qenien e saj shtatzanë. Shtatëzani të tilla ishin të papranueshme sepse mund të sillnin në jetë fëmijë të padëshiruar nga kanuni dhe nga feja. Këtë fakt e ka studiuar edhe sociologu Zyhdi Dervishi, i cili ndër të tjera thekson:

“Në rrethanat e mospërdorimit të pajisjeve kontraceptive të çfarëdolloji, ruajtja e virgjërisë së vajzave, deri në martesë, konsidrohej një çështje mjaft e rëndësishme morale dhe shoqërore, sepse nga marrëdhëniet seksuale paramartesor mund të lindnin fëmijë të paligjshëm. Opinioni tradicional i shoqërisë shqiptare fëmijë të tillë i trajtonte si turpërimin më të rëndë, jo vetëm për femrën që i sillte në jetë, por edhe për familjen e fisin e saj... Në gojë të popullit ata quhen “pjellë e mallkueme”. Me qëllim që të mos turpëroheshin nga pjella të tilla “të mallkueme” meshkujt e rritur të familjes, të fisit, në shumicën e rasteve e vrisnin një vajzë të mbetur shtatzënë nga marrëdhëniet e paligjshme që në fazat e para të shtazanisë” (Dervishi, Z., 2008:101).

Sipas Kanunit të Lumës, përveçse kur nuk e gjen të virgjër, burri ka të drejtë ta ndajë gruan edhe “kur e sheh se nuk jetohet më me të”, ndërsa gruaja nuk e ka këtë të drejtë edhe nëse “ai asht shëmtaq, don një tjetër ose e ban me ortake” (martohet me një tjetër). Burri mund ta ndajë gruan, nëse asaj i dalin fjalë si e pandershme edhe “pa e kap nja m’nja me një të huej” ose nëse ajo shkon shtatzanë tek burri, sepse kështu prindërit e saj i kanë dhanë një cucë të martume. Edhe kur thyen ndalimin e parjes së të fejuarit, vajza e fejuar ndahet. Sipas Kanunit të Lumës, në paragrafin 150, thuhet se ndarja e vajzës së fejuar është një dramë e madhe për familjen e saj: “E lshumja e cucës asht mort pa shokë” (Hixha, Sh., 2013:109). Në rast se burri vendos ta ndajë gruan, sipas paragrafit 153, ai duhet të japë sqarime dhe prova tek vëllezërit e saj, sepse nga ndarja e saj turpërohen edhe ata “sepse e lshumja e grues ka të fikmen dhe faqen e zezë mbrapa”

(Po aty). Paragrafi 155, i këtij Kanuni, përcakton edhe mënyrën e kthimit të gruas së ndarë tëk familjarët e saj: “Për turpin e bërë, gruen e lshume e çojnë në derë të babës vjehri me një shoq, po kryeult” (Po aty:110).

5.3.19.5. Poligamia: një e drejtë për burrin

Normat kulturore kanunore lejonin poligaminë në formën e poligjinisë, të martesës së një burri me disa gra njëherësh. Islami e përforcoi zakonin e poligjinisë, duke lejuar martesën e një burri me katër gra në të njejtën kohë. Burri me disa gra duhej të realizonte *drejtësinë përballë të gjitha grave*, si në ushqim, veshmbathje, marrëdhënie seksuale dhe dashuri. “Një nga arsytet madhore për justifikimin e poligjinisë në islam është shmangia e tradhëtisë bashkëshortore (zinasë) nga ana e burrit, prandaj atij i lejohet të martohet me disa gra, ndërsa gruaja, edhe po qe se burri ka edhe tre gra të tjera, nuk ka të drejtë të mendojë dhe jo më të shkojë me një burrë tjetër: asaj nuk i lejohet martesë përveçse me një burrë” (Topalloglu, B., 1997:106).

Në Shqipëri, poligamia u ndalua me ligj për herë të parë në regjimin e Mbretit Zog, por në praktikë zakoni i poligjinisë vazhdoi. Burrat martoheshin me dy deri në tre gra, por kurorë vinin vetëm me gruan e parë, në emër të së cilës regjistroheshin edhe fëmijët e lindur nga gratë e tjera. Të gjitha gratë e një burri jetonin në një shtëpi, secila në dhomën e vet. Sipas Kanunit të Bendës burri mund të martohej disa herë “kur gruaja asht plak dhe nuk lind djal (Goci, H.,: 2010:49). Ndërsa në Kanunin e Lumës, në paragrafin 127, thuhet se burri nuk ka kufizime për martesën e dytë dhe të tretë, madje ai mund të martohet edhe për qef me deri katër gra “Burri ka të drejtë me i ba grues deri në tre ortake. Kur janë në moshë të re, ortaket dajnë si nja e nja shtratin me burrin; derisa ortakja ma e vjetër t’i bishtnojnë shtratit me burrë. Gruaja më e vjetër është zonjë shtëpie, ndërsa gruaja më e re njihet nusja e konakut dhe i lan e shplan teshat e shtëpis ortakes ma të vjetër” (Hoxha, Sh., 2013:119).

Sipas normave kanunore, burri martohet edhe për qef, kurse gruaja vetëm nëse i vdes burri. Përcaktimi kanunor është shumë i padrejtë dhe i ashpër kur trajton të drejtën e gruas për të zgjedhur njeriun me të cilin dëshiron të martohet. Martesën me dashuri për gruan, kanuni e quan martesë qefi dhe e shpall të pavlefshme, të turpshme, të dënueshme, der me vdekje. Kanuni nuk i njeh gruas martesë qefi, siç i njeh burrit, madje shprehet për ndëshkimin kapital në mënyrë të prerë për gratë që duan të martohen me dashuri. Në Kanunin e Lumës, paragrafi 188, shprehet se

“Grues që ka një burrë e don me marr një tjetër, *plumbin në gojë asaj dhe atij që e merr*” (Hoha, Sh., 2013:115). Po sipas këtij Kanuni, paragrafet 140-142, nën titullin “Shkelja e kunorës”, sanksionojnë te drejtën e burrit për tradhëti bashkëshortore dhe ndëshkimin me vdekje të gruas për të njëjtën gjë, duke u shprehur se kurora shkelet veç nga ana e burrit, sepse “Burri njuhet burrë, e grueja njuhet grue, prandaj njësoj nuk janë... burri ash zot në shtëpi të vet e grueja asht rob në shpi të huej. Bani e shkeli kunorën burri, gjegje nuk i jep kuj; shkeli kunorën grueja, i jep gjegje burrit e ka plumbin kres, pse nuk asht e leme (e lindur në atë shtëpi), por e bleme” (Po aty:107).

5.3.19.6. Trashëgimia: përjashtim për gruan

Në familjen patriarkale, sipas normave kulturore kanunore, prona është e përbashkët dhe administrohet nga i zoti i shtëpisë. Patrilineariteti siguron që trashëgimia të kalojë në linjë mashkullore nga linja e gjakut. Në rast se nuk ka djem trashëgimtarë, pronën e trashëgojnë meshkujt më të afërt të fisit. Prona mund të trashëgohet përkohësisht nga vajza, der në gjallje të saj, nëse ajo nuk martohet ose fut dhëndërr brenda. Por me vdekjen e vajzës, prona u kalon kushërinjve të parë nga babai sepse është pronë e përbashkët e fisit. Në kanunin e Bnedës thuhet se pasuria ndahet mes djemve dhe vajza nuk merr pjesë trualli, por vleftë në para, për aq sa kushton pjesa që i takon, ndërsa në pasuri të burrit, gruaja nuk ka fare të drejtë pasurie (Goci, H.,2010:83). Gruaja është e huaj, si në shtëpi të saj, ashtu edhe në shtëpi të burrit, në asnjërin prej familjeve ajo nuk trashëgon pasuri, sepse sipas traditës, pasuria trashëgohet në linjë mashkullore nga ana e gjakut. Sipas Kanunit të Skënderbeut, në paragrafin 838 thuhet se “trashëgimia brenda gjakut ec në vijë të drejtë: prej stërgjyshit, tek gjyshi, tek baba, djali, nipi e stërnip. Vajzat nuk trashëgojnë as te prindja, as te burri, kurrnji pasuri të patundshme” (Ilia, F., 1993:67).

5.3.19.7. Paragjykimet e bashkëshortit ndaj gruas

Të dhënat e anketimit tregojnë se pesha specifike e grave të paragjykuara prej bashkëshortëve rritet me 10 për qind nga fejesa (4.2 për qind) në martesë (14.2 për qind). Jetesa në fshat, në familje patriarkale, dhe veprimi i normave kulturore kanunore kanë ushtruar ndikim

në mendësitë e meshkujve. Megjithë përpjekjet emancipuese që u bënë gjatë kohës së regjimit socialist në fshat, ato pak i prekën mendësitë e burrave dhe mbase, edhe për shkak të jetëgjatësisë së shkurtër të programit emancipues, normat kanunore në nënkulturën rurale nuk u sfiduan krejtësisht. Rënia e regjimit socialist i dha fund programit shtetëror për emancipimin e fshatit. Periudha që pasoi rënien e socializmit, risolli në jetë normat kulturore kanunore në fshat, të cilat, përgjatë regjimit socialist, kishin fjetur në ndërgjegjen e banorëve, për t'u rizgjuar me forcë pas vitit 1990. Madje, gjatë kohës së migrimit të brendshëm masiv të fshatarëve drejt qyteteve të mëdha si Tirana dhe Durrësi, edhe qytetet u shndërruan në mozaikë nënkulturash fshatare e krahinore që të ardhurit sollën me vete.

Paragjykimet që burrat kanë ndaj grave të tyre në fshat janë të shumta, por për studimin rezultojnë se, në morinë e shkaqeve paragjykuese, tre janë më të rëndësishmet: (i) sjellja, (ii) komunikimi dhe (iii) veshja. Gratë pohojnë se burrat i kanë paragjykuar për sjelljet dhe komunikimin që ato kanë në lidhje me ta dhe familjarët e tyre, madje për këtë të fundit edhe më shumë. Duke qenë se afërsia fizike mes njerëzve në fshat është e ngushtë dhe kontaktet e tyre janë të shpeshta, gratë kanë komunikim të vazhdueshëm me njerëzit e familjes dhe fisit të burrit. Këto kontakte bëhen shpesh pre e paragjytimeve nga ana e familjarëve dhe të afërme të bashkëshortit, të cilët i komunikojnë këtij të fundit pakënaqësitë e tyre në lidhje me sjelljet e bashkëshortes së tij. Të tilla paragjytime kanë të bëjnë me mënyrën se si ndërvepron gruaja me njerëzit e burrit, a është ajo e dëgjueshme dhe e përlur, a punon shumë në ekonominë familjare, a është e shtruar dhe e duruar, etj. Paragjykimet e njerëzve të afërt lenë gjurmë në opinionin e burrit për gruan e vet dhe gratë shprehen se ato duhet të provojnë vazhdimisht të kundërtën e atyre që i janë transmetuar të shoqit. Ato ndihen shumë të irrituara që punët dhe sjelljet e tyre nuk kanë peshë përpara paragjytimeve të familjarëve dhe fisit, që shpesh ndodh të bëhen pjesë e opinionit të burrit. Sjellja e grave paragjykohet edhe kur ato punojnë jashtë shtëpisë. Një pjesë e grave shprehen se vuajnë shfaqje ekstreme dhe brutale të xhelozisë së burrave për dyshime të kota për kohën që ato janë në punë. Ato treguan shumë histori të tilla, ndër të cilat po veçoj një të rrëfyer nga një grua e re: “Unë kam mbaruar shkollën e lartë dhe punoj në një institucion publik. Në punë jam futur më shumë me ndërhyrjen e burrit dhe njerëzve të tij se sa për meritë, ju e dini se si funksionon punësimi tek ne, me miqësi... Burri e njihte vetë drejtuesin e institucionit që më punësoi dhe meqë më futi vetë duhej të kishte besim se e kishte shok. Gjatë kohës që isha në punë, burri më merrte disa herë në telefon dhe më pyeste ku isha dhe më thoshte

t'ja vertetoja që isha aty ku thosha, si për shembull nëse isha në zyrë me koleget e punës ai kërkonte që unë t'ja nxirrja në telefon, megjithëse koleget e mia nuk kishin shumë muhabet me burrin. Isha në siklet me këto kontrole të tij, jo sepse vihesha nën mbikqyrje vetë, por sepse duhet të përfshija edhe njerëz të tjerë në këtë mesele dhe kjo më turpëronte pa masë. Në fillim shoqet e mia nuk e keqkuptuan interesimin e tim shoqi për të folur në telefon me të, sepse unë u thosha që “do t’ju përshëndesë”, por pastaj ato e kuptuan dhe nuk pranorin ta përshëndesnin më, sepse nuk i lidhte puna të përshëndesnin burrin tim 10 herë në ditë. Natyrisht refuzimi i tyre për t’i konfirmuar atij me telefon se unë isha në praninë e tyre ma rëndoi situatën. Im shoq nga kontrolli me telefon, filloi kontrollin fizik. Vinte përditë në zyrë me pretekstin se do takonte një shok, se do takonte drejtuesin tim, se i ra rruga andej, se kishte një porosi për mua, etj. Këto vizita të tij u bënë shumë të besdisshme për shoqet e mia të zyrës, sepse ai nuk mjaftohej me një përshëndetje, por ulej dhe rrinte në zyrën time dhe vëzhgonte kush hynte e kush dilte. Shoqet e mia filuan edhe ta tallnin, madje të tregonin qyfyre me të. Edhe banorët që vinin në zyrën tonë e vunë re këtë, sa filluan të thoshin se “filani ka filluar punë në x vend”. Shoqet e mia u ankuan tek drejtuesi, po ashtu edhe disa banorë që ishin konfliktuar me tim shoq, gjatë kohës që kishin punë me mua në institucion, dhe si përfundim drejtuesi e thirri për kafe dhe i kërkoi që të mos dukej për ca kohë në institucion se i kishte nxjerrë nam të keq vetes dhe më kishte bërë mua për gjynah në sytë e stafit. Ai e qetësoi tim shoq që të mos kishte dyshime për mua, se isha punonjëse shumë e mirë dhe grua e ndershme, që nuk kisha se më kë e tradhëtoja, sepse isha gjithë kohës me kokën ulur mbi letra dhe pas pune në shtëpi. Biseda me drejtuesin tim sikur bëri efekt, ai i besonte pak atij si shok, por nuk besonte se unë nuk do bëja gjë, sepse sipas tij mund të bija viktimitë e ndonjë mashtruesi a dashakeqi dhe se isha shumë naive dhe e sinqertë. Për ca kohë i ndaloi vizitat dhe shoqet e mia ranë rehat. Por nuk zgjati shumë dhe filloi persekutimin me telefon dhe verifikim në vend. Një ditë mori në telefon kur unë nuk isha në zyrën time, por kisha shkuar tek protokollit për të marrë ca shkresa. Fakti që unë nuk i isha përgjigjur në celular e kishte xhindosur dhe i kishte ndezur fantazinë e sëmurë. Erdhi si i tërbuar në zyrë. Më tha pse nuk i përgjigjesha në celular. Më pyeti për emrin e punonjësës së protokollit dhe shkoi ta takonte, por në atë moment ajo kishte dalë. Kaq deshi që ai ta humbte toruan dhe të më akuzonte se po e gënjeja pa pikën e turpit në sy të të tjerëve. Më terhoqi për krahu dhe filloi të me qëllonte me grushta deri në makinë. Në institucion nuk kishte shumë njerëz në atë moment. Nga njëra anë ishte gjë e mirë, sepse nuk doja të më shihnin në atë gjendje, por nga ana tjetër, nuk kisha

ndihmë. Më futi në makinë duke më qëlluar. Në shtëpi vazhdoi seanca e dytë e rrahjes; me thoshte ta shihja në sy kur më gjuante. Instiktivisht mbuloja fytyrën me duar, por një grusht më kapi në cepin e vetullës dhe më plasi gjaku çurg. Shoqet e mia i binin pa pushim celularit duke e acaruar edhe më shumë, njera prej tyre e kishte lajmëruar vëllain polic, që solli një furgon policie. Kur policët i ranë derës, im shoq e ndali drurin, më tha të shkoja në banjo të pastrohesh nga gjaku dhe të mos dilja që aty, e të mos hapja zë. Ashtu bëra. Policët pyetën për mua dhe ai u tha se nuk ndihesha mirë dhe isha shtrirë. Ata i thanë që do kalonin më vonë, këtë taktikë vëllai i shoqes sime e përdori që ta shkurajonte atë të vazhdonte dhunën duke e paralajmëruar se ishin aty verdallë dhe se do ktheheshin prapë. Nuk shkova në punë për një javë rresht, e kisha kokën gjithë xhunga dhe më dhimbte aq shumë sa nuk e vendosja dot as në jastëk, syrin e kisha të nxirë. Kur dola në punë shkova me syze dielli. Shoqet e kuptuan dhe më thanë ta denoncoja, por unë nuk e bëra. Ai më la rehat për ca kohë, por tani ka filluar përsëri të dyshojë. Çfarë të bëj, me vjen keq ta le, ai është xheloz sepse më do!”.

5.3.19.8. Veshja si shkak për paragjykimet dhe nga bashkëshorti

Shumë nga gratë e anketuara pohojnë se shkak për paragjykimet e bashkëshortëve është veshja e tyre. Ato ndihen shumë të trysnuara për veshjen. Nga njëra anë duhet të vishen mrë që të përcjellin një imazh të kuruar tek të tjerët, nga ana tjetër nuk mund të vishen si duan, sepse burrat bëhen xhelozë ose grindavecë duke aluduar se duan t’u bien në sy burrave të tjerë. Paragjykimet për veshjen rëndojnë si për gratë që punojnë brenda ekonomisë familjare, ashtu edhe për ato në punë me pagesë jashtë shtëpisë. Gratë shtëpiake hasin në kundërshtimin e burrave për të pasur një garderobë me pretendimin se janë shtëpiake. Nëse duhet të vishen për ndonjë rast, kërkojnë fustane tek gratë e familjes ose të fisit, ose mendohen disa herë para se ta blejnë.

Gratë e punësuar janë edhe më të paragjykuara nga bashkëshortët për veshjen. Atyre u kontrollonet graderoba, se çfarë do veshin. Ato duhet të vishen në mënyrë sa më modeste, që të mos tërheqin vëmendjen e burrave të tjerë dhe të mos zgjojnë inatin e burrave të vet. Disa prej tyre, shumë të reja në moshë, vishen me rroba për një moshë më të madhe, vetëm e vetëm që të mos konfirmojnë paragjykimet e burrave kundrejt veshjes së tyre. Ato ankohen se burrat nuk i lenë të vishen, për arsyen se në fshat ka shumë paragjykimet dhe gratë që vishen bukur përfliken se duan të bien në sy. Këto paragjykimet janë ngulitur fort në mendjen e banorëve në fshat, të

cilët, jo vetëm grave, por edhe vajzave të reja u bëjnë komente të shumta paragjyquese për veshjen.

5.3.20. Të paragjykuara nga kunatat

Kunatat, gratë e vëllezërve të bashkëshortit janë po aq paragjyquese sa bashkëshortët dhe vjehrrët. Kështu mendojnë rreth 13.7 për qind e të anketuarave. Përgjithësisht, kunatat, gratë e vëllezërve, kanë status të barabartë brenda familjes, ato trajtohen të gjitha njëjloj nga familjarët e bashkëshortit. Gjithësesi, në raport me njëra-tjetrën, kunatat nuk janë njësoj. Kunata më e madhe ka një status më të privilegjuar në familjen e bashkëshortit, për disa arsye. *E para*, ajo ka ardhur më parë se nusja e re në shtëpi dhe njihet prej një kohe më të gjatë nga familjarët e bashkëshortit; *e dyta*, ajo ka nusëruar më gjatë dhe për këtë shkak mund të ketë fituar respektin e familjarëve të burrit; *e treta*, ajo mund të ketë fëmijë, gjë që i jep automatikisht një status më të lartë në raport me nusen e re, dhe *e katërta*, ajo mund të jetë me e madhe në moshë gjë që i jep gjithashtu një status më të ngritur.

Kunata e madhe ndodhet edhe me afër vjehrrës, për shkak se ka ndërvepruar për një kohë më të gjatë me vjehrrën, me të cilën, përgjithsisht, ka krijuar një komunikim më të qëndrueshëm, ndërsa nusja e re do kohë të përshtatet me zakonet dhe me pozitën e vet në hierarkinë familjare si personi më inferior dhe i duhet të mësojë pozitën dhe të drejtat e secilit në raport me të, përfshirë edhe kunatën më të madhe. Kunata e madhe merr edhe rolin e zonjës së shtëpisë, në mungesë të vjehrrës. Kunata bëhet zonjë shtëpie edhe në rast se vjehrra nuk është më e zonja të urdhërojë dhe mbajë rregull e pastërti brenda në shtëpi. Si zonjë shtëpie ajo urdhëron kunatat e tjera.

5.3.20.1. ... nga gratë e kunetërve

Kunatat janë paragjyquese ndaj njëra tjetrës për sjelljet, komunikimin, aftësitë dhe për origjinën fshatare dhe krahinore. Kunatat, kur bashkëjetojnë në një shtëpi, kanë rivalitet të hapur për pushtet mbi njëra-tjetrën dhe për ndikim mbi familjarët e bashkëshortit. Gratë pohojnë se kunatat kanë qenë paragjyquese, edhe kur kanë jetuar në një shtëpi me to, edhe kur kanë jetuar veç. Kunatat janë vecanërisht paragjyquese kur bashkëjetojnë me gratë nën një kulm. Kunatat më të mëdha i ndihmojnë nuset e reja kur vijnë në shtëpi, kjo është detyrë funksionale e tyre. Krahas

vjehrrës, ato i mësojnë nuses së re “granimin dhe cullnimin”, si të përmbushin funksionet e rolit social të gruas sipas zakonit dhe se si të rrisin fëmijët (cullt). Për ndihmën që i japin në vitin e parë të martesës ose edhe më gjatë, kunatat presin më shumë se mirënjohje nga nusja e re, ato duan që nusja t’u rrijë si nxënëse dhe madje të tregojë të njejtën përvullësi dhe nështrim që tregon për njerëzit e shtëpisë së burrit. Kunatat duan ndonjëherë që nusja t’u bindet urdhrave të tyre, njësoj siç i bindet vjehrrës. Meqë nuset e reja refuzojnë të sillen sikurse e presin kunatat e mëdha, atëherë ato bëhen pre e paragjykimeve si “mosmirnjohëse, kryeneçe, etj”.

Gratë pohojnë se kunatat e mëdha nuk janë mjaftuar vetëm duke i paragjykuar, por edhe i kanë përgojuar ndër njerëz, në fis dhe fqinjësi. Njëra nga gratë rrëfeu se si kunata e kishte persekutuar se ajo nuk i nënshtrohej: “Unë u dashurova shumë e re me burrin tim dhe kunata më mbështeti shumë tek familja e burrit, kur po diskutohej fejesa, sepse ne ishim rritur në një lagje të dyja dhe njiheshim që prej fëmijërisë. Ajo ishte disa vjeçe më e madhe se unë dhe ishte martuar para meje. Kur erdha nuse, ajo edhe më ndihmoi të kuptoja se cilat ishin detyrat e mia si nuse dhe më tregonte se si bëheshin punët, pritëshin e repektoheshin njerëzit e shtëpisë. Unë hyra nuse në një shtëpi djemsh. Vjehrra ishte një grua shumë e urtë, por shumë e ndikuar nga kunata. Kunata kishte marrë komandën për të gjitha punët në shtëpi, madje edhe mbi djemtë e tjerë. Edhe burri im ia bënte shumë respektin kunatës së madhe, sepse ajo i kishte larë e shpëlarë, veshur e ushqyer për disa vjet, që kur kishte ardhur nuse. Ata e shihnin më shumë si bijë shtëpie, se sa si nuse. Në fakt, ajo e kishte firuar respektin e tyre, sepse kishte punuar shumë në atë shtëpi. Ajo vetë vinte nga një shtëpi me shumë vajza dhe ishte mësuar të shërbente. Edhe unë e respektoja kunatën time dhe ja tregoja, me rast e pa rast, që i isha shumë mirënjohëse. Ajo kishte shumë veti të mira, por ishte shumë e rreptë. Me marrjen në dorë të frenave në shtëpi ajo pyetej për gjithçka, edhe vjehrra me atë komunikonte më shumë. Vjehrra kishte zënë një qoshe në shtëpi dhe shijonte kafënë dhe ushqimet që i çonim ne, duke thënë se “paskesh dhënë zoti edhe një ditë të bardhë për të, pasi i kishte dhënë dy vajza”. Unë punoja gjithë ditën, edhe me qëllimin që të merrja një vlerësim të mirë nga njerëzit e shtëpisë dhe burri im. Por, po të mos fliste kunata ata nuk jepnin kurrfarë vlerësimi. As burri im nuk guxonte të më përgëzonte, nëse këtë nuk e kishte bërë më parë kunata. Pak nga pak, kunata filloi të sillej më shumë si vjehrrë me mua, më urdhëronte për çdo punë, më linte punët më të rënda, vetë mbante gatimin dhe qokat nëpër njerëz bashkë me vjehrrën. Kur kthehëj nga vizitat pyeste a ishte bërë kjo, a ishte larë ajo, etj. Ajo fillonte të më kërkonte hesap për çdo gjë. I thashë tim shoqi që kunata po e kalonte masën duke m’i lënë të

gjitha punët mua, si brenda edhe jashtë shtëpisë. Im shoq më tha të mos hapja gojë dhe të bëja si të urdhëronte ajo, sepse me punë dhe bindje do fitoja respektin e të gjithëve. Isha vetëm një shërbëtoreshë në atë shtëpi. Kur fillova të mos i bindem më kunatës, më hakërrehej se po të donte “më nxirrte fishek nga shtëpia, siç edhe më kishte futur, se po të mos ishte për të, nuk do isha nuse në atë shtëpi”.

Kunatat e paragjykojnë shumë njëra-tjetrën për pastërtinë e shtëpisë, për gatimin, për punët brenda dhe jashtë shtëpisë. Ato duket sikur konkurrojnë me njëra-tjetrën kush të marrë më shumë levdën nga njerëzit e burrit, duke hedhur baltë mbi njëra-tjetrën. Kujdesi për fëmijët është një tjetër shkak për paragjykim. Sidomos, kunatat më të mëdha në moshë i paragjykojnë më të rejtat se nuk dinë të rrisin fëmijë, se nuk i ushqejnë mirë, nuk i mbajnë pastër dhe nuk i edukojnë me norma.

Origjina është gjithashtu një shkak për paragjykim. Gratë janë paragjykuar nga kunatat e tyre për origjinën fshatare dhe krahinore. Kunatat kanë shfaqur paragjykim të shumta në drejtim të njëra-tjetrës duke u mburrur se “nga fshati ynë jemi më të mirë, i kemi traditat më të forta, i respektojmë zakonet, kurse ju jeni injorantë!”, etj.

5.3.20.2. ... edhe nga motrat e bashkëshortit

Paragjykuar nga motrat e burrit janë ndjerë 10.4% e të anketuarave. Motra e burrit është më pak paragjykuar se gruaja e vëllait, për shkak se ajo nuk konkurron për pozitë e pushtet në shtëpi e familjarëve të vet. Gjithashtu, pjesa më e madhe e motrave të burrit janë të martuara dhe nuk jetojnë në një shtëpi me vëllezërit dhe një pjesë e vogël janë më të reja se nuset e vëllezërve. Bijat e shtëpisë janë paragjykuar ndaj nuseve për sjelljet, aftësitë dhe komunikimin. Ato paragjykojnë sidomos krenarinë e nuseve të vëllezërve dhe prirjen e tyre për t’u dukur më të mira nga ç’janë në të vërtetë, ose se sillen keq me ato vetë dhe më nënat e tyre. Edhe komunikimi është shkak për paragjykim, sepse motrave të bashkëshortit u duket se nuset komunikojnë ftohtë, në mënyrë hipokrite dhe ndonjëherë mëmërisin në vend që të përshëndesin.

Një tjetër paragjykim është edhe ndikimi që nuset kanë tek bashkëshortet e tyre, duke u folur keq për motrën dhe nënën e burrit dhe ky ftoh marrëdhëniet me to. I njëjti paragjykim është edhe për fëmijët e vëllait, kur ata sillen ftohtë me gjyshërit e të atit dhe hallat, mendohet se nusja

ka ndikuar për keq, duke e larguar dashurinë e fëmijëve nga njerëzit e babait ose duke i afruar vetëm me njerëzit e vet.

Ndonjëherë, motra e burrit merr edhe rolin e zonjës së shtëpisë në mungesë të nënës së saj. Sipas Kanunit të Bendës, vajza e shtëpisë e merr rolin e zonjës së shtëpisë dhe urdhëron nuset kur nuk janë burrat në shtëpi (Goci, H., 2010:52). Ndërsa në Kanunin e Lumës, paragrafi 40 shprehet se “cuca e pamartume asht zonjë shpie, kur nuk ka grue tjetër në shtëpi”, që do të thotë se nëse ka nuse, më e madhja prej tyre urdhëron (Hoxha, Sh., 2013:89). Siç del edhe nga anketimi, motrat e bashkëshortëve zenë vendin e parafundit si paragjyquese, gjë që tregon se ato ose nuk janë shumë në kontakt me nuset, sepse janë të martuara dhe jetojnë në shtëpitë e veta ose janë më të reja se nuset e vëllezërve dhe nuk i venë re sjelljet e tyre. Megjithatë, gratë tregojnë se kanë pasur marrëdhënie të mira me motrat e burrit në përgjithësi, ato edhe u janë gjendur kur kanë pasur mosmarrëveshje me vjehrrën dhe bashkëshortin.

5.3.20.3. Kunati më pak paragjyqes

Kunati është i fundit në rradhën e paragjyqesve. Mendojnë kështu rreth 2.6 për qind e të anketuarave. Vëllai ose vëllezërit e burrit kanë pak marrëdhënie ndërvarësie me nusen e vëllait. Edhe nëse kanë, ajo është më shumë një marrëdhënie e njëanshme, ku nusja shërben dhe kunati përfiton nga shërbimi i nuses. Kunati në përgjithësi ruan distancë edhe fizike edhe komunikuese me nusen, sepse ajo është gruaja e të vëllait dhe nuk është e pranueshme që kunati të afrohet me nusen e tij. Edhe paragjykimet, kunetërit më shumë i huazojnë nga nënat, motrat dhe bashkëshortet e veta, se sa nga komunikimi i drejtëpërdrejtë me nusen e vëllait. Kur janë në një shtëpi, kunati komunikon me nusen aq sa komunikon edhe vjehrrin, mbase edhe më pak. Ndërsa kur janë në shtëpi të veçanta, kunati komunikon me raste, kur takohen ose kur këmbëjnë vizita.

Në shtëpinë e bashkëshortit, nusja bëhet pjesë e familjes dhe mund të konsiderohet e afërt, si bijë për prindërit e burrit ose si motër për kunatin. Gratë pohuan se në përgjithësi kishin marrëdhënie korrekte me kunetërit. Vetëm në disa raste ato u shprehën se kunetërit janë sjellë vrazhdë me to, i kanë kontrolluar ku shkojnë, i kanë folur për veshjen, madje edhe i kanë rrahur, megjithëse rrahja e kunatës është e ndaluar nga kanuni dhe opinioni në përgjithësi. Sipas kanunit, vetëm burri e rreh gruan e vet. Kunati nuk ka të drejtë të rrahë gruan e vëllait dhe as ta vrasë, përveçse kur e kap në flagrancë për tradhëti bashkëshortore. Edhe nëse sheh a dëgjon diçka për

kunatën, kunati ka për detyrë të informojë të vëllanë. Sipas Kanunit të Lumës, paragrafi 52 shprehet se “kunati ka për detyrë me ia veshue (t’ia thotë në vesh) t’shoq, për xhit (çfarë) sheh e ndin për kunatë, por kunatën e shnjëzume (perdalë) e mbyt burri, kunati e mbyt kunatën veç po e gjet nja mbi nja me njeri t’huej, përndryshe valli i tij i lyp gjakun” (Hoxha, Sh., 2013:93).


KAPITULLI VI

PARAGJYKIMET PËR VAJZAT DHE GRATË NË PUNË

Deri në vitin 1990, shumica e vajzave dhe grave në moshë pune në Farkë punonin në ndërmarrjen bujqësore shtetërore “Gjergj Dimitrov”. Me shpërbërjen e regjimit socialist, u shpërbë edhe kjo ndërmarrje. Vajzat dhe gratë e punësuar në ndërmarrjen bujqësore u gjendën të papuna. Papunësia që vazhdoi përgjatë viteve të tranzicionit shkaktoi varfërim dhe çintegrim shoqëror për vajzat dhe gratë. Në lidhje me pasojat e shpunësimit të vajzave dhe grave pas shpërbërjes së regjimit socialist totalitar, sociologu Zyhdi Dervishi argumenton: “Epidemia e shpunësimit goditi më shumë vajzat dhe gratë, duke i detyruar ato të rikonstruktojnë pothuaj të gjithë sistemin e marrëdhënieve të tyre me të tjerët, me të afërmit dhe me shoqërinë në tërësi, duke i vënë ato, sit ë thuash, në syrin e ciklonit të vështirësive dhe sfidave të shumëllojshme” (2001:12).

6.1. Papunësia: Këputja e hallkës së integritit shoqëror

Në komunën Farkë, sipas të dhënave të studimit për gjendjen e punësimit të vajzave dhe grave, rezulton se rreth 46.1 për qind janë të vetpunësuar në ekonominë bujqësore të familjes, por vetdeklarohen të papuna ngaqë nuk kryejnë punë me pagesë jashtë ekonomisë familjare.



Ato punojnë si punëtore pa pagesë të familjeve të tyre, duke kontribuar në mënyrë të tërthortë në ekonominë e familjes, megjithëse nuk sigurojnë të ardhura prej punës me pagesë. Në shkallë vendi, në vitin 2012 sipas të dhënave të INSTAT, të punësuarat si punëtore pa pagesë të familjes ishin 50.8 për qind e vajzave dhe grave të moshës 15-64 vjeç (INSTAT, 2013:39). Në vitin 2012, rreth 58.5 për qind e të angazhuarve në punë bujqësie ishin vajza dhe gra, ndërsa meshkujt ishin punësuar më shumë në sektorin privat jobujqësor (INSTAT, 2013:40). Në vitin 2013, në sektorin privat bujqësor femrat zinin përqindjen më të lartë të të punësuarve në sektorin bujqësor (54.4 për qind), ndërsa në sektorin shtetëror zinin 48.0 për qind të punësimit (INSTAT, 2014:63).

Ndër të anketuarat e vetëpunësuarat, pa pagesë, brenda ekonomisë familjare, pjesa më e madhe, 77.0 për qind, janë të angazhuara në punë bujqësie brenda ekonomisë familjare, ndërsa 23.0 për qind janë vetpunësuar në njësitë e prodhimit bujqësor dhe të shitjes me pakicë, që i kanë në pronësi të familjes ose të bashkëshortëve. Produktet bujqësore dhe blegtorale të siguruarat prej punës së grave përdoren kryesisht për konsum familjar, ndërsa një pjesë tregtohen në Farkë dhe në Tiranë. Të papuna janë 19.1 për qind e të anketuarave, të cilat ndodhen jashtë marrëdhënies së punës për shkak se studiojnë (70.0 për qind) ose janë pensioniste (30.0 për qind).

Të punësuarat në punë me pagesë, jashtë ekonomisë familjare, janë 34.8 për qind e të anketuarave, ndër të cilat 52.3 për qind janë të punësuarat në sektorin privat dhe 47.7 për qind në sektorin publik. Këto të dhëna janë të përafërta me statistikat e ofruara nga INSTAT, sipas të cilave, në vitin 2012, femrat ishin punësuar 54.5 për qind në sektorin privat dhe 43.9 për qind në

sektorin publik shtetëror (INSTAT, 2013:33). Në vitin 2013, të punësuarat në sektorin shtetëror zinin 48.0 për qind të të punësuarve (INSTAT, 2014:63). Pjesa më e madhe e të anketuarave, të punësuarat në sektorin publik, punojnë në sektorin arsimor (52.7 për qind), ndërsa pjesa tjetër punojnë në sektorin e shëndetësisë (27.7 për qind) dhe në administratën publike vendore (19.6 për qind). Këto të dhëna janë të përafërta me statistikat zyrtare, sipas të cilave, në vitin 2012, femrat zinin peshën më të lartë të të punësuarve në arsim dhe shëndetsi, përkatësisht 68.3 për qind dhe 66.9 për qind (INSTAT, 2013:33), ndërsa në vitin 2013 zinin përkatësisht 68.2 për qind dhe 72.4 për qind (INSTAT, 2014:63).

Spektori privat jobujqësor përfaqësohet kryesisht prej industrisë nxjerrëse dhe përpunuese, sektorit të energjitikës, gazit dhe ujrave, të industrisë së ndërtimit dhe prej shërbimeve të orientuara drejt tregut, prandaj punëson më shumë meshkuj se sa femra. Sipas të dhenave të INSTAT, në vitin 2012, sektori jo-bujqësor privat kishte punësuar 61.2 për qind meshkuj, ndërsa sektori bujqësor privat kishte punësuar 58.5 për qind vajza dhe gra (INSTAT, 2013:40). Siç shihet edhe nga të dhënat zyrtare, të vitit 2013, raportet e punësimit në sektorin privat paraqiten simetrikisht të përmbysyra për gjinitë, në sektorin privat jo-bujqësor punojnë përkatësisht rreth 60 për qind meshkuj dhe rreth 40 për qind femrave, ndërsa në sektorin privat bujqësor punojnë rreth 40 për qind meshkuj dhe rreth 60 për qind femra. Të anketuarat e punësuarat në sektorin privat punojnë kryesisht në firmat shqiptare që ushtrojnë veprimtaritë prodhuese dhe tregtare në Komunën Farkë si fasoneri, rrobaqepësi, shtëpi botuese, bare, restorante, hotele, ferma bujqësore dhe qendra tregtare TEG (Tirana East Gate).

Të gjitha vajzat dhe gratë e anketuara, si të punësuarat në punë me pagesë jashtë ekonomisë familjare, ashtu edhe ato të vetdeklaruara të papuna, por të punësuarat pa pagesë në ekonominë e familjes, pavarësisht nga mosha, shpenzojnë një pjesë të madhe të kohës për punë të papaguar për mirëqenien ekonomike të familjes, për mirëmbajtjen e shtëpisë dhe për përkuqjesin ndaj fëmijëve dhe të moshuarve. Përdorimi i kohës është ngushtësisht i lidhur me përkatësinë gjinore. Gratë kryejnë më shumë punë pa pagesë brenda ekonomisë familjare. Puna e përkuqjesjes është një detyrë që normat kulturore e lidhin me rolin social të gruas.

Shumica e të anketuarave, rreth 72.8 për qind e deklarojnë se të ardhurat kryesore për familjen sigurohen nga burrat, vetëm 27.2 deklarojnë se të ardhurat kryesore të familjes sigurohen nga gratë. Të ardhurat sigurohen kryesisht prej punësimit me pagesë jashtë ekonomisë familjare. Nga të dhënat e anketimit duket qartë se të ardhurat kryesore të familjes sigurohen prej

punësimi të burrave, të cilët shumicën e kohës e shpenzojnë jashtë shtëpisë, duke punuar për të siguruar “ushqimin” për familjen. Pjesa më e madhe e të anketuarave nuk janë të punësuar jashtë ekonomisë familjare, por e punojnë pa pagesë brenda ekonomisë bujqësore të familjes.

Edhe pse nuk shpërblehet me para, puna e papaguar e grave ndikon në mënyrë të tërthortë në ekonominë e familjes dhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë në mirëqenien e pjesëtarëve të saj. Jo vetëm gratë që punojnë pa pagesë në ekonominë bujqësore të familjes, por edhe gratë e punësuar në punë me pagesë jashtë ekonomisë familjare kryejnë punë të papaguar në funksion të mbarëvajtjes së ekonomisë familjare dhe të mirëqenies së pjesëtarëve të familjes. Gratë e punësuar shpenzojnë edhe më shumë kohë se burrat e punësuar duke punuar pa pagesë në familje. Të dhënat e studimit mbështeten edhe prej statistikave zyrtare sipas të cilave, vajzat dhe gratë fshatare, të moshës 15-64 vjeç, shpenzojnë pesë orë më shumë punë të papaguar ose shtatë herë më shumë kohë për punë të papaguar se sa burrat në fshat, përkatësisht 5:46 orë përkundrejt 0:48 orë (INSTAT, 2013:41). Vajzat në fshat, gjithashtu, shpenzojnë shumë më tepër kohë se sa djemtë për të bërë punë të papaguar pranë ekonomisë së familjes. Të dhënat zyrtare e vërtetojnë këtë fakt me shifra konkrete, sipas të cilave vajzat e grup-moshës 10-14 vjeç shpenzojnë afërsisht katër herë më shumë kohë për punë të papaguar se djemtë (INSTAT, 2013:41).

6.2. Konfliktet me pronarët në punë: motivet kryesore

Reth 30.4 për qind e vajzave dhe e grave të punësuar janë shprehur se kanë konflikte me pronarët e ndërmarrjeve private dhe me titullarët e institucioneve shtetërore ku punojnë. Konfliktet shkaktohen më së shumti nga keqkuptimet në lidhje me punën dhe komunikimin me drejtuesit e njësive ku punojnë. Duke mos i zgjidhur problemet me drejtuesit e njësive, punonjëset i drejtohen pronarëve ose titullarëve për të vendosur në vend ndonjë padrejtësi që u është bërë për orarin dhe pagesën. Të anketuarat e punësuar kanë tentuar t’i zgjidhin problemet nëpërmjet shkuarjes direkt tek zyrat e eprorëve më të lartë, duke anashkaluar ose duke shmangur me vetëdije nivelin e ndërmjetëm të drejtimit, që janë drejtuesit ose menaxherët. Përgjithësisht, të punësuarat kanë gjetur zgjidhje për ankesat në lidhje me punën tek eprorët, por një pjesë e tyre janë kthyer mbrapsht tek drejtuesit e nivelit të mesëm, të cilët i kanë në varësi të drejtëpërdrejtë,

gjë që i ka acaruar ankueset, të cilat kanë menduar se delegimi i ankesës për drejtuesit tek këta të fundit i ka ekspozuar ndaj hakmarrjes së drejtuesve, pa i dhënë zgjidhje ankesave për punën.

Duke besuar se tek eprorët do gjejnë një rrugëzgjdhje për problemet e punës, ato kanë kërkuar me këmbëngulje që ata të ndërhyjnë në favor të tyre, me bindjen se pretendimet e tyre kanë qenë të drejta. Mosangazhimi i pronarëve dhe titullarëve në zgjidhjen e ankesave të tyre, ndonjëherë ka shkaktuar konflikte mes të punësuarave dhe eprorëve. Konfliktet janë shfaqur në formën e komunikimit, kur ndaj vajzave dhe grave të punësuarave eprorët kanë përdorur një gjuhë jo shumë etike. Eprorët kanë dashur t'i përcjellin vajzat dhe gratë ankuese në nivele më të ulëta drejtimi, kur ato kanë këmbëngulur që t'u jepet drejtim me patjetër problemeve që kanë hasur në punë e sipër, me kolegët dhe drejtuesit e njësive ku janë punësuar.

Një pjesë e pronarëve janë edhe vetë të përfshirë në procesin e prodhimit, duke u vënë në kontakt të drejtëpërdrejtë me të punësuarat. Ata kanë kryer paralelisht dy role njëherësh, edhe të pronarit, edhe të drejtuesit të njësisë prodhuese dhe si të tillë janë përballur edhe më shpesh me punonjëset e njësive që kanë në pronësi. Arsyet më të shpeshta të konflikteve kanë qenë për shkak të komunikimit dhe çështjeve të punës. Të anketuarat pohojnë se punëdhënësit u kanë kërkuar të punojnë jashtë orarit dhe gjatë ditëve të fundjavave dhe të pushimeve zyrtare, por nuk i kanë paguar orët dhe ditët shtesë. Kur punonjëset kanë kërkuar të drejtat e tyre, pronarët u janë përgjigjur se duhet t'u jenë mirënjohesë që u kanë dhënë punë dhe pagë. Vajzat dhe gratë e punësuarave janë ndier të nënvlerësuara prej pronarëve që u kanë kërkuar t'ua dinë atyre për nder që janë të punësuarave.


Më të vështirë e kanë pasur të ankohen vajzat dhe gratë që kanë pasur lidhje familjare me punëdhënësin, për shkak se pronarët e kanë kuptuar ankesën si pakënaqësi ndaj tyre dhe jo si kritikë për kushtet e papërshtatshme të punës. Një numër i konsiderueshëm grash të reja janë punësuar në bizneset dhe firmat private që kanë krijuar familjarët e bashkëshortëve të tyre. Ato janë shumë të kujdesshme në marrëdhënien e punës, pasi keqkuptimet me pronarët mund t'i vendosin përpara përgjegjësisë bashkëshortit dhe familjarëve të tij.

Ndër të punësuarat me lidhje familjare, konfliktet më të shumta i kanë përjetuar gratë që kanë pasur pronar bashkëshortin e tyre. Ato e kanë pasur shumë të vështirë që të ankohen për problemet që kanë pasur me pronarin si bashkëshort, pasi kërkesat e tyre janë shpërfillur dhe madje janë konsideruar si të padrejta. Grave që janë punësuar në njësitë prodhuese dhe tregtare të shërbimit dhe shitjes me pakicë, që janë në pronësi të bashkëshortëve, puna në këto njësi nuk u

llogaritet si punë, por si një kontribut që ato duhet ta japin pa shpërblim, në formë vullnetare. Ato ndihen të shfrytëzuara prej pronarëve bashkëshortë sepse nuk paguhen për punën që bëjnë. Gratë e punësuarat prej bashkëshortëve nuk kanë akses as tek fitimet që sigurohen prej biznesit të familjes, ato duhet t'i drejtohen pronarëve bashkëshortë për mjete monetare që iu lipsen për nevojat familjare dhe vetjake.

Njëra nga gratë e punësuarat prej bashkëshortit pohoi se do kishte qenë më mirë të punësohej tek një biznes tjetër se sa në atë të bashkëshortit. Ndër të tjera, ajo u shpreh: “Ne kemi një biznes si familje në pronësi të bashkëshortit. Ai merret vetëm me furnizimin, ndërsa unë me gjithë punët e tjera, që nga prodhimi e deri tek mbajtja e llogarive. Ngaqë është burimi kryesor i të ardhurave për familjen, i jam përkushtuar kësaj pune prej vitesh, pa orar. Unë nuk marr pagesë për punën që bëj sepse llogaritë i mban bashkëshorti dhe fitimet nga biznesi i merr ai. Kur duhet të bëj ndonjë shpenzim për fëmijët, shtëpinë ose për vete, i lutem të më japë ndonjë lek a thua se i dua për qef. Por, ajo që më mërzi më shumë është se i lutem për paratë që i kemi fituar edhe prej punës sime. Kudo tjetër të kisha punuar do isha më pak e stresuar, sepse jo vetëm që do punoja me orar të përcaktuar, por do merrja edhe shpërblim timin, do i kisha lekët e punës sime në xhepin tim dhe do e mbaja kokën lart që isha në punë. Ndërsa kështu, punoj pa orar dhe pa shpërblim, madje duroj edhe nëvlerësimin e bashkëshortit tim. Sa herë që biznesi nuk ecën mirë, bashkëshorti ankohet sikur është faji im që nuk kemi pasur mjaftueshëm fitime, meqë unë merrem me procesin e prodhimit. Do të doja shumë të punoja tek një institucion ose firmë private tjetër, do i kurseja vetes shqetësimet që më shkakton kjo punë dhe sjellja e bashkëshortit tim si pronar i gjithçkaje, edhe imi”. Ky rrëfim tregon se si lidhja bashkëshortore i pengon gratë e punësuarat në bizneset e familjeve të tyre të kërkojnë realizimin e të drejtave të tyre si punonjëse. Kërkesat e tyre nuk merren në konsideratë nga pronarët bashkëshortë, madje injorohen dhe ato nuk kanë se ku të ankohen për konfliktet që kanë me ta.

Vajzat dhe gratë e punësuarat konfliktohen për shumë arsye me pronarët, ndër të cilat, më kryesorët janë paragjykimet përçmuese të pronarëve për aftësitë profesionale të punonjëseve, gabimet në punë, abuzimet me pagën dhe keqkuptimet e rastit.



Konfliktet që motivohen prej paragjykitimeve përçmuese të pronarëve për aftësitë profesionale të vajzave dhe grave punonjëse janë mjaft të përhapura. Kështu mendojnë rreth 33.5 për qind e të anketuarave. Punonjëset ndeshen shpesh me paragjykitime për aftësitë e tyre dhe për cilësinë e punës së kryer. Edhe kur puna është kryer mirë dhe me cilësi të lartë, ato pohojnë se rrallë përgëzohen për aftësitë profesionale. Pronarët duket sikur janë të pakënaqur me punën dhe pretendojnë më shumë cilësi. Njëra prej të punësuarave në një fasoneri të zonës u shpreh: “Ne punojmë pa e ngritur kokën nga makina qepëse sepse nga një gabim i vogël puna shkon dëm. Të gjitha jemi marrë në punë si rrobaqepëse profesioniste, sepse kemi punuar më parë në këtë zanat. Puna këtu është me normë dhe duhet përfunduar brenda një orari të caktuar, në mënyrë që malli të shkojë aty ku është porositur ose në treg. Ne jemi shumë të ndërgjegjshme që prej punës sonë varet shitja dhe fitimi, dhe prej fitimit varen pagesat tona, prandaj e bëjmë punën me shumë përgjegjësi. Por, pronari duket sikur nuk kënaqet asnjëherë prej punës sonë. Shpesh ai ankohet se jemi të ngathëta dhe se i bëjmë bisht punës. Janë të shpeshta rastet kur pronari ankohet edhe për cilësinë e punës sonë, pa të drejtë, duke vënë në dyshim aftësitë tona. Të gjitha këto pakënaqësi, që burojnë prej paragjykitimit të punës sonë prej tij, na krijojnë shumë stres, sidomos punonjëseve më të reja që kanë nevojë për inkurajim. Këto paragjykitime, të përsëritura dhe të shprehura pa takt, na mërzhisin shumë, pasi në ka gjë që pronari nuk duhet të verë në dyshim është pikërisht aftësia jonë për ta kryer atë punë, pasi vijmë të gjitha nga një zanat që e kemi ushtruar prej

vitesh. Ne nuk pranojmë të vlerësohemi negativisht për një punë që dimë ta bëjmë nga dikush që nuk e njih zënat tonë”. Nga rrëfimet e punonjësve duket se pronarët i trysnojnë punonjëset të punojnë më shumë për të rritur normën e fitimit. Ata nuk tregojnë kënaqësi ndaj punës së kryer prej punonjësve dhe e komentojnë me nota negative cilësinë e punës për t’i nxitur ato të punojnë më shumë. Pronarët tregohen vigjilentë ndaj punonjësve për t’i venë nën presion për të mos ulur ritmin e punës dhe të mos vetkënaqen me arritjet profesionale, sepse vetkënaqësia mund të shkaktojë shkrehje, çmobilizim dhe shpërqëndrim.

Konfliktet për gabimet e punonjësve në punë renditen në vend të dytë, me 27.8 për qind. Gjatë procesit të punës, kryhen edhe gabime, por pronarët janë të kujdesshëm që gabimet të ndodhin sa më rrallë, pasi kanë kosto. Duke qenë se një pjesë e pronarëve janë përfshirë edhe vetë në procesin e punës, si drejtues, ata kanë mundësi të shohin nga afër punën e punonjësve dhe të dëshmojnë gabimet e kryera prej tyre. Njëra prej të anketuarave që punonte në një restorant si ndihmës-kuzhinierë u shpreh se e kishte shumë e vështirë të punonte në të njëjtin vend me pronarin e restorantit: “Unë kam vite që punoj si kuzhinierë, por këtu kam ardhur si ndihmëse sepse kuzhinier është vetë pronari. Ai është shumë i rreptë dhe kërkues. Ka një komunikim të vrazhdë që më krijon një ndjesi alarmi që më shpërqëndron. Shumicën e herëve konfliktohemi për gabimet që ndodhin gjatë punës, kur unë e ndihmoj të pregatisë porositë dhe pjatat. Ngaqë është nevrrik, ai nxehet shpesh. Porosit disa asortimente njëherësh dhe kur ia jap bërtet se jam e “ngordhur” ose “hutaqe” dhe sipas tij duhet të veprojmë më shpejt. Në mes të punës më kërcënon se do më heqë nga puna, sepse sipas tij vonoj porositë. Edhe kur gabon vetë, mundohet të ma veshë fajin mua. Jam e ndërjegjshme që në punë bëhen edhe gabime, por kjo është e natyrshme, sepse siç thotë një fjalë e urtë “Ku hahet, bëhen thërrime!”. Por shefi e ekgjeron me sharjet për gabimet në punë dhe me kërcënimet se do më mbajë pagën për gabimet ose që do të më largojë nga puna.”. Kjo dëshmi tregon se konfliktet për gabimet në punë janë më të shumta, sidomos kur pronarët janë vetë drejtues të njësive prodhuese ose tregtuese.

Konfliktet që lindin për shkak të abuzimit me pagën janë në vend të tretë. Kështu mendojnë rreth 16.6 për qind e të anketuarave. Megjithëse më të pakët në përqindje, konfliktet për pagën janë shumë shqetësuese për punonjëset. Përgjithësisht, të anketuarat pohojnë se pronarët janë treguar korrektë me pagesat, por ka raste kur ata abuzojnë me pagën, duke mos u llogaritur saktë orët ose ditët e punës. Një grua që punonte në një shtyshkronjë tregoi se si në mënyrë të përsëritur asaj i ishte dhënë një shpërblim më i pakët se sa ai që meritonte, sepse

pronari harronte të mbante shënim orët tepër dhe punën në ditët e pushimeve, për të cilat i kishte premtuar se do t'i paguante: “Unë punoj prej dy vitesh këtu dhe e vetmja arsye konflikti me pronarin ka qenë moskorrektesa e tij për të më paguar ashtu siç duhet. Në fakt, edhe shoqet e mia e kanë hasur këtë problem, por ato nuk flasin për këtë gjë, sepse kanë frikë se mos pronari zemërohet dhe i merr inat. Unë e kam burrin pa punë dhe kam dy fëmijë të vegjël për të rritur. Kam pranuar të punoj jashtë orarit dhe në ditë pushimesh për të marrë një shtese rroge. Jam konfliktuar me pronarin, jo vetëm sepse nuk më ka paguar orët shtesë, të cilat thotë se nuk i ka shënuar, por edhe për pagën mujore që e vonon me disa muaj”. Si rrjedhojë e mungesës së mekanizmave mbrojtëse, punonjëset lihen në mëshirën e pronarëve për t'i paguar ose jo. Duke qenë se ka shumë kërkesa për punë në zonë, pronarët abuzojnë me punonjëset, duke iu hakërryer se po të ankohen ata i zëvendësojnë.

Për keqkuptime të rastit janë konfliktuar 13.9 për qind e të anketuarave. Vajzat dhe gratë e anketuara tregojnë kujdes në komunikimin me pronarët, pasi duan të shmangin krijimin e përshtypjeve negative tek pronarët, por keqkuptimet janë të pashmangshme. Konfliktet gjenerojnë në procesin e punës dhe për çështje që lidhen me punën. Konfliktet për keqkuptime të rastit janë krijuar më shumë prej stilit arrogant të komunikimit nga ana e pronarëve, se sa nga ana e punonjëseve, të cilat, në komunikimin me pronarët, kanë pasur një pozitë inferiore.


Paragjykimet përçmuese të pronarëve për besimin fetar përbëjnë 5.5 për qind të konflikteve të punonjëseve me pronarët. Siç duket edhe nga të dhënat e anketimit, konfliktet për çështje besimi fetar janë shumë të rralla dhe nuk përbëjnë ndonjë shqetësim për të anketuarat.

Ndërsa konfliktet për shkak të kërkesave të paligjshme të pronarit për të abuzuar me ligjet renditën të fundit me 2.7 për qind. Punonjëset që kanë pasur përgjegjësi për raportimet tek autoritetet shtetërore për detyrimet që pronarët e tyre kanë ndaj punonjësve dhe shtetit kanë deklaruar se pronarët u kanë kërkuar në raste të rralla që ato të abuzojnë me ligjet. Abuzimi ka ndodhur më së shumti në rastin e deklarimit të punonjësve dhe të xhiros së fitimit, kur ekonomistët kanë mbajtur dy libra llogarish, njërin me fakte reale për pronarin dhe tjetrin me shifra të zvogëluara për autoritetet tatimore.

6.3. Konfliktet me drejtuesit në punë

Përqindja e vajzave dhe grave të punësuar që konfliktohen me drejtuesit e njësive ku punojnë, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat është shumë e lartë, 86.3 për qind. Të punësuarat konfliktohen më shpesh me drejtuesit e njësive ku punojnë se sa me pronarët ose me titullarët, sepse me drejtuesit janë në kontakt më të shpeshtë, për shkak të varësisë së drejtëpërdrejtë prej tyre. Ndërsa kontaktet me pronarët dhe me titullarët janë më të rralla dhe më institucionale.

Motivet e konfliktimit me drejtuesit



6.3.1. Konflikte nga keqkuptime të rastit

Konfliktet për keqkuptime të rastit në komunikim, zenë vendin e parë, ndër motivet e konflikteve mes punonjëseve dhe drejtuesve. Kështu mendojnë rreth 28.9 për qind,. Vajzat dhe gratë e punësuar janë në kontakt të drejtëpërdrejtë me drejtuesit e njësive ku punojnë. Për shkak të kontaktit të përditshëm, ata janë edhe në komunikim të vazhdueshëm me ta. Drejtuesit janë shumë të përfshirë në procesin e prodhimit dhe të shërbimit. Ata janë edhe vetë pjesë e ekipit të

punonjësve dhe e shohin nga afër punën e vajzave dhe grave të punësuar. Në komunikimin e përditshëm, ndërmjet drejtuesve dhe të punësuarave, lindin shpesh mosmarrëveshje për çështje të punës. Të anketuarat pohojnë se drejtuesit e njësive ku punojnë janë shumë të pranishëm përgjatë punës dhe nderhyjnë shpesh në punën e tyre. Njëra prej të punësuarave në një fasoneri pohoi se menaxherja ishte shumë e bezdisshme dhe i krijonte stres punonjësve, me të cilat konfliktohej shpesh: “Unë punoj prej tre vitesh këtu. Punën e bëj pa hile dhe nuk duroj dot kur menaxherja vjen dhe më kontrollon orë e çast se si jam duke punuar. Ajo nuk është grua zemërkeqe, por gojën e ka helm. Na shan e fyen se nuk punojmë sa duhet. Ajo e shkretë gojë e ka bërë hasëm me të gjitha gratë këtu, të cilat sa herë që mundohen ta sqarojnë, aq herë përfundojnë në sherr me të, sepse ajo mendon se po i kthejnë fjalën. Ne ja kemi mësuar huqin tani dhe mundohemi të mos ja vemë re, por ajo na provokon vetë dhe pastaj do që ne të heshtim. Nuk kemi as ku ankohe mi, sepse është kunata e pronarit. Ai për atë punë e ka vënë aty, të na rrijë neve çekiç mbi kokë, dhe po u qamë tek ai, ai do besojë atë dhe jo neve”.

6.3.2. Konflikte nga gabimet në punë

Konfliktet për shkak të gabimeve në punë zenë vendin e dytë. Kështu mendojnë rreth 27.4 për qind e të anketuarave. Këto janë konflikte që kanë të bëjnë me marrëdhënien e punës. Niveli i lartë i konfliktimit të punonjësve me drejtuesit ndodh kryesisht në njësitë ekonomike private më shumë se sa në njësitë e shërbimit publik shtetëror. Njësitë ekonomike private mbulojnë veprimtari prodhuese ose tregtimi, ku puna e vajzave dhe grave është thelbësore. Më të ekspozuara ndaj konflikteve për gabime në punë janë vajzat dhe gratë që punojnë në njësitë private si punëtore. Vajzat dhe gratë me shkollë të lartë punojnë përgjithësisht në institucione publike si shkolla, ambulanca dhe në administratën e njësisë vendore. Për shkak të institucionalizimit dhe formalizimit të marrëdhënieve të punës në institucionet shtetërore, detyrat e personelit punonjës janë më të qarta se sa në ndërmarrjet private. Vendet e punës në institucionet shtetërore përmbajnë udhëzime të qarta për postin e punës dhe personeli e ka të qartë se çfarë pritet të bëjë. Po ashtu, edhe drejtuesit e institucioneve publike, duke e konsideruar si të mirëqenë faktin se punonjësit që kanë nën mbikqyerje e njohin profilin e punës, janë më pak ndërhyrës në punën e punonjësve të tyre se sa janë drejtuesit e njësive ekonomike private.

Vajzat dhe gratë që punonjë në firmat private pohojnë se drejtuesit sillen në mënyrë arrogante me to dhe se ato nuk kanë shumë mundësi të ankohen tek pronarët, që në shumicën e rasteve janë të afërm ose miq të drejtuesve. Megjithëse janë marrë në punë nga pronarët, vajzat dhe gratë e punësuar pohojnë se qëndrimi i tyre në punë varet shumë nga opinion i drejtuesve. Duke qenë të pranishëm përditë në punë dhe duke e marrë me drejtimin e njësisë ekonomike, drejtuesit janë njerëzit me më shumë ndikim në organizimin e punës së njësisë. Pronarët e ndjekin së largu veprimtarinë ekonomike, kur nuk janë edhe vetë të punësuar në ndërmarrjen që kanë në pronësi, prandaj fjala e drejtuesve ka shumë peshë për ta. Punonjëset i ruhen shumë vlerësimit të drejtuesve për punën, pasi prej tyre varet qëndrimi i tyre në punë. Gabimet në punë, si produktet skarco ose shërbimet e vonuara, kanë pasoja ndëshkuese për punonjëset që janë përgjegjëse për to. Ndëshkimi mund të jetë largimi nga sektori ku punon në një sektor më të vështirë ose mbajtja e një sasive të hollash nga paga për të dëmshpërblyer dëmin. Një mesogrua që shërbente në një restorant të zonës u shpreh se administratori ishte i pamëshirshëm ndaj gabimeve në punë dhe merrte masa të ashpra ndaj punonjëseve që gabonin. Ajo tregoi se si një punonjëse e mirëmbajtjes së restorantit ishte detyruar nga administratori të paguante me të hollat nga paga ndreqjen e sifonit të banjës së restorantit, i cili ishte bllokuar, ngaqë klientët kishin hedhur sende të pakalueshme. Ai ia kishte faturuar asaj dëmin që kishin shkaktuar klientët, me pretesktin se ajo duhej të qëndronte pas derës sa herë që banja përdorej nga klientët, gjë që ishte e pamundur, sepse e njejta punonjëse merrej njëkohësisht edhe me pastrimin e sallës dhe mjediseve të jashtme të restorantit. Shoqet e punës, të cilave u erdhi keq për punonjësen e pastrimit, paga e të cilës ishte qesharake, mblodhën lekët për të kompensuar sasinë e mbajtur nga drejtuesi.

6.3.3. Abuzime të pronarëve me pagën

Konfliktet që kanë si motiv abuzimin me pagën, renditen në vend të tretë. Kështu mendojnë rreth 23.2 për qind e të anketuarave. Konfliktet për abuzimin me pagën janë një çështje shumë e mprehtë për punonjëset. Atyre u vjen shumë rëndë të diskutojnë për pagën, pasi mendojnë se paga është fiksuar njëherë e mirë me marrëveshjen e punës që është bërë në kontratë. Në institucionet shtetërore nuk ekzistojnë probleme të abuzimit me pagën, por në firmat private ndodhin. Njëra nga arsyet që artikulohej më shpesh nga pronarët dhe administratorët si

justifikim i abuzimit me pagën ishin vonesat në pagesa nga ana e porositësve. Zakonisht, njësitë ekonomike prodhuese fillonin të punonin për porosinë kur porositësi jepte paradhënie, me të cilën sigurohej lënda e parë. Pjesa tjetër e pagesës kryhej kur malli dorëzohej tek porositësi. Jo gjithmonë, porositësit ishin korrektë me pjesën e mbetur dhe ngeleshin debitorë tek prodhuesit. Mungesa e korrektesës në pagesa kishte ndikim të drejtëpërdrejtë në pagat e punonjësve. Punonjëset e anketuara nuk ishin të sigurt nëse moskorrektesa e porositësve penalizonte financiarisht vetëm ato, apo edhe pronarët dhe drejtuesit. Njëra nga punonjëset e një shtypshkronje pas anketimit tha: "U bënë disa vite që punoj në këtë firmë. Pronarët janë njerëz të mirë dhe menaxherja po ashtu. Por ne kemi shpesh probleme me pagën, të cilën nuk e marrim rregullisht. Arsyeja që na jep menaxherja për vonesat në paga është mospagesa e porosisë së librave, broshurave, fletushkave, posterave, etj nga ana e porositësit. Ka ndodhur që kemi ndjetur deri në tre muaj pa paga dhe kemi vazhduar punën rregullisht, sepse pronarët na kishin premtuar që do të na paguanin. Ne u kemi besuar, por ka qenë shumë e vështirë të shtyjme muajt pa rrogë. Kur i kemi marrë ato të shkreta para, na është dukur sikur na i kanë falur dhe jo sikur i kemi merituar".

Të njëjtin shqetësim ngritën edhe të anketuarat që punojnë në restorantet dhe hotelet e zonës. Ato paguheshin pas disa muajsh, ndërkohë që punonin rregullisht. Arsyeja e paraqitur nga drejtuesit ishte mungesa e klientëve dhe pamjaftueshmëria financiare, por të punësuarat vazhdonin të shkonin në punë nga nevoja për të ruajtur vendin e punës dhe me shpresën se do paguheshin një ditë. Njëra nga vajzat, që punonte në një hotel si recepcioniste, tregoi se ajo kishte disa muaj që nuk e kishte marrë rrogën, sepse puna ishte shumë e pakët, por ajo qëndronte ende aty sepse shpresonte se do paguhej për ditët që kishte shkuar në punë, pavarësisht faktit se nuk kishte pasur shumë klientë: "Unë punoj në një hotel të zonës, por që nuk ka shumë punë. Zakonisht hotelet në periferi të Tiranës nuk para frekuentohen nga të huajt, të cilët qëndrojnë në hotelet brenda qytetit, sa më afër qendrës, për të shmangur transportin dhe për të bërë pak jetë sociale në kryeqytet. Me thënë të vërtetën, hoteli më shumë siguron të ardhura prej restorantit se sa prej klientëve që vijnë për të fjetur. Në raste të rralla kemi pasur grupe klientësh që kanë ardhur nga ndonjë organizatë e huaj ose institucion shtetëror që kanë kryer konferenca ose seminare në hotelin tonë, por veprimari të tilla janë të rralla. Hoteli funksionon më shumë si motel, lëshojmë dhoma me orë. Menaxheri më thotë shpesh se do t'i verë kyçin hotelit, sepse më shumë ka

shpenzime se sa të ardhura. Me justifikimin se nuk ka punë në hotel, menaxheri nuk më ka paguar prej katër muajsh. E kam të vështirë të shoh edhe për punë tjetër se jam gjithë ditën ketu”.

6.3.4. Paragjykimet për aftësitë: burim konfliktesh

Rreth 8.2 për qind e të anketuarave mendojnë se shkaku kryesor i konflikteve mes punonjëseve dhe drejtuesve janë paragjykimet përçmuese të drejtuesve për aftësitë profesionale të të punësuarave. Ndonëse më të pakta krahasuar me konfliktet për pagën dhe punën, konfliktet për paragjykimet për aftësitë për punë janë shumë shqetësuese për gratë. Ato mendojnë se janë marrë në punën që bëjnë, pikërisht sepse dinë ta bëjnë atë. Përçmimi që drejtuesit tregojnë për aftësitë profesionale i fyen vajzat dhe gratë e punësuarat. Paragjykimet janë edhe më të rënda, kur drejtuesit që i shfaqin ato nuk e njohin fare profesionin për të cilin paragjykojnë. Një grua që punonte në një firmë të prodhimit të verës tregoi se si menaxheri i nënçmonte aftësitë e saj për punën: “Në punën që bëj ndihem mirë sepse jam në zanatin tim, kam mbaruar shkollën bujqësore për vreshtari dhe e njoh tipologjinë dhe cilësinë e rrushit që përdoret për verë. Mirëpo menaxheri, që për vete mezi e ka marrë shkollën e mesme, më paragjykon për dijet e mia dhe për aftësinë që kam për të punuar për prodhimin e verës. Ai më flet me ironi përpara punëtorëve të tjerë të firmës, duke u tallur me formimin tim. Unë ndihem shumë e nervozuar në prani të tij, sepse është shumë mistrec. Nuk e ka për gjë fyerjen. Sa herë jap një mendim për mallin, ai më drejtohet me përçmim “Mos na u hiq si shkencëtare ti, sikur ke bërë ndonjë shpikje”. Nja dy punëtorë që i rrinë nga pas qeshin me servilizëm, por të tjerët, që kanë respekt për punën time, nuk ia mbajnë izon. Më vjen inat të më nënvlerësojë një individ që nuk e ka haberin nga zanati. Të ishte ndonjë drejtues agronom me shkollë të lartë ia kisha falur sarkazmën, por drejtuesit pa shkollë nuk durohen”.

6.3.5. Kërkesa abuzive të drejtuesve: burim konfliktesh

Kërkesat e padrejta të drejtuesit për të abuzuar me ligjet me qëllim që ai të përfitojë në mënyrë të paligjshme janë motivi i konflikteve për 5.8 për qind të të anketuarave. Konfliktohen për këtë arsye, më së shumti, vajzat dhe gratë që punojnë si ekonomiste në firmat private. Atyre u kërkohet nga drejtuesit që të punojnë me dy palë libra bilancesh, ku në njërin pasqyrohen pagat

dhe fitimet reale dhe në tjetrin shifra fiktive për organet tatimore. Ekonomistet që përballen me kërkesa të tilla ndihen shumë të trysnuara sepse ligji ndëshkon çdo lloj mashtrimi financiar. Nëse kapen në shkelje të ligjit, ato mbajnë përgjegjësi ligjore, sepse janë personat përgjegjës për financat dhe mund të përfundojnë në burg për mashtrim, ndërsa firma mund t'ia hedhë duke paguar një gjobë. Një ekonomiste me përvojë tregoi se në vitet e para të tranzicionit, kur legjislati në fushën fiskale ishte në hapat e para dhe kur sipërmarrja private ishte në formim e sipër, ishte më e lehtë të punohej me dy palë llogari, por me kalimin e viteve edhe fusha e biznesit u rregullua ligjërisht më mirë. Ndër të tjera, ajo pohoi: “Që firmat private punonin me dy palë libra llogarie dihej, por lejohej, mbase ngaqë nuk kishte shumë parashikime ligjore dhe ngaqë punonjësit tatimorë ishin lehtësisht të korruptueshëm. Por vitet e fundit, legjislati është zhvilluar shumë dhe zbatimi i ligjit është më rigoroz. Edhe punonjësit tatimorë ndërrohen shpesh dhe është e pamundur të gjesh gjuhën me këdo që vjen. Firma, kur nuk çante dot me tatimorët në terren, korruptonte ndonjë shef në zyrat e tatimeve, që i urdhëronte ata poshtë ta linin firmën rehat. Por, tani gjërat janë vështirësuar shumë dhe mua më bëhet shumë presion, që, meqë kam përvojë si ekonomiste, të gjej mënyra për t'ja hedhur tatimeve. Ua kam shpjeguar më shumë se një herë pronarëve edhe menaxherit se nuk është e mundur të vazhdohet me mashtrim financiar, pasi është vepër e dënueshme penalisht, por duket se atyre nuk u bën përshtypje, më thonë se po u zbulua gjë, ata do gjejnë mënyrën për ta zgjidhur me para nën dorë dhe më thonë të vazhdoj me dy libra. Jam në ankth të madh për këtë punë. Sa herë vjen fundi i muajit dhe duhet të bëj bilancet për raportimin mujor më ze paniku. Nuk ecet më me mashtrime, infomalitetit po i vjen fundi”.

6.3.6. Konflikte edhe nga ngacmimet seksuale

Për ngacmimet seksuale në punë, janë konfliktuar me drejtuesit e njësive private rreth 4.1 për qind e të anketuarave. Vajzat dhe gratë që janë ngacmuar seksualisht në punë janë në një përqindje të vogël, por ngacmimi seksual është shumë shqetësues për to. Drejtuesit ngacmojnë më shumë vajza dhe gra të reja, të cilat janë pa mbrojtje nga meshkujt e familjes ose të fisit. Dukuria e ngacmimit seksual në fshat është e kufizuar, sepse banorët njihen dhe drejtuesit i ruhen hakmarrjes së familjarëve dhe të afërmeve të punonjësve në njësitë e tyre. Në bizneset private, një pjesë e punonjësve janë edhe të afërta me pronarët dhe drejtuesit, sepse janë


pjesëtarë të një familjeje, fisi a krushqie. Ngacmimet seksuale në një kolektiv me punonjës me lidhje familjare janë shumë të rralla. Familjet e vajzave dhe grave të punësuar në firmat private duan shumë garanci për nderin dhe moralin e vajzave dhe nuseve të tyre, sepse nuk duan që ato të përfundojnë në “duar të këqia” drejtuesish të pamoralshëm që mund të përfitojnë.

Vajzat dhe gratë që bien pre e ngacmimeve seksuale janë ose në lidhje të largëta krushqie me drejtuesit, ose pa lidhje fare. Në mungesë të lidhjeve fisnore, drejtuesit i kanë “duart e lira” për të ngacmuar punonjëset, të cilat ndihen shumë të bezdisura dhe të trembura njëkohësisht, Ato nuk guxojnë të flasin, pasi drejtuesi është i afërmi i shoqeve të punës. Njëra prej grave të reja që punonte në një firmë private tha se ngacmimet e drejtuesit ja kishin bërë punën ferr, por ajo nuk mund të largohet sepse ishte nevojtare dhe i duhej puna, aq më tepër që në fshat të gjesh punë është shumë e vështirë: “U bënë dy vite që punoj këtu. Që në fillim menaxheri më vardisej, por unë i shkura joja të gjitha veprimet e tij. Ai vazhdon të ngulmojë dhe më afrohet shumë. M’ë është shndërruar në makth, kudo shkoj më del para ose më vihet pas. Nuk lëviz e pashoqëruar, nga frika se mos më fut duart me forcë në ndonjë cep. Lëviz me shoqet, që të mos jem vetëm. Luan me mua si macja me miun. Nuk kam ku të ankojem, sepse menaxheri është vëllai i pronarit. Pronari do mbajë anën e tij, e jo timen. Edhe me shoqet nuk hapem dot, sepse ose janë kushërira, ose kanë miqësi familjare me të. Po të hapem, kam frikë se mos më fajësojnë mua sikur e kam provokuar vetë. Nuk i tregoj as bashkëshortit, sepse ai është mik me pronarin, vëllain e menaxherit dhe nuk dua të fus sherrin mes familjeve, sepse po unë do fajësohesha edhe për këtë. Jam shumë e stresuar, por nuk e le dot punën, sepse më duhet paga”. Histori të tilla dëshmojnë se sa të pambrojtura janë vajzat dhe gratë nga ngacmimet seksuale të drejtuesve në firmat private. E vetmja gjë që u garanton mbrojtje është lidhja familjare dhe fisnore, të cilën drejtuesit e respektojnë, sepse përndryshe ndëshkohen prej moralit kolektiv të fisit dhe fshatit. Ndërsa, vajzat dhe gratë, që nuk e kanë këtë lidhje me drejtuesit, janë shumë të ekspozuara ndaj ngacmimeve seksuale dhe e kanë të pamundur të ankohen, pasi rrezikojnë të tërheqin dyshimet për imoralitet mbi veten dhe të humbin vendin e punës.

6.4. Shpeshtësia e paragjytimeve të drejtuesve

Vetëm 20.3 për qind e të anketuarave nuk kanë pasur konflikte me drejtuesit në punë, ndërsa shumica janë konfliktuar. Gratë që konfliktohen çdo ditë, çdo javë dhe çdo muaj me drejtuesit e njësisë ku punojnë përbëjnë 30.2 të të punësuarave. Ndër to, 8.5 konfliktohen çdo javë, 8.1 për qind konfliktohen dy-tre herë në muaj dhe 13.6 për qind konfliktohen më rrallë se një herë në muaj. Konfliktet e shpeshta me drejtuesit kanë një ndikim negativ në motivimin për punë dhe në shëndetin mendor të të anketuarave. Ato pohojnë se është e vështirë të punohet në një mjedis të mbushur me konflikte, ku klima është mbytëse.

Denduria e konfliktimit me drejtuesit në punë



Njëra prej të punësuarave, që konfliktohej çdo javë me drejtuesin e njësisë, u shpreh: “Më duket sikur çdo ditë, kur shkoj punë, shkoj në luftë. Jam bërë me takikardi, më vjen zemra në grykë sa herë ngjis ato të mallkuara shkallë dhe më priten gjunjët në mes. Nuk dua të bëj sherr me njeri, e ca më pak me menaxherin, por ai është shumë këmbëngulës në të vetën dhe më e keqja është se nuk hap rrugë, sikur ka vënë dyllë në vesh dhe nuk dëgjon se çfarë i them, dëgjon vetëm ç’thotë vetë. Ne, vartëset, nuk kemi të drejtë ta kundërshtojmë, as të mbrojmë veten. Nuk është se e ka vetëm me mua, por shumë shoqe të miat përjetojnë të njejtin persekutim. Vijnë pa

qef në punë. I bëmë një letër pronarit, ku i thamë të vërtetën për gjendjen e padurueshme që na ishte krijuar në punë dhe pronari në vend që të vinte vetë e të na dëgjonte na la atë të na bënte gjyqin. Që nga ajo ditë rrimë si mbi gjemba me frikën se do na heqë prej pune. Dy nga shoqet që morën iniciativën për të shkruajtur letrën, pas bisedës me menaxherin u larguan nga puna. Por përpara se të iknin, ato ja përplasën në surrat që ai na binte më qafë kot dhe se puna e tij e vetme ishte të na nxinte jetën. Ai i mohoi të gjitha dhe i tha pronarit se letrën e kishin shkruar ato të dyja ndërsa ne të tjerat ishim vënë nën presion për të firmosur. Pronari nuk kërkoi ballafaqim, por bëri si i tha administratori, i largoi gratë nga puna. Ndihe mi shumë të turpëruara që nuk ja dolëm të ishim të bashkuara, por u tulatëm dhe tani menaxherin e kemi si çekan mbi krye, duke na kujtuar me rast e pa rast se sa bujar është që nuk na shporri të gjithave”.

Edhe gratë që konfliktohen dy-tre herë në muaj përjetojnë të njejtat shqetësime: janë të pamotivuara për punë dhe kanë ndjesi ankthi. Të nxitur nga pronarët për të maksimizuar fitimet, drejtuesit ushtrojnë shumë trysni mbi punonjëset për të punuar më shpejt, për të punuar mbi normen dhe për të dalë në punë ditët e pushimeve të fundjavës dhe në festat zyrtare. Vajzat dhe gratë e punësuar u shprehën se ato nuk janë shumë të mbrojtura prej abuzimit që u bëhet nga drejtuesit dhe pronarët në firmat private, megjithëse e dinë se ka një ligj për punën që i mbron ato nga abuzimi i punëdhënësve. Të trembura se mos humbin vendin e punës, të cilin mezi e kanë siguruar, ato detyrohen të heshtin përpara padrejtësive që u bëhen dhe mundohen të shmangin konfliktet me drejtuesit.

Vajzat dhe gratë që konfliktohen më rrallë se një herë në muaj përbëjnë 13.6 për qind të anketuarave. Ato pohojnë se konfliktet në punë me drejtuesit janë të pashmangshme. Megjithatë, ato tregohen të kujdeshme që të mos konfliktohen, të shmangin konfrontimet me drejtuesit, prej frikës se mos këta e personalizojnë konfliktin dhe hakmerren. Edhe pse bëjnë shumë përpjekje për të mos rënë pre e konflikteve me drejtuesit, shumë vajza dhe gra përfundojnë në situata konfliktuale, të iniciuara më së shumti prej vetë drejtuesve, të cilët nuk i kursejnë kritikën dhe sharjet as ndaj punonjëseve më të përkushtuara. Njëra prej punonjëseve të një firme private, që kishte vite që punonte në firmë, u shpreh se drejtuesja e njësisë ishte gjithnjë e pakënaqur, pavarësisht cilësisë së punës: “Nuk di nëse menaxherja është vërtet e pakënaqur prej punës sime apo luan rolin, ngaqë nuk do të tregojë shenja kënaqësie nga frika se mos shkrehemi. Unë kam shumë përvojë dhe jam e sigurt në aftësitë e mia. Por shefja nuk i njeh fjalët “Të lumshin duart!”. Nuk është se e pres një gjë të tillë, sepse nuk kam nevojë për lëvdata,

ca më tepër në moshën time. Për të nxitur ritmin e punës ajo shpesh na kritikon të gjithave, se nuk punojmë me shpejtësinë e duhur”.

Një përqindje e konsiderueshme të anketuarash, rreth gjysma ose 49.5 për qind, nuk kanë dashur t’i përgjigjen pyetjes në lidhje me konfliktimin me drejtuesit. Ato as nuk e kanë pohuar, por as e kanë mohuar që kanë konflikte, Heshturazi, ato e kanë lënë të nënkuptohet se konfliktet ekzistojnë. Arsyeja kryesore që të anketuarat nuk janë përgjigjur për konfliktet me drejtuesit është sepse anketimet me punonjëset u zhvilluan në mjediset e punës dhe të anketuarat nuk ishin të qeta të shpreheshin, sepse kishin drojë se mos dëgjoheshin ose kuptoheshin prej drejtuesve që ishin të pranishëm gjatë kohës së anketimit. Ishte e pamundur t’i shmangie drejtuesit nga mjedisi i punës gjatë anketimit, sepse anketimi u krye gjatë orarit të punës, për t’i pasur punonjëset të grumbulluara në një vend. Gjatë kohës së anketimit, drejtuesit ishin në punë, duke mbikqyryr procesin e punës. Sado që anketat u kryen me secilën nga punëtoret kokë më kokë, mënjanë të tjerëve, përsëri ato u bënë brenda mjedisit të punës. Edhe të anketuarat që u shprehën për dendurinë e konflikteve ishin shumë të rezervuara kur flisnin për këtë çështje, pasi prania e drejtuesve ose edhe e shoqeve të punës i trysnonte, u krijonte shqetësim.

6.5. Opinionet për punën e kryer nga gratë

Vajzat dhe gratë e anketuara u pyetën për opinionet rreth punës së grave. Të dhënat e anketimit për përgjigjet e tyre janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme. Nga përgjigjet e të anketuarave duket qartë se puna e grave çmohet pozitivisht, por ka edhe paragjykime të shumta, sidomos në drejtim të aftësive.

Sa përputhet mendimi juaj me pohimet e mëposhtme për qëndrimin e grave ndaj punës?	Shkalla e përputhshmërisë				
	Shumë %	Disi %	Pak %	Aspak %	Pa përgjigje %
a- Gratë janë më punëtore se burrat	68.2	24.3	4.3	2.8	0.4
b- Gratë janë më korrekte se sa burrat në marrëdhëniet e punës	66.8	24.4	5.7	2.1	1.0
c- Gratë janë më modeste se burrat për punën që kryejnë	55.8	27.5	9.5	6.1	1.1

d- Gratë kanë më pak pretendime se sa burrat për pagën për të njejtën punë	42.6	26.5	16.4	13.2	1.3
e- Gratë nuk ankohen kur paguhen më pak se sa e meritojnë	42.0	22.0	18.9	16.2	0.9
f- Gratë nuk ankohen kur u veshtirësohen kushtet e punës ose kur u shtohet ngarkesa	36.4	26.0	19.9	16.8	0.9
g- Gratë janë më pak të korruptueshme se burrat	47.0	24.6	18.0	9.2	1.2
h- Gratë e respektojnë ligjin më korrektësisht se burrat	65.0	21.1	9.7	3.6	0.6
i- Gratë bëjnë punë vullnetare më shumë se burrat	72.2	13.2	8.5	45.2	0.9
j- Gratë ankohen më pak se burrat për kushtet jo të përshtatshme të punës	42.3	26.2	17.6	11.8	2.1
k- Gratë ndihen inferiore ndaj burrave në punë	40.9	26.9	14.7	15.0	2.5

6.5.1. Më punëtore se burrat

Shumica e të anketuarave, 68.2 për qind, mendojnë se vajzat dhe gratë janë më punëtore se burrat. Ato e kanë të vërtetuar këtë opinion, pasi ato vetë punojnë shumë, si brenda familjes, ashtu edhe në punë me pagesë që të sigurojnë të ardhura për familjen. Në mjedisin fshatar të Farkës, pesha kryesore e punëve në bujqësi dhe brenda familjes mbahet prej grave. Burrat mundohen të gjejnë punë me pagesë në kryeqytet. Kur kthehen nga puna, ata angazhohen më pak se sa gratë me punët bujqësore dhe rrallë ose aspak me punët e shtëpisë. Të anketuarat, sidomos gratë pohuan se janë të parat që ngrihen nga gjumi dhe të fundit që shkojnë në shtrat. Ato qëndrojnë shumicën e kohës duke punuar dhe duke u shërbyer personave të familjes. Megjithëse burrat janë ata që sigurojnë të ardhurat kryesore, gratë u shprehën se edhe ato vetë janë shumë të zëna me punë bujqësie. Prodhimet e punës së tyre vlejnë për ekonominë e familjes sepse konsumohen brenda saj. Kur prodhimet janë më shumë se sa konsumi familjar, ato edhe tregtohen dhe nga shitja sigurohen të ardhura për familjen.

Rreth 24.3 për qind e të anketuarave mendojnë se opinioni që gratë janë më punëtore se burrat nuk është krejtësisht i qëndrueshëm. Ato mendojnë se meqë të ardhurat kryesore në familje sigurohen prej burrave, atëherë edhe burrat janë punëtorë. Në fshat, ka shumë punë, prandaj edhe burrat marrin pjesë në punët bujqësore. Shtëpitë e reja të ngritura në fshat janë ngritur prej punës së burrave. Është e vertetë që burrat nuk angazhohen shumë në punë shtëpie, por është e justifikueshme, sepse kulturalisht nuk është e pëlqyeshme që burrat të bëjnë punë në shtëpi, edhe për faktin se shumica e grave janë shtëpiake.

6.5.2. Më korrekte se sa burrat në marrëdhëniet e punës

Pjesa më e madhe e të anketuarave, 66.8 për qind, janë të mendimit se gratë janë më korrekte se sa burrat në marrëdhëniet e punës. Vajzat dhe gratë punojnë me shumë përkushtim kudo që punësohen. Ato janë shumë korrekte dhe mundohen të plotësojnë të gjitha kërkesat e punëdhënësve me ndershmëri. Mënyra se si e organizojnë kohën e punës gratë është shumë më efikase se sa e burrave, të cilët gjatë kohës së punës shkojnë nëpër bar-kafenetë e fshatit, sidomos ata që punojnë në administratën publike. Njëra prej të punësuarave në njësinë administrative të Farkës e përshkroi kështu ditën e punës: “Unë kam pak vite që punoj në këtë njësi, por që më kanë mjaftuar për të kuptuar se si punohet këtu. Pothuajse më shumë se gjysma e administratës janë vajza dhe gra të mirëshkolluara, të cilat gjithë kohës janë të zëna me punët e njësisë në zyrat e tyre ose në kontakt me banorët e zonës, të cilët vijnë për zgjidhur nevojat e tyre. Burrat janë në minorancë si të punësuar, por thuajse të gjithë mbajnë poste drejtuese dhe ata që kanë ngelur pa u bërë shefa punojnë specialistë. Në katin e poshtëm të ndërtesës së njësisë është hapur një bar-kafe. Burrat e nisin punën tek bari, me një kafe e një gotë raki me njëri-tjetrin, ose me ndonjë banor të fshatit, të cilit i kanë lënë takim tek bari. Ata duket sikur e kanë zyrën në bar. Kurse gratë qëndrojnë në zyrë, duke u marrë me punët e njësisë. Edhe kur u pihet kafe, ato e porosisin në zyrë për të mos u shkëputur nga puna. Jam e sigurtë që e gjithë pesha e punës në administratë mbahet prej grave. Edhe kryetari i njësisë grave u drejtohet për të mbaruar punët, sepse duket se është i bindur që burrat nuk do ja dalin t’i përfundojnë porositë e tij në kohë. Banorët që kanë takuar më parë shefat, u drejtohen grave për t’u zgjidhur hallet sepse ato janë në dijeni të punëve. Është e padrejtë që duke punuar më shumë se burrat gratë mbajnë poste më të ulta ekzekutive

dhe paguhen më pak. Ndërkohë që burrat shpenzojnë më shumë kohë për kafe dhe për punët e veta dhe emërohen shefa”.

Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarave, 24.4 për qind, mendojnë se opinioni se gratë janë më korrekte se burrat në marrëdhëniet e punës është pjesërisht i vërtetë. Sipas tyre, gratë në përgjithësi janë më korrekte se burrat sepse ato nuk hyjnë në botën e pazareve për përfitime. Megjithatë, ato mendojnë se korrektësia nuk karakterizon vetëm gratë. Gjatë përvojës së tyre, ato kanë njohur dhe punuar edhe me burra që kanë qenë korrekte në marrëdhëniet e punës. Ato mendojnë se korrektësia nuk ka të bëjë me gjininë, por me karakterin dhe personalitetin. Një njeri me karakter të mirë është i ndershëm në marrëdhënie më të tjerët, pavarësisht faktit është grua apo burrë.

Një pjesë e vogël e të anketuarave, 5.7 për qind, mendojnë se opinioni për gratë si punonjëse më korrekte se burrat është pak i vërtetë. Ato u shprehën se gjatë punës së tyre kanë njohur burra që kanë qenë shumë korrekte dhe janë marrë si shembull prej të tjerëve në punë. Gjithësesi ato pohuan se prej grave pritët të jenë më shumë korrekte se burrat në punë. Prandaj drejtuesit janë më të rreptë ndaj grave që nuk janë korrekte në punë. Ata i kritikojnë dhe ua venë në pah më shumë moskorrektesën, ndërsa ndaj burrave janë më tolerantë.

6.5.3. Më modeste për punën që kryejnë

Rreth 55.8 për qind e të anketuarave mendojnë se gratë janë më modeste se burrat për punën që kryejnë. Modestia është një virtyt i pëlqyeshëm që vlerësohet pozitivisht nga shumica e vajzave dhe grave. Mirëpo, modestia i bën ato të padukshme, pasi duke mos i vlerësuar si të rëndësishme rezultatet e punës së tyre, ato nënvlerësojnë edhe aftësitë e veta. Një mësuese e shkollës së mesme pohoi se ajo vetë dhe shoqet e saj punonin me shumë përkushtim me nxënësit me përparim të dobët në mësim, ndërsa kolegët e saj, me përjashtim të njërit, ishin shumë indiferentë për ecurinë mësimore të nxënësve, madje edhe paragjykues për aftësitë e tyre, gjë që i mbante ata larg nxënësve: «U bënë rreth 15 vjet që jam mësuese dhe jam shumë e kënaqur nga puna e mësuesisë, sado që është e lodhshme. Në shkollë të mesme nxënësit janë të vështirë, pasi nuk binden edhe aq lehtë të mësojnë. Gjithësesi, unë dhe koleget bëjmë shumë punë bindëse me ta që shkolla vlen, se u duhet për punë dhe për bashkëjetesë shoqërore. Ne mësueset merremi shumë me ta. Edhe kur nxënësit kanë konflikte me njëri-tjetrin, ne mësueset mundohemi t'i

pajtojmë dhe të ulim gjakrat e nxeura mes tyre. Me keqardhje shoh që kolegët burra nuk shqetësohen edhe aq për nxënësit, me përjashtim të njërit. Ata kanë një qëndrim shumë indiferent, si për ecurinë mësimore të tyre, ashtu edhe për shqetësimet e tjera që interferojnë në mundësitë për të mësuar. Kur bisedojmë në sallën e mësuesve për rezultatet që kanë nxënësit, gratë nuk i atribuojnë asnjëherë vetes merita kur klasat dalin mirë në lëndët e tyre, ndërsa burrat të gjithë mossuksesin ia dedikojnë nxënësve, të cilët i vlerësojnë si të paaftë, të painteresuar dhe të pasjellshëm. Kur një klasë doli dobët në një testim që u krye nga drejtoria arsimore, kolegu që jepte mësim në atë klasë u justifikua duke fajësuar nxënësit si të paaftë, ndërsa një mësuese, klasa e së cilës kishte kapur rezultate më të mira në të njëjtin testim, u shpreh se nuk ishte shumë e kënaqur, pasi po të kishte punuar më shumë me nxënësit ata do kishin dalë më mirë, pra fajësoi veten për rezultatin dhe jo nxënësit».

Një pjesë e të anketuarave, 26.5 për qind, mendojnë se është disi e vërtetë që gratë janë më modeste se burrat për punën e kryer. Ato shprehen se në përgjithsi modestia karakterizon më shumë gratë se burrat, por ato kanë njohur edhe burra modestë në punë. Janë 9.5 për qind të anketuarat që mendojnë se është pak e vërtetë që gratë janë më modeste për punën e tyre. Ato shprehen se modestia në kohën e sotme nuk është ndonjë avantazh për gratë, prandaj gratë e punësuar, sidomos ato të reja, mundohen ta reklamojnë sa më shumë punën që bëjnë, në mënyrë që të marrin vlerësime nga punëdhënësit. Dikur shprehen ato, kur gratë punonin në ndërmarrjen bujqësore ishin aq modeste sa edhe kur lëvdoheshin për punën e kryer, faqe të tjerëve, skuqeshin nga turpi, ndërsa në ditët e sotme vajzat e shkolluara, që ia dinë vlerën vetes dhe punës, nuk e fshehin krenarinë për zotësitë në punë.

Një pjesë e të anketuarave, 6.1 për qind, shprehen se nuk është aspak e vërtetë që gratë janë më modeste se burrat për punën e tyre. Kur gratë janë të bindura në aftësitë e veta dhe kur puna e tyre jep rezultate të dukshme, ato janë të vetëdijshme për vlerën që kanë si profesioniste dhe e mbajnë kokën lart, sikurse burrat e zotë në punën e tyre.

6.5.4. Kanë më pak pretendime për pagën se burrat

Pjesa më e madhe e të anketuarave, 46.2 për qind, mendojnë se për të njëjtën punë gratë kanë më pak pretendime për pagën se sa burrat. Ato pohojnë se gratë nuk i diskutojnë dhe as i kundërshtojnë kushtet e punës, kur ato janë të papërshtatshme dhe i pranojnë më lehtë se sa

burrat kërkesat e punëdhënësve për punë shtesë. Tek marrëveshja e punës përfshihet edhe shpërblimi për punën, por gratë e kanë shumë të vështirë të negociojnë për pagën dhe e pranojnë pa diskutime shifrën që u afrohet. Gratë që janë punësuar në firma private, edhe kur janë pyetur se sa mendonin të shpërbleheshin, nuk kanë guxuar t'i vënë një çmim punës së tyre. Ato e kanë pranuar në heshtje shpërblimin që u është propozuar, pa guxuar as të infomohen për kushtet e punës. Njëra nga të anketuarat që punonte në një firmë private të prodhimit të verës, ku punonin edhe disa burra u shpreh: “Në firmën ku punoj unë, shumica e të punësuarve janë vajza dhe gra. Kur na morën në punë, as nuk na thanë fare se sa do paguheshim dhe na vinte shumë turp të pyesnim. Gjatë muajit të parë të punës e mësuam. Paga ishte shumë e ulët, por ne menduam që më mirë me atë pagë se sa pa punë fare dhe nuk u ndiem. Në ndërmarrje ishin punësuar edhe disa burra, të cilët nuk u kënaqën me pagesën dhe bënë fjalë me administratorin, duke i thënë se pagesa ishte qesharake. Sipas tyre, administratori u kishte lënë të kuptonin se do merrnin një pagë më të mirë se sa ajo që po merrnin dhe ata ngulnin këmbë të paguheshin më shumë. Administratori u tha që nuk mund t’ua rriste pagën për atë punë që po bënin, por do rishikonte ngarkesën dhe llojin e punës për ta. Ne i dëgjuam këto biseda dhe u dhamë të drejtë burrave, por nuk morëm guximin të kërkonim të njëjtën gjë. Puna sa vinte e shtoej dhe administratori na kishte thënë se sa më shumë punë të kishte, aq më shumë do paguheshim, por në fakt ne paguheshim njësoj. Administratori justifikojte se paratë shkonin për të përballuar çmimet e larta të lëndës së parë dhe koston e furnizim-shpërndarjes. Ne punonim edhe në ditë festash zyrtare dhe nuk paguheshim për ditë pushimesh. Kur e pyetëm administratorin se përse nuk bënim pushim për festa zyrtare na u përgjigj se ato janë për shtetin dhe jo për privatin. Çmimet rriten për ditë, ne punojmë më shumë, por paga ngelet njësoj. Burrat që e hapën gojën janë rregulluar në punë më të mira brenda firmës dhe paguhen më mirë”.

Të anketuarat që mendojnë se është disi e vërtetë që gratë kanë më pak pretendime se burrat për pagën janë 26.5 për qind. Në ekonominë e tregut është mëse normale që të pretendohet një shpërblim i denjë për të përballuar shpenzimet e jetesës. Sikurse burrat, edhe gratë e punësuar kontribuojnë në ekonominë e familjes, prandaj është e pranueshme që edhe ato të kenë pretendime për pagën. Një pjesë e të anketuarave, 16.4 mendojnë se opinioni se gratë kanë më pak pretendime për t’u paguar është pak i vërtetë, sepse kushtet e jetesës dhe çmimet e larta ua imponojnë atyre këtë kërkesë. Në të shkuarën, kur punonin në ndërmarrjen bujqësore, pagat ishin të përcaktuara nga shteti dhe nuk kishte pretendime nga ana e punonjësve. Por, që nga koha kur

është mbyllur ndërmarrja shtetërore, kushtet e punës dhe pagat kanë ndryshuar shumë. Tregu ka mekanizmat e vet të rregullimit të pagave, të cilat nuk ndikohen më nga ndërhyrja e shtetit, përveç vendosjes së pagës minimale. Pretendimet për pagën, përveçse me kërkesat e familjes për shpenzime mujore dhe me nivelin e çmimeve, lidhen edhe me llojin dhe kushtet e punës. Vajzat dhe gratë e arsimuara, sidomos ato me arsim të lartë kanë më shumë pretendime për pagën, bazuar në nivelin e tyre të arsimit dhe specializimin pasuniversitar. Të anketuarat mendojnë se kjo kategori vajzash dhe grash kanë të drejtë të kenë pretendime për pagën, për shkak të investimit më të madh në arsimimin e tyre.

Një përqindje e vogël e të anketuarave, 13.2 për qind, mendojnë se gratë kanë po aq pretendime se burrat për pagën. Por kjo është një përqindje e vogël, sikurse është përqindja e vajzave dhe grave që guxojnë të pretendojnë një pagë dinjitoze. Njëra prej vajzave të arsimuara, që kishte negociuar me pronarin për pagën, pohoi se paga duhet të jetë një çështje e diskutueshme bashkë me kushtet e punës dhe jo e përcaktuar njëanshmërisht nga punëdhënësi. Ndër të tjera, ajo u shpreh: “Unë kam mbaruar master për ekonomi, drejtimi financë dhe jam specializuar për të punaur me biznesin. Kam bërë edhe kurset e auditimit dhe të menaxhim biznesit. Unë u mora në punë me konkurs dhe kur u pyeta në intervistë për pagesën unë dhashë variantin tim, pasi isha njohur me ngarkesën e punës dhe kisha pasur disa përvoja të mëparshme nëpër biznese si financiere. Mesa duket, punëdhënësit tim nuk i kishte ndodhur që një vajzë të kërkonte të negocionte pagën dhe u duk i çuditur, jo më shumë nga shifra që artikulovala, se sa nga guximi. Më tha se shifra që kishte menduar firma ishte poshtë pritshmërive të mia, por unë ngulmova që të gjenim një të mesme që të kënaqte të dyja palët. Vija nga një përvojë tepër zhgënjyese me një punëdhënës të mëparshëm që, për 12 orë punë në ditë, më paguante vetëm 15.000 lekë të reja në muaj. Nuk do isha larguar nëse nuk do më kishte rënë të fikët në punë. Isha e shfrytëzuar deri në palcë nga punëdhënësi i parë, i cili naivitetin tim si punonjëse pa përvojë e shfrytëzoi shumë mirë. Firma auditonte bizneset dhe unë punoja për auditimin mujor, bilancin dhe deklaratimet tatimore për llogari të firmave. Kur nisa punë, kisha pak dosje, por ngaqë punoja shpejt i hapa punë vetes, sa më shumë punoja aq më i madh bëhej pirgu i dosjeve. I bëja sepse mendoja se punëdhënësi ishte duke vepruar ndershmërisht. Madje kur zbrisja për të marrë ndonjë kafë poshtë, ai ma priste “Mos u vono, se të presin dosjet!”. Kur i njoftova largimin tim nga puna më pyeti për arsyen dhe i thashë që nuk e përballoja dot 12 orarëshin në ditë dhe ai m’u përgjigj se kështu janë të gjitha punët në privat, pa orar. Madje, sipas tij, unë duhej t’i isha edhe

mirënjohëse sepse më kishte paguar, ndërkohë që duhej ta kisha paguar unë atë, sepse kisha mësuar zanatin. Ky ishte kulmi! Më erdhi keq për veten time, sa e pavlerësuar kisha qenë dhe sa keq isha shfrytëzuar, duke u treguar e zellshme dhe e sinqertë. Kjo përvojë më hapi sytë që të kërkoja vlerën e merituar për punën që do bëja tek punëdhënësit e tjerë. Firma që më punësoi me konkurs e pranoi kërkuesën time. Jam shumë e kënaqur nga puna tani. Në mbarim të vitit të parë të punës, bordi i firmës propozoi rritje në detyrë për mua. Besoj se pretendimi im për pagën ishte i justifikuar dhe punëdhënësi e vërtetoi këtë duke vlerësuar punën time”.

6.5.5. Ankohen më pak për kushtet e papërshtatshme të punës

Pjesa më e madhe e të anketuarave, 42.0 për qind mendojnë se gratë nuk ankohen kur paguhen më pak se sa e meritojnë. Të punësuarat në privat u shprehën se ato nuk ankohen, kur punëdhënësi i ngarkon punë shtesë pa pagesë. Në përgjithësi ato pohojnë se punëdhënësit janë treguar korrektë me pagat, pavarësisht se ndonjëherë ua kanë vonuar pagat, por për punën shtesë, ato nuk paguhen. Njëra nga gratë që punonte në një firmë shtypshkronje u shpreh se kur ka fluks të madh pune, punohet jashtë orarit, për t’iu përgjigjur në kohë porositësve, por orët e punës jashtë orarit nuk llogariten si punë me pagesë, por si vazhdimësi normale: „Kohzgjatje të tilla janë të zakonshme. Kur ndonjëra ankohet se përse nuk paguhet për orët shtesë, manaxherja i përgjigjet se po të kishte punuar më shpejt do e kishte përfunduar punën brenda orarit, pra që është faji i saj që rri më gjatë në punë për ta mbaruar. Kur dëgjojmë këtë përgjigje, ne të tjerat nuk guxojmë të flasim më. Manaxherja na e kujton shpesh që duhet t’i jemi mirënjohse pronarit që na mban në punë dhe t’i jemi borxhlie gjithë jetën sepse pas derës presin plot gra të tjera që kërkojnë punë. Është e kotë të ankohesh, sepse jo vetëm që nuk e gjen të drejtën, por të tregojnë derën. Prandaj pranojmë çfarëdo kërkesë për punë jashtë orarit. Nuk duam të humbasim punën që kemi“.

Rreth 22.0 për qind e të anketuarave, mendojnë se është disi e vërtetë që gratë nuk ankohen kur paguhen më pak se sa e meritojnë. Ato pohojnë se gratë janë të vetdijshme për punën që bëjnë dhe kanë të drejtë të kërkojnë shpërblimin që meritojnë. Duke e ditur se pagat vendosen nga punëdhënësi, në varësi të punës, gratë e punësuarat që bëjnë punën sipas kërkesave, nuk kanë se përse të ngurrojnë të kërkojnë shpërblimin për punën e bërë. Nëse fitimet e firmës rriten prej punës, atëherë një pjesë e tyre duhet të shkojë për rritje pagash. Megjithatë, rrallë herë

ndodh që pagat të rriten kur firmat sigurojnë fitime prej biznesit. Edhe kur rriten, kjo ndodh për shkak të ngritjes në detyrë, e cila kushtëzohet me arritjen të mëparshme në punë.

Një pjesë e të anketuarave, 18.9 për qind mendojnë se është pak e vërtetë që gratë nuk ankohen për pagën, pasi paga është rezultat i punës së tyre dhe nëse ato nuk pretendojnë të shpërblehen për punën, kjo është në dëm të tyre. Ato shprehen se, në ekonominë e tregut, pagat nuk janë të përcaktuara njëherë e përgjithmonë dhe lëvizin me rritjen e çmimeve, prandaj edhe pretendimet për pagë janë të justifikuara. Përgjithësisht, vajzat dhe gratë e punësuarat e kanë kuptuar se duhet të ankohen kur nuk shpërblehen aq sa e meritojnë, në mënyrë që të dëgjohen.

Një përqindje më e vogël e të anketuarave, 16.2 për qind, mendojnë se opinioni që gratë ankohen më pak kur nuk paguhen nuk qëndron. Kjo ndodh kur të punësuarat janë të mirarsimuara dhe kanë vetëbesim në kërkesat e tyre për punën dhe pagën. Njëra nga të punësuarat në administratën vendore kishte pasur një përvojë të tillë dhe kishte mundur të merrte shpërblimin që i takonte pasi ishte ankuar: "Kur punuam planin urbanistik të njësisë sonë administrative, unë dhe kolegja e zyrës punuam ditë e natë për disa muaj rresht mbi studimin. Në përfundim të vitit, u shpërndanë shpërblime shtesë për punonjësit dhe unë bashkë me kolegen time u shpërblyem në një shifër qesharake, njësoj me punonjës të tjerë, që nuk kishin punuar as çerekun e punës sonë. Kryetari donte t'i shpërblente të gjithë njësoj, që të mos kishte hatërmbetje mes punonjësve dhe të shmangte fjalët. Unë u ankova dhe kryetari reagoi me shumë mirëkuptim, madje u shpreh se se duke dashur të bënte drejtësi për të gjithë njësoj, në fakt po bënte padrejtësi ndaj atyre që kishin punuar më shumë. Nuk ishte vetëm çështje pagese, por edhe vlerësimi për punën e bërë".

Përgjithësisht, vajzat dhe gratë e anketuara kanë shumë pak pretendime për kushtet e punës. Rreth 34.6 për qind e të anketuarave mendojnë se është shumë e vërtetë që gratë nuk ankohen kur u vështirësohen kushtet e punës, ose kur u shtohet ngarkesa. Për shkak të mundësive të pakëta për punësim, vajzat dhe gratë e pranojnë punën pavarësisht nga kushtet. Thjeshtësia e tyre shkon deri aty sa shprehen se mjaft të kenë një punë, por nuk ka rëndësi se si janë kushtet dhe ngarkesa. Njëra nga gratë që punonte në një restorant të zonës u shpreh se është e vështirë të ankohesh kur shtohet ngarkesa e punës, pasi sa më shumë njerëz të vijnë për të bujtur, aq më mirë është për biznesin: "Ne e kemi të qartë se puna jonë varet nga njerëzit që vijnë në restorant. Nëse ka shumë ngarkesë, qëndrojmë më gjatë në punë sepse duhet të shërbejmë derisa largohet klienti i fundit. Pronari na thotë që nga puna jonë varet se sa i preferuar do jetë restoranti,

prandaj, po deshëm të qëndrojmë në punë, duhet të punojmë shumë dhe me cilësi, që të kënaqen klientët. Natyrisht që kur vijnë shumë njerëz, edhe fitimet janë më të shumta, por ne nuk paguhemi më shumë kur ka shtesë pune. Pronari na thotë që fitimet i përdor për mirëmbajtje. Sipas tij, ne duhet të jemi të kënaqura me pagën që kemi, sepse mund të ngeleshim edhe pa rrogë”.

Një pjesë e të anketuarave, rreth 26.0 për qind mendojnë se opinioni që gratë nuk ankohen kur u vështirësohen kushtet e punës është pjesërisht i vertetë. Ato shprehen se jo gjithmonë gratë pranojnë çfarëdo kërkesë të punëdhënësit për rritjen e ngarkesës së punës. Duke i njohur kushtet e kontratës së punës, gratë e dinë me siguri se çfarë pune pritet prej tyre dhe ngarkesën që përmbahet në të. Ato nuk e pranojnë ngarkesën shtesë po qe se nuk binden se shtesa do të paguhet. Do ishte kundër interesit të tyre të pranonin të bënin punë shtesë pa pagesë. Në mënyrë të ngashme mendojnë edhe 19.9 për qind e të anketuarave, të cilat shprehen se opinioni që gratë nuk ankohen për kushtet e punës dhe ngarkesën nuk qëndron shumë, pasi ato i kanë të gjitha mundësitë të shprehin pakënaqësitë në lidhje me punën. Rreth 16.8 për qind e të anketuarave janë të mendimit se gratë ankohen pak për kushtet e punës dhe ngarkesën. Ato shprehen se gratë nuk kanë pse të mos kërkojnë shpërblim për punën që bëjnë dhe as të rrinë gojëkyçur, kur kushtet e punës përkeqësohen.

Të anketuarat që mendojnë se gratë ankohen më pak se burrat për kushtet jo të përshtatshme të punës janë 42.3 për qind. Sipas tyre, gratë dhe vajzat që punojnë në firmat private nuk ankohen fare për kushtet e punës, madje as për vonesat në pagë që zgjasin me muaj. Kushtet e punës, sidomos në firmat private në sektorin fason, nuk janë shumë të përshtatshme. Vajzat dhe gratë e punësuarat në këtë sektor ankohen se punojnë në kushte klimaterike të papërshtatshme, pa asnjë lloj konforti, në salla të mëdha që dikur kanë qenë magazina ose në ndërtesa të reja plot lagështirë. Njëra prej të anketuarave që punonte në një fasoneri jorganësh tregoi se sa të vështira ishin kushtet e punës dhe se si punëtorët nuk guxonin të ankoheshin nga frika se mos keqkuptoheshin prej pronarëve se mos po kërkonin luks: “Punishtja ku punoj i ngjan më shumë një stalle me katër mure dhe një çati. Ne gratë jemi grumbulluar në mes të stallës dhe punojmë në kushte mjerane, në mes të lagështisë dhe mykut. Në dimër na mpihen duart nga i ftohti dhe lagështia dhe ngrohemi duke punuar shpinë me shpinë me njera-tjetrën. Më ngrohtë është jashtë se sa brenda punishtes. Kur ka ditë me diell në dimër gëzohemi se nuk do na pikon çatia dhe uji nuk do lëpijë muret që janë të mykura. Ndonjëherë dalim edhe të marrim ca rreze të

ngrohta dielli që të na ngrohen duart që na janë mpirë nga i ftohti brenda. Në verë nuk rrihet prej të nxehtit mbytës që përzihet me duhmën e rëndë të mykut dhe lagështisë dhe na djegin sytë nga djersa. Në këto kushte punojmë 8 deri në 10 orë në ditë dhe nuk ankohe mi dot, sepse njëra prej pronareve që bën manaxheren e punishtes qëndron me ne në punishte dhe thotë se kur duron ajo, ne punëtoret nuk kemi se përse të ankohe mi. Kur i kërkua që në dimër të vendoste një furnellë me korent që të ngrohje sallën ajo na tha se firma mezi përballonte faturën e energjisë për ndriçim e jo më për ngrohje”.

Rreth 26.2 për qind e të anketuarave mendojnë se opinioni që *gratë ankohen më pak se burrat për kushtet jo të përshtatshme të punës* është disi i vërtetë. Ato shprehen se përgjithësisht gratë durojnë më shumë dhe pranojnë të bëjnë më shumë sakrifica duke mohuar mirëqenien e vet. Duke qenë se puna me pagesë është një aset i rrallë në fshat, gratë e punësuarat jashtë shtëpisë nuk ankohen për kushtet e punës. Në njëfarë mënyrë ato janë përshtatur me kushtet e vështira të punës, duke bërë punë të rënda në bujqësi e blegtori që në moshë të re, dhe shumica e punëve bujqësore kryhen ose jashtë në natyrë ose në hambare dhe stalla. Të mësuara me kushte të rënda pune, vajzat dhe gratë fshatare, të punësuarat në firmat private, nuk ankohen për kushtet e punës. Ato i gëzohen faktit që janë në punë, ndërkohë që shumica e grave në fshat janë të papuna ose shtëpiake, si dhe nuk duan të rrezikojnë vendin e punës duke u ankuar.

Mendojnë se opinioni që *gratë ankohen më pak se burrat për kushtet jo të përshtatshme të punës* është pak i vërtetë 17.6 për qind dhe aspak i vërtetë 11.8 për qind e të anketuarave. Sipas opinionit të tyre, vajzat dhe gratë e punësuarat, sidomos në sektorin publik, ankohen për kushtet e papërshtatshme të punës. Edhe kur kushtet e punës përkeqësohen, ato kërkojnë përmirësimin e tyre. Por, të punësuarat në sektorin publik janë përgjithësisht mësuese, mjekë dhe infermiere, si dhe punonjëse të administratës vendore. Ato në punën e tyre kanë të bëjnë me një rrez të tjerë, të cilëve u ofrojnë shërbim, prandaj përmirësimin e kushteve të punës nuk e shohin si përfitim për vete, por për banorët e fshatit që marrin shërbime prej tyre. Një infermiere që punonte në qendrën shëndetësore të fshatit u shpreh: “Qendra është ndërtuar para njëzet vitesh dhe në të nuk janë bërë rregullime për mirëmbajtjen për një kohë të gjatë, gjë që shkaktoi degradim të godinës, rënie pjesore të mureve dhe lagështi. Në këto kushte ishte e vështirë të kryeshin vizita mjekësore ose të mbaheshin pacientët për shtrim ditor në raste urgjencash. Ishte e nevojshme të bëheshin rregullime në infrastrukturën e qendrës, në mënyrë që të ishte funksionale dhe të punohej. Unë dhe mjekja e qendrës e kishim të vështirë të qëndronim me orë të

tëra në punë, nga mungesa e kushteve minimale infrastrukturore dhe mungesa e ngrohjes në dimër. Prandaj, para dy vitesh, u ankuam në drejtorinë e shëndetit dhe bëmë një kërkesë për rikonstruktim të godinës, përmirësim të kushteve infrastrukturore, për ngrohje dhe për lavaman dhe ujë të rrjedhshëm. Në fillim, specialisti i drejtorisë së shëndetit na tha se po kërkonim gjithë këtë salltanet për vete, por ne i thamë se e kërkonim për pacientët. Pas shumë ndërhyrjeve edhe nga ana e kryetarit të njësisë dhe deputetit të zonës, u miratua rikonstrukcioni i qendrës shëndetësore”.

6.5.6. Janë më pak të korruptueshme

Rreth 47.0 për qind e të anketuarave janë të opinionit se gratë korruptohen më pak se burrat. Ato shprehen se gratë i përmbahen më shumë rregullores së punës dhe ligjeve të shtetit. Korrektësia e grave ndaj klientëve lidhet me shkallën e lartë të përgjegjshmërisë së grave ndaj ligjeve. Gjithashtu, gratë i druhen ndëshkimit ligjor për korrupsionin dhe frika nga ligji i frenon të korruptohen. Gratë nuk përfshihen në afera korruptive, që më së shumti ndodhin mes burrave, të cilët gjejnë mënyrat për të negociuar për ndarjen e parave. Gratë e kanë të kufizuar kohën e qëndrimit jashtë shtëpisë pas punës, prandaj nuk kanë edhe mundësi të qëndrojnë në shoqërinë e personave që tentojnë të kryejnë korrupsion ose të ndërmjetësojnë. Kur janë të punësuar në institucione publike, gratë kryejnë punën në shërbim të banorëve nga zyrat e tyre dhe nuk shoqërohen me ta në kafenetë e fshatit, siç ndodh me burrat nëpunës të administratës. Ato ruajnë marrëdhënie institucionale me përfituesit e shërbimeve publike dhe nuk shoqërohen me ta në mjedise jashtë institucionit.

Edhe gratë që punojnë në institucionet e shëndetit dhe të arsimit publik, duke qenë ofruese të drejtëpërdrejta shërbimi, nuk korruptohen lehtë sepse kanë njohje me përfituesit e shërbimeve publike si nxënësit ose pacientët. Kjo gjë dëshmohet nga shumë të anketuara që punojnë si mësuese dhe mjekë. Njëra prej mësueseve të anketuara, pas anketimit, për çështjen e korruptimit të grave u shpreh se gratë kanë një sens morali më të zhvilluar se burrat në lidhje me paratë: «Ne grave edhe kur na jepet mundësia për të marrë para i refuzojmë ato sepse mendojmë se nuk na takojnë, pasi paguhemi për punën. Mua më janë ofruar para nga prindër që i kanë pasur nxënësit me rezultate të dobëta në lëndën time për t’u vënë një notë më të mirë, por nuk kam pranuar kurrë. Është detyra ime si mësuese që t’i mësoj fëmijët e tyre të marrin vetë nota të mira

dhe jo t'u marr para prindërve. Kur kam punuar në mënyrë të diferencuar me disa fëmijë pas orarit të mësimëve, ndonjë prind ka dashur edhe të më paguajë, por unë përsëri e kam refuzuar. Ndonjëherë për të më bërë qefin, kur fëmijët u kanë dalë mirë në lëndën time, prindërit në shenjë mirënjohjeje më kanë sjellë edhe dhurata, të cilat i kam kthyer mbrapsht me shumë mirësjellje, sepse e di që ata nuk e kanë bërë me qëllim të keq. Njoh edhe kolege të tjera që kanë pasur situata të ngjashme dhe kanë reaguar njësoj si unë. Mendoj se në mësuesit kemi shumë ndikim në modelimin e personalitetit të nxënësve, prandaj bëjmë shumë kujdes për të dhënë një shembull të mirë, që ata të na marrin për modele të vlefshme. Nëse u mësojmë nxënësve se për punën që paguhemi nga shteti duhet të na paguajnë edhe ata nga xhepi, ne i edukojmë të bëhen të pandershëm. Duke u sjellë ne pandershmerisht sot me ta, i mësojmë ata të sillen pandershmerisht me ne nesër ».

Rreth 24.6 për qind të të anketuarave mendojnë se opinioni që gratë janë më pak të korruptueshme se burrat është disi i vërtetë. Ato pohojnë se korrupsioni është shumë i përhapur dhe nuk ka mundësi që vetëm burrat të korruptohen. Megjithëse pranojnë se përgjithësisht gratë janë përfolur më rrallë për korrupsion, ato mendojnë se kjo ka ndodhur ngaqë gratë kanë më pak mundësi të korruptohen, sepse korrupsioni ndodh në nivele të larta pushteti dhe ka pak gra në këto nivele. Ndërsa përsa i përket pagesave nën dorë, ato mendojnë se edhe gratë pranojnë para nën dorë për një punë që janë paguar tashmë, megjithëse bëjnë më shumë rezistencë se burrat.

Një pjesë e të anketuarave, 18.0 për qind mendojnë se ky opinion qëndron pak. Gratë janë të përfshira në veprimtaritë ekonomike, po aq sa edhe burrat dhe nuk janë të imunizuara ndaj ngasjeve korruptive. Paratë e korrupsionit mund t'i shtojnë diçka të ardhurave mujore, mund t'i ndihmojnë për të përballuar shpenzimet e jetësës, prandaj gratë mund ta pranojnë korrupsionin njësoj si burrat. Për më tepër, korrupsioni është bërë një dukuri kaq e zakonshme, saqë duket sikur është normalizuar. Këtë gjë e pranojnë edhe 9.2 për qind e të anketuarave, të cilat mendojnë se nuk është fare e vërtetë që gratë nuk korruptohen. Sipas tyre, gratë janë po aq të korruptueshme sa edhe burrat, nëse u jepet mundësia, sepse moralizimi që pengonte korrupsionin si një dukuri të keqe, antihumane dhe antishoqërore është zhbërë. Ato pohojnë se vendet e punës në shtet mbahen më shumë për të siguruar para nëpërmjet korrupsionit, se sa për të marrë pagën. Një infermiere, që ishte punësuar duke dhënë rryshfet, u shpreh se për të nxjerrë paratë që kishte paguar për punësimin ishte e detyruar të pranonte para nga pacientët, megjithëse kjo gjë ishte

shumë e papëlqyeshme për të, pasi jo vetëm që e kishte për detyrë t'u shërbente, por edhe kishte njohje me shumicën prej tyre, sepse ishin nga i njefti fshat.

6.5.7. Respektojnë ligjin më korrektësisht se burrat

Të anketuarat që mendojnë se gratë e respektojnë më korrektësisht ligjin se burrat përbëjnë 65.0 për qind. Pjesa më e madhe e vajzave dhe grave që kanë të bëjnë me ligjet janë punësuar kryesisht në institucionet shtetërore dhe i përmbahen me rigorozitet zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore. Ndërsa në sektorin privat, vetëm një pjesë e vogël e të punësuarave kanë të bëjnë me ligjin. Ato janë përgjithësisht në pozicione vendimarrëse, si drejtuese njësisish, juriste ose ekonomiste. Gratë në këto pozicione kanë formim universitar dhe janë njohëse të mira të kuadrit ligjor dhe sanksioneve në rast moszbatimi të tij. Gjithashtu, gratë nuk i anashkalojnë kërkesat ligjore dhe i referohen ligjit për përmbushjen e funksioneve të postit të tyre. Janë 21.1 për qind të anketuarat që mendojnë se ky pohim është disi i vërtetë, ndërsa 9.7 për qind mendojnë se është pak i vërtetë.

6.5.8. Më të prirura për punë vullnetare

Shumica e të anketuarave, 72.2 për qind, mendojnë se gratë bëjnë punë vullnetare më shumë se burrat. Ky opinion është shumë i vërtetë në fshat, ku mbarëvajtja e punëve në bujqësi e blegtori, si dhe punët brenda shtëpisë përballohen më shumë prej grave. Vullnetarizmi është parë ngushtësisht i lidhur me figurën e gruas, sidomos të nënës, e cila mban peshën kryesore të përkujdesjes dhe edukimit të fëmijëve. Gjithashtu, përkujdesi dhe shërbimet për bashkëshortin, për të moshuarit dhe për personat e pamundur në familje janë detyra që përmbushen prej punës së palodhur dhe vetmohuese të grave dhe vajzave. Edhe kur bëhen gjyshe, gratë i përkushtohen tërësisht detyrës fisnike të përkujdesjes dhe edukimit të nipërve dhe mbesave. Në lidhje me vullnetarizmin e nënave në shoqërinë shqiptare, sociologu Zyhdi Dervishi shprehet:

“Veprimtaritë vullnetare brenda ekonomisë shtëpiake dhe përkujdesi për rritjen e fëmijëve përthithin pjesën më të madhe të energjive fizike, mendore e shpirtërore të nënave, të cilat në shumicën e rasteve vetprivohen nga kënaqësitë e jetës, nga përparimi në karrierën

profesionale e shoqërore, në dobi të karrierës së bashkëshortëve e sidomos të fëmijëve. Në formimin e personalitetit njerëzor e profesional të çdo njeriu përgjithësisht janë mishëruar edhe mundimet e shumëllojshme e të pallogaritshme, investimet intelektuale dhe emocionale të nënës... Nënata shqiptare, deri në çastet e fundit të jetës, janë tërësisht në shërbim të pasardhësve. Nëse do të ngrihej një panteon për vullnetarët në çdo shoqëri, dhe veçanërisht në shoqërinë shqiptare, në vendin qendror, pa kurrëfarë mëdyshjeje do të ishte figura e nënës (Dervishi, Z., 2011:31-32).

Të anketuarat që mendojnë se ky pohim është disi i vërtetë janë 13.2 për qind, ndërsa 8.5 për qind mendojnë se është pak i vërtetë. Ato mendojnë se punët e shumta bujqësore në fshat kërkojnë edhe angazhimin e burrave. Pjesëmarrja e burrave në punë vullnetare brenda ekonomisë familjare lidhet kryesisht me punët bujqësore dhe blegtorale dhe jo me punët e shtëpisë dhe shoqërizimin e fëmijëve. Burrat nuk angazhohen në punë shtëpie dhe përkujdesi, pasi këto janë detyra që i atribuohen tërësisht grave. Një pakicë prej 5.2 për qind mendojnë se ky pohim nuk është aspak i vërtetë. Ato pretendojnë se me punë vullnetare në fshat merren të gjithë, pasi ekonomia bujqësore është e tillë që angazhon të gjithë pjesëtarët e familjes, pavarësisht gjinisë dhe moshës.

6.5.11. Përse gratë ndihen inferiore ndaj burrave në punë?

Rreth 40.9 për qind e të anketuarave mendojnë se gratë ndihen inferiore ndaj burrave në punë. Mungesa e vetvlerësimit për aftësitë profesionale është një dukuri shqetësuese për gratë, jo vetëm në sektorin privat, por edhe në atë publik. Një mësuese që kishte rreth 30 vjet në profesion u shpreh me nota humori se edhe për të zgjedhur një drejtues në shkollë, trupa pedagogjike e përbërë e gjitha nga gratë kishte menduar të drejtohej nga i vetmi burrë, mësuesi i edukimit fizik. Në fakt, zgjedhja e drejtorit nuk kishte të bënte vetëm me nënvlerësimin e grave për aftësitë e tyre drejtuese, por edhe me ngarkesën që mund t'i shtonte punës së grave drejtimi shkollës. Duke dashur të përfundonin sa më shpejt punën dhe të merreshin vetëm me mësimin, ato ia lanë drejtimin kolegut të tyre.

Ndërsa gratë dhe vajzat që punonin në firmat private fasone u shprehën se puna që ato bënin fliste vetë për statusin e tyre. Ato që punonin në fasoneri ishin të gjitha gra, burrrat merreshin me drejtimin e njërive fasone ose ishin punësuar si shoferë dhe si punonjës logjistike. Burrrat paguheshin më mirë se sa punëtorët, të cilat bënin punë krahu. Edhe disnivele i pagave u jepte të drejtë opinionëve se puna e grave ka më pak vlerë, gjë që i shtynte gratë të besonin vërtetë se ishin inferiore ndaj burrave në punë. Të këtij opinioni, ishin edhe 26.9 për qind të të anketuarave. Sipas tyre, gratë ndihen inferiore ndaj burrave, pasi punët që ato kryejnë vlerësohen më pak. Gratë mbajnë të vetme peshën e punëve rraskapitëse në shtëpi, përkujdesin për shëndetin dhe edukimin e fëmijevë, deri sa ata bëhen adoleshentë dhe këto veprimtari nuk u quhen punë, por detyrë që gratë duhet ta përmbushin me patjetër.

Edhe në ekonominë bujqësore, gratë mbulojnë një pjesë të madhe të veprimtarive, por angazhimi i tyre nuk u llogaritet si punë me vlerë. Të rritura me vetvlerësim të ulët për kapacitetin dhe aftësitë e tyre, vajzat dhe gratë në fshat, edhe kur punësohen, vazhdojnë ta ruajnë perceptimin e krijuar për veten gjatë fëmijërisë. Ato ndihen inferiore para burrave dhe nuk besojnë se puna e tyre ka po aq vlerë sa edhe ajo e burrave. Edhe kur kryejnë punë të një vështirësie të lartë, vajzat dhe gratë në fshat tregohen shumë modeste për arritjet e veta.

Mendojnë se pohimi që «*Gratë ndihen inferiore ndaj burrave në punë*» është pak i vërtetë, 14.7 për qind e të anketuarave dhe aspak i vërtetë 15.0 për qind e tyre. Sipas tyre, vajzat dhe gratë nuk kanë pse ndihen inferiore ndaj burrave për punën që kryejnë, pasi puna nuk ka gjini. Vajzat dhe gratë e afta profesionalisht ia dinë vlerën punës së tyre dhe nuk tregojnë shenja inferioriteti ndaj burrave. Këtë siguri ato e kanë fituar prej përvojës si profesioniste në një sektor prodhimi ose shërbimi. Një arkitekte që punonte në njësinë vendore tregoi se ajo punonte në një zyrë me tre kolegë burra dhe nuk ishte ndjerë inferiore përpara tyre: “Ne kemi tre vite që punonjmë në të njëjtën zyrë dhe bashkëpunonjmë ngushtë për projektet e urbanistikës në njësinë tonë. Secili nga ne jep kontributin e vet si profesionist i fushës. Kur u hap vendi i shefit të sektorit të urbanistikës, unë garova bashkë me njërin prej kolegëve të mi për atë post dhe e fitova. Tani jam drejtuesja e njësisë dhe nuk ndihem e kompleksuar për të drejtuar tre burra, pasi drejtimi ka të bëjë me punën dhe unë ndihem e aftë në profesionin. E kam ndonjëherë të vështirë t’i mbledh dhe t’i shtroj në punë, sepse përumben në biseda pa lidhje me punën ose u shkrep për një kafe dhe qëndrojnë më gjatë se duhet në bar-kafene, prandaj më duhet të punoj më gjatë për

të kompensuar mungesat në punë e tyre. Ajo që përgjigjet për afatet e projekteve jam unë si përgjegjëse sektori dhe jo ata”.

6.6. Paragjykimet ne vendin e punës

Vajzat dhe gratë e punësuar paragjykoen shumë, në të gjitha njësitë ku janë punësuar, si në institucionet dhe ndërmarrjet publike, ashtu edhe në firmat private ku janë punësuar ose ku janë pronare. Paragjykimet më të shumta janë ato për aftësitë profesionale, për intelektin si punonjëse dhe drejtuese, për aftësitë sipërmarrëse për pronaret që kanë hapur njësi ekonomike private dhe për konfliktin e përgjegjësive si punonjëse dhe si gra të martuara ose si nëna me fëmijë.

6.6.1. Paragjykimet në institucionet dhe ndërmarrjet publike


Ndër të anketuarat e punësuar në institucionet dhe ndërmarrjet publike, 65.0 për qind deklarojnë se janë paragjykuar në punë prej kolegëve, drejtuesve dhe vartësve, ndërsa 35.0 për qind shprehen se nuk janë paragjykuar. Shkalla e lartë e paragjykimeve në punë lidhet më së shumti me: aftësitë e grave për punën, me komunikimin dhe me sjelljet. Paragjykimet mbarten prej të gjithë personave që ndodhen në një marrëdhënie pune me vajzat dhe gratë, pavarësisht pozicionit hierarkik që kanë. Më shumë paragjykes janë kolegët e punës në institucionin ose ndërmarrjen publike. Kështu mendojnë rreth 54.0 për qind e të anketuarave. Në rradhë të dytë, vijnë drejtuesit e institucioneve ose ndërmarrjeve publike të cilët, sipas opinionit të 43.0 për qind të të anketuarave janë paragjykes ndaj vajzave dhe grave punonjëse që kanë në vartësi. Në vend të tretë, renditen punonjësit që vajzat dhe gratë drejtuese kanë në vartësi, sipas opinionit të 3.0 për qind të anketuarave.

6.6.1.1. Paragjykuar më shumë nga kolegët e punës

Kolegët e punës janë më shumë paragjykes se sa drejtuesit dhe se sa vartësit e vajzave dhe grave që punojnë në institucionet dhe ndërmarrjet publike. Kolegët janë në kontakt më të

drejtëpërdrejtë me to se sa janë drejtuesit ose vartësit. Ka disa arsye që shpjegojnë nivelin më të lartë të paragjyqimeve ndër kolegët e punës, krahasuar me drejtuesit dhe me vartësit. *Së pari*, me kolegët e punës vajzat dhe gratë e anketuara ndajnë hapësirën e punës. Duke pasur kontakte të ngushta me kolegët e punës, për shkak të të punuarit brenda një hapësire të caktuar, vajzat dhe gratë punonjëse janë shumë të vëzhguara nga kolegët e institucionit ku punojnë. Prania e kolegëve brenda hapësirës së ngushtë profesionale i ekspozon vajzat dhe gratë ndaj gjykimeve vlerësuese të kolegëve, të cilët kanë shumë mundësi të marrin informacion për shkallën e profesionalizmit, për sjelljet dhe për komunikimin e kolegeve të tyre. Nga njëra anë, duke qenë se veprojnë brenda një hapësirë të ngushtë profesionale, vajzat dhe gratë janë të detyruara të ndërveprojnë me kolegët e tyre dhe të komunikojnë vazhdimisht me ta për çështje të ndryshme që lidhen ose jo me profesionin. Nga ana tjetër, për shkak të ndërveprimit të vazhdueshëm me vajzat dhe gratë punonjëse, kolegët kanë mundësi t'i njohin më nga afër ato dhe, e për pasojë, kanë edhe më shumë mundësi se të tjerët t'i vlerësojnë për punën që kryejnë dhe marrëdhëniet që ndërtojnë në hapësirën profesionale të institucionit ose ndërmarrjes publike.

Paragjykuar më shumë në ndërmarrjen/institucionin publik



Distanca e pakët që i ndan vajzat dhe gratë nga kolegët e punës bën që këta të kenë mundësi të qëmtojnë nga afër sjelljen e vajzave dhe grave punonjëse dhe të mobilizojnë qëndrimet dhe opinionet paragjyquese ndaj tyre. Një juriste që punonte në njësinë administrative

u shpreh se ajo ndihej gjatë gjithë kohës e vëzhguar nga kolegët për punën që bënte dhe se e kishte të pamundur të ndalte paragjykimet e tyre në drejtim të aftësive të saj profesionale, pasi ishte e detyruar të qëndronte në një hapësirë me ta: “U bënë disa vite që punoj në këtë njësi. Që prej fillimit, jam ndier e paragjykuar nga kolegët e institucionit, të cilët, nisur nga mosha ime e re, mendonin se isha e paaftë të kryeja punën e juristes në administratën vendore. Jam përpjekur shumë që t’u mbushja mendjen se unë isha e aftë për punën dhe ndihesha e bezdisur prej faktit se isha vazhdimisht e vëzhguar prej tyre. Qëndrimi me ta në të njëjtën zyrë më bënte nervoze sepse nuk mbroheshja dot prej vlerësimeve të tyre, të cilat në shumicën e herëve ishin negative. Nëse vlerësimet e tyre do ishin kritika dashamirëse ndaj meje, do t’u isha shumë mirënjohëse, por ato ishin qëndrime paragjykuuese sepse isha grua dhe e re në moshë. Këto dy cilësi ishin shkak i paragjytimeve edhe për aftësitë e mia profesionale. Këto qëndrime i kam hasur shpesh gjatë punës sime, sepse jam paragjykuar edhe atëherë kur rezultati i punës nuk varej krejtësisht nga unë. Ata ishin të prirur të mendonin se një grua e re në moshë nuk bënte për atë punë dhe se një burrë, qoftë edhe i moshës sime, do ta kishte kryer më mirë. I dëgjoja shpesh të thoshin me njëri-tjetrin se punët juridike në administratë nuk mund të behëshin nga gratë, sepse kërkonin një nivel të lartë profesionalizmi që, sipas tyre, gratë nuk mund ta kenë sepse nuk kanë kohë t’i përkushtohen karrierës për shkak të përgjegjësive familjare”. Rrëfimi i të anketuarës tregon se si hapësira e përbashkët i vendos vajzat dhe gratë në një pozicion të hapur frontal me kolegët e punës dhe lehtëson veprimin goditës të paragjytimeve të kolegëve si në një poligon qitjeje pa pengesa.

Së dyti, kolegët e punës ndajnë me vajzat dhe gratë punonjëse në institucionet dhe ndërmarrjet publike edhe kohën e punës. Ata janë vazhdimisht në praninë e njëri-tjetrit përgjatë orarit të punës. Koha që kalojnë bashkë me kolegët është shumë domethënëse në tërësinë e kohës fizike të të punësuarave. Duke qenë se me vajzat dhe gratë punonjëse rrinë për një kohë të gjatë në institucion, kolegët kanë mundësi të informohen në vazhdimësi për ecurinë e punës së tyre dhe për aftësitë e tyre profesionale. Komunikimi i vazhdueshëm me to i informon për sjelljen dhe qëndrimet. Duke qenë se pjesën më të madhe të kohës fizike të qëndrimit në punë, vajzat dhe gratë e kalojnë në prani të kolegëve, është e kuptueshme se përse shumica e paragjytimeve vijnë prej kolegëve. Të anketuarat shprehen se koha që kalojnë në marrëdhënie me kolegët e punës duhej të shërbente për të zbehur paragjykimet e kolegëve ndaj aftësive të tyre, por në fakt kolegët, të kapur fort pas stereotipeve gjinore për aftësitë profesionale të grave, mundohen të

konfirmojnë paragjykimet e veta duke gjetur gabime në punë dhe duke ia faturuar ato pamjaftueshmërisë profesionale të vajzave dhe grave.

Së treti, me kolegët e punës, vajzat dhe gratë kanë një profil të ngjashëm pune, sepse kanë një profesion, gjë që i vendos në konkurrencë të drejtëpërdrejtë me kolegët. Punonjësit e një niveli konkurrojnë mes tyre për më shumë vlerësim institucional dhe për t'u ngritur në detyrë. Konkurrenca personale i nxit punonjësit që të qëmtojnë punën e vajzave dhe grave, për të identifikuar dobësi profesionale, të cilat mund të përdoren për të justifikuar paragjykimet lidhur me aftësitë për punë. Interesi personal për përfitime morale dhe materiale i shtyn kolegët të mbivlerësojnë aftësitë e veta dhe të nënçmojnë aftësitë e vajzave dhe grave, me të cilat punojnë. Faktorët kohë dhe hapësirë, që i vendosin vajzat dhe gratë në një marrëdhënie të ngushtë me kolegët, ndikojnë shumë në përshfaqjen e paragjykimeve përçmuese të kolegëve për aftësitë profesionale të punonjëseve vajza dhe gra.

6.6.1.2. Paragjykuar edhe nga drejtuesit e njësisë

Rreth 43.0% e të anketuarave janë paragjykuar nga drejtuesit e njësisë. Megjithëse vijnë të dytët për nga rradha, drejtuesit shfaqin një shumëllojshmëri paragjykimesh ndaj aftësisë profesionale dhe sjelljes së punonjëseve të tyre. Drejtuesit janë më pak në kontakt me punonjëset vajza dhe gra se sa janë kolegët e punës. Kolegët kanë një marrëdhënie horizontale me vajzat dhe gratë, ndërsa drejtuesit kanë marrëdhënie vertikale. Vajzat dhe gratë punonjëse nuk kanë kontakte shumë të shpeshta me drejtuesit, sa ç'kanë me kolegët, me të cilët ndajnë të njëjtën hapësirë dhe në prani të të cilëve kalojnë shumicën e kohës që janë në punë. Me drejtuesit kontaktet janë më të rralla, kryesisht për arsye që lidhen me mbarëvajtjen e punës, me mbikqyerjen e cilësisë së punës dhe me takimet e përjavshme në mbledhjet e personelit të organizuara nga drejtuesit. Duke qenë se kontaktet me drejtuesit nuk janë shumë intensive, vajzat dhe gratë kanë njëfarë distance prej drejtuesve, gjë që i mbron prej vëzhgimit të vazhdueshëm të tyre.


Megjithatë, vajzat dhe gratë që punojnë nëpër institucionet dhe ndërmarrjet publike nuk janë të imunizuara nga paragjykimet e drejtuesve. Përkundrazi, paragjykimet janë shumë të pranishme ndër drejtuesit dhe përshfaqen në shumë forma. Vajzat dhe gratë e anketuara u shprehën se drejtuesit janë shumë paragjykues për aftësitë e tyre si profesioniste. Ata

paragjykojnë edhe mënyrën se si komunikojnë vajzat dhe gratë punonjëse me drejtuesit. Pavarësisht nga profesioni dhe vjetërsia në punë, të anketuarat u shprehën se e kishin përjetuar peshën e paragjyqimeve përcmuese të drejtuesve për aftësitë e tyre profesionale. Një mësuese tregoi se si ishte ndjerë e paragjykuar nga nëndejtori i shkollës për aftësitë e saj pedagogjike: “Prej vitësh kam punuar në arsim dhe ia jam përkushtuar me mish e shpirt pedagogjisë. Qëndrimi me të rinjtë më mban ende të re në koncepte dhe ide. Mendohem t’i përshtatem interesave njohëse të nxënësve të mi, duke përzgjedhur informacion bashkëkohor, përtej librit, për t’i motivuar më shumë të lexojnë dhe të diskutojnë në klasë. Megjithëse nxënësit janë të kënaqur më stilin tim të mësimdhënies, nëndrejtori nuk është. Jam ndier e fyer kur më ka paragjykuar si të paaftë për t’u mësuar nxënësve lëndët e profilit shoqëror, pasi sipas tij e mbush orën me gjëra që nuk lidhen me lëndët. Madje, për të parë se çfarë përfshija në programin e lëndëve, ai nuk mjaftohej me ditarin e punës, por bënte edhe kontrole gjatë orës së mësimin. Nuk dija si ta interpretoja sjelljen e çuditshme të nëndrejtorit, i cili, për të mbështetur dyshimet e tij për aftësitë e mia, bëhej edhe më mistrec, duke kërkuar të kontrollonte edhe përmbajtjen e materialeve shtesë që u jepja nxënësve për lexim. Nëndrejtorit i ishte mbushur mendja që, meqë isha ca më e moshuar se ai, unë duhej të isha edhe e dalë mode për mësimdhënie dhe bënte çmos të vërtetonte paragjykimin e vet. Kur e diskutova këtë çështje në një bisedë miqësore me shoqet e punës, ato më pohuan se nëndrejtori sillej pak a a shumë në të njëjtën mënyrë edhe më ato. Mesa duket, meqë ishte ngarkuar për pjesën e organizimit të mësimin, ai mendohej të vinte autoritetin mbi personelin mësimor, i cili përbëhet kyesisht nga gra, përmes një kontrolli të tepërt dhe të pajustificuar. Me ne mësueset, që na kishte në vartësi, ai tregonte një sjellje intolerante dhe shumë autoritare, ndërsa me drejtorin e shkollës, që kishte ardhur i ri në shkollën tonë, sillej në mënyrë servile, duke iu vardisur para mbrapa”.

Ka edhe raste kur paragjykimet përshtatën në mënyrë të sofistikuar, të maskuar me mirsjellje. Një grua e re që punonte si informatciene në një zyrë të administratës vendore pohoi se për shkak se ishte grua, drejtuesi i sektorit nuk i besonte shumë punë asaj, por kolegut të saj: “Ne jemi dy informatciene në njësi. Kemi mbaruar fakultetin në të njëjtin kurs paralel dhe njihemi mirë që nga koha e shkollës, gjatë të cilës më është dashur të ndihmoj shpesh kolegun tim të zyrës me detyra të gatshme dhe ushtrime të zgjidhura për ta nxjerrë nga situata. Rastisi që u emëruam të dy në të njëjtin vend pune dhe tani punojmë bashkë në një sektor. Shefi ynë është shumë kërkuar dhe do që punët që na janë ngarkuar të mbarojnë shpejt, madje para afatit. Unë

punoj shumë që të kap afatet e caktuara nga shefi dhe shpesh mbuloj edhe kolegun tim, i cili për shkak të qëndrimit ndaj punës që kanë burrat në institucionin tonë, e shpenzon kohën tek bari ngjitur me njësinë vendore. Edhe pse punën e bëj unë, shefi thërret në zyrë për t'u sqaruar kolegun tim. Kjo sjellje e shefit më dëshpëron sepse duket sheshit se ai e nënvlerëson kapacitetin tim si informaticiene dhe beson se punën e kryen kolegu im. Kur duhej të informatizojmë të dhënat e shërbimeve dhe të përfituesve të njësisë, ose kur duhej të regjistronim zgjedhësit për periudhat zgjedhore, unë krijoja sistemin, ndërsa kolegu im më ndihmonte të hidhnim të dhënat në sistem. Shefi që mbetej i kënaqur nga puna, lavdëronte pa kursime kolegun tim, si “njëshin” e informatikës. Më vinte për të qeshur dhe për të qarë njëkohësisht. Shefi e shmangte komunikimin e drejtëpërdrejtë me mua dhe thërriste vazhdimisht në zyrë kolegun tim për ta ngarkuar me detyra, një pjesë të të cilave ky duhej të m'i delegonte mua, a thua se ishte shefi im i vërtetë. Sipas shefit, puna e informatikës ishte për njëri-z shumë të zgjuar, ishte punë burrash!”.

Të anketuarat pohojnë se gjatë përvojës së tyre profesionale në institucionet dhe ndërmarrjet publike ka pasur më shumë drejtues burra se sa drejtuese gra dhe vajza. Ky fakt shpjegon edhe njëri-z prej arsyeve të përqindjes së lartë të paragjyqimeve nga ana e drejtuesve burra. Ndër drejtuesit, gratë veçojnë burrat si më paragjyqes. Kështu mendojnë rreth 76.0 për qind e të anketuarave. Gratë renditen të dytat si drejtuese paragjyqese, sipas 16.0 për qind të të anketuarave. Ndërsa vajzat drejtuese renditen të fundit tek paragjyqesit, sipas opinionit të 8.0 për qind të të anketuarave. Meqë burrat kanë qenë më të pranishëm në nivelet drejtuese, edhe përqindja më e madhe e paragjyqimeve ndaj grave që punojnë nëpër institucione dhe ndërmarrje publike vijnë prej drejtuesve burra. Drejtuesit burra shfaqin një shumëllojshmëri paragjyqimesh për gratë, përgjithësisht të lidhura me aftësitë profesionale dhe përparimin në karrierë, për shkak të konkurrencës së përgjegjësive për punën me përgjegjësitë për familjen. Këto mendësi janë shumë të përhapura në fshat dhe përshfaqen haptazi në qëndrimet e drejtuesve.



Gratë që punojnë nëpër institucione publike janë përgjithësisht me arsim të lartë, por niveli arsimor i tyre nuk i mbron nga paragjykimet e shumta që lidhen me rolin dhe statusin shoqëror të gruas. Drejtuesit burra janë tradicionalë në qëndrimet e tyre ndaj punonjëseve që kanë në vartësi. Edhe pse vartëset e tyre janë me arsim të lartë dhe të punësuar në profesion sipas arsimit, drejtuesit i shohin më shumë në rolin social të gruas, si shërbyese të familjes dhe përkujdesëse të fëmijëve, se sa si punonjëse me aspirata profesionale.

Kur shfaqin kompetenca profesionale, gratë paragjykohe se kanë përvetësuar sjellje mashkullore në punë. Këtë paragjykim e pohuan shumë të anketuara, të cilat u shprehën se zotësia profesionale dhe suksesi në karrierë shihen më shumë si cilësi mashkullore se sa si tipare femërore. Vajzat dhe gratë, që tregohen shumë më të afta se kolegët, kryejnë një lloj “deviance” nga pritshmëritë e stereotipizuara të shoqërisë, sipas të cilave nga gratë dhe vajzat nuk pritet të shfaqin kompetencë të lartë në fushën e intelektit dhe të aftësive profesionale. Specialistet që përmbushin pritshmëritë e drejtuesve vlerësohen për punën, por paragjykohe se shfaqin tipare mashkullore, përse u përket aftësive. Njëra prej specialisteve të anketuara, gjatë një bisede të lire, pasi plotësoi anketën, e pohoi këtë fakt, duke rrëfyer: “Kam punuar si specialiste në ndërmarrjen e gjelbërimit dhe jam përpjekur që të tregoj me punë vlerat e mia si specialiste në fushën e mjedisit. Në përgjithësi, njësia jonë është e gjelbëruar, por me përparimin e ndërtimeve

disa-katëshe nga zona e liqenit, hapësira e gjelbërt është sakrifikuar në favor të urbanizimit. Jam munduar të ruaj sipërfaqen e blertë brenda territorit të njësisë, duke kërkuar edhe fonde për ripërtëritjen e hapësirave të kërcënuara nga zhveshja e bimësisë, si pasojë e ndërtimeve. Duke pasur rezultate të dukshme në punë, drejtori më ka përgëzuar shpesh, por gjithnjë e mbyll duke më thënë: "Sa keq që je grua! Ty duhej të të kishin vënë të drejtoje, sepse je e aftë si burrë!".


Edhe një grua tjetër, që kishte punuar me një vajzë shumë të zonjën në profesion, shprehu të njejtën indinjatë për paragjykimet e drejtuesve për punën e grave, madje edhe kur puna ishte e suksesshme. Ndër të tjera ajo u shpreh: "Në institucionin tonë kemi pasur një vajzë shumë të aftë profesionalisht. Ajo ishte shumë e thjeshtë dhe e drejtëpërdrejtë në komunikim. Të gjithë e admironin për zotësinë dhe e kishin zili njëkohësisht, sepse ajo jo vetëm që nuk mbahej për aftësitë që kishte, por ruante një profil të ulët, për të mos rënë në sy. Një ditë dëgjova shefin e sektorit tek lëvdonte punën e saj para drejtorit të zyrës sonë. Drejtori e aprovonte me kokë dhe në fund u shpreh: "Ngaqë shfaq shumë kompetencë dhe zgjuarsi ngjan më shumë si burrë se sa si grua. S'ke ç'ë do femrën ashtu, se nuk e merr vesh se ç'është. Më mirë të jetë më pak e zgjuar dhe të duket femër!". Sipas opinionit të drejtuesve, sa më kompetencë të shfaqte një grua në punë aq më pak vlerësohej, sepse kishte vepruar si burrë.

Megjithëse më të pakta në drejtimin e institucioneve dhe ndërmarrjeve publike, edhe gratë drejtuese shfaqin paragjykime ndaj vajzave dhe grave që kanë në vartësi hierarkike. Ishin të shumta komentet e të anketuarave për qëndrimet paragjyquese të drejtuesve gra ndaj tyre. Njëra prej punonjëseve të një institucioni publik tregoi se si ajo vetë kishte rënë pre e këtyre paragjykimeve, duke u shprehur: "Është një perceptim i gabuar të mendohet se vetëm burrat janë paragjyqes ndaj grave. Mendoj se gratë janë edhe më shumë paragjyqese nda njëra-tjetrës, se sa janë burrat ndaj tyre. Kjo vjen prej faktit se gratë konkurrojnë me njëra-tjetrën, më shumë se sa me burrat, për pushtet brenda grupit".

6.6.1.3. Nivele të ulëta drejtimi: intensitet më i lartë paragjykimesh

Rreth 84.2 për qind e të anketuarave mendojnë se burrat në nivele të ulëta drejtimi janë më paragjyqes se sa drejtuesit e niveleve të mesme dhe të larta. Gratë dhe vajzat drejtuese zenë një përqindje shumë më të ulët në shkallën e paragjykimeve. Mendojnë se gratë në nivele të ulëta

janë më shumë paragjyqese 8.8 për qind e të anketuarave. Ndërsa 7.0 për qind e tyre mendojnë se më paragjyqese janë vajzat në nivele të ulëta drejtimi.



Në nivelet drejtuese në institucionet publike ndodhen më shumë burra se sa vajza dhe gra. Kjo mund të jetë njëra prej arsyeve se përse përqindja më e madhe e paragjyqesve në nivelet drejtuese zihet nga burrat dhe jo nga gratë. Drejtuesit burra në nivele të ulëta janë në komunikim të përditshëm me vajzat dhe gratë e anketuara më shumë se sa drejtuesit në nivele të mesme dhe të larta. Ata mbikqyrin në mënyrë të drejtëpërdrejtë punën e vajzave dhe grave që kanë në varësi në institucionet dhe ndëmrjet publike, e për pasojë janë edhe më paragjyqes. Duke pasur një pozicion hierarkik shumë pranë vajzave dhe grave punonjëse, ata komunikojnë më shpesh dhe i shprehin më hapur paragjykimet që kanë në drejtim të tyre.

Rreth gjysma e të anketuarave, 50.0 për qind, mendojnë se në nivelet e mesme të drejtimit, personat më paragjyqes janë burrat. Mendojnë se grate drejtuese në nivele të mesme drejtimi janë më shumë paragjyqese 37.5 për qind e të anketuarave. Ndërsa, 12.5 për qind e të anketuarave mendojnë se drejtueset vajza të niveleve të mesme të drejtimit janë më shumë paragjyqese. Opinione të anketuarave për paragjykimet e drejtuesve të lartë janë pak a shumë të ngjashme me ato për drejtuesit në nivele të larta. Kështu, mendojnë se më paragjyqesit ndër

drejtuesit e lartë janë burrat 63.2 për qind e të anketuarave. Ndërsa, rreth 26.3 për qind e tyre mendojnë se gratë drejtuese të niveleve të larta janë më paragjyqese. Vetëm 10.5 për qind e të anketuarave mendojnë se në nivelet e larta drejtuese, më paragjyqeset janë vajzat.

Në të gjitha nivelet drejtuese, burrat zenë përqindjen më të lartë të paragjyqesve ndaj vajzave dhe grave që punojnë në institucionet dhe ndërmarrjet publike, ndërsa gratë dhe vajzat zenë një përqindje më të ulët, edhe për shkak të përqindjes së ulët të tyre në pozicione drejtuese. Të anketuarat mendojnë se burrat në nivele drejtuese të ulëta janë më paragjyqes se sa burrat drejtues në nivele të mesme dhe të larta dhe se sa gratë dhe vajzat drejtuese në të gjitha nivelet. Kjo përqindje e lartë e paragjyqimeve që mbarten nga burrat drejtues të niveleve të ulëta shpjegohet, jo vetëm me shkallën e lartë të stereotipizimit gjinor të opinioneve të tyre që janë përçmuese për aftësitë e vajzave dhe grave, por edhe me distancën e afërt sociale që ata kanë më punonjëset vajza dhe gra në institucionet ku punojnë si drejtues, e cila i ve ata në një kontakt më të drejtëpërdrejtë me to dhe mundëson shfaqjen e paragjyqimeve ndaj tyre. Drejtuesit e niveleve të mesme dhe të larta janë në një shkallë më të lartë hierarkie se sa burrat drejtues në nivele të mesme, e për këtë arsye, janë më të largët në komunikim dhe marrëdhënie me gratë dhe vajzat punonjëse. Largësia për shkak të burokracisë bën që drejtuesit në pozicione më të larta të kenë më pak kontakte e, për pasojë, t'i shfaqin më rrallë paragjykimet, megjithëse janë paragjyqes në një përqindje të lartë.

6.6.1.4. Paragjykuar nga vartësit

Rreth 3.0 për qind e të anketuarave shprehen se paragjykojnë nga vartësit në institucionet publike. Njëra prej arsyeve të përqindjes së ulët të paragjyqimeve për drejtueset është fakti se ka shumë pak vajza dhe gra në pozicione drejtuese në ndërmarrjet dhe institucionet publike. Megjithëse përqindja e paragjyqimeve të vartësve ndaj eproreve vajza dhe gra është e ulët, intensiteti i paragjyqimeve është i fortë. Drejtueset e pakta që kanë mundur të drejtojnë institucionet dhe ndërmarrjet publike janë ndeshur me paragjyqime në drejtim të aftësive drejtuese të tyre për shkak se janë gra dhe kapaciteti për të drejtuar të tjerët shihet kulturalisht si atribut mashkullor.


Edhe vetë të anketuarat e pohojnë faktin se gratë drejtuese janë përballur me paragjyqime të shumta për aftësitë drejtuese, më shumë se sa burrat drejtues. Njëra prej të punësuarave në një

institucion publik u shpreh se ajo e kishte paragjykuar shumë drejtuesen e saj në fillim, por me kalimin e kohës, paragjykimet ishin rrëzuar, sepse drejtuesja kishte treguar të kundërtën e asaj çka besohej për aftësitë drejtuese të grave:”Kur na emëruan një grua për drejtuese në institucionin tonë, të parat që filluan ta paragjykonin për paaftësi në drejtim ishim ne gratë. Për të provuar se kishim të drejtë që ajo nuk kishte kapacitet për drejtuese ne i vinim re gjithçka, madje qëllimisht errësonim edhe arritjet e saj si drejtuese, duke ia atribuar arritjet më shumë rrethanave dhe ndihmës nga të tjetët, se sa stilit të saj të drejtimit. Ajo ishte miqësore dhe mbështetëse, por ne këtë sjellje të saj e morëm për strategji për të na hyrë në zemër me sjellje të mirë, se pale se ku do ta nxirrte kokën. Dyshonim se mos donte që të fitonte pëlqimin tonë për të na vënë pastaj kundra njëra-tjetrës dhe tregoheshim të rezervuara në komunikimin me të. Mendonim se do kishim qenë shumë më mirë po të kishim pasur një burrë për drejtor, sepse besonim se burrat drejtues janë më tolerantë me gratë. Qëndrimet e saj korrekte ndaj punës i komentonim si intolerancë ndaj nesh dhe me këtë përmbushnim profecinë tonë se ajo nuk vlente për drejtuese. Kur ajo me të drejtë kërkonte shpjegime për punën, ne e merrnim për ndërhyrje në punën tonë dhe këmbënguljen e saj për të realizuar punën e përkthenim si arrogancë. I vinim re çdo gjë dhe komentonim çdo dite mënyrën se si ishte veshur, si fliste, si ecte, si komunikonte me ne. Por, me kalimin e kohës, e kuptuam se ajo ishte një drejtuese shumë e zonja, korrekte dhe dashamirëse njëkohësisht. Ajo na pyeste shpesh për familjet, sidomos për fëmijët, duke na lënë të nënkuptonim se ajo do të na mirëkuptonte nëse do duhej të mungonim për arsye familjare dhe do të na lejonte të qëndronim pranë fëmijëve kur të ishte e nevojshme. Megjithëse tregohej miqësore me ne, ajo nuk favorizonte në punë dhe në marrëdhënie asnjërën dhe ruante një etikë të lavdërueshme komunikimi edhe në situata të vështira. E kuptuam që i kishim rënë më qafë më kot me dyshimet tona se ajo nuk vlente, duke e paragjykuar si grua. Nuk ishim mësuar të shihnim gra në drejtim, ishim drejtuar gjithnjë nga burra”.

6.6.1.5. Më paragjyqese ndaj njëra-tjetrës, se burrat ndaj tyre

Shumica e punonjësve në institucionet publike janë gra. Burrat, ndonëse zenë një përqindje më të ulët të punonjësve, kryesojnë në postet drejtuese. Pra vajzat dhe gratë e anketuara punonjnë në mjedise pune me më shumë gra. Për këtë arsye edhe përqindja më e lartë e paragjyqesve ndër kolegët e punës janë gra. Të këtij opinion janë rreth 65.0 për qind e të

anketuarave. Kolegët burra zenë një përqindje më të vogël si paragjykses, sipas opinionit të 20.0 për qind të anketuarave, ndërsa vajzat zenë vendin e fundit të paragjyksesve ndër kolegët e punës, sipas mendimit të 15.0 për qind të të anketuarave. Kësisoj, të anketuarat mendojnë se koleget gra janë më shumë paragjykses se sa kolegët burrat dhe se sa koleget vajza. Gratë me specializim të njejtë dhe në pozita të ngjashme pune e paragjykojnë njëra-tjetrën për aftësitë, për nivelin arsimor dhe për arritjet profesionale.



Të rritura në mjedis shoqëror, plot paragjykime dhe stereotipe gjinore, vajzat dhe gratë janë edhe vetë mbartëse dhe shprehëse të tyre. Mjedisi i punës, sikurse mjedisi familjar dhe ai shkollor, janë të mbushur me paragjykime, të cilat kanë bërë vend edhe në mendësitë e vajzave dhe grave. Të edukuara me normat kulturore, që nënvlerësojnë kapacitetin intelektual dhe aftësitë profesionale të grave, vajzat dhe gratë e punësuarat arrijnë t'i besojnë edhe vetë opinionet nënvlerëse për vlerat e tyre profesionale dhe nënvlerësojnë aftësitë e njëra-tjetrës, më shumë nga sa i nënvlerësojnë burrat, që punojnë në të njejtin profil pune. Paragjykimet dhe stereotipet gjinore kanë ndikim edhe tek vetvlerësimi i ulët se ato mund të bëjnë një karrierë profesionale në ngjitje. Gratë dhe vajzat e punësuarat në institucionet dhe ndërmarrjet publike, duke pasur një vetëbesim të pakët se mund të ngjisin shkallët e karrierës me meritë, dëshirojnë të kenë një detyrë profesionale dhe nuk aspirojnë të shkojnë më lart. Paragjykimet që kanë zënë vend në


vetëdijen e tyre i pengojnë, jo vetëm për të vlerësuar objektivisht aftësitë individuale, por edhe aftësitë e kolegeve të tjera.

6.6.1.6. Shpeshësia e paragjyqimeve në institucionet dhe ndërmarrjet publike

Vajzat dhe gratë e punësuara në institucionet dhe ndërmarrjet publike përballen shpesh me paragjyqime ndaj tyre. Pjesa më e madhe e të anketuarave, 57.9 për qind, përballen me një denduri të lartë paragjyqimesh çdo ditë, çdo javë e çdo muaj. Janë ndjerë të paragjykuara çdo ditë 13.3 për qind e të punësuarave në institucionet dhe ndërmarrjet publike. Ato pohojnë se paragjykimet i pengojnë të përqëndrohen në punë dhe u ngjallin ndjesi bezdie. Ato shprehen se e kanë të vështirë të tolerojnë faktin e të qenit të paragjykuara për ditë. Njëra prej tyre u shpreh se për të, të punonte në një mjedis aq paragjyqes, ishte “si të jetonte në një fushë beteje, gjithnjë në alarm”. Edhe një tjetër u shpreh se përballja me paragjykimet çdo ditë e kishte bërë mjedisin e punës shumë armiqësor, aq sa kishte menduar të ndërronte institucion.

Më shumë, nën presionin e përditshëm të paragjyqimeve ndodhen vajzat dhe gratë e reja, të cilat nuk kanë përvojën e mjaftueshme për t’i kryer punët që u ngarkohen aq cilësisht sa ç’pritet. Atyre u duhet kohë të fitojnë shprehitë e nevojshme profesionale, për të qenë në lartësinë e detyrës, siç edhe kërkohet prej institucionit. Mungesa e shkathhtësisë në profesion i ekspozon ato ndaj paragjyqimeve të kolegëve dhe drejtuesve, si punonjëse të ngathëta dhe të paaftha. Madje, ato paragjykojnë edhe për nivelin e dijeve që kanë përvetësuar në shkollën e lartë, sikur nuk kanë mësuar sa duhet ose që i kanë marrë notat pa meritë. Vajzat dhe gratë që shigjetohen për ditë nga paragjykimet e kolegëve të punës e kanë të vështirë të mësohen t’i tolerojnë këto opinione nënçmuese për aftësitë e tyre dhe bezdisen shumë prej tyre.

Denduria e paragjytimeve në ndërmarrjen/institucionin publik



Përqindja e vajzave dhe grave që paragjykojnë çdo javë në institucionet dhe ndërmarrjet publike është 24.1 për qind. Megjithatë paragjykojnë më rrallë se sa për ditë, vajzat dhe gratë e paragjykuara çdo javë shprehen se kanë shqetësime të ngjashme me ato që paragjykojnë përditë.

Denduria e paragjytimeve i çmotivon të punojnë. Ato pohuan se nuk shkojnë me shumë dëshirë në punë, pasi e dinë që, edhe pse përpiqen maksimalisht që ta kryejnë punën siç duhet, nuk i shmangin dot sulmet paragjyqese ndaj tyre, në drejtim të aftësive, arsimit dhe sjelljes.

Është e konsiderueshme përqindja e vajzave dhe grave që ndeshen me paragjytime çdo muaj në institucionet ose ndërmarrjet publike ku punojnë. Pohojnë se janë paragjykuar çdo muaj rreth 20.1 për qind e të anketuarave. Ato shprehen se paragjykimet u vijnë nga shumë fronte, nga kolegët dhe drejtuesit. Edhe pse denduria e paragjytimeve ndaj tyre është më e pakët krahasuar me ato që paragjykojnë çdo ditë e çdo javë të muajit, gratë dhe vajzat e paragjykuara çdo muaj ndihen të ndënvlerësuara në punë dhe pohojnë se paragjykimet interferojnë shumë në ndjesitë e tyre në lidhje me punën dhe në marrëdhëniet e tyre me kolegët dhe drejtuesit. Një mesogrua që ishte specialiste në administratën publike tregoi se si ishte ndier e paragjykuar prej drejtueses së saj për punën që bënte, edhe pse kishte vite punë në atë profesion. Ndër të tjera, ajo tregoi: “Kam shumë vite në këtë profesion dhe kam kaluar shumë përvoja. Kam pritur e përcjellë shumë shefa e drejtorë, të cilët vitet e tranzicionit janë ndërruar ca si shpesh, sa herë ndërronin partitë në pushtet ose koalicionet politike. Drejtuesit që na vinin emëroheshin më shumë për merita partiake se sa për merita profesionale. Qëlloi të na vinte një shefe e tillë në institucion para disa


vitesh. Ajo ishte një vajzë relativisht e re në moshë dhe nuk para ia thoshte shumë nga zanati. Natyrisht, duke qenë e re dhe pa përvojë pune, e ca më pak drejtimi, shpesh bëhej qesharake në vendimet që merrte dhe me mënyrën se si silllej me personelin. Mua në fillim më erdhi që në krye të institucionit erdhi një vajzë e re, sepse mendoja se do sillte një frymë dhe vision të ri në institucion, i cili këtë të fundit e kishte humbur me kohë, për shkak të përkohshmërisë së drejtuesve të tjerë dhe mungesës së interesit të tyre për të punuar për institucionin. Mendoheja ta mirëkuptoja drejtuesen e re dhe u thashë edhe kolegëve që duhej të tregoheshim të duruar dhe t'i jepnim kohë të mësohej me punën dhe me drejtimin. Në kundërshtim me dashamirësinë time ndaj saj, shefja ishte shumë zezze, madje në shumë raste edhe e paedukatë. Nuk mjaftonte sjellja arrogante për të më lënduar, por shfaqte edhe shumë paragjykime ndaj aftësive të mia si specialiste, duke u shprehur se të vjetrës i kishte ikur koha. Zakonisht këto opinione përçmuese për specialistët e vjetër, ndër të cilët më e vjetra isha unë, i shprehte në mbledhjen e përmuajshme me personelin. Ajo nuk përçmonte vetëm moshën dhe vjetërsinë time si specialiste, por edhe mënyrën e të menduarit, që, sipas saj, i përkiste një epoke që ishte përmbysuar dhe se institucioni kishte ngelur pas nga profesionistë që u kishte perënduar koha. Me paragjykime dhe oratori boshe, shefja mendohej të bënte për vete më të rinjtë në institucion. E vija re në shikimet e kolegëve të mi më të rinj se sa në siklet viheshin në mbledhjet e përmuajshme të stafit. Fillova t'i shmangesha komunikimit me shefen, pasi shihja se donte të më sfidonte në ca gjëra që nuk vareshin prej meje si mosha, pamja. Por, mbledhjet e përmuajshme nuk i shmangia dot, kështu që e kisha rracion një denigrim para stafit si përgjegjëse për prapambetjen institucionale, për shkak se vija nga një kulturë pune që i përkiste një regjimi paraardhës, ndërsa shefja e re, lindur e rritur në demokraci, na kishte kulturë më të mirë se sa e imja, por që vetëm kulturë pune nuk ishte”.

Rreth 42.1 për qind e të anketuarave janë paragjykuar më rrallë se një herë në muaj. Të tilla ishin profesionistët që kishin krijuar një qëndrueshmëri profesionale, si pasojë e vjetërsisë në punë. Edhe pse paragjykohehin më rrallë, ato u shprehën se ishin shumë qefmbetura me personat që i paragjykojnë, ndërkohë që ato kanë dhënë prova se vlejné për punën që kryejné. Arsyeja kryesore se përse paragjykohehen sipas tyre është se janë gra. Njëra prej të anketuarave u shpreh: “Është e vështirë të besohet se gratë janë shumë të zonjat në profesion, sepse shpesh mendohet se gratë nuk e kanë mendjen tek puna, por tek shtëpia dhe fëmijët. Për ne, profesionistët në institucionet publike, thuhet se në vend që t'i shërbejmë ne punës, na shërben

puna neve, që do të thotë se vendi i punës i është përshtatur rolit tonë si gra, si nëna dhe si bashkëshorte dhe se institucionet janë “vend pëllumbash” për gratë. Por këto opinione nuk janë të vërteta, sepse gratë nëpër institucione dhe shërbime publike punojnë shumë dhe i përkushtohen me shumë seriozitet punës. Më qëllon shpesh të shoh kolegët e mi nëpër kafene gjatë orarit të punës, por kjo gjë ndodh shumë rrallë ose thujtse asnjehere për specialistet gra në institucionin ku punoj”.

6.6.1.7. Shkaqet e paragjytimeve ndaj vajzave dhe grave të punësuar

Janë të shumta shkaqet për të cilat vajzat dhe gratë e punësuar në institucionet dhe ndërmarrjet publike ndihen të paragjykuara, por ndër më kryesoret veçohen tre: aftësitë për punë, morali dhe sjellja. Paragjykime të tjera që rëndojnë mbi gratë dhe vajzat e punësuar në institucionet publike janë edhe origjina, arsimimi, veshja, komunikimi, etj.



6.6.1.7.1. ... edhe sit ë paaftha për punë

Rreth 41.1 për qind e të anketuarave, të punësuar në institucionet dhe ndërmarrjet publike, janë paragjykuar për aftësi të pamjaftueshme në punë. Të anketuarat pohojnë se për punën e kryer nga gratë ka shumë paragjykime, sidomos për punë që nuk janë tipike për rolin femëror, siç janë profesionet nga inxhinieria, arkitektura, drejtësia penal ose funksione ekzekutive

drejtuese. Janë më pak të paragjykuara vajzat dhe gratë që punojnë në profesione të lidhura me rolin social femëror të shërbimit ndaj të tjerëve, të përkujdesjes dhe të edukimit si: mësuesia, pediatria, puna sociale, noteria, specialiste të rangjeve të ulëta, etj. Aftësitë janë shënjestra kryesore e paragjykimeve, pasi ato lidhen drejtpërdrejtë me cilësinë e punës dhe përmbushjen e detyrave funksionale të profilit të punës. Vajzat dhe gratë që punojnë në institucione dhe ndërmarrje publike paragjykohen se kanë më pak aftësi se sa burrat për të kryer punë cilësore. Shkak kryesor për këtë paragjykim është konkurrenca e përgjegjësive të roleve shoqërore që kanë grate, duke qenë njëherësh punonjëse dhe familjare. Meqë kulturalisht, gratë kanë përgjegjësinë kryesore për t'u shërbyer të tjerëve në familje, ato shihen si më të përshtatshme në rolin shoqëror të shtëpiakes. Gratë vlerësohen pozitivisht nëse tregojnë aftësi të mira shërbyese dhe përkujdesëse për familjen, fëmijët, të moshuarit dhe bashkësinë e ngushtë shoqërore. Ajo çfarë shoqëria pret nga gratë është të shërbejnë në familje, të rrisin dhe edukojnë fëmijët, të bëjnë punët e shtëpisë, të kujdesen dhe t'u shërbejnë të moshuarve dhe bashkëshortit. Roli ekonomik i gruas si punonjëse, megjithëse është një domosdoshmëri ekonomike për familjen, nuk vlerësohet edhe aq shumë kulturalisht sa ç'vlerësohet roli si përkujdesëse.

Rolin ekonomik, si sigures ushqimi për familjen, normat tradicionale që gjallojnë ende, vazhdojnë ta shohin si të përshtatshëm vetëm për burrat. Nga burrat pritet të sigurojnë ushqimin, pra të punojnë, ndërsa nga gratë jo. Prej tyre pritet që të përkujdesen për familjen dhe jo të kenë funksione ekonomike jashtë ekonomisë familjare. Gratë e punësuara ndodhen nën trysni të dyfishtë paragjykimesh: *e para*, sepse duke qenë të punësuara ato nuk përmbushin rolin shoqëror si shërbyese brenda ekonomisë shtëpiake që u ka përcaktuar kultura, dhe *e dyta*, duke qenë se për gratë parësore konsiderohet familja dhe jo puna, mendohet se gratë e punësuara nuk e kanë mendjen tek puna, por tek shtëpia dhe tek fëmijët. Këto paragjykime rëndojnë mbi të gjitha gratë, por më shumë mbi gratë e martuara dhe sidomos mbi nënat e reja, që janë edhe të punësuara. Është e vërtetë që funksionet prodhuese ekonomike përkojnë me funksionet riprodhuese për shumicën e grave dhe burrave të rinj në moshë, që sapo kanë krijuar familjen. Por, përgjegjësia përkujdesëse për të vegjlit rëndon vetëm mbi nënat e reja dhe jo mbi baballarët e rinj. Gruas i kërkohet prej normave kulturore të shkepusë marrëdhëniet e punës dhe të qëndrojnë në shtëpi për mirëritjen e fëmijëve, ndërsa burrit jo. Ai vazhdon i patrazuar karrierën profesionale pa shikëputje nga puna, pavarësisht ardhjes së fëmijëve në jetë. Edhe kur fëmijët rriten dhe janë të aftë të kujdesen për veten, gratë mbahen përgjegjëse për edukimin, arsimin, shëndetin, higjenën,

ushqyerjen dhe sjelljen e tyre. Prandaj, gratë, sado të rritur të jenë fëmijët, ngarkohen kulturalisht me detyra shërbimi ndaj familjes më shumë se sa me detyra ekonomike jashtë shtëpisë.

Me kërkesat në rritje të standardit të jetesës, një familje përfiton ekonomikisht më shumë nëse dy të rritur në moshë pune janë në punë me pagesë, se sa kur punon vetëm njëri. Gratë e punësuarat pohuan, se familjet e tyre nuk e kanë mundësinë ekonomike të përballojnë shpenzimet për jetesën vetëm me një pagë, prandaj ato e kanë ndier për detyrë të punojnë në punë me pagesë dhe të shërbejnë të vetme në familje. Përbushja e dy roleve njëkohësisht, e rolit ekonomik dhe e rolit përkujdesës, i përball gratë me paragjykime të shumta për aftësitë e tyre për punë, pasi kulturalisht ajo çfarë pritet të përmbushin gratë lidhet me rolin përkujdesës dhe jo me atë ekonomik. Për këtë arsye, gratë e punësuarat, edhe kur shfaqin aftësi të mira profesionale, paragjykohen se nuk janë sa duhet të afta për punë. Ato paragjykohen si të afta vetëm në rolin përkujdesës mëmësor dhe shërbyes bashkëshortor. Edhe vajzat, sikurse gratë, shihen si të vlefshme më shumë në rolin shërbyes se sa atë ekonomik. Ato projektohen në rolin e ardhshëm si bashkëshorte dhe nëna, prandaj paragjykohen për investim të pakët në profesion.

Paragjykimet për aftësitë profesionale i pengojnë realisht gratë dhe vajzat të ngjiten në shkallët e karrierës profesionale dhe të drejtimit ezekutiv të institucioneve dhe ndërmarrjeve publike. Sa më shumë aftësi dhe përkushtim të tregojnë vajzat dhe gratë në punë, aq më shumë paragjykohen ato se janë duke lënë pas dore detyrën kryesore shoqërore që u ka përcaktuar tradita kulturore, shërbimin dhe përkujdesin familjar. Të anketuarat e shprehën hapur shqetësimin se përpjekjet e tyre për t'u angazhuar me profesionin paragjykohen si përpjekje për t'i bërë bisht shërbimit ndaj familjes, që është edhe roli për të cilin janë destinuar kulturalisht. Njëra prej të anketuarave tregoi se përballja me paragjykimet si e punësuar dhe si nënë e re i kishte krijuar asaj ndjenjën e fajit se “u kishte hyrë në hak fëmijëve duke punuar”, ndjenjë që i përforcohej çdo ditë prej opinionit të të tjerëve se “gruaja është bërë për të ndejtur në shtëpi dhe për të rritur fëmijët, jo për të punuar”.

Gratë, që ishin rikthyer në punë, pasi kishin qëndruar përkohësisht jashtë marrëdhënieve të punës për rritjen e fëmijëve të vegjël, pohuan se kishin hasur në paragjykime të shumta kur ishin rikthyer në punë, në lidhje me pamjaftueshmërinë e aftësive për punën, sepse sipas kolegëve dhe drejtuesve edhe ato aftësi që kishin pasur i kishin humbur me shkëputjen nga puna. Është e vërtetë që shkëputja nga puna mund të shkaktojë një “përgjumje” profesionale, por rikthimi në punë mund të jetë një “rizgjim profesional”, siç e përshkroi një e anketuar, e cila ndër

të tjera tregoi: “Kur u ktheva nga leja e lindjes, isha gjithë energji për të punuar, më kishte munguar profesioni, shoqet e zyrës, njerëzit me të cilët punoja, më kishte marrë malli për punën dhe më hanin duart për punë. Megjithë entuziazmin tim, pengohesha të punoja nga qëndrimet paragjyquese të kolegëve dhe sidomos drejtuesve të institucionit, të cilët nuk më jepnin punë me rëndësi, duke më përjashtuar nga të gjitha projektet e sektorit dhe nga mundësia për të ushtruar profesionin. Kërkova që të kisha projektet e mia për të punuar, por m’u përgjigjën se nuk mund të përfshihesha sepse kisha fëmijë për të rritur, sepse do mungoja shpesh, se nuk do mund të vizitoja punën në terren, etj.” Këto histori shprehin qartë ndikimin që kanë paragjykimet për aftësitë tek përparimi i vajzave dhe grave në karrierën profesionale dhe në postet drejtuese në institucionet dhe ndërmarrjet publike.

6.6.1.7.2. Të ngacmuara dhe të paragjykuara

Në vend të dytë, vijnë paragjykimet për moralin dhe ngacmimet seksuale në punë. Pohojnë se kanë përjetuar peshën e rëndë të paragjyqimeve për moralin dhe ngacmime seksuale në punë rreth 15.0 për qind e të anketuarave. Ngacmimet seksuale në vendin e punës janë shumë shqetësuese për vajzat dhe gratë. Megjithëse masat ndëshkuese për ngacmimet seksuale në legjislacionin e punës, ende vajzat dhe gratë e punësuar ndihen të kërcënuara në mjedisin e punës.

Të anketuarat shprehin se puna në institucionet dhe ndërmarrjet publike duhej t’u siguronte atyre mbrojtje nga ngacmimet seksuale më shumë se sa puna në firmat private, sepse në institucionet shtetërore ligji zbatohet më rigorozisht se sa në ato private. Por, edhe pse kanë patur pritshmëri ndaj institucioneve dhe ndërmarrjeve publike se do të ishin më të sigurta përsa i përket ngacmimeve seksuale, për shkak të forcës së zbatimit të ligjit në këto institucione, vajzat dhe gratë janë përballur në një masë të konsiderueshme më këtë dukuri. Ngacmimet seksuale në institucionet dhe ndërmarrjet publike ndodhin për disa arsye, ndër të cilat mund të veçohen dy si më kryesoret.

Së pari, në institucionet publike, niveli i njohjes mes të punësuarve nuk është aq i lartë sa për të penguar ngacmimet seksuale. Të anketuarat që ishin ngacmuar seksualisht në punë pohuan se nuk kishin njohje me ngacmuesit, të cilët ishin kryeshit drejtues të niveleve të ulëta dhe më rrallë të niveleve të larta. Ato pohojnë se po të ishin punësuar në ndonjë firmë private ngacmimi

do të kishte qenë më i pakët ose mund të mos kishte ndodhur fare, pasi do kishin shkuar atje me njohje ose rekomandim familjar. Meqë të afërmit e grave dhe vajzave të punësuara në firma private kanë lidhje familjare, miqsore ose shoqërore me pronarin ose administratorin e firmës, mundësia e këtyre të fundit për t'i ngacmuar seksualisht minimizohet.

Edhe punësimi në institucionet dhe ndërmarrjet publike për një pjesë të të punësuarave është kryer përmes njohjeve dhe rekomandimeve nga ana e të afërmeve, por drejtuesit e institucioneve dhe punonjësit meshkuj në institucionin publik nuk kanë pasur lidhje familjare, miqësore dhe shoqërore me të punësuarat, sepse lidhjet nepotike formalisht janë të ndaluara për shkak të konfliktit të interesit në punësimin e të afërmeve. Është e pazakontë, por jo e pamundur, që në institucionet publike të punojnë persona me lidhje të ngushta gjaku, si persona të një familjeje ose fisi. Duke qenë se në institucionet publike të punësuarit nuk ndodhen në marrëdhënie të ngushta familjare dhe fisnore, midis tyre nuk ka pengesa morale për pëlqim seksual. Ngacmimet seksuale në vendin e punës kanë ardhur për shkak të mosnjohjes - në kuptimin e mungesës së lidhjes fisnore dhe shoqërore - të ngacmuesit me të ngacmuarën. Tërheqja seksuale që kolegu ose drejtuesi kanë pasur ndaj vajzës dhe gruas së punësuar nuk është penguar nga tabutë kulturore në lidhje me moralin për familjen dhe fisin.

Së dyti, ngacmimet seksuale në vendin e punës në institucionet dhe ndërmarrjet publike kanë ndodhur për shkëmbime favoresh. Kryesisht ngacmuesit kanë qenë në pozita drejtuese dhe në këmbim të një favoriti u kanë kërkuar vajzave dhe grave të punësuara t'i shpërblejnë me marrëdhënie seksuale. Ngacmimet seksuale kanë qenë përpjekje të fshehura ose të maskuara të drejtuesve ndaj të punësuarave, përgjithësisht në moshë të re. Megjithatë, refuzimi i vazhdueshëm i të punësuarave i ka bërë ata më këmbëngulës, gjë që ka rënë në sy të punonjësve të tjerë. Janë pikërisht këto dy situata që i kanë krijuar shumë shqetësime vajzave dhe grave të ngacmuara seksualisht: *e para*, ngacmimi prej drejtuesit dhe *e dyta*, rënia në sy të të tjerëve si e ngacmuar.

Ngacmimi prej drejtuesve u ka shkaktuar neveri dhe përbuzje vajzave dhe grave të ngacmuara, ndërsa vëzhgimi i ngacmimit prej të tjerëve u ka shkaktuar shumë ankth, pasi janë ndjerë edhe më të paragjykuara kur janë fajësuar ato vetë për ngacmimet. Njëra prej grave, që ishte ngacmuar seksualisht nga një drejtues i nivelit të ulët, pohoi se më të lehtë e kishte të përballej me ngacmimet e shefit, se sa me shikimet e kolegëve, të cilët dukej sikur e akuzonin se ajo ishte fajtorja. Ndër të tjera, ajo tha: «Unë e fitova vendin e punës me konkurs, pasi dola e

para në testim. Shefi më tha se unë e kisha fituar vërtet konkursin, por me ndërhyrjen e tij, sepse si puna ime, sipas tij, paskeshin qenë të gjithë konkurentët. Ai më paskësh zgjedhur mua sepse i kisha pëlqyer shumë atij dhe se kishte menduar të kishte një lidhje jashtmartesore me mua, dhe meqë ishim të dy të martuar, na leverdiste të mbanin një lidhje të fshehtë në punë, larg syve të bashkëshortëve. « Në punë – tha ai – nuk kuptohet gjë, nuk dyshon njeri! ». Unë e prita ftohtë propozimin e tij dhe nuk i dhashë rëndësi. Vazhdova të vijoj punën time, duke bërë sikur nuk e kisha dëgjuar atë propozim të turpshëm dhe përpiqesha ta shmangia. Por, sa më shumë e shmangia, aq më ngulmues bëhej ai. Më kërkonte me kast në zyrë, që gjoja t'i raportoja për punën. Kur nuk më gjente në zyrë, ngrinte katin në këmbë duke thërritur se ku kisha shkuar pa lejen e tij. Më mbante pas pune, gjoja për të më komunikuar ndonjë detyrë shtesë. Më ftonte për kafe e dreka pas pune, por unë nuk i përgjigjesha. Ngulmimi i tij ra në sy të kolegëve, të cilët më shihnin me dyshim. Njëra prej kolegeve të zyrës, në mllef e sipër që shefi e kishte bërë zyrën tonë si të tijën, m'u hakërrye: «Ku theve këmbën dhe erdhe në këtë zyrë, prej teje nuk kemi rehat as ne, na ngeli shefi në zyrë, të kishe thyer qafën gjetiu». Shefi ma nxiu faqen para të tjerëve, filluan të dyshonin të gjithë, edhe pse nuk kisha asnjë lidhje me të, i dëgjoja të përshpërsisinin nën zë se «unë e provokoj», «se e kisha fajin vetë që e kisha ndjellë pas vetes», «se ia kisha luajtuar vetë», etj.

6.6.1.7.3. Të paragjykuara për mënyrën e sjelljes

Për mënyrën e sjelljes janë paragjykuar 11.9 për qind e të anketuarave. Nga vajzat dhe gratë pritet të shfaqin një sjellje të përshtatshme me normat kulturore për gjininë. Stereotipet gjinore imponojnë nënshtrim të vajzave dhe grave ndaj burrave. Nëse ato kundërshtojnë ose shprehin pikpamjet dhe e tyre, atëherë ato nuk shihen me sy të mirë, pasi kanë dalë nga kornizat kulturore të sjelljes së duhur për vajzën dhe gruan. Vajzat dhe gratë që kanë shprehur mendimet e veta pa droje para kolektivit ose drejtuesve kanë qenë të paragjykuara për sjelljen e tyre, sikur kanë dashur të bien në sy më shumë se të tjerat. Edhe vajzat që kanë shfaqur një lloj autonomie në punën e tyre dhe kanë treguar aftësi sipërore profesionale dhe intelektuale janë paragjykuar se kanë përvetësuar tipare mashkullore profesionale dhe kanë devijuar nga modeli femëror i gruas së heshtur, modeste dhe të nështruar.

Janë paragjykuar për sjelljen, edhe vajzat dhe gratë që kanë argumentuar më këmbëngulje rëndësinë e pikpamjeve të veta duke mos u tërhequr përpara insinuatave denigruese të kolegëve dhe drejtuesve, të cilët i kanë etiketuar si grindavece, kryeneçe, të pasjellshme, që nuk dinë të mbajnë vendin që u takon, etj. Një pjesë e paragjykimeve për sjelljen e vajzave dhe grave lidhen e dhe me kërkesat e tyre për përmirsimin e kushteve të punës dhe të shpërblimit për punën shtesë. Ato janë cilësuar si të pasjellshme, mosmirënjohëse, të paduruara, mendjemëdha, arrogante, etj.


Rreth 32.1 për qind e të anketuarave janë ndër të paragjykuara për shkaqe që lidhen me arsimin e pamjaftueshëm, me mënyrën e veshjes, me cilësitë fizike, me origjinën krahinore, me mënyrën e të folurit dhe dialektit, me mënyrën e komunikimit më eprorët, vartësit dhe meshkujt në përgjithësi.

6.6.2. Paragjykimet për të punësuarat në firmat private

Vajzat dhe gratë e anketuara që kanë punuar në firma private pohojnë se janë paragjykuar prej drejtuesve 49.0 për qind, prej kolegëve 45.0 për qind dhe prej vartësve 6.0 për qind. Siç shihet edhe nga të dhënat, drejtuesit janë më paragjykses se sa kolegët e punës dhe se sa vartësit. Në firmat private, vajzat dhe gratë e anketuara punojnë me vajza dhe gra të tjera më së shumti, dhe me përjashtime të rralla ka edhe ndonjë burrë në kolektivat e tyre. Firmat private që kryejnë veprimtari ekonomike në zonë janë përgjithësisht fasoneri dhe kanë punësuar thuajse vetëm vajza dhe gra. Burrat janë më shumë në pozicione që nuk kanë lidhje me procesin e prodhimit, por të shpërndarjes, furnizimit dhe transportit. Drejtuesit e firmave private janë ose vetë pronarët e firmave ose persona të vendosur prej tyre për të administruar biznesin.

6.6.2.1. Paragjykuar më shumë prej drejtuesve se prej kolegëve


Gratë janë paragjykuar më shumë prej drejtuesve, se sa prej kolegeve të punës për shkak se drejtuesit presin që ato të jenë më të shkathëta në punë dhe të sigurojnë cilësi të lartë të prodhimeve. Ndërsa koleget gra janë në pozita të ngjashme me të anketuarat e, për pasojë, kanë më pak paragjykime në lidhje me punën e kryer nga vajzat dhe gratë se sa drejtuesit e firmave.



Vartësit zenë një përqindje fare të vogël tek paragjykesit, pasi të anketuarat që punojnë në firmat private janë pothuajse të gjitha punëtore dhe në fare pak raste drejtuese. Megjithatë edhe drejtueset e firmave kanë ndeshur në paragjykime të vartësve të tyre në lidhje me komunikimin dhe humanizmin. Një administratore shtypshkronje u shpreh se për shkak të llojit të punës, që funksionon në bazë të porosive të klientëve, ajo u kërkonte vajzave dhe grave që kishte në vartësi të ishin më të shpejta dhe ta kryenin punën me saktësi: “Në punë të tilla, që kanë afate që nuk presin, është e nevojshme të drejtoj punën me një ritëm të përshpejtuar, në mënyrë që produkti të përfundojë në kohë. Porositësi mund të jetë për shembull një institucion që do të promovojë veprimtarinë e vet në një konferencë dhe i duhen produktet që ka porositur për ditën e konferencës, pra unë nuk mund t’ja shtyj datën e prodhimit dhe për këtë arsye kërkoj më shumë shpejtësi dhe rendiment në punë. Për këtë sjellje, vartëset më paragjykojnë si të pandjeshme dhe të orientuar vetëm drejt fitimit. Unë e kuptoj ndonjëherë edhe përmes shikimit të tyre që ato nuk e miratojnë sjelljen time, por nuk kam kohë për të humbur në diskutime mbi sjelljen, rëndësi ka të kryhet puna në kohë dhe të sigurohet pagesa për porositë. Në fund të fundit, prej asaj pune, paguhemi të gjitha”.

6.6.2.2. Gratë më paragjyqese për njëra-tjetrën

Meqë shumica e punonjësve në firmat private janë vajza dhe gra, edhe përqindja më e lartë e paragjyqesve është po prej tyre, ndërsa burrat janë pakicë në firmat private dhe nuk janë të përfshirë në procesin e prodhimit drejtpërdrejt, pra nuk ndajnë të njëjtin mjedis pune me të punësuarat. Paragjykimet nga koleget gra zenë peshën më të madhe. Kështu mendojnë 62.0 përqind e të anketuarave, ndërsa 25.0 përqind e tyre mendojnë se kolget vajza janë më paragjyqese në firmat private. Mendojnë se burrat janë më shumë paragjyqes në firmat private 13.0 përqind e të anketuarave. Siç edhe duket nga të dhënat e anketimit, gratë janë më shumë paragjyqese për njëra-tjetrën se sa janë vajzat për gratë, kjo jo vetëm për shkak të numrit më të madh të grave të punësuar në firmat private krahasuar me vajzat, por edhe për shkak se përgjithësisht vajzat janë më pak paragjyqese se gratë.




Vajzat edhe brenda mjedisve të punës në firmat private kishin më shumë shoqëri me njëra-tjetrën dhe me raste shoqëroheshin me gratë e martuara. Ato shprehen se gratë diskutojnë për çështje që janë jashtë interes të tyre si vajza, si për shembull për martesën, për fëmijët, për detyrimet dhe vështirësitë e jetës si gra të martuara, etj, ndërsa vajzat kanë për objekt bisedash çështje të tjera që lidhen më së shumti me të ardhmen e tyre ekonomike, me gjetjen e një partneri për të krijuar familjen, me interesa vetjake për të vazhduar studimet e larta, për të gjetur një punë më të mirë, etj. Duke bërë jetë pak a shumë të ndara, në grup vajzash dhe grup grash, vajzat dhe gratë kanë më shumë bashkëveprim brenda grupit të cilit i përkasin se sa mes grupeve. Për këtë arsye, vajzat shprehen më pak për cilësitë, aftësitë dhe sjelljen e grave, se sa gratë për vajzat.


Vajzat pohojnë se ato vëzhgohen më shumë prej grave se sa gratë prej tyre. Vajzave nuk u interesojnë bisedat dhe shqetësimet e grave, sepse nuk i përkasin stadi jetësor në të cilin ndodhen. Ndërsa gratë janë më paragjyqese edhe në drejtim të njëra-tjetrës, edhe në drejtim të vajzave. Ato u venë re vajzave veshjen, qëndrimet, aftësitë në punë, komunikimin, shoqërimin me punëtorët e firmës, etj. Ndaj njëra-tjetrës, gratë janë më shumë paragjyqese për aftësitë dhe për komunikimin, ndërsa ndaj vajzave për aftësitë dhe moralin. Duke qenë se kryejnë të gjitha punë të njëjtë, ato ndihen në garë se kush punon më mirë dhe presin të vlerësohen sa më pozitivisht për punën.

6.6.2.3. Drejtueset gra janë më paragjyqese se ata burra

Në firmat private shumica e drejtuesve janë gra, ndërsa pronarët janë pothuajse krejtësisht burra. Gratë pronare kanë përgjithësisht biznese të vogla si bar-kafene, parukeri, rrobaqepësi, ndërsa burrat janë pronarë firmash dhe biznesesh të mesme dhe të mëdha. Në bizneset e zonës, ndonjëherë pronarët identifikohen edhe si drejtues të biznesit, sidomos në rastin e biznesit të kulinarisë dhe hotelerisë. Ndërsa në firmat fasone, pronarët kanë emëruar më shumë drejtuese gra, të cilat ndonjëherë janë edhe të afërmet e pronarit si motra, bashkëshortja, vajza ose kushërira e parë. Duke qenë se firmat private drejtohen më shumë nga gratë edhe përqindja më e lartë e paragjyqimeve vjen nga drejtueset gra. Rreth 51.0 për qind e të anketuarave që punojnë në firmat private janë paragjykuar nga drejtueset gra. Ndaj paragjyqimeve të drejtuesve burrat janë ekspozuar rreth 42.0 për qind e të anketuarave. Ndërsa, një pjesë e vogël e tyre, 7.0 për qind janë paragjykuar më shumë nga drejtueset vajza në firmat private.



Më paragjyqese janë gratë në të gjitha nivelet drejtuese, dhe ndër to, më paragjyqeset janë ato në nivele të ulëta drejtimi, pasi ato ndodhen në kontakt më të shpeshtë me të punësuarat se sa drejtues të tjerë të niveleve më të larta. Drejtueset gra të niveleve më të ulëta janë më pranë procesit të prodhimit dhe mbikëqyrin drejtpërdrejt punën e vajzave dhe grave, kështu që kanë më shumë mundësi të informohen për punën e tyre dhe t'ua komunikojnë më shpesh paragjykimet për punën e tyre. Të anketuarat pohojnë se drejtueset e nivelit të ulët e njohin mirë punën prodhuese, jo vetëm sepse qëndrojnë në hapësirën ku kryhet prodhimi, por edhe sepse kanë punuar vetë si punëtore në fillimet e biznesit, pra e njohin profesionin. Paragjykimet më të shumta të drejtueseve të niveleve të ulëta shkojnë më shumë në drejtim të aftësive, shkathtësisë në punë dhe cilësisë së punës. Ato u bëjnë presion të punësuarave të jenë të kujdesshme për punën që kryejnë pasi në të kundërt do mbajnë përgjegjësi për mallin skarco. Në punë ndodhin edhe gabime, prandaj gratë ndihen të kërcënuara nga qortimet ndëshkuese të drejtueseve të niveleve të ulëta. Ato janë, jo vetëm të paragjykuara për aftësitë për punë, por edhe të kërcënuara me humbjen e vendit të punës ose me dëmshpërblimin e dëmeve dhe gabimeve në punë.



Në nivelet e mesme dhe të larta të drejtimit, paragjykes ndaj grave dhe vajzave janë më shumë drejtuesit burra se sa drejtueset gra. Ndihen të paragjykuara nga drejtuesit burra të


niveleve të mesme 50.0 për qind e të punësuarave në firma private, ndërsa gjysma tjetër ndihen të paragjykuara nga gratë dhe vajzat përkatësisht, 28.6 për qind dhe 21.4 për. Ajo që bie në sy tek paragjykimet nga ana e drejtuesve të nivelit të mesëm është shkalla e lartë e paragjyimit të vajzave drejtuese ndaj grave dhe vajzave që kanë në vartësi. Vajzat drejtuese në nivele të mesme drejtimi në firmat private janë me shkollë të lartë dhe ato janë paragjyuese ndaj punonjëseve me nivel më të ulët arsimor se sa ato vetë. Niveli arsimor i vartësve është shkaku për të cilin drejtueset vajza i paragjykojnë të punësuarat, sepse mendojnë se për shkak të nivelit të pamjaftueshëm arsimor, punëtoret që kanë në varësi nuk kanë shprehitë e duhura profesionale dhe etikë komunikimi. Ato presin që punëtoret të shfaqin përlulësi dhe inferioritet përpara tyre si drejtuese dhe nëse vajzat dhe gratë punonjëse nuk veprojnë kështu, atëherë ato i paragjykojnë për sjellje jo etike dhe komunikim të papërshtatshëm për rangun.

Në nivelet e larta drejtuese të firmave private ka vetëm burra dhe gra. Drejtuesit burra në nivele të larta janë më paragjykes se gratë. Kështu mendojnë rreth 52.1 për qind e të anketuarave, ndërsa 47.9 për qind e tyre mendojnë se gratë drejtuese janë më shumë paragjyuese se burrat. Diferenca në perceptimet paragjyuese të drejtuesve burra dhe gra të niveleve të larta është e vogël. Ata janë paragjykes për aftësitë e grave për punën, për përgjegjshmërinë e tyre ndaj punës, për gabimet në punë, për sjelljet dhe komunikimin e punonjëseve me ta. Të anketuarat shprehen se edhe pse kanë pasur kontakte më të rralla me drejtuesit në nivele të larta, ato janë ndjerë të paragjykuara prej tyre, për shkak se janë punëtores të thjeshta, pa ndonjë status profesional dhe pa karrierë.

Gjithashtu, ato pohojnë se drejtuesit e niveleve të larta, duke i parë si punëtores të thjeshta, i paragjykojnë si persona pa arsim dhe me mangësi në komunikim. Një pjesë e drejtuesve të lartë identifikohen edhe si pronarët e firmave private, të cilët i paragjykojnë gratë dhe vajzat punëtores si mosmirënjohëse, kur ato kanë pretendime për pagën dhe kushtet e punës. Sipas tyre, punëtores duhet t'u jenë shumë mirënjohëse që ata u kanë ofruar punë dhe u kanë dhënë mundësi të mbajnë familjen. Kur gratë dhe vajzat punëtores kërkojnë të paguhen në kohë, pronarët, të cilët i vonojnë pagesat ndonjëherë edhe disa muaj rresht, i paragjykojnë ato si mistrece, të paduruara dhe injorante në çështje biznesi.

6.6.2.4. Shpeshtësia e të paragjykuarit në firmat private

Rreth 40.7 për qind e vajzave dhe grave që punojnë në firmat private përballen me paragjykimet. Ndër to paragjykohen çdo ditë 15.2 për qind, çdo javë 11.2 për qind dhe çdo muaj 14.3 për qind.



Denduria e lartë e paragjytimeve u krijon një gjendje ankthi të punësuarave, të cilat i druhen largimit nga puna, për shkak të paragjytimeve. Sikurse pohojnë të anketuarat që punojnë në firma private, ato janë në tension të vazhdueshëm, sepse u duket sikur janë në prove, përgjatë gjithë kohës së punës. Niveli i përkushtimit dhe përgjesisë për punën nuk llogaritet prej paragjykesve.

Një pakicë e të punësuarave, 21.9 për qind, janë paragjykuar më rrallë se një herë në muaj. Ato pohojnë se janë “zanatçie që ja kanë marrë dorën punës” dhe paragjykimet në drejtim të tyre lidhen më shumë me mënyrën e komunikimit me drejtuesit dhe kërkesat për pagë më të lartë për punën që kryejnë, se sa për aftësitë. Është relativisht e lartë përqindja e të punësuarave në firma private, 37.9 për qind që nuk janë përgjigjur se sa shpesh janë paragjykuar. Kjo ka ndodhur, jo sepse ato nuk janë paragjykuar në punë, por sepse e kishin të vështirë të shpreheshin në prani të kolegeve dhe drejtuesve të firmës, të cilët gjatë kohës së anketimit ishin të pranishëm në mjediset ku u krye anketimi. Ato hezituan të përgjigjeshin për të shmangur ndëshkimin që mund të merrnin si pasojë e rrëfimit të situatës së tyre. Megjithatë, në heshtje, ato nuk e mohuan që ishin të paragjykuara.

6.6.2.5. Shkaqet e paragjytimeve


Janë të shumta shkaqet për të cilat vajzat dhe gratë e punësuara në firma private paragjyken. Ndër më të zakonshmet janë paragjykimet për aftësitë për punën, për mungesë takti në komunikim, për mënyrën e sjelljes dhe e veshjes, ankesat për pagën dhe, më pak, paragjykimet për cilësitë fizike, origjinën dhe dialektin.

6.6.2.5.1. Të paragjykuara si të paaftha

Përqindjen më të lartë ndër shkaqet e paragjytimeve ndaj vajzave dhe grave punonjëse në firmat private e zenë ato për aftësitë në punë, 40.7 për qind. Këto paragjytime lidhet më së shumti me nivelin arsimor të të punësuarave në firma private, të cilat, përgjithësisht, janë me shkollë të mesme. Fakti që nuk kanë vazhduar një shkollë të lartë i bën të tjerët të besojnë se ato nuk kanë intelektin e mjaftueshëm e, për pasojë, nuk kanë as aftësitë e duhura profesionale. Megjithatë, vajzat dhe gratë e punësuara në firmat private punonin me shumë përgjegjësi. Për më tepër, ato ndodheshin nën kërcënimin e vazhdueshëm të drejtuesve dhe pronarëve të firmës private se, nëse kryenin gabime në punë, ato do të dëmshpërblenin mallin, do t'u mbahej paga dhe mund të hiqeshin nga puna.

Paragjykimet në drejtim të aftësive u krijonin shumë bezdi të punësuarave, të cilat, me keqardhje, shpreheshin se nëse ato do ishin të paaftha, sikurse paragjykohehin, atëherë puna nuk do të ecte dhe firma do ishte mbyllur. Por, firmat, jo vetëm që nuk ishin mbyllur, por kishin rritur veprimtarinë, duke marrë më shumë porosi dhe duke kryer më shumë punë. Shumica e grave dhe vajzave paragjykuara ishin punëtore të përfshira drejtpërdrejt në proces prodhimi dhe paragjykohehin, jo vetëm për ngathtësi në punë, por edhe për paaftësi për të kryer punën me cilësi. Sa herë që punët në firmë ngecnin, për arsye objektive që lidheshin me biznesin ose me prodhimin, vajzat dhe gratë punëtore akuzoheshin se ishte faji i tyre dhe kërcënoheshin se do ngeleshin pa paga.

Shkaqet kryesore të paragjytimeve në firmat private



6.6.2.5.2. Të paragjykuara për mangësi në komunikim

Të paragjykuarat për mungesë takti në komunikim dhe për mënyrën e sjelljes janë përkatësisht 13.8 për qind dhe 10.3 për qind. Ato shprehen se drejtueset në firmat private kërkojnë më shumë punë prej tyre dhe u flasin me arrogancë dhe shpërfillje. Punëtorët nuk e tolerojnë dot këtë sjellje të drejtueseve dhe mbrohen duke treguar se e kanë kryer punën. Kur punëtorët vetmbrohen nga sulmet paragjyquese të drejtueseve për normën dhe cilësinë e punës, atëherë ato paragjykojnë se nuk njohin pozicionin e tyre që është ta mbajnë gojën mbyllur dhe të mos flasin përpara shefave edhe kur këta nuk kanë të drejtë. Veçanërisht i vështirë, për vajzat dhe gratë punëtore, është komunikimi me drejtueset e niveleve të mesme, të cilat, duke i iu ndejtur punëtoreve mbi kokë, bëhen të bezdisshme me komentet e tyre paragjyquese dhe denigruese. Sulmet paragjyquese për mënyrën e sjelljes nuk i kursejnë punëtorët as kur ato kërkojnë plotësimin e të drejtave elementare në punë, siç janë sigurimi i pagës në kohë dhe kushtet minimale të punës. Kur punëtorët kërkojnë të paguhen dhe të kenë kushte që sigurojnë mbarëvajtjen e punës, ato paragjykojnë se nuk dinë të sillen, se kërkojnë më shumë se sa u takon, se janë mosmirënjohëse ndaj firmës që i ka punësuar, se janë “dhi të zgjebosura me bishtin përperjet!”. Këto paragjytime u krijojnë shumë bezdi të punësuarave në firma private. Vajzat dhe gratë punëtore nuk kanë ku të ankohen për pakënaqësitë në punë, pasi ata që duhet t’i dëgjojnë edhe i paragjykojnë.

6.6.2.5.3. Të paragjykuara për mënyrën e veshjes

Punëtorët në firmat private paragjykohen edhe për mënyrën e veshjes. Kështu janë shprehur rreth 10.3 për qind etë anketuarave. Shumica e të punësuarave në firma private janë përgjithësisht vajza dhe gra të reja. Atyre u vihet re mënyra se si vishen dhe u komentohet shumë pamja, si nga njëra-tjetra, ashtu edhe nga drejtueset. Të anketuarat pohojnë se veshja e tyre është objekt i vazhdueshëm komentesh nga ana e drejtueseve. Mjediset e firmave private ku zhvillohet aktiviteti fason dhe veprimtari të tjera ekonomike në zonë kanë kushte materiale mjerane. Zakonisht, puna kryhet në kapanone të mëdha, në formë magazinash, pa shumë ndriçim dhe ajrosje. Sidomos, në muajt e nxëhtë të vitit, kapanonet e lagështa, me pak ndriçim natyral, shndërrohen në mjedise me vapë të padurueshme dhe punëtorët e kanë të pamundur të mbajnë veshje të tepërta si uniformë, përparëse apo bluza me mëngë të gjata. Ato vijnë në punë me kanatiere ose bluza me rripa dhe marrin edhe veshje rezervë për t'u ndërruar në punë. Kjo veshje është e përshtatshme në kushtet e të nxehtit dhe lagështisë që e rrit duhmën mbyhtëse të ajrit. Veshja e lehtë komentohet si një prirje e vajzave dhe e grave për t'u dukur. Ato pohuan se drejtueset i përgojnë shpesh se vijnë në punë si në pasarelë mode, se nuk e kanë mendjen të punojnë, por të pispilloren, se vijnë në punë që të zbulojnë hiret, se duan të bien në sy të meshkujve punëtorë të firmës, etj. Njëra prej të anketuarave që ishte paragjykuar për veshjen, pas plotësimit të anketës, u shpreh: “Në kapanonin ku punojmë nuk ka sistem ngrohje dhe ftohje, dritaret janë vendosur lart dhe drita hyn me vështirësi, prandaj në mes të kapanonit është vendosur një neon i gjatë që të shohim kur qepim. Kapanoni është i lagësht dhe vjen era myk, prandaj jemi të detyruara ta mbajmë portën e kapanonit hapur, si në dimër edhe në verë. Që nga prilli e deri në tetor mbytemi brenda kapanonit sepse i nxehti që depërton brenda përzihet me lagështinë dhe ajri rëndohet, aq sa ne mezi mbushemi me frymë. Në temperatura të larta, që janë më të larta brenda se jashtë, përpiqemi të përqendrohemi dhe të punojmë me cilësi që të mos dalë malli skarco. Është e pamundur të punohet në kushte të tilla veshur me uniforma pune dhe të mbuluara, prandaj vishemi lehtë, me bluza pambuku me rripa që të mos na rëndojnë veshjet. Bluzat na ngjisin në trup nga djersa dhe mund të mos kemi pamje të hijshme, por kjo nuk varet nga ne. Unë jam munduar t’ia shpjegoj shefes qëllimin e veshjes në këtë mënyrë, por ajo më paragjykon, më thotë se vij ashtu për t’i rënë në sy burrave, për t’i prishur mendjen punëtorëve të firmës, për të treguar se kam trup të bukur, por asgjë prej këtyre nuk është e vertetë. Kur i

kërkuam që të vendosej sistem ftohje për verë dhe ngrohje për dimër, shefja tha se firma nuk kishte para për të harxhuar për tekantona, dhe nëse nuk na pëlqentë të punonim në ato kushte, e kishim derën hapur”.


6.6.2.5.4. Të paragjykuara edhe kur ankohen për pagën

Për ankesat për pagën janë paragjykuar 6.8 për qind e të punësuarave në firmat private. Pronarët dhe administratorët e firmave private nuk janë shumë korrektë në dhënien e pagës në fund muaji, por e vonojnë, ndonjëherë edhe disa muaj. Prandaj, një pjesë e vajzave dhe grave të punësuarave në firma private ankohen. Ankesat e tyre të drejta për pagën keqkuptohen prej drejtuesve, administratorëve dhe madje edhe pronarëve, të cilët i paragjykojnë gratë si të paduruara dhe grindavece, kur ato kërkojnë të paguhen në kohë.

Të anketuarat u shprehën se paga është mundësia e vetme për të përballuar shpenzimet e familjes, dhe nëse nuk paguhen në kohë ato janë të detyruara të marrin para hua për të përballuar koston e jetesës së përditëshme. “Është e tëprt t’i shpjegoj një individ të rritur, që ka për të mbajtur familjen, se paga është e rëndësishme – u shpreh një e anketuar. Jeta ka ligjet e veta dhe shpenzimet për të jetuar do kryehen sido që të jetë, me pagë ose pa pagë. Edhe ne, si çdo familje tjetër, kemi shpenzime ditore sepse konsumojmë ushqim, drita, ujë, por këto shpenzime kryhen të gjitha me para. Nëse nuk marrim pagën, e kemi të pamundur të jetojmë. Unë nuk mund t’i le fëmijët pa ngrënë, duke u shpjeguar se firma ka tre muaj që nuk na paguan, ata nuk duan t’ia dinë për këtë. As dritat dhe ujin nuk mund t’i le pa paguar, sepse nëse nuk i paguan ndërpriten. Nuk e kuptoj se përse administratori dhe pronari bëjnë sikur nuk i marrin vesh këto gjëra. Më vjen shumë turp që çdo fund muaji duhet të bëj fjalë me drejtuesit për pagën. Po ata vetë a mund të rrinë pa paga?”.

6.6.3. Paragjykimet për të vetpunësuarat si pronare

Pjesa më e madhe e bizneseve të mesme dhe të mëdha janë në pronësi të burrave. Gratë kanë në pronësi biznese të vogla dhe familjare, si bar-kafene, parukeri, dyqan ushqimesh, etj. Gratë pronare të bizneseve të vogla paragjykohe për guximin për t'u marrë me biznes. Është e papranueshme nga normat kulturore që gratë të kenë të drejta pronësie dhe ca më pak të bëjnë punë fitmprurëse duke qenë pronare të bizneseve të tyre. Gratë janë konsideruar nga tradita kulturore si qenie shoqërore me rol të mirëpërcaktuar brenda ekonomisë familjare. Dalja nga ky rol kulturor shkon ndesh me stereotipet gjinore për rolin social të gruas dhe bën që veprimtaria e tyre fitmruerëse të duket si deviancë gjinore, sepse kryhet nga gratë.



6.6.3.1. Paragjykuar nga rivalët e njësive private analoge

Paragjykimet ndaj vajzave dhe grave që kanë guxuar të jenë sipërmarrëse vijnë nga drejtime të shumta: nga të njohurit, nga rivalët, nga punonjësit, nga të afërmit, etj. Përqindja me e lartë e paragjykimeve ndaj vajzave dhe grave sipërmarrëse vjen prej rivalëve të njësive analoge. Kështu shprehen rreth 43.0 për qind e të anketuarave që janë pronare të njësive private. Për

pronaret e lokaleve si bar-kafene dhe restorante paragjykesit kanë qenë rivalët meshkuj, të cilët kanë një restorant ose kafene në zonë. Të anketuarat që kanë një biznes të tillë pohojnë se burrat rivalë janë shumë paragjykes. Për të denigruar figurën e grave sipërmarrëse me të njejtin biznes me të tyrin, këta rivalë i paragjykojnë dhe përgojnë gratë për moralin. Ata pretendojnë se gratë i kanë hapur lokalet për të mbledhur burra dhe për të krijuar lidhje intime me meshkuj. Njëra prej grave që kishte hapur vetë një kafene tregoi se si një pronar kafeje disa metra larg lokalit të saj përhapte thëshetheme për të sikur lokali i saj mbushej me meshkuj sepse, sipas tij, ajo për atë punë e kishte hapur lokalin. Ndër të tjera ajo u shpreh: “Unë hapa një bar-kafene poshtë shtëpisë sepse kjo ishte mundësia e vetme për të ushqyer familjen. Burri është me diabet dhe nuk punon dot. Unë duhet të punoj për të siguruar mbijetesën e familjes. Isha e papunë dhe pas vitesh për të gjetur punë, gjeta lokalin si rrugëzgjdhje. Të parët që më shkelën në lokal ishin fqinjët. Lokali mbushej plot, me njerëz të lagjes dhe të afërm të tyre. Por, mborthësia e lokalit tim ngjalli zilinë e pronarit që kishte lokalin disa metra larg meje. Ai si fillim kërcënoi tim shoq që ta mbyllte lokalin sepse, sipas tij, i paskeshim marrë klientët. Si nuk i eci kërcënimi me tim shoq, ai filloi të nxirrte fjalë në lagje se unë e kisha hapur lokalin për prostitucion”.

6.6.3.2. Paragjykuar nga të njohurit

Rreth 29.0 për qind e grave që kanë në pronësi biznese janë paragjykuar nga të njohurit, të cilët duke iu përmbajtur stereotipeve gjinore për rolin dhe statusin e gruas, nuk i kanë miratuar veprimet e tyre si sipërmarrëse. Përkundrazi i kanë shkurajuar, duke i këshilluar se biznesi nuk është punë për gratë, por për burrat. Përveç arsyeve kulturore, të njohurit dhe të afërmit e grave pronare kanë qenë hezitues për veprimtarinë sipërmarrëse të grave edhe për një arsye tjerë që lidhet me konkurrencën e pandershme në fushën e biznesit. Ata janë nisur nga qëllime të mira për t’i mbrojtur nga zhgënjimi që shkakton rivaliteti i pandershëm në biznes. Ata kanë menduar se duke mos pasur njohje të mjaftueshme me njerëz të pushtetshëm dhe duke mos njohur dredhitë e sipërmarrjes, vajzat dhe gratë do të humbisnin investimet dhe energjitë në një terren që nuk është miqësor për gratë, siç është biznesi. Sipas tyre, konkurrenca e pandershme që mund t’bëjnë bizneseve të tyre, biznese të tjera të ngjashme, do kishte pasoja në falimentimin e sipërmarrjes së grave. Përveç kësaj, gratë do përballeshin edhe me kërcënime që do t’u vinin nga rivalët meshkuj që kanë biznese analoge në zonë.

Rreth 14.0 e vajzave dhe grave pronare janë paragjykuar nga vajza dhe gra të tjera, me të cilat janë konfliktuar para se të organizonin njësinë private. Këto, duke dyshuar në aftësitë sipërmarrëse të vajzave dhe grave pronare, i kanë paragjykuar për pazotësi dhe mungesë njohurish nga fusha e biznesit. Pronaret e anketuara pohojnë se janë ironizuar me sarkazëm nga ana e vajzave dhe grave me të cilat kanë pasur mosmarrëveshje. Njëra prej tyre, që kishte hapur një parukeri, tregoi se e kishte përjetuar vetë peshën e paragjykimeve të tilla: “Kur hapa parukerinë, vajzat dhe gratë e zonës me të cilat nuk kisha pasur ndonjë marrëdhënie të ngrohtë u treguan shumë dyshuese për biznesin tim. Ato më paragjykonin se unë nuk merrja vesh nga estetika, madje më vinin në vesh thashethemet e tyre se unë nuk dija të rregulloja flokët e mia, pale të zbukuroja kokat e të tjerave. Më vinte shumë keq që i dëgjoja të flisnin pas krahëve dhe doja t’u kthehesha, kur i shihja në lagje, por nuk doja të nxirrja në shesh gratë që m’i kishin thënë këto fjalë, të cilat ishin kliente të miat. Unë e fitova betejën e thashethemeve dhe paragjykimeve, duke punuar. Klientet e mia ishin shumë të kënaqura me punën time dhe shërbenin si kundërpeshë ndaj grave që flisnin keq për mua duke bërë kundër-reklamë”.

6.6.3.3. Paragjykuar nga vartëset


Vajzat dhe gratë pronare janë paragjykuar edhe nga vajzat dhe gratë punonjëse të njërive të tyre private. Kështu janë shprehur rreth 14.0 për qind e të anketuarave. Punonjëset i paragjykojnë pronaret se këto janë shumë të orientuara drejt parasë dhe u kërkojnë punonjëseve të punojnë jashtë orarit dhe në ditë fundjave dhe festash zyrtare. Njëra prej të anketuarave që kishte në pronësi një laborator dentar u shpreh se punonjësja e saj ishte jo vetëm e përkëdhelur, por edhe e pabindur. Ndër të tjera ajo rrëfen: “Punësora një vajzë për të më ndihmuar me mirëmbajtjen e laboratorit dhe me punë të tjera, si dërgimi dhe marrja e porosive tek dentistët me të cilët isha lidhur. I thashë që puna në një laborator dentar është më shumë perspektivë dhe se ajo mund të mësonte shumë duke më ndjekur mua. Madje i sugjerova që të vazhdonte shkollën për laborante dentare në mënyrë që të punonim bashkë ose të hapte laboratorin e saj në të ardhmen. Ajo ishte vajzë e sjellshme, por nuk kishte kulturë pune si shumica e të rinjve sot, të cilët nuk kanë bërë asnjë ditë praktikë punë gjatë shkollës së mesme. Megjithatë, duke e ditur këtë problem, unë tregohesha tolerante dhe mundohesha ta këshilloja të ishte më e vëmendshme, më e shkathët, të mësonte të ma merrte punën nga dora dhe jo ta ngucja unë me urdhëra për çdo

gjë. Nëse unë nuk e urdhëroja për të bërë gjërat që duhej t'i bënte vetë, ajo ishte e gatëshme të rrinte gjithë ditën ulur dhe të luante në celular. U detyrova t'i them se celularin duhej ta fikte kur ishte në punë dhe se duhej të merrej me punët e laboratorit se për atë punë e kisha punësuar, jo për të zënë qoshen dhe të luante me celular. E kishte bërë celularin gjymtyrë të pestë, nuk e ndante nga dora. Kur e dërgoja të merrte porositë, ajo e kishte me shumë përtesë dhe vonohej në mënyrë të paarsyeshme dhe pa dhënë shpjegime për vonesat. Kur i thosha të pastronte laboratorin, grumbullonte ndonjë papastërti mbi tavolinë dhe nuk pastronte veglat dhe klinikën. E pyeta se përse nuk donte të pastronte dhe m'u përgjigj se nuk mendonte se ishte punësuar për të pastruar, por për të bërë laboranten. Në mllëf e sipër, hoqa përparësen dhe i thashë: Na merre, pa të shohim si e bën laboranten!. Ajo më pa gjithë inat dhe u largua.”.

6.6.3.4. Shpeshtësia e paragjytimeve

Vajzat dhe gratë që kanë në pronësi një njësi ekonomike private paragjykohen me një denduri të lartë prej të njohurve, punonjëseve dhe rivalëve. Paragjykohen çdo ditë, çdo javë dhe çdo muaj 63.4 për qind e tyre dhe më rrallë se një herë një muaj 28.6 për qind. Denduria e paragjytimeve të përditshme është 28.6 për qind dhe është më e lartë se paragjykimet e përjavshme dhe të përmuajshme, që janë përkatësisht 21.4 për qind secila. Denduria e paragjytimeve ndaj vajzave dhe grave sipërmarrëse është e lartë për disa arsye. *E para*, sepse ato kanë sfiduar rolet dhe stereotipet gjinore në lidhje me rolin e gruas si pasive, e nenshtuar dhe e varur nga të tjerët. *E dyta*, sepse aftësitë sipërmarrëse konsiderohen si attribute mashkullore.

Denduria e paragjykimeve ndaj pronareve në firmat private




E treta, bota e biznesit është një fushë loje me lojtarë përgjithësisht meshkuj, ku gratë shihen si të tjerësuara, si persona që kanë deviuar nga standardi normativ kulturor për gruan. Aq e vërtetë është kjo, sa në gjuhën e folur shqip është keqpërshtatur termi anglisht për sipërmarrësin burrë edhe për gruan, pra një grua sipërmarrëse në gjuhën e përditshme nuk thirret business-women por “biznesmene” (businessmen do të thotë sipërmarrës në anglisht). Kjo vështirësi përshtatjeje e terminologjisë tregon se sa e pamundur ka qenë në perceptimin popullor të mendohet për gratë si sipërmarrëse, ashtu sikurse edhe burrat. *E katërta*, perceptimi shoqëror për sipërmarrjen fitimprurëse është ngushtësisht i lidhur me fuqinë, pushtetin dhe parënë, koncepte këto që asociohen ngushtësisht me tiparet mashkullore dhe jo ato femërore, prandaj gratë duket se janë të papërshtashme për t’u marrë me biznes. Perceptimi se bota e biznesit është e pistë dhe u shkon vetëm burrave, sepse ata mund t’i zgjidhin gjërat me dredhi dhe forcë, i përjashton gratë nga kjo lloj logjike. Gratë perceptohen si qenie naëve që nuk janë të përshtatshme për botën e pistë të biznesit. Për më tepër, përse i përket biznesit, është i përhapur gjerësisht perceptimi shoqëror se me biznes janë marrë njerëzit që vijnë nga shtresa të ulëta shoqërore, të paarsimuar, që e kanë vënë kapitalin pasuror me veprimtari të paligjshme si trafikimi i qenieve njerëzore, prostitucioni dhe shpërndarja e narkotikëve. Gratë që duan të merren me biznes projektohen në perceptimin shoqëror më shumë si viktime të destinuara të mashtrohen dhe të nxirren me dredhi dhe forcë nga bota e parasë, se sa sipërmarrëse që mund të kenë sukses, sepse suksesi nuk varet prej meritave dhe aftësive sipërmarrëse më shumë se sa prej

shkathësive për të çarë në rrjetin e komplikuar të botës së biznesit e cila është plot të papritura të pakëndshme, sidomos për gratë.

6.6.3.5. Shkaqet e të paragjykuarit

Ka një shumësi shkaqesh për të cilat vajzat dhe gratë sipërmarrëse etiketohen, por arsyeja më e shpeshtë, e përmendur pothuajse prej të gjithave si një refren, është xhelozia për arritjet e tyre si sipërmarrëse. Me xhelozia ato nënkuptonin njëkohësisht mungesën e besimit të të tjerëve për aftësitë e tyre për të ndërmarrë një veprimtari private dhe zilinë për suksesin e tyre.

Vajzat dhe gratë pronare pohuan se janë paragjykuar më rëndë atëherë kur kanë zbatuar me korrektësi ligjet e shtetit (30.0 për qind), se sa kur kanë abuzuar me to (25.0 për qind), për përfitime vetjake. Përqindja më e lartë e paragjykimit kur janë treguar korrekte me kërkesat ligjore në lidhje me veprimtaritë fitimprurëse private shpjegohet me faktin se për shumë vite biznesi ka funksionuar jashtë kuadrit ligjor, jo për shkak të mungesës së ligjeve, por kryesisht për shkak të moszbatimit të tyre prej shumicës së sipërmarrësve. Gratë dhe vajzat që kanë zbatuar ligjet janë paragjykuar si naëve, që nuk kanë ditur të ruajnë fitimet e veta nga tatimi dhe që ia kanë falur paratë shtetit, ndërkohë që bizneset në përgjithësi i kanë shmangur detyrimet ligjore dhe kanë punuar me dy bilance, njërin për vete, në të cilin mbajnë shënime shifrat reale të biznesit dhe tjetrin për tatimet ku deklarojnë fitime më të pakëta.



Madje, sipërmarrëset që kanë paguar rregullisht detyrimet ligjore si tatimin mbi vlerën e shtuar, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për vete dhe për të punësuarat, janë paragjykuar sepse kanë prishur rregullin e heshtur të funksionimit të biznesit. Në fakt, pronaret e bizneseve të vogla që paguajnë detyrimet financiare ndaj shtetit shprehen se ato janë më të qeta duke vepruar kështu, pasi nuk u duhet të gjejnë një punonjës tatimesh si protektor për t'i mbrojtur nga kontrollet tatimore, siç veprojnë shumica e bizneseve, të cilave shërbimi i protektoratit tatimor u kushton, sepse personi i korruptuar merr rryshfet nën dorë për shërbimin që kryen në favor të sipërmarrësve që mashtrojnë. Mosdeklarimi i fitimit dhe mospagimi i detyrimeve ekonomike ndaj shtetit është një veprimtari kriminale që kryhet nga sipërmarrësit mashtrues në bashkëpunim me tatimorët e korruptuar. Gratë që janë të rregullta në veprimtarinë fitimprurëse nuk kanë dashur të shkelin ligjin për disa arsye. *E para*, sepse shkelja e ligjit ndëshkohet dhe gratë nuk duan të kenë problem të tilla. *E dyta*, duke punuar në shkelje të ligjit, ato do të përjetonin ankth të madh se mos zbuloheshin për aktivitetin kriminal. Sikurse e shprehu në mënyrë lakonike një pronare: “Unë dua ta bëj gjumin e qetë, shkelja e ligjit të trazon natën dhe ditën. Më mirë të jem në rregull me shtetin se sa të rri me sytë nga dera se mos vijnë të më arrestojnë për mashtrim financiar. Pastaj, tatimorët që na kontrollojnë janë të përkohshëm dhe i bie t’i gjej anën secilit tatimor që vjen i ri në detyrë e deri sa t’ia gjej do rri me lepur në bark nga frika se mos kapem. Ilaçe do më bëheshin ato para të shkreta që do ruaja nga mashtrimi. Sa të bëhem për ilaçe, më mirë të paguaj e të rri e qetë në punë time”.

Mirëpo edhe kur kanë abuzuar me zbatimin e ligjeve, 25.0 për qind e grave sipërmarrëse pohojnë se janë ndjerë të paragjykuara. Ato shpjegojnë se janë paragjykuar sepse kanë përvetësuar një sjellje jo korrekte në kundërshtim me normat e moralit, duke mashtruar. Mashtrimi në biznes është një sjellje më e toleruar për burrat sipërmarrës se sa për gratë sipërmarrëse. Gratë që mashtrojnë janë duke kryer një aktivitet kriminal dhe përfshirja në sjellje deviante është e pamoralshme për gratë, kurse burrat devijojnë me lehtë nga normat morale, madje ata edhe amnistohen më lehtë nga morali shoqëror.

Publiku i gjerë është mësuar të shohë si deviantë më shumë meshkujt se sa gratë, sepse është kulturalisht e palejueshme që gratë të përfshihen në sjellje kriminale, pasi ajo konsiderohet si sjellje mashkullore. Gratë sipërmarrëse që mashtrojnë autoritetet shtetërore për fitimet nga biznesi kanë devijuar dyfish, një herë nga ligji dhe njëherë nga normat kulturore, duke u sjellë në

mënyrë mashkullore, në vend që t'i përmbahen rolit shoqëror për gjininë. Nga njëra anë, ato përballen me stigmën shoqërore sepse kanë shkelur moret e kulturës, duke e marrë edhe me biznes si burrat, dhe nga ana tjetër ato paragjykojnë se kanë shkelur ligjin si burrat. Opinioni shoqëror i paragjykon sipërmarrësit sepse ato nuk përmbushin pritshmëritë morale për sjelljen e gruas. Gratë që mashtrojnë me deklarinimin e fitimit dhe që nuk zbatojnë detyrimet fiskale ndaj shtetit janë dy herë deviante, e para sepse kanë shkelur normat kulturore mbi moralin femëror duke u sjellë si burra, dhe e dyta sepse kanë shkelur ligjin duke deviuar nga zbatimi i ligjit që është më shumë sjellje mashkullore.

KAPITULLI VII

VETVRASJA SI FORMË REAGIMI NDAJ PARAGJYKIMEVE

7.1. Vetvrasja: rrugë shpëtimi nga paragjykimet

Vetvrasja është një dukuri shqetësuese për vajzat dhe gratë që jetojnë në fshat, e cila, ndër të tjera, shkaktohet edhe nga paragjykimet e shumta në drejtim të karakterit, personalitetit dhe moralit të tyre. Paragjykimet dhe denigrimi shoqëror që pësojnë vajzat dhe grate, si pasojë e paragjykimeve, i shtojnë ato drejt tentativave vetvrasëse. Mjedisi shoqëror, e sidomos ai familjar, është i tejmbushur me paragjykime kundrejt vajzave dhe grave. Në fshat, paragjykimet e shndërrojnë mjedisin familjar, nga një vend që duhet t'u sigurojë vajzave dhe grave mbrojtje, në një mjedis abuziv, në të cilin paragjykimet veprojnë më fort, duke shkaktuar përjetime negative. Një pjesë e vajzave dhe grave, duke përjetuar një dëshpërim të thellë prej sulmeve paragjykuese, nuk dëshirojnë të jetojnë më si të paragjykuara dhe tentojnë të vetvriten. Pjesa më e madhe e paragjykimeve lidhen me rolet sociale të vajzave dhe grave, kryesisht me funksionet e riprodhimit, shërbimit dhe të përkujdesjes. Sado përpjekje bëjnë vajzat dhe gratë në fshat për të përmbushur rolet shoqërore, është e pamundur që të shmangen paragjykimet për aftësitë e tyre. Për pasojë, vajzat dhe gratë nuk u shpëtojnë dot paragjykimeve dhe efekteve të tyre. Prandaj, një pjesë e tyre, sidomos ato të paragjykuara më rëndë në drejtim të moralit, karakterit dhe personalitetit tentojnë të vetvriten.

7.2. Këndvështrimi dyrhemian për vetvrasjen

Studimi më me ndikim për çështjen e vetvrasjes vazhdon të jetë ai i realizuar nga Emile Durkheim, “Vetvrasja”, botuar për herë të parë në vitin 1897. Vetvrasja është një dukuri shoqërore që shkon përtej aktit individual. Durkheim e përcaktoi vetvrasjen si një vdekje që e shkakton vetë viktimën, duke bërë diçka (akt pozitiv), si për shembull duke shkrehur një armë zjarri ose duke mos e bërë (akt negativ), si për shembull duke mos ngrënë: “Vetvrasja është vdekja që ndodh nëpërmjet dhe si rrjedhojë e një veprimi pozitiv ose negativ të vetë viktimës që e di se me veprimet e veta do shkaktojë vdekjen” (Durkheim, E., 2015:8). Durkheim thekson se vetvrasja shkaktohet prej mungesës së integritetit të individit në bashkësinë shoqërore. Motivet e vetvrasjes përcaktojnë edhe tipologjinë e tyre në katër forma: egoiste, altruiste, anomike dhe fataliste. Dy të parat ndodhin prej shkallës së integritetit moral të individit në bashkësinë kolektive ku jeton. Vetvrasja egoiste ndodh kur individi ka një nivel të ulët integriteti në bashkësi. Për shkak të individualizmit të theksuar, ai nuk e gjen veten në atë bashkësi (familjare, fetare, politike, etj.). Mund të thuhet se individi është strukturuar në mënyrë të papërshtatshme si element i bashkësisë shoqërore.

Ndërsa vdekja altruiste ndodh kur individi nuk ka “pronësi” mbi veten e vet, pasi ai është në funksion të shoqërisë dhe moralit të saj. Ai që kryen vetvrasje altruiste është më i strukturuar se sa duhet si element i bashkësisë ku jeton. Ndërgjegjja individuale e atyre që kryejnë vetvrasje egoiste ka një përputhshmëri të pakët morale me ndërgjegjen kolektive që përfaqësohet dhe shprehet nga besimet, vlerat, qëndrimet, normat dhe praktikën shoqërore të përbashkëta. Ndërsa ndërgjegjja e atyre që kryejnë vetvrasje altruiste ka një shkrirje me ndërgjegjen kolektive dhe jeta e tyre drejtohet thuhetse në mënyrë të verbër nga normat dhe traditat shoqërore, jashtë të cilave ata nuk jetojnë dot dhe për këtë arsye janë të gatshëm të vdesin. Normat shoqërore e imponojnë vdekjen si diçka shoqërisht të pëlqyeshme dhe moralisht të pranueshme. Personi heq dorë nga jeta për një ideal ose besim në të cilin beson shoqëria. Raste të tilla vdekjesh përmbushin një pritshmëri, një ideal, një detyrë fisnike në të mirë të bashkësisë që e lartëson moralisht personin si për shembull për vërtetimin për çështje fetare, atdhedashurie. E tillë është edhe praktika Suti në Indi, vetvrasja e gruas kur i vdes burri, kur gruaja e ve hidhet në zjarrin ku digjet kufoma

e bashkëshortit të vdekur, sepse kështu e diktojnë normat shoqërore, përndryshe ajo nuk do të respektohet prej bashkësisë (Liddle, J., Joshi, R., 1985:74).

Vetvrasja anomike ndodh si pasojë e mungesës së rregullit shoqëror mbi jetën e individit. Sipas Durkheim, vetvrasja anomike është simptomë kronike e shoqërisë moderne, në të cilën fuqia e fesë zbehet dhe zhvillimi i industrisë bëhet një qëllim në vetvete, ndërkohë që do të duhej të ishte një mjet për arritjen e qëllimit që është mirëqenia kolektive. Nevojat dhe dëshirat e individëve rregullohen prej moralit të shoqërisë, por kur në shoqëri ndodhin kriza ekonomike, madje edhe kur ndodh një rritje e shpejtë ekonomike, shoqëria nuk është më në gjendje të ushtrojë funksione rregulluese të jetës së individëve, sepse priset ekuilibri shoqëror. Kur ndodhin ndryshime të shpejta dhe të papritura shoqërore, ndryshojnë edhe vlerat dhe nevojat e grupeve shoqërore. Rivendosja e rregullit shoqëror në jetën e individëve dhe rregullimi i nevojave të grupeve të ndryshme shoqërore kërkon kohë. Përgjatë kësaj periudhe kalimtare njerëzit mund t'i humbin qëllimet në jetë duke përjetuar një gjendje anomie. Në gjendje anomie, ndodhin vetvrasje për shkak të mungesës së rregullimit shoqëror mbi nevojat dhe interesat e individëve dhe grupimeve ku ata bëjnë pjesë. Në shoqëritë e industrializuara vetvrasja ndodh më së shumti tek ata që ushtrojnë profesione të lidhura me industrinë dhe tregtinë. Nëse vetvrasjet egoiste dhe altruiste varen nga shkalla e atashimit të individëve me shoqërinë, vetvrasjet anomike varen nga mënyra se si është rregulluar jeta e individëve prej shoqërisë (Durkheim, E., 2015:30).

Meqë anomia prek edhe marrëdhëniet martesore, ndodhin edhe vetvrasje anomike për shkak të mosfunksionimit të martesës. Megjithatë, shprehja më e zakonshme e anomisë martesore është më shumë divorci se sa vetvrasja. Koeficienti i vetvrasjeve anomike, sipas Durkheim, është më i lartë tek burrat se sa tek gratë, sepse burrat humbin përfitimet që kanë prej martesës, por gratë tentojnë të vetvriten më shpesh se sa burrat. Burrat kanë më shumë përfitime prej rregullimit martesor se sa gratë, edhe pse është pretenduar se martesa ka qenë në favor të grave sepse i lidh burrat pas tyre, ndërsa burrat i shtrëngon të lidhen vetëm pas një gruaje dhe t'i japin fund kapriçove të tyre seksuale. Për zgjidhjen e problemit të anomisë martesore, Durkheim sugjeron më shumë liri dhe barazi për gratë në martesë. Ndërsa për vetvrasjet egoiste sugjeron si zgjidhje futjen e individëve të çintegruar në rrjedhën e shoqërisë, nëpërmjet grupeve shoqërore që mund t'i ofrojnë lidhje të qëndrueshme dhe të ushtrojnë ndikim mbi vetëdijen individuale. Individit sundohet prej një realiteti më të madh se sa realiteti i tij individual, ai është i zhytur në realitetin kolektiv, i cili ka një ndërgjegje të vetën që imponohet mbi ndërgjegjen individuale.

Forma e fundit e vetvrasjes është vetvrasja fataliste; ajo është e kundërta e vetvrasjes anomike, sepse shkaktohet nga rregullimi i tepërt i jetës individuale prej shoqërisë. Vetvrasjet e këtij lloji ndodhin për shkak të despotizmit të skajshëm moral dhe fizik që shoqëria ushtron tek individët, nëpërmjet institucioneve të saj si: familja, politika, feja, etj. Njerëzit që kryejnë vetvrasje fataliste janë të pashpresë, sepse rregullimi tiranik shoqëror u ka bllokur çdo mundësi shpëtimi dhe shoqëria iu shtyp pasionet dhe dëshirat. Vetvrasja fataliste nuk është dukuri tipike e shoqërisë moderne, por e shoqërive të mbyllura. Në shoqëritë moderne të industrializuara, ku individualizmi merr përparësi, vetvrasja anomike është më e përhapur.

7.3. Vetvrasjet në Republikën e Shqipërisë sipas të dhëna zyrtare

Studimet mbi vetvrasjen janë të pakta, për shkak të vështirësisë që paraqet hulumtimi empirik i dukurisë së vetvrasjes. Statistikat zyrtare të Institutit të Shëndetit Publik flasin për një rritje të numrit të vetvrasjeve dhe tentativave vetvrasëse në formën e dëmtimeve të qëllimta gjatë dy dhjetëvjeçarëve të parë të tranzicionit (Burazeri, G., Bregu A., Qirjako, Roshi, E., G., Petrela, K., Bukli, M., Achtenberg, A., 2014:73). Të dhënat statistikore për vetvrasjet në Shqipëri janë mbledhur rregullisht prej Institutit të Statistikave, INSTAT, për vitet 1999-2008. Që nga viti 1999 e deri në vitin 2002 numri i vetvrasjeve pësoi një rënie të lehtë, por në vitin 2004 u ringrit. Të dhënat në tabelën e mëposhtme japin një pasqyrë të numrit të vrasjeve për periudhën 1999-2008 (INSTAT a, 2005:61; INSTAT b, 2005:28; INSTAT, 2008:19; INSTAT, 2009:19).

Tabela 1: Vetvrasjet nga viti 1999-2008

Vetvrasje											
Vitet											
	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	Gjithsej
Meshkuj	102	74	77	83	73	89	88	110	77	99	872
Femra	53	34	33	38	47	55	55	45	47	61	468
Gjithsej	155	108	110	121	120	144	143	155	124	160	1340

Burimi INSTAT a, INSTAT 2005, INSTAT 2008, INSTAT 2009

Siç shihet edhe nga statistikat, përgjatë një dhjetëvjeçari, nga viti 1999 deri në vitin 2008, janë kryer 1340 vetvrasje prej të cilave 34.9 për qind janë kryer nga vajzat dhe gratë. Rritja e numrit të vetvrasjeve në Shqipëri mund të interpretohet në dritën e perspektivës dyrkheimiane si vetvrasje anomike, për shkak të mungesës së rregullimit të jetës individuale nga normat shoqërore ekzistuese, pas periudhës së regjimit socialist. Ajo çka mund të duket si një përvojë individuale, në fakt mund të interpretohet si një dukuri sociale, sepse mund të shpjegohet nëpërmjet ndikimit të strukturave shoqërore në jetën e individëve. Sikurse thekson Durkheim, vetvrasja ka një shpjegim shoqëror, sepse janë institucionet shoqërore, të cilat ai i quan shoqëria familjare, politike, ekonomike dhe grupet fetare ato që i japin formë sjelljes e individëve dhe që ndikojnë në përmbushjen e qëllimeve të tyre në jetë (Durkheim, E., 1930:6).

Tabela 2. Llojet e vetvrasjeve për periudhën 1999-2004

Vetvrasje –Suicides							
Vitet – Years							
Llojet e vetvrasjeve	199	200	200	200	200	2004	Typology of suicides
	9	0	1	2	3		
Vetvrasje me substanca të ngurta	23	12	13	17	25	30	Suicide with solid substance
Vetvrasje me varje në litar	30	2	26	33	32	44	Suicide from hanging
Vetvrasje me gaz	2	23	10		1	2	Suicide from gas suffocation
Vetvrasje me mbytje në ujë	9	2	38	7	10	8	Suicide from drowning
Vetvrasje me armë zjarri	67	51	4	45	34	40	Suicide with fire weapon
Vetvrasje me vegla prerëse	2	4	8		3	2	Suicide with cutting tools
Vetvrasje me kërcim nga vend i lartë	14	8	9	10	4	8	Suicide by jumping from tall buildings
Vetvrasje të tjera	8	6	2	9	11	10	Other kinds of suicide
Gjithsej	155	108	110	121	120	144	Total

Burimi : INSTAT b, 2005:62

Përgjithësisht, në Europë, vetvrasjet kanë qenë më të shpeshta për meshkujt se sa për femrat, por që prej viteve 1980 ka një rritje të tentativave për vetvrasjeve tek femrat (Schmidtke, A., Brille-Brahe, U., 1996:327). Edhe në Shqipëri, ka një rritje të tentativave vetëvrasëse për vajzat dhe gratë. Nga dukuria e vetvrasjes, përgjatë viteve të tranzicionit passocialist janë prekur edhe vajzat dhe gratë, të cilat njësoj si burrat vuajnë mungesën e rregullit shoqëror dhe pasiguritë

e shumta që ofron periudha e tranzicionit, si: pasiguria dhe pamjaftueshmëria ekonomike, ndryshimet kulturore, paqëndrueshmëria politike dhe atomizimi i shoqërisë.

Tabela 3. Llojet e vetvrasjeve të kryera nga femrat në vitet 1999-2004

Vetvrasje – Suicides							
Femra – Females							
Vitet – Years							
Llojet e vetvrasjeve	1999	2000	2001	2002	2003	2004	Typology of suicides
Vetvrasje me substanca të ngurta	14	8	5	7	17	21	Suicide with solid substance
Vetvrasje me varje në litar	8	2	9	12	9	15	Suicide from hanging
Vetvrasje me gaz	1	10	3				Suicide from gas suffocation
Vetvrasje me mbytje në ujë	5	2	8	4	4	3	Suicide from drowning
Vetvrasje me armë zjarri	19	10	2	11	8	9	Suicide with fire weapon
Vetvrasje me vegla prerëse		2	4	1	1		Suicide with cutting tools
Vetvrasje me kërcim nga vend i lartë	4	0	2	3	2	3	Suicide by jumping from tall buildings
Vetvrasje të tjera	2	0			6	4	Other kinds of suicide
Gjithsej	53	34	33	38	47	55	Total

Burimi : INSTAT b, 2005 :62

Nga më shqetësueset është vetvrasja me substanca të ngurta, e cila në pesë vite, nga vitit 1999 deri në vitin 2004 ka shënuar 72 raste. Përdorimi i substancave helmuese është mënyra më e përhapur e vetvrasjes. Vajzat dhe gratë vendosin të vetvriten duke përdorur helm fotoksinë, në gjuhën popullore i njohur si bar miu, të cilin e sigurojnë lehtësisht në depot farmaceutike për kafshët shtëpiake. Vajzat dhe gratë nga fshati e paraqesin si një arsyetim të justifikuar përpara farmacistëve blerjen e fosoksinës për ta përdorur kundra brejtësve si minj shtëpie, minj are, nuse lale, etj që dëmtojnë objektet shtëpiake, ushqimet dhe produktet bujqësore e blegtorale që prodhohen në fshat. Në rend të dytë rradhiten vetvrasjet me armë zjarri, të cilat në pesë vite 1999-2004 kanë shënuar 59 raste. Armët e zjarrit kanë qarkulluar nëpër duart e popullsisë civile që prej hapjes së depove të armëve në vitin 1997. Në vend të tretë renditen vetvrasjet me varje në litar, të cilat ndodhin në mjediset shtëpiake. Në fshat vajzat dhe gratë e vetvrasura me varje në litar i kanë kryer këto akte edhe në mjediset ku mbahen prodhimet bujqësore ose bagëtitë.

Dukuri e vetvrasjes ka njohur rritje pas shpërbërjes së regjimit socialist totalitar, për shkak të ndryshimeve rrënjësore që ndodhën në shoqërinë shqiptare. Të gjendur në një kontekst të ri ekonomik, politik dhe shoqëror, pas shpërbërjes së regjimit socialist, njerzit nuk mundën të vetregulloheshin. Mosfunksionimi i ndërgjegjes kolektive u bë shkak për çoroditje mendore. Njerëzit u gjendën të papërgatitur për ndryshimet e shpejta dhe rrënjësore. Jeta e tyre iu ekspozua ndryshimeve të papritura që shkaktuan konfuzion vleror dhe normativ. Nga jeta e “kronometruar” në regjimin socialist, me një rregullsi konstante dhe ecuri lehtësisht të parashikueshme, njerëzit u zgjuan në një realitet të ri, në shtjellën e një ndryshimi marramendës që zhvendosi edhe boshtin moral vleror.

Jeta individuale, nevojat dhe dëshirat vetjake, rregulloheshin prej funksionimit të institucioneve shoqërore në regjimin socialist. Shumica e njerëzve besonin në norma dhe vlera të përbashkëta dhe kryenin të njejtat praktika. Besimi dhe praktikimi i të njejtave gjëra u jepte njerëzve siguri mendore dhe veprimeve të tyre një vlerë shoqërore. Ndërgjegja individuale e secilit mbështetej në ndërgjegjen kolektive. Mirëpo, me zbehjen e funksioneve rregullatore të institucioneve shoqërore, u përmbysën edhe rregullat e dikurshme. Horizonti i rregullimit shoqëror, me mundësitë që ofronte, për disa u shtri aq shumë sa shkonte përtej kufirit që ata nuk mund t'i kapnin, ndërsa për disa u ngushtua aq shumë sa nuk e duruan dot shtrëngimin, dhe ranë viktimë e shtysave për vetvrasje anomike. Procesi i atomizimit shoqëror dhe migrimi masiv shkaktoi shpërbërjen e shumë familjeve dhe grupeve shoqërore. Vorbulla e tranzicionit, përfshiu në syrin e ciklonit institucionin e martesës dhe familjes. Rregullimi shoqëror i martesës u dobësua, duke shkaktuar anomie martesore që çoi në rritjen e numrit të divorceve. Të gjendur të papërgatitur për ndryshime të tilla në marrëdhënien martesore, një pjesë e njerëzve të divorcuar kanë zgjedhur vetvrasjen si mënyrë shpëtimi nga anomia martesore. Rritja e numrit të vetvrasjeve është tregues i shpërbërjes së ndërgjegjes kolektive. Dukuria dëshmon për një shturje të indit social ku individët mbahen të lidhur me njëri-tjetrin. Individët jetojnë në një realitet më të madh se ai që kanë krijuar vetë, ata janë të zhytur në ndërgjegjen kolektive, e cila ka një fuqi sipërore ndaj ndërgjegjes individuale. Rregullimi që ushtron ndërgjegja kolektive në jetën e individëve mundëson integrimin e tyre në shoqëri. Nëse ky rregullim mungon, atëherë individët ndodhen në një gjendje të çekuilibruar anomike që i shtyn drejt vetvrasjes.

Sipas një studimi të kryer nga INSTAT në vitin 2007 për shkaqet e vdekjeve në Shqipëri mbështetur te klasifikimi ndërkombëtar i Organizatës Botërore të Shëndetësisë, me treguesit e

ICD-9 b, që bazohen në certifikatat mjekësore të skedës së vdekjes, zonat rurale janë më të prekura se sa zonat urbane nga dukuria e vetvrasjes. Në fshatra ndodhin më shumë vetvrasje se sa në qytete. Sipas të statistikave zyrtare të ofruara nga Instituti i Statistikës për vitin 2007, nga 124 vetvrasjeve, 75 ose 60.5 për qind ishin kryer në fshatra dhe 49 ose 39.5 për qind ishi kryer në qytete (INSTAT b, 2008:35).

Tabela 4. Numri i vdekjeve nga aksidentet sipas nëngrupeve, për vitin 2007

Vdekjet aksidentale	Gjithsej	Sipas gjinisë		Sipas vendbanimit	
		Meshkuj	Femra	Qytet	Fshat
Gjithsej	827	637	190	342	485
Vetvrasje	124	77	47	49	75
Vrasje	86	72	14	43	43

Burimi: INSTAT b, 2008:35

Nga të dhënat statistikore për vitin 2007, numri i vetvrasjeve ishte më i lartë se i vrasjeve, përkatësisht 124 vetvrasje dhe 86 vrasje. Në raport me numrin e përgjithshëm të vdekjeve nga aksidentet, vdekjet nga vetvrasjet përbënin 15.0 për qind të vetvrasjeve, ndërsa vdekjet nga vrasjet 10.4 për qind. Nga 190 vajza dhe gra që kanë vdekur si pasojë e aksidenteve në vitin 2007, 47 ose 24.7 për qind kanë vdekur si pasojë e vetvrasjeve. Nga të dhënat zyrtare, rezulton se gratë vetvriten më pak se burrat. Në vitin 2007, vetvrasjet për burrat zinin 62.1 për qind, ndërsa për gratë zinin 37.9 për qind. Meshkujt vriten pothuajse po aq sa edhe vetvriten, ndërsa gratë vetvriten më shumë se sa vriten. Në vitin 2007, burrat përfaqësonin 51.7 për qind të të vetvrasjeve dhe 48.3 për qind të të vrasjeve, ndërsa gratë përfaqësonin 77.1 për qind të vetvrasjeve dhe 22.9 për qind të të vrasjeve.

Sipas të dhënave të INSTAT për vitin 2007, vetvrasjet zinin 59.1 për qind, ndërsa vrasjet 40.9 për qind, pra numri i vdekjeve nga vetvrasjet ishte më i lartë se sa ai nga vrasjet. Studimet në fushën e mjekësisë, për vitet 2008-2013, i konfirmojnë të dhënat statistikore për rritjen e numrit të vdekjeve nga vetvrasjet, duke vënë në dukje se numri i rasteve të vetvrasjeve e ka tejkaluar atë të vrasjeve: “Për periudhën pesëvjeçare 2008-2013, numri i vdekjeve të shkaktuara nga vetvrasjet ishte 486, ndërsa ai i vdekjeve. Për vitin 2014, në Shqipëri, u regjistruan 205 raste të vdekjeve prej vetvrasjeve, që do të thotë se për 100 mijë banorë u vetvranë 5.93 vetë (WHO, 2015:1).

Më të rrezikuara përsa i përket gjinisë janë grup-mosha 24-35 vjeç për femrat dhe 45-54 vjeç për meshkujt, ndërkohë që ka një rritje të numrit të vetvrasjeve edhe tek moshat e reja sidomos tek grupmosha 15-24 vjeç (WHO, 2003:2). Përgjithësisht, vetvrasjet prekin më shumë burrat se gratë, por gratë kryejnë më shumë tentativa për t'u vetvuarë (Scmidtke, A., & Brille-Brahe, U., 1996:327). Në zonat rurale, dukuria e vetvrasjes është edhe më kritike për vajzat dhe gratë, ku mundësitë për mirëqenie shpirtërore e materiale dhe për një jetë aktive ekonomike e shoqërore janë më të kufizuara se sa në qytete. Siç venë në dukje edhe studimet sociologjike, punët e rënda në fshat rëndojnë më shumë mbi shpatullat e vajzave dhe grave:

“Në shumicën e ekonomive të vogla bujqësore private në fshatra “motori kryesor lëvizës” është puna e gjallë e vajzave dhe grave, e cila përgjithësisht kryhet me ato mjete të thjeshta si në fillim të shekullit XX. Shumica e vajzave dhe grave që punojnë në fshatra janë skllavëruar nga një punë e tillë rraskapitëse. Për më tepër, perspektivat e mekanizimit të punëve në sektorin e bujqësisë duken fare të largëta dhe për faktin se shumica e ekonomive bujqësore janë shumë të vogla, nuk e lejojnë blerjen e teknikave bashkëkohore (Dervishi, Z., 2001:16).

7.4. Vetvrasja si një formë reagimi ndaj paragjytimeve të shumfishta


Me rëndësi në kërkim është evidentimi i tentativave vetvrasëse si një mënyrë reagimi ndaj paragjytimeve. Të dhënat për mënyrën e reagimit ndaj paragjytimeve të mbledhura nëpërmjet anketimit u plotësuan prej të dhënave të mbledhura nga intervistimi i thelluar për shkaqet dhe format e vetvrasjes në rastet e paragjykitimit. Vajzat dhe gratë e anketuara u pyetën nëse kishin menduar ose tentuar të kryenin ndonjëherë vetvrasje për shkak të paragjytimeve ndaj tyre dhe se në cilat situata kishte ndodhur kjo gjë. Gjithashtu, për të specifikuar shkaqet që mund t'i kenë shtyrë vajzat dhe gratë të mendojnë për vetvrasjen si rrugë shpëtimi prej paragjytimeve, në studim u përdorën pyetje të posaçme lidhur me situatat në të cilat vajzat dhe gratë ishin paragjykuar më rëndë dhe se si kishin reaguar ato kur ishin paragjykuar për profile të ndryshme të personalitetit, të karakterit dhe të moralit. Për mënyrën e reagimit ndaj paragjytimeve u pyetën

të gjitha vajzat dhe gratë që u anketuan, të cilat ofruan informacion mbi format më të rënda të paragjyqimeve në adresë të tyre dhe mënyrat e reagimit ndaj tyre.

Nga 672 vajza dhe gra të anektuara, 124 prej tyre ose 18.5 për qind kanë tentuar të vetvriten për shkak të formave të rënda të paragjyqimeve të përdorura në drejtim të tyre nga persona të afërm në mjedisin familjar dhe shoqëror. Paragjykimet që rëndojnë më shumë mbi vajzat dhe gratë në fshat janë ato mbi karakterin, personalitetin dhe moralin. Vajzat dhe gratë në fshat tregohen shumë të kujdeshme për të mos tërhequr vëmndjen mbi veten për të mos u shndërruar në objekt thashethemesh. Ndër mënyrat më të shpeshta të vetvrasjes, vajzat dhe gratë përmendin: helmimin me fotoksinë, vrasjen me pistoletë, mbytje në rezervuarin ose në liqenin e Farkës, varje me litar, kontaktin me rrymën elektrike ose hedhjen përpara makinës për t'u shtypur.

Ndër të anketuarat që kanë menduar të vetvriten, rreth 20.0 për qind kanë menduar të vetvriten *shpeshherë*. Ato kanë qenë nën peshën e rëndë të paragjyqimeve dhe e kanë përjetuar me një intensitet më të madh emocional vuajtjen që i kanë shkaktuar paragjykimet. Kryesisht kanë tentuar të vetvriten gratë e martuara për t'i dhënë fund fjalëve dhe dhunës së ushtruar ndaj tyre nga bashkëshortët dhe familjarët e tij. Në raste të më të rralla, pre e tentativave vetvrasëse kanë rënë edhe vajzat e reja, të cilat janë penguar të dashurojnë dhe janë detyruar të heqin dorë nga dashuria, si pasojë e thashethemeve të shumta për moralin.

Kanë menduar të kryejnë vetvrasje




Rreth 40.0 për qind e vajzave dhe grave të anektuara që janë paragjykuar rëndë për anë të ndryshme të personalitetit, karakterit dhe moralit të tyre kanë menduar *rrallë herë* të kryejnë vetvrasje. Ato janë gjendur më rrallë në ciklonin e paragjyqimeve, por i kanë përjetuar thellë fyerjet dhe denigrimin që kanë pësuar. Janë rreth 40.0 për qind vajzat dhe gratë që e kanë

menduar *një herë* të vetvriten, si pasojë e paragjytimeve të rënda ndaj personalitetit, karakterit dhe moralit të tyre. Megjithëse kanë menduar vetëm një herë për vetvrasjen si rrugëzgjdhje për të mbyllur gojët e liga të njerëzve paragjykses, vajzat dhe gratë në këtë kategori përfaqësojnë një numër të konsiderueshëm të atyre që kanë menduar të vetvriten.

7.4.1. Moshë më e rrezikuar për vetvrasje

Moshë më e rrezikuar për vetvrasje përfaqësohet nga vajzat dhe gratë e grup-moshës 25-34 vjeç, të cilat përfaqësojnë 39.5 për qind të rasteve. Kjo grup-moshë përbën 30.2 për qind të të anketuarave, por paraqet përqindjen më të lartë përse i takon të menduarit për t'u vetvrasur. Përqindja e vajzave dhe grave të grup-moshës 18-24 vjeç që kanë menduar të vetvriten është 30.7 dhe vjen e dyta si grup-moshë e rrezikuar. Në këtë grup-moshë, është veçanërisht shqetësues fakti se ka një prani të lartë të vajzave dhe grave që kanë menduar të vetvriten të moshës 18 dhe 19 vjeç, me rreth 45.8 për qind të rasteve (brenda grup-moshës 18-24 vjeç). Dukuria e vetvrasjes, edhe pse shënon ulje tek grup-moshë 35-44 vjeç, është gjithësesi problematike, pasi në këtë grup-moshë janë 22.6 për qind gratë që kanë menduar të vetvriten.

Mendimet për t'u vetvrasur sipas grup-moshave



Tentativat vetvrasëse tek moshat e reja përbëjnë një dukuri mjaft shqetësuese për familjet dhe shoqërinë shqiptare. Në këtë grup-moshë mbizotërojnë dëshirat për të arritur suksese personale në jetë. Kjo grup-moshë preket nga zhvillime të rëndësishme të jetës, madje më të

rëndësishmet për të gjithë jetën, siç është shkollimi në universitet, zënia me punë, krijimi i lidhjeve intime të qëndrueshme dhe afatgjata që përfundojnë në fejesë dhe martesë, krijimi i familjes dhe shpesh ardhja e fëmijëve në jetë. Në këtë segment të ciklit të jetës, ndaj vajzave dhe grave të reja ushtrohet një trysni e madhe shoqërore për t'ia dalë njëkohësisht në disa fronte, si: shkollë, punë, dhe familje, ndërkohë që ato nuk janë të përgatitura të marrin mbi vete këto përgjegjësi të mëdha dhe të shumëfishta. Për shkak se mund të mos ia dalin t'i përmbushin me sukses të gjitha pritshmëritë në një kohë relativisht të shkurtër të ciklit të jetës, vajzat dhe gratë e grupmoshës 18-24 vjeç mund të përjetojnë përvoja zhgënjyese, që jo gjithmonë varen nga aftësitë dhe dëshira e tyre. Arritjet personale varen shumë edhe nga rrethanat dhe mundësitë që iu jepen nga mjedisi shoqëror. Vajzat dhe gratë e reja në fshat i kanë të kufizuara mundësitë për të ndjekur dëshirat dhe aspiratat rinore. Jeta e tyre përcaktohet më së shumti prej rrethanave mjedisore dhe prej zgjedhjeve që prindërit ose të afërmit e familjes bëjnë për to. Një pjesë e vajzave të moshës 18 dhe 19 vjeç që nuk ndjekin shkollën ndihen thellësisht të dëshpëruara sepse për to jeta shkollore sinjifikon vazhdimësinë e lidhjeve shoqërore dhe mundësinë e vetme për t'u larguar nga fshati.

Mosvazhdimi i shkollës së lartë i dënon vajzat e kësaj moshe me izolim dhe jetë të varfër shoqërore, brenda mureve të shtëpisë. Jeta e tyre përfaqësohet nga një ritual i mërzitshëm punësh rraskapitëse bujqësore dhe shtëpiake. Një pjesë e prindërve stepen t'i dërgojnë vajzat në shkollë të lartë sepse i druhen stilit urban të jetesës, i cili mund të ndikojë në largimin e vajzave nga tutela e kontrollit prindëror dhe mund t'i ekzpozojë ato ndaj rrezikut të shthurjes morale në kryeqytet. Prindërit mundohen t'i fejojnë dhe martojnë vajzat që pas përfundimit të shkollës së mesme, kur ato nuk vazhdojnë shkollën e lartë. Vajzat e kanë të vështirë të pajtohen me mendësi të tilla. Mungesa e vetkontrollit mbi jetën personale dhe kontrollimi i rreptë prindëror ua pamundëson realizimin e dëshirave. Vajzat që kanë mbaruar shkollën e mesme dhe që qëndrojnë mbyllur në shtëpi pas përfundimit të shkollës e konsiderojnë jetën pas shkollës si të pakuptimtë dhe të varfër, si një jetë që nuk ja vlen. Vajzat dhe gratë e grupmoshës 25-34 vjeç janë më të prirura ta mendojnë vetvrasjen. Kushtet e vështira të jetesës në fshat dhe mosvlerësimi i punës rraskapitëse të kryer nga gratë në ekonominë familjare bujqësore e rëndojnë gjendjen shpirtërore të tyre dhe i shtyjnë rreth 39.5 për qind të mendojnë për t'u vetvrasur. Arsyet për të cilat vajzat dhe gratë mendojnë të vetvriten janë të shumta, por ndër më kryesoret janë disa.

Së pari, vajzat dhe gratë në fshat ndodhen nën tryshninë e paragjyqimeve të shumëfishta kundrejt dinjitetit, karakterit, personalitetit, moralit dhe aftësive të tyre. Paragjykimet gjenerojnë një mendësi që zhvlerëson shumë prej veprimtarive që kryhen prej vajzave dhe grave në fshat, si veprimtari pa ndonjë vlerë të madhe ekonomike dhe shoqërore, siç janë përkujdesja, punët e shtëpisë dhe të ekonomisë familjare bujqësore. Këto punë, sipas mendësive patriarkale, janë detyrë funksionale e grve në kulturën rurale, gjë që krijon perceptimin se këto punë janë pjesë e natyrshme ose e lindur e rolit femëror, kur në fakt janë detyra dhe funksione të përcaktuara shoqërisht në përmbushje të rolit shoqëror.

Së dyti, paragjykimet shënojnë shpesh karakterin e vajzave dhe grave. Karakteri është një prej faktorëve të brendshëm me më shumë ndikim në sjelljen njerëzore. Shpesh vajzat dhe gratë paragjyqohen si qenie me karakter të dobët, pasi janë më të dobëta fizikisht se burrat. Perceptimi shoqëror për karakterin femëror ngrihet mbi dallimin në forcë e frikë mes meshkujve dhe femrave. Është fakt i njohur se meshkujt kanë fizik më fortë që u jep përparësi krahasuar me femrat në përballimin e vështirësive që kërkojnë fuqi fizike. Por, fuqia fizike dhe forca e karakterit janë dy gjëra të ndryshme dhe nuk kanë domosdoshmërisht lidhje me njëra-tjetrën. Një grua me një fizik më të dobët se të një burri nuk është *apriori* më e dobët në karakter. Përkundrazi, kujtesa historike e ruajtur në folklorin shqiptar sjell dëshmi të rezistencës heroike të vajzave dhe grave, të cilat të për të mbrojtur veten nga pushtuesit kanë kryer akte kolektive të vetvrasjes, gjë që tregon një forcë të pashembullt karakteri. Vajzat dhe gratë e anketuara pohojnë se janë paragjykuar për karakter të pavendosur dhe të dobët vetëm sepse nuk janë të forta fizikisht dhe ky paragjykim ka shërbyer si justifikim për të rritur kontrollin familjar dhe farefisnor mbi sjelljen e tyre brenda dhe, sidomos, jashtë shtëpisë në marrëdhënie me të tjerët.

Së treti, përveç karakterit, vajzat dhe gratë janë paragjykuar edhe për personalitetin. Personaliteti, formohet përgjatë procesit të shoqërizimit. Bashkë me karakterin, personaliteti është përcaktues i brendshëm i sjelljes. Shpesh, karakteri dhe personaliteti perceptohen si e njëjta gjë dhe ndonjëherë edhe të anketuarat termat karakter dhe personalitet i përdornin si sinonime. Personaliteti ndikohet nga rrethanat dhe kushtet shoqërore, në të cilat shoqërizohen vajzat dhe gratë. Ndikimi kulturor i mendësive rurale për rolin dhe statusin shoqëror të vajzave dhe grave në shoqërinë fshatare ka bërë që ato të vendosen në pozita shoqërore të nënrenditura ndaj burrave. Nënkulura rurale e zonës së Farkës, bashkë me ndikimet islame dhe patriarkale, nxisin tek vajzat dhe gratë formimin e një personaliteti të brishtë që shfaqet në forma të ndryshme si: mungesë

guximi për t'u shprehur, përulësi, pavendosmëri, pazotësi për të vendosur për veten, varësi ndaj personave të rritur, ndaj burrave të familjes, vetëvlerësim të ulët, etj.

Përveç këtyre karakteristikave të nxitura nga normat kulturore, në formimin e personalitetit të vajzave dhe grave ndikojnë edhe paragjykimet e shumta për to, që i konsiderojnë ato si qenie me personalitet të brishtë, të pazonjat t'i dalin zot vetes, të paafta për të marrë vendime, që kanë nevojë të udhëhiqen prej të tjerëve, të merren në mbrojtje që të mos viktimizohen, etj. Një ndikim të konsiderueshëm në gjallimin e këtyre paragjykimeve luan edhe kufizimi i mundësive për vajzat dhe gratë në fshat që nuk i lejon ato të bëjnë një jetë aktive shoqërore, që i le jashtë linjave të informacionit, që i pengon të krijojnë marrëdhënie me të tjerët, etj. Megjithëse vajzat dhe gratë e anketuara shfaqin një personalitet të përshtatur ndaj normave kulturore dhe pritshmërive shoqërore, përsëri ato nuk i shpëtojnë dot “shigjetave të helmatisura” të paragjykimeve në drejtim të personalitetit të tyre.

Janë të shumta dëshmitë e grave që janë paragjykuar për personalitetin prej familjarëve dhe të afërmve të bashkëshortit. Historitë duket sikur janë krijuar nga e njejta regji, edhe pse janë jetuar nga personazhe të ndryshme. Regjia e njëjtë është e tillë sepse ushqehet prej të njejtit burim normash kulturore që nxit qëndrime dhe opinione paragjykuuese ndaj vajzave dhe grave. Në njërën prej bisedave, një mesogrua rrëfeu vuajtjet shpirtërore që i kishin shkaktuar familjarët e bashkëshortit që e paragjykonin vazhdimisht për personalitetin e saj: “Bashkëshorti im ndikohej shumë prej fjalëve të familjarëve të tij. Ne jetonim me ta dhe për timshoq fjala e tyre vlente më shumë se e imja, ata ishin shumë veta kundër meje, kurse unë isha një kundër të gjithëve. Më e keqja ishte se edhe bashkëshorti im rreshtohej në anën e tyre, megjithëse mundohesha të mbrohesh me fakte. Ata e frynin duke i thënë se unë isha pa personalitet, se nuk e dija vendin tim në shtëpi dhe se ngrija krye, madje për ta unë i kisha zënë vendin ndonjë tjetre që e meritonte më shumë vendin e nuses në atë shtëpi se sa unë. Për të mos i dhënë shkas konfliktit, duroja dhe nuk bëja zë, por nuk ja vlente. Sa më urtë sillesha, aq më pak respekt tregonin ata ndaj meje. Isha personi i dorës së fundit në atë shtëpi që thirresha vetëm kur duhej t'u shërbeja dhe jo në emër, por nuse. Ata i ankoheshin bashkëshortit se unë i bëja punët me zor, se nuk vija buzën në gaz kur më urdhëronin nga mëngjesi deri në darkë, se nuk u ktheja “xhevap” kur më kërkonin llogari, etj. Unë dhe bashkëshorti ishim martuar me dashuri. I duroja tekat dhe fyerjet e familjarëve të tij ndaj meje vetëm për hir të dashurisë që kisha për të dhe doja me gjithë shpirt që t'u hyja në zemër dhe të fitoja respektin e tyre. Por ishte e kotë, fjalët e tyre e

helmuan keqas dashurinë tonë dhe martesë na u kthye në ferr. Unë isha shumë e palumtur në atë shtëpi, qaja shpesh, doja të ikja, por prindërit e mi nuk do më pranonin. Kam ngrënë bukë me lot në atë shtëpi. Nuk gjeja më asnjë motiv për të jetuar, isha shumë e pashpresë për gjendjen time. Nuk më rëndonin edhe aq detyrat pafund si shërbëtore se sa fjalët poshtëruese ndaj meje dhe mosreagimi i bashkëshortit tim, i cili dukej se kishte ndryshuar edhe ndjenjat për mua, më dukej sikur nuk më donte më, përdorte fyret e tyre kundër meje, gjë që më dëshpëronte pa masë sepse ai ishte e vetmja arsye që qëndroja aty, që vazhdoja të jetoja. Nuk doja më të trajtohesha si plaçkë, si send pa vlerë në atë shtëpi, si skllave pa emër... Mungesa e mbështetjes së bashkëshortit ma rëndonte vuajtjen që më shkaktonte familjarët e tij. Kam menduar shpesh të vras veten!”. Dëshmi të tilla janë disa. Gjithësesi, ato janë vetëm maja e ajzbergut të vuajtjeve që përjetojnë vajzat dhe gratë në fshat, si pasojë e paragjyqimeve të pabaza që i dhunojnë psikologjikisht.

Së katërti, vajzat dhe gratë paragjyqohen për moralin. Etiketimet në drejtim të moralit zenë më pak vend se sa paragjyqimet në drejtim të karakterit dhe të personalitetit, por janë shumë më të rënda se sa ato. Morali është një çështje me rëndësi kapitale për jetën e vajzave dhe grave në fshat, sepse prej tij varet qëndrimi që do të mbajnë ndaj tyre bashkëshorti, familjarët e bashkëshortit, të afërmit e tij, fqinjët dhe të njohurit. Dyshimet rreth moralit të vajzave dhe grave nxisin një proces ndëshkues ndaj tyre, edhe kur nuk vërtetohen ose kur morali është vënë në diskutim për rrethana që nuk varen prej tyre. Ndodh që edhe kur janë të pafajshme, vajzat dhe gratë të etiketohen si fajtoreshë. Ato mbahen si përgjegjëse për vëmendjen që kanë tërhequr mbi veten kur janë vikimë e ngacmimeve seksuale me justifikimin se ato vetë i kanë provokuar fjalët që thuhet për to. Për fjalët ka një shprehje të urtë: “Ku ka zë, s’është pa gjë!” Të ndodhura në mes të zjarrit të ngacmimeve provokuese dhe rrezikut për ndëshkim edhe kur nuk janë fajtoreshë, vajzat dhe gratë shpesh shkurajohen të flasin kur viktimizohen, ngacmohen, përfliten ose ndëshkohen për moral, pasi druhen se mos duke e bërë të dukshme gjendjen e tyre, jo vetëm që nuk do të gjejnë ngushëllim për atë që u ka ndodhur, por mund të fajësohen edhe me shumë duke rritur valën e thashethemeve dhe duke zgjeruar rrethin e kuriozëve. Paragjyqimet për moralin i detyrojnë vajzat dhe gratë në fshat të vetcensurojnë sjelljet, ndërveprimet dhe komunikimet me të tjerët, si brenda ashtu edhe jashtë rrethit familjar. Paragjyqimet mbajnë ndezur “llampën e kuqe të alarmit” të vetë vajzave dhe grave dhe të të afërmeve të tyre për të ruajtur të panjollë emrin e tyre dhe familjeve. Për të mos u përballur me ndëshkime morale nga ana e bashkësisë fshatare,

familjet fshtare kontrollojnë në mënyrë të rreptë sjelljen, ndërveprimin dhe komunikimin e vajzave dhe grave. Familja dhe farefisi ushtrojnë funksione disiplinuese ndaj sjelljes së vajzave dhe grave me pretekstin se është më mirë që vajzat dhe gratë të vuajnë censurën paralajmëruese në gjirin e familjes se sa të përgojohen për moral.

Akuzat në drejtim të moralit janë veçanërisht të rënda dhe ato nxisin tek vajzat dhe gratë mendime për të vrarë veten. Megjithëse parargykimet për karakterin dhe personalitetin janë më të shpeshta, ato nuk kanë qenë aq me ndikim në nxitjen e mendimeve për të vrarë veten se sa parargykimet dhe fajësimi për çështje të moralit tek vajzat dhe gratë. Në një bisedë, një vajzë në shkollë të mesme, e cila për shkak të fjalëve të shoqeve të shkollës që e përgojonin për moralin e saj, rrezikonte të hiqej nga shkolla prej babait, dëshmoi se kishte menduar të vriste veten, nëse kjo gjë do të ndodhte vërtet: "Në shkollë të mesme më dolën fjalë sikur doja një djalë. Fjalët morën dhenë dhe i shkuan në vesh edhe babait tim, i cili pa më pyetur i mori për të vërteta dhe më kërcënoi se do më hiqte nga shkolla, sepse kisha shkelur besimin e tij dhe kisha çnderuar familjen dhe emrin tim. Unë u tremba për vdekje se kjo gjë mund të ndodhte vërtet dhe mendova që, nëse babai do më hiqte nga shkolla, do ta vrisja veten. Më rëndonte shumë fakti që babai im i merrte për të mirëqena thashethemet dhe nuk më besonte mua. Më vinte edhe shumë inat me shoqet e shkollës që e kishin përhapur këtë thashethem, vetëm sepse një djalë kishte shprehur pëlqimin për mua. I thashë nënës sime që, nëse babai më hiqte nga shkolla, ai thjesht do i bënte qefin për gojuesve dhe do më vriste mua. Sa të jetoja me barrën e një turpi që nuk e kisha bërë dhe të mbyllesha në shtëpi si e burgosuar pa faj, do ishte më e udhës të vrisja veten dhe të shpëtoja edhe nga fjalët, edhe nga zhgënjimi prej babait tim, që i besonte gjithkujt përveç meje. Nëna u alarmua nga fjalët e mia dhe u mundua të më ngushëllonte që mbase do ishte mirë të mos shkoja për pak ditë në shkollë që të harrohej kjo bisedë". Kjo histori e trishtë tregon vuajtjen shpirtërore që etiketimet për çështje nderi u shkaktojnë vajzave të reja, të cilat si rrugë shpëtimi prej tyre mendojnë ndonjëherë edhe vetrasjen.

7.4.2. Niveli arsimor: cilat janë më të rrezikuara për vetvrasje?

Përqindjen më të lartë të vajzave dhe grave që kanë menduar për vetvrasjen e zenë ato me arsim të mesëm. Shumica e të anketuarave janë me shkollë të mesme dhe të papuna. Në pamundësi për të gjetur një punë, për shkak të mungesës së arsimit të lartë, ato e kalojnë gjithë

kohën në shtëpi, duke punuar në ekonominë familjare dhe duke u përkujdesur. Duke qenë shtëpiake, ato janë edhe më shumë në kontakt me familjarët e bashkëshortit dhe fqinjët, që në fshat vazhdojnë të ruajnë traditën e vizitave për kafe tek njëri-tjetri, sidomos gratë, të cilat në fshat e kanë të vështirë të shkojnë nëpër bar-kafenetë e fshatit për të kaluar kohën sepse përgojohen.

Vajzat dhe gratë me arsim të mesëm bëjnë një jetë shumë të mbyllur si shtëpiake, me një rutinë të përcaktuar punësh të rëndomta të ekonomisë familjare, e cila u merr shumë kohë fizike, bashkë me përkujdesjen për të gjithë familjarët e bashkëshortit dhe fëmijët e vet. Ato janë vazhdimisht të vëzhguara për sjelljen dhe komunikimin nga ana e familjarëve të bashkëshortit dhe nga ana e fqinjëve, sepse janë në një kontakt të vazhdueshëm me ta për gjatë gjithë ditës. Shpesh, duke pasur një punë në dorë ose duke ushqyer fëmijën, ato duhet edhe të “sajdisin” ndonjë fqinjë ose ndonjë të afërm që vjen për vizitë dhe që përfundon për drekë a për darkë, gjë që i detyron ato të lenë punët e nisura dhe të merren me nderimin e miqve, siç e dikton tradita e mikpritjes. Gruas i vihet re çdo detaj i sjelljes dhe komunikimit; prej saj pritet të jetë e urtë, kokëulur, të mos tregojë shenja mërzie, të tregohet e gatshme për të shëbyer dhe të jetë e bindur ndaj urdhërave dhe dëshirave të të tjerëve. Është e vështirë për një grua të martuar në fshat të mbajë gjithnjë këtë standard sjelljeje të pëlqyeshme nga tradita. Punët e stërmundimshme në ekonominë familjare dhe shpeshtësia e vizitave të të tjerëve (në fshat nuk ka ndonjë protokoll për vizitat që mund të kryhen në çdo kohë) e pamundësojnë sjelljen që imponon tradita tek gratë. Ato nuk mund të jenë gjithë kohës të qeshura dhe të nusërojnë për orë të tëra gjatë vizitave të të afërmeve dhe farefisit, sepse e kanë kohën të zënë me punë shtëpie dhe bujqësie.

Mungesa e gadishmërisë së vajzave dhe grave për të vepruar në mënyrë stereotipike gjinore, sipas prishmërive të normave tradicionale përkthehet prej të afërmeve dhe fqinjëve si problem personaliteti i vajzave dhe grave, si mosbindje ndaj zakoneve të mira, si qëndrime moderne, e për pasojë të shthurura, etj. Janë të shumta paragjykimet në drejtim të personalitetit për vajzat dhe gratë shtëpiake. Ato paragjykohen se nuk shërbejnë sa dhe si duhet dhe se nuk duan të pranojnë rolin e tyre si “nuse”. Ato paragjykohen në drejtim të personalitetit pikërisht sepse i bëjnë rezistencë normave kulturore. Sipas opinionit në fshat, nëse do ishin vajza dhe gra me personalitet të mirë, do t’i përvetësonin dhe zbatonin me zell dhe dëshirë normat e zakonet, sepse vetëm devotshmëria ndaj rolit si shërbyese do t’i shpërblente me vlerësim kolektiv për sjellje e mirë.

Vajzat dhe gratë, paragjyken shumë edhe në drejtim të karakterit si frikacake, që i druhen ndëshkimit, prandaj, që t'i bëjnë gjërat ashtu siç u kërkohet, ato duhen ndëshkuar. Veçanërisht, gratë me shkollë të mesme dëshmojnë për një shkallë të lartë dhune dhe paragjykimesh në drejtim të tyre nga ana e bashkëshortit dhe e familjarëve të tij. Ato vuajnë edhe mungesën e respektit ndaj tyre, pavarësisht stërmundimit për të shërbyer me përkushtim. Puna në shërbim të tjerëve konsiderohet si funksion i natyrshëm i grave, për të cilin kanë lindur dhe që duhet ta kryejnë pa u pyetur. Ato ndihen shumë të dëshpëruara kur paragjyken dhe përfliten për personalitetin dhe karakterin, ndërkohë që presin të vlerësohen për sakrificën vetjake që bëjnë, duke u shërbyer të tjerëve dhe duke lënë kërkesat e veta të paplotësuara. Shpeshtësia më të cilën paragjyken për personalitetin dhe karakterin i bën të dyshojnë vërtet për vlerat e vetes.


Mosvlerësimi për mundimin që bëjnë për t'u siguruar të tjerëve mirëqenie materiale dhe shpirtërore, si dhe qëndrimi i të tjerëve ndaj punës së tyre, ndonjëherë edhe i depersonalizon. Në vend që të diskutojnë pozitën e tyre të nënrenditur shoqërore dhe qëndrimin denigrues ndaj tyre, ato rropaten edhe më shumë për t'u mbushur mendjen paragjykuesve për të kundërtën. Kur shohin se përpjekje të tilla nuk kanë sukses, ato zhgenjehen dhe e humbin shpresën se pozita shoqërore brenda familjes dhe respekti për punën e tyre do të mund shtohet. Sado përpjekje që të bëjnë për t'u konformuar me normat kulturore, vajzat dhe gratë në fshat mbeten të nëvlerësuara dhe të paragjykuara. Për këtë arsye, një pjesë e tyre e humbin motivin për të jetuar dhe mendojnë për vetvrasjen si rrugë shpëtimi, jo vetëm nga paragjykimet, por edhe nga puna rutinë rraskapitëse e pavlerësuar.

Ndonëse më rrallë se sa për personalitetin dhe karakterin, vajzat dhe gratë me shkollë të mesme paragjyken edhe në drejtim të moralit, sidomos për jetën e mëparshme në shkollë të mesme. Atyre iu bëhet biografia e jetës shkollë, për njohjet dhe kontaktet që kanë pasur me të tjerët, kryesisht djem, përpara se të njihnin bashkëshortët e tyre. Madje edhe kur ndodh që gjërat nuk shkojnë mirë në familje ose kur u bie ndonjë fatkeqësi, ato paragjyken se u kanë ndodhur për një arsye që lidhet me moralin e tyre më shumë se sa me rrethanat. Një grua që prej vitesh nuk lindte fëmijë tregoi pas anketës se si puna e rëndë dhe qëndrimet aspak dashamirëse në familjen e bashkëshortit e kishin stresuar atë aq shumë sa nuk kishte mundur të kishte dot fëmijë për tre vite pas martesë: “Unë isha shumë e re kur u martova dhe meqë isha nusja e vogël, trajtohesha prej të gjithëve si shërbëtoare. Më urdhëronin për çdo gjë, edhe për një gotë ujë. Ngrihesha e para dhe shtrihesha e fundit. Qëndoja gjithë ditën në majë të këmbëve. Kur vinte

darka, më zinte gjumi në këmbë prej lodhjes. Siç e do zakoni, brenda vitit të parë të martesës, nusja duhet të ngelë shtatzënë, por unë nuk po ngelja. Përveç hallit të përgojimit se nuk isha e shkathët sa duhet, se isha e dobët, se më zinte gjumi në këmbë, duhej të duroja edhe fyerjet se nuk po lindja fëmijë si: mushkë, shterpë, barktharë, etj. Isha shumë nervoze dhe më pushtoi ankthi, ca nga sharjet dhe ca nga frika se mund të mos lindja vërtet. Kjo gjendje zgjati dy vjet, jetova ferrin për së gjalli. Ishte e pamundur të isha e qetë në atë shtëpi, ku më paragjykonin çdo minutë se nuk bëja dot fëmijë, madje më thoshin se po më mbaronte afati dhe bashkëshortit tim do t'i gjenin një nuse tjetër. Gati sa nuk u çmenda nga dëshpërimi. Kam menduar disa herë të vras veten, për t'u hakmarrë ndaj tyre, t'ua mbyllja gojën njëherë e mirë”.

Me interes është prirja e lartë që kanë vajzat dhe gratë me arsim të lartë për t'u vetvuarë. Ato përfaqësojnë vetëm 22.0 për qind të të anketuarave, por në lidhje me vetvrasjen ato përbëjnë 36.0 për qind të atyre që kanë menduar për të.

Mendimet për t'u vetvuarë sipas nivelit arsimor



Vajzat dhe gratë me arsim të lartë janë jo vetëm pre e paragjytimeve në fshat, por edhe qëndrimeve denigruese ndaj statusit të tyre si intelektuale. Është paradoksale që vajzat dhe gratë me arsim të lartë të jenë pre e paragjytimeve dhe të mos vlerësohen, në vend që të nderohen, për statusin e tyre arsimor. Në fshat, vajzat dhe gratë me arsim të lartë, edhe pse mund të kenë një status më të lartë punësimi se ato me formim parauniversitar, kanë vuajtur njësoj nënvlerësimin shoqërorë si vajza dhe gra. Pak rëndësi ka për mendësitë rurale patriarkale nëse një vajzë ose grua ka arsim të lartë apo jo, ajo gjithësesi është grua dhe si e tillë i nënshtrohet të gjitha normave kulturore që parashikohen për rolin gjinor, sikurse edhe gratë e tjera më pak të arsimuara. Por, vajzat dhe gratë me arsim të lartë e kanë pasur më të vështirë të konformohen me

mendësitë patriarkale në fshat, sepse për shkak të arsimit të lartë që e kanë marrë duke studiuar nëpër universitete që ndodhen në qytete të mëdha, ato kanë përvetësuar elementë të nënkulturës urbane të qyteteve ku kanë studiuar dhe jetuar për disa vite përgjatë shkollimit të lartë. Gjithashtu, jeta larg shtëpisë dhe fshatit i ka aftësuar të formojnë shprehi të jetesës së pavarur dhe të mbështeten tek zotësitë e veta për të zgjidhur problemet e jetës shkollore. Kur kthehen në fshat, vajzat me shkollë të lartë e kanë të vështirë të pranojnë pa asnjë lloj kritike dhe rezistence të brendshme nënshtrimin që u imponon nënkultura rurale që mbartet në mendësitë e banorëve të fshatit.

Gratë me arsim të lartë artikuloan shumë qartë se sa të vështirë e kishin pasur ato të “bëheshin nuse zakoni” pas përfundimeve të shkollës së lartë në kryeqytet. Një mjeke, në prag pensioni, tregoi se kur ishte në përfundim të studimeve të larta, familja e kishte fejuar me një djalë që kishte përfunduar studimet e larta dhe fill pas diplomimit ishte martuar me të: “Kur hyra nuse në shtëpinë e bashkëshortit gjeta 11 frymë. Të gjithë, sipas zakonit prisnin shërbim prej meje si nuse e re. Për ta nuk kishte rëndësi nëse unë isha vajzë me shkollë, shkolla mund të ishte një plus për ta vetëm nëse unë edhe e shkolluar i bindesha zakonit dhe shërbeja kokëulur dhe pa bërë zë. Bashkëshorti im ishte fëmija e parë dhe pas tij vinin edhe gjashtë të tjerë. Në shtëpinë e tij jetonte edhe gjyshi me gjyshen, përveç prindërve. Vjehrra ime u gëzua shumë që u bë me nuse në shtëpi, se iu shtua një krah për punët rraskapistëse që bënte ajo vetë që nga mëngjesi deri në darkë. Unë u punësova si mjeke në ambulancën e fshatit dhe ndiqja të gjitha rastet si mjeke familje dhe si pediatre. Kisha shumë punë dhe njëherë nuk prisnin të hapej ambulanca kur kishin urgjenca, por trokisnin në derë në mes të natës. Shpesh isha e përgjumur gjatë ditës dhe nuk përqëndroheshja dot. Unë nuk trajtohesha pa respekt në shtëpinë e bashkëshortit, por familjarët e tij prisnin nga unë të isha në rol si nuse zakoni, të përmbushja të gjitha detyrimet që kishte roli i nuses së shtëpisë, pavarësisht se isha e punësuar në punë pa orar. Nga mbingarkesa prej punëve në shtëpi dhe nga tejldhja në profesion, ndonjëherë, nuk ja dilja t’i kryeja mirë punët e shtëpisë që nuk mbaronin kurrë dhe për këtë familjarët e bashkëshortit e shprehnin hapur zemërimin, madje njëherë kunati i vogël të cilit nuk i ishte tharë bluzja që i kisha larë në darkë më qortoi se përse nuk e kisha larë në drekë dhe më tregoi edhe se çfarë priste ai dhe të tjerët në atë shtëpi prej meje: “Në këtë shtëpi të kemi marrë për punë, jo për mjeke!”. Kjo dëshmi tregon se si stereotipet gjinore në lidhje me rolin e gruas në familje nuk kursejnë as vajzat dhe gratë me arsim

të lartë. Kur marrohen, ato janë njësoj të detyruara prej normave kulturore të futen në rolin tradicional të shërbimit, pavarësisht shkollës së arsimit dhe profesionit.

Vajzat dhe gratë me arsim të lartë e kanë të vështirë të pajtohen me norma të tilla që i konsiderojnë ato vetëm në rolin e shërbyeses brenda familjes. Paragjykimet që lidhen me stereotipet gjinore u rëndojnë shumë vajzave dhe grave me shkollë të lartë, pasi ato i kanë sfiduar pjesërisht, në mos krejtësisht, paragjykimet gjinore duke vazhduar arsimin e lartë, duke u larguar për studime në moshë të re, duke gjetur një punë me prestigj shoqëror dhe duke marrë edhe përgjegjësi si drejtuese të njësive publike ku kanë punuar.

Vajzat dhe gratë e anketuara me arsim 8-vjeçar janë përballur më rrallë me mendimet për t'u vetvlarë se sa ato me shkollë të mesme dhe të lartë. Ato janë më të konformuara me rolin gjinor dhe me pritshmëritë që familja dhe shoqëria ka ndaj tyre. Për shkak të qëndrimit të një kohe më të shkurtër në sistemin arsimor, krahasuar me ato me shkollë të mesme dhe të lartë, vajzat dhe gratë me shkollë 8-vjeçare janë ekspozuar më pak ndaj koncepteve të të drejtave të tyre, ndaj kontakteve me bashkmoshatarët pas përfundimit të shkollës dhe kanë bërë një jetë më të izoluar në fshat. Ato janë më të prirura të pranojnë normat tradicionale dhe nuk e kundërshtojnë pozitën e tyre të nënshtruar në familje, pasi mendojnë se e meritojnë këtë status, për shkak të mungesës së arsimit të mesëm dhe të lartë. Gratë me arsim 8-vjeçar shfaqin një vetvlerësim të ulët për aftësitë e tyre, sidomos në lidhje me punësimin, pasi pretendojnë se vetëm arsimi është pasaportë për në tregun e punës, të cilin ato nuk e zotërojnë. Ato janë fejuar dhe martuar në një moshë shumë të re dhe kanë marrë shpejt përgjegjësi për familjen.

Familjet në të cilat kanë shkuar nuse dhe bashkëshortët e tyre gjithashtu kanë nivel të ngjashëm arsimor me të tyrin dhe ndjekin me rigorozitet normat zakonore. Duke qenë se e pranojnë me më shumë vetdije pozitën e tyre të nënrenditur në familje dhe në shoqëri, vajzat dhe gratë me arsim 8-vjeçar kanë edhe më pak mendime kundërshtuese për gjendjen e tyre. Duke e pranuar pa shumë kritikë jetën që bëjnë, ato përjetojnë edhe më pak mendime për t'u vetvlarë për shkak të paragjykimeve ndaj tyre, të cilat i besojnë edhe vetë si të vërteta.

Ato që i kanë shtyrë vajzat dhe gratë me shkollë 8-vjeçare drejt mendimeve për t'u vetvlarë kanë qenë më shumë etiketimet negative për çështje nderi. Ndërkohë që pranojnë me vetëpërlulësi gjendjen e tyre dhe paragjykimet në drejtime të ndryshme për gratë, kur vjen puna tek morali ato shqetësohen dhe i kundërshtojnë me forcë. Gjithësesi, duke jetuar në një mjedis familjar me shumë paragjykimet, ato nuk mund t'i ndalin paragjykimet për moralin femëror, që

sipas njerëzve me të cilët bashkëjetojnë është jo i mirë, djallëzor, dashakeq, ambicioz, egoist dhe lakmitar. Ndonjëherë paragjykimet ndaj moralit femëror përdoren për të justifikuar edhe « fatin e keq të të qenit grua ». Disa gra dëshmuar gjatë bisedave se për familjarët dhe bashkëshortët e tyre gratë i meritonin vuajtjet për shkak të moralit të tyre, qëndrim që ushqehet edhe prej historisë së krijimit në bibël, sipas të cilës Eva me dëshirat e saj egoiste e nxiti në veprime imorale Adamin, gjë për të cilën, krijuesi e dënoi përjetësisht me vuajtje. Kjo histori është kopjuar edhe në Kuran dhe është e përhapur në mendësitë e popullatës myslimane. Njëra prej grave që kishte një fëmijë të paralizuar tregoi se ajo ishte akuzuar nga vjehrra dhe kunatat se fajin për atë fatkeqësi e kishte pasur vetë ajo. Me dëshpërim të hellë dhe lot në sy ajo tregoi: «Kur mësova nga ekografia se fëmija i parë ishte djalë u gëzova shumë, sepse nuset që lindin djem gëzojnë më shumë respekt. Por, gëzimi m'u pre kur lindi djali. Mjekët më thanë se fëmija do të kishte probleme me zhvillimin. Unë u dëshpërova shumë se e kisha fëmijën e parë. Nuk më shkohej në shtëpi, sepse më dukej sikur kisha bërë faj. Vjehrra dhe kunatat më priten me turinj të varur. Djali po rritej mirë dhe dukej sikur nuk do kishte probleme. Por pas muajit të gjashtë ato u bënë të dukshme. E kam qarë për së gjalli atë fëmijë. Por megjithë hallin duhej të duroja edhe fjalët e vjehrrës dhe kunatave sipas të cilave « kot nuk ma kishte dhënë zoti mua një fëmijë sakat, për të zezat që kisha bërë ». Këto sharje më acaruan pa masë dhe ishin burim sherresh në familje. Në vend që t'i kisha ndihmë për fëmijën, ato më rrinin larg. Kaq injorante ishin ato sa mendonin se fëmija ishte ndëshkim për gjynahet e mia. Kam menduar disa herë të vras veten që të shpëtoja nga poshtërimi, por më dhimbsej shumë djali». Dëshmi të tilla provojnë mungesën e informacionit shkencor dhe të etikës në komunikim ndaj grave me shkollë 8-vjeçare. Ato konsiderohen si qenie inferior, meqë kanë arsim të pamjaftueshëm dhe, si të tilla, nënvlerësohen si të paditura, të painformuara dhe të paedukuara.

Vajzat dhe gratë që parapëlqejnë një punë intelektuale, me shumë dinjitet, por me pak të ardhura janë 73.2 për qind e atyre që kanë menduar të kryejnë vetvrasje, ndërsa vajzat dhe gratë që parapëlqejnë më shumë një punë të rëndomtë, por që u siguron shumë të ardhura janë 26.8 për qind e atyre që kanë menduar të kryejnë vetvrasje. Vajzat dhe gratë që parapëlqejnë një punë intelektuale me prestigj janë më të prirura të mendojnë për vetvrasjen si mënyrë shpëtimi nga denigrimi që iu shkaktojnë paragjykimet e shumëlloshme kundër tyre. Edhe të dhënat e një studimi të mëparshëm të ndërmarë në vitin 2000, nga sociologu Zyhdi Dervishi, tregojnë se 71,61 për qind e vajzave dhe grave, në vendin tonë, në kundërshtim me logjikën e ekonomisë së

tregut, e cila kërkon që çdo njeri i aftë për punë të përshtatet shpejt dhe pa paragjykitime në lloje të ndryshme pune, edhe jashtë specialitetit të vet, orientohen më shumë drejt punës intelektuale të keqpaguar, se sa drejt punëve të rëndomta të mirëpaguara, sepse punët e kualifikuara profesionale sigurojnë më shumë “prestigj dhe dukje”(Dervishi, Z., 2001:15).

Vajzat dhe gratë që parapëlqejnë një punë intelektuale që siguron pak të ardhura, në vend të një pune të rëndomtë me shumë të ardhura, mendojnë se puna intelektuale i shpërblen njërëzit në forma jomateriale: *e para* sepse u siguron dinjitet vetjak dhe *e dyta* sepse u jep respekt shoqëror, që dikush në punë të rëndomtë nuk do ta kishte asnjëherë. Duke qenë se dinjiteti vetjak dhe respekti kolektiv kanë vlerë parësore për këto vajza dhe gra, ato janë të gatshme të zgjedhin punë të keqpaguara më shumë se punë të mirëpaguara. Kjo qasje ndaj punës dhe ky “profil aristokratik” në modelimin psikokulturor të vajzave dhe grave është disi problematik në kushtet e ekonomisë së tregut (Dervishi, Z., 2001:16). Është paradoksale që, ndërsa në shumicën e vendeve të industrializuara, njërëzit orientohen drejt punëve më fitimprurëse, në vendin tonë, vajzat dhe gratë orientohen në drejtimin e kundërt, drejt punëve më pak fitimprurëse. Në qëndrimin e vajzave dhe grave ndaj punës intelektuale vihen re reminishenca të trashëgimisë socialiste, në të cilën puna intelektuale ishte më e nderuar dhe më e mirëpaguar se sa punët jointelektuale. Punët jointelektuale ishin kryeshit punë krahu që kryheshin prej njerëzve më pak të arsimuar, të cilët nuk gëzonin ndonjë respekt të madh në sytë e opinionit publik, pavarësisht propagandës ideologjike se “puna është nder dhe lavdi!”. Puna prodhuese në industri dhe bujqësi çmohej shumë prej ideologjisë së Partisë së Punës, pasi prej saj siguroheshin të mirat materiale dhe shërbimet e drejtëpërdrejta. Madje për të zbatuar në praktikë këtë ideologji populiste, gjatë regjimit socialist, në poste vendimmarrëse drejtuese u punësuan punëtorë të thjeshtë, që vinin nga klasa punëtore. Kjo mendësi populiste u zbatua edhe në sektorin e arsimit, ku puna prodhuese, së bashku me formimin ushtarak, u bënë pjesë e programit të detyrueshëm shkollor, për t’i mbajtur të rinjtë të lidhur me prodhimin.

Megjithëse puna prodhuese mori përparësi ndaj punës intelektuale, në realitet kjo e fundit ishte më e vlerësuar moralisht. Intelektualët shiheshin si individë të pajisur me dije nga shkenca, historia dhe artet, për të cilat gëzonin reputacion të madh shoqëror. Pavarësisht perceptimit të përhapur se çdo punë jomanuale ishte punë intelektuale, në fakt, jo të gjithë ata që quheshin intelektualë ishin vërtetë të tillë dhe jo të gjitha punët që nuk ishin punë krahu ishin punë

intelektuale. Në lidhje me perceptimin popullor për inteligjencën në vendin tonë gjatë regjimit socialist, një studim për kulturën, sociologu Zyhdi Dervishi argumenton:

“Sikurse në mjaft prej vendeve ish-socialiste të Lindjes, edhe në shtetin shqiptar të viteve 1945-1990, te shtresa e inteligjencies përfshiheshin të gjithë punonjësit që nuk merreshin profesionalisht me punë fizike, por me punë drejtuese, organizuse e krijuese si drejtuesit administrativë dhe organizatorët e prodhimit e të veprimtarive të tjera të të gjitha niveleve, nga brigadierët deri te ministrat, specialistët e shëndetësisë, personeli inxhiniero-teknik dhe ekonomistët, studiuesit dhe ndihmësit e tyre, shkrimtarët dhe artistët e të gjithë profileve, gazetarët dhe juristët, personeli komandues i të gjitha niveleve në ushtri dhe në struktura të tjera të ruajtjes së rendit, etj. Specialistët të tillë mund të ishin me arsim të lartë, të mesëm ose gjysmë të mesëm. Punonjësit me arsim të lartë dhe shumica e punonjësve me arsim të mesëm, që nuk punonin drejtpërdrejt në prodhim, përfshiheshin tek shtresa e inteligjencies. Përtej interesave politike të regjimit socialist totalitar për të rritur artificialisht numrin e inteligjencies, që konsiderohej si një përparësi e rendit socialist në krahasim me atë kapitalist, në opinionin e kulturuar të shoqërisë shqiptare, edhe në vitet 1945-1990, intelektualë të vërtetë konsideroheshin vetëm ata punonjës me shkollë të lartë, me grada ose tituj shkencorë që merreshin me punë të mirëfilltë krijuese në fushën e arteve, të shkencave dhe të përparimeve teknike dhe kishin arritur rezultate të rëndësishme në fushën përkatëse (Dervishi, Z., 2013:135).

Gjithashtu, puna intelektuale ishte edhe më e vlerësuar financiarisht se sa puna e krahut. Bashkë me prestigjin shoqëror ecte edhe mirëqenia materiale e punës intelektuale. Për këtë arsye, një pjesë e madhe e vajzave dhe grave mendojnë se do të ishte më mirë të kishin një punë intelektuale. Gjatë bisedave pas anketimit, gratë me arsim të lartë, shumica e të cilave ishin mësuese, u shprehën me keqardhje për statusin e nënvlerësuar të profesionit të mësuesisë, sidomos nga pikëpamja financiare.

Në vitet e tranzicionit passocialist, ka rënë edhe respekti për figurën e mësuesit. Mungesa e mekanizmave rregullatore të shtetit në ekonominë e tregut ka bërë që disa profesione, sidomos ato të lidhura me shërbimin publik si mësuesia të shpërblehen pak. Mbivlerësimi i kapitalit financiar më shumë se sa kapitali i dijes në vitet e tranzicionit ka bërë që të vlerësohen si më të vlefshëm ata që kanë grumbulluar kapital financiar, pavarësisht mënyrës se si e kanë mbledhur, se sa ata që kanë ushtruar një profesion që kategorizohet si intelektual. Një mësuese matematike në shkollë të mesme, tregoi se si e kishte përjetuar këtë përmbysje pozicionesh, kur kishte takuar një ish-nxënësen e saj që ishte bërë parukiere: „Shkova një ditë të prisja flokët tek një parukeri që kemi në lagje dhe aty takova një ish-nxënësen time, e cila më tha se ishte edhe pronarja e parukerisë. E përgëzoja për biznesin, siç e quante ajo dyqanin e vogël, ku mezi rrotullohej. Kur mbaroi punë, e pyeta për çmimin. U çudita se ishte shumë i kripur. Ish-nxënësja ime që mezi kishte kaluar të katër vitet e shkollës së mesme fitonte me një prerje flokësh sa paguhesha unë për një ditë pune si mësuese. Nuk i shpëtova dot profesionit dhe i bëra llogaritë me zë të lartë duke i thënë se fitimi i saj ditor mund të ishte sa një javë pune e një mësueseje në shkollë të mesme, ndërkohë që puna e mësueses ishte më e lodhshme dhe kishte më shumë përgjegjësi se sa prerja e flokëve. Nxënësja ime, të cilën paraja e kishte mësuar edhe të fliste, ma preu me ironi: “Epo ju mësuese, si intelektuale që jeni, rrini tërë ditën kot me regjistër në dorë, ndërsa mua më bie bretku në këmbë duke prerë flokë!” E pyeta se mos më mbante mëri ngaqë i kisha vënë nota të ulëta në matematikë (në fakt mezi e kisha kaluar me ndërhyrje) por, ajo me një buzëqeshje të sinqertë u përgjigj: “Përkundrazi, të jam mirënjohëse, sepse po të më kishit vënë nota të mira do shkoja në shkollë të lartë dhe do të përfundoja një copë mësuese! Me paratë prej parukerisë do hap një sallon të madh estetike“. Edhe kjo histori dëshmon qartë se si punët të rëndomta janë më të shpërblyera financiarisht se sa punët intelektuale.


7.5. Në ndihmë të vajzave dhe grave që mendojnë të vetvriten

Në 60.5 për qind të rasteve, vajzave dhe grave që kanë menduar të kryejnë vetvrasje u janë gjendur më pranë nënat dhe motrat, përkatësisht me 37.1 për qind dhe 23.4 për qind. Nënat e kanë të lindur ndjesinë e mbrojtjes së jetës në përgjithësi dhe të mbrojtjes së jetës së fëmijëve të tyre në veçanti. Kur kanë menduar për vetvrasjen, vajzat dhe gratë kanë qenë në momente

dëshpërimi të thellë dhe pa motiv për të jetuar. Këto shqetësime janë vënë re nga nënat dhe motrat e tyre, të cilat, duke e ndjerë rrezikun për humbjen e jetës, kanë reaguar për të parandaluar vetvrasjet me anë të këshillave ose duke i marrë drejtpërdrejt në mbrojtje.

Një ndër arsyet që nënat kanë reaguar me shpejtësi ka qenë edhe shpeshtësia e vetvrasjeve tek vajzat dhe gratë e reja, sidomos në fshatra, për të cilat kanë marrë dijeni nga mediat. Vajzat dhe gratë që kanë tentuar të vetvriten tregojnë se nënat kanë ndërhyrë menjëherë për të ndaluar veprimet që mund të ndërmerren bijat për t'u vetvrasur. Nënat dhe motrat i kanë kuptuar më mirë se kushdo tjetër, pasi ato i kanë kaluar vetë këto përvoja. Njëra nga gratë e reja që kishte menduar për vetvrasjen si një mënyrë për të shpëtuar nga fjalët kishte gjetur ngushëllim tek mbështetja e nënës. Me nota gëzimi ajo e përshkruan kështu historinë e saj: “Po të mos ishte nëna ime, unë nuk do isha gjallë. U martova shumë e re me një burrë shumë më të madh në moshë, i cili punonte në Greqi. Ai vinte shumë rrallë në shtëpi dhe unë kam jetuar me prindërit e tij dhe me kunatat. Nga kjo martesë kam dy fëmijë, të cilët më shumë i kam rritur vetëm. Burri na sillte pak para. Duke qenë se ishim shumë të varfër, mendova të dal e të punoj që të ushqeja fëmijët. Fola me një të afërm nga fisi im që ishte roje i disa pallateve të reja në Selitë dhe ai më gjeti punë si pastruese shkallësh. Unë shkoja në punë për një pagesë fare të vogël, po ishte më mirë se sa pa gjë fare. Në shtëpi vazhdoja punën me turnin e dytë të pastrimit, se kunatat dhe vjehrra prisnin të vija unë që të merresha me shtëpinë dhe fëmijët. Ato më shihnin gjithë dyshim kur kthehesha nga puna dhe filluan të hidhnin fjalë se unë nuk punoja, por bridhja me meshkuj nëpër Tiranë. Edhe kushëririn tim ma vunë si tutor që më gjente klientë. Me këto fjalë helmuan edhe burrin tim, i cili erdhi menjëherë për të më ndarë. Burri, i shtyrë nga vjehrra dhe kunatat, i mori për të vërteta fjalët e tyre dhe më rrahu shumë. Pastaj më tha se dyshonte se fëmijët nuk ishin të tijët. Ai ishte shumë xheloz, por nuk e prisja që të vinte në dyshim edhe atësinë e fëmijëve. Mendova se ai nuk i meritonte fëmijët. Nuk dija ku të shkoja nga fjalët. Nuk doja të jetoja më. Preva damarët në banjë dhe humba ndjenjat. Kur u përmenda, e gjeta veten në spital. Tek koka më rrinte nëna. Dola nga spitali dhe mora mjekim për depresionin. Tani jetoj me nënën dhe fëmijët. Unë vazhdoj pastroj shkallët e pallateve. Tani i marr edhe ata të më ndihmojnë. Nëna na mbledh në darkë. Ajo është engjëlli im”. Histori të tilla, për konflikte familjare dhe për dhunë ndaj grave për arsye xhelozie, thashethemesh dhe paragjykimesh janë të pranishme në fshat.

Iu është gjendur më pranë



Ndërsa në 39.5 për qind të rasteve, vajzave dhe grave që kanë menduar të vetvriten u janë gjetur pranë bashkëshorti (13.7 për qind), babai (12.1 për qind), vëllezërit (8.1 për qind) dhe shoqet e afërta (5.6 për qind). Bashkëshortët, edhe pse kanë qenë për vete abuzues, sidomos në fillimet e marrëdhënies bashkëshortore, si pasojë e ndikimit mbi ta të paragjytimeve, stereotipeve gjinore, përgojimit dhe thashethemeve në adresë të bashkëshorteve të tyre prej familjarëve dhe të afërmeve, pasi kanë mundur të informohen për pavërtetësinë e stereotipeve dhe të përfoljes, kanë reaguar ndaj fjalëve në adresë të bashkëshorteve të tyre, duke i marrë këto të fundit në mbrojtje, sidomos në momente kritike për jetën. Në familjet e veta, bashkëshortët, janë personat më të afërt për gratë e martuara. Duke qenë se pjesa më e madhe e thashethemeve burojnë nga familjarët dhe të afërmit e bashkëshortit, dhe më rrallë nga fqinjët e tij, gratë i drejtohen bashkëshortëve për t'i marrë në mbrojtje nga familjarët.

Baballarët vijnë pas bashkëshortëve në rradhën e mbrojtësve. Ata i mbrojnë bijat e tyre nga mendimet për t'u vetvrrarë, duke i ndihmuar me këshilla dhe duke folur me bashkëshortët për rrezikun që u kanoset vajzave të tyre. Baballarët në fshat, ndonëse kanë qenë të ashpër ndaj bijave, kur këto kanë qenë vajza, tregohen më të butë dhe mirëkuptues kur bijat martohen. Duke i rritur bijat me norma patriarkale, baballarët mendojnë se i kanë përgatitur ato për jetë martesore. Kur bijat iu keqtrajtohen, për shkak të paragjytimeve për karakterin, personalitetin dhe veçanërisht për moralin, baballarët shqetësohen shumë dhe nuk e tolerojnë sjelljen denigruese ndaj bijave. Për një baba në fshat, kthimi i bijës së martuar mbrapsht, ose divorci është një fatkeqësi e madhe. Ai do ndihej shumë i turpëruar për ndarjen e së bijës, pasi në fshat ajo që bëhet me faj për ndarjen është gruaja dhe jo burri. Sipas mendësive fshatare, të ndikuara thellësisht edhe nga kodet e normave kulturore tradicionale, megjithë zbehjen e tyre në ditët e

sotme, kur ndahet një çift, fajin e ka gruaja, e cila nuk ka qenë e zonja të durojë fatin e saj në shtëpi të burrit. Aq më tepër, që sipas normave të nënkulturës rurale, gruaja ndahet kur nuk i bindet burrit dhe familjarëve të tij. Burri i martuar nuk e ndan gruan menjëherë, por pasi i ka dhënë disa paralajmërime në formë qortimi, goditjeje dhe rrahjeje, dhe nëse ai dhe familjarët e tij përsëri janë të pakënaqur nga sjellja e gruas, e ndan. Pothuajse të gjitha vajzat dhe gratë e anketuara pohuan se dhuna psikologjike dhe fizike e familjarëve dhe e bashkëshortëve janë të zakonshme ndaj tyre.

Prindërit në fshat, sidomos nënat përgjithësisht i udhëzojnë bijat të durojnë dhe të përshtaten me rregullat e të jetuarit në një familje rurale patriarkale. Ata i edukojnë vajzat për një jetë të tillë dhe e kanë të vështirë të besojnë se bijat e tyre, pas një edukimi të gjatë me normat e kulturës patriarkale në fshat, nuk i zbatojnë ato në familjet e bashkëshortëve të tyre. Jeta seksuale e vajzave dhe e grave në fshat është shumë e kontrolluar nga meshkujt e familjes dhe shkarjet morale do ishin të rralla, në mos të pamundura sepse merren vesh shumë shpejt. Prandaj, akuzat ndaj moralit të vajzave dhe grave nuk tolerohen prej baballarëve. Ata kanë marrë çdo masë që morali i bijave të tyre të jetë i panjollë duke i edukuar vajzat të vetpërmbahen dhe të censurojnë kontaktet me meshkujt jashtë lidhjeve fisnore. Për këtë arsye, baballarët i marrin në mbrojtje bijat, kur ato paragjykojnë, përfliten dhe ndëshkohen për moral nga ana e bashkëshortëve, familjarëve, të afërmeve dhe fqinjëve të tij.

Vëllezërit, edhe pse të fundit në rradhën e mbrojtësve në familjen e vajzave dhe grave që kanë menduar për vetvrasjen, janë identifikuar si mbrojtësit më të besueshëm të tyre. Duke dashur t'i mbyllin vetë problemet me bashkëshortët dhe familjarët e bashkëshortëve, gratë pohojnë se nuk kanë dashur t'i përfshijnë familjarët e tyre në konflikte. Ato mundohen të mbajnë jashtë këtyre konflikteve sidomos vëllezërit, të cilët duan t'i ruajnë nga përleshjet fizike. Është e lavdërueshme ndjenja përkujdesëse e motrave karshi vëllezërve edhe në kushtet kur ato vetë janë në rrezik për jetën. Gratë pohojnë se vëllezërit, nëse do mësonin për gjendjen e rrezikuar të motrave dhe për mendimet e tyre për t'u vetrvarrë, do të tregoheshin shumë të dhunshëm dhe hakmarrës ndaj bashkëshortëve të motrave. Vëllezërit, nën ndikimin e ndjenjës së dashurisë së thellë për motrat e pambrojtur në një shtëpi të huaja, mund të ndërmarrin akte ekstreme vetgjyqëse për të vënë në vend dinjitetin e nëpërkëmbur të motrave.

Vëllezërit janë personat më të prirur për të mbrojtur motrat, por mbahen qëllimisht të painformuar nga motrat, të cilat e dinë se hakmarrja e tyre mund të jetë e pamëshirshme. Një

grua e shpehu në mënyrë shumë lakonike dhe të qartë arsyen se përse vëllezërve u kërkohet më rrallë ndihmë: “Vëllezërit janë mbrojtës të flaktë të dinjitetit dhe moralit të motrave. Ata është më mirë të mbahen larg zjarrit të konfliktit, të cilin, në vend që ta shuajnë, mund ta ndezin edhe më shumë. Ata i kanë shumë inat njerëzit që i cënojnë motrën. Për vëllain motra është një qenie engjëllore, pa mbrojtje, në duart e bashkëshortit dhe familjarëve të tij. Do ishte shumë e lehtë për një motër të përdorte vëllain për të vënë dinjitetin e saj në vend, por unë nuk do ta bëja, për arsyen se vëllai im nuk do tregonte mëshirë ndaj bashkëshortit tim. Unë nuk kam nevojë ta vërtetoj që vëllai im do t’ia merrte shpirtin kujtdo që do më lëndonte mua me fjalë, sidomos për moralin. Ai i ka dhënë këto prova kur isha në shkollë të mesme, kohë në të cilën nuk m’u afrua asnjë djalë për të më propozuar, sepse vëllai im ua “thyente turinjtë” duke menduar që ishin mashtues që do përfitonin nga naiviteti dhe çiltersia ime”. Vëllezërit kanë qenë mbrojtësit më të zellshëm për 8.1 për qind të vajzave dhe grave që kanë menduar vetvrasjen. Për shkak se vëllezërit përbëjnë një kërcënim real për përfolësit, ndërhyrja paralajmëruese e tyre merret shumë seriozisht prej këtyre të fundit.

REFERENCAT

- Allport, Gordon, W.: *The nature of prejudice*, (25th anniversary edition), London: Unabridged, 1979
- Andrea, Fotaq: Faik Konica dhe fillesa të sociologjisë shqiptare. Revista shkencore akademike *Lente Sociologjike*, Vëllimi2, Nr.1(3):26-43, 2012
- Arendt, Hannah: *Ndërmjet të shkuarës dhe të ardhmes: tetë ese në mendimin politik*, Shtëpia Botuese "Onufri", Tiranë, 1998
- Barber, Elizabeth, W.: *Women's work: the first 2000 years*. New York, New Heaven, 1994
- Basow, Susan: *Stereotipet dhe rolet gjinore*, Shtëpia Botuese "Dituria", Tiranë, 2003
- Bell, Judith: *Doing your research project*, (4th edition), Open University Press, London, 2005
- Bentley, Jerry, H. & Ziegler, Herbert, F.: *Traditions and encounters: A global perspective on the past*, McGraw-Hill Companies, New York, 2003
- Bernstein, Anne, E., & Lenhart, Sharyn, A.: *The psychodynamic treatment of women*, American Psychiatric Press, Washington DC, 1993
- Blackwell-Stratton, M., Breslin, M. L., Mayerson, A. B. and Bailey, S.: Smashing Icons: Disabled Women and the Disability and Women's Movement, in M. Fine and A. Asch (Eds.), *Women with Disabilities: Essays in Psychology, Culture and Politics*, Temple University Press, Philadelphia, 1988
- Bourdieu, Pierre: *Masculine Domination*, Stanford University Press, Stanford, 2001
- Brannon, Linda: *Gender, a psychological perspective*, Allan & Bacon, Massachusetts, 1996
- Bronwyn, Davies: Becoming male or female. In Jackson, Stevi and Scott, Sue, "*Gender: a sociological reader*", Routledge, London, 2002
- Bryman, Allan, *Social Research Methods*, (2nd edition), Oxford University Press, Oxford, 2004
- Burazeri G., Bregu A., Qirjako G., Roshi E., Petrela K., Bukli M., Achtenberg P.: *Raporti Shëndetësor Kombëtar 2014: Gjendja shëndetësore e popullatës shqiptare*, Instituti i Shëndetit Publik, Tiranë, 2014
- Canaj (Abazi), Elidiana: *Ndikimi i mendësive fisnore*, Vështrim Sociologjik, Botimet "Toena", Tiranë, 2008
- Chodorow, Nancy, J.: *Femininities, masculinities, sexualities: Freud and beyond*, Free Association Books, London, 1994
- De Beauvoir, Simone: *Seksi i dytë*, Vëllimi i parë, Shtëpia Botuese "Çabej", Tiranë, 2003
- De Beauvoir, Simone: *Seksi i dytë*, Vëllimi i dytë, Shtëpia Botuese "Çabej", Tiranë, 2003
- De Gaay, Fortman: Dilemmas of transition: The case of Albania, In Fatos Tarifa and Max Spoor (editors), *The first decade and after: Albania's democratic transition and consolidation in the context of South Eastern Europe*, Institute of Social Studies Cestraad, The Hague, 2000

- Dervishi, Zyhdi: Veçori të anketimit për dukuri demografike në realitetin shqiptar, *Revista Demografike*, 1(1):43-53, 1998
- Dervishi, Zyhdi, a: *Gratë në syrin e ciklonit të sfidave dhe perspektiva*, (Botimi i dytë), Shtëpia Botuese “Jerusalem”, Tiranë, 2001
- Dervishi, Zyhdi, b: Urbanizimi i jetës së popullsisë fshatare apo ruralizimi i qyteteve? Rasti i Tiranës, *Revista “Politika & Shoqëria”*, 1(8):33-41, 2001
- Dervishi, Zyhdi: *Firte me plagët*, Shtëpia Botuese “Jerusalem”, Tiranë, 2003
- Dervishi, Zyhdi: *Adoleshentët: bashkëjetesë me demonët e konflikteve*, (Botimi i tretë). Tiranë, Shtëpia Botuese “Jerusalem”, 2005
- Dervishi, Zyhdi, a: *Sociologjia: per shkollën e mesme, (Ribotim)*, Shtëpia Botuese “SHBLSH e re”, Tiranë, 2008
- Dervishi, Zyhdi, b: *Lente të ndërveprimit simbolik*, Shtëpia Botuese “Emal”, Tiranë, 2008
- Dervishi, Zyhdi: *Gratë në turbulencat e mendësive dhe realiteti politik*, Shtëpia Botuese “Emal”, Tiranë, 2010
- Dervishi, Zyhdi: *Vullnetarizimi: ind shumëfunksional i shoqërisë*, Shtëpia Botuese “Emal”, Tiranë, 2011
- Dervishi, Zyhdi: *Nëpër degëzime të kulturës shqiptare*, Emal, Tiranë 2013
- Durkheim, Emile: *Le suicide*, FB Editions (Botimi i parë 1897), Paris, 2015
- Durkheim, Emile: *Suicide, a Study in Sociology*, (Translated version in English by John A. Spaulding and George Simpson), The Free Press, Glencoe, Illinois, 1930
- Dewey, John: *Democracy and Education* (1st publication in 1910), Dover Publications, New York, 2004
- Dewey, John: *Experience and education*, MacMillan, New York, 1938.
- Di Leonardo, Micaela: *Warrior Virgins and Boston Marriages: Spinsterhood in History and Culture*, In Gary David Comstock and Susan E. Henking, (editors), *Que(e)ring Religion: A Critical Anthology*, The Continuum Publishing Company, New York, 1997
- Dickemann, Mildred: *The Balkan Sworn Virgins: A Cross-Gendered Female Role*, In Stephen O. Murray and Will Roscoe, (editors), *Islamic Homosexualities: Culture, History and Literature*, University Press Book, New York, 1997
- Durham, Mary Edith: *Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera për Shqipërinë dhe shqiptarët*, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1990
- Engels, Frederik: *Orgjina e familjes, e pronës private dhe e shtetit*, (Botim me rastin e 100-vjetorit të lindjes), Shtypshkronja “Mihal Duri”, Tiranë, 1976
- Erikson, Erik, H.: *Identity, youth and crisis*, W.W. Norton & company, New York, 1968
- European Commission: *Enlargement Strategy and main challenges 2013-2014*, Brussels, 16.10.2013
- Fisher, Claude. S.: *The urban experience*, Harcourt Brace Jovanovich, California, 1976

- Foucault, Michel: *Histori e Seksualitetit: Vullnet për dije*, Shtëpia Botuese “Dukagjini”, Pejë, 1970
- Fraser, Nancy: *Justice interrupts: critical reflections on the “post-socialist” condition*, Routledge, New York, 1997
- French, Elizabeth, G., & Lesser, Gerald, S.: Some characteristics of the achievement motive in women, *Journal of Abnormal-Social Psychology*, 68(2):119-128, 1964
- Friedan, Betty: *The feminine mystique*, Norton Company, New York, 1963
- Fuga, Artan dhe Dervishi, Zyhdi: *Ndërmjet fshatit dhe qytetërimit global: Integrimi i të rinjve të zonave fshatare në dritëhijet e arsimit të mesëm*, Trajtesë sociologjike, Shtëpia Botuese “Jerusalem”, Tiranë, 2002
- Gazeta “Bashkimi”, 3.1.1967
- Gazeta “Bashkimi”, 15.1.1967
- Gazeta “Bashkimi”, 18.1.1967
- Gazeta “Bashkimi”, 19.1.1967
- Gazeta “Bashkimi”, 24.1.1967
- Gazeta “Bashkimi”, 25.3.1967
- Gazeta “Bashkimi”, 28.3.1967
- Gazeta “Bashkimi”, 29.3.1967
- Gazeta “Bashkimi”, 3.10.1967
- Gazeta “Bashkimi”, 4.10.1967
- Gazeta “Bashkimi”, 5.10.1967
- Gazeta “Bashkimi”, 6.10.1967
- Gazeta “Bashkimi”, 4.1.1968
- Gazeta “Bashkimi”, 6.2.1968
- Gazeta “Bashkimi”, 10.2.1968
- Gazeta “Bashkimi”, 20.3.1970
- Gazeta “Zeri i Popullit”, 6.11.1967
- Gazeta “Zëri i Popullit”, 22.05.1970
- Gazeta “Shqiptarja”, 31.03.2015
- Giambutas, Marija: *The living goddesses*, University of California Press, California, 2001
- Giddens, Anthony: *Sociologjia*, Shtëpia Botuese “Çabej”, Tiranë, 1997
- Gilligan, Carol: *In a different voice*, Harvard University Press, Harvard, 1982
- Gilligan, Carol, Lyons, Nona, P., and Hanmer, Trudy, J.: *Making connections: the relational worlds of adolescent girls at Emma Willard School*, Harvard University Press, Cambridge, 1990
- Gjermani, E., Taga, I., Tahsini, I. & Meshi, M.: *Doracak i ofruesve të shërbimeve për mbrojtjen e viktimave të trafikimit*, Shtëpia Botuese “Media Print”, Tiranë, 2008
- Goldberg, Philip: *Society*, Springer, 5(5):28-30, 1968
- Gray, David: *Doing research in the real world*, Sage Publication Ltd, London, 2007

- Goci, Haxhi: *Kanuni i Krahinës së Bendës*, Shtëpia botuese “Ombra GVG”, Tiranë, 2010
- Gjeçov, Shtjefën: *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Shtëpia Botuese “Kuvendi”, Lezhë, 1998
- Gjergji, Andromaqi: *Mënyra e jetës në shekujt XII-XX*, Shtypshkronja “Kotti”, Korçë, 2002
- Hasluck, Margaret Masson Hardie: *The Unwritten Law in Albania*, University Press, California, 1954
- Hoxha, Shefqet: *Kanuni i Lumës*, Shtëpia botuese “Pavarësia”, Tiranë, 2013
- Illia, Frano: *Kanuni i Skanderbegut*, Editrice la Rosa, Milot, 1993
- Instituti i Statistikës i Republikës së Shqipërisë (INSTAT): *Vjetari statistikor i arsimit*, Tiranë, 1998
- Instituti i Statistikës, (INSTAT) a: *Femra dhe meshkuj në Shqipëri 2004*, Shtypshkronja “Morava”, Tiranë, 2005
- Instituti i Statistikës, (INSTAT) b: *Tregues të shëndetit, 1999-2003*, Shtypshkronja “Morava”, Tiranë, 2005
- Instituti i Statistikës, (INSTAT) a: *Femra dhe meshkuj në Shqipëri 2007*, Shtypshkronja “Albshop”, Tiranë, 2008
- Instituti i Statistikës, (INSTAT) b: *Shkaqet e vdekjeve 2007*, Shtypshkronja “Albshop”, Tiranë, 2008
- Instituti i Statistikës, (INSTAT): *Femra dhe meshkuj në Shqipëri 2008*, Shtypshkronja “Albdesign”, Tiranë, 2009
- Instituti i Statistikës i Republikës së Shqipërisë (INSTAT): *Censusi i popullsisë dhe i banesave 2011*, Tiranë, 2012
- Instituti i Statistikës së Republikës së Shqipërisë (INSTAT): *Femra dhe Meshkuj në Shqipëri 2012*, Tiranë, 2013
- Instituti i Statistikës së Republikës së Shqipërisë (INSTAT): *Femra dhe Meshkuj në Shqipëri 2013*, Tiranë, 2014
- Instituti i Statistikës së Republikës së Shqipërisë (INSTAT): *Arsimi: Nxënës të regjistruar në shkollat e mesme*, Tiranë, 2015, URL: <http://www.instat.gov.al/al/themes/arsimi.aspx?tab=tabs-4>
- Instituti i Studimeve Pedagogjike: *Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar*, Vëllimi I, Shtëpia Botuese “Nënë Tereza”, Tiranë, 2003
- Jackson, Stevi, & Scott, Sue: *Gender: A sociological reader*, Routledge, London, 2002
- Jefferson, Thomas: A bill for the more general diffusion of the knowledge, In P. L. Ford, *The writings of Thomas Jefferson*, Putnam, New York, 1893
- Jenkins, Lori, Musha, Kalie & Molnar, David: *Udha e Shqipërisë drejt demokracisë: një magjepsës në tranzicion*, ORT/USAID, Tiranë, 1999
- Këngë popullore të Luftës NCL dhe të periudhës së ndërtimit socialist*, vëllimi 3, pregatitur nga Haxhihasani, Qemal; Mustaqi Arsen; Vasili Kozma, botuar nga Akademia e Shkencave e RPSH, Tiranë, 1976
- Kimmel, Michael, S.: *The gendered society*. Oxford University Press, New York, 2000

- Komisioni Qendror për Arsimin, Nënkomisioni për analizën e zhvillimit të shkollës, *Për revolucionarizimin e metëjshëm të shkollës sonë*, Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë, 1969
- Komuna Farkë: *Analiza dhe vleresimi i thelluar i situatës ekzistuese, Komuna Farkë: Plani vendor 2012*, Tiranë, Komuna Farkë, 2012
- Konica, Faik: *Vepra*, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1993
- Konica, Faik: Essai sur l'éducation, *Revista Albania* (1898), Botuar me pseudonimin Trank Spirobeg. Perkthyer nga Fotaq Andrea dhe botuar në Revistën shkencore akademike *Lente Sociologjike*, Vëllimi 2, Nr.1(3):9-26, 2012
- Lerner, Gerda: *The Creation of Patriarchy*, Oxford University Press, New York, 1986
- Levack, Brian, P.: *The witch-hunt in early modern Europe*, Routledge, New York, 2013
- Liddle, Joanna & Joshi, Rama: Gender and Imperialism in British India, *Review of Women Studies*, *Economic and Political Review*, 22(4):72-78, 1985
- Lule, Edmond: *Mendime për reformën në arsim*, Filara, Tiranë, 2009
- Martin, Patricia. Y: “Said and done” versus “Saying and doing”: Gendering Practices, *Practicing Gender at Work*, *Gender & Society*, 17(3):342-366, 2003
- Mazari, Natasha: *Koncepti i zhvillimit rajonal për Qarkun e Tiranës: Orientimet strategjike për zhvillimin rajonal 2012-2017*, Këshilli i Qarkut Tiranë, Tiranë, 2012
- Oakley, Anne: Interviewing Women: A contradiction in terms, in H. Roberts (ed.) *Doing Feminist Research*, Routledge & Kegan Paul, London, 1981
- Öhrn, Elisabeth: Marginalization of democratic values: a gendered practice of schooling? *Journal of Inclusive Education*, 5(2):319-328, 2001
- Orenstein, Peggy: *Schoolgirls: Young women, self-esteem and the confidence*, Anchor, CA, 1995
- Orstein, Allan, C., & Hunkins, Francis, P.: *Kurrikula: Baza, Parime, Probleme*, (Botimi i 3-të), Instituti i Studimeve Pedagogjike, Tiranë, 2003
- Papalia, D. E., Olds, S. W. & Feldman, D.R.: *Human Development*, (11th edition), McGraw-Hill Publishers, New York, 2008
- Parsons, Talcott: “Family structure and the socialization of the child”, in T. Parsons and R. Bales (eds) *Family: Socialization and interaction process*, Routledge, London, 1956
- Plumbi, Olga: Gruaja Shqiptare: Feminizmi dhe shoqëria jonë, *Revista Përpyjekja Shqiptare*. Nr.16, Prill 1938, Ribotuar nga Gjermani, E., & Dauti, M., në *Antologji: Studime Gjinore*, Shtëpia Botuese “Mediaprint”, Tiranë, 2012
- Policia e shtetit: Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit në Seminarin Kombëtar për ndjekjen dhe hetimin e veprave penale të trafikimit të personave, qershor 2014, *Faqja zyrtare e Policisë së Shtetit*, aksesuar më 31 mars 2015: <http://www.asp.gov.al/index.php/janar-2014/124-fjala-e-drejtorit-te-pergjithshem-te-policise-se-shtetit-ne-seminarin-kombetar-per-ndjekjen-dhe-hetimin-e-veprave-penale-te-trafikimit-te-personave>

- Pomeranz, Keneth: *The great divergence: China, Europe and the making of the modern world economy*, Princeton University Press, Princeton, 2009
- Pomeroy, Sarah, B.: *Goddesses, Whores, Wives and Slaves in Classical Antiquity*, Knoph Doubleday Publishing Company, New York, 2011
- Post, Susan E. Pritchett: *Women in Modern Albania*, McFarland & Company, North Carolina, London, 1998
- Qirjako, G., Burazeri, G., Amursi, G., Mersini E., Bukli, M.: *Vlerësimi i sjelljeve të lidhura me shëndetin tek fëmijët e moshës shkollore*. Instituti i Shëndetit Publik të Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2013
- Ridgeway, Cecilia. L. and Correll, Shelley, J.: Unpacking the Gender System: A Theoretical Perspective on Gender Beliefs and Social Relations, *Gender & Society*, 18(4):510-531, 2004
- Risman, Barbara. J.: Gender as a Social Structure: Theory Wrestling With Activism, *Gender & Society*, 18(4):429-450, 2004
- Robson, Colin: *Real World Research*, (2nd edition), Black Well Publishing, MA, 2002
- Rush, Benjamin: *A plan for the establishment of the public schools*, Thomas Dobson, Philadelphia, 1796
- Sadikaj, Dilaver: *Lëvizja për emancipimin e plotë të gruas në vitet 1967-1970*, Botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 1982
- Sadker, Myra & Sadker, David.: *Failing at Fairness: How America's Schools Cheat Girls*, Simon and Schuster, Washington, 2010
- Skëndo, Lumo (Frashëri Mit'hat): *Udhëtarët e huaj në Shqipëri gjer në fund të shek.XIX*, Përmbledhje shkrimesh te Revistës "Dituria" 1909-1929, (Përgatitur për botim nga Luan Malltezi dhe Sherif Delvina), Shtëpia Botuese "Eurorilindja", Tiranë, 1999
- Spencer, Herbert: *Education: Intellectual and physical*, Appleton, New York, 1860
- Stanley, Liz & Wise, Sue: What's wrong with socialization? In Jackson, Stevi & Scott, Sue (Eds.), *Gender: A sociological reader*, Routledge, London, 2002
- Shatzmiller, Maya: *Labour in the Medieval Islamic World*, Brill, New York, 1993
- Tirta, Mark: *Etnologjia e përgjithshme*, Shtëpia Botuese "Geer", Tiranë, 2001
- Topalloglu, Beqir: *Gruaja ne Islam*, (Përkthyer nga Mit'hat Hoxha), Universiteti Marmara, Stamboll, 1997
- Thio, Alex: *Sociology*, (2nd edition), Harper & Row, New York, 1989
- Ugolini, Luigi. M.: *Shqipëria e lashtë: gjurmime arkeologjike*, Origjinali i botuar më 1927, Shtëpia botuese "Migjeni", Tiranë, 2009
- Vini, Aleks: *Traditat zakonore në qytetin e Elbasanit*, (Përgatiti për botim Kreshnik Belegu dhe Ortensa Dakli), Shtëpia Botuese "Rama Graf", Elbasan, 2010
- Weinreich, Helen: Sex role socialization, in J. Chetwynd and O. Hartnett (eds) *The sex role system*, Routledge, London, 1978

- Webster, Noah: *Dissertations on the English Language*, Isai Thomas, Boston, 1989
- West, Candace & Zimmerman, Don: Doing gender. *Gender and Society*, (1):125-151, 1987
- Wolf, Margery: *Revolution postponed: women in contemporary China*, Stanford University Press, Stanford, 1985
- Yin, Robert, K.: *Case Study Research: Design and Methods*, (4rth edition), *Applied Social Research Methods Series*, Volume 5, Thousand Oaks, Sage, CA, 2009
- Young, Antonia: *Women Who Become Men: Albanian Sworn Virgins*, Berg, Oxford, 2000
- Young, Antonia and Rice, Jenna: De-centering Albanian Patriarchy: Sworn Virgins and the re-negotiation of Gender Norms in the Post-communist Era, (Pages: 163-175), In Andrea Hemming, Gentiana Kera and Enriketa Pandlemonji, (editors), *Albania: Family, Society and Culture in the 20-th Century*, LIT Verlag Gmbh & Co., Berlin: 2012

SHTOJCA

PYETSORI I ANKETES

ANKETË

(Për çdo pyetje jepni vetëm një përgjigje duke shënuar në rreth numrin përbri përgjigjes së saktë)

Seksioni 1: të dhënat socio-demografike

I. VENDBANIMI: _____

II. SA VJEÇ JENI? ____ vjeç

III. CILI ËSHTË NIVELI MË I LARTË I SHKOLLIMIT TUAJ?

- 1- Fillor
- 2- 8-vjecar
- 3- I mesëm
- 4- I lartë në specialitetin e: _____
- 5- Gradë ose titull shkencor _____

IV. CILIT BESIM I PËRKISNI?

- 1- Protestant
- 2- Katolik
- 3- Ortodoks
- 4- Mysliman syni
- 5- Bektashi
- 6- Tjetër (shëno _____)

V. SA SHPESH I FREKUENTONI INSTITUCIONET FETARE?

- 1- Çdo ditë
- 2- Një herë në javë
- 3- Një herë në muaj
- 4- Me raste festash fetare
- 5- Asnjëherë

0 – Nuk di/pa përgjigje

VI. NËSE KENI VIZITUAR VENDE TE SHENJTA (SI KISHA E LAÇIT, SALI SALLTIKU, DERVISH HATIXHEJA, ETJ) PËRSE I KENI FREKUENTUAR?

- 1- Me shpresën për t'u shëruar nga ndonjë sëmundje e caktuar
- 2- Me shpresën për t'u shëruar ndonje nga familjarët tuaj nga një sëmundje e caktuar
- 3- Me shpresën për mbarësi në jetën intime dhe familjare
- 4- Tjetër (shëno: _____)

VII. CILA ËSHTË GJENDJA JUAJ CIVILE?

- 1- Beqare
- 2- E martuar
- 3- Bashkëjetuese
- 4- E divorcuar
- 5- E ve
- 6- Nënë me fëmijë e pamartuar

VIII. CILI KA QENË VENDBANIMI JUAJ I MËPARSHËM?

- 1- Rrethi _____
- 2- Qyteti _____
- 3- Fshati _____

IX. NËSE KENI FËMIJE, SA KENI?

- 1- Nuk kam fëmijë
- 2- Një fëmijë
- 3- Dy fëmijë
- 4- Tre fëmijë
- 5- Katër fëmijë
- 6- pesë fëmijë
- 7- Më shumë se pesë fëmijë

X. KUSH JETON ME JU NË FAMILJE?

- 1- Bashkëshorti
- 2- Bashkëjetuesi
- 3- Fëmijët
- 4- Prinderit e bashkëshortit
- 5- Motra/motrat e bashkëshortit
- 6- Vëllai/vëllezërit e bashkëshortit
- 7- Prindërit tuaj
- 8- Tjetër (shëno _____)

XI. KUSH I SIGURON TË ARDHURAT KRYESORE NË FAMILJE?

- 1- Unë

- 2- Bashkëshorti
- 3- Bashkëjetuesi
- 4- Prindërit e bashkëshortit
- 5- Motrat e bashkëshortit
- 6- Vëllezërit e bashkëshortit
- 7- Femijët
- 8- Ndhimë nga të afërm në vend
- 9- Ndhimë nga të afërm emigrantë
- 10- Tjetër (shëno: _____)

Seksioni 2: të dhënat për punësimin

XII. NË CILIN SEKTOR JENI PUNËSUAR?

- 1- Punëtore në sektorin publik
- 2- Specialiste me arsim të lartë në sektorin publik
- 3- Në ekonominë private pronë e burrit
- 4- Punëtore në një firmë private të huaj
- 5- Specialiste në një firmë private të huaj
- 6- Punëtore në një firmë private shqiptare
- 7- Specialiste në një firmë private shqiptare
- 8- Punësuar në ekonominë pronë vetjake tuajën
- 9- Studente e sistemit të ditës
- 10- Studente e sistemit me kohë të pjeshme
- 11- E papunë
- 12- Pensionsite
- 13- E dypunësuar në sektorin publik dhe privat

XIII. SA SHPESH JU KA NDODHUR TE KONFLIKTOHENI ME DREJTUESIT NË PUNË?

- 1- Çdo javë
- 2- Dy-tre herë në muaj
- 3- Më rrallë se një herë në muaj
- 4- Asnjëherë

0 – Nuk di/pa përgjigje

XIV. CILAT JANE MOTIVET PER TE CILAT KONFLIKTOHENI ME PRONARIN/PRONARËT?

- 1- Kërkesa të padrejta të pronarit për të abuzuar me ligjet me qëllim që ai të përfitojë në mënyrë të paligjshme
- 2- Paragjykime përçmuese të pronarit për aftësitë tuaja profesionale
- 3- Abuzim me pagën
- 4- Paragjykime përçmuese për bindjet politike
- 5- Paragjykime përçmuese për besimin fetar
- 6- Paragjykime përçmuese për origjinën krahinore
- 7- Keqkuptime të rastit në komunikim
- 8- Gabime në punë
- 9- Ngacmime seksuale nga pronari
- 10- Tjetër (shëno: _____)

XV. CILAT JANË MOTIVET PËR TË CILAT KONFLIKTOHENI ME DREJTUESIT E NJËSISË KU PUNONI?

- 1- Kërkesa të padrejta të drejtuesit/drejtuesve që të përfitojnë në mënyrë të paligjshme
- 2- Paragjykime përçmuese të drejtuesit/drejtuesve për aftësitë tuaja profesionale
- 3- Abuzime të drejtuesve me pagën tuaj
- 4- Paragjykime përçmuese të drejtuesit/drejtuesve për bindjet tuaja politike
- 5- Paragjykime përçmuese të drejtuesit/drejtuesve për bindjet tuaja fetare
- 6- Paragjykime përçmuese për origjinën krahinore
- 7- Keqkuptime të rastit në komunikim
- 8- Gabime në punë
- 9- Ngacmime seksuale nga ana e drejtuesi/drejtuesve
- 10- Tjetër (shëno _____)

XVI. CILAT JANË OPINIONET TUAJA KRYESORE NË LIDHJE ME PUNËN E KRYER NGA GRATË?

Sa përputhet mendimi juaj me pohimet e mëposhtme për qëndrimin e grave ndaj punës?	Shkalla e përputhshmërisë				
	Shumë	Disi	Pak	Aspak	Pa përgjigje
a- Gratë janë më punëtore se burrat	1	2	3	4	0
b- Gratë janë më korrekte në marrëdhëniet e punës se sa burrat	1	2	3	4	0
c- Gratë janë më modeste se burrat për punën që kryjnë	1	2	3	4	0
d- Gratë kanë më pak pretendime për pagën se sa burrat për të njejtën punë	1	2	3	4	0

e- Gratë nuk ankohen kur paguhen më pak se sa e meritojnë	1	2	3	4	0
f- Gratë nuk ankohen kur u veshtirësohen kushtet e punës ose kur u shtohet ngarkesa	1	2	3	4	0
g- Gratë janë më pak të korruptueshme se burrat	1	2	3	4	0
h- Gratë e respektojnë ligjin më korrektësisht se burrat	1	2	3	4	0
i- Gratë bëjnë punë vullnetare më shumë se burrat	1	2	3	4	0
j- Gratë ankohen më pak se burrat për kushtet jo të përshtatshme të punës	1	2	3	4	0
k- Gratë ndihen inferiore ndaj burrave në punë	1	2	3	4	0

SEKSIONI 3: PARAGJYKIMET GJATË KOHËS SË SHKOLLIMIT

XVII. NGA KUSH JENI PARAGJYKUAR MË SHUMË NË SHKOLLËN 8-VJEÇARE?

- 1- Nga shokët
- 2- Nga shoqet
- 3- Nga të afërm të fisit të babait
- 4- Nga të afërm të fisit të nënës
- 5- Nga fqinjët
- 6- Nga mësuesit meshkuj
- 7- Nga mësueset vajza
- 8- Nga mësueset gra

XVIII. SA SHPESH JENI NDJERË E PARAGJYKUAR?

- 1-Çdo ditë
- 2-Çdo javë
- 3-Çdo muaj
- 4-Më rrallë se një herë në muaj
- 5-Asnjëherë

0 – Nuk di/pa përgjigje

XIX. NËSE JENI PARAGJYKUAR, CILI KA QENË SHKAKU KRYESOR I PARAGJYKIMIT?

- 1- Për mënyrën tuaj të veshjes
- 2- Për mënyrën tuaj të sjelljes
- 3- Për cilësitë tuaja fizike (gjatesinë, peshën, flokët, ngjyrën e lëkurës)
- 4- Për besimin tuaj fetar
- 5- Për origjinën tuaj krahinore (zonën nga vini)
- 6- Për origjinën fshatare
- 7- Për mënyrën e të folurit dhe dialektit
- 8- Për aftësitë tuaja
- 9- Tetër (shëno:_____)

XX SHKRUANI DISA ETIKETIME PËRÇMUJES QË PËRDORESHIN MË SHPESH KUNDËR JUSH NË SHKOLLËN 8-VJEÇARE: _____

XXI. NGA KUSH JENI PARAGJYKUAR MË SHUMË NË SHKOLLËN E MESME?

- 1- Nga shokët
- 2- Nga shoqet
- 3- Nga të afërm të fisit të babait
- 4- Nga të afërm të fisit të nënës
- 5- Nga fqinjët
- 6- Nga mësuesit meshkuj
- 7- Nga mësueset vajza
- 8- Nga mësueset gra

XXII. SA SHPESH JENI PARAGJYKUAR?

- 1- Çdo ditë
 - 2- Çdo javë
 - 3- Çdo muaj
 - 4- Më rrallë se një herë në muaj
 - 5- Asnjëherë
-

0 – Nuk di/pa përgjigje

XXIII. NËSE JENI PARAGJYKUAR, CILI KA QENË SHKAKU I PARAGJYKIMIT?

- 1-Për mënyrën tuaj të veshjes
- 2-Për mënyrën tuaj të sjelljes
- 3-Për cilësitë tuaja fizike (gjatësinë, peshën, flokët, ngjyrën)
- 4-Për besimin tuaj fetar
- 5-Për origjinën tuaj krahinore (zonën nga vini)
- 6-Për origjinën fshatare
- 7-Për mënyrën e të folurit dhe dialektit
- 8-Për komunikimet me djemtë
- 9-Për komunikimet me mësuesit meshkuj
- 10- Për aftësitë tuaja
- 11- Tjetër (shëno) _____

XXIV. SHKRUANI ETIKETIMET PËRÇMUESE QË JANË PËRDORUR KUNDËR JUSH NË SHKOLLËN E MESME? _____

XXV. NGA KUSH JENI PARAGJYKUAR MË SHUMË NË SHKOLLËN E LARTË?

- 1-Nga shokët
- 2-Nga shoqet
- 3-Nga të afërm të fisit të babait
- 4-Nga të afërm të fisit të nënës
- 5-Nga fqinjët
- 6-Nga pedagogët meshkuj
- 7-Nga pedagoget vajza
- 8-Nga pedagoget gra

XXVI. SA SHPESH JENI PARAGJYKUAR?

- 1- Çdo ditë
 - 2- Çdo javë
 - 3- Çdo muaj
 - 4- Më rrallë se një herë në muaj
 - 5- Asnjëherë
-

0 – Nuk di/pa përgjigje

XXVII. NËSE JENI PARAGJYKUAR, CILI KA QENË SHKAKU I PARAGJYKIMIT?

- 1- Për mënyrën tuaj të veshjes
- 2- Për mënyrën tuaj të sjelljes
- 3- Për komunikimet tuaja me djemtë
- 4- Për cilësitë tuaja fizike (gjatësinë, peshën, flokët, ngjyrën)
- 5- Për besimin tuaj fetar
- 6- Për origjinën tuaj krahinore (zonën nga vini)
- 7- Për origjinën fshatare
- 8- Për mënyrën e të folurit dhe dialektit
- 9- Për aftësitë tuaja
- 10- Për komunikimet tuaja me pedagogët meshkuj
- 11- Për komunikimet tuaja me meshkuj të tjerë
- 12- Për komunikimet tuaja me meshkujt nëpërmjet internetit
- 13- Tjetër (shëno: _____)

XXVIII. SHKRUANI ETIKETIMET PËRÇMUESE QË JANË PËRDORUR KUNDËR JUSH NË SHKOLLËN E LARTË?

SEKSIONI 4: PARAGJYKIMET NË FAMILJEN E BASHKËSHORTIT

XXIX. NGA KUSH JENI PARAGJYKUAR ME SHUMË NË FAMILJEN E BASHKËSHORTIT?

- 1-Nga familjarë të të fejuarit para fejesës
- 2-Nga të afërm të të fejuarit para fejesës
- 3-Nga familjarë të të fejuarit gjatë fejesës
- 4-Nga të afërm të të fejuarit gjatë fejesës
- 5-Nga familjarë të bashkëshortit pas martesës
- 6-Nga të afërm të bashkëshorti pas martesës
- 7-Nga familjarë të bashkëshortit pasi jeni bërë nënë
- 8-Nga të afërm të bashkëshortit pasi jeni bërë nënë
- 9-Nga fqinjët e familjes së bashkëshortit
- 10- Nga bashkeshorti gjate fejeses

11- Nga bashkeshorti gjate marteses

12- Nuk jam paragjykuar

XXX. CILI JU KA PARAGJYKUAR MË SHUMË NË FAMILJEN E BASHKËSHORTIT?

- 1- Bashkëshorti
- 2- Vjehri
- 3- Vjehrra
- 4- Vëllai i bashkëshortit
- 5- Gruaja e vëllait të bashkëshortit
- 6- Motra e bashkëshortit
- 7- Nuk jam paragjykyar

XXXI. SA SHPESH JENI PARAGJYKUAR?

- 1- Çdo ditë
- 2- Çdo javë
- 3- Çdo muaj
- 4- Më rrallë se një herë në muaj
- 5- Asnjëherë

0 – Nuk di/pa përgjigje

XXXII NËSE JENI PARAGJYKUAR, CILI KA QENË SHKAKU I PARAGJYKIMIT?

- 1-Për mënyrën tuaj të veshjes
- 2-Për mënyrën tuaj të sjelljes
- 3-Për cilësitë tuaja fizike (gjatësinë, peshën, flokët, ngjyrën)
- 4-Për besimin tuaj fetar
- 5-Për origjinën tuaj krahinore (zonën nga vini)
- 6-Për origjinën tuaj fshatare
- 7-Për mënyrën e të folurit dhe dialektit
- 8-Për aftësitë tuaja
- 9-Për mungesë takti në komunikim me familjarët e bashkëshortit
- 10- Për mungesë takti në komunikim me të afërmit e bashkëshortit
- 11- Për kujdes të pamjaftueshëm për fëmijët
- 12- Tjetër (shëno) _____

XXXIII. SHKRUANI ETIKETIMET PËRÇMUESE QË JANË PËRDORUR KUNDËR JUSH PREJ TYRE?

SEKSIONI 5: PARAGJYKIMET NË VENDIN E PUNËS

XXXIV. NGA KUSH JENI PARAGJYKUAR MË SHUMË NË NDËRMARRJEN/INSTITUCIONIN PUBLIK KU PUNONI?

- 1- Nga kolegët burra
- 2- Nga koleget vajza
- 3- Nga koleget gra
- 4- Nga drejtues burra të niveleve të ulëta
- 5- Nga drejteuse vajza të niveleve të ulëta
- 6- Nga drejtuese gra të niveleve të ulëta
- 7- Nga drejtues burra të nivelit të mesëm
- 8- Nga drejteuse vajza të niveleve të mesme
- 9- Nga drejtuese gra të niveleve të mesme
- 10- Nga drejtues burra te nivelit të lartë
- 11- Nga drejtuese vajza të nivelit të lartë
- 12- Nga drejtuese gra të nivelit të lartë
- 13- Nga vartësit tuaj
- 14- Nga vartëset tuaja

XXXV. SA SHPESH JENI PARAGJYKUAR?

- 1- Çdo ditë
- 2- Çdo javë
- 3- Çdo muaj
- 4- Më rrallë se një herë në muaj
- 5- Asnjëherë

0 – Nuk di/pa përgjigje

XXXVI. NËSE JENI PARAGJYKUAR, CILI KA QENË SHKAKU KRYESOR I PARAGJYKIMIT?

- 1-Për arsimin tuaj të pamjaftueshëm
- 2-Për aftësitë tuaja të pamjaftueshme

- 3-Për mënyrën tuaj të veshjes
- 4-Për mënyrën tuaj të sjelljes
- 5-Për cilësitë tuaja fizike (gjatesinë, peshën, flokët, ngjyrën)
- 6-Për besimin tuaj fetar
- 7-Për origjinën tuaj krahinore (zonën nga vini)
- 8-Për origjinën fshatare
- 9-Për komunikimet tuaja me eprorët meshkuj
- 10- Për komunikimet tuaja me vartësit meshkuj
- 11- Për komunikimet tuaja me punëtorët meshkuj
- 12- Për komunikimet tuaja me meshkujt në rrjetet sociale
- 13- Për mënyrën e të folurit dhe dialektit
- 14- Tjetër (shëno:_____)

XXXVII. SHKRUANI ETIKETIMET PËRÇMUESE QË JANË PËRDORUR PREJ TYRE KUNDËR JUSH:

XXXVIII. NGA KUSH JENI PARAGJYKUAR MË SHUMË NË **FIRMËN PRIVATE** KU KENI PUNUAR?

- 1- Nga kolegët burra
- 2- Nga koleget vajza
- 3- Nga koleget gra
- 4- Nga drejtues burra të niveleve të ulëta
- 5- Nga drejtuese vajza të niveleve të ulëta
- 6- Nga drejtuese gra të niveleve të ulëta
- 7- Nga drejtues burra të niveleve të mesme
- 8- Nga drejtuese vajza të niveleve të mesme
- 9- Nga drejtuese gra të niveleve të mesme
- 10- Nga drejtues burra të nivelit të lartë
- 11- Nga drejtuese vajza të nivelit të lartë
- 12- Nga drejtuese gra të nivelit të lartë
- 13- Nga vartësit tuaj burra
- 14- Nga vartëse tuaja vajza
- 15- Nga vartëset tuaja gra

XXXIX. SA SHPESH JENI PARAGJYKUAR?

- 1- Çdo ditë
- 2- Çdo javë
- 3- Çdo muaj
- 4- Më rrallë se një herë në muaj
- 5- Asnjëherë

0 – Nuk di/pa përgjigje

XL. NËSE JENI PARAGJYKUAR, CILI KA QENË SHKAKU KRYESOR I PARAGJYKIMIT?

- 1-Për mungesë takti në komunikim nga ana juaj
- 2-Për mënyrën tuaj të veshjes
- 3-Për mënyrën tuaj të sjelljes
- 4-Për cilësitë tuaja fizike (gjatesinë, peshën, flokët, ngjyrën)
- 5-Për besimin tuaj fetar
- 6-Për origjinën tuaj krahinore (zonën nga vini)
- 7-Për origjinën fshatare
- 8-Për mënyrën e të folurit dhe dialektit
- 9-Për aftësitë tuaja
- 10- Për komunikimin me pronarin/pronarët meshkuj të firmës.
- 11- Për komunikimin me drejtuesin/drejtuesit meshkuj të firmës
- 12- Tjetër (shëno:_____)

XLI. SHKRUANI ETIKETIMET PËRÇMUESE QË JANË PËRDORUR KUNDËR JUSH PREJ TYRE?

XLII. NGA KUSH JENI PARAGJYKUAR MË SHUMË NË FIRMËN/INSTITUCIONIN EDUKATIV/KULTUROR NË TË CILIN JENI **PRONARE**?

- 1- Nga punonjësit burra
- 2- Nga punonjëset vajza
- 3- Nga punonjëset gra
- 4- Nga nepunësit burra
- 5- Nga nepunëset vajza
- 6- Nga nga nepunëset gra
- 7- Nga rivalët tuaja në njësitë analoge

- 8- Nga pronare gra të njësive që zhvillojnë veprimtari ekonomike në fushë tjetër nga ajo e firmës tuaj.
- 9- Nga vajza ose gra, me të cilat jeni konfliktuar para se të organizonit njësinë tuaj private
- 10- Nga burra me të cilët jeni konfliktuar para se të organizonit njësinë tuaj private
- 11- Nga nëpunës të shtetit
- 12- Nga nëpunëse të shtetit
- 13- Nga të njohurit tuaj

XLIII. SA SHPESH JENI PARAGJYKUAR?

- 1- Çdo ditë
- 2- Çdo javë
- 3- Çdo muaj
- 4- Më rrallë se një herë në muaj
- 5- Asnjëherë

0 – Nuk di/pa përgjigje

XLIV. NËSE JENI PARAGJYKUAR, CILI KA QENË SHKAKU I PARAGJYKIMIT?

- 1. Xhelozia për arritjet tuaja
- 2. Dyshimi se për të arritur suksesin ju keni bërë shumë abuzime me zbatimin e ligjeve të shtetit
- 3. Dyshimi se për të arritur suksesin ju keni abuzuar me punën e punëtorëve
- 4. Dyshimi se për të arritur suksesin ju keni abuzuar me punën e nëpunësve dhe specialistëve që keni punësuar
- 5. Dyshimi se për të arritur suksesin ju keni abuzuar moralisht
- 6. Për mënyrën tuaj të veshjes
- 7. Për cilësitë tuaja fizike (gjatësinë, peshën, flokët, ngjyrën)
- 8. Për besimin tuaj fetar
- 9. Për origjinën tuaj krahinore (zonën nga vini)
- 10- Për origjinën fshatare
- 11- Për mënyrën e të folurit dhe dialektit
- 12- Për aftësitë tuaja
- 13- Tjetër (shëno:_____)

XLV. SHKRUANI ETIKETIMET PËRÇMUJES QË JANË PËRDORUR PREJ TYRE KUNDËR JUSH?

XLVI. NË CILAT RRETHANA JU KANË PARAGJYKUAR MË DENDUR DHE MË HIDHUR?

- 1- Kur keni zbatuar me korrektësi ligjet e shtetit
- 2- Kur keni abuzuar me ligjet e shtetit në favour të interesave tuaja

0 -Pa përgjigje

SEKSIONI 6: REAGIMET NDAJ PARAGJYKIMEVE

XLVII. ÇFARË EMOCIONESH JU KANË PROVOKUAR PARAGJYKIMET NDAJ JUSH?

- 1- Bezdi
- 2- Neveri për ata që ju kanë paragjykuar
- 3- Urrejte për ata që ju kanë paragjykuar
- 4- Mëshirë për ata që ju kanë paragjykuar
- 5- Nuk kam ndjerë asgjë

0 – Nuk di/pa përgjigje

XLVIII. SI REAGONI KUR NDJEHENI E PARAGJYKUAR PËR ÇËSHTJE TË RËNDËSISHME TË PUNËS TUAJ?

- 1- I shpërfillni paragjykimet
- 2- Përpiqeni të provoni se paragjykimet nuk qëndrojnë
- 3- I kundërvihen paragjytimeve me paragjytime
- 4- Hakmerreni në forma të ndryshme ndaj njerëzve që ju paragjykojnë
- 5- Tjetër (shëno _____)

0 – Nuk di/pa përgjigje

XLIX. SI REAGONI KUR JENI PARAGJYKUAR PËR ANË TË NDRYSHME TË PERSONALITETIT, TË KARAKTERIT, TË MORALIT TUAJ?

- 1- I shpërfillni paragjykimet
- 2- Përpiqeni të provoni se paragjykimet nuk qëndrojnë
- 3- I kundërvihen paragjytimeve me paragjytime
- 4- Hakmerreni në forma të ndryshme ndaj njerëzve që ju paragjykojnë
- 5- Tjetër (shëno _____)

0 – Nuk di/pa përgjigje

L. KUR JENI NDJERË E PARAGJYKUAR **RËNDË** PËR ANË TË NDRYSHME TË PERSONALITETIT, TË KARAKTERIT, TË **MORALIT** TUAJ, SI KENI MENDUAR TË REAGONI?

- 1- Të dhunoni verbalisht personin/personat që ju kanë paragjykuar
- 2- Të ankoheni te drejtuesit ose nëpunësit e strukturave përkatëse kundër personave që ju kanë paragjykuar
- 3- T'i drejtoheni organeve përkatëse të drejtësisë
- 4- Të dhunoni fizikisht personin/personat që ju kanë paragjykuar
- 5- Ta vrisni personin që ju ka paragjykuar më rëndë
- 6- Tjetër reagim (Shëno: _____)

0 – Nuk di/pa përgjigje

LI. KUR JENI NDJERË E PARAGJYKUAR **RËNDË** PËR AFTËSITË TUAJA **PROFESIONALE**, SI KENI MENDUAR TË REAGONI?

- 1- Të dhunoni verbalisht personin/personat që ju kanë paragjykuar
- 2- Të ankoheni te drejtuesit ose nëpunësit e strukturave përkatëse kundër personave që ju kanë paragjykuar
- 3- T'i drejtoheni organeve përkatëse të drejtësisë
- 4- Të dhunoni fizikisht personin/personat që ju kanë paragjykuar
- 5- Ta vrisni personin që ju ka paragjykuar më rëndë
- 6- Tjetër reagim (Shëno: _____)

0 – Nuk di/pa përgjigje

LII. KUR JENI PARAGJYKUAR **RËNDË** PËR ANË TË NDRYSHME TË PERSONALITETIT, TË KARAKTERIT, TË MORALIT TUAJ, A KENI MENDUAR TË **LARGOHENI NGA SHQIPËRIA**?

- 1- Shpeshherë
- 2- Rrallë herë
- 3- Vetëm një here
- 4- Asnjëherë

0 – Nuk di/pa përgjigje

LIII. KUR JENI PARAGJYKUAR **RËNDË** PËR ANË TË NDRYSHME TË PERSONALITETIT, TË KARAKTERIT, TË MORALIT TUAJ, A KENI MENDUAR **NDONJËHERË TË KRYENI VETËVRASJE**?

- 1- Shpeshherë
- 2- Rrallë herë
- 3- Vetëm një here
- 4- Asnjëherë

0 – Nuk di/pa përgjigje

LIV. NËSE KENI MENDUAR TË KRYENI VETËVRASJE NGA TRYSNIA E PARAGJYKIMEVE, JU LUTEMI PËRSHKRUANI SHKURTIMISHT NJË SITUATË TË TILLË?

SEKSIONI 7/1: VLERAT

LIV. CILAT JANË **TRI VLERAT** QË ÇMONI MË SHUMË (SHËNO ME I MË TË RËNDËSISHMEN DHE ME III MË PAK TË RËNDËSISHMEN) NË TABELËN E POSHTËSHËNUAR?

1- Pasurimin	I	II	III
2- Singëritetin	I	II	III
3- Shpirtin human	I	II	III
4- Tolerancën	I	II	III
5- Çiltërsinë	I	II	III
6- Arsimimin	I	II	III
7- Shpirtin konkurrues	I	II	III
8- Bujarinë	I	II	III
9- Dinjitetin vetjak	I	II	III
10- Atdhetarinë	I	II	III
11- Tjetër (Shëno _____)	I	II	III

0 – Nuk di/pa përgjigje

SEKSIONI 7/2: QËNDRIMET

LVI. ÇFARË PARAPËLQENI MË SHUMË?

- 1- Një punë të rëndomtë por që të siguron shumë të ardhura
- 2- Një punë intelektuale që të siguron prestigj të lartë, por pak të ardhura

0 – Nuk di/pa përgjigje

LVII. CILIN DO TË URRENIT MË SHUMË?

- 1- Një person që ju prish imazhin me paragjykime të ndryshme
- 3- Një person që ju dëmton ekonomikisht

0- Pa përgjigje

LVIII. ME CILIN DO TË PARAPËLQENIT MË SHUMË PËR TË BASHKËPUNUAR?

- 1- Me një person që të ndihmon shumë, por është paragjykues?
- 2- Me një person që nuk të ndihmon, por nuk është paragjykues?

0 – Nuk di/pa përgjigje

LIX. PËRSHKRUANI SHKURTIMISHT MENDIMIN TUAJ PËR PARAGJYKIMET DHE NJERËZIT PARAGJYKUES:

LX. SI KENI REAGUAR NDAJ PERSONAVE QË KANË PARAGJYKUAR NJERËZIT TUAJ TË AFËRM?

- 1- Jeni përpjekur të hidhni poshtë paragjykimet?
- 2- Jeni konfliktuar me paragjykuesin/paragjykuesit
- 3- Keni ndërprerë komunikimet me paragjykuesin/paragjykuesit
- 4- Nuk keni reaguar

0 – Nuk di/pa përgjigje

SEKSIONI 8: TË KËRKUARIT NDIHMË PËR T’U MBROJTUR NGA PARAGJYKIMET

LXI. KUR JENI NDJERË E PARAGJYKUAR RËNDË PËR ÇËSHTJE QË KANË TË BËJNË ME DINJITETIN TUAJ, A KENI KËRKUAR NDIHMËN E VËLLAIT/VËLLEZËRVE?

- 1- Shpesh
- 2- Rrallë

- 3- Shumë rrallë
- 4- Asnjëherë

0 – Nuk di/pa përgjigje

LXII. KUR JENI NDJERË E PARAGJYKUAR RËNDË PËR ÇËSHTJE QË KANË TË BËJNË ME DINJITETIN TUAJ, A KENI KËRKUAR NDIHMËN E **MOTRËS/MOTRAVE**?

- 1- Shpesh
- 2- Rrallë
- 3- Shumë rrallë
- 4- Asnjëherë

0 – Nuk di/pa përgjigje

LXIII. KUR JENI NDJERË E PARAGJYKUAR RËNDË PËR ÇËSHTJE QË KANË TË BËJNË ME DINJITETIN TUAJ, A KENI KËRKUAR NDIHMËN E TË FEJUARIT, TË **BASHKËSHORITIT**, TË BASHKËJETUESIT?

- 1- Shpesh
- 2- Rrallë
- 3- Shumë rrallë
- 4- Asnjëherë

0 – Nuk di/pa përgjigje

LXIV. KUR JENI NDJERË E PARAGJYKUAR RËNDË PËR ÇËSHTJE QË KANË TË BËJNË ME DINJITETIN TUAJ, A KENI KËRKUAR NDIHMËN E **SHOKUT/SHOKËVE MË TË AFËRT**?

- 1- Shpesh
- 2- Rrallë
- 3- Shumë rrallë
- 4- Asnjëherë

0 – Nuk di/pa përgjigje

LXV. KUR JENI NDJERË E PARAGJYKUAR RËNDË PËR ÇËSHTJE QË KANË TË BËJNË ME DINJITETIN TUAJ, A KENI KËRKUAR NDIHMËN E **SHOQES/SHOQEVE MË TË AFËRTA**?

- 1- Shpesh
- 2- Rrallë
- 3- Shumë rrallë

4- Asnjëherë

0 – Nuk di/pa përgjigje

LXVI. KUR JENI NDJERË E PARAGJYKUAR RËNDË PËR ÇËSHTJE QË KANË TË BËJNË ME DINJITETIN TUAJ, **KUSH** JU ËSHTË GJETUR MË PRANË?

- 1- Babai
- 2- Nëna
- 3- Motra/motrat
- 4- Vëllai/vëllezërit
- 5- I fejuari
- 6- Bashkëshorti
- 7- Bashkëjetuesi
- 8- Një shoqe e afërt
- 9- Një shok i afërt
- 10-Një kushërirë e afërt
- 11-Një kushëri i afërt

0 - Pa përgjigje